REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE 2013

Vëllimi I

Botues:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Bordi redaktues:

Prof. Dr. Enver Hasani, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Snezhana Botusharova, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese
Zt. Almiro Rodrigues, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese
Dr. Arbëresha Raça-Shala, Sekretare e Përgjithshme e Gjykatës Kushtetuese

Kontribuesit:

Mr. Volkmar Theobald, Menaxher i projektit, GIZ
Znj. Pranvera Ejupi- Hajzeraj, Kordinatore e projektit, GIZ
Z. Lavdim Krasniqi, Ekspert Ligjor
Z. Fatos Xhelili, Ekspert
Ligjor Premium Consulting

© 2014 Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Të drejtat e autorit:

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetesh, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përjashtim i përgjegjësisë:

Sipas nenit 116.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila është burim primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mbizotëron versioni i botuar në Gazetën Zyrtare.

Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Përmbledhja e vendimeve dhe aktgjykimeve është përpiluar nga "Projekti për Reformë Juridike" implementuar nga Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ), dhe si i tillë, nuk zëvendëson vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe nuk përfaqësojnë formulimin e vërtetë të vendimeve/aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Published by giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE 2013

I GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ky Buletin është mundësuar nga " Projekti për Reformë Juridike" implementuar nga Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, nën mbështetjen e Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

Tabela e përmbajtjes

Parathënie 16

Nr. 1. KI 164/11, Jetuallah Mustafa, datë 21 janar 2013- Vlerësim kushtetues i Vendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 538/2008, të datës 28 qershor 2011 18

Nr. 2. KI 83/12, Muhamet Ukalo dhe Neime Ukalo, datë 21 janar 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 521/2009, të 4 qershorit 2012 25

Nr. 3. KI 81/12, Hazër Susuri dhe Baki Hoxha, datë 29 janar 2013-Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 88/2012, te 18 qershorit 2012 35

Nr. 4. KI 84/12, Sindikata e Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, përfaqësuar nga z. Rifat Halili, kryetar i Sindikatës, dega në Vushtrri, datë 29 janar 2013- Kërkesë për përmirësimin e mirëqenies së pensionistëve dhe për realizimin e të drejtës së përfitimit të pensioneve për invalidët e punës nga autoritetet shtetërore 43

Nr. 5. KI 92/12,.Sali Hajdari, datë 29 janar 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për pensionet 52

Nr. 6. KI 76/12, Qamil Xhemajli, datë 29 janar 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të paspecifikuar të Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me pensionimin e doktorëve të shkencës në Universitetin e Prishtinës. 57

Nr. 7. KI 68/12, Haxhi Morina, datë 29 janar 2013-Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 313/2009, të 26 marsit 2012 64

Nr. 8. KO 131/12, Dr.Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, datë 29 janar 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësinë, Nr. 04/L-125; të miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012. 74

Nr. 9. KI 39/11, Tomë Krasniqi, datë 30 janar 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit Nr. 311/07, të 13 prillit 2007, dhe Vërtetimit Nr. 322/07, të 30 prillit 2007, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 77

Nr. 10. KI 74/12 , Agim Stublla, datë 30 janar 2013- Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PN. nr. 410/2012, të datës 5 qershor 2012 . 89

Nr. 11. KO 97/12, Avokati i Popullit, datë 30 janar 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012 96

Nr. 12. KI 99/12, Emine Tahiri, datë 01 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ac. nr. 583/2012, të 14 shtatorit 2012 99

Nr. 13. KI 71/12, Fikrije Sermaxhaj, datë 01 shkurt 2013-Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 273/2012 të 27 prillit 2012. 106

Nr. 14. KI 67/12, Shaban Kadrija, datë 01 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. I .nr. 366/2009, të 15 marsit 2012. 113

Nr. 15. KI 75/12, Faton Sefa, datë 01 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 106/2010, të 2 majit 2012. 120

Nr. 16. KI 104/12, Azem Kabashi, Tahir Badalli, Osman Zajmi dhe Nafije Krasniqi, datë 01 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së listës përfundimtare të 20% të të ardhurave të shitjes nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore "Industria Ushqimore", hartuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. 127

Nr. 17. KI 79/10, Izet Zejnullahu, datë 01 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 93/2010, të 30 qershorit 2010. 133

Nr. 18. KI 101/12, Arianit Dyla, datë 14 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 42/2012, të 18 qershorit 2012. 139

Nr. 19. KI 106/12, Lulzim Ramaj, datë 14 shkurt 2013- Kërkesë për njohjen e statusit të pjesëtarit të UÇK-së.....147

Nr. 20. KI 87/12, Afrim Rexhepi, datë 14 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap. Nr. 119/2010, të 10 tetorit 2011 153

Nr. 21. KI 123/12, Bajrush Gashi, datë 14 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 65/2012, të 10 shtatorit 2012. 158

Nr. 22. KI 116/12, Lulzim Ramaj, datë 14 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit,1218/2/12, të 12 qershorit 2012 164

Nr. 23. KI 78/12, Bajrush Xhemajli, datë 19 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012. 172

Nr. 24. KI 149/11, Shefqet Aliu, datë 25 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-09-0106, të 7 tetorit 2011 222

Nr. 25. KI 139/12, Besnik Asllani, datë 25 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PKL. nr. 111/2012 i 30 nëntorit 2012 232

Nr. 26. KI 15/12, Xhavit Gashi, datë 25 shkurt 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. I. Nr. 314/2009 i 10 janarit 2012. 245

Nr. 27. KI 21/12, Bedri Selmani, datë 25 shkurt 2013 -Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, SCC-06-0144 të 30 marsit 2009 dhe Aktgjykimit të Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, ASC-09-2006, të 13 tetorit 2011 251

Nr. 28. KI 44/11, Rufki Suma, datë 25 shkurt 2013 –Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të 14 dhjetorit 2010, për shitjen e Ndërmarrjes shoqërore “Sharr Cem” 259

Nr. 29. KI 69/12, Lidhja e Invalidëve Civil të Luftës së Dytë Botërore, datë 25 shkurt 2013 -Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, KRJA nr. 6/2011, i 8 majit 2012 265

Nr. 30. KI 157/11, Bashkimi i Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës i Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Azem Ejupi, avokat, datë 25 shkurt 2013 - Kërkesë për rregullimin e statusit të pensionistëve dhe të invalidëve të punës dhe përmirësimin e mirëqenies së pensionistëve të Republikës së Kosovës nga autoritetet shtetërore 272

Nr. 31. KO 09/13, Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi, datë 25 shkurt 2013 – Konfirmim i amendamentit të propozuar kushtetues, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 18 janar 2013 nëpërmjet shkresës Nr. 04-DO-1357. 280

Nr. 32. KI 51/09, KI 31/10, KI 68/11, KI 99/11, KI 112/11, KI 126/11 KI 07/12, KI 64/12, Vahide Hasani, Alltane Krasniqi, Fetije Berisha, Fahrije Ibrahimi,Sadije Pranaj, Raza Gashi, Nazmije Salihu, Shpresa Lladrovci, datë 26 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së 8 (tetë) aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës 287

Nr. 33. KI 85/12 dhe KI 86/12, Adriatik Gashi dhe Burim Miftari, datë 26 shkurt 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl. nr. 45/12 , të 18 qershorit 2012, së bashku me kërkesën për aplikimin e masës së përkohshme 296

Nr. 34. KI 41/12, Gezim dhe Makfire Kastrati, datë 26 shkurt 2013- Kundër Gjykates Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës 306

Nr. 35. KI 65/11, Holding Corporation "Emin Duraku", datë 28 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit SCC-0041, të datës 27 prill 2011, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit .. 332

Nr. 36. KI 91/12, Ali Latifi, datë 28 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit për caktimin si avokat mbrojtës sipas detyrës zyrtare, të lëshuar nga Prokuroria e EULEX-it në Prizren, në rastin HP-155/12 338

Nr. 37. KI 102/12, Bilall Osmani, datë 28 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. Nr. 15/10, të 21 shkurtit 2011 344

Nr. 38. KI 108/12, Hazir Kadriu, datë 06 mars 2013- Kërkesë për Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 212/2012, të 24 majit 2012 350

Nr. 39. KI 115/12, Fadil Salihu, datë 06 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së rregullsisë së zgjedhjes së Kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj, më 4 nëntor 2012..... 356

Nr. 40. KI 89/12, Brahim Delijaj, datë 07 mars 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 374/2009 të 2 majit 2012. 361

Nr. 41. KI 35/12, Agron Prenaj, datë 07 mars 2013- Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PKL. 11/2012, të 6 shkurtit 2012 370

Nr. 42. KI 103/11, Gani Morina, datë 07 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, AP. Nr. 90/10, të 8 prillit 2011. 377

Nr. 43. KI 90/12, Ramadan Kastrati, datë 07 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit SCC-04-0100 të Dhomës së Posaçme së Gjykatës Supreme të Kosovës, të 18 gushtit 2004 386

Nr. 44. KI 82/12, Milorad Rajović, datë 12 mars 2013- Kërkesë për Vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë së zbatimit të Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2000/4, dhe të Ligjit të Republikës së Kosovës, Nr. 2008/03 - L033 393

Nr. 45. KI 97/11, Mon Nushi, datë 14 mars 2013- Kërkesë për Vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në Prishtinë, Rev. nr. 87/12, e 21 marsit 2011. 402

Nr. 46. KI 49/11, Ibrahim Sokoli, datë 14 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 362/2009, të 4 shkurtit 2011. 409

Nr. 47. KI 113/12, Haki Gjocaj, datë 18 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, P. nr. 791/2012,

të 5 tetorit 2012, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 175/12, të 6 nëntorit 2012 417

Nr. 48. KI 124/11, Ljubiša Živić, datë 18 mars 2013- Vlerësim i procedurave ankimore në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, K66/09, e 25 majit 2010 (stërzgjatje e procedurës). 428

Nr. 49. KI 24/11, Ali Buzhala, datë 18 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 593/2010, të 20 janarit 2011 434

Nr. 50. KI 162/11, Behxhet Makolli, datë 18 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Mlc. nr. 13/2010, të 9 nëntorit 2011 442

Nr. 51. KI 17/13, Bujar Bukoshi, datë 20 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ka, Nr. 562/12 të 8 tetorit 2012 452

Nr. 52. KI 120/10, Zyma Berisha, datë 27 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 308/2007, të 10 qershorit 2010 458

Nr. 53. KI 19/13, Mark Duhanaj, datë 27 mars 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 274/2008, të 2 majit 2012, dhe aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, AP. nr. 316/2012, të 23 gushtit 2012, dhe Pkl. nr. 184/2012, të 17 dhjetorit 2012 504

Nr. 54. KI 19/10, SHpk "Syri", datë 27 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit të nxjerrë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, SCA-09-0041, të 9 shkurtit 2010. 518

Nr. 55. KI 10/13, Enver Zeneli, datë 27 mars 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl.nr.125/2012, i datës 30 nëntor 2012 527

Nr. 56. KI 81/10, datë 27 mars 2013- Aktvendim për përmirësimin e gabimeve teknike në Aktvendimin për papranueshmëri, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për Rastin KI81/10, të datës 15 shtator 2012. 534

Nr. 57. KI 37/12, Murtez Gashi dhe Shehide Gashi, datë 28 mars 2013- Kontestim i kushtetutshmërisë së vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të 29 nëntorit 2011. 537

Nr. 58. KI 141/11, Ramadan Rrahmani, datë 04 prill 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 5017415 të Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës, të 26 shkurtit 2009 542

Nr. 59. KI 14/13, Komuna e Podujevës, 04 prill 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 50/2011, të 22 nëntorit 2012..... 548

Nr. 60. KI 103/12, "Integral" SHPK, datë 04 prill 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0056-A0001, të 7 qershorit 2012. 557

Nr. 61. KI 77/12, Rifat Hamiti, datë 11 prill 2013- Vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I nr. 89/2011, të 5 marsit 2012 564

Nr. 62. KI 20/13, Rifat Osmani, datë 11 prill 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 10/2013 të 22 janarit 2013 577

Nr. 63. KI 114/12, Kastriot Hasi, datë 16 prill 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Konkluzionit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjakovës, nr. 07/351-8460, të 24 janarit 2011..... 587

Nr. 64. KI 130/12, Xhymshit Xhymshiti, datë 16 prill 2013-Vlerësim i kushtetutshmërisë së njoftimit të Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim Prokurorial, ZZVP/12/123, të 23 nëntorit 2012.....597

Nr. 65. KO 131/12 , Dr.Shaip Muja dhe 11 depuetet të tjerë, datë 18 prill 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012. 603

Nr. 66. KO 97/12, Avokati i Popullit, datë 18 prill 2013-Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 90, 95 (1.6), 110, 11 dhe 116 të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012..... 642

Nr. 67. KI 95/12, Daut Jemin Hoxha, datë 02 maj 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit C-III-12-274 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 23 gushtit 2012..... 693

Nr. 68. KI 111/12, Mit'hat Lozhani, datë 02 maj 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit të Lirimit me Kusht, MD/PLK No. 02/12, të 29 majit 2012. 700

Nr. 69. KI 18/13, Blerim Uka, datë 31 maj 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Ac. nr. 1314/2012, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 7 dhjetorit 2012 708

Nr. 70. KI 41/13, Sadik Qollopeku, datë 31 maj 2013- Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 61/2008, të 16 tetorit 2009, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, AC. nr. 158/2010, të 10 tetorit 2011, dhe kërkesë për caktimin e masës të përkohshme..... 716

Nr. 71. KI 02/13, Halil Mazreku, datë 31 maj 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 691/01, të 11 dhjetorit 2007, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 24/09, të 12 majit 2011 728

Nr. 72. KI 73/12, Bujar Sahitaj, datë 31 maj 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 24/2009, të 7 dhjetorit 2011..... 736

Nr. 73. KI 03/13 i KO 28/13, Demë Dashi dhe të tjerët si dhe Ali Lajçi, datë 14 qershor 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për Parkun Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna", të publikuar më 21 janar 2013, në Gazetën Zyrtare..... 743

Nr. 74. KI 01/13, Betim Ramadani, datë 14 qershor 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së njoftimit nga Prokurori i Shtetit, KMLC. nr. 106/2012, të 23 tetorit 2012.....755

Nr. 75. KI 13/13, Nexhat Tahiri, datë 14 qershor 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvëndimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-09-0042, të 29 gushtit 2012..... 762

Nr. 76. KI 04/13, Zahir Hasani, datë 14 qershor 2013— Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 5/2011, të 27 janarit 2011 767

Nr. 77. KI 127/12, Zade Zeqiroviq, datë 14 qershor 2013 -Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ASC-09-0084 të 12 shtatorit 2012 773

Nr. 78. KI 105/12 dhe KI 133/12, Shoqata e gjuetarëve "Dukagjini" Klinë dhe Federata e Gjuetarëve të Kosovës, datë 14 qershor 2013 – Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011 783

Nr. 79. KI 34/13, Besart Begu, datë 14 qershor 2013 –Vlerësim i kushtetutshmërisë së procedurës në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës në rastin A. nr. 1578/12. 791

Nr. 80. KI 37/13, Faton Sefa, datë 14 qershor 2013 –Kërkesë për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. KI 75/12. 797

Nr. 81. KI 23/13, Melihate Hakiqi, datë 18 qershor 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit A nr. 1197/2012, të 27 dhjetorit 2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës 803

Nr. 82. KI 31/13, Ramadan Muja, datë 18 qershor 2013- Ekzekutimi i Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 516/07 të 12 nëntorit 2007 810

Nr. 83. KI 110/12 , Dara Menkovič, datë 18 qershor 2013 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit përshpalljen e listës përfundimtare të 20 %-shit, të hartuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.....817

Nr. 84. KI 119/11, Sadri Mazreku, datë 18 qershor 2013- Vlerësim i Vendimit të Gjykatës Komunale në Malishevë (C. Dr. 90/2004), të 10 qershorit 2005 dhe të Aktgjykimit te Gjykatës Supreme, PKL Nr. 120/08, të 1 shtatorit 2009 823

Nr. 85. KI 129/12, Nezir Bytyqi, datë 20 qershor 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 204/2008 të 29 gushtit 2011..... 829

Nr. 86. KI 11/13, Izahir Troni, datë 20 qershor 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev nr. 34/12, të 8 tetorit 2012 836

Nr. 87. KI 98/12 , Ruzhdi Shala, datë 02 korrik 2013- Kërkesë kushtetuese kundër zvarritjes dhe jo efikasitetit të procedurës hetimore PPN nr.812-1/2008 nga Prokuroria e Qarkut në Prishtinë. 845

Nr. 88. KI 109/12, Kumrije Maloku dhe të tjerë, datë 02 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 466/2009, të 7 qershorit 2012. 856

Nr. 89. KI 122/12, Edison Rinxhi, datë 02 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje, Nr. reg. 46854/2012, të 19 tetorit 2012 866

Nr. 90. KI 22/13, Sokol Mushkolaj, datë 02 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 164/2012, të 5 dhjetorit 2012; të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ap. nr. 4/12, të 28 shtatorit 2012; të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 3 tetorit 2011; dhe të Vendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 20 dhjetorit 2011 873

Nr. 91. KI 38/13, Miftar Krasniqi, datë 02 korrik 2013--Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 48/2012, të 13 prillit 2012. 882

Nr. 92. KI 134/11, KI 135/11, KI 136/11, KI 137/11, Enver Gashi, Shefqet Bici, Ibush Gela, Mustafë Emini, datë 02 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së 4 Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës 888

Nr. 93. KI 66/13, Milazim Gashi, datë 09 korrik 2013 Kundër Kryetarit të Komunës së Graçanicës, z.Bojan Stojanovic 894

Nr. 94. KI 27/13, Kadri Çitaku, datë 09 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 556 / 2011, të 28 shtator 2012 903

Nr. 95. KI 29/13, Feriha Hoti, datë 09 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Mlc. nr. 12/2009, të 14 majit 2012..... 909

Nr. 96. KI 45/13, Jasmine Baxhaku, datë 09 korrik 2013- Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ac. nr. 65/2012, të 29 tetorit 2012 915

Nr. 97. KI 56/13, Jashar Avdullahi, datë 09 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 5/2013, të 4 marsit 2013..... 922

Nr. 98. KI 107/12, Jovica Đorđević, datë 09 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Gž.nr.1490-2011, të 26 qershorit 2012 931

Nr. 99. KI 07/13, Ibish Kastrati, datë 09 korrik 2013 - Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës Komunale në Pejë, N. Nr. 137/08, të 17 nëntorit 2008..... 940

Indeksi i shprehjeve ligjore.....947

Indeksi i neneve të kushtetutës.....963

Parathënie

Me kënaqësi të madhe po e shkruaj këtë parathënie në Buletinin e Praktikës Gjyqësore të vitit 2013 të Gjykatës Kushtetuese, si publikim i katërt i këtij lloji që nga themelimi i Gjykatës, në vjeshtën e vitit 2009. Në parathënien e Buletinit të parë të Praktikës Gjyqësore, që përfshin vendimet e Gjykatës të nxjerra në vitet 2009 dhe 2010, kisha shkruar se "një vend është demokratik dhe i përkushtuar ndaj sundimit të së drejtës vetëm atëherë kur drejtësia administrohet në mënyrë publike, kur gjykatat shqiptojnë vendimet dhe aktgjykimet e tyre në mënyrë të hapur dhe pa u frikësuar edhe kur ato vendime dhe aktgjykime u vihen në dispozicion qytetarëve". Se sa kam pasur të drejtë, tregon fakti se deri më tani Gjykata Kushtetuese, vit pas viti, ka dëshmuar se i zgjidh të gjitha kërkesat e parashtruara në mënyrë të drejtë dhe transparente. Nuk është sekret se populli i Kosovës e konsideron Gjykatën Kushtetuese si njërën prej institucioneve publike më të çmuara dhe më të respektuara në vend. Prandaj, me krenari e prezantoj Buletinin e Praktikës Gjyqësore të vitit 2013, si një dëshmi shtesë e pjekurisë dhe e standardeve më të larta në vendimmarrjen e Gjykatës.

Si me rastin e Buletinit të Praktikës Gjyqësore për vitin 2012, edhe publikimi i këtij Buletini është mundësuar falë një donacioni zemërgjerë të Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për çka Gjykata është shumë falënderuese.

Vendimet që përfshin ky buletin reflektojnë edhe një herë llojllojshmërinë e çështjeve kushtetuese të ngritura para Gjykatës nga palë të autorizuara, qofshin persona fizikë apo persona juridikë ose nga autoritetet publike. Kjo tregon se çuarja përpara e sundimit të ligjit ndodh në çdo nivel të shoqërisë kosovare, për t'u testuar përfundimisht në Gjykatën Kushtetuese, si autoritet përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës.

Dëshira ime është që edhe ky buletin të bëhet mjet praktik në duart e të gjithë praktikuesve të ligjit në Kosovë dhe, aty ku është e mundur, t'i udhëzojë ata në procesin e vendimmarrjes së tyre. Për t'u siguruar se buletinet e ardhshme të praktikës gjyqësore do të jenë po aq të dobishme sikurse ato pararendëse, praktikuesit e ligjit janë të mirëseardhur që çdo sugjerim që mund të kenë t'ia përcjellin Sekretariatit të Gjykatës me qëllim të bërjes së buletineve edhe më të lehta për përdorim, posaçërisht lidhur me qasjen në vendimet relevante nëpërmjet hulumtimit më të lehtë.

Prof. dr. Enver Hasani
Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

KI 164/11, Jetuallah Mustafa, datë 21 janar 2013- Vlerësim kushtetues i Vendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 538/2008, të datës 28 qershor 2011

Rasti KI 164/11, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 korrikut 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë Individuale, mos shterje e mjeteve ligjore, Aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi kërkon përmbarimin e Vendimit Ac. nr. 89/98 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 9 shkurtit 1998, në të cilin KUR-i ishte urdhëruar të rikthejë parashtruesin në vendin e tij të punës, ose në një vend të ngjashëm pune.

Për më tepër, parashtruesi pretendon se, në Aktgjykimin e vet të 22 janarit 2003, Gjykata Komunale në Prishtinë nuk ka përmendur: Prej cilës datë ka filluar të llogaritet periudha kohore e përcaktuar nga Statuti i Parashkrimit. Si ka vendosur Gjykata shumën e kompensimit, e cila do t'i takonte parashtruesit.

Parashtruesi përfundimisht vë në pah se procedurat gjyqësore ishin të stërzgjatura dhe të padrejta dhe se, në mënyrë specifike, vendimi i Gjykatës Supreme, i 20 shtatorit 2011, ishte i njëanshëm dhe nuk ishte gjykuar si duhet.

Gjykata Kushtetuese konkludon se parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI164/11
Parashtrues
Jetullah Mustafa
Vlerësim kushtetues i Vendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 538/2008, të datës 28 qershor 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Kadri Kryeziu, gjyqtar.

Parashtruesi

1. Parashtrues është z. Jetullah Mustafa, me banim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar nga parashtruesi është Vendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 538/2008, i 28 qershorit 2011, që iu dorëzua parashtruesit më 20 shtator 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon që Vendimi i Gjykatës së Qarkut, nr. 89/98, i 9 shkurtit 1998, me anë të të cilit është pranuar kërkesa e tij për kompensim, për periudhën prej 3 dhjetorit 1993 e deri më 2 tetor 1998, të ekzekutohet në tërësinë e tij dhe jo pjesërisht, siç është bërë nga Gjykata Komunale deri më tash.

4. Parashtruesi më tej pohon se vendimi i Gjykatës Supreme, i 28 qershorit 2011, të cilin ai e pranoi më 20 shtator 2011, nuk ishte gjykuar në mënyrë të duhur dhe ishte i njëanshëm.

Baza juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 20 dhjetor 2011, parashtruesi paraqiti një kërkesë në Gjykatë.

7. Më 17 janar 2012, Kryetari i Gjykatës, me Urdhrin nr. 164/11 GJR, caktoi Gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Urdhrin nr. 164/11 KSH, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Gjyljeta Mushkolaj.

8. Më 2 korrik 2012, Kryetari Enver Hasani zëvendësoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj në Kolegjin shqyrtues, mandati i së cilës, si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese, kishte mbaruar më 26 qershor 2012.

9. Më 3 korrik 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 3 dhjetor 1993, ishte ndërprerë kontrata e punësimit të parashtruesit, punëtor i përhershëm në organizatën punuese të Kompanisë së Ujësjellësit Rajonal "Batllava" në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: KUR).

11. Me Vendimin nr. 407/96, të 1 korrikut 1997, Gjykata e Qarkut në Prishtinë gjeti se marrëdhënia e punës së parashtruesit ishte ndërprerë në mënyrë të paligjshme. Ish-punëdhënësi i parashtruesit u ankua kundër këtij vendimi.

12. Më 9 shkurt 1998, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Ac. nr. 89/98, hodhi poshtë ankesën si të pabazuar dhe urdhëroi KUR-in që të rikthejë parashtruesin në vendin e mëparshëm të punës ose në ndonjë vend të ngjashëm pune. Të drejtat nga marrëdhënia e punës duhej të ruheshin patjetër.

13. Më 21 tetor 1998, parashtruesi u kthye në punë.

14. Më 12 shkurt 1999, Gjykata Komunale në Prishtinë miratoi kërkesën e parashtruesit për ekzekutimin e kërkesës për pagat që i detyroheshin atij, për periudhën ndërmjet 9 shkurtit 1998 dhe 21 shtatorit të të njëjtit vit.

15. Me letrën e 26 shkurtit 2001, drejtuar KUR-it, parashtruesi kërkoi kompensim për periudhën 3 dhjetor 1993 e deri më 21 tetor 1998. Një letër e datës 5 prill 2001 refuzoi kërkesën e tij.

16. Parashtruesi parashtroi një kërkesë në Gjykatën Komunale të Prishtinës, më 26 dhjetor 2001, për kompensimin e dëmeve për mospagesën e rrogës gjatë kësaj periudhe.

17. Kjo ishte hedhur poshtë nga Gjykata Komunale në Prishtinë, me Vendimin C1. Nr. 545/2001, e 22 janarit 2003. Gjykata Komunale vendosi që parashtruesi ka humbur të drejtën për kompensim për rrogat e papaguara gjatë kësaj periudhe, me arsyetimin se me nenin 376 (1) të Ligjit për Obligimet, Statuti i Parashkrimit mundëson/lejon 3 vjet kompensimin e pagesës dhe parashtruesi ka qenë kështu 4 muaj e 17 ditë jashtë afatit kohor. Sidoqoftë, Gjykata Komunale nuk ka elaboruar se çfarë date kanë marrë parasysh për të ardhur në atë përfundim.

18. Më 17 shkurt 2005, me Vendimin CI. nr. 377/2004, Gjykata Komunale në Prishtinë hodhi poshtë kërkesën e mëtejme të parashtruesit për kompensim e pagës së papaguar prej 3 dhjetorit 1993 e deri më 21 tetor 1998, me arsyetimin se parashtruesit nuk i takonte kompensimi, pasi në saje të nenit 376 (1) të Ligjit për Obligimet, Statuti i Parashkrimit përcakton 3 vjet për të kërkuar kompensim. Parashtruesi u ankua kundër kësaj në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

19. Gjykata e Qarkut në Prishtinë hodhi poshtë ankesën e parashtruesit më 14 tetor 2005, me Vendimin Ac. nr. 521/2005. Dukej se Gjykata Komunale kishte vepruar drejt, duke vendosur për kërkesën e parashtruesit, sepse pagesat e mbetura ishin jashtë afatit kohor të përcaktuar me Statutin e Parashkrimit dhe duke marrë parasysh periudhën e bombardimeve nga marsi e deri në qershor 1999. Prandaj, Gjykata e Qarkut kishte konfirmuar Aktgjykimin CI. nr. 377/2004 të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

20. Më 31 gusht 2007, parashtruesi kërkoi përsëritjen e procedurës së Gjykatës Komunale, duke propozuar Vendimin I. nr. 2074/98 të Gjykatës Komunale të 12 shkurtit 1999 (shih më lartë paragrafin 4) si evidencë të re.

21. Me vendimin CI. nr. 377/2004 (të 19 shtatorit 2007), Gjykata Komunale hodhi poshtë kërkesën, ndër të tjera, me arsyetimin se kishte skaduar afati kohor 30-ditësh, brenda të cilit duhej të dorëzohej kërkesa për përsëritjen e procedurës, që nga momenti i zbulimit të provave të cekura. Parashtruesi u ankua kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut.

22. Gjykata e Qarkut hodhi poshtë ankesën e parashtruesit, me Vendimin Ac. nr. 907/2007, e 27 gushtit 2008. Më pas, parashtruesi parashtroi një kërkesë për shqyrtim në Gjykatën Supreme.

23. Më 28 qershor 2011, me Vendimin Rev. nr. 538/2008, Gjykata Supreme hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për shqyrtim, duke e konsideruar të pabazuar. Gjykata Supreme shprehej se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar drejt afatin kohor për përsëritjen e procedurës – 30 ditë që nga zbulimi i provave të reja – dhe që, në fakt, kishte skaduar.

24. Parashtruesi mori vendimin e Gjykatës Supreme më 20 shtator 2011.

Pretendimet e parashtruesit

25. Parashtruesi kërkon përmbarimin e Vendimit Ac. nr. 89/98 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 9 shkurtit 1998, në të cilin KUR-i ishte urdhëruar të rikthejë parashtruesin në vendin e tij të punës, ose në një vend të ngjashëm pune.

26. Për më tepër, parashtruesi pretendon se, në Aktgjykimin e vet të 22 janarit 2003, Gjykata Komunale në Prishtinë nuk ka përmendur:

    a. Prej cilës datë ka filluar të llogaritet periudha kohore e përcaktuar nga Statuti i Parashkrimit.

    b. Si ka vendosur Gjykata shumën e kompensimit, e cila do t'i takonte parashtruesit.

27. Parashtruesi përfundimisht vë në pah se procedurat gjyqësore ishin të stërzgjatura dhe të padrejta dhe se, në mënyrë specifike, vendimi i Gjykatës Supreme, i 20 shtatorit 2011, ishte i njëanshëm dhe nuk ishte gjykuar si duhet.

Vlerësimi i papranueshmërisë së kërkesës

28. Nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi shihet se bëhet fjalë për dy grupe procedurash:

    (1) Procedura që ka të bëjë me rrogat e papaguara, që ka përfunduar me vendimin Ac. nr. 521/2005 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, e 14 tetorit 2005, me të cilin u konfirmua Aktgjykimi Cl. nr. 377/2004 i Gjykatës Komunale në Prishtinë, i datës 17 shkurt 2005.

    (2) Procedura që ka të bëjë me përsëritjen e procedurës, që ka përfunduar më 28 qershor 2011, me Vendimin Rev. nr. 238/2008 të Gjykatës Supreme.

29. Sa i përket procedurave nën a), Gjykata vëren se kanë ndërlidhje me ngjarjet para 15 qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Del se ankesa e parashtruesit është jashtë juridiksionit të Gjykatës dhe, kështu, në mospërputhje "*racione temporis*" me dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit (shih, *mutatis mutandis*, *Jasioniene v. Lithuania, kërkesa 41510198, Aktgjykimet e GJEDNJ-së, të 6 marsit dhe 6 qershorit 2003, dhe Rasti nr. KI61/09, Adler Com vs. Urdhri i Kryetarit të Komunës Gjakovës*).

30. Sa i përket procedurave nën b), Gjykata vëren se Gjykata Supreme, në vendimin e vet Rev. nr. 538/2008, të 28 qershorit 2011 (e pranuar nga parashtruesi më 20 shtator 2011) vendosi se gjykatat më të ulëta e kishin zbatuar drejt ligjin kur kanë vendosur për kërkesën për përsëritjen e procedurës, në pajtim me nenin 423 (1) të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Kjo kërkesë do të duhej të ishte dorëzuar brenda afatit 30 ditë nga dita kur pala ka pasur mundësinë të paraqesë fakte të reja.

31. Në këtë drejtim, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi nuk ka përmbushur kërkesën për pranueshmëri, të përcaktuar me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 47.2 të Ligjit, sipas së cilës individët që parashtrojnë një kërkesë në Gjykatë duhet të tregojnë se kanë shteruar të gjitha mjetet ligjore të përcaktuara me Ligj.

32. Arsyetimi për kërkesën e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse (duke përfshirë gjykatat) mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara kushtetuese (*Shih, mutatis mutandis, Selmouni kundër Francës, vendimi nr. 25803/94, i 28 korrikut 1999, dhe rasti KI41/09, Universiteti AAB –Riinvest kundër Qeverisë së Kosovës, Aktvendimi i 27 janarit 2010*).

33. Në rastin e parashtruesit, Gjykata vëren se gjykatat kanë përcaktuar, sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore, që parashtruesi ka iniciuar përsëritjen e procedurës jashtë afatit. Si rrjedhojë e kësaj, gjykatat ishin të parandaluara të merrnin parasysh provat e reja të dorëzuara rishtazi.

34. Në rrethana të tilla, Gjykata konkludon se parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 56(2) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues
Ivan Čukalović

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 83/12, Muhamet Ukalo dhe Neime Ukalo, datë 21 janar 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 521/2009, të 4 qershorit 2012

Lënda KI 83/12, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 nëntorit 2012.

Fjalët kyçe: qartazi e pabazuar, mbrojtja e pronës, e drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale.

Parashtruesit e paraqitën kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 521/2009, të 4 qershorit 2012, sepse parashtruesit e kërkesës pretendojnë se "[...] *janë pronarë të pronës së patundshme të kontestuar, sepse e kanë trashëguar atë. Kjo e drejtë, sipas Kushtetutës, është e paprekshme dhe e garantuar. Sidoqoftë, me aktgjykimet e gjykatave të rregullta, e drejta e pronës i takon A.Q...*" Për me tepër, parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se Gjykata Komunale në Prizren, më 2 qershor 2008, ishte e paanshme, nuk ka vepruar në pajtim me vërejtjet e bëra nga Gjykata Supreme.

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata vlerësoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesit e kërkesës nuk e kanë mbështetur pretendimin e tyre në baza kushtetuese dhe nuk kanë paraqitur asnjë provë që tregon se të drejtat dhe liritë e tyre ishin shkelur nga Gjykata Supreme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI83/12
Parashtruesit
Muhamet Ukalo
Neime Ukalo
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 521/2009, të 4 qershorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Z. Muhamet Ukalo dhe Znj. Neime Ukalo, me vendbanim në Prizren (në tekstin e mëtejmë:" Parashtruesi i kërkesës").

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 521/2009, të 4 qershorit 2012, të cilin e kanë pranuar më 1 gusht 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se aktgjykimi i lartpërmendur i ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë:"Kushtetuta"), respektivisht neni 31 [E drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 46 [Mbrojtja e pronës], dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: the "KEDNJ"),

respektivisht neni 6 (E drejta në proces të rregullt) dhe neni 1 (Mbrojtja e pronës) e Protokollit 1 të KEDNJ.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit, Nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese së Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: "Ligji") dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 17 shtator 2012, Parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së (në tekstin e mëtejmë: "Gjykata").

6. Më 5 tetor 2012, Kryetari i gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR.KI-83/12, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović si gjyqtar raportues. Në të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH.KI-83/12, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 5 nëntor 2012, Kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme.

8. Më 27 nëntor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 21 shkurt 1963, babai i Parashtruesve të Kërkesës nënshkroi kontratën për shitjen e patundshmërisë me Ndërmarrjen Shoqërore "KBI Progress" (në tekstin e mëtejmë: NSH "KBI Progress").

10. Më 15 prill 1967, prona e patundshme iu shit personit të tretë, A.Q.

11. Më 6 dhjetor 1968, babai i Parashtruesit të Kërkesës nënshkroi kontratën për dhuratë për një tjetër pronë të patundshme me NSH-në "KBI Progress".

12. Më 1 shkurt 2001, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi C. nr. 69/2000) e aprovoi padinë e Parashtruesve të Kërkesës dhe konfirmoi se kontratat e nënshkruara më 21 shkurt 1963 dhe më 6 dhjetor 1968 janë të pavlefshme. Pastaj, Gjykata Komunale e obligoi NSH-në "KBI

Progress" t'i pranojë si pronarë të patundshmërisë dhe t'ua dorëzojë në përdorim të lirë dhe posedim si dhe t'ua lejojë regjistrimin e pronës së patundshme në shërbimin kadastral në emër të Parashtruesve të kërkesës. Gjykata Komunale në Prizren konsideron se *"Në pajtim me nenin 37 të Ligjit Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (Fleta Zyrtare 6/1980, Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, janar 30, 1980) pronari mundet të kërkojë me padi kthimin e pronës së paluajtshme me kusht që Parashtruesi mund të konfirmojë se ai/ajo ka të drejtë në pronësinë e pronës së kthyer të paluajtshme."* Për më tepër, Gjykata Komunale konsideron se kontratat e lidhura nga babai i Parashtruesve të kërkesës janë të pavlefshme, sepse ato janë lidhur nën presion dhe rrjedhimisht nuk kanë ndonjë efekt ligjor. Ky aktgjykim mori formën e prerë dhe detyruese më 26 mars 2001.

13. Më 4 prill 2001, Gjykata Komunale në Prizren (Vendimi C. nr. 69/2000) nxori Aktvendimin me të cilin e korrigjoi aktgjykimin e saj të 1 shkurtit 2001. Gjykata Komunale e Prizrenit gabimisht nuk e kishte përfshirë sipërfaqen e tërësishme të patundshmërisë që duhet ti kthehet Parashtruesve. Ky aktvendim mori formën e prerë dhe detyruese më 20 prill 2001.

14. Më 30 prill 2001, Parashtruesit e kërkesës ushtruan propozim në Gjykatën Komunale në Prizren për përmbarimin e Aktgjykimit të formës së prerë dhe detyrues së Gjykatës Komunale në Prizren.

15. Më 22 qershor 2001, the Gjykata Komunale në Prizren (E. nr. 22/01) e lejoi përmbarimin. Më 5 korrik 2002, A.Q. ushtroi kundërshtim dhe kërkoi nga Gjykata Komunale në Prizren që ta shpallë vendimin për përmbarim të 22 qershorit 2001 të papranueshëm.

16. Më 30 gusht 2002, Gjykata Komunale në Prizren (Vendimi E. nr. 22/01) e suspendoi procedurën e përmbarimit sepse A.Q. pretendon se A.Q. e ka te drejtën e pronësisë mbi patundshmërinë e kontestuar. Gjykata Komunale në Prizren e këshilloi më tej A.Q. për të filluar procedurën kontestimore për të zgjidhur kush është pronar i ligjshëm i pronës së patundshme dhe të konfirmojë se përmbarimi është i palejueshëm.

17. Më 1 tetor 2002, A.Q. paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prizren kundër Parashtruesve dhe NSH-së "KBI Progress" në mënyrë që vendimi për përmbarim të shpallet i palejueshëm dhe të konfirmohet e drejta pronësisë e A.Q:.

18. Më 17 dhjetor 2002, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi C. nr. 556/02) e miratoi padinë e A.Q. duke vërtetuar se A.Q. është pronare e

pronës së kontestuar pronësore, bazuar në posedim, mbajtje dhe i obligon Parashtruesit e kërkesës t'ia njohin A.Q. të drejtën dhe të lejojnë regjistrimin e pronës së pamundshme kontestuese. Për më tepër, Gjykata Komunale në Prizren e shpall përmbarimin e vendimit të Gjykatës Komunale E. nr. 22/01 të 22 qershorit 2001 si të papranueshme. Gjykata Komunale në Prizren konsideron:

a. se A.Q. kurrë nuk ka marrë pjesë në procedurë kur Gjykata Komunale e nxori Aktgjykimin e saj (C. nr. 69/2000) më 1 shkurt 2001 dhe më së pari kuptoi për procedurën kur Gjykata Komunale në Prizren doli në pronën e patundshme të për ta përmbaruar vendimin e saj;

b. se A.Q. është mbajtëse në besim e pronës e patundshmërisë së kontestuar prej 1970 deri më tani A.Q. ka poseduar pronën e patundshme të kontestuar bazuar në një transaksion të vlefshëm ligjor– marrëveshja e shitblerjes së nënshkruar më 15 prill 1967. A.Q. ka përdorur pronën e patundshme të kontestuar pa u penguar nga askush ose në ndonjë mënyrë tjetër. Për më tepër, A.Q. nuk dinte asgjë për procedurën në lidhje pronën e kontestuar derisa Gjykata Komunale në Prizren, doli në pronën e kontestuar për ta përmbaruar vendimin E. nr. 22/01 të 22 qershorit 2001;

c. se është e vërtetë se patundshmëria e kontestuar ishte e regjistruar si ndërmarrje shoqërore kur i është shitur NSH-së "KBI Progress" më 21 shkurt 1963, por pasi që kontratat u shpallën të pavlefshme nga Gjykata Komunale në Prizren më 1 shkurt 2001 (Aktgjykimi C. nr. 69/2000), atëherë patundshmëria e kontestuar kurrë nuk ka qenë pronë shoqërore;

d. se A.Q. e ka fituar të drejtën në pronë, bazuar në posedim – në mbajtje, në pajtim me nenin 28 paragrafi 4 i Ligjit Mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (Fleta Zyrtare 6/1980, Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, janar 30, 1980).

Parashtruesit e kërkesës u ankuan kundër këtij Aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

19. Më 28 janar 2004, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktgjykimi Ac. nr. 254/2003) e hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e Parashtruesve të kërkesës dhe e mbështeti Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren të 17 dhjetorit 2002. Parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër këtij Aktgjykimi.

20. Më 21 korrik 2004, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 137/2004) aprovoi kërkesën për revizion dhe anuloi aktgjykimin e gjykatave më të ulëta dhe ia ktheu lëndën gjykatës së instancës së parë për rigjykim. Gjykata Supreme konsideron se "*Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në faktin se ekziston një kontradiktë në mes të asaj çka është thënë në arsyetim dhe provave të administruara në seancën për shqyrtimin kryesor.*" Për më tepër, Gjykata Supreme gjithashtu konsideron se ajo *"[...] nuk mund të pranojë përfundimin e gjykatës së shkallës së dytë, meqë me Ligjin për Ndryshimin e Ligjit Mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (Flet. Zyr. e Jug. 29/96) është shlyer neni 29 i Ligjit Mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, i cili parashikonte se nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë në pasuri shoqërore me parashkrim fitues, pas këtij ndryshimi mbi pronën shoqërore mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrim fitues. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, një normë ligjore bihet për të rregulluar raportet juridike në të ardhmen, përveç nëse në ligj shprehimisht është cekur se kjo normë ka ndikim prapaveprues. Me ligjin e përmendur më lart nuk është parashikuar se kjo normë ka ndikim prapaveprues."*

21. Më 2 qershor 2008, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi C. nr. 160/04) e miratoi padinë e A.Q. duke vërtetuar se A.Q. është pronare e pronës së kontestuar pronësore, bazuar në posedim, mbajtje dhe i obligon Parashtruesit e kërkesës t'ia njohin A.Q. të drejtën dhe të lejojnë regjistrimin e pronës së paluajtshme kontestuese. Për më tepër, Gjykata Komunale në Prizren e shpall përmbarimin e vendimit të Gjykata Komunale E. nr. 22/01 të 22 qershorit 2001 si të papranueshme. Gjykata Komunale në Prizren konsideron:

    a. se A.Q. kurrë nuk ka marrë pjesë në procedurë kur Gjykata Komunale e nxori Aktgjykimin e saj (C. nr. 69/2000) më 1 shkurt 2001 dhe më së pari kuptoi për procedurën kur Gjykata Komunale në Prizren doli në pronën e patundshme të për ta përmbaruar vendimin e saj;

    b. se A.Q. është mbajtëse në besim e pronës e patundshmërisë së kontestuar prej 1970 deri më tani. A.Q. ka poseduar pronën e patundshme të kontestuar bazuar në një transaksion të vlefshëm

ligjor– marrëveshja e shitblerjes së nënshkruar më 15 prill 1967 A.Q. ka përdorur pronën e patundshme të kontestuar pa u penguar nga askush ose në ndonjë mënyrë tjetër. Për më tepër, A.Q. nuk dinte asgjë për procedurën në lidhje pronën e kontestuar derisa Gjykata Komunale në Prizren, doli në pronën e kontestuar për ta përmbaruar vendimin E. nr. 22/01 të 22 qershorit 2001;

c. se është e vërtetë se patundshmëria e kontestuar ishte e regjistruar si ndërmarrje shoqërore kur i është shitur NSH-së "KBI Progress" më 21 shkurt 1963, por pasi që kontratat u shpallën të pavlefshme nga Gjykata Komunale në Prizren më 1 shkurt 2001 (Aktgjykimi C. nr. 69/2000), atëherë patundshmëria e kontestuar kurrë nuk ka qenë pronë shoqërore;

d. se A.Q. e ka fituar të drejtën në pronë, bazuar në posedim – në mbajtje, në pajtim me nenin 28 paragrafi 4 i Ligjit Mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (Fleta Zyrtare 6/1980, Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, janar 30, 1980).

e. se *"duke u thirr në vërejtjet e dhëna në aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 137/04 të dt. 21.07.2005, gjykata konstatoi se në bazë të rregullave juridike të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur është themeluar kjo marrëdhënie juridike në mes të paditëses A. Q. me pronarin e mëparshëm Gj. Q. ka vlejte deri në hyrjen në fuqi të ligjit mbi bazat e marrëdhënieve juridiko pronësore, poseduesi në mirëbesim fiton të drejtën e pronësisë pas posedimit të pandërprerë në afat prej 20 viteve, edhe pse nuk ka qene posedues i ligjshëm. Në rastin konkret paditësja gjithsesi është poseduese në mirëbesim nga se me lidhjen e kësaj kontrate të vlefshme juridike e ka konsideruar veten pronare dhe mbi këtë bazë ka qene poseduese. Çfarëdo procedure qe ashte zhvilluar më vonë paditësja nuk ka qenë e njoftuar e as që ka ditur për zhvillimin e ndonjë procedure lidhur me parcelën kontestuese e as lidhur me zhvillimin e procedurës, në këtë gjykatë."*

Parashtruesit e kërkesës u ankuan kundër këtij Aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prizren.

22. Më 13 tetor 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktgjykimi Ac. nr. 405/2008) hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e Parashtruesve të kërkesës dhe e mbështeti Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren të 2 qershorit 2008. Parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme kundër këtij Aktgjykimi.

23. Më 4 qershor 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 521/2009) hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën për revizion dhe e mbështeti Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të 13 tetorit 2009.

Pretendimet e Parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe asaj Komunale u morën në kundërshtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës dhe neni 6 (E drejta në Proces të Rregullt) neni 1 (Mbrojtja e Pronës) i Protokollit 1 i GJEDNJ, sepse Parashtruesit e kërkesës, gjoja, se *"[...] janë pronarë të pronës së patundshme të kontestuar sepse e kanë trashëguar atë. Kjo e drejtë, sipas Kushtetutës është e paprekshme dhe e garantuar. Sidoqoftë, me aktgjykimet e gjykatave të rregullta, e drejta e pronës i takon A.Q.."*

25. Për më tepër, Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se A.Q. *"[...] nuk është poseduese me mirëbesim e patundshmërisë së kontestuar, posaçërisht nga dita kur Gjykata Komunale në Prizren i ka anuluar kontratat [...]",* d.m.th. nga 1 shkurti 2001.

26. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se Gjykata Komunale në Prizren më 2 qershor 2008 ishte e paanshme dhe si e tillë i ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], sepse Gjykata Komunale më 2 qershor 2008 nuk ka vepruar në pajtim me vërejtjet e bëra nga Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj të 21 korrikut 2004, Aktgjykimi Rev. no. 137/20.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Gjykata vëren se, në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë në lidhje ankesën e Parashtruesve të kërkesës, Gjykata duhet së pari të të shqyrtojë nëse Parashtruesit e kërkesës kanë plotësuar kushtet e pranueshmërisë që parashihen me Kushtetutë, siç janë specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

28. Rregulli 36 1 (c) i Rregullores së punës parasheh se *"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar."*

29. Gjykata Kushtetuese dëshiron të rikujton se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me lajthitjet e fakteve ose

të ligjit (ligjshmërisë) gjoja të kryera nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur t'i merr parasysh vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih: *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I)

28. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që Parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

30. Në rastin e tanishëm, Parashtruesit e kërkesës thjesht kontestojnë nëse gjykatat e rregullta e kanë aplikuar në tërësi ligjin e aplikueshëm dhe nuk pajtohen me të gjeturat faktike të gjykatave të rregullta në lidhje me rastin e tyre.

31. Në të vërtetë, parashtruesit nuk i kanë mbështetur pretendimin në baza kushtetuese, duke treguar dhe nuk kanë ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga gjykatat e rregullta. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të gjejë pse dhe si ishin procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih: *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

32. Prandaj, Parashtruesit e kërkesës nuk kanë treguar pse dhe si gjykatat e rregullta kanë vendosur "në mënyrë të njëanshme", duke ua mohuar të drejtën e tyre në pronë.

33. Rrjedh se Kërkesa është e papranueshme sepse është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (1.c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 27 nëntor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 81/12, Hazër Susuri dhe Baki Hoxha, datë 29 janar 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 88/2012, te 18 qershorit 2012

Rasti KI 81/12, vendim i 15 janarit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë paditësit subsidiarë, prokurori publik, drejta e për mjete juridike, mbrojtja gjyqësore e të drejtave.

Parashtruesit paraqitën kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tyre kushtetuese janë cenuar me vendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Parashtruesit ndër të tjera pretendonin se ushtrimi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nuk ishte vetëm e drejtë e prokurorit publik por dhe e tyre si paditës subsidiarë. Gjykata Supreme kishte përcaktuar se parashtruesit nuk ishin të autorizuar për të paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

Gjykata konstatoi se parashtruesit nuk kishin mbështetur pretendimet e tyre, dhe se vendimi i Gjykatës Supreme ishte i qartë dhe me lidhje logjike ndërmjet arsyetimit dhe bazës ligjore. Gjykata po ashtu ripërsëriti se çështjet e fakteve dhe të ligjit janë në kuadër të juridiksionit të gjykatave të rregullta dhe se Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë apeli apo gjykatë e shkallës së katërt. Për më tepër, Gjykata po ashtu shtjelloi detyrimin kushtetues për respektimin e parimit të ndarjes së pushteteve. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesve si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI81/12
Parashtrues
Hazër Susuri dhe Baki Hoxha
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 88/2012, të 18 qershorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Hazër Susuri dhe z. Baki Hoxha, me banim në Prizren.

Vendimet e kontestuara

2. Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 88/2012, i 18 qershorit 2012.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes ka të bëjë me të drejtën e parashtruesve si paditës subsidiarë në ushtrimin e mjeteve të jashtëzakonshme juridike, përkatësisht me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Procedura në Gjykatë

5. Më 5 shtator 2012, parashtruesit dorëzuan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 5 tetor 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI-81/12, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me vendimin Nr. KSH. KI-81/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

7. Më 1 nëntor 2012, parashtruesit u njoftuan për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Gjykatës Komunale në Gjilan dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

8. Më 6 dhjetor 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve siç janë dorëzuar nga parashtruesit

9. Më 29 nëntor 2011, Gjykata Komunale në Gjilan, me Aktvendimin Ka. nr. 111/2010, në procedurë paraprake ka hedhur aktakuzën e paditësve subsidiarë (parashtruesve), me të cilën pretendohej se i akuzuari X (tani gjyqtar i Gjykatës Supreme) ka kryer veprën penale të nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore, duke shkelur kështu nenin 346 të Kodit Penal të Kosovës, sepse ka pushuar procedurën penale, me arsyetim se nuk ka prova të mjaftueshme për mbështetjen e dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale nga i akuzuari.

10. Më 19 janar 2012, Kolegji Penal i Gjykatës Komunale në Gjilan refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve dhe përcaktoi se nuk kishte prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale të nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore nga neni 346 i KPK-së, dhe se gjyqtari i procedurës për konfirmimin e procedurës paraprake me të drejtë kishte hedhur aktakuzën e paditësve subsidiarë (parashtruesve).

11. Më 18 qershor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin Pkl. nr. 88/2010, hodhi poshtë si të palejueshme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur nga parashtruesit, dhe *inter alia* përcaktoi:

"... kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ka paraqitur personi i paautorizuar, pra paditësi subsidiar, i cili gëzon të njëjtat të drejtat të cilat i gëzon edhe Prokurori Publik, përveç atyre të cilat i takojnë Prokurorit Publik si organ i pushtetit (neni 65 par. 1 KPPK), andaj edhe e drejta e ushtrimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë ekskluzivisht i takon Prokurorit Publik të Kosovës e jo edhe paditësit subsidiar, e për këtë arsye kërkesa si e tillë është e palejuar dhe hedhet poshtë, sepse është ushtruar nga personi i pautorizuar".

"Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të të gjykuarit i është përgjigjur Prokurori Publik i Kosovës me parashtresën KMLP. II. nr. 91/12, e 12 qershorit 2012, me propozim që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të hidhet si e papranueshme ngase është paraqitur nga personi i pautorizuar".

Pretendimet e parashtruesve

12. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata:

a) që kërkesën e tyre ta shpallë të pranueshme;

b) të shpallë të pavlefshëm, kundërkushtetues, Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Pkl. Nr. 88/2010, e 18 qershorit 2012, sepse është në kundërshtim, shkelje të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, duke iu shkurtuar parashtruesve të drejtën për mjete juridike, përkatësisht shkurtimin e të drejtës në ushtrimin e mjeteve të jashtëzakonshme juridike, kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ndaj Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, KA. nr. 111/2010, të 29 nëntorit 2011, si dhe në shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, ngase parashtruesve nuk u është lejuar e drejta në shfrytëzim të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, që parashtruesit, në cilësinë e paditësve subsidiarë, i gëzojnë në rastet kur Prokurori Publik nuk inicion ndjekjen penale;

c) të lejohet si e ligjshme dhe kushtetuese kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur nga parashtruesit kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, KA. nr. 111/2010, të 29 nëntorit 2011;

d) Parashtruesit po ashtu theksojnë:

"... në bazë të rregullit 63 (5) të Rregullores së punës, Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë detyrohet t'i dorëzojë informacione Gjykatës Kushtetuese për masat e ndërmarra në zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese".

13. Përfundimisht, parashtruesit pretendojnë se, bazuar në nenin 65.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK), si paditës subsidiarë, i gëzojnë të njëjtat të drejta që i gëzon Prokurori Publik për të paraqitur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Parashtruesit, po ashtu, pretendojnë se neni 452.1 i KPPK-së përcakton Prokurorin Publik si subjekt për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, mirëpo, në këtë rast, funksionet e Prokurorit Publik janë bartur *ex lege* te parashtruesit, sepse Prokurori Publik ka hequr dorë nga ndjekja penale dhe se, gjithashtu, gjatë procedurës së padisë subsisidiare nuk ka iniciuar ndjekjen penale.

Dispozitat relevante ligjore

14. Neni 65 i KPPK-së përcakton:

"(1) Paditësi subsidiar gëzon të njëjtat të drejta të cilat i gëzon edhe prokurori publik, përveç atyre të cilat i takojnë prokurorit publik si organ i pushtetit".

"(2) Në procedurën e cila zbatohet në bazë të kërkesës së paditësit subsidiar, prokurori publik ka të drejtë që deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të ndërmarrë ndjekjen dhe të mbrojë akuzën".

15. Neni 443, paragrafi 1, i KPPK-së përcakton:

"(1) Rishikimin e procedurës penale mund ta kërkojnë palët dhe mbrojtësi. Pas vdekjes së të dënuarit, rishikimin mund ta kërkojë prokurori publik, bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, farefisi në vijë direkte deri në shkallë të parë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra ose prindi birësues i të dënuarit".

16. Neni 452, paragrafi 1, i KPPK-së përcakton:

"(1) Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqesë prokurori publik i Kosovës, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Pas vdekjes së të pandehurit kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të tij mund të paraqesin personat e paraparë në nenin 443, paragrafi 1, fjalia e fundit e këtij Kodi".

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të gjykuar kërkesën e parashtruesve, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

18. Neni 113.7 i Kushtetutës përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

19. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesit kanë parashtruar ankesa dhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në dy shkallë të pushtetit të rregullt gjyqësor, përkatësisht në Gjykatën Komunale në Gjilan dhe në Kolegjin Penal të së njëjtës, si dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe, rrjedhimisht, kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

20. Bazuar në shkresat e kërkesës, Gjykata vëren se konkludimet e Gjykatës Supreme janë të qarta dhe se ekziston lidhja logjike ndërmjet bazës juridike dhe arsyetimit të dhënë, gjë që tregon se vendimi i Gjykatës Supreme nuk është karakterizuar me padrejtësi ose me arbitraritet.

21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, përveç të tjerash, ka marrë për bazë edhe propozimin e Prokurorit Publik që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, e paraqitur nga parashtruesit në cilësi të paditësve subsidiarë, duhet të hedhet poshtë si e palejueshme, ngase është paraqitur nga persona të paautorizuar.

22. Gjykata ua përkujton parashtruesve se dispozitat përkatëse të KPPK-së, në të vërtetë, u lejojnë diskrecion Prokurorit Publik dhe Gjykatës Supreme të konkludojnë ashtu siç kanë konkluduar në rastin konkret.

23. Gjykata, po ashtu, ua përkujton parashtruesve se ka detyrim kushtetues që të respektojë parimin e ndarjes së pushteteve, të pavarësisë së organeve të pushtetit shtetëror të garantuar me Kushtetutë dhe të kontrollit e balancit ndërmjet tyre, ndërsa veprimi ndryshe do të ishte në kundërshtim me parimin e përmendur dhe, rrjedhimisht, kundërkushtetues.

24. Gjykata në mënyrë të ngjashme ka konkluduar më 12 dhjetor 2011 në Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI92/11, parashtrues

Muhamet Bucaliu – Vlerësim i kushtetushmërisë së Njoftimit të Prokurorit të Shtetit, KMLC. Nr. 37/11, të 2 qershorit 2011.

25. Përkitazi me këtë, parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre, duke shpjeguar se si dhe pse është kryer ndonjë shkelje, ose duke ofruar dëshmi për të vërtetuar se u është shkelur ndonjë e drejtë e garantuar me Kushtetutë.

26. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e gjetjes të fakteve dhe, me këtë rast, thekson se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i saj është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" *(Shih, mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65.; gjithashtu shih edhe Aktvendimin për papranueshmëri në rastin Nr. KI86/11, parashtrues i kërkesës Milaim Berisha, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 20/09, të datës 1 mars 2011, marrë nga Gjykata, më 5 prill 2012).*

27. Për më tepër, kërkesa nuk tregon se Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo në mënyrë të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me ato të gjykatave të rregullta. Si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë dëshmitë para vetes. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato dëshmi, *(Shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, App. Nr 13071/87, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 3, e 10 korrikut 1991).*

28. Fakti se parashtruesit nuk pajtohen me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë që të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të neneve 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës *(Shih, mutatis mutandis, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, Appl. nr. 5503/02, MezoturTiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).*

29. Në këto rrethana, parashtruesit nuk kanë mbështetur me prova pretendimet e tyre, e as shkeljet e nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk tregojnë se gjykatat e rregullta të tri instancave ua kanë mohuar atyre të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

30. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hedhet poshtë si e papranueshme, në pajtueshmëri me rregullin 36 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, si dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 6 dhjetor 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 84/12, Sindikata e Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, përfaqësuar nga z. Rifat Halili, kryetar i Sindikatës, dega në Vushtrri, datë 29 janar 2013- Kërkesë për përmirësimin e mirëqenies së pensionistëve dhe për realizimin e të drejtës së përfitimit të pensioneve për invalidët e punës nga autoritetet shtetërore

Rasti KI 84-2012, vendimi i datës 6 dhjetor 2012

Fjalët kyçe: Ligji i ri për Pensionistët dhe Invalidët e punës, Ligji për Sigurimin Shëndetësor, kërkesa individuale, person juridik, palë e paautorizuar

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës në cilësinë e personit juridik duke pretenduar se me mosmiratimin e Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor dhe të Ligjit për sigurimet shëndetësore, si dhe refuzimit të dhënies së pensioneve për invalidët e punës nga autoritetet qeveritare, pensionistëve u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 3.1 [Barazia Para Ligjit]; me nenin 7.1 [Vlerat]; me nenin 16.1 [Epërsia e Kushtetutës]; me nenin 19, paragrafi 1 dhe 2 [Zbatimi i së drejtës ndërkombëtare]; me nenin 22, paragrafi 1, 2 dhe 3 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare]; me nenin 23 [Dinjiteti i njeriut]; me nenin 25.1 [E drejta për jetën]; me nenin 27 [Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues]; me nenin 51, paragrafi 1 dhe 2 [Mbrojtja shëndetësore dhe sociale]; me nenin 84.2 [Kompetencat e Presidentit]; me nenin 119.4 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe me nenet 7, 22 dhe 25.1 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata kishte vërejtur se parashtruesi i kërkesës nuk kishte specifikuar ndonjë akt të autoritetit publik, me të cilin pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me konventat ndërkombëtare që aplikohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës. Por, vetëm ka ngritur çështjet që kanë të bëjnë me rregullimin e politikave sociale, përkatësisht me përmirësimin e mirëqenies së pensionistëve dhe të invalidëve të punës, duke kërkuar nga Gjykata që të sqarojë se përse kërkesat e parashtruesit (sindikatës), përkitazi me të drejtat e pensionistëve dhe të invalidëve të punës, nuk janë marrë parasysh nga autoritetet shtetërore.

Gjykata në këtë rast i është referuar 113, paragrafi 1, të Kushtetutës, që parasheh:*"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar"* ky paragraf në mënyrë të qartë parasheh se kush mund të konsiderohet palë e autorizuar për të ngritur çështje kushtetuese, përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së një akti të

një autoriteti publik a vlerësimin e kushtetutshmërisë së një ligji. Prandaj, Gjykata kishte konsideruar se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar që të referonte çështje kushtetuese "*in abstracto*" përkitazi me rregullimin e statusit të pensionistëve dhe të invalidëve të punës dhe, për këtë arsye, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës, kjo kërkesë konsiderohet e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI84/12
Parashtruesi
Sindikata e Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, përfaqësuar nga
z. Rifat Halili, kryetar i Sindikatës, dega në Vushtrri
Kërkesë për përmirësimin e mirëqenies së pensionistëve dhe për realizimin e të drejtës së përfitimit të pensioneve për invalidët e punës nga autoritetet shtetërore

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Sindikata e Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, dega në Vushtrri, përfaqësuar nga z. Rifat Halili, kryetar i së njëjtës.

Objekti i çështjes

2. Çështja bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) ka të bëjë me kërkesën/ankesën e Sindikatës së Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, dega në Vushtrri, për përmirësimin e mirëqenies së pensionistëve të Republikës së Kosovës dhe për realizimin e të drejtës së përfitimit të pensioneve për invalidët e punës.

3. Parashtruesi i kërkesës ka shtruar, po ashtu, edhe këto çështje:

   a. Të caktohet pensioni dhe shkalla e invaliditetit për kontributpaguesit në lartësinë 60% nga paga mesatare e të punësuarve në Administratë dhe në Shërbime Publike;

b. Të nxirret Ligji i ri për Pensionistët dhe Invalidët e punës, për faktin që ende nuk ka ligj për sigurimin pensional dhe invalidor;

c. Të nxirret Ligji për Sigurimin Shëndetësor, sepse tash e 13 vjet ai ende nuk është nxjerrë.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 28 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 18 shtator 2012, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën të pakompletuar në Gjykatë.

6. Më 25 shtator 2012, parashtruesit i është kërkuar që kërkesën e parashtruar ta plotësojë me dokumentacion të nevojshëm.

7. Më 1 tetor 2012, parashtruesi dorëzoi përgjigjen në kërkesë dhe kërkesa u regjistrua me nr. KI84/12.

8. Më 5 tetor 2012, Kryetari, me vendimin GJR. KI84/12, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin KSH. KI84/12, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy (anëtar) dhe Ivan Čukalović (anëtar).

9. Më 6 dhjetor 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 3 qershor 2003, Sindikata e Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Kosovës dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, paraqitën një padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, siç thuhet, kundër Republikës së Serbisë, duke u thirrur në ish-Kushtetutën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e KSAK, nr. 4/1974; Ligji mbi sigurimin

pensional dhe invalidor; Gazeta Zyrtare e KSAK, nr. 26/1983 dhe nr. 26/1986; Gazeta Zyrtare e KSAK, nr. 44/1983).

11. Sindikata e Pavarur e Pensionistëve i është drejtuar Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës me një kërkesë për zbatimin e Vendimit të Kuvendit të Kosovës, të 7 korrikut 2005, dhe kishte kërkuar hartimin e Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor (akti nr. 01.05.2006, drejtuar Ministrit të Shëndetësisë, për ndërmarrjen e masave për nxjerrjen e Ligjit, si dhe kërkesën për shërimin e pensionistëve nga organet shtetërore).

12. Më pas, parashtruesi (Sindikata) i kishte shkruar Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, duke e njoftuar për, siç thuhet, shkeljen e Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor, si dhe shkeljen e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 1999/24, më 12 dhjetor 1999, për pagimin e pensioneve. Parashtruesi, gjithashtu, i ishte drejtuar me një shkresë edhe Presidentit të Kosovës, ku, ndër të tjera, kishte kërkuar që të bisedohej për gjendjen e pensionistëve dhe për mundësinë e përmirësimit të mirëqenies së tyre. Sipas Sindikatës, Presidenti i Kosovës nuk kishte pranuar të bisedojë për çështjet në fjalë (akti nr. 6/22.01.2007). Më pas, parashtruesi i kishte shkruar Ministrit të MPMS-së dhe kishte kërkuar nga i njëjti zbatimin e Ligjit për pensionistët dhe invalidët e punës, zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 1999/24. Parashtruesi u ishte drejtuar, gjithashtu, edhe të gjitha partive politike, nga të cilat kishte kërkuar përkrahje në realizimin e të drejtave për pensionistët, duke zbatuar ligjet në fuqi.

13. Parashtruesi pohon se, në vazhdimësi, ju kishte shkruar autoriteteve të vendit, duke kërkuar nga të njëjtit realizimin e të drejtës për sigurimin pensional dhe invalidor. Së fundmi, pohon se janë njoftuar deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës për pakënaqësitë dhe për mospërfilljen e kërkesave të pensionistëve dhe invalidëve të punës nga autoritetet kompetente të vendit.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me mosmiratimin e Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor dhe të Ligjit për sigurimet shëndetësore, si dhe refuzimit të dhënies së pensioneve për invalidët e punës nga autoritetet qeveritare, pensionistëve u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 3.1 [Barazia Para Ligjit]; me nenin 7.1 [Vlerat]; me nenin 16.1 [Epërsia e Kushtetutës]; me nenin 19, paragrafi 1 dhe 2 [Zbatimi i së drejtës ndërkombëtare]; me nenin 22, paragrafi 1, 2 dhe 3 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare]; me nenin 23 [Dinjiteti i njeriut]; me nenin 25.1 [E

drejta për jetën]; me nenin 27 [Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues]; me nenin 51, paragrafi 1 dhe 2 [Mbrojtja shëndetësore dhe sociale]; me nenin 84.2 [Kompetencat e Presidentit]; me nenin 119.4 [Parimet e përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe me nenet 7, 22 dhe 25.1 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Gjykata, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që, së pari, të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

16. Parashtruesi i kërkesës duket të jetë i pakënaqur me autoritetet qeveritare, të cilat janë të thirrura që t'i parashohin dhe t'i rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me politikat sociale, përkatësisht me rregullimin e statusit të pensionistëve dhe invalidëve të punës. Parashtruesi ankohet edhe ndaj vendimeve të lëshuara nga autoritetet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) përkitazi me refuzimin e të drejtës së përfitimit të pensioneve për invalidët e punës.

17. Parashtruesi, gjithashtu, ka adresuar në Gjykatë shqetësimet e tij sa i përket Ligjit për sigurimin e pensioneve për pensionistet dhe invalidët e punës, si dhe sa i përket vonesës pa arsye të nxjerrjes së Ligjit për sigurimet shëndetësore nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht nga ministria përkatëse.

18. Gjykata ka vërejtur se parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar ndonjë akt të autoritetit publik *(shih, neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese),* me të cilin pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare që aplikohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës. Por, vetëm ka ngritur çështjet që kanë të bëjnë me rregullimin e politikave sociale, përkatësisht me përmirësimin e mirëqenies së pensionistëve dhe të invalidëve të punës, duke kërkuar nga Gjykata që të sqarojë se përse kërkesat e parashtruesit, përkitazi me të drejtat e pensionistëve dhe të invalidëve të punës, nuk janë marrë parasysh nga autoritetet shtetërore.

19. Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 1, të Kushtetutës, që parasheh:

> *Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]*
> *1. "Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".*

20. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata që t'u bëje thirrje autoriteteve qeveritare, përkatësisht ministrive përkatëse, që të hartojnë Ligjin për pensionistët dhe invalidët e punës, si dhe nxjerrjen e Ligjit për sigurimin shëndetësor.

21. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 4 të Kushtetutës që përcakton në mënyrë të qartë formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushteteve:

Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

[...]

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ

[...]

4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.

22. Neni 65 i Kushtetutës ka përcaktuar qartë kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës:

Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit]
[...]
(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;

23. Po ashtu, neni *93* i Kushtetutës përcakton qartë kompetencat e Qeverisë:

Neni 93 [Kompetencat e Qeverisë]

Qeveria ka këto kompetenca:

(1) propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;

[...]

(3) propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera;

(4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve.

24. Megjithatë, neni 113 i Kushtetutës, në mënyrë të qartë ka paraparë se kush mund të konsiderohet palë e autorizuar që të referojë çështje kushtetuese, përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së një akti të një autoriteti publik dhe përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së një ligji.

25. Faktikisht, parashtruesi i kërkesës në rastin konkret vepron si person juridik dhe i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, si bazë juridike për parashtrimin e kërkesës së tij.

26. Duke i vlerësuar dhe duke i analizuar me kujdes kërkesat e parashtruesit, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës, si person juridik, në rastin konkret nuk mund të konsiderohet palë e autorizuar që të mund të referojë çështje kushtetuese "*in abstracto*" përkitazi me kërkesën e tij për nxjerrjen e ligjeve dhe për miratimin e tyre, edhe pse parashtruesi posedon autoritet legjitim që t'i përfaqësojë dhe t'i mbrojë interesat dhe të drejtat e anëtarëve të Sindikatës, në rastin konkret, pensionistëve dhe invalidëve të punës.

27. Përveç kësaj, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk parasheh *actio popularis,* që është modalitet i ankesave individuale, çfarë i mundëson cilitdo individi, që tenton të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me pyetje dhe me kërkesa të caktuara, duke aluduar për shkelje të të drejtave kushtetuese të një individi a të një grupi të caktuar.

28. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar që të referojë çështje kushtetuese "*in abstracto"* përkitazi me rregullimin e statusit të pensionistëve dhe të invalidëve të punës dhe, për këtë arsye, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës, kjo kërkesë konsiderohet e papranueshme.

29. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit, dhe me rregullin 56.2 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 56.2 të Rregullores së punës, më 6 dhjetor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 92/12,.Sali Hajdari, datë 29 janar 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për pensionet

Lënda KI-92/12, Vendim i 6 dhjetorit 2012.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, actio popularis, pensionet, ligji, palë e paautorizuar

Parashtruesi paraqiti kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese të komentojë Ligjin për pensionet dhe mënyrën e llogaritjes së përvojës së punës. Parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar prova që do të ishin domethënëse për vendimin e Gjykatës, edhe pse Gjykata nëpërmjet një shkrese ka kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të plotësojë kërkesën e tij në mënyrën e paraparë me ligj.

Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ka kërkuar "koment për Ligjin për pensionet", i cili ende nuk aplikohet te parashtruesi i kërkesës, duke mos cekur se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur.

Duke vendosur për kërkesën e parashtruesit Sali Hajdari, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për të kontestuar kushtetutshmërinë e Ligjit për pensionet në abstrakt dhe për këtë arsye kjo kërkesë duhet shpallur e papranueshme, sepse kërkesën e ka paraqitur pala e paautorizuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI92/12
Parashtrues
Sali Hajdari
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për pensionet

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Sali Hajdari, nga komuna e Gjilanit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Ligjin për pensionet, por nuk cek as numrin e as datën e nxjerrjes së atij ligji.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa e parashtruesit të kërkesës që Gjykata Kushtetuese të komentojë Ligjin për pensionet dhe mënyrën e llogaritjes së përvojës së punës.

Baza ligjore

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe në nenin 21.4 të Kushtetutës, në nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56, paragrafi 2, të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Parashtruesi i kërkesës, më 12 shtator 2012, i parashtroi kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Me vendimin e Kryetarit (Nr. GJR.92/12, të 5 nëntorit 2012), gjyqtarja Snezhana Botusharova u emërua Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, me vendimin e Kryetarit (Nr. KSH. 92/12) u emërua Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

7. Më 6 dhjetor 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtares raportuese Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović, i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar prova që do të ishin domethënëse për vendimin e Gjykatës, edhe pse Gjykata nëpërmjet një shkrese ka kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të plotësojë kërkesën e tij në mënyrën e paraparë me ligj.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

9. Parashtruesi i kërkesës pretendon:

> *"E nderuara Gjykatë po ju drejtohem juve që ta komentoni ligjin mbi pensionin, kur është fjala te shtazhi i punës. Unë kam punuar në BVI për punësim Gjilan para lufte mbi 14 vite dhe pas lufte po në të njëjtën punë punoj që nga mbarimi i luftës që tani quhet QRPP për punësim në Gjilan. Unë tani jam afër pensionimit dhe sipas informatave për të marrë pensionin prej 81 euro, duhet sipas Ligjit që t'i kem shtazh pune mbi 15 vite para lufte. Kurse ky stazhi i pas luftës nuk të njifet dhe mbetesh në pagesën prej 45 euro".*

10. Parashtruesi i kërkesës më tej konsideron:

> *" E nderuara Gjykatë, unë shtazh pune i kam krejt 27 vite edhe para lufte dhe pas lufte si është e mundur që të krahasohem si me ata që*

të cilët nuk kanë as të vetmen ditë pune stazh. Duke e llogaritur 27 vite pune shtazh edhe 10 vite të okupatorit të egër që më kanë larguar nga puna bëjnë 37 vite pune, dhe prapë të mbetem si pa asnjë ditë mua ma merr mendja që më shkilen të drejtat e njeriut më këtë Ligj".
"E nderuara Gjykatë kolegët e mi që e pranuan okupatorin dhe mbetën në punë gjatë okupimit ata tani janë ma në favor dhe po shkojnë në pension me 81 euro kurse unë i gjori mbetem në 45 euro".

11. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me këtë kërkesë:

"Për mos me zgjat ma shumë, besoj që e keni kuptuar se qka po kërkoj nga ju. Ju lutem që të ma ktheni një komentim se kujt duhet t'i drejtohem ose të pajtoj me këto ligje diskriminuese. Dhe t'i marr qato 45 euro si ata që s'kanë punuar asnjëherë".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

12. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës.

13. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafët 1 dhe 7, të Kushtetutës:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

14. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ka kërkuar "koment për Ligjin për pensionet", i cili ende nuk aplikohet tek parashtruesi i kërkesës, ndërkohë që Kushtetuta, në nenin 113, e definon qartë se kush mund të kërkojë vlerësimin e kushtetutshmërisë së një ligji.

15. Një kërkesë e tillë, për "*koment për ligjin për pensionet*" në dobi të të gjithë pensionistëve kosovarë, tregon se parashtruesi i kërkesës

konteston në abstrakt ligjin në fjalë. Po qe se ky është qëllimi i parashtruesit të kërkesës, si individ, ai nuk mund të konsiderohet si palë e autorizuar.

16. Faktikisht, parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës si bazë juridike për parashtrimin e kërkesës së tij. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk paraqet argumente me të cilat do të dëshmonte se është viktimë e drejtpërdrejtë e miratimit të këtij ligji.

17. Neni 113, paragrafët 2, 6 dhe 8 të Kushtetutës, në mënyrë eksplicite përcakton se kush janë palët e autorizuara për t'iu drejtuar Gjykatës përkitazi me pyetjet në abstrakt të vlerësimit kushtetues të ligjit.

18. Përveç kësaj, sistemi i drejtësisë kosovare nuk parasheh *"actio popularis",* që është modalitet i ankesave individuale, çfarë i mundëson cilitdo individ, që tenton të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me rastin e shkeljeve të tilla, edhe pse nuk e ka statusin e viktimës.

19. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për të kontestuar kushtetutshmërinë e Ligjit për pensionet në abstrakt dhe për këtë arsye kjo kërkesë duhet shpallur e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në përputhshmëri me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7, të Kushtetutës, në përputhshmëri me nenet 46, 47 dhe 48 të Ligjit si dhe në përputhshmëri me rregullin 36 (1a) dhe (3c) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, në seancën e mbajtur më 6 dhjetor 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 76/12, Qamil Xhemajli, datë 29 janar 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të paspecifikuar të Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me pensionimin e doktorëve të shkencës në Universitetin e Prishtinës.

Lënda KI-76/12, Vendim i 23 nëntorit 2012.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, qartazi i pabazuar

Parashtruesi paraqiti kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar vendimin e paspecifikuar të Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me pensionimin e doktorëve të shkencës në Universitetin e Prishtinës, të cilin parashtruesi i kërkesës nuk e ka specifikuar me numër, datë ose në një mënyrë tjetër, dhe as që ka cekur se ku është publikuar ky vendim, kështu që ai nuk ka cekur as përmbajtjen e vendimit të cilin e konsideron antikushtetues.

Objekt i çështjes janë të drejtat të cilat parashtruesi i kërkesës konsideron se i takojnë në bazë të vendimit të paspecifikuar të Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me pensionimin e doktorëve të shkencës, të cilët punojnë në U.P., për çka parashtruesi i kërkesës konsideron së të njëjtat të drejta duhet t'u takojnë edhe doktorëve të tjerë, të cilët nuk kanë punuar në U.P. ose të cilët nuk kishin doktoruar në U.P.

Parashtruesi i kërkesës nuk i ka cekur nenet kushtetuese të cilat konsideron se janë shkelur dhe, gjithashtu, nuk ka ofruar dëshmi të tjera, të cilat do të ishin të rëndësishme për vendimin të Gjykatës, edhe pse Gjykata ka kërkuar me shkrim prej parashtruesit të kërkesës ta dërgojë vendimin e Qeverisë, të cilin e konsideron antikushtetues.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e Qamil Xhemalit, Gjykata Kushtetuese, pasi i shqyrtoi proceduarat në përgjithësi, gjeti se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të cekë dhe ta mbështetë me dëshmi se me cilin vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës pretendohet t'i jenë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të kushtetuese, sepse të njëjtën nuk e ka paraqitur krahas me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, Gjykata gjeti se kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI76/12
Parashtruesi
Qamil Xhemajli
Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të paspecifikuar të Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me pensionimin e doktorëve të shkencës në Universitetin e Prishtinës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović , Zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Qamil Xhemajli nga Komuna e Pejës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i paspecifikuar i Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me pensionimin e doktorëve të shkencës të cilët punojnë në Universitetin e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: U.P.) sipas të cilit ata kanë të drejtë në një pension prej 1000 €, të cilin parashtruesi i kërkesës nuk e ka specifikuar me numër, datë ose në një mënyrë tjetër, dhe as që ka cekur se ku është publikuar ky vendim, kështu që ai nuk ka cekur as përmbajtjen e vendimit të cilin e konsideron antikushtetues.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes janë të drejtat të cilat parashtruesi i kërkesës konsideron se i takojnë në bazë të vendimit të paspecifikuar të Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me pensionimin e doktorëve të shkencës të cilët punojnë në U.P, për çka parashtruesi i kërkesës konsideron se të njëjtat të drejta duhet t'i takojnë edhe doktorëve të tjerë të cilët nuk kanë punuar në U.P. ose të cilët nuk kishin doktoruar në U.P.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, në nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: „Ligji“) dhe në rregullin 56. paragrafi 2. të Rregullores.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës më 16 gusht 2012, i parashtroi një kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: „Gjykata“).

6. Më 17. gusht 2012, Gjykata Kushtetuese e informoi parashtruesin e kërkesës që kërkesën e tij ta plotësojë në formularin i cili është i përcaktuar nga ana e Gjykatës dhe në të njëjtën kohë të dorëzojë vendimin e Qeverisë të cilin e konsideron antikushtetues, si dhe dëshmitë se me këtë vendim janë shkelur të drejtat të tij kushtetuese.

7. Parashtruesi i kërkesës më 23 gusht 2012, paraqiti një formular të plotësuar për paraqitjen e kërkesës, por jo edhe vendimin e Qeverisë të cilin e konsideron antikushtetues.

8. Me vendimin e presidentit (nr. GJR. 76/12 të 04 shtatorit 2012), gjykatësi Ivan Čukalović u emërua si Gjyqtar Raportues. Të njëjtën ditë, me vendimin e presidentit nr. KSH. 76/12 u emërua Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtaret: Almiro Rodrigues (kryetar), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

9. Më 23 nëntor 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues Ivan Čukalović, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryetar), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu, i rekomanduan gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës është Dr. i shkencës së agroekonomisë i cili ka doktoruar në Universitetin e Beogradit më 2 korrik 1986.

11. Parashtruesi i kërkesës më 19 qershor 2012 i paraqiti një ankesë Avokatit të Popullit në lidhje me vendimet të Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me pensionimin e doktorëve të shkencës të cilët punojnë në U.P.

12. Institucioni i Avokatit të Popullit më 30 qershor 2012 i dërgoi parashtruesit të kërkesës njoftim për papranueshmërinë në të cilin ndër të tjera cek:

"Meqenëse nga dëshmitë e paraqitura dhe rrethanat e përshkruara në ankesë tuaj rezulton se proceduarat, lidhur me lëndën tuaj janë duke u zhvilluar në organet kompetente, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 20, pika 1.3 të Ligjit për Avokatin e Popullit, ka vendosur ta refuzojë ankesën tuaj si pabazuar.."

13. Parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi të tjera të cilat do të ishin të rëndësishme për vendimin të Gjykatës edhe pse Gjykata ka kërkuar me shkrim prej parashtruesit të kërkesës ta dërgojë vendimin e Qeverisë të cilin e konsideron antikushtetues.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon si në vijim:

"Ankesa e ime ka të bëjë me Vendimin e Qeverisë së RK lidhur me pensionimin e dr. Të shkencave nga UP me pensionimin mujor prej 1000 € në muaj. Ky Vendim është publikuar nga RTK. Nga organet kompetent kam kërkuar Vendimin në fjalë, por nuk kam marr kurrfarë përgjigje!"

"Nga z. Kryeministri dhe Ministri i Drejtësisë z. H. Kuqi më 8. 07. 2012. kam kërkuar që ky Vendim të plotësohet edhe për shkencëtarë që kanë kontribuar në ekonominë Kosovare, por përgjigjja si zakonisht ka munguar!."

15. Parashtruesi me tej konsideron që:

"...me këtë Vendim seleksionues është bërë shkelja e Ligjeve, sepse me të gjitha diplomat e Universitetit (Zagrebit dhe Beogradit) shkruan së „doktorit të shkencave u TAKOJNË të gjitha të drejtat të parapara me ligj".

"Ky Vendim është selektues, ofendues, antiligjor dhe antikushtetues sepse doktorët e shkencave i ndan në dy grupe: a) ata të merituar dhe b) në ata ma pak të merituar që është absurd pa presedanë."

16. Parashtruesit e kërkesës i drejtohen Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë si në vijim:

"Kërkoj nga Gjykata juaj që vendimin e Qeverisë së Kosovës të shpalle antikushtetues."

"Deklaroj së në vitin 1996 jam pensionuar me dhunë dhe mu ka dashtë të pres 12 vite gjersa i kom plotësuar kushtet e pensionit të pleqërisë."

"Jam në moshë të shtyre (74 vite) dhe lëngojë prej shume sëmundjeve të pa shëruara dhe kam pak gjasa të shfrytëzojë këtë të drejt ligjore."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Në mënyre që Gjykata të mund të gjykojë kërkesën e parashtruesit, së pari duhet të vlerëson nëse parashtruesi i ka plotësuar kushtet e pranueshmerisë të parapara me Kushtetutën dhe Ligjin, si dhe me Rregulloren e Punës.

18. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113. paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar."

"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritet publike tët të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuar me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

19. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejtat dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron të kontestoj."

20. Përveç kësaj, rregulli 36 (2) (d) parashikon:

"2. Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:

"d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

21. Parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi *prima facie,* e cila tregon që ka pasur shkelje të drejtave të tij kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi KEDLJ në lidhje me pranueshmerinë e kërkesës, nr. 53363/99 i 31 majit 2005).

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i ja në shkelur të drejtat me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me pensionimin e doktorëve të shkencës të cilit punojnë në Universitetin e Prishtinës, duke mos paraqitur këtë Vendim me të cilin parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.

23. Në fund, kushtet për pranueshmerinë nuk janë plotësuar në këtë parashtresë. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të cekë dhe mbështet me dëshmi me cilin Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës gjoja ju kanë shkelur drejtat dhe liritë e tij të kushtetuese, sepse të njëjtën nuk e ka paraqitur krahas me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese.

24. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2d) të Rregullores së punës e cila parasheh *„Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenit 46, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullit 36 (2d) të rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 23 nëntor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportuese
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 68/12, Haxhi Morina, datë 29 janar 2013-Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 313/2009, të 26 marsit 2012

Lënda KI 68/12, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 nëntorit 2012.

Fjalët kyçe: barazia para ligjit, qartazi e pabazuar, nuk janë shteruar të gjitha mjetet efektive juridike, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkeljet e të drejtave dhe lirive individuale.

Parashtruesi paraqiti kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, A. nr. 313/2009, të 26 marsit 2012, sepse parashtruesi ka marrë një vendim të formës së prerë dhe të detyrueshëm nga Drejtoria për Çështje Juridike dhe Pronësore dhe Konsolidimi i Tokës në Komunën e Gjakovës, më 27 maj 2008, i cili miratoi kërkesën e parashtruesit dhe i ktheu në posedim dhe në pronësi pronën e paluajtshme që ishte eksproprijuar nga ai.

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata vlerësoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi e kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka paraqitur asnjë provë që tregon se të drejtat dhe liritë e tij ishin shkelur nga Gjykata Supreme. Për më tepër, Gjykata konstatoi se parashtruesi ka paraqitur një ankesë në Kolegjin për Ankesa të Dhomës së Posaçme, e cila ende nuk ka nxjerrë një vendim për këtë çështje.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI 68/12
Parashtrues
Haxhi Morina
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 313/2009, të 26 marsit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Haxhi Morina, me banim në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi), i përfaqësuar nga z. Rexhep Gjikolli, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, A. nr. 313/2009, e 26 marsit 2012, që i është dorëzuar atij më 23 maj 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se aktgjykimet e lartpërmendura kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe me nenin 31 [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e

mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 13 korrik 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 4 shtator 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. GJR. KI68/12, caktoi Gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. KSH. KI-68/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 16 shtator 2012, kërkesa i është komunikuar Gjykatës Supreme, Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

8. Më 5 nëntor 2012, Gjykata kërkoi informata nga Gjykata Komunale në Gjakovë dhe nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme përkitazi me statusin e rastit nr. SCC-06-0214, të 8 marsit 2010.

9. Më 12 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Gjakovë iu përgjigj kësaj Gjykate, duke i ofruar informacionin se, parashtruesi, më 29 qershor 2011, ka parashtruar një ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, C. nr. 700/06, të 25 nëntorit 2010. Kjo ankesë është dërguar për shqyrtim dhe për vendim në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, më 26 tetor 2011.

10. Më 14 nëntor 2012, Dhoma e Posaçme iu përgjigj kësaj Gjykate duke ofruar informacion se, sa i përket rastit SCC-06-0214, *"[...] Dhoma e Posaçme ende nuk ka vendosur në meritat e rastit. Ky rast është në pritje për t'u zgjidhur para Kolegjit Ankimor të Dhomës së Posaçme"*.

11. Më 27 nëntor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

12. Më 7 maj 1981, Sekretariati për Ekonomi dhe Financa në Komunën e Gjakovës, (Vendimi 03-465-26/1978), eksproprijoi pronën e paluajtshme të parashtruesit për nevojat e SHAM "Mustafa Bakija". Në

përputhje me këtë vendim, kjo pronë e paluajtshme ishte regjistruar në kadastër me emër të SHAM "Mustafa Bakija.

13. Më 12 korrik 1994, parashtruesi parashtroi një kërkesë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Pronësore dhe Konsolidimit të tokës në Komunën e Gjakovës, duke kërkuar kthimin e pronës së paluajtshme sepse SHAM "Mustafa Bakija" asnjëherë nuk e ka shfrytëzuar pronën për qëllimin për të cilin ishte eksproprijuar.

14. Më 27 maj 2008, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Pronësore dhe Konsolidimit të Tokës në Komunën e Gjakovës (Vendimi 11, nr. 19-465-11/94-08):

    a. Miratoi kërkesën e parashtruesit dhe ia ktheu në posedim dhe në pronësi pronën e paluajtshme, që ishte eksproprijuar nga ai;

    b. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Gjakovës, duhet të çregjistrojë si pronar SHA "STARTI" (ish-SHAM "Mustafa Bakija") në Gjakovë dhe ta regjistrojë pronën e paluajtshme në emër të parashtruesit; dhe

    c. SHA "STARTI" (ish-SHAM "Mustafa Bakija") në Gjakovë ishte urdhëruar t'ia kthente parashtruesit në posedim pronën e paluajtshme.

    Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Pronësore dhe Konsolidimit të Tokës në Komunën e Gjakovës konstatoi se prona e paluajtshme e eksproprijuar nuk ishte shfrytëzuar për destinimin e caktuar, p.sh.: për të ndërtuar një poligon për ushtrime praktike të shoferëve dhe të autobusëve, dhe kjo situatë faktike ishte përcaktuar gjatë vizitës së vendit nga ekspertët përkatës. Prandaj, në pajtim me nenin 8, të Ligjit për Amendamentim dhe Plotësim të Ligjit për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e KSAP, nr. 42/86), Drejtoria për Çështje Juridike dhe Pronësore dhe Konsolidimit të Tokës në Gjakovë erdhi në konkludim se supozimet e parapara ishin përmbushur në pajtim me nenin 8, për kthimin e pronave të paluajtshme të eksproprijuara, pasi që, në afatin 5 vjet nga dita e përcaktimit të ndërtimit, shfrytëzuesi nuk e ka realizuar qëllimin për të cilin ishte eksproprijuar prona e paluajtshme.

    Kundër këtij vendimi ishte lejuar ankesë brenda 30 ditësh. Pasi askush nuk ishte ankuar ndaj këtij vendimi, i njëjti mori formë të prerë dhe u bë detyrues më 11 gusht 2008.

15. Parashtruesi, në pajtim me Vendimin e Drejtorisë për Çështje Juridike dhe Pronësore dhe Konsolidimit të Tokës në Komunën e Gjakovës, parashtroi një kërkesë në Agjencinë Kadastrale në Komunën e Gjakovës, për të regjistruar pronën e paluajtshme në emër të tij.

16. Më 18 nëntor 2008, Zyra Kadastrale në Komunën e Gjakovës pezulloi përkohësisht çështjen administrative për transferimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme në emër të parashtruesit. Zyra Kadastrale në Gjakovë ka konstatuar se, për t'u regjistruar parashtruesi si pronar i paluajtshmërisë, është i nevojshëm pëlqimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në Kosovë, e cila, sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, është kompetente për ndërmarrjet shoqërore dhe për pasuritë e tyre.

17. Më 1 dhjetor 2008, Zyra Kadastrale në Komunën e Gjakovës hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për të regjistruar pronën e paluajtshme në emrin e tij, në pajtim me Vendimin e Drejtorisë për Çështje Juridike dhe Pronësore dhe Konsolidimin e Tokave, sepse parashtruesi nuk kishte dorëzuar pëlqimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për të regjistruar pronën në emrin e tij. Zyra Kadastrale në Gjakovë konstatoi: "*Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2002/12 AKM, tash AKP administron ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet shoqërore, prandaj, duke u nisur nga kjo, kërkohet gjithashtu edhe pëlqimi për transferimin e pronësisë në kadastër*".

18. Parashtruesi parashtroi kërkesë për rivlerësim në Zyrën Kadastrale në Komunën e Gjakovës.

19. Më 9 dhjetor 2008, Zyra Kadastrale në Komunën e Gjakovës mbështeti vendimin e 1 dhjetorit 2008. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

20. Më 31 mars 2009, Agjencia Kadastrale e Kosovës hodhi poshtë, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit dhe mbështeti vendimin e Zyrës Kadastrale në Gjakovë, të 9 dhjetorit 2008. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën Supreme.

21. Më 26 mars 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi A. nr. 313/2009) hodhi poshtë, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit. Gjykata Supreme konstatoi se Agjencia Kadastrale e Kosovës ka vendosur në mënyrë të duhur për çështjen.

Procedura në Dhomën e Posaçme

22. Më 11 maj 2006, parashtruesi inicioi një procedurë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, duke kërkuar që të konfirmojë pronësinë për pronën e paluajtshme të kontestuar.

23. Më 24 tetor 2006, Dhoma e Posaçme nxori një vendim (SCC-06-0214), me ç'rast ankesa kundër SHAM "Mustafa Bakija" ishte referuar në Komunën e Gjakovës për gjykim. Rasti në Gjykatën Komunale në Gjakovë ishte regjistruar me numër C. nr. 700/06.

24. Më 8 mars 2010, parashtruesi parashtroi kërkesë për masë të përkohshme në Dhomën e Posaçme dhe në Gjykatën Komunale në Gjakovë.

25. Më 25 nëntor 2010, Gjykata Komunale në Gjakovë (Aktgjykimi C. nr. 700/06) hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Më 26 qershor 2011, parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi në Dhomën e Posaçme.

26. Më 28 gusht 2012, Kolegji Ankimor i Dhomës së Posaçme ia komunikoi palës së paditur dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit për përgjigje ankesën e parashtruesit.

27. Më 26 shtator 2012, Agjencia Kosovare e Privatizimit e Kosovës dorëzoi një përgjigje përkitazi me kërkesën.

28. Prandaj, përkitazi me rastin, Dhoma e Posaçme nuk ka vendosur ende për meritat e rastit. Ky rast është në pritje për t'u zgjidhur në Kolegjin Ankimor të Dhomës së Posaçme.

Pretendimet e parashtruesit

29. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Vendimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Vendimi i Zyrës Kadastrale në Gjakovë, janë marrë në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, sepse parashtruesi ka marrë një vendim të formës së prerë dhe të detyrueshme nga Drejtoria për Çështje Juridike dhe Pronësore dhe Konsolidimi i Tokës në Komunën e Gjakovës, më 27 maj 2008, i cili miratoi kërkesën e parashtruesit dhe i ktheu në posedim dhe në pronësi pronën e paluajtshme që ishte eksproprijuar nga ai. Më tej, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtjen e Ambientit në Komunën e Gjakovës ishte urdhëruar që të regjistronte pronësinë në emrin e parashtruesit.

30. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se Agjencia Kosovare e Privatizimit është vënë mbi ligjin, sepse Agjencia Kadastrale ka kërkuar nga parashtruesi që ta ketë pëlqimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për ta regjistruar pronësinë e pronës së paluajtshme.

31. Për më tepër, parashtruesi pretendon se procedura për kthimin e pronës ishte iniciuar para se të themelohej Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit asnjëherë nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim procedural.

32. Parashtruesi gjithashtu pretendon se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, neni 24 [Barazia para Ligjit], sepse Dhoma e Posaçme ka miratuar kërkesën e fqinjëve të parashtruesit për masë të përkohshme, përderisa kërkesa e parashtruesit pretendohet se as nuk është shqyrtuar nga Dhoma e Posaçme, edhe pse rasti ishte identik me atë të fqinjëve.

33. Për më shumë, parashtruesi pohon se e drejta e tij për gjykim të drejtë pretendohet të jetë shkelur.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

34. Parashtruesi pretendon se ishte shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe me nenin 31 [e Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] të Kushtetutës. Gjykata vëren se, për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

35. Sa i përket Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, A. nr. 313/2009, të 26 marsit 2012, me ç'rast ishte hedhur poshtë si e pabazuar ankesa e parashtruesit dhe ishte mbështetur vendimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve apo të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmëri). Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt për sa i përket vendimeve të gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96,*

para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

36. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe para organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (*Shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991*).

37. Në rastin konkret, parashtruesi thjesht konteston nëse Gjykata Supreme ka zbatuar tërësisht ligjin e zbatueshëm dhe nuk pajtohet më gjetjet faktike të Gjykatës Supreme përkitazi me rastin e tij.

38. Faktikisht, parashtruesi nuk e ka mbështetur ankesën në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar dëshmi se, nga Gjykata Supreme, janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk vëren që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (*Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për papranueshmëri të Kërkesës, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009*).

39. Prandaj, parashtruesi nuk ka treguar si dhe pse Gjykata Supreme ka vendosur "në mënyrë të njëanshme", duke i mohuar kështu të drejtën e tij në pronë.

40. Del se kërkesa është e papranueshme, sepse është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës.

41. Sa i përket pretendimit të parashtruesit se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, Gjykata thekson se mund të vendosë për pranueshmëri të një kërkese vetëm nëse parashtruesi tregon se ai/ajo i ka shteruar të gjitha mjetet efektive juridike në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit që parasheh:

> *Neni 113.7 i Kushtetutës: "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj";*

Neni 47.2 i Ligjit: "Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

42. Arsyetimi mbi kërkesën e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve kompetente, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike për shkeljet e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (*Shih, Aktvendimi për papranueshmëri: Universiteti AAB-RIINVEST sh.p.k. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI41/09, i 21 janarit 2010; dhe shih, mutatit mutandis, ECHR, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999*).

43. Në rastin konkret, Gjykata gjen se parashtruesi ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë, C. nr 700/06, në Kolegjin Ankimor të Dhomës së Posaçme, duke pretenduar se ai është pronar i pasurisë së paluajtshme, sepse SHAM "Mustafa Bakija" asnjëherë nuk e ka shfrytëzuar për qëllimet që ishte eksproprijuar, dhe kërkoi që SHAM "Mustafa Bakija", nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit të Kosovës, t'ia njohë të drejtën e pronësisë dhe t'ia lejojë ta regjistrojë në regjistrat e kadastrës. Kolegji Ankimor i Dhomës së Posaçme ende nuk ka nxjerrë një vendim për këtë çështje.

44. Del se parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 47 (2) të Ligjit, sepse çështja se kush është pronari i ligjshëm i pasurisë së paluajtshme të kontestuar ende nuk është zgjidhur nga Kolegji Ankimor i Dhomës së Posaçme.

45. Për këto arsye, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1.c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 27 nëntor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KO 131/12, Dr.Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, datë 29 janar 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësinë, Nr. 04/L-125; të miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012.

Rasti KO 131/12, Vendim për masë të përkohshme, i 24 dhjetorit 2012.

Fjalë kyçe: Kërkesë nga Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit, masa e përkohshme.

Parashtruesi konsideron *inter alia* se Ligji për Shëndetësinë përmban dispozita që punëtorët shëndetësorë i vënë në pozita të pabarabarta me të punësuarit në institucione të tjera publike dhe, rrjedhimisht, edhe në pozitë të mos jenë të barabartë para ligjit me punonjësit e tjerë të institucioneve publike.

Parashtruesi kërkon vlerësimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën e Kosovës të neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit të kontestuar.

Më tej, parashtruesi ka kërkuar aplikimin e masës së përkohshme të pezullimit të zbatimit të Ligjit, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës përkitazi me këtë kërkesë.

Me qëllim të evitimit të cenimit të mundshëm të interesit publik dhe të së drejtës së garantuar me Kushtetutë për mbrojtje shëndetësore, Gjykata konsideron se ka arsye për aplikimin e masës së përkohshme për kohë të caktuar.

Për të evituar mundësinë e cenimit edhe të kësaj të drejte të garantuar me Kushtetutë, Gjykata rithekson nevojën për aplikimin e masës së përkohshme për kohë të caktuar.

Prandaj, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të kërkesës, miratohet kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme dhe njëzëri lejojë masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 31 janar 2013, prej ditës së miratimit të këtij Vendimi dhe pezulloi zbatimin e neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të 13 dhjetor 2012, në kohëzgjatje të njëjtë;

VENDIM PËR VAZHDIMIN E MASËS SË PËRKOHSHME
në
Rastin nr. KO131/12
Parashtruesi
Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës
Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësinë nr. 04/L-125, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 13 dhjetor 2012.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, Gjyqtare

Hyrje

1. Më 24 dhjetor 2012, Gjykata Kushtetuese vendosi masë të përkohshme në lidhje me Kërkesën e lartpërmendur. Në vendimin e saj, Gjykata Kushtetuese, mes tjerash, vendosi:

   "...

   I. TË LEJOJË masën e përkohshme;

   II. TË LEJOJË masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 31 janar 2013 prej ditës së miratimit të këtij Vendimi;

   III. TË PEZULLOHET MENJËHERË zbatimi i neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësinë, nr. 04/L-125, të 13 dhjetorit 2012, për të njëjtën kohëzgjatje;

   ..."

2. Sa i përket vazhdimin e së afatit të Masës së Përkohshme si më lart, Gjykata rithekson që «mbrojtja e shëndetit» është kategori kushtetuese

dhe si e tillë, është interes publik që është e drejtë e patjetërsueshme dhe e pacenueshme e njeriut që i përket secilit individ.

3. Në këtë drejtim, duke pasur parasysh që afati kohor i Masës së Përkohshme vendosur nga Gjykata më 24 dhjetor 2012 do të skadojë më 31 janar 2013, si dhe që Gjykata më 24 janar 2013 mori vendim të mbajë dëgjim publik, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të Kërkesës, afati kohor i Masës së Përkohshme vazhdohet për tre (3) muaj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të nenit 116(2) të Kushtetutës, nenit 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, si dhe Rregullit 55 të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese, pasi shqyrtoi çështjen më 24 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TË VAZHDOJË afatin kohor të Masës së Përkohshme të vendosur nga Gjykata në vendimin e saj fillestar të datës 24 dhjetor 2012, për një periudhë të mëtutjeshme prej tre (3) muaj deri më 30 prill 2013;

II. TË MBETET e përkushtuar për çështjen;

III. Ky vendim do t'u komunikohet Palëve; dhe

IV. Ky Vendim do të shpallet në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit, si dhe hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 39/11, Tomë Krasniqi, datë 30 janar 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit Nr. 311/07, të 13 prillit 2007, dhe Vërtetimit Nr. 322/07, të 30 prillit 2007, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

Rasti KI 39/11, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 nëntorit 2012.

Fjalë kyçe: Kërkesë Individuale, mosshterje e mjeteve efektive juridike, palë e paautorizuar, e drejta në pension, e drejta për gjykim të drejtë dhe të pavarur

Parashtruesi pretendon shkelje të nenit 1(2) [Përkufizimi i Shtetit]; të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; të nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut]; të nenit 24(1) [Barazia para Ligjit]; të nenit 31 (1) [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; të nenit 32 [E drejta për Mjete Juridike]; të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës]; të nenit 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 1 [Detyrimi për të Respektuar të Drejtat e Njeriut]; me nenin 6(1) [E Drejta për një Proces të Rregullt]; me nenin 13 [E Drejta për Zgjidhje Efektive]; me nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit]; me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [Mbrojtja e Pronës]; me nenin 1 të Protokollit Nr. 12 [Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit] të Konventës.

Parashtruesi pretendon se institucionet e Republikës së Kosovës, me veprimet gjegjësisht me mosveprimet e tyre, kanë shkelur dispozitat e lartpërmendura të Kushtetutës dhe të Konventës në dëm të tij, me ç'rast parashtruesi është diskriminuar dhe i janë mohuar, ndër të tjera, e drejta për pronë, e drejta për mbrojtje shëndetësore dhe sociale, e drejta për proces të rregullt dhe e drejta për zgjidhje efektive.

Parashtruesi pretendon se kërkesa e tij ka të bëjë me interesin e përgjithshëm publik dhe jo vetëm me atë personal. Me interesin e përgjithshëm publik përfshihen pensionistët e të gjitha kategorive (pensionistët e pleqërisë, pensionistët invalidorë dhe pensionistët familjarë).

Parashtruesi, në procedurë administrative, ka kërkuar nga e paditura (Ministria-DAPK) që t'ia mundësojë pagesën periodike të pensioneve të arritura e të papaguara dhe t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar, që nga data kur ai mëton se kjo e drejtë i është mohuar. Për realizimin e kësaj të drejte, parashtruesi pohon se ka ushtruar kërkesa dhe ankesa të përsëritura dhe ka marrë përgjigje negative.

Për sa i përket rastit në fjalë, parashtruesi nuk ka provuar se procedura administrative, që kishte iniciuar ai, ishte e paefektshme ose e pafrytshme,

përveç deklaratës së tij se ka marrë përgjigje negative. Dhe, në të njëjtën kohë, parashtruesi kishte zhvilluar procedurë civile po ashtu kundër Ministrisë (DAPK) në Gjykatën Komunale në Prishtinë, që ishte iniciuar më 4 maj 2007.

Në rastin në fjalë, parashtruesi nuk e ndoqi procedurën administrative deri në fund dhe në mënyrë pothuajse paralele inicioi procedurë civile në Gjykatën Komunale në Prishtinë, pa pranuar vendim përfundimtar në procedurë administrative. Prandaj, parashtruesi ka dështuar të veprojë në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Gjykata kërkesën e hedhë poshtë si të papranueshme, për shkak të mosshterjes së mjeteve juridike, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 47 të Ligjit.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI39/11
Parashtruesi
Tomë Krasniqi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit Nr. 311/07, të 13 prillit 2007, dhe Vërtetimit Nr. 322/07, të 30 prillit 2007, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Tomë Krasniqi, pensionist, me banim në Prishtinë.

Vendimet e kontestuara

2. Njoftimi Nr. 311/07, i 13 prillit 2007, dhe Vërtetimi Nr. 322/07, i 30 prillit 2007, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes ka të bëjë me humbjen e statusit të pensionistit, përkatësisht me ndërprerjen e pagesave të pensionit që i kishte fituar parashtruesi me Aktvendim të plotfuqishëm Nr. 181 – 1/98, të 11

qershorit 1998, nga Fondi për Sigurimin Pensional e Invalidor të Kosovës në Prishtinë.

Procedura në Gjykatë

5. Më 16 mars 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 18 prill 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI-39/11, caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI-39/11, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 6 korrik 2011, parashtruesi u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Institucionit të Avokatit të Popullit.

8. Më 4 gusht 2011, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale u përgjigj përkitazi me kërkesën e parashtruesit.

9. Më 14 tetor 2011, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë një shkresë që përmbante interpretimin juridik të së "drejtës së fituar" të titulluar "E DREJTA E FITUAR NË PENSION DHE SIGURIA JURIDIKE E SAJ".

10. Më 19 korrik 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI-39/11, caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues, pas përfundimit të mandatit të gjyqtares Gjyljeta Mushkolaj si gjyqtare e Gjykatës. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI-39/11, caktoi Kolegj shqyrtues të ri, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu.

11. Më 27 nëntor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Historiku i kërkesës

12. Më 3 maj 1998, parashtruesit i është pranuar e drejta në shfrytëzimin e pensionit të pleqërisë.

13. Më 11 qershor 1998, parashtruesi, me Aktvendim të plotfuqishëm Nr. 181-1/98 të Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës, fitoi statusin e pensionistit.

14. Parashtruesi, me punë dhe mbi bazën e punës së kaluar, në pajtim me legjislacionin në fuqi nga marrëdhënia e punës, sipas parimeve të solidaritetit dhe të reciprocitetit, në përputhje me Ligjin për Sigurimin Pensional e Invalidor, me sigurim të detyrueshëm fitoi të drejtën për shfrytëzimin e pensionit të pleqërisë. Parashtruesi fitoi të drejtën në fjalë në Bashkësinë rajonale të Fondit për Pensionim të Kosovës në Prishtinë.

15. Parashtruesi ka gëzuar të drejtën e fituar për shfrytëzimin e pensionit të pleqërisë deri në nëntor të vitit 1998, mirëpo, për shkak të rrethanave të krijuara në Kosovë, në fillim të vitit 1999, e drejta e parashtruesit për shfrytëzimin e pensionit të pleqërisë ishte ndërprerë pa kurrfarë baze ligjore.

Përmbledhja e fakteve përkitazi me procedurën administrative

16. Më 11 prill 2007, parashtruesi dorëzoi një ankesë në Departamentin e Administratës Pensionale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: DAPK), në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: Ministria), përkitazi me statusin e tij si pensionist, që parashtruesi e kishte fituar me Aktvendimin e plotfuqishëm Nr. 181-1/98, të 11 qershorit 1998, nga Fondi për Sigurimin Pensional e Invalidor të Kosovës.

17. Më 13 prill 2007, DAPK-ja lëshoi njoftimin me numër Ref. 311/2007 dhe, *ndër të tjera,* informoi parashtruesin se problemi i mospagesës së pensioneve të fituara në bazë të kontributeve paraqet një ndër problemet politike, tash për tash të pazgjidhura.

18. Më 30 prill 2007, DAPK-ja lëshoi vërtetimin Nr. 322/07 që, *ndër të tjera,* theksonte se parashtruesi i kërkesës figuron në evidencën për pagesën e pensionit të fituar në bazë të kontributeve nga Sigurimi Pensional e Invalidor në Prishtinë prej vitit 1998 e tutje.

19. Më 24 janar 2008, parashtruesi kishte paraqitur kërkesë në Ministri (DAPK) për njohjen e të drejtës së tij në pension, bazuar në kontributet e paguara.

20. Më 11 shtator 2009, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Nr. 280/09, urdhëroi Ministrinë (DAPK-në) ta njohë të drejtën e parashtruesit si pensionist kontributpagues.

21. Më 23 shtator 2009, derisa procedura ishte në zhvillim e sipër në Gjykatën Supreme të Kosovës, Ministria (DAPK), me Vendimin 104474, njohu të drejtën e parashtruesit si kontributpagues në shumë mujore 35 €, duke cekur gjithashtu në këshillë juridike se parashtruesi mund të ankohej kundër vendimit të Ministrisë (DAPK-së) brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Këshillit të ankesave në DAPK.

22. Më 19 nëntor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin A. 837/2009, ka kërkuar nga paditësi (parashtruesi) që, në afatin 15-ditësh nga dita e marrjes së Aktvendimit të të padituës (Ministrisë-DAPK-së) Nr. 280/09, të datës 11 shtator 2009, të deklarohet se a është i kënaqur me vendimin, ose nuk heq dorë nga padia. Parashtruesi ishte njoftuar se, nëse nuk vepron sipas Aktvendimit, Gjykata Supreme e Kosovës do ta pezullojë procedurën.

23. Më 23 shkurt 2011, Gjykata Supreme, me Aktvendimin A. nr. 837/2009, pezulloi procedurën, duke theksuar, *ndër të tjera,* si vijon:

> *"Aktvendimi i Gjykatës Nr. 9/2009, datë 01 qershor 2010, paditësit (Parashtruesit) i është dorëzuar më 27 nëntor 2010. Paditësi nuk është deklaruar në afatin e caktuar me aktvendim.*
>
> *Meqë paditësi (Parashtruesi) në afatin e lënë nuk është deklaruar, Gjykata në përputhje me nenin 32. par 1 të LPK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi".*

24. Më 4 gusht 2011, Ministria (DAPK) iu përgjigj Gjykatës përkitazi me kërkesën e parashtruesit, duke cekur, *ndër të tjera,* se parashtruesit të kërkesës i janë njohur të drejtat si shfrytëzues i pensionit bazë dhe pensionit kontributpagues dhe se çështja e pensioneve nga fondi i ish-Federatës Jugosllave mund të zgjidhet vetëm pas negociatave ndërshtetërore.

Përmbledhja e fakteve përkitazi me procedurën civile

25. Më 4 maj 2007, parashtruesi paraqiti padinë C. nr. 1155/07 në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër Qeverisë së Kosovës, përkatësisht kundër Ministrisë (DAPK-së), duke kërkuar rikthimin e statusit të pensionistit kontributpagues dhe kompensimin e shumave nga pensionet e arritura dhe të papaguara në vlerë 18.360 €.

26. Më 14 janar 2008, parashtruesi paraqiti urgjencën e parë në Gjykatën Komunale në Prishtinë për të thirrur seancë gjyqësore përkitazi me padinë C. nr. 1155/07, të datës 4 maj 2007.

27. Më 16 qershor 2008, parashtruesi paraqiti urgjencën e dytë në Gjykatën Komunale në Prishtinë për të thirrur seancë gjyqësore përkitazi me padinë C. nr. 1155/07, të datës 4 maj 2007.

28. Më 17 dhjetor 2008, parashtruesi paraqiti urgjencën e tretë në Gjykatën Komunale në Prishtinë për të thirrur seancë gjyqësore përkitazi me padinë.

29. Më 9 janar 2009, parashtruesi paraqiti parashtresë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me ç'rast kërkoi nga gjykata në fjalë që të konstatojë se parashtruesi ka statusin e pensionistit me të drejta të plota që nga data 1 dhjetor 1998 e tutje, mbi bazën e kontributeve të paguara nga ai për 40 vjet stazh pune.

30. Për më tepër, parashtruesi, mbi bazën e parashtresës së lartpërmendur, kërkoi nga Gjykata Komunale në Prishtinë që të obligojë Republikën e Kosovës, gjegjësisht Ministrinë (DAPK-në), si palë të paditura, t'i paguajnë pensionet e arritura prej 1 dhjetorit 1998 deri në paraqitjen e padisë, në vlerë 18.360 €, dhe nga muaji maj i vitit 2007 t'i paguajnë atij shumën 180 € në muaj, derisa ai ka të drejtë në këtë pagesë, si dhe shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afatin 15-ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

31. Më 28 qershor 2010, parashtruesi paraqiti një tjetër parashtresë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me ç'rast kërkoi përshpejtimin e procedurës gjyqësore dhe caktimin e seancës kryesore përkitazi me lëndën e tij, sepse prej dorëzimit të kërkesëpadisë kishin kaluar më shumë se 3 (tri) vjet.

Procedura në institucionet e tjera

32. Më 30 shtator 2009, Institucioni i Avokatit të Popullit, pas kërkesës së parashtruesit, kërkoi nga Gjykata Komunale në Prishtinë që të informohet për veprimet e ndërmarra dhe ato që planifikohen të ndërmerreshin nga gjykata në fjalë përkitazi me padinë e parashtruesit.

33. Gjykata Komunale në Prishtinë iu përgjigj kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit, duke nënvizuar se ka pranuar padinë nga

parashtruesi i kërkesës, si dhe përgjigjen e palës së paditur dhe se do të procedojë tutje me këtë çështje sipas radhës së lëndëve të arritura në atë Gjykatë.

Pretendimet e parashtruesit

34. Parashtruesi mëton shkelje të nenit 1(2) [Përkufizimi i Shtetit]; të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; të nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut]; të nenit 24(1) [Barazia para Ligjit]; të nenit 31 (1) [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; të nenit 32 [E drejta për Mjete Juridike]; të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës]; të nenit 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 1 [Detyrimi për të Respektuar të Drejtat e Njeriut]; me nenin 6(1) [E Drejta për një Proces të Rregullt]; me nenin 13 [E Drejta për Zgjidhje Efektive]; me nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit]; me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [Mbrojtja e Pronës]; me nenin 1 të Protokollit Nr. 12 [Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit] të Konventës.

35. Parashtruesi mëton se institucionet e Republikës së Kosovës, me veprimet gjegjësisht me mosveprimet e tyre, kanë shkelur dispozitat e lartpërmendura të Kushtetutës dhe të Konventës në dëm të tij, me ç'rast parashtruesi është diskriminuar dhe i janë mohuar, *ndër të tjera,* e drejta për pronë, e drejta për mbrojtje shëndetësore dhe sociale, e drejta për proces të rregullt dhe e drejta për zgjidhje efektive.

36. Parashtruesi mëton se kërkesa e tij ka të bëjë me interesin e përgjithshëm publik dhe jo vetëm me atë personal. Me interesin e përgjithshëm publik përfshihen pensionistët e të gjitha kategorive (pensionistët e pleqërisë, pensionistët invalidorë dhe pensionistët familjarë).

37. Parashtruesi, në procedurë administrative, ka kërkuar nga e paditura (Ministria-DAPK) që t'ia mundësojë pagesën periodike të pensioneve të arritura e të papaguara dhe t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar, që nga data kur ai mëton se kjo e drejtë i është mohuar. Për realizimin e kësaj të drejte, parashtruesi pohon se ka ushtruar kërkesa dhe ankesa të përsëritura dhe ka marrë përgjigje negative.

38. Përfundimisht, parashtruesi kërkon nga Gjykata:

- Rikthimin e statusit të humbur të pensionistit të fituar me punë vetjake mbi bazën e punës së kaluar duke paguar kontribute të

detyrueshme ligjore gjatë tërë kohës kur e ka gëzuar statusin e të siguruarit;

- Zhdëmtimin e plotë mbi bazën e kërkesave të arritura e të papaguara (pensioneve), sipas kësteve të pensioneve të arritura e të papaguara prej ditës kur parashtruesit i janë ndërprerë kështet e pensioneve deri në ditën e pagesës së tyre në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;

- Të vendosë në mënyrë meritore për rastin konkret që i referohet interesit ligjor publik;

- Të vendosë veçanërisht duke zbatuar mekanizmat e mundshëm të drejtësisë nëpërmjet Gjykatës Komunale në Prishtinë, që në cilësinë e gjykatës së rregullt kompetente të realizohet interesi juridik personal i parashtruesit; dhe

- Të vendosë për njoftimin e parashtruesit dhe të palëve të tjera ndërgjyqësore dhe të palëve të interesuara.

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

39. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse ai i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

40. Sa i përket pohimit të parashtruesit se kërkesa e tij ka të bëjë jo vetëm me të si individ por edhe me interesin e përgjithshëm publik, Gjykata përsërit se Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh *actio popularis,* që do të thotë se individët nuk mund të ankohen në abstrakt ose t'i sfidojnë drejtpërsëdrejti veprimet ose mosveprimet e autoriteteve publike. Kushtetuta e Kosovës ofron mbështetje për individët sa i përket veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve publike vetëm përbrenda fushëveprimit të përcaktuar me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, që kërkon nga parashtruesit të tregojnë se janë: (1) palë të autorizuara, (2) të prekur drejtpërsëdrejti nga akti konkret ose mosveprimi i autoriteteve publike, dhe (3) se kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit, për sa i përket interesit të përgjithshëm publik, nuk i plotëson kushtet e lartpërmendura dhe, mbi bazën e këtyre arsyeve, duhet të hedhet poshtë si e papranueshme *(Shih, Aktvendim për papranueshmëri KI51/10, Ljubisha Zhiviq, Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Kryetarit të Republikës së Kosovës*

për emërimin e Goran Zdravkoviqit anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në përfaqësim të komunitetit serb, i datës 2 mars 2012).

41. Parashtruesi ka iniciuar dy procedura pothuajse paralelisht për të rikthyer statusin e pensionistit dhe zhdëmtimin për pensionet e papaguara prej 1 dhjetorit 1998 e deri më tani: (1) procedurën civile në Gjykatën Komunale në Prishtinë nga 4 maji 2007 dhe që ende nuk është zgjidhur, dhe (2) procedurën administrative nga 11 prilli 2007 në Ministri (DAPK) dhe që përfundoi me Aktvendim të Gjykatës Supreme *(A. nr. 837/2009, të 23 shkurtit 2011).*

42. Gjykata Supreme, me Aktvendimin A. nr. 837/2009, të 23 shkurtit 2011, pezulloi procedurën administrative në përputhje me nenin 32, paragrafi 1, të Ligjit për Konfliktet Administrative, pasi që parashtruesi nuk ishte deklaruar brenda afatit të caktuar me aktvendim.

43. Neni 32, paragrafi 1, i Ligjit për Konfliktet Administrative përcakton:

> *"Në qoftë se organi gjatë kohës së procedurës gjyqësore nxjerr aktin tjetër me të cilin ndryshohet ose vihet jashtë fuqie akti administrativ kundër të cilit është ngritur konflikti administrativ, si dhe në rastin nga neni 1 i këtij ligji nxjerr më vonë aktin administrativ, organi, përpos paditësit, do ta njoftojë njëkohësisht edhe gjykatën, para së cilës është ngritur konflikti. Në këtë rast gjykata do ta ftojë paditësin që brenda 15 ditësh të deklarojë nëse me aktin e nxjerrë në afatin e mëvonshëm është i kënaqur ose nuk heq dorë nga padia dhe nëse respektivisht padinë e zgjeron edhe në aktin tjetër. Në qoftë se paditësi deklaron se me aktin e nxjerrë në afatin e mëvonshëm është i kënaqur apo në qoftë se nuk e jep deklaratën brenda afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, gjykata do të nxjerrë aktvendimin mbi pezullimin e procedurës. Në qoftë se paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është i kënaqur, gjykata do ta vazhdojë procedurën".*

44. Për sa i përket procedurës administrative të iniciuar në Ministri (DAPK) për realizimin e të drejtave të tij, parashtruesi ka konsideruar se ka marrë përgjigje negative dhe, si rrjedhojë, pa përfunduar procedurën administrative, kishte iniciuar procedurë civile në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Megjithatë, sipas vlerësimit të Gjykatës, parashtruesi duhet të provojë pse nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike gjatë zhvillimit të procedurës administrative dhe të tregojë se mjetet juridike që kishte në dispozicion sipas legjislacionit të Kosovës ishin të pamjaftueshme ose të pafrytshme, ose që ka pasur rrethana të veçanta që lirojnë parashtruesin nga detyrimi për të shteruar mjetet juridike, gjegjësisht

për të ndjekur procedurën administrative deri në fund. Dyshimi i thjeshtë i parashtruesit nuk e liron atë nga detyrimi për të shteruar mjetin e caktuar juridik. *(Shih, Epözdemir v. Turqi, nr. 57039/00, aktvendim i 31 janarit 2002; Pellegriti v. Itali, nr. 77363/01, aktvendim i 26 majit 2005; MPP Golub v. Ukrainë, nr. 6778/05, aktvendim i 18 tetorit 2005).*

45. Për sa i përket rastit në fjalë, parashtruesi nuk ka provuar se procedura administrative, që kishte iniciuar ai, ishte e paefektshme ose e pafrytshme, përveç deklaratës së tij se ka marrë përgjigje negative. Dhe, në të njëjtën kohë, parashtruesi kishte zhvilluar procedurë civile po ashtu kundër Ministrisë (DAPK) në Gjykatën Komunale në Prishtinë, që ishte iniciuar më 4 maj 2007.

46. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

47. Qëllimi i rregullit të shterimit të mjeteve juridike është që t'u lejojë autoriteteve publike, përfshirë gjykatat e rregullta, mundësinë për t'i parandaluar ose për t'i korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli i shterimit të mjeteve juridike bazohet në karakterin subsidiar të kornizës procedurale të drejtësisë kushtetuese. *(Shih, Aktvendim për papranueshmëri: AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë vs. Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI41/09, i datës 21 janar 2010; dhe shih, mutatis mutandis, ECHR, Selmouni vs. Francë, no. 25 803/94, vendim i 28 korrikut 1999).*

48. Në rastin në fjalë, parashtruesi nuk e ndoqi procedurën administrative deri në fund dhe në mënyrë pothuajse paralele inicioi procedurë civile në Gjykatën Komunale në Prishtinë, pa pranuar vendim përfundimtar në procedurë administrative. Prandaj, parashtruesi ka dështuar të veprojë në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

49. Për më tepër, sa i përket padisë civile të parashtruesit në Gjykatën Komunale të Prishtinës, Gjykata i referohet nenit 31, paragrafi 2 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës:

"Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm,nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".

50. Gjykata thekson se dispozita e lartpërmendur kushtetuese parasheh procedurë më të shpejtë në rastet kur individët përballen me akuzë penale, ndërsa në rastin konkret kemi të bëjmë me padi civile ku Gjykata Komunale në Prishtinë ka marrë përgjigje nga pala e paditur, dhe po ashtu ka theksuar se do të procedojë tutje padinë në fjalë sipas lëndëve të arritura në atë gjykatë.

51. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, për shkak të mosshterjes së mjeteve juridike, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 47 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 47 të Ligjit; si dhe në pajtim me rregullin 36.1 (a) të Rregullores së punës, më 27 nëntor 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 74/12 , Agim Stublla, datë 30 janar 2013- Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PN. nr. 410/2012, të datës 5 qershor 2012

Rasti KI 74/12, Aktvendimi i datës 9 janar 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesa Individuale, qartazi e pabazuar, Aktvendim për papranueshmëri.

Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e parashtruar me 10 shtator 2012, kërkon *"vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PN. nr. 410/2012, të datës 5 qershor 2012",* parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata Kushtetuese të anulojë vendimet e gjykatave të rregullta dhe të bëjë rishikim të procesit gjyqësor, sipas Nenit 442 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Gjykata konstaton që parashtruesi i ankesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij", andaj Gjykata gjen se, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika (c) dhe (d), duhet të refuzohet kërkesa si e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI74/12
Parashtrues
Agim Stublla
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PN. nr. 410/2012, të datës 5 qershor 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Agim Stublla, nga fshati Lluzhan i komunës së Podujevës.

Vendimet e kontestuara

2. Vendime të autoritetit publik, me të cilat pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutë, janë: Aktvendimi i Gjykatës Supreme, PN. nr. 410/2012, i datës 5 qershor 2012; Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut, PN. nr. 65/2012, i datës 3 prill 2012; Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Lipjan, KP. Nr. 30/2011, i datës 8 dhjetor 2011; dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Lipjan, P. nr. 129/2009, i datës 13 shkurt 2010.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së lëndës së parashtruar, më 7 gusht 2012, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, PN. nr. 410/2012, të 5 qershorit 2012; Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut, PN. nr. 65/2012, të 3 prillit 2012; Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Lipjan, KP. Nr. 30/2011, të 8 dhjetorit 2011; dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan, P. nr. 129/2009, të datës 13 shkurt 2010, me ç'rast,

parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata Kushtetuese të anulojë vendimet e gjykatave të rregullta dhe të bëjë rishikim të procesit gjyqësor, sipas Nenit 442 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë

4. Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij, nuk ka potencuar shkelje specifike të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2010 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 29 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Gjykata ka evidencuar që, parashtruesi i kërkesës, edhe më herët, më 13 shtator 2010, kishte paraqitur kërkesë në Gjykatë me objekt të njëjtë shqyrtimi, e cila ka qenë e regjistruar në regjistrin përkatës me Nr. KI84/10.

7. Gjykata, në seancën e mbajtur më 23 shkurt 2011, me shumicë votash e kishte refuzuar si të papranueshme kërkesën KI84/10, në të cilën parashtrues ka qenë z. Stublla.

8. Më 7 gusht 2012, parashtruesi i kërkesës dorëzoi sërish një kërkesë të re në Gjykatën Kushtetuese.

9. Më 4 shtator 2012, me vendimin GJ.R. 74/12, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi si Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani (anëtarë të Kolegjit).

10. Më 2 tetor 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe Gjykatën Supreme përkitazi me regjistrimin e kërkesës.

11. Më 4 tetor 2012, Gjykata Supreme është përgjigjur në kërkesën e Gjykatës nëse kishte ndonjë koment për këtë çështje, duke deklaruar se

të gjitha argumentet përkitazi me çështjen në fjalë janë dhënë në arsyetimin e vendimit.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës ka shërbyer në Shërbimin Policor të Kosovës, si zyrtar policor, që nga data 12 mars 2001.

13. Në mars të vitit 2009, parashtruesi i kërkesës ishte akuzuar për kryerjen e veprës penale vjedhje dhe, më 13 shkurt 2010, nga Gjykata Komunale në Lipjan, me vendimin P. nr. 129/2011, ishte dënuar me tre muaj burgim, të cilin dënim nuk ka për ta mbajtur nëse në afat prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale.

14. Të gjitha faktet e parashtruara nga z. Stublla në kërkesën e re, për sa i përket Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan, P. nr 129/2009, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PKL nr 69/2010, të 6 gushtit 2010, janë krejtësisht të njëjta, sikur në kërkesën e parë të parashtruar në këtë Gjykatë, më 13 shtator 2010.

15. Parashtruesi i kërkesës, megjithatë, në kërkesën e re, si fakte të reja e të pashqyrtuara nga Gjykata Kushtetuese, kishte prezantuar: Aktvendimin e Gjykatës Supreme, PN. nr. 410/2012, e datës 5 qershor 2012; Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut, PN. nr. 65/2012, e datës 3 prill 2012; dhe Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Lipjan, KP. Nr. 30/2011, e datës 8 dhjetor 2011.

16. Më 8 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Lipjan nxori Aktvendimin KP. Nr. 30/2011, duke vepruar në bazë të kërkesës për rishikimin e procedurës penale, me ç'rast hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se kërkesa është e pabazuar, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë provë të re që do ta bënte kërkesën e bazuar dhe se vetëm kishte përsëritur pretendimet e shqyrtuara më parë nga kjo gjykatë.

17. Më 3 prill 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori Aktvendimin PN. nr. 65/2012, duke vepruar në bazë të ankesës së parashtruesit të kërkesës, me ç'rast hodhi poshtë ankesën, me arsyetimin se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 442 të KPPK-së për rishikimin e procedurës penale, andaj e refuzoi ankesën si të pabazuar, dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Lipjan, KP. Nr. 30/2011, e datës 8 dhjetor 2011.

18. Më 5 qershor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar në bazë të ankesës së parashtruesit të kërkesës, nxori Aktvendimin Pn. nr. 410/2012, ku hodhi poshtë ankesën si të palejuar, me arsyetimin që Aktvendimi i Gjykatës së shkallës së dytë është i formës së prerë dhe ankesa, si mjet i rregullt, nuk është e lejuar.

19. Përfundimisht, i pakënaqur me vendimet e lartcekura, më 8 gusht 2012, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar përsëri Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat njerëzore të garantuara me Kushtetutë, duke mos i specifikuar se cilat të drejta pretendon se i janë shkelur.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Për të qenë në gjendje për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë paraprakisht nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen në Kushtetutë.

22. Përkitazi me këtë, Gjykata merr parasysh rregullin 36, par. 1, pika c, dhe par. 3, pika e, e Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *c) Kërkesa është qartazi e bazuar"*
>
> *dhe*
>
> *"(3) Një kërkesë mund të konsiderohet e papranueshme edhe n*ë *rastet vijuese kur:*
>
> *e) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa e re nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri".*

23. Në këtë drejtim, sa i përket çështjeve të ngritura nga parashtruesi, e që kanë të bëjnë me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Lipjan, p. Nr. 129/2009, dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PKL nr. 69/2010, e 6 gushtit 2010, Gjykata konstaton se kjo çështje është tashmë e gjykuar

me vendimin KI84/10 dhe gjykata nuk do ta rivlerësojë kushtetutshmërinë e këtyre akteve juridike.

24. Për këtë, edhe GJEDNJ (*Shih, X kundër Gjermanisë, aplikacioni nr. 1860/63; Duclos kundër Francës, aplikacioni nr. 20940/92, 17.12.1996)* ka theksuar që kërkesa do të shpallet e papranueshme në rastet kur parashtruesi do të përsërisë ankesat që kishte formuluar në një kërkesë të mëparshme.

25. Megjithatë, duke marrë parasysh se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e fakteve të reja, ka paraqitur Aktvendimin e Gjykatës Supreme, PN. nr. 410/2012, e datës 5 qershor 2012; Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut, PN. nr. 65/2012, e datës 3 prill 2012; dhe Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Lipjan, KP. Nr. 30/2011, e datës 8 dhjetor 2011, të cilat kanë të bëjnë me procedurën përkitazi me kërkesën për përsëritjen e procedurës, e cila është e ndryshme nga procedura për mbrojtjen e ligjshmërisë që ishte objekt i shqyrtimit të kërkesës së parë, për këtë arsye, Gjykata, për këtë pjesë të kërkesës, mbështetur edhe në praktikën e GJEDNJ-së *"kur kërkuesi paraqet fakte të reja, kërkesa nuk do të jetë thellësisht e njëjta me kërkesën pararendëse*", kërkesën e re, sa i përket fakteve të reja, do ta marrë në shqyrtim (*Shih, Chappex kundër Zvicrës, aplikacioni nr. 20338/92, i datës 12.10.1994; dhe Patera kundër Çekisë, aplikacioni nr. 25326/03, i datës 10.01.2006*).

26. Bazuar në këtë, Gjykata Kushtetuese, duke bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, PN. nr. 410/2012, të 5 qershorit 2012; Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut, PN. nr. 65/2012, të 3 prillit 2012; dhe Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Lipjan, KP. Nr. 30/2011, të 8 dhjetorit 2011, nuk gjen asnjë fakt të jenë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Në fakt, parashtruesi i kërkesës, përpos shprehjes së pakënaqësisë për aktvendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta, nuk ka argumentuar në mënyrë bindëse se pse gjykimi "nuk ka qenë i drejtë dhe i paanshëm", se në cilën mënyrë ai ka qenë i trajtuar si i pabarabartë, apo cila fazë e procedurës ka qenë kundërkushtetuese.

27. Në nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], pika 3, të Kushtetutës është paraparë qartazi: "Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit", dhe, në nenin 103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave), pika 2, të Kushtetutës, gjithashtu është përcaktuar qartazi: "Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor".

28. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e faktit dhe, me këtë rast, dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të

plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i saj është vetëm të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt", (*Shih, mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65*).

29. Fakti se parashtruesit nuk pajtohen me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (*Shih, mutatis mutandis aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005*).

30. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese nuk gjen fakte se gjykatat e rregullta nuk kanë "gjykuar drejt dhe paanshëm", duke sjellë vendime që mund t'i kenë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

31. Parashtruesi i ankesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij", andaj Gjykata gjen se, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika (c) dhe (d), duhet të refuzohet kërkesa si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36.2 pika (c) dhe (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 21 nëntor 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KO 97/12, Avokati i Popullit, datë 30 janar 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012

Rasti KO 97/12, Vendim për masë të përkohshme, i 24 janarit 2013

Fjalët kyçe: ekonomia, masë e përkohshme, liria e asociimit, ligj i papajtueshëm me Kushtetutën, mbrojtja e pronës

Parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.2 (1) të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar kushtetutshmërinë e neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012, sepse zbatimi i këtij ligji do të shkaktonte dëme të pariparueshme në shoqërinë civile.

Në këtë drejtim, duke pasur parasysh se afati kohor i masës së përkohshme, vendosur nga Gjykata më 24 dhjetor 2012, do të skadojë më 31 janar 2013, si dhe që Gjykata më 24 janar 2013 mori vendim të mbajë dëgjim publik, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të kërkesës, afati kohor i masës së përkohshme vazhdohet edhe për tre (3) muaj.

VENDIM PËR VAZHDIMIN E MASËS SË PËRKOHSHME
në
Rastin nr. KO97/12
Parashtruesi
Institucioni i Avokatit të Popullit
Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, Gjyqtare

Hyrje

1. Më 24 dhjetor 2012, Gjykata Kushtetuese vendosi masë të përkohshme në lidhje me Kërkesën e lartpërmendur. Në vendimin e saj, Gjykata Kushtetuese, mes tjerash, vendosi:

   "...

   I. TË LEJOJË masën e përkohshme

   II. TË LEJOJË masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 31 janar 2013 prej ditës së miratimit të këtij Vendimi

   III. TË PEZULLOHET MENJËHERË zbatimi i neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012, në kohëzgjatje të njëjtë;

   ..."

2. Sa i përket vazhdimin e Masës së Përkohshme si më lart, Gjykata rithekson që zbatimi i Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikro-Financiare dhe Institucionet Mikro-Financiare dhe Institucionet Financiare Jo-Bankare, më saktësisht i neneve të kontestuara 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 do të mund të shkaktonte dëme të pakthyeshme në funksionimin e OJQ-ve, si dhe shoqërisë civile dhe interesit publik në Republikën e Kosovës.

3. Në këtë drejtim, duke pasur parasysh që afati kohor i Masës së Përkohshme vendosur nga Gjykata më 24 dhjetor 2012 do të skadojë më 31 janar 2013, si dhe që Gjykata më 24 janar 2013 mori vendim të mbajë dëgjim publik, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të Kërkesës, afati kohor i Masës së Përkohshme vazhdohet për tre (3) muaj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në bazë të nenit 116(2) të Kushtetutës, nenit 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, si dhe Rregullit 55 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese, pasi shqyrtoi çështjen më 24 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TË VAZHDOJË afatin kohor të Masës së Përkohshme të vendosur nga Gjykata në vendimin e saj fillestar të datës 24 dhjetor 2012, për një periudhë të mëtutjeshme prej tre (3) muaj deri më 30 prill 2013;

II. TË MBETET e përkushtuar për çështjen;

III. Ky vendim do t'u komunikohet Palëve; dhe

IV. Ky Vendim do të shpallet në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit, si dhe hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 99/12, Emine Tahiri, datë 01 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ac. nr. 583/2012, të 14 shtatorit 2012

Lënda KI-99/12, Akvendim i 6 dhjetorit 2012.

Fjalët kyçe: kërkesa individuale, pensioni, e drejta në pension për persona me aftësi të kufizuar, qartazi i pabazuar.

Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ac. nr. 583/2012, të 14 shtatorit 2012, me të cilin hidhet poshtë padia e parashtruar kundër Aktvendimit nr. 5079885, të 27 janarit 2012, të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme MPMS) - Departamenti i Administratës Pensionale (në tekstin e mëtejmë DAP), me të cilin aktvendim është refuzuar kërkesa e parashtruesit që t'i njihet e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuar.

Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se cili nen i Kushtetutës së Kosovës është shkelur me këtë vendim të Gjykatës Supreme. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesë "që të vlerësojë ligjshmërinë e aktgjykimit dhe vendimeve të organeve administrative që kanë proceduar në këtë procedurë, t'i anulojë ato dhe të obligojë Gjykatën Supreme të Kosovës dhe Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale që t'i evitojnë shkeljet ligjore dhe të ma vazhdojnë shfrytëzimin e së drejtës në pensionin e personave me aftësi të kufizuar. Kjo e drejtë më është ndërprerë pa të drejtë".

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtrueses së kërkesës, Emine Tahiri, Gjykata Kushtetuese, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura para gjykatave të rregullta, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta dhe arbitrare. Prandaj, Gjykata gjen se kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI99/12
Parashtrues
Emine Tahiri
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ac. nr. 583/2012, të 14 shtatorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Kadri Kryeziu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Emine Tahiri nga fshati Batllavë, komuna e Podujevës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Ac. nr. 583/2012, i 14 shtatorit 2012, me të cilin hidhet poshtë padia e parashtruar kundër Aktvendimit nr. 5079885, të 27 janarit 2012, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë MPMS) - Departamenti i Administratës Pensionale (në tekstin e mëtejmë DAP), me të cilin Aktvendim është refuzuar kërkesa e parashtruesit që t'i njihet e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuar.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ac. nr. 583/2012, i 14 shtatorit 2012, me të cilin hidhet poshtë kërkesa e parashtruesit të kërkesës që t'i njihet e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuar, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që të "*... vlerësojë ligjshmërinë e aktgjykimit dhe vendimit të organit administrativ të cilët kanë udhëhequr procedurën...*".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, në nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56, pika 2, të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 tetor 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Me Vendimin e Kryetarit (Nr. GJR. 99/12, të 31 tetorit 2012), Gjyqtarja Snezhana Botusharova është caktuar Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit (Nr. KSH. 99/12) është caktuar Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Prof. dr. Ivan Čukalović.

7. Më 19 nëntor 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës se ka filluar procedura e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së vendimit për rastin Nr. KI99/12.

8. Më 6 dhjetor 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtares Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe prof. dr. Ivan Čukalović, i ka paraqitur Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papanueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesit të kërkesës i është njohur e drejta për pension për persona me aftësi të kufizuar, në periudhën nga viti 2006 e deri më 21.12.2011, dy herë me vazhdime prej një viti dhe herën e tretë me kohëzgjatje prej tri vjetësh.

10. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga MPMS-DAP që t'ia vazhdojë të drejtën për pension për persona me aftësi të kufizuar. MPMS-DAP, me Vendimin nr. 5079885, e 29 dhjetorit 2011, hodhi poshtë kërkesën për shqyrtimin e shfrytëzimit të së drejtës për pension për persona me aftësi të kufizuar.

11. Më 26 janar 2012, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë ndaj Vendimit nr. 5079885, të 29 dhjetorit 2011, të MPPMS-DAP.

12. Duke vendosur për ankesën e parashtruesit të kërkesës, MPMS-DAP, Këshilli për ankesa dhe pensione të personave me aftësi të kufizuar në Prishtinë, me vendimin nr. 5079885, e 27 janarit 2012, hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit që t'i njihet e drejta për pension për persona me aftësi të kufizuar dhe ka vërtetuar vendimin e MPMS-DAP nr. 5079885, e 29 dhjetorit 2011.

13. Në vendimin nr. 5079885, e 27 janarit 2012, të MPMS-DAP, Këshilli për ankesa dhe pensione për personat me aftësi të kufizuar në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi kundër Gjykatës Supreme të Kosovës.

14. Duke vendosur për padinë e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Ac. nr. 583/2012, e 14 shtatorit 2012, hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës me këtë arsyetim:

"Nga shkresat e lëndës shihet se organi i shkallës së parë me vendimin nr. 5079885 të datës 29.12.2011, ia refuzon paditëses kërkesën për njohjen e së drejtës në pension me aftësi të kufizuar nga arsyeja se nuk i plotëson kriteret sipas nenit 3 të Ligjit 2003/23 për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar, dhe të njëjtin e bazon ne konstatimin dhe mendimin e komisionit mjekësor të organit të shkallës së parë të datës 20.12.2011, i cili vlerëson se te paditësja nuk është paraqitur kufizimi i përhershëm i aftësisë punuese siç parasheh dispozita e sipër cekur ligjore.

Në procedurën sipas ankesës organi i padituri ka siguruar konstatimin dhe mendimin e komisionit mjekësor të padituri nr. 5079885 të datës 20.02.2012, për vlerësimin e komisionit mjekësor të personave me aftësi të kufizuar të organit të faktit, i cili dakordohet me konstatimin dhe mendimin e komisioneve mjekësore të dhëna më parë. Prandaj edhe me vendimin e kontestuar refuzon si të pabazuar ankesën e paditëses e cila vërteton vendimin e atakuar.

Duke pasur parasysh se komisionet mjekësore me ligj të autorizuara kanë vërtetuar se te paditësja nuk ekziston aftësia e kufizuar për punë, gjykata konstaton se organet administrative drejt kanë zbatuar dispozitën e nenit 3 të Ligjit të cekur më lartë, në bazë të cilit edhe është refuzuar kërkesa e paditëses që t'i njihet e drejta në pension invalidor".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se cili nen i Kushtetutës së Kosovës është shkelur me këtë vendim të Gjykatës Supreme, vetëm se pohon si në vijim:

"Në shkresa të lëndës gjinden provat – raportet mjekësore, fletë lëshimet e spitalit që vërtetojnë gjendjen e rëndë shëndetësore të palës si: fletë lëshimi nr. 7814 i datës 30.12.2003 fletë përcjellja për ekzaminime Histopatologjike dhe Citologjike të datës 22.12.2003, raporti ultrasonografik i abdomenit i datës 27.12.2005, raporti i Qendrës Diagnostike Endokrinologjike i datës 28.05.2005, raporti nr. 1793 i datës 09.09.2005 dhe kartela personale onkologjike Tiranë.
Organi i administratës nuk ka vepruar konform gjendjes shëndetësore të palës dhe provave dhe fakteve të paraqitura, por pa kurrfarë baze ligjore në procedurë të rivlerësimit ka refuzuar kërkesën për vazhdimin e së drejtës në pensionin e personave me aftësi të kufizuara pa dhënë kurrfarë arsyetimi për arsyen e refuzimit të kërkesës vetëm me një konstatim se te pala nuk ekzistojnë shkaqet për njohje –vazhdim të së drejtës në pensionin e personave me aftësi të kufizuara".

16. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesat në vijim:

"Përmes parashtrimit të kërkesës në Gjykatë dëshirojmë që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që të vlerësojë ligjshmërinë e aktgjykimit dhe vendimeve të organeve administrative që kanë proceduar në këtë procedurë, t'i anulojë dhe të obligojë Gjykatën Supreme të Kosovës dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që t'i evitojnë shkeljet ligjore dhe t' ma vazhdojnë shfrytëzimin e së drejtës në pensionin e personave me aftësi të kufizuar. Kjo e drejtë më është ndërprerë pa të drejtë".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

18. Neni 48 i Ligjit të Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Kosovës parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

19. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I*).

20. Parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të saj kushtetuese (*Shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, të 31 majit 2005*). Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se cila e drejtë i është shkelur dhe cili nen i Kushtetutës mbështet kërkesën e saj, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 48 të Ligjit.

21. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e saj dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë, para komisioneve mjekësore të shkallës së parë dhe të dytë të MPMS-DAP dhe para Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (*Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009*).

22. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, që parasheh: "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, më 6 dhjetor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. **TA HEDHË POSHTË** kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 71/12, Fikrije Sermaxhaj, datë 01 shkurt 2013-Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 273/2012 të 27 prillit 2012.

Rasti KI 71/12, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 nëntor 2012.

Fjalë kyçe: Kërkesë Individuale, qartazi e pabazuar, Aktvendim për papranueshmëri.

Parashtruesi konteston Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 273/2012 të 27 prillit 2012. Parashtruesi i kërkesës i propozoi Gjykatës Kushtetuese t'i mbrojë të drejtat e saj, pasi që ajo është një person që nuk ka shtëpi të veten dhe sipas vendimit të kontestuar ajo duhet të largohet nga banesa e saj.

Argumenti kryesor i Parashtruesit të kërkesës në mbështetje të kërkesës është se ajo është e papunë dhe e ka fëmijën e moshës 9 vjeçare dhe se ajo nuk posedon asnjë pronë të luajtshme ose të paluajtshme.

Parashtruesi i Kërkesës as nuk e ka ndërtuar rastin në shkelje të ndonjë të drejte të saj, të garantuar me Kushtetutë e as nuk ka ofruar ndonjë provë *prima facie* mbi një shkelje të tillë dhe Gjykata Kushtetuese dhe shpallë kërkesën si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI71/12
Parashtruesi
Fikrije Sermaxhaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.273/2012 të 27 prillit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtruesi i kërkesës është Fikrije Sermaxhaj, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.273/2012 të 27 prillit 2012.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.273/2012 të 27 prillit 2012 nga ana e Gjykatës Kushtetuese, me të cilin është refuzuar ankesa e Parashtruesit të kërkesës në procedurën e përmbarimit.

4. Në kërkesën e saj, Parashtruesi i kërkesës i propozoi Gjykatës Kushtetuese t'i mbrojë të drejtat e saj, pasi që ajo është një person që nuk ka shtëpi të veten dhe sipas vendimit të kontestuar ajo duhet të largohet nga banesa e saj.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit, dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 23 korrik 2012, Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

7. Më 4 shtator 2012, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Cukalovic (anëtar) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).

8. Më 27 nëntor 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga dokumentet e dorëzuara që mbështesin kërkesën e Parashtruesit të kërkesës mund të përmblidhen faktet si në vijim.

10. Më 7 nëntor 2000, Parashtruesi i kërkesës si blerës nënshkroi kontratën për blerjen e banesës që gjendet në Prishtinë me shitësin M.C. Kjo kontratë u vërtetua në Gjykatën Komunale në Prishtinë më 24 gusht 2000 me numër VR nr 1875/2000.

11. Në një datë të paspecifikuar, Parashtruesi i kërkesës dhe M.C. nënshkruan vërtetimin, i cili vërteton se Parashtruesi i kërkesës i ka ka paguar MC. në tërësi çmimin e blerjes në shumë prej 63,000 Marka Gjermane.

12. Më 17 dhjetor 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin C.nr. 2977/07 dhe aprovoi kërkesëpadinë e M.I. kundër Parashtruesit të kërkesës.

13. Me atë padi, Parashtruesi i kërkesës ishte i obliguar t'ia paguajë paditësit 32,000 Euro në emër të parave të paguara për blerjen e banesës në Prishtinë. Në arsyetimin e Aktgjykimit ishte përmendur se Parashtruesi i kërkesës është motra e gruas së paditësit. Gjithashtu ishte përmendur se Parashtruesi i kërkesës "nuk kishte ofruar asnjë provë nëse ka pasur të holla për blerjen e banesës kontestuese deri sa në anën tjetër ka rezultuar si jokontestues fakti se paditësi vit me radhë ka punuar në Zvicër ku ka siguruar të ardhura, prandaj te kjo gjendje e çështjes, gjykata ka ardhur në përfundim se e paditura nuk ka poseduar të holla për blerjen e banesës, kurse të hollat në emër të shitblerjes së banesës i ka paguar paditësi..."

14. Derisa Parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të ushtrojë ankesë kundër këtij Aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, nuk është e qartë a e ka bërë këtë.

15. Aktgjykimi i përmendur më lart (C.nr. 2977/07 i Gjykatës Komunale në Prishtinë i 17 dhjetorit 2008) u bë i plotfuqishëm dhe i përmbaruesshëm në një datë të paspecifikuar.

16. Rezulton se në pajtim me Ligjin për Procedurën Përmbarimore më 27 prill 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë mori vendimin e kontestuar Ac. Nr. 273/2012. Me atë vendim ankesa e Parashtruesit të kërkesës është refuzuar si e pabazuar dhe u konfirmuan Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë E.nr. 2902/2012 dhe Konkluzioni mbi shitjen e pronës së paluajtshme të datës 27 dhjetor 2011.

17. Nga arsyetimi mund te thuhet se Gjykata Komunale në Prishtinë, si një Gjykatë e instancës së parë, mori Vendimin për Përmbarim, E.nr. 2902/2010, si dhe konkluzion për shitjen e pronës së paluajtshme kreditorit M.I. Duket se M.I. ishte i vetmi ofertues në ankand publik të banesës së lartpërmendur, i cili kishte ofruar çmimin prej 32,000 Euro. Sipas atij vendimi (E.nr 2902/2010) Parashtruesi i kërkesës ishte i obliguar t'ia dorëzojë banesën M.I. Për më tepër, ishte theksuar se ankesa e Parashtruesit të kërkesës kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë (E.nr. 2902/2010) është e pabazuar, pasi që nga dosja e lëndës është e qartë se aktvendimi i Gjykatës së instancës së parë dhe konkluzioni i shitjes është bërë përmes ankandit publik dhe se i vetmi ofertues ishte kreditori (d.m.th M.I.)

18. Përfundimisht, më 5 qershor 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Konkluzionin E.nr 2902/2010 duke e caktuar dëbimin e Parashtruesit të kërkesës për 26 qershor 2012.

Ligji i aplikueshëm

19. Ligji për Procedurën Përmbarimore (Nr. 03/L-008) në nenet 12 dhe 14 përshkruajnë mjetet kundër vendimeve të lëshuara në procedurën përmbarimore si në vijim:

> ***"Neni 12***
> ***Mjetet e goditjes së vendimeve***
> *12.1 Në procedurën përmbarimore janë mjete të zakonshme goditjeje prapësimi dhe ankesa, po qe se nuk janë përjashtuar me këtë ligj.*
>
> *12.2 Kundër aktvendimit të shkallës së parë mundë të paraqitet prapësimi, kurse ankesa vetëm në rastet e parapara me këtë ligj.*
>
> *12.3 Prapësimi i paraqitet gjykatës që e ka dhënë aktvendimin brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit, po qe se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe. Për prapësimin e paraqitur vendosë gjykata që e ka dhënë aktvendimin.*
>
> *12.4 Kundër aktvendimit të dhënë lidhur me prapësimin mund të paraqitet ankesa brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit.*
>
> *12.5 Për ankesën e paraqitur është kompetente të vendos gjykata e shkallës së dytë.*
>
> *12.6 Prapësimi dhe ankesa nuk e ndalin procedurën përmbarimore, por përmbushja e kërkesës së propozuesit të përmbarimit shtyhet deri sa mos të vendosë gjykata e shkallës së parë për prapësimin e paraqitur. Përjashtimisht kur me titullin ekzekutiv është caktuar detyrimi i ushqimit ligjor, apo kur përmbarimi kryhet duke u kaluar të hollat nga llogaria e transaksionit të personit juridik në llogarinë e llojit të njëjtë të propozuesit të përmbarimit, por edhe në rastet tjera të parapara me këtë ligj, mund të realizohet kredia edhe para se të vendoset për prapësimin e debitorit.*
>
> *12.7 Kundër konkluzionit si lloj i vendimit në parim nuk lejohet mjeti i goditjes.*

Neni 14

Mjetet e goditjes së jashtëzakonshme

14.1 Kundër aktvendimit të nxjerrë në formë të prerë në procedurën përmbarimore dhe të sigurimit nuk lejohet revizioni as përsëritja e procedurës.

14.2 Kthimi në gjendjen e mëparshme lejohet vetëm në rast të mosruajtjes së afatit për paraqitjen e prapësimit dhe të ankesës kundër aktvendimit të përmbarueshëm për përmbarimin e detyrueshëm.

Pretendime e parashtruesit të kërkesës

20. Argumenti kryesor i Parashtruesit të kërkesës në mbështetje të kërkesës është se ajo është e papunë dhe e ka fëmijën e moshës 9 vjeçare dhe se ajo nuk posedon asnjë pronë të luajtshme ose të paluajtshme.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

21. Gjykata Kushtetuese dëshiron të rikujton se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me lajthitjet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) gjoja të kryera nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Konventë (kushtetutshmërinë). Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur t'i merr parasysh vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih: *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I), Shih gjithashtu Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin nr. 70/11, Parashtruesit e kërkesës Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Vlerësimi i kushtetutshmërisë i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr. 983/08 të 7 shkurtit 2011).

22. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese vëren nga faktet e paraqitura në Kërkesë, se Parashtruesi i Kërkesës i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore të parapara me Ligjin për Procedurën Përmbarimore të cituar më lart, duke paraqitur ankesë kundër Vendimit për Përmbarim (E.nr 2902/2010) të nxjerrë nga Gjykata Komunale në Prishtinë dhe se

Gjykata e Qarkut në Prishtinë i ka marrë parasysh dhe vërtetë i është përgjigjur ankesave të saj në pikat e ligjit.

23. Prandaj Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në Kërkesë që tregon se rastit i ka munguar paanshmëria apo që procedurat kanë qenë të padrejta në ndonjë mënyrë (Shih: *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

24. Si përfundim, Parashtruesi i Kërkesës as nuk e ka ndërtuar rastin në shkelje të ndonjë të drejte të saj, të garantuar me Kushtetutë e as nuk ka ofruar ndonjë provë *prima facie* mbi një shkelje të tillë (shih Vanek v. Republika e Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmërinë e Kërkesës nr. 53363/99 të 31 majit 2005).

25. Rrjedh se Kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 1. (c) të Rregullores së punës që parasheh se "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e pabazuar."

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, njëzëri

VENDOSI

I. TA SHPALLË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 67/12, Shaban Kadrija, datë 01 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. I .nr. 366/2009, të 15 marsit 2012.

Rasti KI67/12, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 nëntor 2012.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar

Parashtruesi pohon se është shkelur e drejta e tij për punë, e garantuar me Kushtetutë dhe me standarde ndërkombëtare.

Parashtruesi pret që Gjykata Kushtetuese t'ia mundësojë atij kthimin në vendin e mëparshëm të punës. Ai kërkon që Gjykata të zhvleftësojë të gjitha aktgjykimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Parashtruesi, gjithashtu, kërkon që Gjykata Kushtetuese të urdhërojë një kompensim në të holla për humbjen e supozuar të të ardhurave, duke përfshirë edhe shpenzimet gjyqësore.

Gjykata konsideron se në kërkesë nuk ka asgjë që tregon se mungonte paanshmëria në rast, ose që procedurat ishin të padrejta. Parashtruesi as nuk ka ndërtuar rastin për shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, as nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* për atë shkelje, dhe Gjykata Kushtetuese dhe e shpallë kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI67/12
Parashtruesi
Shaban Kadrija
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. I .nr. 366/2009, të 15 marsit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues është Shaban Kadrija, me banim në fshatin Muzeqinë, Komuna e Shtimes.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I. nr. 366/2009, të 15 marsit 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon se është shkelur e drejta e tij për punë, e garantuar me Kushtetutë dhe me standarde ndërkombëtare.

4. Parashtruesi pret që Gjykata Kushtetuese t'ia mundësojë atij kthimin në vendin e mëparshëm të punës. Ai kërkon që Gjykata të zhvleftësojë të gjitha aktgjykimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Parashtruesi, gjithashtu, kërkon që Gjykata Kushtetuese të urdhërojë një kompensim në të holla për humbjen e supozuar të të ardhurave, duke përfshirë edhe shpenzimet gjyqësore.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës të Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 12 korrik 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 4 shtator 2012, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues, dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 27 nëntor 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 6 janar 1990, Kuvendi Komunal i Shtimes, Drejtoria e të Hyrave Shoqërore, nxori Vendimin nr. 04-011-17 në bazë të të cilit parashtruesi kishte lidhur marrëdhënie të përhershme pune, me orar të plotë, në Drejtorinë e të Hyrave Shoqërore, që nga 1 janari 1990. Parashtruesi ishte caktuar në detyrën e nëpunësit për mbledhjen e taksave.

10. Më 12 tetor të të njëjtit vit, Kuvendi Komunal i Shtimes, Drejtoria e të Hyrave Shoqërore, nxori një Vendim të ri, nr. 118-21/90, me të cilin, pa pajtimin e parashtruesit, ishte ndërprerë marrëdhënia e punës së parashtruesit. Arsyetimi i dhënë ishte se ai kishte marrë pjesë në grevën e përgjithshme njëditore të Sindikatës së Pavarur të punonjësve të kombësisë shqiptare, të 3 shtatorit 1990, të cilën Drejtoria e konsideroi si "mungesë pa arsyetim" nga vendi i punës. Për më tepër, parashtruesi nuk ka kryer punën e tij, andaj ka refuzuar obligimet e tij të punës. Kuvendi konsideroi se sjellja e tij kishte penguar punën dhe detyrat e punëtorëve të tjerë.

11. Sindikata e Pavarur e EOA, nëndega në Shtime, nxori një deklaratë (më 18 shtator 2002), sipas kërkesës së parashtruesit, ku thuhej se Sindikata e Pavarur ka kontaktuar Organin Komunal, UNMIK-un dhe Organizatën Qendrore të Kosovës, duke u përpjekur që ta kthejë atë (dhe punonjësit

e tjerë të shkarkuar në mënyrë të ngjashme) në vendin e tyre të mëparshëm të punës.

12. Pas luftës, pasi parashtruesi nuk u kthye në vendin e tij të mëparshëm të punës, ai u përpoq të rifillojë punën në organet komunale në Shtime, duke supozuar se kjo pozitë pune i takonte atij.

13. Sidoqoftë, më 16 mars 2004, Komuna e Shtimes shpalli vendin e lirë (02. nr. 111/406) për këtë pozitë, në gazetën "Koha ditore". Parashtruesi ishte intervistuar për pozitën e lirë, por nuk ishte pranuar.

14. Del se parashtruesi kishte parashtruar dy ankesa ndaj vendimit të panelit intervistues në Komisionin Ankimor të Komunës së Shtimes (nr. 13, të parashtruar më 15 dhjetor 2003, dhe nr. 07/708, të parashtruar më 7 maj 2004). Që të dyja u refuzuan si të pabazuara, duke vendosur se procedura e shpalljes së pozitës së lirë dhe puna e Komisionit përzgjedhës ishte në përputhje me ligjin, përkatësisht me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 të KCS dhe me Urdhëresën Administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 në KCS.

15. Më 21 korrik 2004, parashtruesi parashtroi një ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, i cili, me Vendimin A. 02/52/2004, hodhi poshtë ankesën e parashtruesit, dhe mbeti në fuqi vendimi i Komisionit Ankimor, i 6 korrikut 2004.

16. Rrjedhimisht, me 26 dhjetor 2006, parashtruesi dorëzoi padinë e tij në Gjykatën Komunale në Ferizaj kundër Komunës së Shtimes, si e paditur. Ai kërkoi që Gjykata Komunale e Shtimes të anulojë vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve, sipas vendit të lirë të punës 02 nr. 111/406, të 16 marsit 2004.

17. Gjykata Komunale në Ferizaj, në Aktgjykimin e vet C. nr. 171/077, të 15 majit 2008, përcaktoi se Paneli intervistues kishte respektuar procedurat e parapara me Rregulloren e lartpërmendur të UNMIK-ut gjatë përzgjedhjes dhe refuzoi padinë e parashtruesit si të pabazuar.

18. Gjykata e Qarkut e Prishtinës, në Aktgjykimin e vet Ac. nr. 1018/08, të 6 prillit 2009, pranoi në tërësi vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë (përkatësisht të Gjykatës Komunale në Ferizaj), duke theksuar se kishte përcaktuar drejt situatën faktike, kishte zbatuar drejt të drejtën materiale, dhe se aktgjykimi nuk përmbante shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore.

19. Parashtruesi dorëzoi një ankesë për revizion kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, për shkak të shkeljeve substanciale të dispozitave të Ligjit për Procedurë Kontestimore dhe për zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.

20. Më 15 mars 2012, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Rev. I. 366/2009 dhe hodhi poshtë, si të pabazuar, kërkesën e parashtruesit për revizion. Gjykata Supreme, në arsyetimin e vet, deklaronte se "gjykata e shkallës së dytë kishte zbatuar drejt të drejtën materiale kur kishte refuzuar ankesën e parashtruesit dhe kishte konfirmuar aktgjykimin e shkallës së parë", arsye të cilat janë pranuar tërësisht nga kjo gjykatë.

21. Gjykata Supreme gjithashtu pohoi se "pretendimet e parashtruesit në revizionin se vendi i lirë 'nuk ishte transparent, por që vetëm aplikacionet ishin shpërndarë'" nuk qëndronin, pasi që në dosje është konkursi i publikuar në gazetën "Koha ditore", për vendin e lirë të punës. Gjykata Supreme më tej theksoi se: "Komisioni intervistues i të paditurit... kishte vlerësuar kandidatët sipas dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët dhe kandidati HH ishte vlerësuar me numrin më të lartë të poenëve...".

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi pretendon se kishte pësuar padrejtësi më së shumti, pasi, sipas tij, Komisioni intervistues për pranimin në punë ishte i përbërë kryesisht nga persona me prapavijë të partive politike.

23. Parashtruesi më tej pretendon se gjykatat e rregullta nuk kanë marrë parasysh një padrejtësi të tillë dhe se, sipas tij, "gjykatat nuk kanë marrë parasysh substancën dhe ligjshmërinë e problemit të tij".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Siç u përmend më herët, argumenti kryesor i parashtruesit është se i është bërë padrejtësi më së shumti, pasi, sipas tij, Komisioni intervistues për pranimin në punë ishte kryesisht i përbërë nga persona me prapavijë të partive politike.

25. Gjykata Kushtetuese dëshiron të përsërisë se, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve apo të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmëri). Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt sa i përket vendimeve të gjykatave të

rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I; Shih, gjithashtu, Aktvendimi për papranueshmëri në Rastin nr. 70/11, Parashtruesit: Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, Vlerësimi kushtetues i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A.nr. 983/08, i 7 shkurtit 2011*).

26. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese vëren nga faktet e dorëzuara në kërkesë, se parashtruesi ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, dhe që gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh dhe i janë përgjigjur me të vërtetë ankesave të tij në pikat e ligjit.

27. Prandaj, Gjykata konsideron se në kërkesë nuk ka asgjë që tregon se mungonte paanshmëria në rast, ose që procedurat ishin të padrejta (*Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi për papranueshmëri i GJEDNJ-së, nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009*).

28. Në përmbyllje, parashtruesi as nuk ka ndërtuar rastin për shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, as nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* për atë shkelje (*Shih, Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi për papranueshmëri i GJEDNJ-së, në rastin nr. 53363/99, i 31 majit 2005*).

29. Del se kërkesa është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36.1 (c) të Rregullores së punës që përcakton se "Gjykata vetëm mund të shqyrtojë një kërkesë nëse: c) Kërkesa është qartazi e bazuar".

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 75/12, Faton Sefa, datë 01 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 106/2010, të 2 majit 2012.

Lënda KI 75/12, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 nëntorit 2012.

Fjalët kyçe: qartazi e pabazuar, mbrojtja e pronës, e drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm, e drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale.

Parashtruesi paraqiti kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës të Kosovës, duke kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 106/2010, të 2 majit 2012, sepse të dyja - edhe Gjykata e Qarkut ne Pejë, e edhe Gjykata Supreme- supozohet të kenë injoruar shkeljet procedurale gjatë procedurës disiplinore. Për më tepër, parashtruesi pretendon se ndërprerja e kontratës së punës së parashtruesit ishte në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/27, sepse ai asnjëherë nuk kishte pasur një takim me kompaninë dhe me ndërprerjen e marrëdhënies së punës asnjëherë nuk është specifikuar se cilat dispozita juridike ishin shkelur nga ai.

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata vlerësoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka paraqitur asnjë provë që tregon se të drejtat dhe liritë e tij ishin shkelur nga Gjykata Supreme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI75/12
Parashtruesi
Faton Sefa
Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 106/2010, të 2 majit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Faton Sefa, me banim në Gjakovë, i përfaqësuar nga z. Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 106/2012, të 2 majit 2012, i cili iu dorëzua parashtruesit më 20 qershor 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 106/2010, të 2 majit 2012, me ç'rast supozohet se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm], me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Fundamentale të Njeriut (në tekstin e

mëtejmë: ECHR), përkatësisht me nenin 6 (E Drejta për Gjykim të Drejtë) dhe me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit 1.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 13 gusht 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 17 gusht 2012, parashtruesi dorëzoi autorizimin e avokatit.

7. Më 4 shtator 2012, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI75/12, caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI75/12, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 12 tetor 2012, Gjykata kërkoi sqarime nga Gjykata Supreme përkitazi me Aktgjykimin Rev. nr. 106/2010, të 2 majit 2012. Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të kërkesës, ka vërejtur se kopja e Aktgjykimit Rev. nr. 106/2010 përmbante mospërputhshmëri sa i përket datës së seancës kryesore, që ishte më 09.04.2012, dhe datës së publikimit të Aktgjykimit që përmendet në fund të atij Aktgjykimi, e që ishte më 09.02.2012. Kjo nënkuptonte se Aktgjykimi ishte publikuar 2 muaj para datës së seancës kryesore.

9. Më 25 tetor 2012, Gjykata Supreme iu përgjigj Gjykatës Kushtetuese, duke ofruar një Vendim për të korrigjuar Aktgjykimin Rev. nr. 106/2010, me ç'rast thuhet se datë korrekte duhet të jetë 2 maji 2012.

10. Më 27 nëntor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 18 gusht 2006, kompania "Hidrosistemi Radoniqi" në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Kompania), ndërpreu kontratën e punës me

parashtruesin, sepse pretendohej se parashtruesi nuk kishte përmbushur detyrimet e tij ndaj punës në bazë të kontratës së punës.

12. Më 24 gusht 2006, parashtruesi parashtroi një kërkesë për shqyrtim në Bordin e kompanisë "Hidrosistemi Radoniqi".

13. Edhe pse ky vendim nuk është në kërkesë ose në shkresat e lëndës, parashtruesi pretendon se, më 25 gusht 2006, Komisioni disiplinor ka mbështetur vendimin e Kompanisë, të datës 18 gusht 2006, për të ndërprerë kontratën e punës me parashtruesin.

14. Më 30 gusht 2006, parashtruesi u ankua te Menaxheri i përgjithshëm i Kompanisë, kundër vendimit të Komisionit disiplinor.

15. Edhe pse ky vendim nuk gjendet në kërkesë ose në shkresat e lëndës, parashtruesi pretendon se, më 21 shtator 2006, Menaxheri i përgjithshëm gjeti si të pabazuar ankesën e parashtruesit kundër Komisionit disiplinor.

16. As kontrata e punës së parashtruesit, e as procesverbali i Komisionit disiplinor, nuk gjenden në kërkesë apo në shkresat e lëndës.

17. Nuk është e qartë se a ishte ftuar parashtruesi të marrë pjesë në procedurat e Komisionit disiplinor.

18. Më 8 janar 2009, Gjykata Komunale e Gjakovës (Aktgjykimi C. nr. 172/08) anuloi Vendimin e Komisionit disiplinor, të 25 gushtit 2006, dhe Vendimin e Menaxherit të përgjithshëm, të datës 21 shtator 2006. Më tej, Gjykata Komunale urdhëroi Kompaninë që të kthejë parashtruesin në pozitën e tij të punës dhe, nëse ky kthim nuk mund të bëhet për arsye objektive, atëherë parashtruesi duhet të "... sistemohet në vendin dhe detyrat e punës në pajtim me përgatitjen profesionale dhe aftësinë e arritur në punë". Gjykata Komunale vlerësoi se "arsyet për ndërprerjen kushtëzohen në Kushtet Standarde të bashkëngjitura të punësimit dhe në Ligjin Themelor të Punës të Kosovës". Për më tepër, Gjykata Komunale vlerësoi se "shqyrtimi ishe kryer pa ftesën dhe pa prezencën e punëtorit, pra ka qenë e pamundur të paraqet mbrojtjen e tij". Kompania ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale.

19. Më 9 shkurt 2010, Gjykata e Qarkut në Pejë (Aktgjykimi Ac. nr. 176/09) ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, të 8 janarit 2009, dhe ankesa e parashtruesit u hodh poshtë si e pabazuar. Gjykata e Qarkut në Pejë vlerësoi se "[...] e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të

gabuar [...]", sepse ndërprerja e kontratës së punës është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 11.2 dhe nenit 11.4 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27 në Ligjin Themelor të Punës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës 2001/27). Për më tepër, Gjykata e Qarkut po ashtu vlerësoi se masat disiplinore i janë shqiptuar parashtruesit dhe, pasi që parashtruesi vazhdoi me shkelje të tjera të detyrave të punës, Kompania, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/27, informoi parashtruesin me shkrim dhe ka pasur një takim për ndërprerjen e kontratës së punës dhe i janë shpjeguar arsyet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Parashtruesi pastaj paraqiti një kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut.

20. Më 2 maj 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 106/2010) hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën për revizion. Gjykata Supreme vlerësoi se *"[...] marrëdhënia e punësimit të paditësit është ndërprerë në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligjin në fuqi, andaj çdo pretendim në revizion mbi këtë bazë është i papranueshëm"*.

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe i Gjykatës Supreme është marrë duke shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, sepse të dyja – edhe Gjykata e Qarkut në Pejë e edhe Gjykata Supreme – supozohet të kenë injoruar shkeljet procedurale gjatë procedurës disiplinore.

22. Më tutje, parashtruesi pretendon se ndërprerja e kontratës së punës së parashtruesit ishte në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/27, sepse ai asnjëherë nuk kishte pasur një takim me Kompaninë dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës asnjëherë nuk ka specifikuar se cilat dispozita juridike ishin shkelur nga ai.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Gjykata vëren se, për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton: *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë"*.

25. Më tej, Gjykata i referohet gjithashtu edhe rregullit 36 (1.c) të Rregullores së punës, që përcakton: "Gjykata mund të shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar".

26. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabime të fakteve apo të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për aq sa të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë (kushtetutshmëri). Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis. Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], ro. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I*).

27. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (*Shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991*).

28. Në fakt, në bazë të dokumenteve të paraqitura nga parashtruesi, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë provë që tregon se ai ishte i ftuar ose jo për të marrë pjesë në procedurat disiplinore dhe nëse Gjykata Supreme e injoroi këtë fakt apo jo. Mospajtimi i thjeshtë me Aktgjykimin, i shoqëruar me renditjen e disa dispozitave kushtetuese, nuk është i mjaftueshëm për të ndërtuar një rast për shkelje kushtetuese.

29. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi nuk ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës, andaj kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë si e papranueshme (*Shih, Aktvendimi për papranueshmëri në Rastin nr. KI13/09, Sevdail Avdyli kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. nr. 533/2006, i 11 shtatorit 2006, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, A. nr. 533/2006, i 2 dhjetorit 2006, 17 qershor 2010*).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (1.c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 27 nëntor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 104/12, Azem Kabashi, Tahir Badalli, Osman Zajmi dhe Nafije Krasniqi, datë 01 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së listës përfundimtare të 20% të të ardhurave të shitjes nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore "Industria Ushqimore", hartuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Lënda KI 104/12, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2012.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, qartazi e pabazuar, Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/13 për transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore

Parashtruesit e paraqitën kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar listën e punëtorëve të kualifikueshëm për 20% nga të ardhurat e shitjes së Ndërmarrjes shoqërore "Industria Ushqimore", Prizren, të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, sepse AKP-ja i ka interpretuar në mënyrë të gabueshme dispozitat e neneve 10.1, 10.2 dhe 10-4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 për transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore.

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata vlerësoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesit e kërkesës nuk kanë: a. dorëzuar asnjë dokumentacion mbështetës nëse ata i kanë shteruar të gjitha mjetet ligjore; b. mbështetur me prova në baza kushtetuese; dhe c. ofruar ndonjë provë se të drejtat dhe liritë e tyre janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI 104/12
Parashtruesit
Azem Kabashi
Tahir Badalli
Osman Zajmi
Nafije Krasniqi
Vlerësim i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së listës përfundimtare të 20%-it të ardhurave të shitjes nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore "Industria Ushqimore" hartuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga z. Azem Kabashi, me vendbanim në Korishë, fshat në Prizren, z. Tahir Badalli, me vendbanim në Zhur, fshat në Prizren, z. Osman Zajmi, me vendbanim në Prizren dhe znj. Nafije Krasniqi, me vendbanim në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kontestojnë listën e punëtoreve te kualifikueshëm për 20%-in nga të ardhurat e shitjes së Ndërmarrjes Shoqërore "Industria Ushqimore", Prizren, (në tekstin e mëtejmë: NSH) të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: "AKP").

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit pretendojnë se AKP-ja i ka interpretuar në mënyrë të gabueshme dispozitat e neneve 10.1, 10.2 dhe 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13 për Transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/13).

4. Parashtruesit nuk i referohen asnjë dispozite të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 19 tetor 2012, Parashtruesit dorëzuan në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës ((në tekstin e mëtejmë: "Gjykata") propozimin për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së listës së AKP-së të punëtoreve të kualifikueshëm për 20%-in nga të ardhurat e shitjes së NSH-së.

7. Më 23 tetor 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesit që ta plotësojnë kërkesën në pajtim me rregullin 36.4 të Rregullores së punës, i cili parasheh: *"Nëse kërkesa është e pakompletuar ose nuk përmban informacione të domosdoshme për zhvillimin e procedurave, Gjykata kërkon nga parashtruesi t'i bëjë përmirësimet e domosdoshme brenda një afati të caktuar kohor, por jo më shumë se 30 ditë."* Parashtruesit nuk parashtruan asnjë përgjigje në këtë kërkesë.

8. Më 5 nëntor 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin Nr.GJR.KI-104/12, caktoi Gjyqtarin Robert Carolan si Gjyqtar Raportues. Të njëjtën datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin Nr. KSH.KI-104/12, caktoi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga Gjyqtarët: Altay Suroy (gjyqtar kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 8 nëntor 2012, kërkesa iu komunikua AKP-së.

10. Më 6 dhjetor 2012, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, Kolegji Shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

11. Më 19 tetor 2012, parashtruesit dorëzuan kërkesën me vetëm pesë faqe të përbërë nga: 1. Propozimi për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së listës përfundimtare të 20 %-it, të hartuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit; 2. Lista e AKP-së e punëtoreve të kualifikueshëm për 20%-in nga të ardhurat e shitjes së NSH-së, të publikuar në gazetën ditore Kosova Sot; dhe 3. Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13.

Pretendimet e Parashtruesve

12. Parashtruesit pretendojnë se AKP-ja i ka interpretuar dhe aplikuar në mënyrë të gabueshme dispozitat e neneve 10.1, 10.2 dhe 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13, kur i ka hequr parashtruesit nga lista e punëtoreve të kualifikueshëm për 20% nga të ardhurat e shitjes së NSH-së, sepse nuk i kishin tre vite përvojë pune në NSH. Në vend të kësaj, ata pretendojnë se AKP-ja i ka futur në listë katër punëtorë tjerë, të cilët nuk kanë punuar fare në NSH.

13. Parashtruesit pretendojnë se ata kanë punuar në NSH prej 2001 deri më 2011 dhe se ata i kanë plotësuar kushtet nga nenet 10.1, 10.2 dhe 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesve, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregulloren e punës.

15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.1 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që parasheh se *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar."*

16. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 29 (2) (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) që parasheh se: " (2) *Kërkesa po ashtu duhet të*

përmbajë edhe: (a) emrin dhe adresën e palës e cila e parashtron kërkesën; (b) emrin dhe adresën e përfaqësuesit për dorëzimin e dokumenteve, nëse ka; (c) autorizimin për përfaqësuesin ligjor, nëse ka; (d) emrin dhe adresën e palës ose të palëve kundërshtare, nëse janë të njohura, të cilave u dërgohen dokumentet; (e) mbrojtjen juridike të kërkuar; (f) përmbledhje të shkurtër të fakteve; (g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe (h)) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës." Për më tepër, sipas rregullit 29 (3) parashihet se: *"(3) Kërkesës i bashkëngjiten kopjet e çfarëdo dokumenti relevant për të mbështetur atë. Nëse vetëm disa pjesë të dokumentit janë të rëndësishme atëherë sipas nevojës, duhet të bashkëngjiten vetëm pjesët e tilla."*

17. Në rastin konkret, parashtruesit nuk kanë:

    a. dorëzuar asnjë dokumentacion mbështetës nëse ata i kanë shteruar të gjitha mjetet ligjore;
    b. mbështetur me prova në baza kushtetuese; dhe
    c. ofruar ndonjë provë se të drejtat dhe liritë e tyre janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

18. Rrjedh se kërkesa është e papranueshme sepse është qartazi e pabazuar sipas rregullit 36 (2) të Rregullores së punës i cilia përcakton se: *(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të së drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose d) kur parashtruesi nuk dështon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36 (2) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 6 dhjetor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 79/10, Izet Zejnullahu, datë 01 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 93/2010, të 30 qershorit 2010.

Rasti KI 79/10, Aktvendim për Papranueshmëri, i 6 marsit 2012.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar

Parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata Supreme ka shkelur nenin 21, paragrafin 1 (Parimet e Përgjithshme); nenin 31, paragrafët 2 dhe 3 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm); nenin 49, paragrafin 1 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit); nenin 102, paragrafin 2 (Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor); dhe nenin 104, paragrafin 1 (Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve), të Kushtetutës.

Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që Gjykata Supreme e ka shkelur nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (E drejta për një proces të rregullt).

Parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese ta caktojë masën e përkohshme.

Pasi parashtruesi i kërkesës vetëm konteston nëse Gjykata Supreme e zbatoi ligjin e duhur dhe nxori konkluzion të duhur faktik, duket që parashtruesi i kërkesës thjesht kërkon që kjo Gjykatë ta anulojë vendimin ligjor të Gjykatës Supreme. Prandaj, kjo kërkesë është qartazi e pabazuar në lidhje me shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese apo të drejtave të njeriut dhe, si rrjedhojë, është e papranueshme.

Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë për shkelje kushtetuese nga e cila do të pësonte dëme të pariparueshme, si shpërblimi monetar nga punëdhënësi i tij i mëparshëm për shkëputje të paligjshme të kontratës, nuk ekziston asnjë bazë e vlefshme

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI79/10
Parashtruesi
Izet Zejnullahu
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 93/2010, të 30 qershorit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Izet Zejnullahu, me vendbanim në Vushtrri. Ai përfaqësohet nga avokati Zait Xhemajli, rr. "Meto Bajraktari" nr. 30, Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 93/2010, i 30 qershorit 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi e konteston vendimin e Shërbimit Policor të Kosovës në Prishtinë për shkëputjen e kontratës së tij të punës si zyrtar policor.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 26 gusht 2010. Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin kërkesës më 30 gusht 2010.

6. Më 1 shtator 2010, Kryetari i Gjykatës e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues dhe, po të njëjtën datë, Kryetari e caktoi edhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.

7. Gjykata Kushtetuese i njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës për parashtrimin e kërkesës.

8. Mistria e Punëve të Brendshme iu përgjigj këtij njoftimi më 4 prill 2011.

9. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues më 6 mars 2012 dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Parashtruesi ishte i punësuar në Policinë e Kosovës, por u përjashtua nga Policia në vitin 2008, në përputhje me vendimin e Komisionit disiplinor, të 28 janarit 2008, dhe vendimin e Bordit të ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme - Policisë së Kosovës, të 23 marsit 2008.

11. Arsyet për përjashtimin e tij nga puna ishin se kur parashtruesi konkurroi për punësim në Policinë e Kosovës, ai theksoi në formularin e kërkesës së tij se kundër tij nuk ishte iniciuar asnjë procedurë për veprime të paligjshme. Megjithatë, informacioni i ofruar nuk ishte i saktë. Më 26 tetor 2002, parashtruesi u pyet në formularin për punësim, *"... a jeni arrestuar më parë apo a keni qenë subjekt i ndonjë procedure hetimore?"* Parashtruesi iu përgjigj kësaj pyetjeje me *"Jo"*.

12. Më pas u kuptua që parashtruesi kishte qenë, në të vërtetë, i arrestuar në Republikën Federale të Gjermanisë për një vepër të rëndë penale të

kryer në Manhajm, Gjermani, gjatë vitit 1998-1999. Ai hetim përcaktoi që parashtruesi kishte kaluar një ditë në burg pas arrestimit.

13. Parashtruesi e kontestoi vendimin për përjashtimin e tij nga Policia në Gjykatën Komunale dhe në Gjykatën e Qarkut, dhe ishte i suksesshëm. Megjithatë, Gjykata Supreme, në Aktgjykimin, Rev. nr. 93/2010, të 30 qershorit 2010, theksoi se paraqitja e rreme e rrethanave të dënimit të tij ishte arsyetim për përjashtimin e tij nga puna.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata Supreme ka shkelur nenin 21, paragrafin 1 (Parimet e Përgjithshme); nenin 31, paragrafët 2 dhe 3 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm); nenin 49, paragrafin 1 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit); nenin 102, paragrafin 2 (Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor); dhe nenin 104, paragrafin 1 (Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve), të Kushtetutës.

15. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që Gjykata Supreme e ka shkelur nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (E drejta për një proces të rregullt).

16. Parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese ta caktojë masën e përkohshme.

Përgjigja e palës kundërshtare

17. Ministria e Punëve të Brendshme iu përgjigj Gjykatës nëpërmjet letrës së 4 prillit 2011, duke ripohuar obligimin e zyrtarëve policorë për t'i respektuar rregullat policore, në njërën prej të cilave thuhet: *"Parashtruesit e kërkesës dhe punonjësit duhet të jenë të sinqertë dhe gjithnjë ta thonë apo shkruajnë të vërtetën lidhur me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shërbimin zyrtar, duke përfshirë datën kur e parashtrojnë kërkesën për shërbim, pa marrë parasysh a janë nën betim apo jo".*

Vlerësimi i pranueshmërisë të kërkesës

18. Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis*

mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

19. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të 23 qershorit 2010, ish-punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, para. 66 dhe 67).

20. Pas shqyrtimit të procedurave në këto gjykata si tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk vëren që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

21. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës, Nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

22. Pasi parashtruesi i kërkesës vetëm konteston nëse Gjykata Supreme e zbatoi ligjin e duhur dhe nxori konkluzion të duhur faktik, duket që parashtruesi i kërkesës thjesht kërkon që kjo Gjykatë ta anulojë vendimin ligjor të Gjykatës Supreme. Prandaj, kjo kërkesë është qartazi e pabazuar në lidhje me shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese apo të drejtave të njeriut dhe, si rrjedhojë, është e papranueshme.

Vlerësimi i aspekteve juridike kryesore të kërkesës

23. Pasi kërkesa është e papranueshme, nuk ka bazë juridike për kërkesën e parashtruesit.

24. Pasi kërkesa është e papranueshme dhe pasi parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë për shkelje kushtetuese nga e cila do të pësonte dëme të paripërueshme, si shpërblimi monetar nga punëdhënësi i tij i mëparshëm për shkëputje të paligjshme të kontratës, nuk ekziston asnjë bazë e vlefshme për caktimin e masës së përkohshme.

25. Parashtruesi nuk ka ofruar prova apo argumente për ta bazuar caktimin e masës së përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 6 mars 2012, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme,

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 101/12, Arianit Dyla, datë 14 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 42/2012, të 18 qershorit 2012.

Rasti KI 101/12, Aktvendim për papranueshmëri i 18 janarit 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë Individuale, qartazi të pabazuar, Aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Gjykata") të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimit të Gjykatës Supreme, me të cilin të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një gjykim të drejtë) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: "KEMDNJ") pretendohen të jenë shkelur.

Për më tepër, Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të vendosë masën e përkohshme "[...] të shtyrjes së fillimit të vuajtjes së dënimit me burg përderisa Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të vendos lidhur me këtë kërkesë." Parashtruesi i kërkesës nuk ofron asnjë argument tjetër pse Gjykata duhet të vendosë masën e përkohshme.

Gjykata konstatoi se kërkesa për shkeljet e pretenduara refuzohet si qartazi e pabazuar dhe refuzoi kërkesën për masë të përkohshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI101/12
Parashtruesi
Arianit Dyla
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 42/2012, të 18 qershorit 2012.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Z. Arianit Dyla nga Gjakova (Parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston vendimin e Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 42/2012 të 18 qershorit 2012, i cili i është dorëzuar atij në një ditë të paspecifikuar.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Gjykata") të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimit të Gjykatës Supreme, me të cilin të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (***E drejta për një gjykim të drejtë)*** të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: "KEMDNJ") pretendohen të jenë shkelur.

4. Për më tepër, Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të vendosë masën e përkohshme *"[...] të shtyrjes së fillimit të vuajtjes së dënimit me burg përderisa Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të vendos lidhur me këtë kërkesë."* Parashtruesi i kërkesës nuk ofron asnjë argument tjetër pse Gjykata duhet të vendosë masën e përkohshme.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: "Ligji") dhe rregullave 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 18 tetor 2012, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

7. Më 31 tetor 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (Gjyqtare kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 13 nëntor 2012, Gjykata e informoi Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës në lidhje me dorëzimin e kërkesës.

9. Më 11 dhjetor 2012, Gjykata ia komunikoi kërkesën Prokurorit Publik të Shtetit.

10. Më 18 janar 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 18 maj 2010, Gjykata Komunale e Gjakovës e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale nga neni 253 (1.1) në lidhje me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë:, "KPPPK"), dhe e dënoi atë me gjashtë (6) muaj burgim (Aktgjykimi P. nr. 566/2005). Gjykata Komunale konstatoi se *"I pandehuri i dytë Arianit Dyla gjatë shqyrtimit gjyqësore dhe në fjalën e tij përfundimtare deklaron ne mënyrë te vullnetshme duke i ditur që më parë pasojat, se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe kërkon nga gjykata që të jep një dënim më të*

zbutur." Më tutje konstatoi se *"Një gjendje të këtillë faktike Gjykata vërtetoi në bazë te pranimit te vullnetshëm te fajësisë nga ana e të pandehurve BS dhe Arianit Dyla, dhe në bazë të provave tjera të parashtruara në lëndë. Gjykata ne mënyrë te veçantë vlerësoi mbrojtjen e te pandehurit të dytë Arianit Dyla, i cili e pranoi veprën penale me te cilën akuzohet mirëpo me pranimin e veprës penale nuk do të thotë qe i njëjti te lirohet edhe nga fajësia."*

12. Më 31 tetor 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë (Aktgjykimi Ap. nr. 87/2010) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë.

13. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën Komunale në Gjakovë për ta shtyrë ekzekutimin e dënimit.

14. Më 12 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Gjakovë (Vendimi Esp. nr. 405/2011) e urdhëroi parashtruesin e kërkesës të dorëzojë prova për shkak të sëmundjes serioze akute dhe ta dorëzojë raportin në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore, të lëshuar nga Institucioni Mjekësor ku ai ishte trajtuar, brenda afatit 8-ditor.

15. Më 27 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Gjakovë (Vendimi Esp. nr. 405/2011) e refuzoi kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit.

16. Më 24 janar 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë (Vendimi Pn. Nr. 09/12) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi vendimin e 27 dhjetorit 2012 të Gjykatës Komunale. Gjykata e Qarkut konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar prova të mjaftueshme që do të vërtetonin pretendimin e tij të vuajtjes nga sëmundja.

17. Më 30 janar 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pkl. nr. 134/2011) e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë të 18 majit 2010. Gjykata Supreme konstatoi, *"Nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor dhe nga vet aktgjykimi i shkallës së parë shihet se çështjen e ka gjykuar trupi gjykues i përberë nga një gjyqtar (H.H.) dhe dy gjyqtarë laikë e që është në përputhje të plotë me dispozitën e nenit 22 par. 1 te KPPPK, po ashtu nuk qëndron pretendimi për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor pa prezencën e tij dhe te mbrojtësit të tij, sepse (gjithnjë duke iu referuar shkresave të lëndës respektivisht procesverbalit te shqyrtimit gjyqësor), nga i cili shihet se Arianit Dyla ka deklaruar ne mënyrë te vullnetshme, duke i ditur që më pare pasojat e veprimit të tillë, e ka pranuar fajësinë, dhe gjykata ka gjetur se janë*

përmbushur të gjitha kushtet nga neni 315 par. 1 të KPPPK për pranimin e fajësisë nga i akuzuari, andaj shqyrtimi gjyqësor është konform nenit 359 par. 5 të KPPPK."

18. Më 18 qershor 2012, Gjykata Supreme (Vendimi Pzd. nr. 42/2012) e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për zbutje të dënimit. Gjykata Supreme konstatoi se *"Rrethana që tani parashtruesi e ka paraqitur në kërkesë për zbutje te jashtëzakonshme të dënimit, se e ka gjendjen e vështirë shëndetësore dhe është në terapi te vazhdueshme është rrethanë e re qe është shfaqur pas marrjes së aktgjykimit por jo e natyrës së tillë që justifikonë zbutjen e jashtëzakonshme te dënimit."*

Pretendimet e Parashtruesit

19. Parashtruesi pretendon si në vijim:

    a. *"Aktgjykimet përmbajnë shkelje esenciale penale që janë relevante për këtë fazë të procedurës, përkatësisht shkelje së ligjit penal nga neni 451 par (1), pika 1) e KPPPK, shkelje esenciale të ligjit të procedurës penale, të parapara nga neni 403, paragrafi 1 i dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar ne ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, konform nenit 451 par (1), pika 3) e KPPPK."*

    b. *"Para së gjithash, në shkallë të parë çështjen e ka gjykuar gjyqtari individual."*

    c. *"Përndryshe, seanca e kolegjit është mbajtur pa prezencën time dhe të mbrojtësit tim. Me rëndësi është që është mbajtur pa prezencën time dhe në bazë të asaj më është cenuar e drejta për mbrojtje."*

    d. *"Gjykata nuk ka nxjerrë asnjë provë."*

    e. *"Gjykata kishte detyrim që të përcaktoj dhe të individualizoj veprime e secilit të akuzuar veç e veç."*

    f. *"Sasia e mallit kinse të vjedhur, e përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit nuk është vërtetuar."*

    g. *"Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pzd. nr. 42/2012 të 18.06.2012 e ka refuzuar kërkesën e tij pa dhënë arsye të duhura në mënyrë që ai aktgjykim të trajtohet i drejtë dhe korrekt."*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Gjykata do të mund të shqyrtojë për pranueshmërinë e kërkesës së parashtruesit, nëse parashtruesi i kërkesës dëshmon se i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.

21. Siç shihet më lart, më 30 janar 2012, Gjykata Supreme vendosi se "*Nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor dhe nga vet aktgjykimi i shkallës së parë shihet se çështjen e ka gjykuar trupi gjykues i përberë nga një gjyqtar (H.H.) dhe dy gjyqtarë laikë e që është në përputhje të plotë me dispozitën e nenit 22 par. 1 te KPPK, po ashtu nuk qëndron pretendimi për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor pa prezencën e tij dhe te mbrojtësit të tij, sepse (gjithnjë duke iu referuar shkresave të lëndës respektivisht procesverbalit te shqyrtimit gjyqësor), nga i cili shihet se këtu i gjykuari Arianit Dyla ka deklaruar në mënyrë te vullnetshme, duke i ditur që më parë pasojat e veprimit të tillë, e ka pranuar fajësinë, dhe gjykata ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet nga neni 315 par. 1 të KPPPK për pranimin e fajësisë nga i akuzuari, andaj shqyrtimi gjyqësor është konform nenit 359 par. 5 të KPPPK-së.*"

22. Më 18 qershor 2012, Gjykata Supreme vendosi se *"Rrethana që tani parashtruesi e ka paraqitur në kërkesë për zbutje te jashtëzakonshme të dënimit, se e ka gjendjen e vështirë shëndetësore dhe është ne terapi te vazhdueshme është rrethanë e re që është shfaqur pas marrjes se aktgjykimit por jo e natyrës së tille që justifikojnë zbutjen e jashtëzakonshme te dënimit."*

23. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk e gëzon juridiksionin e apelit dhe nuk mund te ndërhyjë nga aspekti teorik nëse gjykatat e rregullta kanë marrë vendim të gabuar ose kanë bërë vlerësim të gabuar të fakteve. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt (*shih* Rastin Nr. KI 07/09, Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl.nr. 61/07 të 24 nëntorit 2008 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Ap. nr. 510/2007 të 26 marsit 2008, Aktvendimi për Papranueshmëri i 19 majit 2010).

24. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat gjegjëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [ECHR] 1999-1).

25. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar me 10 korrik 1991).

26. Në rastin konkret, parashtruesi thjesht nuk pajtohet me të gjeturat e gjykatave përkitazi me rastin dhe i referohet disa dispozita të Kushtetutës dhe të KPPPK-së, që janë shkelur nga vendimi i kontestuar (Aktgjykimi Pzd. 42/2012) i Gjykatës Supreme.

27. Pra, parashtruesi nuk ka shpjeguar se si dhe përse Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtat e tij dhe dispozitat e KPPPK-së.

28. Si përfundim, parashtruesi nuk ka treguar se procedurat në Gjykatën Supreme ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06 i 30 qershorit 2009).

29. Rregulli 36 (2) d) i Rregullores parasheh se "Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se (...) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

30. Prandaj, duke marrë parasysh çka u tha më sipër, rrjedh se kërkesa për shkeljet e pretenduara duhet të refuzohet si qartazi e pabazuar.

Kërkesa për Masa të Përkohshme

31. Neni 27 i Ligjit dhe, në veçanti, Rregulli 54 (1) i Rregullores së Punës, parashikon se "në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme."

32. Sidoqoftë, duke marrë parasysh se kërkesa është shpallur e papranueshme, parashtruesi nuk ka të drejtë sipas rregullit 54 (1) të Rregullores së Punës të kërkojë masën e përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 27 të Ligjit, rregullit 36 (2.d), rregullit 54 (1) dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, më 18 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TË HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TË HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme;

III. Ky vendim do t'iu komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 106/12, Lulzim Ramaj, datë 14 shkurt 2013- Kërkesë për njohjen e statusit të pjesëtarit të UÇK-së

Rasti KI 106/12, Aktvendim për papranueshmëri i 29 janarit 2013

Fjalë kyçe: vazhdim i rastit, kërkesë individuale, *res judicata*, kërkesë për moszbulimin e identitetit, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale.

Parashtruesi, z. Lulzim Ramaj, e parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës. Kërkesa e tanishme është vazhdim i Rastit Nr. KI 32/11. Parashtruesi ankohet tani se organizata e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) "*refuzon lëshimin e vërtetimit të pjesëtarit të UÇK-së dhe mohon njohjen e statusit të pjesëtarit të UÇK-së, publikimin e rastit në media dhe shpifjet nga OVL e UÇK-së [...]*".

Sa i përket çështjes së pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi kishte dështuar të dorëzojë prova dhe bazë të re dhe të mjaftueshme për një vendim të ri. Prandaj, Gjykata, konstatoi kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme, sepse Gjykata Kushtetuese tashmë ka vendosur për rastin e parashtruesit në Rastin Nr. KI 32/11., përkatësisht rasti është *res judicata*. Për më tepër, sa i përket kërkesës për moszbulimin e identitetit të tij, parashtruesi nuk kishte ofruar bazë mbështetëse dhe as prova për ta mbështetur kërkesën e tij për moszbulimin e identitetit. Prandaj, Gjykata e refuzon kërkesën e tillë si të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI106/12
Parashtrues
Lulzim Ramaj
Kërkesë për njohjen e statusit të pjesëtarit të UÇK-së

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Kërkesa

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Lulzim Ramaj, me vendbanim në Pejë (parashtruesi i kërkesës).

2. Më 3 mars 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesën e parë (Rasti Nr. KI32/11) në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata). Rasti ishte refuzuar si i papranueshëm, më 18 janar 2012.

Objekti i çështjes

3. Kërkesa e tanishme është vazhdim i rastit Nr. KI32/11. Parashtruesi tash ankohet se organizata e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) po *"refuzon lëshimin e vërtetimit të pjesëtarit të UÇK-së dhe mohon njohjen e statusit të pjesëtarit të UÇK-së, publikimi i rastit në media dhe shpifjet nga OVL e UÇK-së [...]"*.

4. Në këtë drejtim, parashtruesi pohon se *"[...] kjo bie ndesh me nenin 21, paragrafi 1, nenin 24, paragrafi 1, nenin 36, paragrafi 1 dhe nenin 41, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; nenin 1, nenin 2, paragrafi 1, nenin 7, nenin a dhe nenin 29, paragrafi 2, të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; nenin 2, paragrafi 1 (a) dhe (b), nenin 5, paragrafi 11 dhe 2, nenin a, paragrafi 2, nenin 14, paragrafi 1,*

nenin 25, paragrafi 1 dhe nenin 26 te Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike; dhe nenin 1 (Detyrimi për t'i zbatuar të drejtat e njeriut) dhe Nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolleve të saj".

5. Për më tepër, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të mos e zbulojë identitetin e tij, pa ofruar arsye të mëtejme.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); në nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 18 janar 2012, Gjykata Kushtetuese, në një rast të mëparshëm (Rasti Nr. KI32/11), e shpalli kërkesën të papranueshme në bazë të asaj se kërkesa e parashtruesit të kërkesës ishte ende në pritje për t'u zgjidhur në Gjykatën Supreme. Prandaj, kërkesa e parashtruesit ishte e parakohshme. Ai përfundim ishte në përputhje me informatat e dhëna parashtruesit të kërkesës nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës se "parashtresa e tij në lidhje me zvarritjen e shqyrtimit nga Gjykata Supreme e Kosovës nuk i plotëson kriteret për t'u trajtuar si zvarritje nga Gjykata". Parashtresa është ende në pritje për t'u zgjidhur në Gjykatën Supreme.

8. Më 22 tetor 2012, parashtruesi dorëzoi një kërkesë të re në Gjykatë.

9. Më 4 dhjetor 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

10. Më 29 janar 2013 Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Asnjë informatë e re në përkitazi me rastin e mëparshëm KI32/11 nuk është dorëzuar në Gjykatë.

12. Faktet, siç janë përshkruar në Rastin KI32/11, ishin si vijon:

13. Më 17 shtator 2010, parashtruesi e dorëzoi një kërkesë në organizatën e veteranëve, OVL e UÇK-së, Dega në Pejë, për njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së dhe, gjithashtu, kërkoi t'i lëshohet "Libreza e UÇK-së".

14. Më 12 tetor 2010, për shkak të heshtjes administrative nga Dega e Pejës, sipas nenit 131 të Ligjit për Procedurën Administrative në Kosovë (Ligji Nr. 02/L-28), parashtruesi ushtroi një ankesë në Organizatën Qendrore të Veteranëve të UÇK-së në Prishtinë.

15. Më 13 dhjetor 2010, parashtruesi paraqiti një kërkesë në Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë, për shkak të faktit se ai nuk e kishte marrë vendimin për ankesën e tij të ushtruar në Organizatën Qendrore të Veteranëve të UÇK-së.

16. Më 28 dhjetor 2010 dhe më 29 janar 2011, parashtruesi dorëzoi ankesa në Inspektoratin Gjyqësor të Kosovës kundër mosveprimit të Gjykatës Supreme.

17. Më 9 shkurt 2011, parashtruesi mori një letër nga Zyra e Avokatit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me të cilën u informua se parashtresa e tij përkitazi me zvarritjen e shqyrtimit nga Gjykata Supreme e Kosovës nuk e kishte plotësuar kriterin kohor për t'u marrë në konsideratë.

18. Më 9 shkurt 2011, parashtruesi i kërkesës e parashtroi një kërkesë tjetër në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke kërkuar shqyrtimin e ankesave të tij, të 28 dhjetorit 2010 dhe të 29 janarit 2011.

19. Faktet në Rastin KI106/12 janë paraqitur si në vijim:

20. Më 1 mars 2011, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër Organizatës Qendrore të Veteranëve të UÇK-së në Prishtinë, pa përmendur se në cilën organizatë ishte ankuar.

21. Më 23 mars 2011, parashtruesi i kërkesës e ndryshoi ankesën e tij dhe, në vend se të kërkojë njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së, ai kërkoi të ketë statusin e pjesëtarit të UÇK-së.

22. Më 4 korrik 2012, parashtruesi kishte paraqitur një parashtresë në Gjykatën Supreme, për të cilën, sipas parashtruesit, nuk kishte marrë

asnjë përgjigje. Parashtruesi nuk ka treguar se çfarë parashtrese kishte paraqitur dhe për çfarë.

23. Më 18 korrik 2012, parashtruesi kishte ushtruar ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës kundër Gjykatës Supreme, për shkak të mosshqyrtimit dhe të moszgjidhjes së rastit të tij.

24. Më 24 gusht 2012, parashtruesi ushtroi ankesë kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për shkak të heshtjes administrative dhe për refuzimin e ankesës së tij të 18 korrikut 2012. Sipas parashtruesit, ai ende nuk ka marrë asnjë përgjigje.

25. Për më tepër, asnjë dokumentacionin mbështetës dhe asnjë informatë nuk është ofruar sa i përket arsyeve të parashtruesit për moszbulimin e identitetit të tij.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

26. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për ankesën e re të parashtruesit të kërkesës, është e nevojshme që në fillim të vlerësohet se a i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) (e), i cili thekson: *"Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur: Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri".*

28. Ankesa e parashtruesit të kërkesës se atij i është refuzuar njohja e statusit të pjesëtarit të UÇK-së, tashmë ishte refuzuar nga Gjykata me Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin Nr. KI32/11.

29. Parashtruesi ka dështuar të ofrojë baza të reja dhe të mjaftueshme për një vendim të ri. Informata e vetme e re që që ka ofruar parashtruesi i kërkesës në Gjykatë është se ai dëshiron ta ndryshojë kërkesën e tij nga njohja e statusit të veteranit të UÇK-së në status të pjesëtarit të UÇK-së. Për më tepër, parashtruesi nuk kishte ofruar në Gjykatë aktin final të lëshuar nga autoriteti publik që ai e konteston në Gjykatë. Për më tepër, procedura, të cilën e kishte ndërmarrë parashtruesi pas Aktvendimit për papranueshmëri në Rastin KI32/11, kishte të bënte gjithashtu me atë se

parashtruesi, në vend se të kërkojë statusin e veteranit të UÇK-së, tani kërkon njohjen e statusit të pjesëtarit të UÇK-së.

30. Prandaj, sipas rregullit 36(3) (e) të Rregullores, Gjykata nuk do të merret me këtë kërkesë.

31. Në këto rrethana, Gjykata konkludon, në bazë të rregullit 36 (3. e) të Rregullores së punës, se kërkesa është e papranueshme, pasi Gjykata tashmë ka vendosur për çështjen në fjalë.

32. Sa i përket kërkesës së parashtruesit të kërkesës për moszbulimin e identitetit të tij, parashtruesi nuk kishte ofruar bazë mbështetëse dhe as prova për ta mbështetur kërkesën e tij për moszbulimin e identitetit. Prandaj, Gjykata e refuzon kërkesën e tillë si të pabazuar.

PER KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të rregullit 36 (3. e) dhe të rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, më 29 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme, pasi Gjykata Kushtetuese tashmë ka vendosur për rastin e parashtruesit të kërkesës në Rastin Nr. KI32/11, që do të thotë rasti është *res judicata*;

II. TA REFUZOJË kërkesën e parashtruesit për moszbulim të identitetit;

III. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

IV. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 87/12, Afrim Rexhepi, datë 14 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap. Nr. 119/2010, të 10 tetorit 2011

Rasti KI87/12, Aktvendim i 21 janar 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë Individuale, jashtë afatit kohor

Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr 119/2010, e 10 tetorit 2011.

Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese "që të hapë hetime ndaj të përfshirëve në këtë Aktgjykim, sepse si pasojë e njerëzve të përfshirë në të unë jam i dëmtuar dhe jam dënuar me 3 vite e 2 muaj burgim pa pasur faj edhe pse unë kam qenë i rrezikuar me armë zjarri askush nuk e ka marrë parasysh këtë, dhe unë nuk jam një njeri i tillë siç më ka përshkruar prokurori publik".

Parashtruesi nuk tregon asnjë të drejtë ose liri themelore apo ndonjë dispozitë kushtetuese, e cila pretendohet të jetë shkelur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës.
Gjykata vëren më tej se kërkesa e parashtruesit iu dorëzua Gjykatës Kushtetuese më 1 tetor 2012, d.m.th., pothuajse dhjetë muaj pas afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

Kështu, kërkesa nuk është dorëzuar në Gjykatë në mënyrë ligjore, siç është përcaktuar me nenin 113 (1) të Kushtetutës dhe shpallet kërkesa e papranueshme për shkak të afatit kohor.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI87/12
Parashtrues
Afrim Rexhepi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap. Nr. 119/2010, të 10 tetorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Afrim Rexhepi, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr 119/2010, e 10 tetorit 2011, që i është dorëzuar parashtruesit më 30 dhjetor 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi ankohet për bashkimin e dënimit unik dhe për refuzimin e ankesës së tij si të pabazuar.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 1 tetor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatë.

6. Më 31 tetor 2012, Kryetari e caktoi Gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

7. Më 3 nëntor 2012, Sekretariati i dërgoi një shkresë parashtruesit, duke kërkuar që ai ta plotësojë kërkesën për Gjykatën Kushtetuese. Më 14 nëntor 2012, duke mos marrë parasysh atë që u tha më lart, Sekretariati e informoi parashtruesin se kërkesa e tij ishte regjistruar.

8. Më 14 nëntor 2012, Sekretariati e informoi Gjykatën Supreme për kërkesën e parashtruesit.

9. Më 30 nëntor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ia dërgoi Sekretariatit kopjen e nënshkruar të fletëkthimit të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme të Kosovës. Sipas fletëkthimit të nënshkruar, parashtruesi e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme më 30 dhjetor 2011.

10. Më 21 janar 2013, pas shqyrtimit të Raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

11. Më 10 tetor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës nxori aktgjykimin e kontestuar (Ap. Nr. 119/2010) dhe aprovoi ankesën e Prokurorit Publik përkitazi me dënimin.

12. Prandaj, Gjykata Supreme i shqiptoi parashtruesit dënimin unik me burg në kohëzgjatje 3 (tri) vjet dhe (2) dy muaj. Ankesa e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës ishte hedhur poshtë si e pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit

13. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese *"që të hapë hetime ndaj të përfshirëve në këtë Aktgjykim, sepse si pasojë e njerëzve të përfshirë në të unë jam i dëmtuar dhe jam dënuar me 3 vite e 2 muaj burgim pa pasur faj edhe pse unë kam qenë i rrezikuar me armë zjarri askush nuk e ka marrë parasysh këtë, dhe unë nuk jam një njeri i tillë siç më ka përshkruar prokurori publik".*

14. Parashtruesi nuk tregon asnjë të drejtë ose liri themelore apo ndonjë dispozitë kushtetuese, e cila pretendohet të jetë shkelur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Pranueshmëria e kërkesës

15. Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës përcakton:

> *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".*

16. Gjykata i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, që parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".*

17. Për më tepër, rregulli 36 [Kriteret e Pranueshmërisë] i Rregullores së punës parasheh:

> *"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse*:
>
> *b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi".*

18. Gjykata vëren se vendimi i plotfuqishëm i gjykatës ishte marrë nga Gjykata Supreme (Ap. nr. 119/2010) më 10 tetor 2011 dhe iu dorëzua parashtruesit më 30 dhjetor 2011.

19. Gjykata vëren më tej se kërkesa e parashtruesit iu dorëzua Gjykatës Kushtetuese më 1 tetor 2012, d.m.th., pothuajse dhjetë muaj pas afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

20. Kështu, kërkesa nuk është dorëzuar në Gjykatë në mënyrë ligjore, siç është përcaktuar me nenin 113 (1) të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

I. TA SHPALLË kërkesën të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 123/12, Bajrush Gashi, datë 14 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 65/2012, të 10 shtatorit 2012.

Rasti KI 123/12, Aktvendim për papranueshmëri i 29 janarit 2013

Fjalë kyçe: vazhdim i rastit, kërkesë individuale, *res judicata*, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi, z. Bajrush Gashi, parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës. Kërkesa e tanishme është vazhdim i Rastit Nr. KI 06/12. Parashtruesi tani ankohet se procedura në Gjykatën e Qarkut ishte në kundërshtim me Kushtetutën dhe Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

Sa i përket çështjes së pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi kishte dështuar të dorëzojë prova dhe bazë të re dhe të mjaftueshme për një vendim të ri. Prandaj, Gjykata, konstatoi kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme, sepse Gjykata Kushtetuese tashmë ka vendosur për rastin e parashtruesit në Rastin Nr. KI 06/12, përkatësisht rasti është *res judicata*.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI123/12
Parashtrues
Bajrush Gashi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. Nr. 65/2012, të 10 shtatorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Kërkesa

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Bajrush Gashi, me banim në fshatin Hoqë e Vogël, Komuna e Rahovecit (parashtrues i kërkesës).

2. Më 27 janar 2012, parashtruesi parashtroi kërkesën e parë (Rasti Nr. KI06/12) në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

3. Më 9 maj 2012, Gjykata e shpalli kërkesën të pranueshme, si dhe gjeti shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe të nenit 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Objekti i çështjes

4. Kjo kërkesë është në vazhdimësi të Rastit Nr. KI06/12. Parashtruesi i kërkesës tash ankohet se:

"...

a. *Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren ka qenë jotransparent, pa fakte e argumente.*
b. *Prokurori i rastit, derisa merrte në pyetje dëshmitarin kryesor të këtij rasti, e ka përjashtuar atë nga zyra e tij, duke e kërcënuar që nëse nuk bashkëpunon, do ta dërgojë në burg.*

c. *Kërkesa ime dhe kërkesa e mbrojtjes sime ishte që V. E. të merret në pyetje si dëshmitar. Prokurori dhe Gjyqtari V. D. kanë refuzuar këtë.*

d. *Gjyqtari V. D., në gjykatën e shkallës së parë ishte Kryetar i Kolegjit, si dhe anëtar i Kolegjit në Gjykatën Supreme. Gjyqtari V. D. ka marrë pjesë drejtpërdrejt dhe indirekt në gjitha ankesat e mia, vetëm për të mbrojtur vendimin jo-transparent të Gjykatës së Qarkut.*

e. *Kam parashtruar ankesë për këtë në Gjykatën Kushtetuese, dhe më keni dhënë këtë të drejtë, si dhe e keni kthyer për rishqyrtim.*

f. *Gjykata Supreme ka ndërruar vetëm kolegjin, si dhe ka vendosur njëjtë si më parë.*

...".

5. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

7. Më 9 maj 2012, Gjykata Kushtetuese, në rastin e mëparshëm Nr. KI06/12, e shpalli kërkesën të pranueshme dhe gjeti shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe të nenit 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të KEDNJ-së, me bazën që

"[...] në rrethanat e rastit, paanshmëria e Gjykatës Supreme ka mundësi të jetë e hapur për dyshim, si dhe frika e parashtruesit në këtë kuptim mund të konsiderohet subjektivisht dhe objektivisht e arsyetuar", sepse "[...] i njëjti gjyqtar që kryesonte kolegjin në Gjykatën e Qarkut në Prizren, gjithashtu mori pjesë në Kolegjin e Gjykatës Supreme, duke vendosur mbi kërkesën e tij për zbutje të dënimit".

8. Pastaj, Gjykata Kushtetuese "SHPALLI të pavlefshëm Vendimin Pzd. Nr. 67/2011 të Gjykatës Supreme, të 12 dhjetorit 2011, i cili shkel nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së", si dhe "I KTHEU Vendimin Pzd. Nr. 67/2011, të Gjykatës Supreme, të 12 dhjetorit 2011, Gjykatës Supreme për rishqyrtim, në pajtim me aktgjykimin e kësaj Gjykate, në bazë të rregullit 74.1 të Rregullores së punës".

9. Më 17 tetor 2012, Gjykata Supreme e njoftoi Gjykatën Kushtetuese që e ka rishqyrtuar vendimin e saj në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, pra duke marrë vendim me një përbërje tjetër të gjyqtarëve (Vendimi Pzd. Nr. 65/2012, i 10 shtatorit 2012).

10. Më 4 dhjetor 2012, parashtruesi parashtroi një kërkesë të re në Gjykatë.

11. Më 10 janar 2013, Kryetari i Gjykatës emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues, si dhe emëroi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

12. Më 29 janar 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandim për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Asnjë informatë e re përkitazi me rastin e mëparshëm KI06/12 nuk i është paraqitur Gjykatës.

14. Faktet, ashtu siç përshkruhen në rastin KI06/12, janë të përmbledhura si në vijim:

15. Më 19 maj 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren shpalli parashtruesin fajtor për kryerjen e veprës penale nga neni 138.6, në lidhje me nenin 138.1 dhe me nenin 328.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK), si dhe e dënoi atë me 4 vjet e 4 muaj burgim (Aktgjykimi P. Nr. 26/09). Parashtruesi u ankua ndaj këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme. Prokurori publik, gjithashtu, u ankua

ndaj këtij aktgjykimi për sa i përket pjesës që kishte të bënte me të bashkëpandehurin G. M.

16. Më 8 dhjetor 2010, Gjykata Supreme hodhi poshtë, si të pabaza, ankesat e parashtruesit dhe të Prokurorit Publik, si dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut (Aktgjykimi Ap. Nr. 259/2009).

17. Më 12 dhjetor 2011, Gjykata Supreme hodhi poshtë, si të pabazë, kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit (Aktgjykimi Pzd. Nr. 67/2011).

18. Në këtë kuptim, parashtruesi pretendoi para Gjykatës Kushtetuese që gjyqtari që ishte kryesues i Kolegjit në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe kishte vendosur rastin e tij, gjithashtu kishte marrë pjesë në vendimin e Gjykatës Supreme për kërkesën e tij për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit (gjyqtari në fjalë).

19. Për më tepër, parashtruesi pretendoi që gjyqtari në fjalë duhej të informonte Gjykatën Supreme se ai kishte qenë kryesues Kolegji në Gjykatën e Qarkut në Prizren, si dhe duhej përjashtuar nga pjesëmarrja në Kolegjin e Gjykatës Supreme.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet Rregullit 36.3.e, i cili përcakton: *"Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: (e) Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri".*

22. Ankesa e parashtruesit përkitazi me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të KEDNJ-së, tashmë është trajtuar nga Gjykata me Aktgjykimin e saj në Rastin Nr. KI06/12.

23. Parashtruesi nuk ka ofruar fakte të reja, e as baza të mjaftueshme për vendim të ri.

24. Për më tepër, Gjykata Supreme tashmë ka njoftuar Gjykatën Kushtetuese që ka vepruar në përputhje me Aktgjykimin kushtetues (*Shih Aktvendimin Pzd. Nr. 65/2012, të 10 shtatorit 2012*).

25. Kështu, në bazë të rregullit 36.3.e të Rregullores, Gjykata nuk do të merret me këtë kërkesë të re.

26. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se kërkesa, në bazë të rregullit 36.3.e të Rregullores së punës, është e papranueshme pasi Gjykata tashmë ka vendosur për çështjen në fjalë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të rregullit 36.3.e dhe të rregullit 56.2 të Rregullores së punës, më 29 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme, pasi Gjykata Kushtetuese tashmë ka vendosur për rastin e parashtruesit të kërkesës në Rastin Nr. KI06/12, do të thotë rasti është *res judicata*;

II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve; dhe

III. TA PUBLIKOJË vendimin në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 116/12, Lulzim Ramaj, datë 14 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit,1218/2/12, të 12 qershorit 2012

Rasti KI 116/12, Aktvendim për papranueshmëri i 25 janarit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme, keqpërdorim i së drejtës për peticion, zbulim i identitetit, barazia para ligjit, e drejta e qasjes në dokumente publike.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar sepse Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës ka arkëtuar të holla në mënyrë të kundërligjshme nga ai, se ia ka vonuar dërgesat postare, se i janë dorëzuar dërgesa të papastra dhe se ai është fyer dhe është kërcënuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Postës Rajonale në Pejë.

Gjykata së pari konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e pafatshme përkatësisht nuk ishte parashtruar në Gjykatë në pajtim me Nenin 49 të Ligjit. Gjykata, më tej, arsyetoi se parashtruesi kishte keqpërdorur të drejtën e tij për peticion sepse ai në mënyrë të vazhdueshme, kishte parashtruar kërkesa të ngjashme që në të kaluarën ishin shpallur të papranueshme. Gjykata po ashtu refuzoi kërkesën e parashtruesit për mos zbulim të identitetit. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (3) d të Rregullores së punës vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI116/12
Parashtrues
Lulzim Ramaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, 1218/2/12, të 12 qershorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Lulzim Ramaj, me vendbanim në Pejë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit, 1218/2/12, të 12 qershorit 2012, i cili i është dorëzuar atij më 13 qershor 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është ankesa e parashtruesit të kërkesës se Posta Rajonale në Pejë i ka arkëtuar në mënyrë të kundërligjshme të holla, se ia ka vonuar dërgesat postare, se dërgesat postare i janë dorëzuar atij të papastra dhe se ai i është nënshtruar fyerjeve dhe kërcënimeve nga Kryeshefi Ekzekutiv i Postës Rajonale në Pejë.

4. Parashtruesi, gjithashtu, kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të mos ia zbulojë identitetin.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe të rregullit 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 12 nëntor 2012, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 4 dhjetor 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

8. Më 4 janar 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Autoritetin Rregullator të Telekomunikacionit për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 25 janar 2013, Kolegji shqyrtues e ka shqyrtuar raportin e Gjyqtarit raportues dhe i ka paraqitur Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 18 janar 2012, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër nëpunësve postarë të Postës Rajonale në Pejë, duke pretenduar arkëtim të kundërligjshëm të 0.10 € për një kartëpostale, pasi që, me Udhëzimin Administrativ Nr. 2005/4, për shërbimet universale postare nuk parashihet ndonjë taksë postare për kartëpostale.

11. Më 10 shkurt 2012, parashtruesi paraqiti kërkesë në Postë për t'ia dhënë çmimoren e shërbimeve postare të Kosovës.

12. Më 13 shkurt 2012, parashtruesi pati një telefonatë nga Kryeshefi Ekzekutiv i Postës Rajonale në Pejë ku iu tha se çmimorja mund të gjendet në muret e Postës, si dhe në ueb-faqen e Postës.

13. Më 15 shkurt 2012, parashtruesi ushtroi ankesë në Autoritetin Rregullator të Telekomunikacionit (në tekstin e mëtejmë: ART) kundër Postës Rajonale në Pejë.

14. Më 21 shkurt 2012, parashtruesi ushtroi ankesë kundër nëpunësit postar të Zyrës postare në Prishtinë, në Drejtorinë e Postave të Kosovës, për fshehjen e peshës në fletëdërgesë. Parashtruesi nuk ka marrë përgjigje nga e njëjta.

15. Më 25 prill 2012, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme te Kosovës kundër vendimit të ART-së, Nr. 937/2/12, të 14 marsit 2012. Deri më tash, parashtruesi nuk ka marrë asnjë përgjigje për këtë.

16. Më 24 gusht 2012, parashtruesi e njoftoi Këshillin Gjyqësor të Kosovës se Gjykata Supreme e Kosovës nuk e kishte shqyrtuar padinë e tij.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi pretendon shkeljen e nenit 21, paragrafi 1 [Parimet e Përgjithshme]; të nenit 24, paragrafi 1 [Barazia para Ligjit]; të nenit 36, paragrafi 1 [E Drejta e Privatësisë]; të nenit 41, paragrafi 1 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], të Kushtetutës; si dhe të nenit 1 [Detyrimi për të Respektuar të Drejtat e Njeriut] dhe të nenit 14 [Ndalimi i Diskriminimit], të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Parashtruesi, gjithashtu, pretendon shkelje të dispozitave të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

18. Parashtruesi pretendon se Posta ka arkëtuar të holla në mënyrë të kundërligjshme nga ai, se ia ka vonuar dërgesat postare, se i janë dorëzuar dërgesa të papastra dhe se ai është fyer dhe është kërcënuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Postës Rajonale në Pejë.

19. Parashtruesi kërkon *inter alia* nga Gjykata:

- Ta detyrojë ART-në që ta largojë Kryeshefin Ekzekutiv të Postës Rajonale në Pejë;
- Ta largojë nga puna Udhëheqësin për Shërbimet Postare të Kosovës;
- Ta largojë nga puna Kontrollorin postar të Postës Rajonale në Pejë;

- Ta largojë nga puna Kontrollorin e Qendrës Transite të Postës;

- Ta largojë nga puna nëpunësin postar të Postës Rajonale në Pejë, ndaj të cilit parashtruesi ka ushtruar ankesë më 21.7.2012;

- T'i largojë nga puna të gjithë punëtorët që kanë keqpërdorur detyrën zyrtare, sipas vërtetimeve postare të paraqitura nga parashtruesi, dhe të dënojë secilin veç e veç nga 5.000 (pesë mijë) € në bazë të dispozitave të Ligjit për Shërbimet Postare dhe të Ligjit të Punës;

- T'i paguhet dëmshpërblimi në shumën 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) €;

- T'i paguhet dëmshpërblimi për shkresa në shumën 300.000 (treqind mijë) €;

- Të lirohet parashtruesi i kërkesës nga barra financiare e procedurës gjyqësore në bazë të nenit 31, paragrafi 6 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës.

Vlerësimi i kërkesës

20. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje me Ligj dhe me Rregullore të punës të Gjykatës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili thekson:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi*".

22. Gjykata vëren se vendimi i kontestuar i ART-së i është dorëzuar parashtruesit më 13 qershor 2012 dhe se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën më 12 nëntor 2012.

23. Prandaj, parashtruesi është dashur të dorëzojë kërkesën më së largu deri më 13 tetor 2012, në mënyrë që t'i përmbahet afatit ligjor për parashtrimin e kërkesës, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.

Parashtruesi e dorëzoi kërkesën më 12 nëntor 2012, një muaj pas afatit të paparë ligjor.

24. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e paafatshme.

25. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 36 (3, d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:

d) Gjykata konsideron që kërkesa është keqpërdorim i së drejtës për peticion".

26. Gjykata, po ashtu, vëren se parashtruesi ka parashtruar 4 kërkesa të ndryshme në Gjykatë, duke përfshirë edhe këtë kërkesë. Kërkesat e dorëzuara nga parashtruesi janë si në vijim:

- Aktvendim për papranueshmëri në Rastin Nr. KI126/10, parashtrues Lulzim Ramaj – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, Nr. 140, të 25 janarit 2010, të nxjerrë nga Gjykata më 19 janar 2012;

- Aktvendim për papranueshmëri në Rastin Nr. KI32/11, parashtrues Lulzim Ramaj – Kërkesë për njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së, të nxjerrë nga Gjykata më 20 prill 2012;

- Kërkesa KI106/12, e cila ende nuk është shqyrtuar nga Gjykata dhe e cila ka për objekt shqyrtimi kërkesën e parashtruesit përkitazi me statusin e veteranit të UÇK-së.

27. Gjykata i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], të Kushtetutës, i cili thotë:

"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

28. Gjykata thekson se praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i shpjegon mënyrat e ndryshme që tregojnë tendencën e shpërdorimit të së drejtës për kërkesë nga parashtruesit. Njëra nga ato është kur parashtruesit vazhdimisht parashtrojnë në Gjykatë kërkesa të bezdisshme dhe qartazi të pabazuara, të cilat janë të ngjashme me

kërkesat e parashtruara në të kaluarën, dhe të cilat tashmë janë shpallur të papranueshme *(Shih, M.v. Mbretëria e Bashkuar (dec.), dhe Philis vs. Greqisë (dec.)).*

29. Në këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesi i ka parashtruar 4 kërkesa të ndryshme, nga të cilat dy tashmë janë shpallur të papranueshme.

30. Gjykata konsideron se, në rastin e tanishëm, parashtruesi me të vërtetë e ka keqpërdorur të drejtën për kërkesë, sepse ai, në mënyrë të vazhdueshme, ka parashtruar kërkesa të ngjashme, të cilat në të kaluarën ishin shpallur të papranueshme.

31. Për më tepër, parashtruesi nuk ka ofruar baza dhe prova që do ta mbështetnin kërkesën e parashtruesit për moszbulim të identitetit.

32. Gjykata konsideron se ai, në asnjë mënyrë, nuk e ka arsyetuar me prova pse nuk duhet t'i zbulohet identiteti.

33. Prandaj, Gjykata e refuzon si të pabazuar kërkesën e tij për moszbulimin e identitetit.

34. Në përgjithësi, kërkesa nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (3, d) të Rregullores së punës dhe duhet të refuzohet si e papranueshme, ndërsa kërkesa për mbrojtje të identitetit duhet të refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës; në mbështetje të nenit 49 të Ligjit; si dhe në pajtim me rregullin 36 (3, d) të Rregullores së punës, më 25 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën e parashtruesit për moszbulim të identitetit;

III. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

IV. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 78/12, Bajrush Xhemajli, datë 19 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012.

Rasti KI 78/12, Aktgjykimi i 24 janarit 2013

Fjalë kyçe: masë e përkohshme, kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi parashtroi kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012, sepse Gjykata Supreme pa ndonjë arsyetim të qëndrueshëm, nuk ka shqyrtuar provat e propozuara nga mbrojtja. Për më tepër, parashtruesi kërkoi nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme sepse "Nëse një aktgjykim i favorshëm nga Gjykata Kushtetuese do të shkaktonte rigjykim të mundshëm të këtij rasti ku parashtruesi do të mund të lirohej nga përgjegjësia, atëherë mungesa e kësaj mase të përkohshme do të linte parashtruesin me një vuajtje të jashtëligjshme të një dënimi te pamerituar."

Sa i përket çështjes së pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se në bazë të nenit 113.7, kërkesa ishte e pabazuar sepse në rastin konkret z. Bajrush Xhemajli e konteston kushtetutshmërinë e Vendimit Pkl. nr. 70/2012 të Gjykatës Supreme, të 22 qershorit 2012. Prandaj, parashtruesi duhet të konsiderohet si palë e autorizuar, me të drejtë të ngrejë rastin në Gjykatë dhe t'i ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, siç parashihen me ligj, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës. Sa i përket kërkesës së nenit 49 të Ligjit se parashtruesi është dashur të dorëzojë kërkesën brenda periudhës prej katër (4) muajsh, Gjykata përcakton nga parashtresat e parashtruesit se atij i është dorëzuar vendimi i lartpërmendur i Gjykatës Supreme më 26 korrik 2012, përderisa parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 23 gusht 2012, përkatësisht brenda afati prej katër muajve siç parashihet me nenin 49 të Ligjit. Për më tepër, parashtruesi kishte përcaktuar në detaje se cilat të drejta sipas Kushtetutës dhe KEDNJ pretendohen t'i jenë shkelur nga autoriteti publik. Prandaj, Gjykata gjithashtu gjen se parashtruesi i ka plotësuar kërkesat e nenit 48 të Ligjit.

Sa i përket meritave të kërkesës, Gjykata vëren se mënyra e në të cilën janë trajtuar provat në rastin e parashtruesit, demonstron një kompleks vendimesh, të cilat reciprokisht përforcojnë ndikimin e tyre mbi drejtësinë e gjykimit të parashtruesit. Së pari, gjykatat e rregullta në vazhdimësi kanë refuzuar të autorizojnë një ekspertizë plotësuese për faktorët që ndikuan në aksident. Së dyti, gjykatat e rregullta e justifikuan këtë refuzim në bazë të asaj se situata ishte mjaft e qartë për ta, në bazë të raportit ekzistues të ekspertëve. Megjithatë, raporti i ekspertit në fjale ishte i bazuar në raportin e Policisë, në

skica dhe në foto, pa ndonjë procedurë nga eksperti për të verifikuar nga ai vetë, me përpjekje individuale, informatat e përmbajtura në raportet policore. Vlefshmëria e raporteve të Policisë, gjithashtu, nuk ishte vërtetuar në asnjë fazë të procedurës nga ndonjë zyrtar i autorizuar gjyqësor ose nga ndonjë gjykatë. Është e diskutueshme ajo se deri ne çfarë mase ishte në pozitë parashtruesi të kontestonte përmbajtjen e raporteve të Policisë, edhe në qoftë se ai ishte ne gjendje të kontestonte raportin e ekspertit bazuar në këto raporte policore. Për këto mangësi ne trajtimin e provave në rastin e parashtruesit, Gjykata konstaton se, kur shikohet drejtësia e procedurës penale në rastin e parashtruesit si tërësi, nuk mund të thuhet se ai ka përfituar nga një "gjykim i drejtë" sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe sipas nenit 31 të Kushtetutës. Gjykata e shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe ktheu Aktgjykimin e Gjykatës Supreme për rivendosje, në përputhje me Aktgjykimin e kësaj Gjykate.

AKTGJYKIM
në
Rastin Nr. KI78/12
Parashtrues
Bajrush Xhemajli
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Bajrush Xhemajli, i cili përfaqësohet nga Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini", Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012, që i është dorëzuar parashtruesit më 26 korrik 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se aktgjykimi i lartpërmendur ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), neni 6 (E Drejta për një Proces të Rregullt); dhe me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 10.

4. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme për shkak se:

   a. *"[...] një zbatim i këtij aktgjykimi antikushtetues do të privonte Parashtruesin nga liria me muaj e ndoshta edhe me vite [...]"* dhe *"do të shkaktonte dëme të paripërueshme për Parashtruesin pasi që ai do të privohej nga liria pa iu ofruar atij në rastin penalo-juridik një procedurë që i garantohet me Kushtetutë";*

   b. *"Nëse një aktgjykim i favorshëm nga Gjykata Kushtetuese do të shkaktonte rigjykim të mundshëm të këtij rasti ku Parashtruesi do të mund të lirohej nga përgjegjësia, atëherë mungesa e kësaj mase të përkohshme do të linte Parashtruesin me një vuajtje të jashtëligjshme të një dënimi të pamerituar";*

   c. *"[...] privimi nga liria nuk mund të zhbëhet pasi që [...] nuk do të kompensohet koha që Parashtruesi do ta kalonte i privuar nga liria, dhe pasojat fiziko-psikike që një privim i tillë do të lente në Parashtruesin. Ky theksim qëndron edhe me shumë duke pasur parasysh gjendjen e mjere shëndetësore të Parashtruesit, të cilit nuk do të mund t'i ofrohej kujdesi i mjaftueshëm shëndetësor brenda institucionit korrektues".*

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës; neni 22 e neni 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe rregulli 54 e rregulli 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 23 gusht 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatë.

7. Më 4 shtator 2012, Kryetari, me vendimin Nr. GJR. KI78/12, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu si gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me vendimin Nr. KSH KI78/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova.

8. Më 5 shator 2012, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme dhe Prokurorinë e Shtetit për kërkesën e parashtruar.

9. Më 21 shtator 2012, Gjykata aprovoi kërkesën e parashtruesit për masë përkohshme në kohëzgjatje deri më 31 dhjetor 2012.

10. Më 21 shtator 2012, Gjykata i kërkoi Gjykatës Supreme që të dërgojë dosjen e plotë të lëndëve P. Nr. 485/09, të datës 26 nëntor 2010; Ap. Nr. 134/2011, të datës 8 mars 2012; dhe Pkl. Nr. 70/2012, të datës 22 qershor 2012, duke përfshirë këtu edhe procesverbalet e gjykatave të të gjitha instancave të përfshira në këtë rast.

11. Më 19 nëntor 2012, Gjykata edhe një herë kërkoi nga Gjykata Supreme të dorëzojë shkresat e lëndës P. Nr. 485/09, të 26 nëntorit 2010; Ap. Nr. 134/2011, të 8 marsit 2012; dhe Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012, duke përfshirë edhe procesverbalet e gjykatave të të gjitha instancave të përfshira në këtë rast.

12. Më 20 nëntor 2012, Gjykata Supreme iu përgjigj Gjykatës Kushtetuese dhe dorëzoi shkresat e lëndës P. Nr. 485/09, të 26 nëntorit 2010; AP. Nr. 134/2011, të 8 marsit 2012; dhe Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012, duke përfshirë këtu edhe procesverbalet e gjykatave të të gjitha instancave të përfshira në këtë rast.

13. Më 5 dhjetor 2012, duke marrë parasysh nevojën për të shqyrtuar përgjigjen e Gjykatës Supreme që është pranuar më 20 nëntor 2012, Gjykata vazhdoi kohëzgjatjen e masës së përkohshme, të vendosur nga Gjykata në Vendimin e saj fillestar të 24 shtatorit 2012, me një periudhë shtesë prej tre muajsh deri më 31 mars 2013.

14. Më 24 janar 2013, Gjykata diskutoi dhe votoi përkitazi me rastin.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 21 maj 2009, ndodhi një aksident komunikacioni në të cilin u përfshinë katër automjete. Si pasojë e këtij aksidenti, një person vdiq dhe disa të tjerë u lënduan. Në ditën e aksidentit, Policia, që u thirr për të dalë në vendin e ngjarjes së aksidentit të komunikacionit, përgatiti raportet e personave të përfshirë në aksident, bëri fotot e aksidentit dhe përpiloi raportin për të dhënat e gjurmëve në rrugë (d.m.th., mati gjatësinë e gjurmëve të frenimit, pozicionin përfundimtar të automjetit, etj.).

16. Në të njëjtën ditë, Policia mori deklaratën e njërit prej vozitësve, I. G., i cili ishte i përfshirë në aksidentin e komunikacionit.

17. Më 22 maj 2009, Policia mori deklaratat e dëshmitarëve, K. G. dhe K. SH., të cilët ishin përfshirë gjithashtu në aksidentin e komunikacionit.

18. Më 23 maj 2009, Policia mori deklaratën e njërit nga vozitësit, S. GJ., i cili ishte përfshirë gjithashtu në aksidentin e komunikacionit.

19. Më 28 maj 2009, Policia mori deklaratën e një vozitësi tjetër, D. B., i cili ishte përfshirë gjithashtu në aksidentin e komunikacionit.

20. Më 1 qershor 2009, Policia ia dorëzoi rastin Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë.

21. Më 9 qershor 2009, polici D. B., ia parashtroi një raport shtesë Prokurorit Publik të Qarkut dhe e informoi të njëjtin se ka pasur gabime teknike në raportin e dorëzuar më 1 qershor 2009, d.m.th., se ishte shkruar gabimisht emri i njërit nga vozitësit që ishte i përfshirë në aksidentin e komunikacionit. Në vend të I. G., do të duhej të ishte I. H.

22. Më 18 qershor 2009, Njësia e Hetimeve të Komunikacionit të Policisë ia dorëzoi raportin e autopsisë Prokurorit Publik të Qarkut.

23. Më 7 korrik 2009, Policia mori deklaratën e parashtruesit që ishte i përfshirë në aksidentin e komunikacionit.

24. Në një datë të pacaktuar, polici D. B. ia parashtroi një raport shtesë Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë dhe e informoi të njëjtin se, më 9 korrik 2009, u mor një deklaratë nga parashtruesi, si dhe një kopje e lejes së vozitjes.

25. Në një datë të pacaktuar, polici D. B. përpiloi një raport hetimor të aksidentit të komunikacionit, duke përfshirë informatat si në vijim: a) çfarë automjetesh janë përfshirë në aksident dhe kush ishte i përfshirë në të, përfshirë edhe të lënduarit; b) kushtet e rrugës; c) deklaratat e personave të përfshirë; d) gjurmët në rrugë (gjurmët në rrugë dhe pozicioni përfundimtar i automjeteve është shpjeguar); e) një përshkrim i aksidentit; f) veprimet e ndërmarra (Policia në vendngjarjen e aksidentit të komunikacionit kishte përpiluar skicat, kishte bërë fotografitë dhe matjet e nevojshme); g) vërejtjet (pasi Policia nuk kishte mundur të kontaktonte parashtruesin, ata nuk e kishin lejen e tij të vozitjes); h) konkludimi (në bazë të inspektimit të vendngjarjes dhe provave të gjetura në vendngjarje të aksidentit të komunikacionit, Policia ka gjetur se parashtruesi ishte i dyshuari i bazuar që kishte kryer vepër penale sipas nenit 297, paragrafi 5, në lidhje me paragrafin 1-3 [Rrezikimi i trafikut publik] Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në

tekstin e mëtejmë: KPPK), i cili parasheh: *(1) Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik dhe rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve apo pasurinë me përmasa të mëdha dhe me këtë i shkakton lëndime të lehta trupore personit apo dëm thelbësor material që tejkalon vlerën mbi 1.000 euro dënohet me gjobë apo me burgim deri në pesë vjet. (3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në dy vjet. (5) Nëse vepra penale nga paragrafi 3 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet".*

26. Më 4 shtator 2009, Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë mori vendim (PP. Nr. 565/6/2009) të iniciojë hetime kundër parashtruesit, për shkak të dyshimit të bazuar se ai kishte kryer vepër penale sipas nenit 297, paragrafi 5, në lidhje me paragrafin 1-3 [Rrezikimi i trafikut publik] të KPPK-së.

27. Më 10 shtator 2009, Prokurori i Qarkut mori në pyetje parashtruesin përkitazi me aksidentin e komunikacionit (Procesverbali PP. Nr. 565-6/2009). Parashtruesi deklaroi se ishte duke vozitur me shpejtësinë 60-70 km/h, në anën e majtë të rrugës drejt Ferizajt, kur një automjet është përpjekur të voziste në anën e djathtë të tij dhe prej atij momenti nuk i kujtohej më asgjë. Parashtruesi deklaron se atij, gjithashtu, i kujtohej një automjet 20 metra para tij dhe një tjetër automjet 20 metra pas tij.

28. Më 10 shtator 2009, Prokurori Publik i Qarkut e intervistoi një dëshmitar/palë e lënduar, D. B., i cili dëshmoi se ai/ajo ishte në anën e tij/saj të rrugës për në Prishtinë dhe se atij/asaj nuk i kujtohej aksidenti i komunikacionit, ose kush e ka goditur atë, sepse pas ndeshjes ai/ajo kishte humbur vetëdijen dhe nuk i kujtohej asgjë (Procesverbali PP. Nr. 565-1/2009).

29. Më 10 shtator 2009, Prokurori Publik i Qarkut e intervistoi (Procesverbali PP. nr. 565-1/2009) një dëshmitar/palë e dëmtuar, I. H., i cili dëshmoi se ai/ajo ishte në rrugën për në Hajvali, duke vozitur 50-60 km/h, në anën e majtë. Më tej, I. H. dëshmoi se para tij/saj ishte një veturë në anën e djathtë dhe, papritmas, nga asgjëkund u shfaq një veturë që u përpoq të kalonte në anën e tij/saj të djathtë dhe u përpoq të kalojë para automjetit të tij/saj, si gërshërë, ndërmjet automjetit të tij/saj dhe automjetit tjetër para tij/saj, në anën e majtë. I. H. deklaroi se, në atë moment, automjeti i tij/saj u godit nga automjeti tjetër. Sipas procesverbalit, I. H. nuk e di nëse vetura që goditi atë zhvillonte

shpejtësi të madhe apo jo, por ai/ajo ka dëgjuar se vetura që kishte goditur atë ishte duke zhvilluar shpejtësi të madhe. Gjithashtu, I. H. ka deklaruar në procesverbal se atij /asaj nuk i kujtohej si është zhvilluar ngjarja, pasi vetura e tij/saj ishte goditur.

30. Më 25 shtator 2009, Prokurori Publik i Qarkut intervistoi një dëshmitar/palë e dëmtuar, H. R., që ishte babai i personit të vdekur në aksident, por që ai ishte i pranishëm kur kishte ndodhur aksidenti (Procesverbali PP. nr. 565-1/2009).

31. Më 30 shtator 2009, Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë parashtroi një kërkesë (PP. Nr. 565-1/2009) në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, për të urdhëruar një ekspert komunikacioni që të hetojë rastin dhe të përgatisë një raport. Eksperti i komunikacionit duhej të siguronte ekspertizë për rrethanat e aksidentit, për shpejtësinë e veturës në momentin e aksidentit, për rrugën e për kushtet klimatike, dhe për vërtetimin e fakteve e të rrethanave të tjera relevante për ndjekjen e kësaj vepre penale.

32. Më 7 tetor 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (GJPP. Nr. 246/09) urdhëroi një ekspert që të sigurojë një raport të ekspertizës në veprën penale. Gjykata e Qarkut, më tej, konstatoi: *"Eksperti i komunikacionit duhet të vërtetojë të gjitha rrethanat në të cilat kishte ndodhur aksidenti, rrugën dhe kushtet klimatike, dhe të vërtetojë faktet dhe rrethanat relevante për ndjekjen e kësaj vepre penale"*.

33. Më 14 tetor 2009, eksperti i komunikacionit kompletoi raportin e tij për aksidentin e komunikacionit dhe bëri konkludimin e tij se, "në bazë të analizave të hollësishme që kam në posedim, në bazë të raportit hetimor, skicave dhe fotografive në vendngjarje, fotografitë e veturave të dëmtuara, dhe deklaratat e palëve të përfshira si dhe dëshmitarët *[...]"*, ngasësi i automjetit "Nissan", gjegjësisht parashtruesi, ishte i vetmi kontribuues i aksidentit.

34. Më 24 nëntor 2009, Zyra e Prokurorit Publik të Qarkut ngriti Aktakuzë (PP. nr. 565-1/2009) në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër parashtruesit, sepse ka kryer veprën penale në bazë të nenit 297, paragrafi 5, lidhur me paragrafin 1-3 [Rrezikimi i trafikut publik] të KPPK-së. Zyra e Prokurorit Publik të Qarkut i propozoi gjyqtarit për konfirmim që të lexohet mendimi i raporteve mjekësore përkitazi me lëndimet, raporti i ekspertit të komunikacionit dhe raporti i autopsisë, si dhe të shikohen skicat dhe fotografitë e aksidentit të komunikacionit.

35. Më 1 mars 2010, parashtruesi ia dorëzoi një deklaratë gjyqtarit për konfirmim në Gjykatën e Qarkut, duke kundërshtuar aktakuzën dhe i propozoi gjyqtarit për konfirmim të mos e konfirmojë aktakuzën. Parashtruesi argumentoi se:

a. Aktakuza është përgjithësuese dhe nuk përmban ndonjë provë mbështetëse;

b. Aktakuza nuk është në përputhje me nenin 305, paragrafi 1 dhe paragrafi 4, të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPPK);

c. Aktakuza është kryesisht e bazuar në raportin e ekspertit të komunikacionit, raport ky që përmban vetëm një përshkrim të aksidentit të komunikacionit, të bazuar në informatat e marra nga Policia. Raporti i ekspertit të komunikacionit nuk jep sqarime të pranueshme përkitazi me faktorët dhe me rrethanat që mund të kenë kontribuar në aksidentin e komunikacionit. Prandaj, parashtruesi propozoi të përzgjidhet një tjetër ekspertizë, gjegjësisht një e ashtuquajtur superekspertizë.

36. Më 1 mars 2010, gjyqtari për konfirmim të aktakuzës e konfirmoi aktakuzën ndaj parashtruesit (Ka. Nr. 438/2009).

37. Më 1 tetor 2010, gjatë seancës kryesore, parashtruesi edhe një herë e kontestoi raportin e ekspertit të komunikacionit se kishte disa mangësi, se ishte i paqartë dhe se ende kishte dilemë përkitazi me faktorët e tjerë që mund të kishin kontribuar në aksidentin e komunikacionit. Rrjedhimisht, parashtruesi kërkoi që gjykata të ftojë ekspertin e komunikacionit për të dhënë sqarime të mëtejme dhe, nëse ai nuk jep sqarime të mëtejme, të urdhërohet një superekspertizë, që të kryhet një vlerësim dhe të urdhërohet një ekspert të shikojë gjendjen teknike të veturës. Pas vërejtjeve të parashtruesit, Gjykata e Qarkut vendosi të ftojë ekspertin e komunikacionit për të siguruar sqarimet për raportin e tij të ekspertizës. Përkitazi me propozimin që të urdhërohet një ekspert për të shikuar gjendjen teknike të veturës, një vendim do të merret gjatë seancës kryesore.

38. Më 18 nëntor 2010, vazhdoi seanca kryesore, me ç'rast eksperti i komunikacionit iu përgjigj pyetjeve të parashtruesit. Në këtë seancë kryesore, eksperti i komunikacionit u shpreh: "*Nga shkresat e lëndës kemi evidencë vetëm në lidhje me shkaqet subjektive, dmth. nga palët e përfshira në aksident, përderisa prova tjera siç janë rruga dhe mjetet që kanë shkaktuar aksidentin, nuk kemi. Unë vetëm kam analizuar*

shkresat e lëndës, nuk kam marrë pjesë në inspektimin e vendit të ngjarjes". Pas marrjes në pyetje të ekspertit të komunikacionit, Gjykata hodhi poshtë propozimin e parashtruesit për urdhërimin e një superekspertize dhe për të caktuar një ekspert që të kontrollojë gjendjen teknike të veturës, "sepse gjykata konsideroi se raporti i ekspertit të komunikacionit dhe sqarimet e ofruara nga eksperti ishin të mjaftueshme për të vlerësuar situatën faktike".

39. Më 23 nëntor 2010, parashtruesi, në deklaratën e tij përfundimtare, përsëriti edhe një herë kërkesën e tij për një superekspertizë dhe për një urdhërim të kontrollimit të gjendjes teknike të veturës.

40. Më 26 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi P. Nr. 485/09) gjeti parashtruesin fajtor për kryerjen e veprës penale sipas nenit 297, paragrafi 5, në lidhje me paragrafin 1-3 të KPPK-së. Gjykata e Qarkut në Prishtinë vendosi se deklaratat e të dëmtuarve ishin pa kundërthënie, në pajtim me ekspertizën e me deklaratën e ekspertit të komunikacionit, në pajtim me ekspertizat mjeko-ligjore për lëndimet që pësuan të njëjtit dhe në pajtim me raportin e autopsisë për të ndjerin. Prandaj, Gjykata e Qarkut ia fali besimin e plotë deklaratave të tyre. Për më tepër, Gjykata, gjithashtu, u mbështet në raportin e obduksionit dhe në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit, Gjykata e Qarkut theksoi *"[...] se në asnjë fazë të procedurës nuk është vërtetuar gjendja teknike e veturës të akuzuarit edhe pse ka qenë obligim ligjor, sipas vlerësimit të gjykatës, është rrethanë irelevante sepse [...] aksidenti i komunikacionit është shkaktuar si pasojë e veprimeve të të akuzuarit pas goditjes së veturës e cila ka qarkulluar në shiritin e majtë të rrugës dhe nga lëndimet e pësuara në këtë aksident, sipas raportit i autopsisë, ka vdekur [...], të dëmtuarit [...] kanë pësuar lëndime të rënda trupore dhe [...], lëndime të lehta trupore, si vërtetohet nga mendimi i ekspertit mjeko-ligjor, ndërsa në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit është konstatuar se nuk ka lëshime të pjesëmarrësve tjerë në komunikacion të cilat kishin me qenë faktor kontribuues të këtij aksidenti. Prandaj, sipas vlerësimit të gjykatës kjo mbrojtje kishte për qëllim justifikimin e veprimeve inkriminuese të të akuzuarit si dhe shmangien e përgjegjësisë penale të tij"*.

41. Kundër këtij aktgjykimi parashtruesi dorëzoi ankesë në Gjykatën Supreme.

42. Më 8 mars 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Ap. Nr. 134/2011) hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e parashtruesit. Gjykata Supreme konstatoi se në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar vendi dhe

koha e ndodhjes së aksidentit, pjesëmarrësit dhe pasojat e shkaktuara. Për më tepër:

> "...
>
> *Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, nuk ka pas indikacione se automjeti i të akuzuarit nuk ka qenë në gjendje të rregullt, sepse ai asnjëherë nuk ka pohuar një fakt të këtillë, e në anën tjetër eksperti i komunikacionit ka gjetur se bartja e automjetit mund të shkaktohet për shkak të mosfunksionimit të sistemit të frenimit por në rastin konkret deri të bartja e automjetit nuk ka ardhur për atë shkasë por automjeti i të akuzuarit është bartur pasi e ka goditur/prekur automjetin të cilin ka tentuar ta tejkaloje. Gjykata e shkalles së parë drejt ka konkluduar se gjetja e ekspertit është e drejt sepse [...] kjo prove ka qenë në përputhje me provat tjera të administruara.*
>
> *Sipas ankesës faktori tjetër – 'faktori rrugë' ka ndikuar në shkaktimin e aksidentit dhe gjendja faktike edhe për këtë fakt është vërtetuar në mënyrë të gabuar. Kështu, sipas ankesës shkaktar i aksidentit është edhe mungesa e mbrojtësit në mes dy drejtimeve. Mirëpo, ky fakt nga mbrojtja është potencuar edhe gjatë procedurës së shkalles së parë dhe nga eksperti i komunikacionit është kërkuar përgjigje dhe eksperti qartazi ka deklaruar se ekzistimi i mbrojtjes do të kishte ndikuar që të mos vinte deri të aksidenti në përmasa të këtilla por jo edhe se ky është faktor i shkaktimit të vet aksidentit.*
>
> *Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme janë të pabazuara thëniet ankimore se eksperti ka dhëne konstatim dhe mendim jo profesional, i cili nuk ka mbështetje në provat e administruara. Përkundrazi, në kohën e dhënies se ekspertizës, eksperti, siç edhe vet ka deklaruar, ka pas në dispozicion të gjitha shkresat e lëndës dhe konstatimi dhe mendimi i tij janë në përputhje, pra nuk kanë asnjë paqartësi apo kundërthënie me provat tjera të administruara, siç janë skica dhe fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes, në të cilat shihen gjurmët në rrugë, dëmtimet dhe pozita e fundit te automjeteve, si dhe deklaratat gojore të dëshmitarëve të dëgjuar.*
>
> ..."

Kundër këtij aktgjykimi, parashtruesi paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

43. Më 22 qershor 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pkl. Nr. 70/2012) hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë. Për më tepër, Gjykata Supreme konstatoi: *"Mbrojtësit e të akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës i kanë përsëritur pothuajse të njëjtat pretendime, duke bërë këtë edhe tani në këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, përkatësisht duke pretenduar se gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt, për faktin se sipas tyre gjykata nuk ka arritur të vërtetojë me saktësi se kush ishte ai që kontribuoi në shkaktimin e këtij aksidentit me pasoja fatale: faktori njeri, faktori rrugë apo faktori teknik (ndonjë defekt eventual në mjet), prandaj, sipas tyre, në rrethana të tilla, ka qenë e domosdoshme të urdhërohet kryerja e një superekspertize. Të gjitha këto pretendime, për të cilat kanë marrë përgjigje të mjaftueshme nga kolegji i kësaj Gjykate, janë të pabazuara. Gjykata mund të caktojë një ekspert tjetër apo të caktojë edhe super ekspertizën në rast se në mendimin e eksperteve ka kundërthënie, të meta apo shfaqet dyshim i arsyeshëm për saktësinë e mendimit të dhëne, nëse të dhënat në konstatimin e eksperteve, (kur kemi dy) ndryshojnë thellësisht ose kur konstatimet e tyre janë të paqarta, jo të plota e në kundërshtim me vetveten ose me rrethanat e shqyrtuara dhe kur të gjitha këto nuk mund të mënjanohen me marrjen e sërishme në pyetje të eksperteve. Në situatën konkrete, nuk qëndron asnjëra nga këto rrethana që do ta detyronin gjykatën të kërkojë kryerjen e një super ekspertizë".*

44. Më 17 prill 2012, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktvendim ED. Nr. 17/12) aprovoi kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim për periudhën kohore 3 (tre) muaj.

45. Më 18 korrik 2012, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktvendim ED. Nr. 17/12) prapë aprovoi kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim për periudhën kohore 2 (dy) muaj. Parashtruesi ishte i detyruar që, më 19 shtator 2012, të paraqitej për fillimin e vuajtjes së dënimit.

Pretendimet e parashtruesit

46. Parashtruesi pohon me sa vijon:

(i) Shkelja e parimit të barazisë së armëve ndërmjet palëve në procedurë

1. Parashtruesi pohon që *"[...] gjykata pa ndonjë arsyetim të qëndrueshëm, nuk ka shqyrtuar provat e propozuara nga*

mbrojtja. Provat e paadministruara nga kjo gjykatë janë shumë relevante dhe me ndikim për vërtetimin e fajësisë apo pafajësisë së tij. Në procedurën e zhvilluar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, mbrojtja e Parashtruesit kishte kërkuar që gjykata të administroje edhe provat të cilat kanë të bëjnë me pjesën e përgjegjësisë së aktorëve të tjerë në fatkeqësinë e komunikacionit, e sidomos shpejtësinë e automjetit me të cilin është ndeshur fillimisht automjeti i Parashtruesit, [...], si dhe ekzaminimin teknik të veturës të cilën ishte duke e drejtuar Parashtruesi në ditën kritike. Një gjë e tillë u kërkua nga mbrojtja, duke u mbështetur në deklarimet e ekspertit të komunikacionit [...], sipas të cilit në aksidentet e komunikacionit kontribuojnë tre faktorë dhe atë: faktori njeri, faktori rrugë dhe faktori makine. Duke marre parasysh faktin se në çështjen penalo-juridike në fjalë për të vërtetuar faktet relevante është angazhuar eksperti i komunikacionit, ai është munduar të japë përgjigje në ekzistimin apo mosekzistimin e dy faktorëve të parë dhe kontributin e tyre në shkaktimin e aksidentit të komunikacionit. Për këtë arsye, e gjithnjë duke marrë parasysh se faktori makinë ka mund të jetë kontribuues në aksidentin në fjalë, gjykata është dashur që të administrojë edhe këtë provë, duke angazhuar ekspertin e lëmisë së makinerisë, në mënyrë që të vërtetojë ndikimin apo mos-ndikimin e këtij faktori në shkaktimin e aksidentit. Ky mohim nga ana e Gjykatës është cenim i të drejtave të Parashtruesit";

(ii) Gjykata e Qarkut në Prishtinë mbështet vendimin në dëshminë e personit, i cili nuk ka mundur të ofrojë informata për ngjarjen/aksidentin

2. Parashtruesi pohon: *"Z. [...] nuk ka qenë vrojtues i drejtpërdrejtë i ngjarjes së ndodhur dhe për këtë arsye nuk është dashur të dëgjohet në cilësinë e dëshmitarit";*

(iii) Vlerësimet e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë përkitazi me ekspertizën e ekspertit të komunikacionit

3. Parashtruesi pohon: *"Në pjesën arsyetuese të Aktgjykimit (fq. 7), gjykata konstaton se 'Gjykata është bazuar në ekspertizë me arsyetimin se e njëjta në mënyrë të detajuar ka dhënë shpjegime për të dhënat e vërtetuara nga shkresat e lëndës, në të cilat e ka bazuar ekspertizën, por edhe për metodat shkencore të cilat i ka përdorë gjatë ekspertimit të bërë'. Ky vlerësim i punës së ekspertit nga Gjykata është shumë sipërfaqësore dhe jo-kritik. Ekspertiza është provë sikurse edhe provat tjera në procedurën penale dhe*

rrjedhimisht gjykata duhet ta vlerësoj këtë provë duke arsyetuar rrjedhën logjike të saj. Gjykata nuk mund të konstatojë se ekspertiza është në përputhje me metodat shkencore, sepse po ti dinte metodat shkencore nuk do të kishte pasur nevojë të angazhojë ekspert. Ekzistojnë një mori rregullash shkencore në lidhje me përcaktimin e shpejtësisë së automjetit para shkaktimit të aksidentit. Prandaj konsiderojmë se kërkesa e mbrojtjes së të pandehurit (tani të gjykuarit) për përsëritjen e ekspertizës apo për ekspertizë nga një ekspert tjetër i komunikacionit ishte e arsyeshme dhe kishte për qëllim verifikimin e metodave shkencore të përdorura në këtë rast penalo-juridik";

(iv) Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Ap. nr. 134/2011

4. Parashtruesi pohon: *"Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar si gjykatë e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsye të qarta juridiko-kushtetuese në aspekt të të gjitha fakteve të cilat janë relevante për dhënien e një vendimi të ligjshëm, por në mënyrë eksplicite, pa ndonjë vlerësim, i ka vlerësuar si të pabazuara pretendimet ankimore të Parashtruesit të kësaj kërkesë";*

(v) Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. Nr. 70/2012

5. Parashtruesi pohon: *"Gjykata Supreme me këtë rast nuk çmon fare se për çfarë arsye e konsideron ekspertizën e ekspertit të komunikacionit si të drejte, por vetëm ja falë besimin vlerësimeve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë pa ndonjë vlerësim kritik të këtij pretendimi ankimore".*

47. Për më tepër, parashtruesi i referohet rastit *Kraska kundër Zvicrës*, ku *"Gjykata Evropiane ka thënë se efekti i Nenit 6.1 është që t'ia mundësojë gjykatës kompetente të kryeje ekzaminimin e duhur të parashtresave, të argumenteve dhe provave të sjella nga palët, pa cenuar vlerësimin nëse ata janë apo nuk janë të rëndësishme për vendimin e saj"* (*Shih, Kraska c. Suisse, Kërkesa nr. 13942/88, Aktgjykim i 19 prillit 1993).*

48. Gjithashtu, sipas parashtruesit, *"gjykata duhet të bëjë një ekzaminim të vërtetë të argumenteve dhe dëshmive të palëve, duke vlerësuar rendësinë e tyre për vendimin që do të dorëzohet"* (*Shih, Quadrelli v. Italy, Kërkesa nr. 28168/95, Aktgjykim i 11 janarit 2000*).

49. Parashtruesi i referohet edhe rastit *Bonisch kundër Austrisë*, ku *"Gjykata Evropiane ka gjetur shkelje të Nenit 6.1 të Konventës*

Evropiane kur mbrojtja ka qenë në vështirësi për të caktuar një ekspertizë të re – tjetër" (*Shih, Bönisch v. Austria, Kërkesa nr. 8658/79, Aktgjykim i 6 majit 1985).*

50. Parashtruesi, gjithashtu, pohon: *"Njëherë, po kjo gjykatë (GJEDNJ) ka gjetur shkelje të Nenit 6.1 të Konventës Evropiane kur dëgjimi i ekspertëve të tjerë (duke përfshirë një ekspert privat i cili kishte ardhur në rezultate të ndryshme) ishte refuzuar nga gjykata pasi që ishte dëgjuar vetëm një ekspert i një instituti që kishte konkluduar në dëm të të pandehurit (Shih, Brandstetter v. Austria, Kërkesa nr. 13468/87, Aktgjykim i 28 gushtit 1991; G.B. v. France, Kërkesa nr. 44069/98, Aktgjykim i 2 tetorit 2001;* dhe *Benderskiy v. Ukraine, Kërkesa nr. 22750/02, Aktgjykim i 15 nëntorit 2007).*

Dispozitat e ligjit të aplikueshëm përkitazi me hetimet dhe me provat

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26), i 6 korrikut 2003

51. Neni 152 i KPPPK-së:

"...

(1) Rregullat e provës parashtruar në këtë kapitull zbatohen në të gjitha procedurat penale para gjykatës dhe, në rastet kur e parasheh ky Kod, ato gjithashtu zbatohen në procedurat para prokurorit dhe policisë.

(2) Gjykata, sipas vlerësimit të vet, mund të pranojë dhe të marrë parasysh çdo provë të pranueshme që ajo mendon se është e rëndësishme për procedurën penale konkrete dhe ka autoritetin të vlerësojë lirisht të gjitha provat e parashtruara me qëllim të përcaktimit të rëndësisë ose papranueshmërisë së tyre.

(3) Gjykata mund të refuzojë kërkesën për marrjen e provës:

1) Kur marrja e provës së tillë për të plotësuar provat tjera është e panevojshme dhe e tepërt, sepse çështja është e njohur në vija të përgjithshme;

2) Kur fakti që do të provohet është i parëndësishëm për vendimin apo është
provuar;

3) Kur prova është tërësisht e papërshtatshme ose e paarritshme dhe

4) Kur kërkesa bëhet për të zgjatur procedurën.

...".

52. Neni 153 i KPPPK-së:

"...

(1) Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu.

(2) Gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme.

...".

53. Neni 154 i KPPPK-së:

"...

(1) Për pranimin e provës gjykata vendos me kërkesë të palës ose sipas detyrës zyrtare.

(2) Çështja lidhur me pranimin e provës mund të ngrihet nga pala në kohën kur prova i paraqitet gjykatës dhe në rast të veçantë në seancën për konfirmimin e aktakuzës. Përjashtimisht, mund të ngrihet më vonë, nëse çështjet nuk i janë bërë të njohura palës në kohën kur prova është paraqitur, ose ekzistojnë rrethana të tjera të justifikueshme. Gjykata mund të kërkojë që çështja të paraqitet me shkrim. Në mungesë të kërkesës së palës, gjykata duhet të vendosë mbi pranimin e provës sipas detyrës zyrtare kurdoherë që gjatë procedurës lind dyshimi mbi ligjshmërinë e provës.

(3) Aktvendimin që e merr gjykata mbi pranueshmërinë e provës duhet arsyetuar. Nëse aktvendimi mbi pranimin e provës merret në fazën paraprake të procedurës, ai mund të kundërshtohet në kolegjin prej tre gjyqtarësh me ankesë të veçantë brenda dyzet e tetë orëve nga koha e pranimit të aktvendimit.

(4) Prova e papranueshme veçohet nga shkresat e lëndës dhe vuloset. Prova e tillë ruhet në gjykatë ndaras nga shkresat dhe provat. Prova e veçuar nuk mund të shqyrtohet e as të përdoret në procedurë, përveç në procedurë të ankesës kundër aktvendimit mbi pranueshmërinë.

(5) Në të gjitha fazat e procedurës gjykata detyrohet të sigurojë që asnjë provë e papranueshme, referencë a dëshmi në provën e tillë të mos përfshihet në shkresa ose të mos paraqitet në shqyrtim gjyqësor a në seancë dëgjimi para shqyrtimit gjyqësor.

(6) Prova, e cila me aktvendim është konstatuar si e papranueshme, në një fazë të mëvonshme të procedurës me aktvendim mund të konstatohet si e pranueshme.

...".

54. Neni 155 i KPPPK-së:

"...

(1) Gjatë çdo intervistimi ose marrjeje në pyetje ndalohet që:

1) Liria e të pandehurit për të formuluar dhe shprehur mendimin e tij të ndikohet
nëpërmjet keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të
drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit;

2) I pandehuri të kanoset me masa të ndaluara me ligj;

3) Të premtohet ndonjë përfitim i paparaparë me ligj; dhe

4) Të dobësohet kujtesa e të pandehurit ose aftësia e tij për të kuptuar.

(2) Ndalesa nga paragrafi 1 i këtij neni zbatohet pavarësisht nga pëlqimi i personit të intervistuar ose të marrë në pyetje.

(3) Kur intervistimi ose marrja në pyetje është zbatuar në kundërshtim me paragrafin1 të këtij neni, procesverbali i intervistimit ose marrjes së tillë në pyetje është i papranueshëm.

...".

55. Neni 156 i KPPPK-së:

"...

(1) Deklarimi i të pandehurit dhënë policisë ose prokurorit publik mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur është marrë në pajtim me dispozitat e nenit 229 deri në 236 të këtij Kodi. Deklarimi i tillë mund të përdoret për ta kundërshtuar deklarimin e të pandehurit në gjyq (neni 372, paragrafi 2 i këtij Kodi).

(2) Deklarimi i dëshmitarit i dhënë në polici ose para prokurorit publik mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur të pandehurit ose mbrojtësit i është dhënë mundësia ta kundërshtojë atë nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë ndonjë faze të procedurës penale.

...".

56. Neni 176 i KPPPK-së:

"...

(1) Ekspertimin e urdhëron gjykata me shkrim në bazë të kërkesës së prokurorit publik, të mbrojtësit ose sipas detyrës zyrtare. Në urdhëresë shënohen faktet të cilat shqyrtohen dhe ato vlerësohen nga ekspertët si dhe personat që duhet ta kryejnë ekspertimin. Urdhri u dërgohet palëve.

(2) Në qoftë se për llojin e veçantë të ekspertimit ekziston institucioni profesional ose ekspertimi mund të bëhet në kuadër të organit të veçantë publik për ekspertime, sidomos për ato më të ndërlikuarat, sipas rregullit, i besohen institucionit të tillë profesional apo organit publik. Institucioni profesional apo organi publik cakton një ose më shumë ekspertë të cilët do të bëjnë ekspertimin.

(3) Nëse gjykata cakton ekspertin, atëherë sipas rregullit cakton një ekspert, por në rastet kur vlerësimi i ekspertit është i ndërlikuar, atëherë i cakton dy ose më shumë ekspertë.

(4) Nëse për ndonjë lloj të ekspertimit në gjykatë ka ekspertë të përhershëm, ekspertë të tjerë mund të caktohen vetëm kur ekziston

rrezik nga shtyerja ose kur ekspertët e përhershëm janë të penguar, apo kur këtë e kërkojnë rrethana të tjera.

...".

57. Neni 185 i KPPPK-së:

"...

Në qoftë se në mendimin e ekspertëve ka kundërthënie, të meta apo nëse shfaqet dyshimi i arsyeshëm për saktësinë e mendimit të dhënë, kurse këto të meta ose dyshime nuk mund të menjanohen me marrjen e sërishme në pyetje të ekspertëve, atëherë kërkohet mendimi i ekspertëve të tjerë.

...".

58. Neni 200 i KPPPK-së:

..."

(1) Policia heton veprat penale dhe pa vonesë ndërmerr të gjitha masat në mënyrë që të parandalohet fshehja e provave.

(2) Sapo policia të njoftohet qoftë nëpërmjet paraqitjes së kallëzimit penal apo në ndonjë mënyrë tjetër për vepër penale të dyshuar e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, pa vonesë dhe jo më vonë se njëzet e katër orë nga marrja e këtij informacioni informon prokurorin publik dhe sa më parë i siguron raporte të tjera dhe të dhëna plotësuese.

(3) Prokurori publik drejton dhe mbikëqyr punën e policisë gjyqësore në fazën paraprake të procedurës penale.

...".

59. Neni 221 i KPPPK-së:

"...

(1) Hetimi fillohet me aktvendim të prokurorit publik. Aktvendimi përcakton personin kundër të cilit kryhet hetimi, kohën e fillimit të hetimit, përshkrimin e veprës e cila tregon elementet e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale, rrethanat dhe faktet që e

justifikojnë dyshimin e arsyeshëm për veprën penale dhe provat me informacionin e mbledhur deri në atë moment. Një kopje e aktvendimit të hetimit i dërgohet pa vonesë gjyqtarit të procedurës paraprake.

(2) Rezultatet e veprimeve hetimore (siç është mbledhja e provave) janë pjesë e lëndës hetimore.

(3) Hetimi zbatohet dhe mbikëqyret nga prokurori publik.

(4) Prokurori publik mund të ndërmarrë veprime hetimore ose të autorizojë policinë gjyqësore që të ndërmarrë veprime hetimore lidhur me marrjen e provave.

...".

60. Neni 254 i KPPPK-së:

"...

(1) Prokurori publik ose gjykata mund të urdhërojë këqyrjen ose rikonstruksionin e vendit të ngjarjes për të shqyrtuar provat e mbledhura ose për të qartësuar faktet e rëndësishme për procedurën penale.

(2) Këqyrjen ose rikonstruksionin e tillë të vendit të ngjarjes e kryen gjykata, prokurori publik ose policia. Prokurori publik dhe policia mund të kryejnë këqyrjen ose rikonstruksionin e tillë për t'u njoftuar personalisht me gjendjen, e cila do t'u ndihmonte në përcaktimin e besueshmërisë ose gjetjen e fakteve, por, në rastin e tillë, kur i pandehuri ose mbrojtësi i tij nuk janë njoftuar për këtë, rezultatet për gjykatën janë të papranueshme. Prokurori publik mund ta përsërisë këqyrjen ose rikonstruksionin e tillë me njoftimin e të pandehurit dhe mbrojtësit, siç parashihet me këtë nen, me ç'rast rezultatet e tilla janë të pranueshme.

(3) I pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë të drejtë të jenë të pranishëm në këqyrje ose në rikonstruksion të vendit të ngjarjes.

(4) Rikonstruksioni kryhet me rikrijimin e fakteve ose të situatave nën rrethanat e të cilave është zhvilluar ngjarja, bazuar në provat e mbledhura. Nëse faktet ose situatat paraqiten ndryshe në dëshmitë e dëshmitarëve konkretë, në parim, rikonstruksioni i ngjarjes zbatohet veçmas me secilin dëshmitar.

(5) Gjatë rikonstruksionit të ngjarjes duhet pasur kujdes që të mos shkelet ligji dhe rendi, të mos fyhet morali publik apo të vihet në rrezik jeta ose shëndeti i njerëzve.

(6) Këqyrja ose rikonstruksioni i vendit të ngjarjes mund të ndihmohet nga specialistët e mjekësisë ligjore, nga personeli i transportit dhe nga ekspertë të lëmenjve të tjera për të mbrojtur ose përshkruar provat, për të bërë matjet dhe incizimet e nevojshme, për të bërë skicat apo për të mbledhur informata të tjera.

(7) Eksperti gjithashtu mund të thirret që të jetë i pranishëm në këqyrje apo në rikonstruksion të vendit të ngjarjes kur prania e tij nga prokurori publik ose gjykata konsiderohet e dobishme.

...".

61. Neni 387 i KPPPK-së:

"...

(1) Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor.

(2) Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar.

...".

Pranueshmëria e kërkesës

62. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë që parashihen me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të Punës.

63. Gjykata duhet së pari të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë: *"Individët*

janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj". Në këtë drejtim, kërkesa është dorëzuar në Gjykatë nga një individ.

64. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit, duhet të dorëzojë kërkesë brenda 4 muajsh pas vendimit të formës së prerë të gjykatës. Më 22 qershor 2012, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Pkl. Nr. 70/2012, ndërsa parashtruesi i kërkesës e pranoi Aktgjykimin më 26 korrik 2012. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 23 gusht 2012. Prandaj, parashtruesi i kërkesës e ka respektuar afatin e nevojshëm për dorëzimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

65. Veç kësaj, Gjykata Supreme konsiderohet "si gjykata e instancës së fundit për ta gjykuar çështjen në këtë procedurë penale". Si rezultat, Gjykata gjithashtu përfundon se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në Kosovë.

66. Përfundimisht, neni 48 i Ligjit, përcakton: *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë"*. Përkitazi me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pkl. Nr. 70/2012, me të cilin pretendon se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; dhe me nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Prandaj, parashtruesi i kërkesës e ka plotësuar gjithashtu edhe këtë kusht.

67. Pasi parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe i ka përmbushur të gjitha afatet e nevojshme për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë.

Meritat

68. Pasi parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kërkesat procedurale për pranueshmëri, Gjykata duhet së pari t'i shqyrtojë meritat e ankesës së parashtruesit të kërkesës.

69. Sa i përket parashtresat e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se pretendimi i parashtruesit të kërkesës lidhet me mënyrën e trajtimit të provave në procedurën kundër tij. Pretendimi kryesor i parashtruesit ka të bëjë me refuzimin e vazhdueshëm të gjykatave të rregullta që ato të autorizojnë një ekspertizë shtesë me të cilën do të verifikohej se sa ndikuan në aksident faktorët teknikë dhe rrugorë. Megjithatë, ky pretendim gjithashtu përfshin çështjen e gjerë të vlerësimit të provave në tërësi. Konkretisht, Gjykata vëren se raporti i ekspertit përbën bazë dominuese për gjykimin e parashtruesit të kërkesës. Si i tillë, raporti i ekspertit ishte plotësisht i bazuar në raportin e Policisë, në skicat dhe në fotografitë e bëra në vendin e ngjarjes, para përfshirjes së Prokurorit Publik. Këto elemente komplekse që kanë të bëjnë me trajtimin e provave nga gjykatat, shtrojnë çështjen e paanshmërisë së procedurave gjyqësore.

70. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar prova shtesë që do të shqyrtoheshin nga gjykatat e rregullta, sepse, sipas mendimit të tij, kjo do ishte relevante dhe bindëse për të përcaktuar në mënyrë të drejtë fajësinë apo pafajësinë e tij. Sipas parashtruesit të kërkesës, provat që do të administroheshin kanë të bëjnë me pjesën e përgjegjësisë së pjesëmarrësve tjerë në aksidentin e komunikacionit, në veçanti me shpejtësinë e automjetit që u godit nga automjeti i parashtruesit të kërkesës, si dhe me shqyrtimin teknik të automjetit që po ngiste parashtruesi i kërkesës në ditën përkatëse. Kjo ishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës, bazuar në dëshminë e ekspertit të komunikacionit, sipas të cilit janë tre faktorë që kontribuojnë në aksidente komunikacioni: faktori njeri, faktori rrugë dhe faktori automjet.

71. Në këtë rast, më 21 maj 2009, parashtruesi i kërkesës, me automjetin e tij, të cilin e voziste vetë, ishte i përfshirë në aksident komunikacioni me 4 automjete dhe, në këtë aksident, si pasojë e lëndimeve të marra, ka humbur jetën një person. Në aktakuzën e tij, Prokurori Publik i Qarkut pretendon se parashtruesi kishte shkelur kodin penal: *"Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik dhe rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve apo pasurinë me përmasa të mëdha [...]"* (*Shih, neni 297 paragrafi 5, në lidhje me paragrafin 1-3 [Rrezikimi i trafikut publik] i KPPK-së*).

72. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Prokurori Publik i Qarkut e ka barrën e të provuarit përtej dyshimit të bazuar se, më 21 maj 2009, parashtruesi: (1) i ka shkelur ligjet e komunikacionit publik: (2) se kjo shkelje e ka rrezikuar komunikacionin publik dhe jetët njerëzore ose pronën; dhe (3) se shkelja ka qenë më tepër se një shkelje e vogël. Megjithatë, parashtruesi nuk duhet të provojë asgjë, sepse ai supozohet të jetë i

pafajshëm për akuzat, derisa Prokurori Publik i Qarkut nuk dëshmon se ai është fajtor përtej dyshimit të bazuar për të tri elementet e akuzës së tij (*Shih nenin 3 të KPPPK-së*).

73. Në këtë rast, Gjykata vëren nga shkresat e lëndës se asnjërit nga dëshmitarët okularë të aksidentit nuk i kujtohet se çfarë ka ndodhur më 21 maj 2009. Kjo u konfirmua nga procesverbali me dëshmitë e palëve të dëmtuara:

a. pala e dëmtuar D. B. deklaroi: *"Unë nuk e mbaj mend momentin kur ka ndodhur aksidenti, unë nuk e pashë kush më goditi mua. Pas ndeshjes, unë kam humbur vetëdijen dhe nuk mbaj mend asgjë".*

b. H. R. është dëgjuar si dëshmitar, edhe pse ai nuk ishte i pranishëm kur ka ndodhur aksidenti.

c. pala e dëmtuar B. B. deklaroi: *"Nuk mbaj mend asgjë, sepse kam humbur vetëdijen dhe prapë më erdhi vetëdija në spital".*

d. pala e dëmtuar V. B. deklaroi: *"Unë nuk e mbaj mend se si erdhi deri te aksidenti dhe unë nuk e di se në cilën anë të rrugës ne ishim duke ngarë veturën. Mua më kujtohet vetëm momenti pas aksidentit".*

e. pala e dëmtuar I. H. deklaroi: *"[...] nuk e din nëse vetura që e goditi atë kishte ngarë shpejt apo jo, po ai/ajo kishte dëgjuar se vetura që e godit atë kishte ngarë shumë shpejt. Atij/asaj, gjithashtu, nuk i kujtohet se si rrjedhën ngjarjet pasi që vetura e tij/saj ishte goditur".*

74. Gjykata, më tutje, vëren se eksperti i komunikacionit, i emëruar nga gjykata e rregullt, asnjëherë nuk e kishte kontrolluar asnjërin nga automjetet, përfshirë këtu edhe automjetin që voziste parashtruesi, i përfshirë në këtë aksident. Ai, gjithashtu, nuk i kishte shqyrtuar kushtet e rrugës ku ka ndodhur aksidenti. Eksperti i komunikacionit i gjykatës, thjesht, i kishte shikuar raportet e Policisë, të cilat ishin përgatitur disa ditë pas aksidentit.

75. Për më tepër, Gjykata vëren, nga shkresat e lëndës, se eksperti i komunikacionit dëshmoi që janë tre faktorë që kontribuojnë në shkaktimin e aksidentit të komunikacionit: 1) faktori njeri; 2) faktori rrugë; dhe 3) faktori automjet. Ai u pajtua se nuk e kishte shqyrtuar as faktorin rrugë e as faktorin automjet, edhe pse dha një opinion që

rezultoi me gjetjen e gjykatës, përtej dyshimit të bazuar, se parashtruesi, gjatë vozitjes, më 21 maj 2009, e kishte shkelur ligjin e komunikacionit publik dhe se sjellja e tij [...] në shkallë të madhe [...] ishte shkak i afërt i aksidentit dhe i vdekjes së njërit nga personat e përfshirë në aksident.

76. Gjykata vëren më tej se, në mënyrë të përsëritur dhe në kohë të duhur, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar që gjykatat e rregullta ta lejojnë një ekspert tjetër që t'i kontrollojë automjetet, kushtet e rrugës dhe raportet e Policisë dhe që, më pas, të japë mendimin e vet për shkakun e aksidentit, apo nëse ka pasur më shumë se një faktor që ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit. Kjo kërkesë është parashtruar nga parashtruesi me qëllim të përcaktimit nëse ndonjëri nga automjetet e përfshira në aksident ka pasur prishje mekanike që do të ketë ndikuar që automjeti të mos funksionojë si duhet në kohën e aksidentit. Nëse automjetet ose kushtet e rrugës kishin krijuar rrethana që do të bënin të pamundur ose shumë të vështirë kontrollin mbi automjetet, kjo provë, sipas parashtruesit, do të ishte një faktor në përcaktimin nëse ai mund të ketë kontrolluar kushtet në të cilat u shkaktua aksidenti. Nëse ai nuk kishte mundur t'i kontrollonte këto kushte, ky do të ishte një faktor relevant për gjykatën për ta marrë parasysh në vendosje nëse Prokurori Publik i Qarkut kishte provuar përtej dyshimit të bazuar se parashtruesi ka qenë përgjegjës, "në një masë të madhe" për aksidentin e trafikut (*Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pkl. Nr. 70/12*).

77. Megjithatë, Gjykata vëren se, në përgjigje të kërkesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Qarkut arriti në përfundimin e thjeshtë se ajo kishte prova të mjaftueshme edhe pa e marrë parasysh gjendjen e automjeteve apo të kushteve të rrugës dhe pa dhënë arsye për këtë konkluzion. (*Shih Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, P. Nr. 485/09*).

78. Në mënyrë të ngjashme, Gjykata vëren se, Gjykata Supreme, duke pranuar se eksperti i komunikacionit dëshmoi që rrëshqitja e automjetit të parashtruesit në ditën e aksidentit mund të jetë shkaktuar nga mosfunksionimi i sistemit të frenave, arriti në përfundim që mendimi i ekspertit gjyqësor ishte i drejtë, pa dhënë asnjë arsye të hollësishme për konkluzionin e vet (*Shih Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Ap. Nr. 134/2011*).

79. Gjykata Supreme më tutje gjen se mund të caktohet një ekspert tjetër, apo të bëhet një superekspertizë në rast të kontradiktës së mendimeve të ekspertëve, apo të dyshimit të bazuar në saktësinë e mendimit, në pajtim me nenin 152, paragrafi 3, të KPPPK-së, i cili thotë: "*Gjykata mund të refuzojë kërkesën për marrjen e provës: 1) Kur marrja e provës së tillë për të plotësuar provat tjera është e panevojshme dhe e tepërt, sepse*

çështja është e njohur në vija të përgjithshme; 2) Kur fakti që do të provohet është i parëndësishëm për vendimin apo është provuar; 3) Kur prova është tërësisht e papërshtatshme ose e paarritshme; dhe 4) Kur kërkesa bëhet për të zgjatur procedurën".

80. Në këtë drejtim, pyetja e ngritur në këtë Gjykatë është nëse, në këtë kontekst, Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme kanë shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesit "[...] t'i marrë në pyetje dëshmitarët dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë të cilët mund t'i sqarojnë provat". Megjithatë, Gjykata Kushtetuese nuk mundet dhe nuk do të përpiqet të përcaktojë nëse, në bazë të ligjit apo të dëshmive, ka prova të mjaftueshme për ta shpallur parashtruesin fajtor për vepër penale. Ajo vetëm do të përpiqet, në pajtim me Kushtetutën, të përgjigjet nëse gjykatat e rregullta kanë shkelur në mënyrë procedurale të drejtat e parashtruesit.

81. Sa i përket kësaj, Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili, për aq sa është relevant, parasheh:

> *"4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet",*

dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, i cili, për aq sa është relevant, parasheh:

> *"3. Çdo i akuzuar ka, së paku, të drejtat e mëposhtme: (d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës".*

82. Gjykata vëren se neni 6 (3. d) përbëhet nga tri elemente të veçanta, d.m.th.: a) të drejtën për të sfiduar dëshmitarët e prokurorisë (ose të ekzaminojë provat e tjera të paraqitura nga prokuroria në mbështetje të rastit të tyre); b) të drejtën, në rrethana të caktuara, për të thirrur një dëshmitar sipas zgjedhjes së dikujt për të dëshmuar në gjyq, d.m.th. për mbrojtjen; dhe c) të drejtën për të pyetur dëshmitarët e prokurorisë në të njëjtat kushte si ato të ofruara për dëshmitarët e mbrojtjes.

83. Për më tepër, përkitazi me elementet që lidhen me trajtimin e provave nga gjykatat, Gjykata vëren se, edhe pse pranimi i provave të nxjerra të paligjshme në vetvete nuk shkel nenin 6, por GJEDNJ-ja në rastin

Schenk ka konstatuar se (*Shih, Schenk kundër Zvicrës, 12 korrik 1988*) kjo mund të shpie në padrejtësi përkitazi me faktet e një rasti të veçantë.

84. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja, në rastin Vidal (*Shih, Vidal kundër Belgjikës, Kërkesa nr. 12351/86, Aktgjykimi i 22 prillit 1992*) ka pasur një pretendim se, duke dështuar për të thirrur katër dëshmitarët e mbrojtjes, të cilët Vidal i kishte kërkuar, Gjykata e Apelit në Belgjikë e kishte privuar atë nga mjetet e tij të vetme për përcaktimin e pafajësisë së tij. Në rastin konkret, parashtruesi kishte qenë fillimisht i liruar pas dëgjimit të disa dëshmitarëve. Kur Gjykata e Apelit e zëvendësoi dënimin e tij, nuk kishte prova të freskëta, përveç deklaratave me gojë të parashtruesit dhe të të burgosurit, ajo e bazoi vendimin e saj tërësisht në dokumentet e dosjes së lëndës. GJEDNJ-ja konstatoi: *"Si një rregull i përgjithshëm, gjykatat vendore duhet t'i vlerësojnë provat përpara tyre si dhe rëndësinë e provave të cilat të pandehurit kërkojnë që të paraqiten. Më konkretisht, neni 6 para. 3 (d) (neni 6-3-d) u lë atyre, përsëri si rregull e përgjithshme, të vlerësojnë nëse është e përshtatshme që të thërrasin dëshmitarë, në kuptimin e 'pavarësisë' dhënë asaj fjale në sistemin e Konventës; 'nuk kërkon praninë dhe marrjen në pyetje të çdo dëshmitari në emër të të akuzuarit: qëllimi i saj thelbësor, siç tregohet nga fjalët 'në kushte të njëjta' është 'barazia e plotë e armëve', në këtë çështje'. Gjykata e Apelit në Bruksel nuk ka dëgjuar ndonjë dëshmitar, qoftë për prokurori ose për mbrojtje, para se të nxjerrë aktgjykimin. Koncepti i 'barazisë së armëve' nuk shter përmbajtjen e paragrafëve 3 (d) të nenit 6 (neni. 6-3-d), e as atë të paragrafit 1 (neni. 6-1), fraza e të cilit paraqet një kërkesë në mesin e shumë të tjerave. Detyra e Gjykatës Evropiane është të konstatojë se a kanë qenë procedurat e drejta në çështjen, e konsideruar si një tërësi, siç kërkohet nga paragrafi 1 (neni 6-1)".*

85. GJEDNJ, më tutje, gjeti se "*Parashtruesi i kërkesës fillimisht ishte liruar pasi që u dëgjuan disa dëshmitarë. Kur gjyqtarët ankimor zëvendësuan një dënim, ata nuk kishin dëshmi të freskëta, përveç deklaratave me gojë të dy të pandehurve (në Liège) ose të pandehurit të vetëm të mbetur (në Bruksel), ata e bazuan vendimin e tyre tërësisht në dokumentet në dosjen e rastit. Për më tepër, Gjykata e Apelit në Bruksel nuk dha arsyet për refuzimin, i cili thjesht nënkuptohej, e parashtresave që kërkonin thirrjen e zotit Scohy, z Bodart, z Dauphin dhe z Dausin si dëshmitarë. Për të qenë të sigurt, nuk është funksioni i gjykatës për të shprehur një opinion mbi rëndësinë e provave të ofruara dhe të refuzuara, as më në përgjithësi mbi fajësinë apo pafajësinë e z. Vidal, por heshtja e plotë e aktgjykimit të 11 dhjetorit 1985 në lidhje me pikën në fjalë, nuk është në përputhje me konceptin e një gjykimi të drejtë që është baza e nenit 6 (neni 6). Kjo është gjithnjë e*

më shumë kështu sepse Gjykata e Apelit në Bruksel kishte rritur dënimin, i cili ishte nxjerrë më 26 tetor 1984, duke i zëvendësuar katër vjet me tre vjet duke mos e pezulluar dënimin, siç kishte vepruar Gjykata e Apelit në Liège. Me pak fjalë, të drejtat e mbrojtjes ishin të kufizuara në një masë të tillë, në rastin konkret sa që Parashtruesi i kërkesës nuk kishte një gjykim të drejtë. Si pasojë e kësaj ishte shkelur neni 6 (neni 6)".

86. Për më tepër, në rastin V. D. (*Shih, V. D. kundër Rumanisë, Kërkesa nr. 7078/02, Aktgjykimi i 28 qershorit 2010*), një shtetas rumun u dënua me dhjetë vjet burgim për dhunim, pesë vjet për incest dhe gjashtë muaj për grabitje të armatosur. Vendimi ishte bazuar kryesisht në deklaratat e dhëna në polici nga gjyshja e parashtruesit dhe nga fqinji i saj. Më tej, vendimi u bazua në deklaratat e pesë dëshmitarëve indirekt dhe në një raport mjeko-ligjor që nuk kishte përfshirë testin e ADN-së, pavarësisht kërkesave të parashtruesit për këtë. Gjykata, më tej, nxori aktgjykimin pa dëgjuar dëshminë e një dëshmitari të mbrojtjes, të cilin parashtruesi kishte kërkuar ta merrnin në pyetje, pasi dëshmitari nuk ishte paraqitur kur ishte ftuar, dhe pa ndonjë gjurmë të gishtërinjve të marrë në skenën e krimit të pretenduar.

87. Në këtë rast, GJEDNJ-ja gjeti *se "një test i ADN-së do të konfirmonte të paktën versionin e ngjarjeve të viktimës apo do t'i ofronte V. D. informacione të konsiderueshme në mënyrë që të dëmtonte besueshmërinë e rrëfimit së saj. Megjithatë, gjykatat nuk kishin autorizuar asnjë provë të tillë".* GJEDNJ-ja konstatoi, më tej, se *"këtu kishte edhe mangësi tjera në hetimet e bëra më 1 prill 2001, përfshirë edhe dështimin e policisë për të kërkuar gjurmët e sulmit në vendin e ngjarjes".* Rrjedhimisht, GJEDNJ-ja konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 6 (1) dhe (3. d) të KEDNJ-së. Në rastin konkret, V. D.-së nuk i ishte dhënë një mundësi për të mbrojtur rastin e tij dhe dënimi i tij kryesisht ishte bazuar në një deklaratë nga ana e viktimës, e cila nuk i ishte lexuar atij në asnjë moment gjatë procedurës. Asnjë hap tjetër nuk ishte ndërmarrë për t'ia mundësuar atij që t'i kontestonte deklaratat e viktimës dhe besueshmërinë e tyre.

88. Në rastin Elsholz (*Shih, Elsholz kundër Gjermanisë, Kërkesa nr. 25735/94, Aktgjykimi i 13 korrikut 2000*), GJEDNJ-ja gjeti se *"për shkak të mungesës së provave të ekspertëve fiziologjik dhe rrethanave që Gjykata Rajonale nuk ka mbajtur një seancë të mëtejshme, edhe pse, sipas mendimit të Gjykatës, ankesa e Parashtruesit të kërkesës e ngriste çështjen e fakteve dhe të ligjit të cilat nuk mund të zgjidhen në mënyrë adekuate në bazë të materialit me shkrim në dispozicion të Gjykatës Rajonale, procedura e shikuar në tërësi, nuk i përmbushi*

kërkesat e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda kuptimit të nenit 6. Në këtë mënyrë, kishte një shkelje të kësaj dispozite".

89. Pas kësaj që u tha më lart, Gjykata vëren se parimi i "barazisë së armëve" kërkon që secilës palë t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj, nën kushtet që nuk e vendosin atë në një pozitë të pafavorshme *vis-à-vis* një pale tjetër. Edhe pse nuk ka asnjë përkufizim shterues se cilat janë kërkesat minimale të "barazisë së armëve", duhet të ketë garanci adekuate procedurale të përshtatshme për natyrën e rastit dhe që korrespondon me atë që është në pyetje ndërmjet palëve. Këtu mund të përfshihen mundësitë për të paraqitur fakte.

90. Sa i përket kësaj, Gjykata vëren se, refuzimi nga një gjykatë që të emërojë një ekspert, të dëgjojë një dëshmitar, ose të pranojë lloje të tjera të provave në rrethana të caktuara, mund ta bëjnë procedurën të padrejtë, përveç nëse kufizimet e tilla janë në përputhje me parimin e "barazisë së armëve", zbatimi i plotë i të cilave është qëllimi thelbësor i nenit 6 (3. d) të KEDNJ-së dhe, gjithashtu, i nenit 31 të Kushtetutës.

91. Më tej, personat që pretendojnë shkeljen e nenit 6 (3. d) të KEDNJ-së, duhet të dëshmojnë që jo vetëm se ata nuk ishin të lejuar për të thirrur një dëshmitar të caktuar, por edhe se dëgjimi i dëshmitarit ishte absolutisht i nevojshëm në mënyrë që të konstatohej e vërteta dhe se dështimi për të dëgjuar dëshmitarin cenoi të drejtat e mbrojtjes dhe ndershmërinë e procedurës, si një tërësi.

92. Gjykata vëren se, në rastin konkret, gjykatat e rregullta e kanë shpallur fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale sipas nenin 297, paragrafi 5, në lidhje me paragrafin 1 të KPPK-së, duke u mbështetur ekskluzivisht në dëshminë e palës së dëmtuar, në ekspertin e komunikacionit, në ekspertizën e mjekëve ligjorë për lëndimet shkaktuar palëve të dëmtuara dhe në raportin e autopsisë për të vdekurin, të propozuar nga prokuroria.

93. Se a i është lejuar parashtruesit të kërkesës të ftojë një dëshmitar të caktuar, Gjykata vëren se, pas shqyrtimit të ekspertit të komunikacionit, parashtruesi i kërkesës ngriti çështjen e kryerjes së një superekspertize, gjegjësisht të caktimit të një eksperti të automjeteve. Megjithatë, kjo u refuzua për shkak se gjykatat e rregullta konsideruan se "*raporti i ekspertit të komunikacionit dhe shpjegimi i dhënë nga eksperti i komunikacionit ishin të mjaftueshme për të konstatuar gjendjen faktike"* dhe se nuk kemi të bëjmë me *"rastin e opinioneve kontradiktore të ekspertëve, ose dyshimeve të arsyeshme në saktësinë e mendimit të dhënë"*. Megjithatë, Gjykata vëren se ishte vetëm një

mendim i ekspertit në të cilin gjykatat bazuan vlerësimin e tyre. Prandaj, nuk mund të ngrihet çështja e mendimeve kontradiktore.

94. Gjykata, më tej, vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron që dështmia e ekspertit të komunikacionit ishte e pamjaftueshme për konstatimin e gjendjes faktike, sepse, sipas dështmisë së ekspertit të komunikacionit, ishin tre faktorë që kontribuuan në aksidentin e komunikacionit: faktori njeri, faktori rrugë dhe faktori automjet. Megjithatë, eksperti i komunikacionit, në raportin e tij, e konstatoi vetëm faktorin njeri dhe, sipas parashtruesit, do të ishte e rëndësishme dhe bindëse të përcaktohet si duhet fajësia apo pafajësia e tij, që të konstatohen gjithashtu edhe dy faktorët e tjerë, gjegjësisht faktori rrugë dhe faktori automjet.

95. Më tej, Gjykata vëren se neni 185 i KPPPK-së parasheh: "*Në qoftë se në mendimin e ekspertëve ka kundërthënie, të meta apo nëse shfaqet dyshimi i arsyeshëm për saktësinë e mendimit të dhënë, kurse këto të meta ose dyshime nuk mund të mënjanohen me marrjen e sërishme në pyetje të ekspertëve, atëherë kërkohet mendimi i ekspertëve të tjerë*". Kjo dispozitë me fjalën *"duhet"* e obligon Gjykatën të kërkojë një ekspert tjetër, nëse plotësohen kushtet. Sa i përket çështjes nëse janë plotësuar kushtet, Gjykata vëren se eksperti i komunikacionit vetë ka deklaruar që faktori automjet vërtet mund të jetë faktor relevant, por që një faktor i tillë nuk mund të vërtetohet, sepse nuk është bërë asnjë kontroll teknik i automjetit. Për më tepër, Gjykata vëren se neni 176 i KPPPK-së parasheh mundësinë e caktimit të një ose të disa ekspertëve, nëse analiza e ekspertit është e komplikuar, ose nëse këtë e kërkojnë rrethanat e tjera.

96. Nëse nga gjykatat e rregullta do të ishte urdhëruar një superekspertizë, ajo do të mund të konfirmonte ose raportin fillestar të ekspertit të komunikacionit, ose versionin e parashtruesit të kërkesës, se ka pasur faktorë të tjerë që ndikuan në shkakun e aksidentit të komunikacionit.

97. Për më tepër, Gjykata vëren se eksperti i komunikacionit e kishte bazuar mendimin e tij vetëm në shkresat e lëndës, siç janë skicat dhe fotodokumentet e vendit të aksidentit dhe në dështmitë e dështmitarëve të dëgjuar dhe nuk e kishte formuar mendimin e tij në mënyrë të pavarur.

98. Gjykata më tej vëren se, një garanci tjetër e KPPPK-së për të siguruar të drejtën për një gjykim të drejtë dhe për konstatimin e gjendjes faktike, është paraparë me nenin 254 të KPPPK-së: *"Prokurori publik ose gjykata mund të urdhërojë këqyrjen ose rikonstruksionin e vendit të*

ngjarjes për të shqyrtuar provat e mbledhura ose për të qartësuar faktet e rëndësishme për procedurën penale. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë të drejtë të jenë të pranishëm në këqyrje ose në rikonstruksion të vendit të ngjarjes. Rikonstruksioni kryhet me rikrijimin e fakteve ose të situatave nën rrethanat e të cilave është zhvilluar ngjarja, bazuar në provat e mbledhura. Nëse faktet ose situatat paraqiten ndryshe në dëshmitë e dëshmitarëve konkretë, në parim, rikonstruksioni i ngjarjes zbatohet veçmas me secilin dëshmitar. Këqyrja ose rikonstruksioni i vendit të ngjarjes mund të ndihmohet nga specialistët e mjekësisë ligjore, nga personeli i transportit dhe nga ekspertë të lëmenjve të tjera për të mbrojtur ose përshkruar provat, për të bërë matjet dhe incizimet e nevojshme, për të bërë skicat apo për të mbledhur informata të tjera". Megjithatë, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta nuk urdhëruan një rindërtim, për të qartësuar faktet që janë të rëndësishme për procedurën penale.

99. Përveç kësaj, sa i përket pranimit të marrjes së paligjshme të provave, të cilat mund të shpijnë në padrejtësi të fakteve të një rasti konkret, Gjykata vëren se neni 200.2 i KPPPK-së parasheh*: "Sapo policia të njoftohet qoftë nëpërmjet paraqitjes së kallëzimit penal apo në ndonjë mënyrë tjetër për vepër penale të dyshuar e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, pa vonesë dhe jo më vonë se njëzet e katër orë nga marrja e këtij informacioni informon prokurorin publik dhe sa më parë i siguron raporte të tjera dhe të dhëna plotësuese".* Kjo bëhet për shkak se neni 200.4 e obligon prokurorin publik të drejtojë dhe të mbikëqyrë punën e policisë gjyqësore në fazën paraprake të procedurës penale. Gjykata vëren se neni 221.4 parasheh angazhim të drejtpërdrejtë të prokurorit publik. *"Prokurori publik mund të ndërmarrë veprime hetimore ose të autorizojë policinë gjyqësore që të ndërmarrë veprime hetimore lidhur me marrjen e provave".*

100. Përkitazi me këtë, Gjykata nuk ka asnjë dëshmi në shkresat e lëndës se policia kishte vepruar në pajtim me nenin 200.2, gjegjësisht se e kishte njoftuar prokurorin publik brenda 24 orësh nga marrja e informacionit për një vepër penale, apo nëse prokurori publik kishte mbikëqyrur veprimet hetimore, sidomos pasi aksidenti kishte përfundim fatal. Gjykata vëren se Policia kishte mbledhur dëshmi më 21 maj 2009, në ditën e aksidentit të komunikacionit, dhe mori deklaratën e dëshmitarëve. Më 1 qershor 2009, Policia ia paraqiti rastin Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë (*Shih paragrafin 15 dhe më tej të këtij Aktgjykimi*). Gjykata vëren se zyrtari i policisë, D. B., i cili, në një datë të paspecifikuar, hartoi një raport për hetimin e aksidentit të përmendur të komunikacionit: *"Në lidhje me rastin është informuar Prokuroria Publike Komunale, Prokurori në detyrë D. H. i cili nuk vizitoi vendin e*

ngjarjes, por autorizoi ndërmarrjen e veprimeve hetimore [...]". Megjithatë, Gjykata nuk ka asnjë dëshmi se është bërë kjo.

101. Gjykata vëren më tej, në bazë të shkresave të lëndës, se e vetmja provë që është marrë me urdhër të Gjykatës dhe me kërkesën e prokurorit ishte eksperti i komunikacionit.

102. Për më tepër, Gjykata vëren se Prokurori Publik i Qarkut, vetëm më 4 shtator 2009, mori vendim për të iniciuar hetimet me qëllim të sigurimit të provave sipas nenit 22.1 të KPPPK-së, i cili parasheh: *"Hetimi fillohet me aktvendim të prokurorit publik. Aktvendimi përcakton personin kundër të cilit kryhet hetimi, kohën e fillimit të hetimit, përshkrimin e veprës e cila tregon elementet e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale, rrethanat dhe faktet që e justifikojnë dyshimin e arsyeshëm për veprën penale dhe provat me informacionin e mbledhur deri në atë moment. Një kopje e aktvendimit të hetimit i dërgohet pa vonesë gjyqtarit të procedurës paraprake*". Ky veprim u ndërmor pas tre (3) muajsh dhe pasi policia tanimë kishte mbledhur prova. Gjykata vëren se, pas këtij vendimi, prova e vetme që u sigurua ishte marrja e deklaratës së palëve të përfshira dhe kërkesa për një ekspert të komunikacionit. Pavarësisht nga kjo, gjykatat e rregullta gjithashtu morën parasysh grumbullimin e dëshmive të bëra nga Policia, i cili ishte bërë, si u tha më sipër, pa mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Prokurorit Publik (*Shih seancën e gjykimit të 18 nëntorit 2010*) dhe, siç mund të shihet nga shkresat e lëndës, pa njoftimin e parashtruesit ose të Prokurorit Publik nga ana e Policisë përkitazi me provat që ishin mbledhur.

103. Në këtë drejtim, në pajtim me nenin 153 të KPPPK-së: *"Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu*" dhe "*Gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj në prova të papranueshme"*. Pa marrë parasysh këtë, kur vendosën për fajësinë e parashtruesit, gjykatat e rregullta morën në konsideratë të gjitha provat e përmendura më sipër.

104. Gjykata konstaton se, mënyra në të cilën janë trajtuar provat në rastin e parashtruesit, demonstron një kompleks vendimesh, të cilat reciprokisht përforcojnë ndikimin e tyre mbi drejtësinë e gjykimit të parashtruesit. Së pari, gjykatat e rregullta në vazhdimësi kanë refuzuar të autorizojnë një ekspertizë plotësuese për faktorët që ndikuan në aksident. Së dyti, gjykatat e rregullta e justifikuan këtë refuzim në bazë të asaj se situata ishte mjaft e qartë për ta, në bazë të raportit ekzistues të ekspertëve. Megjithatë, raporti i ekspertit në fjalë ishte i bazuar në raportin e

Policisë, në skica dhe në foto, pa ndonjë procedurë nga eksperti për të verifikuar nga ai vetë, me përpjekje individuale, informatat e përmbajtura në raportet policore. Vlefshmëria e raporteve të Policisë, gjithashtu, nuk ishte vërtetuar në asnjë fazë të procedurës nga ndonjë zyrtar i autorizuar gjyqësor ose nga ndonjë gjykatë. Është e diskutueshme ajo se deri në çfarë mase ishte në pozitë parashtruesi të kontestonte përmbajtjen e raporteve të Policisë, edhe në qoftë se ai ishte në gjendje të kontestonte raportin e ekspertit bazuar në këto raporte policore.

105. Për këto mangësi në trajtimin e provave në rastin e parashtruesit, Gjykata konstaton se, kur shikohet drejtësia e procedurës penale në rastin e parashtruesit si tërësi, nuk mund të thuhet se ai ka përfituar nga një "gjykim i drejtë" sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe sipas nenit 31 të Kushtetutës.

106. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së, është shkelur për shkak se dështimi për t'i lejuar kërkesat e parashtruesit të kërkesës për kundërekspertizë cenoi të drejtat e mbrojtjes dhe ndershmërinë e procedurave në tërësi dhe e privuan parashtruesin nga mundësia për të paraqitur argumente në mbrojtjen e tij në të njëjtat kushte si të prokurorisë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në seancën e saj, mbajtur më 24 janar 2013

I. SHPALLI, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. KONSTATOI, me shumicë votash, se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 [E drejta për proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. SHPALLI, me shumicë votash, të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. Nr. 70/2012, e 22 qershorit 2012;

IV. KTHEU, me shumicë votash, Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për rivendosje, në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese;

V. LEJOI, me shumicë votash, masën e përkohshme deri në kohën kur Gjykata Supreme e Kosovës të rivendosë për çështjen sipas *ratio decidendi* të Gjykatës Kushtetuese;

VI. MBETET e përkushtuar ndaj çështjes, në pritje të respektimit të këtij urdhri;

VII. URDHËROI që ky aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare; dhe

VIII. DEKLAROI se ky aktgjykim është efektiv menjëherë.

Gjyqtarët Altay Suroy, Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova këtij aktgjykimi ia bashkëngjitin Mendimin e tyre të përbashkët mospajtues për t'u publikuar së bashku me të.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

Mendim i përbashkët mospajtues
nga
gjyqtarët Altay Suroy, Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova
Rasti Nr. KI78/12
Parashtrues
Bajrush Xhemajli
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012

1. Ne marrim parasysh aktgjykimin e nxjerrë nga shumica e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Shumica). Megjithatë, nuk mund të pajtohemi me të, për arsyet e mëposhtme.

Fushëveprimi i kërkesës

2. Parashtruesi ankohet për rregullsinë e gjykimit, në të cilin është dënuar për veprën e rrezikimit të trafikut publik. Parashtruesi pretendon se gjykimi penal, në rastin e tillë, ka shkelur nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ).

3. Veçanërisht, parashtruesi pohon se gjykatat e rregullta kanë refuzuar kërkesën e tij për të urdhëruar ekspertizë shtesë për disa rrethana në aksidentin e trafikut, ku ka qenë i përfshirë ai. Parashtruesi pretendon se, me refuzimin e kësaj kërkese, gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë. Veçanërisht, parashtruesi pohon se nuk ka gëzuar "barazinë e armëve" me anën e akuzës në këtë gjykim, siç kërkohet për gjykim të drejtë, sepse Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme kanë refuzuar të angazhojnë ekspertë shtesë.

4. Ne theksojmë se parashtruesi, në procedurat e ndryshme gjyqësore të rastit të tij, nuk ka ngritur çështje të shkeljes së rregullave të provave, që ndikojnë në pranueshmërinë e provave nga Gjykata e Qarkut dhe nga Gjykata Supreme. Ne konsiderojmë se shumica ka zgjeruar vlerësimin e saj përtej kërkesës, duke përfshirë edhe diskutimin e vlefshmërisë së provave të shqyrtuara nga Gjykata Supreme dhe nga Gjykata e Qarkut. Për mendimin tonë, ky diskutim është jashtë fushëveprimit të kërkesës, si dhe jashtë diskutimit për rastin në Gjykatën Kushtetuese.

5. Për më tepër, nuk është roli i Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë pranueshmërinë e provave në gjykime penale, por duhet ta kufizojë veten brenda shqyrtimit të procedurave penale si të tëra, për përmbushjen nga to të të drejtës për gjykim të drejtë.

Sa i përket fakteve në përgjithësi

6. Ne konsiderojmë se ka elemente faktike në shkresat e rastit, të dorëzuar nga parashtruesi, që nuk reflektohen plotësisht në aktgjykimin e shumicës, por që do të mund të çonin në përfundim tjetër. Kështu, do t'i ritheksojmë faktet e rastit ashtu siç na janë paraqitur nga shkresat e rastit.

Sa i përket Aktakuzës

7. Kërkesa e parashtruar fillon me një aksident trafiku rrugor që ka ndodhur më 21 maj 2009. Rreth orës 08:30, parashtruesi ka qenë duke vozitur veturën e tij zyrtare, "Nissan Terrano", nga Prishtina drejt vendit të tij të punës, në Ferizaj. Ka qenë i vetëm në veturë. Sapo ka dalë nga Prishtina, në "Veternik", parashtruesi është përfshirë në një aksident me tri vetura të tjera. Një vozitës i një veture tjetër ka vdekur, derisa disa të tjerë në veturat e tjera kanë pësuar lëndime fizike.

8. Sipas shkresave, Policia ka mbledhur prova në vendin e ngjarjes, duke përfshirë fotografimin e veturave, pozitat e tyre relative pas aksidentit, gjurmët në sipërfaqen e rrugës, si dhe skicat e vendit të ngjarjes. Në ditët

në vijim, Policia ka marrë deklaratat e personave të ndryshëm të përfshirë në aksident, deri në masën e mundshme, duke marrë parasysh gjendjen e tyre shëndetësore. Një numër dëshmitarësh, përfshirë edhe vetë parashtruesin, kanë mbetur pa vetëdije në spital për periudha të ndryshme kohore, duke filluar nga një javë e deri në disa javë, për shkak të lëndimeve të tyre.

9. Më 14 tetor 2009, një ekspert trafiku, i angazhuar nga Prokurori Publik i Qarkut, ka dorëzuar një raport në bazë të provave të mbledhura nga Policia. Ekspertiza e raportit ka shtjelluar shkaqet e aksidentit, ka vlerësuar shpejtësinë dhe pozitat relative në rrugë të disa veturave të përfshira në aksident, si dhe ka identifikuar veprimet e parashtruesit si shkak i aksidentit.

10. Më 24 nëntor 2009, Prokurori ka parashtruar aktakuzën, duke akuzuar parashtruesin për veprën penale të rrezikimit të trafikut publik, sipas paragrafit 5, të nenit 297, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK).

11. Më 1 mars 2010, kjo aktakuzë u konfirmua nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Ka. Nr. 438/09).

12. Aktakuza (PP. Nr. 565-1/2009) thekson se aktakuza është ngritur në bazë të provave në vijim:

> *"Gjendja faktike është vërtetuar në tërësi në bazë të mbrojtjes së të pandehurit Bajrush Xhemajlit, dëshmive të dëmtuarve-dëshmitarëve, ekspertizës së ekspertit të komunikacionit, skicës së vendit të ngjarjes dhe fotodokumentacionit si dhe mendimit dhe konstatimit të ekspertit të mjekësisë ligjore për personat e lënduar".*

13. Më 1 mars 2010, parashtruesi ka parashtruar një kundërshtim ndaj Aktakuzës te Gjyqtari i konfirmimit në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Parashtruesi ka kundërshtuar gjetjet e ekspertit të trafikut, duke pretenduar që kjo ekspertizë kishte krijuar gati gjithë bazën e Aktakuzës, si dhe që ajo përmbante një numër mangësish.

14. Veçanërisht, parashtruesi thekson:

> *"Ekspertiza e theksuar në tërësinë e vet përmban përshkrimin e aksidentit dhe vendit të ngjarjes, duke u bazuar në të dhënat e siguruara nga policia. Në ekspertizë përveç tjerash është konstatuar:*

'Shkaktar i këtij aksidenti sipas mendimit tim janë lëshimet e vozitësit të veturës Nissan me targa OOO-KS-035 i cili ka zhvilluar shpejtësi më të madhe se ajo e lejuar, duke tejkaluar në mënyrë të pasigurt Kombin VW nga ana e djathtë dhe duke u kthyer në mënyrë të pasigurt prapë në shiritin e majtë me të cilin rast e godet (prek) kombin VW, pas këtij tejkalimi me të cilin rast humb kontrollin dhe del në kahjen e kundërt të rrugës, ku ndeshet me veturat tjera të markës Mercedes 124 dhe Ford Mondeo të cilat ishin duke lëvizur nga kahja e kundërt në shiritin e tyre të komunikacionit në mënyrë të rregullt.
Nga shkresat e lëndës dhe analiza teknike e ketij aksidenti nuk kam gjetur lëshime të pjesëmarrësve tjerë që do të mund të ishin faktorë kontribues të këtij aksidenti'.

Ekspertiza dhe mendimi përfundimtar i paraqitur në të mbetet e mangët dhe e paqartë meqë nuk janë dhënë janë dhënë sqarime të pranueshme lidhur me shkaqet dhe rrethanat tjera që kanë kontribuar në ndodhjen e aksidentit.

Kështu në ekpertize nuk janë dhënë sqarime lidhur me Kombin VW i cili ka qarkulluar në anën e majtë të rrugës. Ekspertiza është dashtë që të sqarojë dhe të japë përgjigje në keto rrethana;

- *a është dashtë të lëvizë-qarkullojë në trakën e majtë ashtu si ka lëvizë apo është dashtë të kaloje në trakën e djathtë në të cilen zakonisht lëvizin veturat me shpejtësi me të vogël.*

- *a ka mundur ta vërejë dhe a e ka vërejtur veturën Nissan se e ka ndërmarrë veprimin e tejkalimit dhe a i ka ndërmarrë masat e duhura (zvogëlimin e shpejtësisë) që t'i mundësojë tejkalimin pa pengesë. Kjo rrethanë posaçërisht është dashtë të sqarohet meqë sipas skicës nga vendi i ngjarjes me simulimin e rrjedhës së aksidentit që është pjesë e ekspertizës*

rezulton se vetura Nissan që e ka vozitur i akuzuari, e ka goditur (fërkuar) veturën Kombi me pjesën e prapme të anës së majtë pra kur vetëm pak i ka mbetur pa e bërë tejkalimin.

Ekspertiza është e mangët dhe e paqartë edhe në rrethanën lidhur me shpejtësinë që e kanë zhvilluar veturat pjesëmarrese në aksident. Nga ekspertiza nuk mund të vërtetohet se cilët janë parametrat në të cilat është bazuar ekperti kur ka konkluduar se kinse vetura Nissan ka zhvilluar shpejtësi rreth 100 kmh.

Duke pasur parasysh mbrojtjen e të akuzuarit se shpejtësia me të cilen ka vozitur para se të ndodhë aksidenti ka qenë 60-70 km/h, dhe faktin se komunikacioni është i dendur në atë pjesë të rrugës, mendimi dhe vlerësimi i ekspertit të komunikacionit edhe në ketë rrethanë është i pabazuar".

15. Në bazë të këtyre pretendimeve, parashtruesi i kërkon Gjykatës së Qarkut të bëjë një ekspertizë tjetër. Parashtruesi thekson:

"Për këto arsye konsideroj se aktakuza nuk ka mundur të bazohet në këtë provë, e për t'u mënjanuar këto të meta dhe paqartësi, gjithherë me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të saktë të gjendjes faktike, propozoj që të angazhohet ekspert tjetër apo ekip i ekspertëve për kryerjen e superekspertizës".

Sa i përket gjykimit

16. Më 1 tetor 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka mbajtur një seancë dëgjimore, ku janë marrë deklaratat e dëshmitarëve, si dhe janë lexuar raportet e ekspertëve të forensikës dhe të ekspertit të trafikut. Parashtruesi ka kërkuar qartësimin e ekspertizës së trafikut, derisa eksperti i trafikut është ftuar të paraqitet në Gjykatë.

17. Më 18 nëntor 2010, Gjykata vazhdoi me shqyrtimin e dëshmive, si dhe dëgjoi ekspertin e trafikut. Eksperti i trafikut shpjegoi se si kishte arritur te përfundimet e tij, shpjegoi metodologjinë që kishte përdorur për kalkulimin e shpejtësisë së veturave të ndryshme, si dhe u përgjigj në pyetje të veçanta kur u mor në pyetje nga parashtruesi.

18. Në veçanti, eksperti qartësoi se nuk kishte gjetur prova për të dëshmuar ndonjë defekt në veturën e parashtruesit. Eksperti qartësoi vlerësimin e tij se vetura e parashtruesit kishte tejkaluar një veturë tjetër në anën e

djathtë, para se të kthehej në shiritin e majtë, duke goditur kështu veturën tjetër. Eksperti, gjithashtu, konfirmoi se kishte përpiluar ekspertizën e tij në bazë të dosjes së hetimeve, si dhe nuk kishte vizituar vetë vendin e ngjarjes.

19. Në këtë moment, parashtruesi i kërkoi Gjykatës të angazhojë ekspertizë shtesë. Parashtruesi kërkonte sqarime për dy pika:

a. Ekspertiza ishte e paqartë, si dhe nevojitej një superekspertizë për të ardhur tek e vërteta për shkaqet dhe/ose personat që shkaktuan aksidentin; si dhe
b. Ekspertiza teknike që nevojitet për të vlerësuar gjendjen e veturës së parashtruesit, për të parë nëse ndonjë defekt teknik kishte kontribuar në këtë aksident.

20. Gjykata e Qarkut e refuzoi këtë kërkesë, duke arsyetuar vendimin e saj me këto fjalë:

"Lidhur me propozimin e mbrojtësve për caktimin e superekspertizës së komunikacionit dhe për caktimin e ekspertit të makinerisë, Gjykata, duke konsideruar se në ekspertizën e komunkacionit dhe sqarimet e dhëna nga eksperti janë të mjaftueshme për vërtetimin e gjendjes faktike, merr këtë:

AKTVENDIM

Refuzohet propozimi i mbrojtjes së të akuzuarit për caktimin e superekspertizës dhe caktimin e ekspertit të makinerisë për konstatitimin e rregullsisë së veturës së tipit Nissan para aksidentit të komunikacionit".

21. Gjykata vazhdoi me shqyrtimin e provave, si dhe lexoi raportin e autopsisë dhe atë të vendit të ngjarjes, të hartuar nga Policia e Kosovës. Ajo shqyrtoi, gjithashtu, dokumentacionin fotografik të vendit të ngjarjes.

22. Në këtë moment, Gjykata pyeti parashtruesin nëse kishte për të deklaruar diçka në mbrojtje të tij, ndërsa ai shprehu dëshirën të mbrohej në heshtje në këtë fazë, në pritje të fjalës përfundimtare të mbrojtjes.

23. Më 23 nëntor 2010, parashtruesi dorëzoi fjalën e tij përfundimtare të mbrojtjes përkitazi me akuzat kundër tij. Në këtë parashtresë, parashtruesi deklaroi se gjithnjë e ka pranuar përgjegjësinë dhe/ose fajin e

tij për këtë aksident, por këtë e ka bërë duke refuzuar faktin që ai ishte *"i vetmi shkaktar i aksidentit"*.

24. Parashtruesi konsideronte se Gjykata ishte bazuar ekskluzivisht tek ekspertiza e ekspertit të trafikut, si dhe që kjo ekspertizë ishte konfuze për një numër pikash. Veçanërisht, parashtruesi konsideronte se Gjykata ishte e obliguar të kërkonte ekspertiza të tjera për të vërtetuar: (1) shpejtësinë e veturës së tij; (2) sjelljen e vozitësit të veturës të cilën po tejkalonte; dhe (3) gjendjen teknike të veturës së tij.

25. Më 26 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë dënoi parashtruesin për vepër penale të rrezikimit të trafikut publik, sipas paragrafit 5, të nenit 297, të KPPK-së. Parashtruesi u dënua me burgim në kohëzgjatje 2 vjet e 6 muaj, si dhe me dënimin shtesë 3 vjet ndalim i vozitjes, me efekt pas vuajtjes së dënimit me burg.

26. Sa i përket kundërshtimit të parashtruesit ndaj ekspertizës së komunikacionit, Gjykata thekson:

> *"Objekt vlerësimi nga gjykata ishte edhe ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Yll Koshi dhe deklarata e tij e dhënë në shqyrtimin gjyqësor lidhur me sqarimin e konstatimit dhe mendimit të dhënë në këtë ekspertizë, si dhe pas vlerësimit të plotë dhe të gjithanshëm, gjeti se kjo ekspertizë është precize, objektive dhe e bazuar në rregullat e shkencës dhe profesionalizmit, për arsye se eksperti në shqyrtimin gjyqësor në mënyrë të detajuar ka dhënë shpjegime për të dhënat e vërtetuara nga shkresat e lëndës, në të cilat e ka bazuar ekspertizën, por edhe për metodat shkencore që ka përdorur gjatë ekspertimit të bërë, prandaj gjykata ua fali besimin e plotë, ndërsa vërejtjet e mbrojtjes së të akuzuarit i vlerësoi si të paargumentuara, hipotetike dhe të pambështetura nga ndonjë provë konkrete".*

27. Vijimisht, parashtruesi dorëzoi ankesë në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut.

28. Veçanërisht, parashtruesi ankohej se Gjykata e Qarkut nuk kishte marrë parasysh nëse faktorë dhe/ose persona të tjerë kishin kontribuar në shkaktimin e aksidentit. Parashtruesi theksonte se, pasi nuk ishte angazhuar superekspertiza për sqarimin e këtyre faktorëve, kjo duhet të kishte çuar në përfundimin se ka dyshim të arsyeshëm mbi faktin nëse parashtruesi ishte shkaktari i vetëm i aksidentit.

29. Më 8 mars 2012, Gjykata Supreme refuzoi ankesën si të pabazuar.

30. Vijimisht, parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

31. Edhe në ankesën e tij, edhe në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, parashtruesi bazohet në të njëjtat argumente në mbrojtje të tij, që i kishte theksuar në Gjykatën e Qarkut.

32. Më 22 qershor 2012, Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, duke arsyetuar se:

> *"Mbrojtja e të akuzuarit gjatë gjitha fazave të procedurës ka përsëritur të njëjtit pohime, tani edhe me këtë mjet të jashtëzakonshëm, respektivisht duke pretenduar që gjendja faktike nuk është vlerësuar drejt, për shkak të faktit që sipas tyre, gjykata nuk ka arritur të vlerësojë saktësisht kush ka kontribuar në shkaktimin e këtij aksidenti me pasoja fatale: faktori njeri, faktori rrugë, apo faktori teknik (defektet eventuale teknike), si dhe kështu, sipas tyre, në rrethana të tilla, ka qenë e domosdoshme të urdhërohet kryerja e një superekspertize. Gjitha këto pretendime që kanë marrë përgjigje të mjaftueshme nga kolegji i kësaj gjykate janë të pabazuara. Gjykata mund të emërojë një ekspert tjetër apo kryerjen e superekspertizës në rast të kundërthënieve mes mendimeve të ekspertëve, dështimeve apo dyshimeve të arsyeshme, në lidhje me saktësinë e mendimit të dhënë, nëse të dhënat në përfundimet e ekspertëve (kur ka dy të tilla) dallojnë thellësisht ose kur përfundimet e tyre janë të mospërputhshme, jo të plota apo në kundërthënie me vetveten apo me rrethanat e vlerësuara, si dhe kur gjitha këto nuk mund të sqarohen me marrjen e sërishme në pyetje të ekspertëve. Në situatën konkrete, asnjë nga këto rrethana nuk do të shtynte gjykatën që të kërkonte kryerjen e superekspertizës".*

33. Ne konsiderojmë që vendimi i Gjykatës Supreme ka analizuar thellësisht argumentet e parashtruara nga parashtruesi, është i bazuar në vlerësim të arsyeshëm dhe të arsyetuar të provave, si dhe i dhënë brenda kompetencës dhe diskrecionit të saj.

Sa i përket praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

34. Sa i përket vlerësimit të provave nga gjykatat e rregullta, ne përkujtojmë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (*Shih, Elsholz kundër Gjermanisë, Nr. 25735/94, 13 korrik 2000, para. 66*):

> *"Gjykata rikujton që pranueshmëria e provave është kryesisht çështje e rregullimit me ligje vendore, si dhe që si rregull i përgjithshëm, i mbetet gjykatave vendore t'i vlerësojnë dëshmitë e paraqitura. Detyra e Gjykatës në bazë të Konventës është që të vërtetojë nëse procedurat në përgjithësi, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë mbledhur dëshmitë, kanë qenë të drejta (Shih, mutatis mutandis, Aktgjykimi Schenk kundër Zvicrës, i 12 korrikut 1988, Seria A, nr. 140, p. 29, §§ 45 dhe 46; si dhe Aktgjykimi H. Kundër Francës, i 24 tetorit 1989, Seria A, nr. 162-A, p. 23, §§ 60-61).*

35. Për pasojë, nuk është roli i Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme kanë vlerësuar në mënyrë të drejtë dëshmitë e paraqitura në rastin e parashtruesit. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vlerësojë nëse procedurat në përgjithësi kanë qenë të drejta.

36. Ne nuk pajtohemi me gjetjen e shumicës, të theksuar në paragrafin 105 të Aktgjykimit, që:

> *"[...] kur shikohet rregullsia e procedurave penale në rastin e Parashtruesit si të tërë, nuk mund të thuhet që ai ka gëzuar 'gjykim të drejtë' në kuptimin e nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës".*

37. Në fakt, ne theksojmë se parashtruesi nuk ka kontestuar përgjegjësinë e tij për aksidentin e komunikacionit në bazë të të cilit është dënuar, por thjesht ka kontestuar se ai nuk ka qenë i vetmi shkaktar. Ai vazhdimisht kishte kërkuar ekspertizë shtesë për të përcaktuar nëse do të mund të kishte pasur shkaqe të tjera kontribuuese apo jo, qofshin ato njerëzore apo teknike, për të cilat ka sugjeruar një numër mundësish.

38. Më tutje, theksojmë se parashtruesi ka pasur mundësi të ngrejë brengat e tij përkitazi me këta faktorë të tjerë të mundshëm kontribuues me ekspertin e komunikacionit, si dhe në Gjykatën e Qarkut dhe në Gjykatën Supreme. Ne theksojmë se eksperti i komunikacionit i është përgjigjur brengave për faktorët e përmendur nga parashtruesi, si dhe ka shpjeguar pse asnjëri nga këta faktorë nuk ka pasur rëndësi për aksidentin konkret.

39. Përveç këtyre, ne theksojmë se edhe Gjykata e Qarkut, e edhe Gjykata Supreme, kanë marrë parasysh brengat e parashtruesit, si dhe kanë vendosur që ekspertiza e komunikacionit, përgjigjet e ekspertit të komunikacionit në pyetjet e parashtruesit, të kombinuara me dëshmitë e tjera të paraqitura, kanë trajtuar këto brenga në mënyrë adekuate dhe të plotë.

40. Në këto rrethana, nuk mund të thuhet se parashtruesi nuk ka pasur mundësi të shumta për të shqyrtuar dëshmitë dhe që pyetjet e tij të merren seriozisht. As nuk mund të thuhet se parashtruesi është penguar në ndonjë mënyrë në paraqitjen e ekspertizës apo të dëshmive të tjera në mbrojtje të tij, me vetiniciativën e tij.

41. Sa i përket refuzimit nga gjykatat për të angazhuar ekspertizë tjetër, që nuk është e njëjtë me refuzimin e pranimit të dëshmive të parashtruara në emër të parashtruesit, shumica i referohet veçanërisht paragrafit 4, të nenit 31, të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet".*

42. Shumica, gjithashtu, i referohet paragrafit 3(d), të nenit 6, të Konventës Evropiane, i cili përcakton:

> *"3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*
>
> *d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës".*

43. Shumica është bazuar në një numër aktgjykimesh të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (GJEDNJ) për të nxjerrë përfundimet e saj. Megjithatë, aktgjykimet e cituara janë të pavend, si dhe, si të tilla, nuk mund të mbështesin logjikisht përfundimin e shumicës.

44. Aktgjykimi i tillë i parë është rasti Vidal kundër Belgjikës, Nr. 12351/86, 22 prill 1992. Në atë rast, GJEDNJ-ja theksoi: *"Si rregull i përgjithshëm,*

është roli i gjykatave vendore që të vlerësojnë dëshmitë e paraqitura tek ato, si dhe peshën e dëshmive që të paditurit kërkojnë të sjellin." [...] "...nuk kërkon pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të secilit dëshmitar në emër të të akuzuarit; synimi i saj thelbësor, siç ceket me fjalët «në të njëjtat kushte» është «barazi e armëve» e plotë në këtë rast".

45. Në atë rast, Gjykata e Apelit në Belgjikë e kishte bazuar vendimin e saj krejtësisht te shkresat e rastit, si dhe kishte refuzuar të ftonte katër dëshmitarë të kërkuar e të paraqitur nga mbrojtja. Për më tepër, Gjykata e Apelit nuk kishte dhënë kurrfarë arsyeje për refuzimin e kësaj kërkese. Heshtja e plotë e gjykatës për këtë kërkesë, e kombinuar me verdiktin e gjykatës që rriti dënimin, u vlerësuan të ishin në mospërputhje me konceptin e gjykimit të rregullt sipas nenit 6 të KEDNJ-së.

46. E kundërta e kësaj, në rastin e parashtruesit, Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme kanë marrë parasysh kërkesën e parashtruesit për ekspertizë shtesë, si dhe secila prej tyre ka ofruar arsye të hollësishme për refuzimin e tyre. Asnjë dëshmitar, e as dëshmi të tjera të propozuara nga mbrojtja, nuk janë refuzuar. Për më tepër, Gjykata Supreme, sipas ankesës, nuk ka ndryshuar dënimin e parashtruesit, e as nuk ka ndryshuar në mënyra të tjera verdiktin e Gjykatës së Qarkut. Si i tillë, rasti i parashtruesit duhet dalluar nga rasti Vidal i përmendur më lart.

47. Rasti i dytë i përmendur nga shumica është Aktgjykimi V. D. kundër Rumanisë, Nr. 7078/02, 28 qershor 2010. Ai rast kishte të bënte me refuzimin e gjykatave që të kërkojnë një test ADN-je, siç është kërkuar nga i dyshuari në një rast përdhunimi. Rezultatet e atij testi të ADN-së do të mund të ofronin informata që do të mund të ishin vendimtare për gjetjen e fajtorit për veprën penale të përdhunimit. Si e tillë, ekspertiza ishte vetë zemra e çështjes së vërtetimit të fajësisë apo të pafajësisë.

48. E kundërta e kësaj, në rastin e parashtruesit, përgjegjësia për aksidentin që tërheq akuzat penale nuk është qenësore për ankesën, e parashtruesi as që e ka kontestuar përgjegjësinë e tij për aksidentin e trafikut, në bazë të të cilit është dënuar. Parashtruesi, thjesht, ka theksuar mundësinë që do të mund të kishte pasur faktorë të tjerë kontribuues. Si e tillë, ekspertiza e kërkuar është e rëndësishme për gjetjen e fajësisë apo të pafajësisë, por nuk është qenësore. Kështu, rasti i parashtruesit duhet gjithashtu të dallohet nga rasti V. D. kundër Rumanisë.

49. Rasti i tretë i përmendur është Elsholz kundër Gjermanisë (cituar më lart). Ky rast kishte të bënte me babanë që kërkonte të drejtat e vizitës së djalit të tij të mitur. Babai kishte kërkuar kontroll psikologjik të djalit të tij, për të sqaruar gjendjen mendore të djalit përkitazi me disa deklarata që djali

kishte bërë për babanë e tij. GJEDNJ-ja, në atë rast, kishte gjetur se refuzimi nga gjykatat vendore që t'i japin babait të drejtat e vizitës kishin cenuar tashmë të drejtën e respektimit të jetës së tij familjare. Si e tillë, çështja e gjykimit të rregullt, në kuptimin e refuzimit të kërkesës për ekspertizë psikologjike, i kishte kontribuar shkeljes përfundimtare të të drejtave të babait për respektim të jetës së tij private.

50. E kundërta e kësaj, në rastin e parashtruesit, nuk janë gjetur shkelje të tjera të të drejtave të parashtruesit. Si i tillë, refuzimi nga Gjykata Supreme dhe nga Gjykata e Qarkut që të urdhërohet superekspertiza, nuk ka prekur të drejtat e tjera të parashtruesit. Prapë, rasti i parashtruesit duhet të dallohet, gjithashtu, nga rasti Elsholz kundër Gjermanisë.

Përfundimi

51. Në përfundim, ne theksojmë, në të kundërtën e vendimit të shumicës, se parashtruesi ka pasur mundësi adekuate për të vënë në pikëpyetje dëshmitë e paraqitura në rastin e tij. Me kërkesën e parashtruesit, eksperti i komunikacionit është thirrur të sqaronte ekspertizën e tij, si dhe parashtruesi ka pasur mundësi të paraqesë brengat e tij përkitazi me ekspertizën. Nga dosja e rastit mund të shihet se eksperti i komunikacionit i është përgjigjur të gjitha pyetjeve të parashtruesit me përgjigje të arsyetuara. Në këto rrethana, nuk mund të pajtohemi me shumicën se ka pasur ndonjë shkelje të të drejtave të parashtruesit për "barazi të armëve" me palën e akuzës në gjykimin e tij.

52. Veçanërisht, ne gjejmë që arsyetimi i parashtruesit për kërkesën e tij për superekspertizë nuk është bazuar në argumentin që ai nuk ka qenë përgjegjës për aksidentin, që ka çuar në dënimin e tij për rrezikim të komunikacionit publik.

53. Në vend të kësaj, kërkesa e tij për superekspertizë është bazuar në argumentin që faktorë të tjerë kanë mundur të kontribuojnë në aksident, si dhe ka kërkuar që këta faktorë të hulumtohen, ashtu që të pranohen apo të hedhen poshtë nga gjykatat.

54. Në të vërtetë, eksperti i komunikacionit kishte marrë parasysh brengat e parashtruesit, si dhe kishte pranuar që, "në parim", këto gjëra do të mund të kontribuonin në aksident, por që, në rrethanat konkrete, nuk kishin kontribuar.

55. Më tutje, ne gjejmë që nuk është roli i gjykatave penale të hulumtojnë e të shqyrtojnë secilin shpjegim të mundshëm alternativ të një ngjarjeje, por që të arrijnë një konkludim të arsyeshëm për fajësi apo për pafajësi.

56. Përfundimisht, ne gjejmë, brenda fakteve të rastit, që gjykimi ndaj parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë, si dhe që konkludimi i rastit të tij është bazuar në vlerësim të arsyeshëm dhe të arsyetuar të provave nga Gjykata e Qarkut dhe nga Gjykata Supreme.

57. Përveç këtyre, ne gjejmë që nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të përcaktojë nëse Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme kanë vlerësuar në mënyrë të drejtë provat e parashtruara në rastin e parashtruesit, siç ka bërë shumica.

58. Përgjithësisht, parashtruesi ka pasur mundësi të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij, si dhe nuk është penguar në paraqitjen e dëshmitarëve dhe të ekspertëve në emër të tij, me të njëjtat kushte si ata kundër tij.

59. Kështu, ne konkludojmë që nuk ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe sipas nenit 6 [E Drejta për Proces të Rregullt Gjyqësor] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Rrjedhimisht, kërkesa është dashur të hedhet poshtë si e pabazuar.

Dorëzuar me respekt,

Altay Suroy Gjyqtar	Almiro Rodrigues Gjyqtar	Snezhana Botusharova Gjyqtare

Mendimi konkurrues
i
gjyqtarit Robert Carolan
në
Rastin nr. KI78/12
Parashtrues
Bajrush Xhemajli
Vlerësimi kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Pkl.nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012

Pajtohem me mendimin dhe aktgjykimin e shumicës në këtë rast për të gjitha arsyet e dhëna në mendimin e shumicës dhe për disa arsye tjera.

Në këtë rast parashtruesi i kërkesës ishte akuzuar për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 paragrafi 5 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK). Ky ligj në mënyrë specifike parashikon:

> *(1)Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik dhe rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve apo pasurinë me përmasa të mëdha dhe me këtë i shkakton lëndime të lehta trupore personit apo dëm thelbësor material që tejkalon vlerën mbi 1.000 euro dënohet me gjobë apo me burgim deri në pesë vjet. (3)Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në dy vjet. (5) Nëse vepra penale nga paragrafi 3 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose me dëm thelbësor material, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet, e nëse vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo të më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.*
> (me theks të shtuar)

Para se të mund të dënohet për këtë vepër penale ndonjë i akuzuar për shkelje të këtij ligji penal duhet të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm se:

(1) i akuzuari e ka shkelur ligjin mbi trafikun; dhe

(2) akti(et) e të akuzuarit e kanë rrezikuar trafikun publik, jetën e njerëzve apo pasurinë; dhe

(3) akti i të akuzuarit ka qenë "me përmasa të mëdha" apo ka qenë shkaktari kryesor i lëndimit apo vdekjes.

Ky ligj parashikon se mund të ketë shkaktarë të shumëfishtë të aksidentit të komunikacionit. I njëjti nuk e dënon apo nuk e bën të jetë penal një akt që thjesht mund të jetë një nga shumë shkaqet e një aksidenti të komunikacionit përderisa nuk është shkaku kryesor i aksidentit. Thjesht pakujdesia gjatë vozitjes së automjetit që rezulton me lëndim apo vdekje nuk është krim i dënueshëm me këtë ligj. Kjo pakujdesi duhet të jetë e "madhe" apo pakujdesi e rëndë për të ardhur deri te shkelja e këtij ligji.

Për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se sjellja e parashtruesit të kërkesës në vozitje ka qenë shkaktari kryesor i aksidentit gjykata e shkallës së parë si gjykatë për gjetjen e fakteve në rastin e parashtruesit ka qenë e obliguar të ekzaminojë të gjitha provat dhe të gjitha shkaktarët e mundshëm të aksidentit. Në këtë rast, gjykata e shkallës së parë nuk bëri një ekzaminim të tillë madje as pas kërkesave të vazhdueshme që parashtruesi ia drejtoi gjykatës së shkallës së parë për të bërë një ekzaminim të tillë. Në të vërtetë, eksperti i trafikut i caktuar nga gjykata në rastin e parashtruesit të kërkesës sinqerisht e kishte pranuar se:

> "*Nga shkresat e lëndës kemi evidencë vetëm në lidhje me shkaqet subjektive, dmth. Nga palët e përfshira në aksident, përderisa prova tjera siç janë rruga dhe mjetet që kanë shkaktuar aksidentin, nuk kemi. Unë vetëm kam analizuar shkresat e lëndës, nuk kam marrë pjesë në inspektimin e vendit të ngjarjes*"

Sipas dëshmisë së ekspertit të trafikut janë tre faktorë që kontribuojnë në shkaktimin e aksidenteve të trafikut: (1) faktori njeri (2) faktori rrugë dhe (3) faktori automjet. Por eksperti i trafikut në raportin e tij në rastin e parashtruesit të kërkesës vetëm konstatoi faktorin njeri, dhe jo faktorin rrugë apo faktorin automjet edhe pse ai e pranoi se ekzaminimi i këtyre faktorëve shtesë do të ishte relevant për të nxjerrë një mendim përkitazi me shkaktarin e aksidentit dhe nëse ai shkaktar ka qenë "me përmasa të mëdha". Për pasojë asnjëherë nuk u përcaktua nëse automjeti i parashtruesit apo automjetet e tre vozitësve tjerë kishin probleme të panjohura mekanike në kohën e aksidentit që kanë mundur të kontribuojnë në shkaktimin e aksidentit. Asnjëherë nuk u përcaktua nëse kushtet e rrugës kanë munduar të kontribuojnë në shkaktimin e aksidentit. Përveç kësaj, shpejtësia dhe sjellja në vozitje e vozitësve tjerë kurrë nuk u vërtetua me ekzaminimin e përplasjes dhe dëmit të shkaktuar automjeteve tjera të përfshira në aksident. Asnjë përgjigje në ndonjërën nga këto pyetje nuk u lejua që t'i parashtrohet gjykatës së shkallës së parë përkundër kërkesave të përsëritura nga parashtruesi për caktimin e një eksperti për të kryer një hetim dhe ekzaminim të hollësishëm në përpjekje për t'u përgjigjur këtyre pyetjeve për të konstatuar nëse parashtruesi i kërkesës ka qenë shkaktar i aksidentit "me përmasa të mëdha".

Në përgjigje të kërkesave të përsëritura të parashtruesit për ekzaminim nga një ekspert tjetër gjykata e shkallës së parë theksoi:

> "....*gjykata konsideroi se raporti* i ekspertit të komunikacionit dhe shpjegimi i dhënë nga eksperti i komunikacionit ishin të mjaftueshme për të konstatuar gjendjen faktike"

Gjykata e shkallës së parë kurrë nuk dha ndonjë arsye se pse erdhi deri te ky përfundim madje edhe kur eksperti i trafikut i caktuar nga vetë ajo dëshmoi se faktori automjet dhe faktori rrugë mund të kontribuojnë në shkaktimin e aksidentit automobilistik.

Në përmbyllje të gjykimit të tij në gjykatën e shkallës së parë më 23 nëntor 2010 parashtruesi i kërkesës e pranoi se ai kishte një pjesë të përgjegjësisë për shkaktimin e aksidentit, por kurrë nuk e pranoi dhe as nuk deklaroi se e kishte shkelur ligjin mbi trafikun se kishte rrezikuar jetën e njeriut apo pasurinë apo se sjellja e tij në vozitje ishte shkaktari "me përmasa të mëdha" i aksidentit që kishte rezultuar me vdekjen e një qenie tjetër njerëzore. Ai vazhdimisht ka këmbëngulur në pafajësinë e tij në lidhje me akuzat penale dhe vazhdimisht ka kërkuar nga gjykata e shkallës së parë që të caktonte një ekspert të trafikut për ekzaminuar hollësisht të gjithë faktorët që kanë mundur të shkaktojnë aksidentin.

Disa kanë sugjeruar se pasi që parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar se sjellja e tij në vozitje ka qenë një shkaktar i aksidentit është jorelevant dhe i parëndësishëm fakti se gjykata e shkallës së parë ia ka refuzuar kërkesën për zhvillimin e një hetimi të hollësishëm nga eksperti i trafikut. Ky është një konkludim i gabuar. Parashtruesi i kërkesës nuk është deklaruar fajtor për akuzat dhe nuk e ka pranuar fajësinë ndaj akuzave. Nëse do të kishte vepruar ashtu, nuk do të kishte arsye për gjykim penal.

Pasi që gjykimi ka ndodhur, që të tri elementet e akuzës ndaj parashtruesit është dashur të provohen përtej dyshimit të arsyeshëm. Parashtruesi i kërkesës vazhdimisht ka kërkuar nga gjykata e shkallës së parë që të caktohet një ekspert i trafikut që do të mund të kryente një hetim të hollësishëm të aksidentit duke ekzaminuar të gjithë faktorët që kanë mundur të kontribuojnë në shkaktimin e aksidentit dhe të nxjerrë një mendim eksperti për shkaktarin e aksidentit. Kjo kërkesë vazhdimisht është mohuar, mohim ky që ka qenë cenim i të drejtave kushtetuese të parashtruesit në bazë të nenit 31.4 të Kushtetutës.

Disa kanë sugjeruar se kjo Gjykatë në mënyrë të palejueshme ka vlerësuar provat në rastin e parashtruesit të kërkesës. Edhe ky është një konkludim i gabuar. Kjo Gjykatë vetëm ka konkluduar se nga pikëpamja procedurale parashtruesit të kërkesës nuk i është lejuar që të paraqesë prova dhe dëshmitarë relevantë në gjykimin e tij. Pasi që parashtruesit nuk i është lejuar që të paraqesë prova të tilla, ai nuk ka pasur gjykim të drejtë siç kërkohet me Kushtetutë. Në të vërtetë, për shkak se gjykata e shkallës së parë nuk ka lejuar që një ekspert tjetër i trafikut të ekzaminojë provat, vendngjarjen dhe automjetet e përfshira pa një sqarim të arsyetuar, është pothuajse e pamundur që të vlerësohen provat në këtë rast. Rrjedhimisht kjo Gjykatë nuk është duke vlerësuar provat. Në të vërtetë është vetëm duke vlerësuar se a i janë cenuar të drejtat kushtetuese parashtruesit të kërkesës. Në këtë rast, ato të drejta i janë cenuar në mënyrë të vazhdueshme.

Robert Carolan
Gjyqtar
Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

KI 149/11, Shefqet Aliu, datë 25 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-09-0106, të 7 tetorit 2011

Lënda KI 149/11, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 dhjetorit 2012.

Fjalët kyçe: ekonomia, barazia para ligjit, masë e përkohshme, kërkesa individuale, qartazi e pabazuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, e drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar vendimin e Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, sepse ia mundësoi ndërmarrjes që të fitojë tenderin që ishte anuluar më parë me një aktgjykim të formës së prerë, përkatësisht, Gjykata vendosi në favor të një pale në dëm të palës tjetër. Parashtruesi i kërkesës më tej kërkoi nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme për ndalimin e ekzekutimit të Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme, ASC-09-0106, për arsye se të gjitha kushtet janë përmbushur për vendosjen e masës së përkohshme për ndalimin e ekzekutimit dhe probabiliteti se ekziston rreziku i drejtpërdrejtë i shkaktimit të dëmit ndaj së drejtës së këtij parashtruesi.

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata vlerësoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk sqaron si dhe pse Kolegji për Ankesa i Dhomës së Posaçme (Aktgjykimi ASC-09-0106) ka shkelur parimin *res judicata*, të drejtën për barazi para ligjit dhe të drejtën për mjete juridike. Më tej, duke marrë parasysh se kërkesa u gjet e papranueshme, parashtruesi i kërkesës nuk ka të drejtë, sipas rregullit 54 (1) të Rregullores së punës, të kërkojë masa të përkohshme

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI149/11
Parashtrues
Shefqet Aliu
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-09-0106, të 7 tetorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Shefqet Aliu (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi), i përfaqësuar nga z. Shabi Sh. Isufi, avokat nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston vendimin e Kolegjit të ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i ankesave), ASC-09-0106, të 7 tetorit 2011, që iu dorëzua atij më 18 tetor 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se vendimi i lartpërmendur ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta): nenin 10 [Ekonomia], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [e Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 34 [e Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër].

4. Për më tepër, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme për ndalimin e ekzekutimit të aktgjykimit të Dhomës së Posaçme, ASC-09-0106, për arsye se *"[...] të gjitha kushtet janë përmbushur për lëshuarjen e masës së përkohshme për ndalimin e ekzekutimit të Aktgjykimit të përmendur **fomus boni turis** - probabiliteti se ekziston e drejta kryesore e kërkuar dhe **periculum in mora** - rreziku i drejtpërdrejtë i shkaktimit të dëmit ndaj të drejtës së këtij parashtruesi. Për më tepër, ekzekutimi i Aktgjykimit do t'i shkaktonte '[...] punëtorëve të fabrikës së radiatorëve dhe shtetit të Kosovës një dëm të pa-riparueshëm, sepse vlera e shitjes së NSH 'Jugoterm' në vlerë prej 1.100.000, është më e vogël se sa repromateriali i ndërmarrjes".*

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenin 22 dhe në nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 54, në rregullin 55 e në rregullin 56(2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 16 nëntor 2011, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatë.

7. Më 5 dhjetor 2011, parashtruesi kërkoi nga Gjykata të vendosë masën e përkohshme.

8. Më 17 janar 2012, Kryetari caktoi gjyqtaren Iliriana Islami Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Gjyljeta Mushkolaj.

9. Më 17 prill 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesi këto sqarime:

> *"... Së pari çështja mes 'ENG Office' dhe AKM-së (0056) në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme është zhvilluar pa praninë tuaj. Pse nuk keni paraqitur një kërkesë në Gjykatën Supreme për të qenë të pranishëm si palë e tretë e interesuar në këtë rast? Nëse nuk keni qenë në dijeni për vazhdimësinë e rastit, pse nuk filluat një rast të ri për të parashtruar ankesat tuaja në Gjykatën Supreme?*

Së dyti, cili është interesi juaj material që ju nxiti të kërkonit që të zhvleftësohet rezultati i tenderit në rend të parë?

Së treti, pse nuk keni kërkuar nga Gjykata Supreme të ftojë 'ENG Office' si palë të tretë apo si dëshmitar gjatë rastit tuaj SCC-06-0475?

Së fundi, ju lutemi na ofroni kopjet e të gjitha dokumenteve që keni paraqitur kur keni aplikuar në Gjykatën Supreme".

10. Më 24 prill 2012, parashtruesi iu përgjigj Gjykatës, duke theksuar:

"...

a) Çështja e Ndërmarrjes Private 'ENG Office' nga Gjilani dhe e AKM-se, e cila i referohet numrit SCC-08-0056 te datës 13.11.2009 ne Dhomën e Posaçme te Gjykatës Supreme te Kosove është zhvilluar pa prezencën time, pasi unë nuk kam qenë i përfshirë si palë në procedurë sipas padisë të iniciuar nga 'ENG Office'. Krahas këtij fakti, ne paraprakisht sipas çështjes kontestimore e cila i referohet numrit veprues SCC-06-0475 e datës 08.08.2007, në të cilën çështje me Aktvendimin e DHPGJS, SCA-08-0007 i datës 06.03.2008, ishte refuzuar kërkesa për rishqyrtimin e ushtruar nga 'ENG Office' dhe ky Aktvendim ishte shpallur përfundimtar, ligjërisht i detyrueshëm dhe pa të drejtë apelimi dhe rishikimi. Meqenëse kemi patur të bëjmë me Aktvendimin e formës se prerë SCA-08-0007 te datës 06.03.2008, me te cilin ishte refuzuar kërkesa për rishikim e ushtruar nga 'ENG Office', dhe Aktgjykimi SCC-06-0475 ishte vërtetuar, konsiston se çështje juridike kishte marrë fund, andaj unë nuk kam mundur të parashikoj se Ndërmarrja ENG Office, do të mund të vazhdoj procedurën gjyqësore lidhur me tenderin e anuluar sipas Aktgjykimit te përmendur me larte. Duke u bazuar ne këtë fakt, nuk ka patur nevoje që të filloj një rast të ri lidhur me çështjen qe kishte te bej me Ndërmarrjen Publike 'Jugoterm', pasi tere kohen kam pritur qe të ritenderohet. Lidhur me pyetjen pse nuk kam filluar një rast te ri për te parashtruar ne Gjykatën Supreme te Kosovës, këtë nuk kam mund ta bëj, sepse kemi patur te bëjmë me çështjen e gjykuar, ndërsa kur Aktgjykimi SCC-08-0056 i datës 13.11.2009 ishte vërtetuar sipas Aktgjykimit ASC-09-0106, dhe tani me kishte marrë formën e prere, andaj unë nuk kam mundur të parashtroj

ndonjë mjet juridik te një gjykate e cila pas marrjes se Aktgjykimit SCC-06-0475, i cili me Aktvendimin SCA-08-0007 ishte refuzuar kërkesa për rishikim e bërë nga 'ENG Office', dhe ky Aktvendim ishte përfundimtar, ligjërisht i detyrueshëm dhe ndaj tij nuk ka mund te apelohet ose rishikohet, sepse DHPGJS me vendimet e saja kishte shkelë Kushtetutën dhe Ligjin, duke vendosur për të dytën herë për çështjen të cilën me herët e kishte gjykuar.

b) Interesi im material që më nxiti të kërkoj anulimin e tenderit, në rend te pare ishte sepse 'ENG Office' sipas tenderit të fituar kishte anuluar njëanshëm Marrëveshjen tonë paraprake dhe më kishte eliminuar si aksionar prej 30 %.

c) Lidhur me pyetjen e parashtruar, përse nuk është kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës të ftohet 'ENG Office' si pale e trete për rastin SCC-06-0475, këtë nuk ka qene e nevojshme ta bej, sepse 'ENG Office' ka qenë e përfshirë ne këtë rast dhe kishte berë Kërkesën për rishqyrtimin e vendimeve të DHPGJS, i cili ishte mjet i rregullt juridik, mirëpo me Aktvendimin SCA-08-0007 i datës 06.03.2008, ishte refuzuar Kërkesa e Ndërmarrjes private 'ENG Office' për rishikim, andaj nga ky fakt konsiston se 'ENG Office' ka qenë e kyçur si palë në çështjen SCC-06-0475.

d) Lidhur me kërkesën që t'i ofrojmë kopjet dhe dokumentet kur kemi aplikuar ne Gjykatën Supreme te Kosovës, bashkangjitur me këtë përgjigje, ju dërgojmë edhe Padinë e parashtruar nga Shefqet Aliu ne Gjykatën Supreme te Kosovës, ndërsa provat e tjera të cilat eventualisht kishin me ju shërbyer ne këtë rast, gjinden ne kërkesën e parashtruar nga ana e AKP-se te Gjykata Kushtetuese e Kosovës me datë 12.12.2011, e cila mban Numrin e protokollit 4360 dhe Numrin e lendes KI 160/11.

..."

11. Më 26 nëntor 2012, Kryetari Enver Hasani zëvendësoi gjyqtaren Iliriana Islami, si Gjyqtare raportuese, me gjyqtarin Almiro Rodrigues, dhe zëvendësoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj, në Kolegjin shqyrtues, me gjyqtarin Ivan Čukalovic, sepse mandati i tyre si gjyqtare të Gjykatës Kushtetuese kishte përfunduar më 26 qershor 2012.

12. Më 26 nëntor 2012, kërkesa iu komunikua Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) dhe Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme).

13. Më 5 dhjetor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Në vitin 2006, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM) shpalli tender për shitjen e Ndërmarrjes "Jugoterm" në Gjilan. Ofertuesit, që kishin aplikuar për tenderin e publikuar, ishin: "ENG Office" në Gjilan, NPT "Kalabria" e përfaqësuar nga Shefqet Aliu (në këtë rast, parashtruesi), dhe "Install Engineering" Prishtina. "ENG Office" nga Gjilani ishte shpallur fitues.

15. Më 14 nëntor 2006, parashtruesi ushtroi padi në Dhomën e Posaçme, duke kërkuar që të anulohet procedura e tenderimit, me pretendimin se kishte pasur marrëveshje të fshehta ndërmjet ofertuesve, ku edhe ai kishte qenë pjesë e atyre marrëveshjeve, me ç'rast ishin shkelur rregullat e tenderit.

16. Më 8 gusht 2007, Dhoma e Posaçme nxori një Aktgjykim (Aktgjykimi SCC-06-0475), me ç'rast pjesërisht e pranoi padinë. Dhoma e Posaçme detyroi AKM-në që të anulojë tenderin, ku Ndërmarrja Publike "ENG Office" ishte shpallur fitues në shitjen e Ndërmarrjes së re "Jugoterm", sepse Dhoma e Posaçme gjeti se ka pasur parregullsi në procesin e tenderimit. Një pjesë e padisë, nëpërmjet së cilës kërkohet nga Dhoma e Posaçme që ta urdhërojë AKM-në të organizojë një tender të ri për ndërmarrjen e re të lartpërmendur, është hedhur poshtë, sepse varet nga AKM-ja se a do të vendosë për tender të ri ose jo.

17. "ENG Office", që kishte blerë Ndërmarrjen e Re "Jugoterm", dhe parashtruesi kërkuan nga e njëjta Dhomë e Posaçme ta rishqyrtojë Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme, të 8 gushtit 2007.

18. Më 5 shkurt 2008, e njëjta Dhomë e Posaçme (Vendimi SCA-08-0007) ka hedhur poshtë kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga "ENG Office", me arsyetimin se nuk ishte ngritur asnjë pretendim i ri faktik apo juridik dhe se Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme, i 8 gushtit 2007, ishte në përputhje me ligjin në fuqi. Ky vendim ishte përfundimtar dhe detyrues dhe ndaj tij nuk mund të ushtrohej ankesë.

19. Më 3 mars 2008, "ENG Office" parashtroi një padi në Dhomën e Posaçme kundër AKM-së për shkelje të rregullave të tenderit dhe propozoi që AKM-ja të detyrohet të nënshkruajë marrëveshjen me "ENG Office" si fitues në procesin e tenderit dhe të paguajë kompensimin për dëmet materiale dhe jomateriale.

20. Më 16 prill 2008, "ENG Office" parashtroi një kërkesë në Dhomën e Posaçme që të lëshojë një ndalim të përkohshëm për të ndaluar AKM-në të marrë ndonjë masë përkitazi me Ndërmarrjen e Re"Jugoterm".

21. Më 14 nëntor 2008, Dhoma e Posaçme (Vendimi SCC-08-0056) miratoi kërkesën për lëshimin e ndalimit të përkohshëm dhe me anë të kësaj AKM-ja *"[...] ndalohet të kryejë çfarëdo procedure të çfarëdo natyre në lidhje me privatizimin e Ndërmarrjes 'Jugoterm' derisa të jepet aktgjykimi përfundimtar në lidhje me këtë lëndë".* Dhoma e Posaçme konstatoi se *"[...] duke marrë parasysh të gjitha faktet ashtu si janë ato para Dhomës, Dhoma vlerëson se në të vërtetë prima facie, paditësi mund të pësojë një dëm të pariparueshëm nëse ndërmarrja tenderohet sërish e i jepet një pale të tretë".*

22. Më 22 tetor 2009, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Trupi gjykues) pjesërisht pranoi padinë nga "ENG Office". Trupi gjykues konkludoi (Aktgjykimi SCC-08-0056) se "ENG Office" është fitues i tenderit, obligoi AKM-në dhe AKP-në që të gjejnë mënyrë me anë të së cilës procedurat e nevojshme do të përmbyllin tenderin. Gjithashtu, obligoi AKM-në të paguajë kompensim për dëmet materiale. Trupi gjykues konkludoi, duke u bazuar në evidencën e dorëzuar, se anulimi i bërë nga Drejtori menaxhues i AKP-së është i pavlefshëm, sepse Bordi i Drejtorëve është i vetmi organ i autorizuar për të anuluar tenderin. Më tej, Trupi gjykues konkludoi se ky rast nuk mund të konsiderohet *res judicata,* sepse palët në Aktgjykimin SCC-06-0475, e 8 gushtit 2007, ishin palë të tjera prej atyre që janë në këtë rast dhe kjo kërkesë është, po ashtu, kërkesë tjetër.

23. Më 17 dhjetor 209, AKP-ja ushtroi ankesë në Kolegjin e ankesave kundër Aktgjykimit të 22 tetorit 2009, sepse ky aktgjykim po shkelte parimin *res judicata.*

24. Më 7 tetor 2010, Kolegji i ankesave (Aktgjykimi ASC-09-0106) hodhi poshtë ankesën e AKP-së si të pabazuar dhe mbështeti aktgjykimin e Trupit gjykues, të 22 tetorit 2009 (Aktgjykimi ASC-08-0056). Kolegji i ankesave vendosi që "*me faktin se paditësja e lëndës në fjalë nuk ka qenë palë e procesit gjyqësor dhe pasi që ndërmarrja nuk ka pasur mundësitë e rregullta për të prezantuar dëshmi që mbështesin*

qëndrimin e saj dhe të përdorë mjetet e zakonshme që janë në dispozicion të palës në procedurë, nga këto çështje plotësisht procedurale duhet të nxirret përfundimi se aktgjykimi i mëparshëm nuk mund të parandalojë shqyrtimin e padisë së paditëses ENG Office".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi pretendon se Dhoma e Posaçme "me Aktgjykimin e saj përfundimtar anulon tenderin, derisa me një tjetër aktgjykim të formës së prerë i mundëson Ndërmarrjes Private 'ENG Office' nga Gjilani që të fitojë këtë tender që ishte anuluar më parë me një aktgjykim të formës së prerë. Ky veprim i gjykatës është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, për arsye se gjykata ia mundëson 'ENG Office' nga Gjilani që të fitojë një tender që ishte anuluar me një vendim të formës së prerë, dhe pastaj një vendim i ri është marrë për një çështje që tashmë ishte gjykuar. Me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 10 dhe nenit 34 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës".

26. Për më tepër, parashtruesi pretendon se Dhoma e Posaçme, me Aktgjykimin e saj përfundimtar, *"ka favorizuar kundërligjshëm ndërmarrjen 'ENG Office' nga Gjilani, përderisa ka mohuar të drejtat e 2 pjesëmarrësve të tjerë dhe kështu ka shkelur dispozitën e nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku parashihet barazia e palëve para ligjit"*. Në këtë drejtim, parashtruesi gjithashtu pohon se "*Dhoma e Posaçme me dashje apo pa dashje bënë shkeljen e dispozitave të nenit 31 dhe 32 të Kushtetutës së R. Kosovës, sepse tejkalon kompetencat saja duke gjykuar në favor të njërës palë, në dëm të palëve tjera dhe në dëm të interesit shtetëror, dhe në anën tjetër palëve tjera iu pamundëson të drejtën në përdorimin e mjeteve juridike*".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Gjykata vëren se parashtruesi ankohet për shkeljen e parimit *res judicata*, shkelje e së drejtës për *barazi para ligjit* dhe shkelje e së drejtës për *mjete juridike*.

28. Në këtë drejtim, Gjykata, së pari vlerëson nëse parashtruesi ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Siç shihet më lart, Kolegji i ankesave, me vendim të arsyetuar shumë mirë, vendosi që "*me faktin se paditësja e lëndës në fjalë nuk ka qenë palë e procesit gjyqësor dhe pasi që ndërmarrja nuk ka pasur*

mundësitë e rregullta për të prezantuar dëshmi që mbështesin qëndrimin e saj dhe të përdorë mjetet e zakonshme që janë në dispozicion të palës në procedurë, nga këto çështje plotësisht procedural duhet të nxirret përfundimi se aktgjykimi i mëparshëm nuk mund të parandalojë shqyrtimin e padisë së paditëses ENG Office".

30. Ndërkohë, Gjykata thekson se, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, sa i përket vendimeve të nxjerra nga gjykatat e rregullta.

31. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, Garcia v. Spain [GC], Nr. 30544/96, para. 28, [GJEDNJ] 1999-I*).

32. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në atë mënyrë që parashtruesit të kenë pasur gjykim të drejtë (*Shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991*).

33. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës thjesht nuk pajtohet me gjetjet e gjykatës përkitazi me rastin dhe cek disa dispozita juridike të Kushtetutës, si të shkelura nga vendimi i kontestuar (Aktgjykimi SC-09-0106) i Kolegjit të ankesave të Dhomës së Posaçme.

34. Domethënë, parashtruesi nuk sqaron si dhe pse Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme (Aktgjykimi ASC-09-0106) ka shkelur parimin *res judicata*, të drejtën për barazi para ligjit dhe të drejtën për mjete juridike.

35. Si përfundim, parashtruesi nuk tregon se procedurat para Dhomës së Posaçme ishin në ndonjë mënyrë të padrejta, apo të prekura nga arbitrariteti (*Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009*).

36. Rregulli 36 (2.d) i Rregullores parasheh: " Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: (...) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

37. Prandaj, duke marrë parasysh rrethanat e mësipërme, rezulton se kërkesa përkitazi me shkeljet e pretenduara duhet të refuzohet si qartazi e pabazuar.

Kërkesa për masë të përkohshme

38. Neni 27 i Ligjit dhe, në veçanti rregulli 54 (1) i Rregullores së punës, përcakton se "përderisa një kërkesë është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme".

39. Megjithatë, duke marrë parasysh se kërkesa është gjetur e papranueshme, parashtruesi nuk ka të drejtë, sipas rregullit 54 (1) të Rregullores së punës, të kërkojë masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36(2.d) të Rregullores së punës; në pajtim me nenin 27 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 54(1) e me rregullin 56(2) të Rregullores së punës, më 5 dhjetor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. Ky vendim do t'iu komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 139/12, Besnik Asllani, datë 25 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PKL. nr. 111/2012 i 30 nëntorit 2012

Rasti KI 139/12, Aktvendim për papranueshmëri i 29 janarit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, kontest penal, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshem, parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale, kërkesë qartazi e pabazuar

Parashtruesi i kërkesës pretendonte se me aktgjykimi i Gjykatës Supreme shkeli të drejtat e tij kushtetuese, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], si dhe shkelje të nenit 6, në lidhje me nenin 13, të KEDNJ-së. Parashtruesi, konkretisht kishte kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që të anulojë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, si dhe dy aktgjykimet e Gjykatës Supreme dhe çështjen ta kthejë në rigjykim në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, sipas udhëzimeve përkitazi me përdorimin e standardit të të provuarit përtej dyshimit të bazuar si dhe interpretimin e ligjit penal në pajtim me parimin e prezumimit të pafajësisë.

Në këtë rast, Gjykata vëren se bazat e ankesës në Gjykatën Supreme, qoftë në instancën e dytë apo në mbrojtjen e ligjshmërisë, përmbajnë pretendime që kanë të bëjnë me shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendimit për sanksionet penale.

Gjykata, vlerësoi se pretendime e tilla jenë të fushës së ligjshmërisë. Gjykata Kushtetuese më tej vëren se në Gjykatën e Qarkut dhe në Gjykatën Supreme asnjë pretendim nuk është bërë nga parashtruesi i kërkesës mbi bazën e kushtetutshmërisë, qoftë në mënyrë implicite qoftë në substancë, që do ngrittë shkeljen e pretenduar të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të parashtruesit të garantuara me Kushtetutë.

Prandaj, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës as nuk ka ndërtuar e as nuk ka dëshmuar një rast *prima facie,* qoftë mbi bazën meritave apo pranueshmërisë së kërkesës. Në tërësi, Gjykata konstatoi se kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar.

Sa i përket kërkesës për mase te përkohshme, Gjykata konsideroi se, pasi që kërkesa e parashtruesit ishte qartazi e pabazuar dhe e papranueshme, ne këtë rast, kërkesa për masë të përkohshme nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit prandaj dhe refuzuar.

VENDIM PËR KËRKESËN PËR MASË TË PËRKOHSHME DHE AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI139/12
Parashtrues
Besnik Asllani
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PKL. nr. 111/2012 i 30 nëntorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Besnik Asllani, me vendbanim në Prishtinë, i përfaqësuar nga z. Bejtush Isufi, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi gjyqësor i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PKL. nr. 111/2012 i 30 nëntorit 2012, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 18 dhjetor 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

4. Parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të lëshojë masë të përkohshme përkitazi me pezullimin e ekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 433/2009, të 7 shtatorit 2010.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); në nenin 27 dhe nenit 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 28 dhe rregullin 54 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 31 dhjetor 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 17 janar 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

8. Më 22 janar 2013, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës dhe e informoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës me Nr. KI139/12.

9. Më 29 janar 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 5 tetor 2009, Prokurori ngriti aktakuzë (PP. nr. 668-6/2009) në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, duke akuzuar parashtruesin për kryerjen e veprës penale të detyrimit në tentativë.

11. Më 7 shtator 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori Aktgjykimin (P. nr. 433/2009) me të cilin shpall fajtor parashtruesin për veprën penale të detyrimit në tentativë dhe e dënon me burgim në kohëzgjatje 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj.

12. Më 7 mars 2011, Prokurori ushtroi ankesë ndaj Aktgjykimit, duke kërkuar dënim më të lartë për të akuzuarit.

13. Më 11 janar 2012, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin (Ap. nr. 155/11) me të cilin e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut (P. nr. 433/2009 të 7 shtatorit 2010) përkitazi me cilësimin dhe me

kualifikimin juridik të veprës penale dhe pjesërisht miratoi ankesën e Prokurorit. Prandaj, aktgjykimi i sipërpërmendur është ndryshuar vetëm përkitazi me vendimin për shqiptimin e masës së dënimit, duke shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje katër (4) vjet dhe duke aplikuar gjithashtu dënimin me gjobë në shumën 1.000 (një mijë) euro.

14. Më 8 mars 2012, parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, duke pretenduar se gjykata e instancës së parë e ka konstatuar gabimisht gjendjen faktike dhe gabimisht e ka aplikuar ligjin, me propozim që gjykata ta ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (P. nr. 433/2009) dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (Ap. nr. 155/11) dhe ta lirojë nga akuza parashtruesin, ose çështjen ta kthejë në rigjykim.

15. Më 30 nëntor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës (PKL. nr. 111/2012) e refuzoi si të pabazuar kërkesën, duke vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (Ap. nr. 155/11 të 11 janarit 2012). Gjykata Supreme ka konstatuar se këto çështje të ngritura nga mbrojtja e parashtruesit nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat kushtetuese, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale], si dhe shkelje të nenit 6, në lidhje me nenin 13, të KEDNJ-së.

17. Parashtruesi ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që të anulojë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut si dhe dy aktgjykimet e Gjykatës Supreme dhe çështjen ta kthejë në rigjykim në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, sipas udhëzimeve përkitazi me përdorimin e standardit të të provuarit përtej dyshimit të bazuar si dhe interpretimin e ligjit penal në pajtim me parimin e prezumimit të pafajësisë.

18. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës "kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës që të jap përgjigje në tri pyetje:

a) A është përdorur standardi i të provuarit "përtej dyshimit të bazuar" për të përcaktuar fajësinë e Besnik Asllanit nga ana e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës (duke vepruar si gjykatë e instancës së dytë)?

b) A është shkelur parimi i legalitetit në rastin konkret nga tri instancat?

c) A ka pasur paraqitësi i kërkesës një gjykim të drejtë në mungesë të arsyetimit adekuat nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës duke vepruar në bazë të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë?

Kërkesa për masë të përkohshme

19. Parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata të vendosë masa të përkohshme për pezullimin "e ekzekutimit të dënimit të caktuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (P. nr. 433/2009 të 7 shtatorit 2010) të vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës (Ap. nr. 155/11 të 11 janarit 2012) deri sa kjo çështje të përfundojë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

20. Parashtruesi pretendon që:

> *"Në rastin konkret në rast të mos miratimit të kërkese për masë të përkohshme siguruese paraqitësi i kërkesës do të pësoj dëm të pariparueshme. Kjo për faktin se edhe përkundër që me asnjë provë nuk është vërtetuar fajësia e tij, atij do ti privohet e drejta themelore e njeriut - liria dhe do të duhet të shkoj në vuajtje të dënimit me burgim së shpejti. Kërkesa e paraqitësit është poashtu "prima facie" e bazuar ngase mund të shihet shumë qartë se ai është dënuar duke u bazuar vetëm në një dyshim i cili asnjëherë nuk u provua dhe sistemi gjyqësor dështoi ti ofroj mbrojtjen e duhur juridike".*

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.2 [Efekti Juridik i Vendimeve] i Kushtetutës i cili përcakton:

> *"2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme".*

22. Gjykata gjithashtu merr në konsiderim nenin 27 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të*

nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik".

23. Për më tepër, rregulli 54 (1) të Rregullores së punës parasheh se:

"*Ne çfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës se përkohshme.*"

24. Së fundi, rregulli 55 (1) i Rregullores së punës parasheh se:

"Kërkesa për masë të përkohshme do të shqyrtohet me shpejtësi nga Gjykata dhe do t'i jepet përparësi para të gjitha kërkesave te tjera."

25. Për më tepër, në mënyrë që gjykata të vendosë masën e përkohshme, duhet që, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, të gjejë se:

"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmerinë e saj, rastin prima facie për pranueshmerinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon mase të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(c) masa e përkohshme është me interes publik.
Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Në këtë rast, Gjykata i referohet nenit 113 *[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] që përcakton se:*

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të

garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

27. Neni 47 (2) i Ligjit për gjykatë gjithashtu parasheh se:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

28. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit i cili parasheh se:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

29. Për më tepër, Rregulli 36 (1) a) dhe c) i Rregullores parasheh që:

(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

a) janë shteruar te gjitha mjetet juridike efektive te përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit te kundërshtuar;

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi; ose

c) kërkesa është qartazi e bazuar.

30. Gjykata konsideron se parashtruesi e ka përmbushur afatin e përcaktuar prej katër muajve, të numëruar prej ditës kur atij i është dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës Supreme; se e ka arsyetuar kërkesën me fakte relevante dhe me një referencë të qartë për shkeljet e pretenduara; se e ka kontestuar në mënyrë eksplicite aktgjykimin e Gjykatës Supreme si një akt konkret të autoritetit publik, objekt i shqyrtimit; se e ka theksuar në mënyrë të qartë mbrojtjen e kërkuar juridike dhe se i ka bashkëngjitur vendimet e ndryshme dhe informatat dhe dokumentet tjera mbështetëse.

31. Në bazë të asaj që u tha më lart, parashtruesi kryesisht pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 31 (E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm).

32. Parashtruesi pohon se "Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar nga parashtruesi i

kërkesës, nxori një aktgjykim mjaft formal. Ky vendim i gjykatës nuk ofron arsyetim adekuat në lidhje me pretendimet e ngritura nga mbrojtja."

33. Gjykata vëren se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut (P.nr. 433/2009) thekson:

> *I akuzuari Besnik Asllani, në mbrojtjen e vet, nuk ka pranuar veprën penale në pikën I të dispozitivit të aktakuzës të detyrimit në tentativë nga neni 267 para. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 20 te KPK, ndërsa ka pranuar fajësinë për veprën penale nga neni 328 par. 2 të KPK (mbajtja ne pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve).*

34. Në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut (P.nr. 433/2009) më tutje theksohet:

> *"Gjendjen e këtillë faktike përveç provave te administruara dhe të analizuara me lartë, gjykata e ka vërtetuar edhe nga vërtetimet mbi marrjen e sendeve, konfiskimin e armëve, dhe fishekëve, telefonave, raportin e ekzaminimit balistik, raportin mbi ekzaminimin e IMEJL-it, të telefonave, raportin mbi ekzaminimin e aparateve telefonike, raportin mbi përgjimin e bisedave telefonike mes të akuzuarve dhe të dëmtuarit, raportet e ndryshme mbi zbatimin masave të fshehta teknike sipas urdhëresave të gjykatës, hyrjet-daljet dhe SMS, mes të akuzuarve dhe të dëmtuarit, si dhe shikimi ne foto dokumentacioni e hetimeve."*

35. Parashtruesi ushtroi ankesë ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjykatën Supreme "*për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet ose të ndryshohet ashtu që i akuzuari të lirohet nga akuza për veprën penale të detyrimit, ndërsa t'i shqiptohet dënimi më i butë për veprën penale mbajtja ne pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 te KPK."*

36. Gjykata Supreme (Ap.nr. 155/2011, 11 janar 2012) pas analizës së tërësishme të bazave të ankesës gjeti se *"pretendimet e ankimuara të lartpërmendura janë të pabazuara."*

37. Parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme, *"për shkak të shkeljeve esenciale të*

dispozitave të procedurës penale nga neni 403 para. 1 pika 12 te KPPK, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme ta anulojë aktgjykimin e shkalles se parë dhe atë te shkalles se dytë dhe lëndën t'ia kthejë ne rigjykim dhe rivendosje Gjykatës së shkallës së pare,apo ta liroj të dënuarin nga akuza."

38. Gjykata Supreme (Pkl. Nr. 111/2012 të 30.11.2012) pas shqyrtimit të padisë në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se kërkesa është e pabazuar.

39. Gjykata Kushtetuese vëren se bazat e ankesës në Gjykatën Supreme, qoftë në instancën e dytë apo në mbrojtjen e ligjshmërisë, përmbajnë pretendime që kanë të bëjnë me shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendimit për sanksionet penale.

40. Gjykata Kushtetuese konsideron se ato pretendime mund të jenë të fushës së ligjshmërisë.

41. Gjykata Kushtetuese më tej vëren se në Gjykatën e Qarkut dhe në Gjykatën Supreme asnjë pretendim nuk është bërë nga parashtruesi i kërkesës mbi bazën e kushtetutshmërisë, qoftë në mënyrë implicite qoftë në substancë, që do ngrittë shkeljen e pretenduar të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të parashtruesit të garantuara me Kushtetutë.

42. Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane (shih rastin Fressoz dhe Roire kundër Francës (Kërkesa nr. 29183/95), Aktgjykimi i 21 janarit 1999) e ritheksoi, *mutatis mutandis*, se "qëllimi i rregullit [rregullit për shterimin] i referuara më lartë është që t'u jepet mundësia shteteve kontraktuese që të parandalojnë ose korrigjojnë – zakonisht përmes gjykatave – shkeljet e pretenduara kundër tyre para se këto pretendime të ngritën në Gjykatë. Ky rregull duhet të zbatohet me "me një shkallë fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruara"; mjafton që ankesat që mendohet të paraqiten më vonë në Strasburg të jenë ngritur "të paktën në substancë dhe në pajtim me kërkesat formale dhe afatet kohore të përcaktuara në ligjin nacional", pranë autoriteteve nacionale (shih Castells kundër Spanjës, aktgjykimi i 23 prillit 1992, seria A nr. 236, p. 19, § 27, dhe the Akdivar dhe të tjetër kundër Turqisë, aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, Raportet 1996-IV, pp. 1210-11, §§ 65-69)". .

43. Në pajtim me parimin e subsidiaritetit, parashtruesi i kërkesës është i detyruar të shterë të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, siç parashihet në nenin 113 (7) dhe dispozita të tjera ligjore, të cilat u përmendën më lart.

44. Në të vërtetë, qëllimi i rregullit të shterimit është që, ne këtë rast, t'i ofrohet Gjykatës së Qarkut dhe asaj Supreme mundësia e korrigjimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës. Rregulli i shterimit është në mënyrë funksionale i ndërthurur me karakterin e subsidiaritetit të kornizës procedurale të drejtësisë kushtetuese. (*Shih, mutatis mutandis Selmouni kundër Francës [GCl, § 74; Kudla kundër Polonisë [GCl, § 152; Andrashik dhe të tjerët kundër Sllovakisë [dec.]).*

45. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Përndryshe, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Ai dështim do të kuptohet si heqje dorë nga e të drejta për të kundërshtuar më tej shkeljen dhe për t'u ankuar. *(Shih, Aktvendimi ne rastin Kl07/09, Deme KURBOGAJ dhe Besnik KURBOGAJ, Vlerësim i Aktgjykimit te Gjykatës Supreme, Pkl.nr. 61/07, te 24 nëntorit 2008, paragrafi 18).*

46. Kurdo që kontestohet një vendim në bazë të një qëndrimi juridik që është i papranueshëm nga pikëvështrimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, gjykatave të rregullta që sollën vendimin, u duhet ofruar mundësia e rishqyrtimit të vendimit të kontestuar. Kjo do të thotë se, çdoherë, kur pretendohet shkelja e të drejtave te njeriut, nuk është e thënë qe ky pretendim të arrijë në Gjykatën Kushtetuese para se të shqyrtohet paraprakisht nga nga gjykatat e rregullta.

47. Parashtruesi i kërkesës, në këtë rast, do të duhej të ishte ankuar në mënyrë implicite apo në substancë pranë Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Supreme kundër shkeljes së pretenduar të së drejtës së tij për gjykim të drejtë, pasi që ato gjykata " gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit" (neni 102 (3) i Kushtetutës).

48. Ne praktikë, asgjë nuk e ndaloi parashtruesin e kërkesës që të ankohej para Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Supreme për shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij për gjykim të drejtë. Nëse ato gjykata do ta merrnin në shqyrtim shkeljen dhe do ta korrigjonin atë, kjo do të

përfundonte; nëse ato nuk do ta rregullonin shkeljen, apo nuk do ta shqyrtonin atë, parashtruesi i kërkesës do t'i kishte plotësuar kushtet e pranueshmerisë për shterimin e mjeteve, në kuptimin që këtyre gjykatave u është ofruar mundësia e korrigjimit të shkeljes së pretenduar.

49. Ne fakt, kjo analizë është në përputhshmëri me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane, e cila parasheh që parashtruesit vetëm duhet shteruar mjetet vendore që i kanë në dispozicion në teori dhe në praktikë në kohën përkatëse, që do të thotë se janë të arritshme, në gjendje të sigurojnë zgjidhje lidhur me ankesat e tyre dhe të ofrojnë mundësi të arsyeshme për sukses (*Shih, Sejdovic kundër Italisë [GCl, nr. 56581/00, KEDNJ 2006-IJ § 46)*. Duhet vlerësuar, në të gjitha rrethanat e rastit, nëse parashtruesi i kërkesës ka bërë gjithçka që me arsye pritet prej tij ose prej saj për të shteruar mjetet vendore *(Shih, D.H. dhe te tjerët kundër Republikës Çeke [GCl, §§ 11622)*.

50. Gjykata Kushtetuese gjithashtu aplikoi arsyetimin e njëjtë kur nxori Aktvendimet për Papranushmëri në bazë të mos-shterjes së mjeteve, më 4 dhjetor 2012, në Rastin nr. KI 120/11, Ministria e Shëndetësisë - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme A.nr. 551; më 27 janar 2010 në Rastin Nr. KI 49/09, Universiteti AAB RIINVEST SH.P.K. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe më 23 mars 2010, në Vendimin e saj në Rastin Nr. 73/09, Mimoza Kusari Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor.

51. Parimisht dhe në fakt, parashtruesi i kërkesës nuk mund të ankohet drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të pretenduar të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore pa e ngritur një shkelje të tillë të pretenduar në mënyrë implicite apo në substancë pranë Gjykatë së Qarkut dhe Gjykatës Supreme..

52. Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese konsideron se faktet e rastit nuk lejojnë një konkludim bindës se bazat e ankesës "*shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, shkelje e ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal* " të pretenduara pranë Gjykatës Supreme e kalojnë testin e Gjykatës Evropiane. Rrjedhimisht, nuk ka nevojë që të shqyrtohet çështja në këto rrethana të rastit.

53. Për më tepër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka argumentuar dhe mbështetur me prova shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij nga Gjykata Supreme.

54. Në fakt, pretendimi i parashtruesit për shkeljen e të drejtave kushtetuese nuk paraqet bazë të mjaftueshme *prima facie* për ngritjen e rastit në Gjykatë; pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me vendimin e Gjykatës Supreme nuk mund të jetë bazë kushtetuese për t'u ankuar pranë Gjykatës Kushtetuese.

55. Për më tepër, Gjykata vëren se, për të pasur një rast *prima facie* që përmbush kriteret e pranueshmërisë së kërkesës, parashtruesi duhet të dëshmojë se procedurat në Gjykatën Supreme, shikuar në tërësinë e tyre, nuk janë zbatuar në mënyrë të tillë që parashtruesi të ketë pasur një gjykim të drejtë, apo që shkeljet e tjera të së drejtave kushtetuese mund të jenë kryer nga ana e Gjykatës Supreme gjatë procesit të gjykimit.

56. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1.c) të Rregullores së punës, e cila përcakton: *"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) Kërkesa është qartazi e bazuar"*.

57. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të trajtojë gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përderisa ato nuk i shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

58. Andaj, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së tretë, në rastin konkret, kur shqyrton vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe të së drejtës materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz vs. Spain [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

59. Për më tepër, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme, kur ka vendosur për kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë, nuk ka dhënë arsye të qarta përkitazi me refuzimin e kërkesës së parashtruar dhe i njëjti, po ashtu, ankohet se Gjykata Supreme nuk ka qenë e përkushtuar ta trajtojë rastin në mënyrën e duhur.

60. Sidoqoftë, parashtruesi nuk shpjegon pse dhe si janë shkelur të drejtat e tij, ai nuk e mbështetë pretendimin *prima facie* mbi baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga Gjykata Supreme dhe se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ.

61. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis,* Shub vs. Lithuania, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

62. Në fakt, parashtruesi nuk ka provuar *prima facie* pse dhe si i ka shkelur Gjykata Supreme të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës, si dhe shkelje të nenit 6 në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.

63. Prandaj, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës as nuk ka ndërtuar e as nuk ka dëshmuar një rast *prima facie,* qoftë mbi bazën meritave apo pranueshmërisë së kërkesës.

64. Në tërësi, Gjykata konstaton se kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar.

65. Gjykata më tutje konstaton se pasi që kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, kërkesa për masë të përkohshme nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit prandaj dhe duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 116 (2) të Kushtetutës; në bazë të nenit 27 dhe nenit 48 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.1 (c), me rregullin 55 dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores, më 29 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve; dhe

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 15/12, Xhavit Gashi, datë 25 shkurt 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. I. Nr. 314/2009 i 10 janarit 2012.

KI15/12, Aktvendim për papranueshmëri i datës 29 janar 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar, e drejta e punës

Parashtruesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për ta detyruar Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që ta kthej atë ne vendin e tij të mëparshëm të punës, ose në detyra që i përgjigjen përgatitjes së tij profesionale, si dhe kompensimin e të ardhurave personale.

Parashtruesi nga Gjykata Kushtetuese po ashtu kërkon që të hidhen poshtë të gjitha aktgjykimet e lartcekura, sepse sipas parashtruesit të kërkesës në rastin e tij nuk është respektuar drejtësia.

Parashtruesi në kërkesën e tij nuk thekson se cili nen i Kushtetutës është shkelur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe gjykatave tjera të rregullta.

Gjykata Kushtetuese gjen se kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar për arsye se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr.KI-15/12
Parashtruesi
Xhavit Gashi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.I.Nr.314, të 10 janarit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa ishte paraqitur nga Xhavit Gashi, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës Supreme, Rev. I. Nr. 314/2009 të 10 janarit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes ka të bëj me kërkesën e parashtruesit për të detyruar Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale që parashtruesin ta kthejë në punën tij të mëparshme, ose në detyra të punës që i përgjigjen përgatitjes profesionale, si dhe kompensimin e të ardhurave personale.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 21.4 dhe në nenin 113.7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedurat në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 shkurt 2012, Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Me vendimin e Kryetarit për caktimin e Gjyqtarit Raportues me Nr. GJR. KI 15/12 të datës 21 shkurt 2012, Gjyqtarja Gjyljeta Mushkolaj është caktuar Gjyqtare Raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit për caktimin e kolegjit shqyrtues me Nr. KSH. 15/12, është caktuar Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Iliriana Islami.

7. Me Vendimin e Kryetarit për zëvendësimin e Gjyqtarit raportues me Nr. GJR. KI 15/12 të datës 2 korrik 2012, Gjyqtari Kadri Kryeziu është caktuar Gjyqtar Raportues. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit për zëvendësimin e gjyqtarit në kolegj shqyrtues me Nr. KSH. 15/12, është caktuar Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

8. Më 10 dhjetor 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës lidhur me regjistrimin e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. *Parashtruesi, sipas shkresave të bashkëngjitura në kërkesën e tij, ka qenë në marrëdhënie pune si vozitës në ish-Fondin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Punësuarve në Prishtinë, duke vazhduar marrëdhënien e punës deri me 1 tetor 2000.*

10. *Si rezultat i procesit të themelimit të Departamentit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr, 2000/10), më 25 shator 2000 shpallen konkurse për pranimin e personelit. Pas aplikimit dhe zhvillimit të procedurave të konkursit, parashtruesi nuk pranohet në pozitën, për të cilën kishte konkurruar.*

11. *Më 24 mars 2003, parashtruesi i kërkesë ka ushtruar padi kundër Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar kthimin në punën e tij të mëparshme si "vozitës", ose në tjetër punë apo detyra të punës që janë në përputhje me përgatitjen e tij profesionale, si dhe kompensimin e të ardhurave.*

12. *Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin e saj Cl. Nr. 85/2003 të 23 shtatorit 2004 refuzon kërkesëpadinë e parashtruesit, duke vlerësuar se as Departamenti Shëndetësisë dhe i Mirëqenies Sociale dhe as Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale nuk kanë vazhdimësinë dhe se nuk janë trashëgimtar të Fondit të atëhershëm për Sigurimin Pensional dhe Invalidor dhe si rezultat i kësaj Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale nuk mund të detyrohet për kthimin e parashtruesit në punë.*

13. Parashtruesi i kërkesës ka ushtruar ankesë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin e saj AC. Nr. 415/05 të 19 shkurtit 2007 ka vlerësuar se " *gjykata e shkallës së parë në gjendjen e vërtetuar faktike në mënyrë të drejtë ka aplikuar dispozitat materiale, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.*"

14. Parashtruesi i kërkesë po ashtu ka paraqitur revizion ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata Supreme me aktgjykimin e saj Rev. I. Nr. 314/2009 të datës 10 janar 2012 ka refuzuar si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës duke konsideruar [...]" *si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave të instancës më të ulët sipas të cilit është refuzuar kërkesëpadia e paditësit, pasi që nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar se as Departamenti i Administrativ i Punës dhe Punësimit të themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/24 si dhe Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, përfshirë si i paditur në këtë kontest nuk janë trashëgimtar të Fondit të atëhershëm për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Punësuarve të Kosovës, punëtor i së cilës ka qenë paditësi. Paditësi me të padituri nuk ka themeluar marrëdhënie pune dhe se i padituri nuk ka detyrim ndaj paditësit dhe të njëjtit i mungon legjitimiteti pasiv në procedurë.*"

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se cili nen i Kushtetutës është shkelur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe gjykatave tjera të rregullta.

16. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesën që [...] " *të vendosë në favor tim sepse ndaj meje Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka bërë padrejtësi duke më larguar nga puna pa kurrfarë mbështetje ligjore.*"

17. Parashtruesi nga Gjykata Kushtetuese po ashtu kërkon që të hidhen poshtë të gjitha aktgjykimet e lartcekura, sepse sipas parashtruesit të kërkesës në rastin e tij nuk është respektuar drejtësia.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës

19. Neni 48 i Ligjit Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Kosovës parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.“

20. Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se cila e drejtë i është shkelur dhe cili nen i Kushtetutës mbështetë kërkesën e tij, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

21. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, ku shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta, përveç nëse dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis,* Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para.28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

22. Parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (Shih, *mutatis mutandis,* Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99 të 31 majit 2005).

23. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që ta paraqesë rastin e tij pranë gjykatave të rregullta. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat e duhura, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (Shih, *mutatis mutandis,* Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

24. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36.2 (b) të Rregullores së punës që parasheh *"Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse:* b) *faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese"*.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 48 të Ligjit dhe në përputhshmëri me rregullin 36. 2 (b) të Rregullores, më 17 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 21/12, Bedri Selmani, datë 25 shkurt 2013 -Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, SCC-06-0144 të 30 marsit 2009 dhe Aktgjykimit të Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, ASC-09-2006, të 13 tetorit 2011

KI 21/12, Aktvendim për papranueshmëri i datës 29 janar 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar, privatizimi

Në kërkesën e tij, parashtruesi kërkon si në vijim: 1. Të drejtat e tij pronësore mbi fondet që i kishte investuar për renovimin e *"Autoservisit"* në shumën e përgjithshme 1,356,882.00 €; 2. Të drejtat e tij pronësore mbi fondet e investuara në hotelin dhe restorantin *"Victory",* në shumën e përgjithshme 1,527,832.00 €; 3. Të drejtën e përdorimit të parcelës së tokës urbane në të cilën *"Autoservisi"* dhe hoteli e restoranti *"Victory"* janë ndërtuar; 4. E drejta e parablerjës së tokës shoqërore ku janë ndërtuar objektet e *"Autoservisit"* dhe hotelit e restorantit *"Victory"* me rastin e privatizimit.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, përkatësisht Trupi Gjykues dhe Kolegji për Ankesa i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, gjegjësisht nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] paragrafi 1 dhe 2, dhe nenin 121 [Prona], paragrafi 1 të kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesa është qartazi e pabazuar për arsye se parashtruesi nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI21/12
Parashtruesi
Bedri Selmani
Vlerësim
i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, SCC-06-0144 të 30 marsit 2009 dhe Aktgjykimit të Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, ASC-09-2006, të 13 tetorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Bedri Selmani nga Prishtina

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston aktgjykimin e Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: Trupi Gjykues), SCC-06-0144 i 30 marsit 2009, dhe Aktgjykimin e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Ankesave), ASC-09-0006 i 12 tetorit 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon që aktgjykimet e sipërpërmendura i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin

119 [Parimet e Përgjithshme] paragrafi 1 dhe 2, dhe nenin 121 [Prona], paragrafi 1 të kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121) (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedurat në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 mars 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 5 mars 2012, Kryetari e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Gjyljeta Mushkolaj.

7. Më 4 dhjetor 2012, Kryetari nënshkroi Vendimin për zëvendësimin e gjyqtarëve në Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Surroy dhe Ivan Čukalović.

8. Më 10 dhjetor 2012, kërkesa iu komunikua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 5 prill 2000, parashtruesi i kërkesës i cili pohon se është themelues, pronar dhe drejtor i kompanisë private "Autokosova" kishte lidhur Marrëveshje me Ndërmarrjen Shoqërore "Autoprishtina" në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Marrëveshja). Ndërmarrja Shoqërore është trashëgimtare e ndërmarrjes Organizata Punuese Auto Salloni "Boško Cakić" e themeluar në dhjetor 1989. Parashtruesi pretendon se sipas Marrëveshjes, ai kishte bërë "renovimin dhe rehabilitimin" e një ndërtese në pronësi të Ndërmarrjes Shoqërore "Autoprishtina". Marrëveshja për partneritet u regjistrua në Regjistrin Afarist të UNMIK-ut më 15 dhjetor 2000.

10. Më 10 nëntor 2000, Bordi Mbikëqyrës i Ndërmarrjes Shoqërore "Autoprishtina" në mënyrë të njëanshme ndërpreu bashkëpunimin me parashtruesin e kërkesës. Edhe pse Ndërmarrja Shoqërore pretendonte se Marrëveshja 2000 ishte ndërprerë, punëtorët e ndërmarrjes shoqërore kishin punuar për Autoprishtina-Autokosova ose për ndonjë

subjekt tjetër në pronësi të parashtruesit të kërkesës deri në tetor 2003. Në tetor 2003, punëtorët e ndërprenë punën në Autoprishtinë-Autokosovë dhe filluan të operojnë në biznesin me auto-shërbim dhe pjesë rezervë, në mënyrë të pavarur nga Autoprishtina-Autokosova apo ndonjë subjekt tjetër i lidhur me parashtruesin e kërkesës.

11. Më 3 prill 2006, parashtruesi i kërkesës inicioi kontest në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit. Në padinë e tij fillestare, parashtruesi kishte kërkuar vendim –ndalim të përkohshëm. Kjo kërkesë ishte tërhequr nga parashtruesi në seancën gojore më 13 dhjetor 2006.

12. Më 18 janar 2007, parashtruesi parashtroi një kërkesë, duke kërkuar që hoteli dhe restoranti "Victory" të bashkohen si Paditës në procedurë. Dhoma e Posaçme lëshoi një urdhër për bashkimin e hotelit dhe restorantit "VICTORY" si Paditësi i Dytë në procedurë. Disa ndryshime tjera i ishin bërë padisë, ndryshimi i fundit ishte ai i shkurtit 2007. Parashtruesi i kërkesës në padinë e tij kërkoi si në vijim: shumën €1,219,446.22 t'i paguhet Autoprishtinës-Autokosovës në mënyrë që t'i njihet e drejta e pronësisë në fondet e investuara në objektin shoqëror "Autoservis"; shumën €1,036,994.32 t'i paguhet hotelit dhe restorantit "Victory" në mënyrë që t'i njihet e drejta e pronësisë në fondet e investuara në ndërtimin e objektit të hotelit privat; njohjen e së drejtës së Autoprishtinës-Autokosova në përdorimin e tokës ku gjendet "Autoservisi"; njohjen e së drejtës së hotelit dhe restorantit "Victory" në përdorimin e tokës ku gjendet hoteli "Victory"; shpallja e së drejtës së prioritetit të Autoprishtinës-Autokosovës për blerjen e objektit në pronësi shoqërore dhe tokës ku gjendet "Autoservisi" dhe deklaratën e së drejtës së prioritetit të hotelit dhe restorantit "Victory" për të blerë tokën në pronësi shoqërore ku gjendet hoteli "Victory".

13. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM-ja) ushtroi mbrojtje dhe kundërpadi në emrin e vet dhe në emër të Ndërmarrjes Shoqërore.

14. Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme në Aktgjykimin e saj SCC-06-0144 të 30 marsit 2009 refuzoi padinë kundër Ndërmarrjes Shoqërore "Autoprishtina" si të pabazuar, refuzoi kërkesën për vendim-ndalim të përkohshëm kundër AKM-së si të tërhequr dhe e refuzoi kundërpadinë e AKM-së si të papranueshme.

15. Më 15 maj 2009, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Trupit Gjykues, SCC-06-0144, të 30 marsit 2009. Ankesa

bazohet në bazat e shkeljeve thelbësore të Ligjit për Procedurën Kontestimore, në verifikimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe në aplikimin e gabueshëm të së drejtës materiale.

16. Më 18 nëntor 2009, AKM-ja në emër të vet dhe në emër të Ndërmarrjes Shoqërore Autoprishtina paraqiti përgjigje në ankesë, në të cilën pohonte se argumentet e Ankuesve janë pa kurrfarë baze ligjore, duke kërkuar se ankesa duhet të refuzohet dhe Aktgjykimi i Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme duhet të vërtetohet.

17. Më 13 tetor 2011, Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme në Aktgjykimin ASC-09-0006 e refuzoi ankesën si të pabazuar, vendosi të vërtetojë Aktgjykimin e Trupit Gjykues të 30 marsit 2009 dhe e ndryshoi aktgjykimin e Trupit Gjykues duke shtuar fjalinë vijuese: "padia e hotelit dhe restorantit "Victory" është refuzuar si e pabazuar".

18. Më 17 tetor 2011, Aktgjykimi i Kolegjit të Ankesave iu dorëzua parashtruesit të kërkesës.

19. Më 30 janar 2012, parashtruesi paraqiti kërkesë Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë të Aktgjykimit të Kolegjit për Ankesa.

20. Më 2 shkurt 2012, Prokurori i Shtetit në një Njoftimin Nr. 6/2012 "nuk gjeti asnjë bazë ligjore për parashtrimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Siç theksohet më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, se Trupi Gjykues dhe Kolegji për Ankesa i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] paragrafi 1 dhe 2, dhe nenin 121 [Prona], paragrafi 1 të kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës.

22. Në kërkesën e tij, parashtruesi kërkon si në vijim: 1. Të drejtat e tij pronësore mbi fondet që i kishte investuar për renovimin e "Autoservisit" në shumën e përgjithshme €1,356,882.00; 2. Të drejtat e tij pronësore mbi fondet e investuara në hotelin dhe restorantin "Victory", në shumën e përgjithshme €1,527,832.00; 3. Të drejtën e përdorimit të parcelës së tokës urbane në të cilën "Autoservisi" dhe hoteli e restoranti "Victory" janë ndërtuar; 4. E drejta e parablerjës së

tokës shoqërore ku janë ndërtuar objektet e "Autoservisit" dhe hotelit e restorantit "Victory" me rastin e privatizimit.

23. Parashtruesi e përfundon padinë e tij, duke pretenduar se "*Ky veprim i Dhomës se Posaçme të Gjykatës Supreme te Kosovës për çështje qe lidhen me Agjencinë Kosovare te Mirëbesimit, që u realizua duke shkelur ne mënyrë flagrante edhe dispozitat e procedurës civile (të përcaktuara me Ligjin mbi Procedurën Kontestimore), bie drejtpërdrejtë ndesh me dispozitat e Ligjit për Investimet e Huaja dhe me dispozitat e vete Kushtetutës së Republikës së Kosovës, më saktësisht -me nenin 119, paragrafi 2, lidhur me paragrafin 1 te këtij neni (nenit 119) dhe nenin 121, paragrafi 1.*"

Pranueshmëria e kërkesës

24. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Gjykata, së pari duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 te Kushtetutës të parashtrojë kërkesë në Gjykatë. Në këtë kërkesë, gjykata vëren se parashtruesi, është person fizik dhe është palë e autorizuar në përputhje me kërkesat e nenit 113.7 (Kërkesat Individuale) të Kushtetutës.

26. Gjykata, po ashtu, duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kërkesat e nenit 113 (7) të Kushtetutës dhe nenit 47 (2) të Ligjit.

    Neni 113, paragrafi 7 parasheh:

    "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

    Parashtruesi i kërkesës ka dëshmuar se ai i ka shterur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion sipas ligjit të aplikueshëm.

27. Parashtruesi gjithashtu duhet të dëshmojë se ai i ka plotësuar kërkesat e nenit 49 të Ligjit në lidhje me parashtrimin e kërkesës brenda afatit ligjor. Nga dosja e lëndës mund të shihet se më 30 janar 2012, parashtruesi e kishte paraqitur kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të

Aktgjykimit të Kolegjit për ankesa te Prokurori i shtetit, derisa parashtruesi e paraqiti kërkesën në Gjykatë më 2 mars 2012, që nënkupton se kërkesa ishte dorëzuar brenda afatit katër mujor, të paraparë në Ligj dhe Rregullore të punës.

28. Në këtë kërkesë, parashtruesit i janë ofruar mundësi të shumta ta paraqes rastin e tij në gjykatat e rregullta. Ndërkohë, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e shkallës se katërt kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

29. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara ne tërësinë e tyre, janë paraqitur, respektivisht mbajtur në mënyrë te tillë ashtu qe parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *mutatis mutandis*, Raporti i Komisionit Evropian për te Drejtat e Njeriut ne rastin Edwards kundër Mbretërisë se Bashkuar, kërkesa Nr. 13071/87, e datës 10 korrik 1991).

30. Në të vërtetë, parashtruesi nuk e ka mbështetur kërkesën në baza kushtetuese dhe nuk ka dëshmuar që të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga gjykatat e rregullta (Shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-se për Pranueshmëri të kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009)·

31. Rregulli 36.2 (d) i Rregullores se punës parasheh që "*Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi te pabazuar nëse bindet se (...) parashtruesi nuk dëshmon ne mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij*".

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe në përputhshmëri me rregullin 36. 2 (b) dhe (d) të Rregullores së Punës, më 17 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 44/11, Rufki Suma, datë 25 shkurt 2013 –Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të 14 dhjetorit 2010, për shitjen e Ndërmarrjes shoqërore "Sharr Cem"

Lënda KI 44/11, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 dhjetorit 2012

Fjalët kyçe: locus standi, dinjiteti i njeriut, shkelje të të drejtave dhe lirive individuale, shkelja e së drejtës për konkurrencë të lirë

Parashtruesi parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.4 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), me të cilin Ndërmarrja shoqërore "Sharr Cem" u privatizua më 14 dhjetor 2010. Parashtruesi i kërkesës pohon se privatizimi i "Sharr Cem"-it ishte bërë në kundërshtim me urdhëresat e AKP-së për rregullat e përgjithshme të tenderit për privatizim (spin-off i zakonshëm) dhe për rregullat e përgjithshme të tenderit për likuidim; në kundërshtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Nr. 03/L-067); në kundërshtim me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës; dhe në kundërshtim me nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, pasi privatizimi ka ndodhur pa lajmërim publik të tij nga ana e AKP-së.

Në lidhje me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata vlerësoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse pretendimet e parashtruesit se ka pasur shkelje sipas nenit 113.4, në rastin konkret, është në kundërshtim me Kushtetutën, sepse kompetencat e Komunës, sipas nenit të lartpërmendur, për të parashtruar një kërkesë në këtë gjykatë, janë të kufizuara në këto çështje: ligjet ose aktet e Qeverisë që cenojnë përgjegjësitë komunale ose që i zvogëlojnë të hyrat e Komunës, që ndryshe përcaktohen me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe me Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI44/11
Parashtrues
Rufki Suma
Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të datës 14 dhjetor 2010, për shitjen e Ndërmarrjes Shoqërore "Sharr Cem"

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Rufki Suma, kryetar i Komunës së Hani të Elezit, të cilin e përfaqëson z. Bajrush Laçi, shef i Departamentit Ligjor të Komunës së Hani të Elezit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston vendimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), me të cilin Ndërmarrja Shoqërore "Sharr Cem" u privatizua më 14 dhjetor 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 30 mars 2011, duke pretenduar se i janë cenuar të drejtat e garantuara me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe me nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës; neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121, i datës 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 30 mars 2011, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 19 prill 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 44/11, emëroi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 44/11, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.

7. Më 25 maj 2011, Gjykata kërkoi sqarime dhe dokumente shtesë për ato që kanë të bëjnë me:

   a. Cila është baza juridike e kërkesës;
   b. Cili është vendimi i kontestuar;
   c. Prova se janë shterur mjetet juridike dhe prova për privatizimin e "Sharr Cem"-it; dhe
   d. Autorizimin.

8. Më 2 qershor 2011, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi sqarimet dhe dokumentet shtesë:

   a. Kërkesa është ngritur në bazë të nenit 113.4 të Kushtetutës;

   b. Vendim i kontestuar është vendimi i AKP-së për privatizimin e "Sharr Cem"-it;

   c. Parashtruesi i kërkesës, më 8 prill 2011, ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme përkitazi me privatizimin e "Sharr Cem"-it; dhe

   d. Autorizimi po ashtu është dorëzuar.

9. Më 15 qershor 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe AKP-së.

10. Më 2 korrik 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 44/11, zëvendësoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues: gjyqtarët Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami, me gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues) dhe Enver Hasani, pasi mandati i gjyqtareve Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami, si gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, ka skaduar më 26 qershor 2012.

11. Më 5 dhjetor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 14 dhjetor 2010, "Sharr Cem" u privatizua nga AKP-ja.

13. Më 15 dhjetor 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në AKP për pezullimin e privatizimit të "Sharr Cem"-it. Parashtruesi i kërkesës nuk mori asnjë përgjigje në këtë kërkesë.

14. Më 27 janar 2011, Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit mori vendim për të ushtruar padi kundër AKP-së për shkak të privatizimit të "Sharr Cem"-it pa i respektuar procedurat ligjore dhe pa e reklamuar fare tenderin për privatizim (Vendimi Nr. 01/15-2011).

15. Më 8 prill 2011, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke pretenduar se privatizimi i "Sharr Cem"-it ishte bërë pa e lajmëruar publikisht privatizimin.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pohon se privatizimi i "Sharr Cem"-it ishte bërë në kundërshtim me urdhëresat e AKP-së për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit për Privatizim (spin-off i zakonshëm) dhe për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit për Likuidim; në kundërshtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Nr. 03/L-067); në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës; dhe në kundërshtim me nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, pasi privatizimi ka ndodhur pa lajmërimin publik të tij nga ana e AKP-së. Prandaj, pretendohet se me këtë veprim të AKP-së është kufizuar e drejta për konkurrencë të lirë, duke përjashtuar ofertuesit e tjerë dhe duke e shitur këtë ndërmarrje me "çmim simbolik" – 30.1 milionë euro.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës ankohet se privatizimi i "Sharr Cem"-it është bërë pa e lajmëruar publikisht privatizimin e tij dhe kësisoj i janë cenuar të drejtat e tij të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], me nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe me nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës.

18. Megjithatë, për të qenë kërkesa e pranueshme, parashtruesi i kërkesës së pari duhet të provojë se i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

19. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën në bazë të nenit 113.4 të Kushtetutës, i cili parasheh:

> "Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt".

20. Në këtë drejtim, pretendimet e parashtruesit se ka pasur shkelje sipas nenit 113.4, në rastin konkret, është në kundërshtim me Kushtetutën, sepse kompetencat e Komunës, sipas nenit të lartpërmendur, për të parashtruar një kërkesë në këtë Gjykatë, janë të kufizuara në këto çështje: Ligjet ose aktet e Qeverisë që cenojnë përgjegjësitë komunale ose që zvogëlojnë të hyrat e Komunës, që ndryshe përcaktohen me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe me Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale.

21. Në këto rrethana, parashtruesit i mungon *locus standi* për të referuar këtë rast në Gjykatë. Prandaj, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.4 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, si dhe në pajtim me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 5 dhjetor 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 69/12, Lidhja e Invalidëve Civil të Luftës së Dytë Botërore, datë 25 shkurt 2013 -Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, KRJA nr. 6/2011, i 8 majit 2012

KI 69/12, Aktvendim për papranueshmëri i datës 6 shkurt 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar, lidhja e Invalidëve të Luftës së Dytë Botërore.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës KRJA nr. 6/2011, i 8 majit 2012 ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 3, paragrafin 2, nenin 22 dhe nenin 24 të Kushtetutës.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës dhe të anëtarëve të familjeve të tyre të garantuara me Ligjin për mbrojtjen e Invalidëve Civilë të Luftës së Dytë Botërore. Sipas parashtruesit të kërkesës, ky Ligj vazhdon të jetë në fuqi. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës i referohet dispozitave të Rregullores së UNMIK -ut nr. 1999/24 për Ligjin në fuqi në Kosovë, i cili përcakton se *"Ligji i aplikueshëm në Kosovë [...] do të jetë ligji në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989."*

Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se Ligji për Pensionet e Aftësisë së Kufizuar nuk përfshin këtë kategori të personave, të cilit janë të përfshirë në Ligjin e vitit 1976 dhe për këtë arsye *"Ligji i vitit 1976 është ende në fuqi dhe si i tillë duhet të zbatohet edhe më tej."*

Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkesa është qartazi e pabazuar për arsye se parashtruesi nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI 69/12
Parashtruesi
Lidhja e Invalidëve Civile të Luftës së Dytë Botërore
Vlerësim i kushtetutshmërisë
të Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës KRJA, nr. 6/2011 të 8 majit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Lidhja e Invalidëve Civile të Luftës së Dytë Botërore.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme KRJA, nr. 6/2011 të 8 majit 2012, dorëzuar parashtruesit të kërkesës me datë 18 maj 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon së Vendimi i lartpërmendur ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 3, paragrafi 2 [Barazia para Ligjit], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare] dhe nenin 24 [Barazia para Ligjit].

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenet 113.7 dhe 21.4 te Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedurat në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 korrik 2012, parashtruesi paraqiti kërkesën në Gjykatë.

6. Më 4 shtator 2012, Kryetari emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Surroy dhe Ivan Čukalović.

7. Më 10 dhjetor 2012, kërkesa i është komunikuar Gjykatës Supreme.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesi i kërkesës, përkatësisht Lidhja e Invalidëve Civil të Lutës së Dytë Botërore, është regjistruar në bazë të Rregullores së UNMIK- ut 1999/22 si një OJQ me status të përfituesit publik më 6 mars 2000.

9. Invalidët e luftës civile kanë gëzuar të drejta dhe mbrojtje sipas dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e Invalidëve Civil të Luftës (të botuar në Gazetën Zyrtare të Kosovës nr. 32), dhe i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 26 korrik 1976 (në tekstin e mëtejme: Ligji i 1976).

10. Me rastin e shpalljes së Rregullores së UNMIK –ut 2000/66 mbi përfitimet për invalidët e luftës të Kosovës dhe për të afërmit e atyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë [UNMIK/REG/2000/66], kjo kategori e invalidëve nuk ishte përfshirë.

11. Pasi që Aktgjykimi i Gjykatës Komunale të Prishtinës, C. nr. 595/05, i 7 marsit 2006, e kishte refuzuar padinë e parashtruesit të kërkesës dhe duke shpallur veten si jokompetent, duke arsyetuar se në këtë rast procedurat e aplikueshme administrative duhet të ndiqen, më 3 maj 2006, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Qendra për Punë Sociale në Podujevë (Kërkesa nr. 33422, të 3 majit 2006), përcaktimin e diskriminimit, kompensimin për shkak të diskriminimit dhe njohjen e të drejtës për mbrojtje dhe kujdes në të ardhmen, përkatësisht trajtim të barabartë me kategoritë e invalidëve të tjerë të luftës. Qendra nuk ishte përgjigjur në kërkesën e parashtruesit të kërkesës.

12. Më 17 tetor 2006, parashtruesi i kërkesës paraqiti një padi në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke kërkuar përcaktimin e diskriminimit dhe shumën e kompensimit financiar të dëmit të shkaktuar për shkak të diskriminimit dhe njohjen e të drejtës për mbrojtjen dhe kujdesin në të ardhmen të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht trajtimin e barabartë me kategoritë tjera të invalidëve të luftës.

13. Më 31 mars 2009, Gjykata Supreme e Kosovës në Aktvendimin e saj A. nr. 2630/2006 e refuzoi padinë si të pabazuar për shkak të mungesës së kornizës ligjore që e mbështetë parashtruesin e kërkesës.

14. Më 30 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti një kërkesë për rishikimin e Aktvendimit të Gjykatës Supreme A. nr. 2630/2006, duke pretenduar se Invalidët Civilë të Luftës së Dytë Botërore janë të diskriminuar pasi që Ligji për Invalidët Civilë të Luftës të 1976 nuk ishte duke u zbatuar ndaj tyre dhe më tej duke propozuar që të njihen të drejtat e tyre, si invalidë të Luftës së Dytë Botërorë, të cilat ata pretendojnë se i kanë sipas Ligjit kundër Diskriminimit nr. 2004/3.

15. Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin e saj KRJA nr. 6/2011, të 31 marsit 2009, e refuzoi kërkesën si të papranueshme, duke arsyetuar që Ligji i 1976 nuk është në fuqi dhe duke pasur parasysh mungesën e një ligji të veçantë për këtë kategori të invalidëve, kërkesa e tyre nuk mund të aprovohet.

16. Gjykata Supreme në Aktvendimin e saj KRJA nr. 6/2011 më tej pretendon se ”edhe Invalidët Civilë të Luftës se dytë botërore, gëzojnë të drejtat në mbrojtje financiare sipas kushteve dhe kritereve të parapara me Ligjin për pensionet për persona me aftësi të kufizuara (Ligji nr. 2003/23 - Rregullorja e UNMIK-ut nr 2003/40), kështu që nuk mund të thuhet se atyre iu është cenuar ndonjë e drejtë në ketë drejtim”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Siç theksohet më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës KRJA nr. 6/2011, i 8 majit 2012 ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 3, paragrafin 2, nenin 22 dhe nenin 24 të Kushtetutës.

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës dhe të anëtarëve të familjeve të tyre të garantuara me Ligjin për mbrojtjen e Invalidëve Civilë të Luftës. Sipas parashtruesit të kërkesës, ky Ligj vazhdon të jetë në fuqi. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës i referohet dispozitave të Rregullores së

UNMIK -ut nr. 1999/24 për Ligjin në fuqi në Kosovë, i cili përcakton se "Ligji i aplikueshëm në Kosovë [...] do të jetë ligji në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989."

19. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se Ligji për Pensionet e Aftësisë së Kufizuar nuk përfshin këtë kategori të personave, të cilit janë të përfshirë në Ligjin e vitit 1976 dhe për këtë arsye "Ligji i vitit 1976 është ende në fuqi dhe si i tillë duhet të zbatohet edhe më tej."

20. Parashtruesi i kërkesës konsideron se ka pasur shkelje të vazhdueshme kundër kategorisë së Invalidëve Civilë të Luftës se Dytë Botërore siç përshkruhet në dispozitat e Ligjit kundër diskriminimit nr. 2003/4.

21. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të përcaktojë se ka pasur shkelje të nenit 3, paragrafi 2, nenit 22 dhe 24, si dhe të anulojë Aktvendimin e Gjykatës Supreme KRJA nr. 6/2011 të 8 majit 2012, dhe Aktvendimin A. nr. 2630/2006 të 31 marsit 2009.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Para së gjithash, në mënyrë që të jetë në gjendje për të gjykuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës ka plotësuar të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të cilat janë të parapara me Kushtetutë dhe specifikohen më tej me Ligjin dhe me Rregulloren e punës.

23. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të parashtruar një kërkesë në Gjykatë, në përputhje me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës. Sa i përket kërkesës në fjalë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është person juridik. Neni 21 (4) i Kushtetutës siguron që

"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."

Parashtruesi i kërkesës, pra, ka të drejtë të paraqesë një ankesë kushtetuese (Shih, Aktvendimin në rastin nr. KI 41/09, AAB – Universiteti Riinvest SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, paragrafi 14).

24. Gjykata gjithashtu duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kërkesat e nenit 113 (7) të Kushtetutës dhe nenit 47 (2) të këtij ligji.

Neni 113, paragrafi 7 parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Vendimi përfundimtar mbi rastin e parashtruesit të kërkesës është Aktvendimi i Gjykatës Supreme KRJA, nr. 6/2011 të 8 majit 2012. Si rezultat, parashtruesi i kërkesës ka treguar se ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjeve në fuqi.

25. Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se i ka plotësuar kërkesat e nenit 49 të Ligjit në lidhje me dorëzimin e kërkesës brenda afatit ligjor. Kjo mund të shihet nga shkresat e lëndës se vendimi i fundit për rastin e parashtruesit është Aktvendimi i Gjykatës Supreme KRJA, nr. 6/2011 të 8 majit 2012, ndërsa parashtruesi ka paraqitur kërkesën në Gjykatë më 13 korrik 2012, që do të thotë se kërkesa është paraqitur brenda afatit katër mujor të përcaktuar me Ligj dhe me Rregulloren e punës.

26. Ndërkohë, Gjykata thekson se, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur i merr parasysh vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjit procedural dhe material (Shih, *mutatis mutandis,* Greqia kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtave e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

27. Gjykata mund të shqyrtojë vetëm nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës ka pasur një gjykim të drejtë (Shih, midis autoriteteve të tjera Raportin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. nr. 13071/87, të aprovuar më 10 korrik 1991).

28. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur padinë mbi baza kushtetuese dhe nuk ka dhënë dëshmi se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga gjykatat e rregullta (Shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ mbi pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06 të 30 qershor 2009).

29. Rregulli 36.2 (d) të Rregullores parasheh se "*Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se (...) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*"

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe në përputhshmëri me rregullin 36. 2 (b) dhe (d) të Rregullores së Punës, më 17 janar 2013, me shumicë votash

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 157/11, Bashkimi i Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës i Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Azem Ejupi, avokat, datë 25 shkurt 2013 - Kërkesë për rregullimin e statusit të pensionistëve dhe të invalidëve të punës dhe përmirësimin e mirëqenies së pensionistëve të Republikës së Kosovës nga autoritetet shtetërore

Rasti KI157/11, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, person juridik, rregulli i statusit pensional, pale e paautorizuar

Në ketë rast, parashtruesi i kërkesës pretendonte se, duke mohuar dhe duke hequr të drejtat e fituara në bazë të Ligjit mbi Sigurimin Pensional dhe lnvalidor, pensionistëve kontributpagues u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 22, me nenin 23, me nenin 51 (paragrafi 1) të Kushtetutës, me nenin 17 (paragrafi 2) të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, me nenin 26 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe me protokollet e tij, dhe me nenin 9 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Gjykata, ne rastin konkret kishte analizuar dhe ka vlerësuar me kujdes kërkesat e parashtruesit dhe gjeti se, parashtruesi i kërkesës, si person juridik në rastin konkret, nuk mund të konsiderohej palë e autorizuar që të mund të referonte çështje kushtetuese *in abstracto* përkitazi me rregullimin e statusit të pensionistëve dhe të invalidëve të punës, si dhe përkitazi me përmirësimin e mirëqenies sociale të tyre, duke u bazuar në kontributet pensionale të paguara gjatë viteve. Përkitazi me këtë, Gjykata theksoi se, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk parasheh *actio popularis,* që është modalitet i ankesave individuale, çfarë i mundëson çdo individi, që tenton të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me pyetje dhe me kërkesa të caktuara, duke aluduar për shkelje të të drejtave kushtetuese të një individi a të një grupi të caktuar.

Prandaj, Gjykata gjeti se, parashtruesi i kërkesës nuk ishte palë e autorizuar për të referuar çështje kushtetuese *in abstrakto* përkitazi me rregullimin e statusit të pensionistëve dhe të invalidëve të punës. Për këtë arsye, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës, kjo kërkesë është deklaruar e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI157/11
Parashtrues
Bashkimi i Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës i Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga z. Azem Ejupi, avokat
Kërkesë për rregullimin e statusit të pensionistëve dhe të invalidëve të punës dhe përmirësimin e mirëqenies së pensionistëve të Republikës së Kosovës nga autoritetet shtetërore

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Bashkimi i Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës i Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga z. Azem Ejupi, avokat.

Objekti i çështjes

2. Çështja bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) ka të bëjë me kërkesën e Bashkimit të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Republikës së Kosovës përkitazi me njohjen e të drejtës statusore dhe sociale për sigurimet pensionale dhe invalidore.

3. Parashtruesi, ndër të tjera, kërkon nga Gjykata që të ndikojë tek autoritetet shtetërore në zbatimin e Ligjit mbi Sigurimin Pensional dhe Invalidor të ish-KSA të Kosovës, sepse, sipas parashtruesit, ligji në fjalë ende nuk është shfuqizuar me asnjë akt tjetër. Më këtë ligj, pensionistët dhe invalidët e punës pohojnë se e kishin të rregulluar statusin e pensionistit dhe kanë gëzuar të drejtat që ua mundësonte ky ligj.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 28 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 2 dhjetor 2011, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 30 nëntor 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës me Nr. KI157/11.

7. Më 5 janar 2012, Kryetari, me vendimin GJR. KI157/11, caktoi gjyqtaren Iliriana Islami Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin KSH. KI157/11, caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy (anëtar) dhe Gjyljeta Mushkolaj (anëtare).

8. Më 26 nëntor 2012, Kryetari, me vendimin GHR. 157/11, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues, që e zëvendëson gjyqtaren Iliriana Islami, e cila, më 26 qershor 2012, përfundoi mandatin e saj si gjyqtare në Gjykatë dhe caktoi anëtarët e Kolegjit të ri shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy (anëtar) dhe Arta Rama-Harizi (anëtare), që e zëvendëson gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj, e cila po ashtu, më 26 qershor 2012 përfundoi mandatin e saj si gjyqtare në Gjykatë.

9. Më 17 janar 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi rrëfen se, prej vitit 1998 dhe deri më sot, pensionistët e Kosovës nuk kanë pranuar pensionin e merituar dhe janë ende pa sigurime shëndetësore dhe sociale, pa status të zgjidhur dhe në gjendje jo të përshtatshme materiale. Parashtruesi pohon se më të shkelurit janë pensionistët që kanë paguar kontribute për sigurimin pensional dhe invalidor, duke përfshirë edhe pensionistët familjarë.

11. Parashtruesi pretendon se pensionistët janë diskriminuar fillimisht nga pushteti i Serbisë, ndërsa, pas vitit 1999, nga UNMIK-u dhe, së fundmi, edhe nga autoritetet qeveritare të Republikës së Kosovës. Parashtruesi, ndër të tjera, pohon:

> *"Prej fundit të vitit 1998, deri në gusht të vitit 2002, pensionistëve nuk u është paguar kurrfarë shume e pensionit. Tek pas miratimit të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/35, dt. 21 dhjetor 2001, mbi Pensionet në Kosovë, e ndryshuar me Rregulloren Nr. 2005/20, si dhe Ligjit Nr. 2002/11 mbi Metodologjinë e caktimit të lartësisë së pensionit bazë në Kosovë dhe caktimin e datës për sigurimin e pensioneve bazë, prej 1 korrikut 2002 ka filluar njëfarë pagese e quajtur pensioni bazë, nga 28 marka gjermane në muaj, për të gjithë personat me moshe mbi 65 vjeç".*

12. Parashtruesi përmend faktin që, shumë nga pensionistët kontributpagues, të drejtën e pensionit e kanë fituar në bazë të Ligjit mbi Sigurimin Pensional dhe lnvalidor të ish-KSA të Kosovës (Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 26/83, Nr. 26/86 dhe Nr. 11/88). Sipas parashtruesit, ligji në fjalë nuk është shfuqizuar ende me asnjë akt dhe, sipas dispozitave të atij ligji, pensionisti, në bazë të statusit të fituar ligjor, kishte të drejtë jo vetëm për pagesën e pensionit të llogaritur në bazë të stazhit të punës dhe shumës së kontributeve të paguara, por kishte edhe një varg privilegjesh dhe të drejtash të tjera.

13. Parashtruesi pohon se sot pensionistët nuk gëzojnë asnjë nga të drejtat që kishin fituar në bazë të ligjit në kohën kur kanë dalë në pension. Ata vetëm e marrin një shumë të caktuar 45+35 euro, gjithsej 80 euro, dhe asgjë me tepër, pa marrë parasysh gjatësinë e stazhit ose shumën e kontributeve të paguara.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, duke mohuar dhe duke hequr të drejtat e fituara në bazë të Ligjit mbi Sigurimin Pensional dhe lnvalidor, pensionistëve kontributpagues u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 22, me nenin 23, me nenin 51 (paragrafi 1) të Kushtetutës, me nenin 17 (paragrafi 2) të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, me nenin 26 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe me protokollet e tij, dhe me nenin 9 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Gjykata, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që, së pari, të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje me Ligj dhe me Rregullore të punës.

16. Parashtruesi i kërkesës duket të jetë i pakënaqur me autoritetet qeveritare, të cilat janë të thirrura t'i parashohin dhe t'i rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me politikat sociale, përkatësisht të bëjnë rregullimin e statusit të pensionistëve dhe të invalidëve të punës.

17. Gjykata ka vërejtur se parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar ndonjë akt të autoritetit publik *(Shih, neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese),* me të cilin pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare që aplikohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës. Por, vetëm ka ngritur çështjet që kanë të bëjnë me rregullimin e politikave sociale, përkatësisht me përmirësimin e mirëqenies së pensionistëve dhe të invalidëve të punës, duke kërkuar nga Gjykata të sqarojë se përse nuk janë marrë parasysh nga autoritetet shtetërore kërkesat e parashtruesit për sa i përket të drejtave të pensionistëve dhe të invalidëve të punës.

18. Gjykata i referohet nenit 113, paragrafit 1, të Kushtetutës, që parasheh:

> *Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]*
>
> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".*

19. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ka kërkuar që Gjykata t'u bëjë thirrje autoriteteve qeveritare, përkatësisht ministrive përkatëse, që të hartojnë Ligjin për Pensionistët dhe Invalidët e Punës, si dhe të nxjerrin Ligjin për Sigurimin Shëndetësor.

20. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 4 të Kushtetutës, që përcakton në mënyrë të qartë formën e qeverisjes dhe ndarjen e pushteteve:

> *Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]*
>
> *"[...]*

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ

[...]

4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar".

21. Neni 65 i Kushtetutës ka përcaktuar qartë kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës:

Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit]

"[...]

(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme".

22. Po ashtu, neni *93* i Kushtetutës përcakton qartë kompetencat e Qeverisë:

Neni 93 [Kompetencat e Qeverisë]

"Qeveria ka këto kompetenca:

(2) propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;
[...]
(3) propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera;

(4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve".

23. Megjithatë, neni 113 i Kushtetutës, në mënyrë të qartë ka paraparë se kush mund të konsiderohet palë e autorizuar për të referuar çështje kushtetuese përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së një akti të një autoriteti publik dhe përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së një ligji.

24. Faktikisht, parashtruesi i kërkesës, në rastin konkret, vepron si person juridik dhe i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, si bazë juridike për parashtrimin e kërkesës së tij.

25. Gjykata ka analizuar dhe ka vlerësuar me kujdes kërkesat e parashtruesit dhe konkludoi se parashtruesi i kërkesës, si person juridik në rastin konkret, nuk mund të konsiderohet palë e autorizuar që të mund të referojë çështje kushtetuese *in abstracto* përkitazi me rregullimin e statusit të pensionistëve dhe të invalidëve të punës, si dhe përkitazi me përmirësimin e mirëqenies sociale të tyre, duke u bazuar në kontributet pensionale të paguara gjatë viteve.

26. Përveç kësaj, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk parasheh *actio popularis,* që është modalitet i ankesave individuale, çfarë i mundëson çdo individi, që tenton të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me pyetje dhe me kërkesa të caktuara, duke aluduar për shkelje të të drejtave kushtetuese të një individi a të një grupi të caktuar.

27. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për të referuar çështje kushtetuese *in abstrakto* përkitazi me rregullimin e statusit të pensionistëve dhe të invalidëve të punës. Për këtë arsye, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës, kjo kërkesë konsiderohet e papranueshme.

28. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 56.2 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 56.2 të Rregullores së punës, më 17 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KO 09/13, Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi, datë 25 shkurt 2013 – Konfirmim i amendamentit të propozuar kushtetues, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 18 janar 2013 nëpërmjet shkresës Nr. 04-DO-1357.

Rasti KO 09/13, Aktgjykimi i 29 janarit 2013

Fjalë kyçe: amnistia, konfirmimi i amendamentit të propozuar kushtetues, Kryetari i Kuvendit

Parashtruesi, z. Jakup Krasniqi, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, parashtroi kërkesë në pajtim me nenin 113.9 të Kushtetutës së Kosovës. Parashtruesi dorëzoi në Gjykatë "amendamentin e propozuar nga Qeveria e Kosovës në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (...) për të konfirmuar nëse amendamenti i propozuar do t'i pakësonte ndonjë nga të drejtat dhe liritë e parapara me Kapitullin II të Kushtetutës."

Sa i përket çështjes së pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi e dorëzoi kërkesën për vlerësim paraprak të amendamentit të propozuar të Kushtetutës, në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës. Sa i përket kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar kushtetues, Gjykata konstatoi se amendamenti i propozuar është në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Rasti Nr. KO 61/12 dhe Gjykata konfirmoi se amendamenti i ri i propozuar nuk pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.

AKTGJYKIM
në
Rastin Nr. KO09/13
Konfirmim i amendamentit të propozuar kushtetues, të paraqitur nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 18 janar 2013, nëpërmjet shkresës Nr. 04-DO-1357

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Hyrje

1. Më 22 qershor 2012, Kryetari i Kuvendit të Kosovës dorëzoi kërkesën e parë (Rasti Nr. KO 61/12) në Gjykatën Kushtetuese përkitazi me propozimin e Qeverisë për amendamentet kushtetuese, duke kërkuar vlerësim nëse amendamentet e propozuara nga Qeveria pakësojnë ndonjë nga të drejtat dhe liritë e parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.

2. Më 31 tetor 2012, Gjykata Kushtetuese vendosi:

"...

(1) Njëzëri

I. Kërkesa e parashtruar nga Kryetari i Kuvendit, më 22 qershor 2012, me amendamentet e propozuara të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është e pranueshme;

(2) Me shumicë

1. Amendamenti 1 i propozuar – Amnistia, paragrafi i parë, përkitazi me ***"personat e cekur me emër",*** *pakëson të*

drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara me Kapitullin II të Kushtetutës;

(3) Njëzëri

3. *Amendamenti 1 i propozuar – Amnistia, paragrafi i dytë dhe i tretë, nuk pakësojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara me Kapitullin II të Kushtetutës;*

Amendamenti 2 i propozuar – Neni 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] i Kushtetutës nuk pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.

....”

4. Më 17 dhjetor 2012, Kryesia e Kuvendit (Vendimi Nr. 04-P-124/k), në bazë të nenit 67.6 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës, që parasheh se *“Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës të Kuvendit”;* të nenit 82 [Procedurat për amendamentin e Kushtetutës] të Rregullores së Kuvendit, që parasheh se *“1. Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve, sipas Rregullores së Kuvendit, mund ta propozojnë amendimin e Kushtetutës. 2. Çdo amendim e kërkon miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit, që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve, që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës”;* si dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. KO61/12, nxori përfundimin të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që, në cilësinë e propozuesit, të bëjë riformulimin e propozimit të Amendamentit I në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që ka të bëjë me amnistinë, në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, Nr. KO61/12.

5. Më 11 janar 2013, Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Drejtësisë i ka përcjellë Kryeministrit, z. Hashim Thaçi, propozimin për amendamentim kushtetues për futjen e Amnistisë si kompetencë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në përputhje me udhëzimet e Gjykatës Kushtetuese, sipas Aktgjykimit AGJ303/12 përkitazi me propozimin për futjen e Amnistisë si kategori kushtetuese. Për me tepër, Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Drejtësisë kanë informuar Kryeministrin, z. Hashim Thaçi, që Ministria e Drejtësisë do ta përgatisë edhe një ligj të përgjithshëm për amnistinë, ku do të sqaroheshin

procedurat për miratimin e ligjeve përkatëse për dhënien e amnistisë, përjashtimet, si dhe mënyra e realizimit të saj më pas.

6. Më 16 janar 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës, "në bazë të nenit 92.4 të Kushtetutës, që parasheh se *"Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese e akteve të tjera, si dhe mund të japë mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga ajo";* në bazë të nenit 93.4 të Kushtetutës, që parasheh se *"merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve"*; si dhe në bazë të nenit 144.1 të Kushtetutës, që parasheh se *"Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit, sipas Rregullores së Punës të Kuvendit, mund të propozojnë ndryshime dhe amendamentime të kësaj Kushtetute",* ka miratuar Vendimin Nr. 01/113 për aprovimin e propozimit të Ministrisë së Drejtësisë për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Propozimet e Qeverisë për amendamentimin e Kushtetutës).

7. Më 18 janar 2013, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i ka dorëzuar Gjykatës "amendamentin e propozuar nga Qeveria e Kosovës në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (...) për të vlerësuar nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës".

Baza juridike

8. Kërkesa bazohet në nenin 113.9 dhe në nenin 144.3 të Kushtetutës, në nenin 20 dhe në nenin 54 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

9. Më 18 janar 2013, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i referoi Gjykatës Kushtetuese propozimin e Qeverisë për amendamentin kushtetues, duke kërkuar vlerësim nëse amendamenti i propozuar nga Qeveria pakëson ndonjë nga të drejtat dhe liritë e parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.

10. Më 25 janar 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues dhe caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve:

Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.

11. Më 25 janar 2013, Kryetari i Kuvendit u informua se Gjykata kishte regjistruar kërkesën.

12. Po të njëjtën ditë, nga një kopje e kërkesës iu dërgua Presidentes së Republikës së Kosovës, Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Avokatit të Popullit.

13. Më 29 janar 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Altay Suroy, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Gjykata shqyrton nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

15. Neni 113.9 i Kushtetutës, thotë:

> *"Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës".*

16. Gjykata vëren se Kryetari i Kuvendit paraqiti kërkesë për vlerësim paraprak të amendamentit të propozuar të Kushtetutës, kështu që, në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës, Kryetari i Kuvendit është palë e autorizuar për ta referuar këtë rast në Gjykatë.

Shtrirja e konfirmimit kushtetues

17. Kryetari i Kuvendit paraqiti një (1) amendament të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

18. Konfirmimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar, nga ana e kësaj Gjykate, nuk bëhet duke marrë parasysh vetëm të drejtat dhe liritë e njeriut që përfshihen në Kapitullin II, por edhe gjithë shkronjën dhe frymën e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, siç sqarohet më tepër nga paragrafi 56 e deri te paragrafi 71, të Aktgjykimit të nxjerrë më 20 korrik 2012, në rastet KO29/12 dhe KO48/12 (Amendamentet e

propozuara të Kushtetutës nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 23 mars 2012 dhe më 4 maj 2012).

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar kushtetues

Amendamenti 1 i propozuar: Amnistia

19. Amendamenti 1 propozon që nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës t'i shtohet paragrafi i ri 15, i cili do të thotë:

> *"(15) jep amnisti me ligj përkatës i cili miratohet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit".*

20. Prandaj, amendamenti i propozuar sugjeron që, në kompetencën ekzistuese të Kuvendit, të shtohet një kompetencë e re, përkatësisht të shtohet kompetenca për të dhënë amnisti me ligj përkatës, i cili do të miratohet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

21. Gjykata konsideron se ndryshimi i propozuar është në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. KO61/12. Gjykata, po ashtu, konfirmon se amendamenti i ri i propozuar nuk pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.9 dhe nenit 144.3 të Kushtetutës, në bazë të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në bazë të rregullit 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 29 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. Kërkesa e parashtruar nga Kryetari i Kuvendit, më 18 janar 2013, që përmban amendamentin e propozuar të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është e pranueshme;

II. Amendamenti 1 i ri i propozuar – Amnistia, neni 65, paragrafi 15, i Kushtetutës, nuk pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara me Kapitullin II të Kushtetutës;

III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 51/09, KI 31/10, KI 68/11, KI 99/11, KI 112/11, KI 126/11 KI 07/12, KI 64/12, Vahide Hasani, Alltane Krasniqi, Fetije Berisha, Fahrije Ibrahimi,Sadije Pranaj, Raza Gashi, Nazmije Salihu, Shpresa Lladrovci, datë 26 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së 8 (tetë) aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

Rastet KI51/09, KI31/10, KI68/11, KI99/11, KI112/11, KI126/11 KI07/12, KI64/12, Aktvendim për papranueshmëri i 22 janarit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë papranueshme, kërkesë qartazi e pabazuar, fondi për sigurim pensional dhe invalidor, kompensim i përkohshëm, të drejtat subjektive

Kërkesa bazohet në Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56 të Rregullores së punës. Parashtrueset, ndër të tjera, pohuan se vendimet e gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të cilat miratuan vendimin e Korporatës Energjetike të Kosovës për ndërprerje të pagesave ndaj tyre si trashëgimtare të burrave të tyre të ndjerë, ishin të padrejta dhe cenonin të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë.

Gjykata theksoi se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë apeli, apo gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Më tutje, Gjykata po ashtu theksoi se marrëveshjet për kompensim të përkohshëm nuk mund të barten tek parashtrueset e kërkesave sepse ato marrëveshje ishin lidhur nga burrat e tyre të ndjerë dhe jo nga vetë ato. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesve të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin
KI51/09, KI31/10, KI68-11, KI99/11, KI112/11, KI126/11 KI07/12, KI64/12,
Parashtrues
Vahide Hasani, Alltane Krasniqi, Fetije Berisha, Fahrije Ibrahimi, Sadije Pranaj, Raza Gashi, Nazmije Salihu, Shpresa Lladrovci
Vlerësim i kushtetutshmërisë së 8 (tetë) aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Hyrje

1. Ky raport ka të bëjë me kërkesat e paraqitura nga parashtrueset e shënuara më poshtë, kërkesa këto të dorëzuara në Gjykatën Kushtetuese, nga tetë (**8**) **të veja** të ish-punëtorëve të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) ndërmjet viteve 2009 dhe 2012.

2. Rastet në fjalë janë të ngjashme me rastin KI40/09, "Imer Ibrahimi dhe 48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës", "Gani Prokshi dhe 15 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 16 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës", "Isuf Mërlaku dhe 25 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës" dhe "Ilaz Halili dhe 20 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës".

Parashtrueset e kërkesës në rastin në fjalë janë:

3. Në këtë Aktgjykim, për referim më të lehtë, parashtrueset mund të referohen kolektivisht si "Vahide Hasani dhe të tjerët":

1. Vahide Hasani,
2. Alltane Krasniqi,
3. Shpresa Lladrovci,
4. Fetije Berisha,
5. Sadije Pranaj,
6. Fahrije Ibrahimi,
7. Raza Gashi dhe
8. Nazife Xhafolli.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve individuale të nxjerra nga Gjykata Supreme e Republikës se Kosovës në tetë (8) rastet individuale të parashtrueseve kundër KEK-ut, siç është cekur më lart.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në nenin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Përmbledhje e fakteve siç pretendohen nga palët

6. Faktet e këtyre kërkesave janë të ngjashme me ato në rastin "Imer Ibrahimi dhe 48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës", me rastin "Gani Prokshi dhe 15 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 16 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës" dhe me rastin "Isuf Mërlaku dhe 25 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës". Shih aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: rasti "Ibrahimi dhe të tjerët", i 23 qershorit 2010, rasti "Prokshi dhe të tjerët", i 18 tetorit 2010, dhe rasti "Mërlaku dhe të tjerët", i 10 marsit 2011).

7. Gjatë vitit 2001 dhe 2002, secili **bashkëshort** i ndjerë i parashtrueseve në këtë kërkesë, si dhe parashtrueset në aktgjykimin e lartcekur, nënshkroi Marrëveshje për Kompensim të Përkohshëm të Pagës për Shkëputje të Kontratës së Punës me punëdhënësin e tyre, KEK-un. Këto marrëveshje ishin, në thelb, të njëjta.

8. Neni 1 i Marrëveshjes përcaktoi se, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, nr. 26/83, 26/86 dhe 11/88*)* dhe konstatimit të Komisionit Invalidor të KEK-ut, përfituesi (d.m.th., secili parashtrues) ka të drejtë për kompensim të përkohshëm për shkak të ndërprerjes së kontratës së punës, deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor.

9. Neni 2 i kësaj Marrëveshjeje precizon se shuma mujore që duhet t'i paguhet secilit parashtrues do të ishte 206 marka gjermane.

10. Neni 3 përcaktoi që "pagesa do të përfundojë në ditën e funksionimit të Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor. Prej asaj dite e tutje, shfrytëzuesi mund t'i realizojë të drejtat e veta në Fondin e Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor (Fondi Pensional Invalidor i Kosovës) dhe KEK-ut do t'i hiqen obligimet ndaj shfrytëzuesit sipas kësaj Marrëveshjeje".

11. Më 1 nëntor 2002, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut miratoi një vendim për themelimin e Fondit Pensional, në përputhje me kriteret e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/30 për Pensionet në Kosovë. Neni 3 i këtij vendimi thotë: "Fondi Pensional do të vazhdojë të ekzistojë për një periudhë të pacaktuar kohore, në pajtim me kriteret dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligjet për pensione, të miratuara nga Bordi i Fondit Pensional dhe KEK-u, në përputhje me këtë vendim, apo derisa kushtet ligjore për ekzistimin dhe funksionimin e Fondit të jenë në përputhje me rregulloret për pension ose rregullat për pension të miratuara nga ABPK-ja".

12. Më 25 korrik 2006, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut e anuloi vendimin në fjalë për themelimin e Fondit Pensional Suplementar dhe ndërpreu financimin dhe punën e Fondit Pensional Suplementar, që nga 31 korriku 2006. Sipas vendimit të 25 korrikut 2006, të gjithë përfituesve u garantohej pagesa e plotë në përputhje me Statutin e Fondit. Për më tepër, obligimi i përgjithshëm ndaj përfituesve ishte 2.395.487 euro, depozitat bankare ishin 3.677.383 euro, dhe suficiti nga mjetet ishte 1.281.896 euro. Vendimi thotë se punëtorët e KEK-ut, të cilët Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i pranon si persona me aftësi të kufizuar për punë, do t'i gëzojnë të drejtat e parapara nga Ministria. Më 14 nëntor 2006, KEK-u e informoi Autoritetin Qendror Bankar se "vendimi për revokimin e Fondit Pensional të KEK-ut bazohet në vendimin e Bordit Ekzekutiv të KEK-ut dhe në vendimin e Bordit Menaxhues për

Pensione... <u>për shkak të rrezikut financiar që kjo skemë paraqet për KEK-un në të ardhmen</u>".

13. Sipas parashtrueseve, KEK-u ndërpreu pa asnjë njoftim pagesën e paraparë me marrëveshjet, pas vdekjes së bashkëshortëve të tyre. Parashtrueset pohojnë që një veprim i tillë është në kundërshtim me marrëveshjet e nënshkruara nga bashkëshortët e tyre.

14. Parashtrueset gjithashtu pohojnë që dihet mirë se Fondi Pensional dhe Invalidor i Kosovës nuk është themeluar ende.

15. Parashtrueset ngritën padi kundër KEK-ut në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me të cilën kërkonin që Gjykata ta urdhëronte KEK-un t'ua paguante pagesat e papaguara dhe të vazhdonte t'ua paguante nga 105 euro (që është e barabartë me 206 marka gjermane) deri në përmbushjen e kushteve për ndërprerjen e pagesës.

16. Gjykata Komunale në Prishtinë i miratoi paditë e parashtrueseve dhe urdhëroi kompensim monetar. Gjykata Komunale në Prishtinë konstatoi (*p.sh., Aktgjykimi C. Nr. 2267/2006, i 20 prillit, në rastin e parashtrueses së parë Vahide Hasani*) se kushtet e parapara në nenin 3 të Marrëveshjes nuk ishin përmbushur. Neni 3 i Marrëveshjes parashikon kompensimin e pagës deri në themelimin e Fondit Pensional Invalidor, "që do të thotë të drejtën për skemë të pensioneve, që nuk është e mundur për bashkëshortin e saj, pasi që edhe po të ishte ende gjallë, ai nuk do të kishte mbushur moshën 65-vjeçare dhe se parashtruesi i trashëgon të drejtat e bashkëshortit të saj për vazhdimin e pranimit të këtyre pagesave".

17. Kundër aktgjykimeve të Gjykatës Komunale KEK-u paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut, duke thënë, ndër të tjera, se aktgjykimi i Gjykatës Komunale nuk ishte i drejtë, sepse marrëveshjet ishin nënshkruar me parashtrueset për shkak të invaliditetit të tyre dhe se nuk mund të kërkojnë vazhdimin e tyre pas vdekjes së bashkëshortëve të tyre.

18. KEK-u ritheksoi se Gjykata ishte e detyruar të vendoste duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/40 për shpalljen e Ligjit për Pensionet Invalidore, sipas të cilës parashtrueset kishin të drejtë për pension invalidor.

19. Gjykata e Qarkut në Prishtinë i hodhi poshtë ankesat e KEK-ut dhe i konsideroi parashtresat e tyre të pabazuara.

20. KEK-u parashtroi revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljes së supozuar thelbësore të Ligjit për procedurën kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Aty përsëritej që parashtrueset kishin të drejtë për pension sipas Ligjit 2003/40 dhe që, për shkak të arsyeve humanitare, KEK-u kishte vazhduar t'i paguante kompensimet mujore për 60 muaj.

21. Gjykata Supreme i miratoi revizionet e KEK-ut, i anuloi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Komunale në Prishtinë, dhe i refuzoi si të pabaza paditë e parashtrueseve.

22. Gjykata Supreme theksoi që mënyra e ndërprerjes së punësimit konsiderohej e ligjshme sipas nenit 11.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë.

23. Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e parashtrueseve, duke theksuar se, "fakti që *Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor* nuk është funksional, nuk ndikon në rastin e parashtrueseve pasi që marrëveshja është nënshkruar ndërmjet bashkëshortëve të ndjerë të parashtrueseve, prandaj, sipas nenit 359 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore (LMD), KEK-u nuk ka obligime të mëtejme.

24. Gjykata Supreme theksoi që KEK-u nuk ka detyrim të mëtejmë ndaj parashtrueseve. Për më tepër, parashtrueset vazhduan të marrin pagesa nga KEK-u për 60 muaj, sipas statutit që hyri në fuqi më 2002.

25. Disa nga parashtrueset kanë kërkuar nga Gjykata Supreme për të përsëritur procedurat bazuar në letrën e Ministrisë për Mirëqenie, duke konfirmuar se Fondi për Pension Invalidor nuk është funksional deri më këtë datë.

26. Më 15 maj 2009, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Kosovës lëshoi këtë njoftim:

"Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, në arsyetimin e vet të p.sh. Aktgjykimit Rev. Nr. 338/2008, që në Republikën e Kosovës ekziston Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor që është funksional që nga 1 janari 2004 nuk është i saktë dhe është i pabazuar. Në dhënien e kësaj deklarate, ne kemi parasysh faktin që Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/40 shpall Ligjin Nr. 2003/213 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, i cili i rregullon rastet e personave me paaftësi të përhershme, të cilët mund ta gëzojnë këtë skemë në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj. Prandaj, më lejoni të theksoj që dispozitat e këtij Ligji nuk parashikojnë themelimin e

Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të vendit. Themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Republikën e Kosovës përcaktohet me Ligjin për Sigurim Pensional dhe Invalidor, i cili është në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës." Në të njëjtin njoftim shpjegohet që, në kohën e shkrimit të atij njoftimi, pensioni ndër të tjera ekzistonte, *"pensioni invalidor në shumë prej 45 eurove, siç rregullohet me Ligjin për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar (përfitues të tyre janë të gjithë personat me aftësi të kufizuara të plotë dhe të përhershme)", si dhe "pensionet e kontributdhënësve prej 82 eurove, që rregullohen me vendim të Qeverisë (përfitues të të cilit janë të gjithë pensionistët që e kanë arritur moshën e pensionimit prej 65-vjetësh, si dhe të cilët kanë së paku 15 vjet përvojë pune)".*

27. Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e parashtrueseve për përsëritjen e procedurës, duke theksuar se çështja që Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Kosovës nuk është ende funksional nuk ka ndikim në rastin e parashtrueseve, sepse marrëveshja e përkohshme është nënshkruar nga bashkëshortët e tyre të ndjerë.

28. Gjykata Supreme ritheksoi se "e drejta për kompensim të përkohshëm nuk mund të transferohet tek personat tjerë, sepse kjo është një e drejtë subjektive e lidhur ngushtë ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit".

29. Gjykata Supreme vendosi se KEK-u i ka plotësuar detyrimet e veta, duke vazhduar t'ua paguajë parashtrueseve nga 105 euro për 60 muaj.

Ankesat

30. Parashtrueset ankohen se u janë shkelur të drejtat, për shkak se KEK-u ua ndërpreu pagesat pas vdekjes së bashkëshortëve të tyre, të cilët ishin nënshkrues të këtyre marrëveshjeve, përkundër faktit se kushti i përcaktuar me nenin 3, themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor, nuk ishte përmbushur.

Përmbledhje e procedurave në Gjykatë

31. Ndërmjet vitit 2009 dhe qershorit 2012, parashtrueset individualisht i kanë dorëzuar kërkesat në Gjykatë Kushtetuese.

32. Ndërmjet vitit 2010 dhe 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës përkitazi me kërkesat e parashtrueseve.

33. Më 17 shkurt 2012, Kryetari i Gjykatës e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe e caktoi Kolegjin shqyrtues të Gjykatës, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.

34. Më 15 tetor 2012 Kryetari me Vendim (nr. Kolegji shqyrtues KI-KEK/VI) caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues, pasi mandati i gjyqtares Iliriana Islami, si gjyqtare në Gjykatë, kishte përfunduar.

35. Më 17 tetor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesave.

Pranueshmëria

36. Për të gjykuar për kërkesat e parashtruesve, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë.

37. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë apeli, apo gjykatë e shkallës së katërt, për vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

38. Gjykata përkujton kriterin e pranueshmërisë, të paraparë me nenin 34 të Konventës, sipas së cilit çdo kërkesë duhet të dorëzohet nga një parashtrues, i cili mund të deklarojë se është një viktimë e shkeljes së Konventës. Një lidhje duhet të krijohet ndërmjet parashtruesit dhe dëmit, që ai/ajo kishte pësuar për shkak të shkeljes së pretenduar.

39. Gjykata Supreme, në pjesën operative të vendimit, theksoi: "E drejta nuk mund t'i transferohet personave tjerë pasi që është një e drejtë subjektive, e lidhur ngushtë ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe se kjo çështje ka të bëjë me kompensimin e përkohshëm për ndërprerjen e punësimit dhe jo me pensionin ligjor dhe prandaj fakti që Fondi i Pensionit Invalidor nuk është funksional nuk ndikon në rastin e parashtrueseve, pasi që Marrëveshja është nënshkruar me bashkëshortët e parashtrueseve (të ndjerë) prandaj sipas nenit 359 të Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore, KEK-u nuk ka detyrime të mëtejme".

40. Për më tepër, neni 51 i Kushtetutës [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], që i referohet disa nga parashtrueseve të lartpërmendura përkitazi me pensionet, thjesht thekson se "Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj". Kjo nuk do të thotë se një qytetar ka një pension apo të diktojë se si një person mund të kualifikohet për një pension.

41. Për sa i përket arsyetimit të Gjykatës Kushtetuese në aktgjykimin e saj të mëparshëm, që ka të bëjë me ish-punëtorët e KEK-ut, ky i fundit nuk mund të zbatohet te parashtrueset e tashme për shkak se ato nuk ishin nënshkruese të Marrëveshjes me KEK-un dhe, si i tillë, është i natyrës së jotransferueshme.

42. Për më tepër, parashtrueset nuk precizojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë asnjë dispozitë kushtetuese, e cila mund të jetë shkelur me vendimin që ato e kontestojnë, pa qenë në gjendje të dëshmojnë se "statusi i viktimës sipas aktit të autoritetit publik" siç është paraparë në nenet 34 të Konventës së BE-së për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

43. Duke shqyrtuar në tërësi të dy procedurat administrative, Gjykata Kushtetuese nuk gjen se procedurat relevante ishin në ndonjë mënyrë të padrejta ose arbitrare (*Shih, mutatis mutandis, Shub v. Lithuania, ECHR Vendimi sa i përket pranueshmërisë së Kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009*).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 114 (7) të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, si dhe në pajtim me rregullin 36 të Rregullores së punës, më 17 tetor 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. T'I BASHKOJË kërkesat;

II. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 85/12 dhe KI 86/12, Adriatik Gashi dhe Burim Miftari, datë 26 shkurt 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl. nr. 45/12 , të 18 qershorit 2012, së bashku me kërkesën për aplikimin e masës së përkohshme

Rasti KI 85/12 dhe KI 86/12, Aktvendim për papranueshmëri i 22 janarit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, procedurë penale, parimi 'beneficium cohaesionis

Parashtruesit paraqitën kërkesat e tyre në menyrë të ndara, bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se Aktgjykimi i Supreme Pkl. nr. 45/12 i ka shkelur të drejtat e tyre ë garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]të Kushtetutës, pasiqë sipas parashtruesve, se gjykatat Ankimore të rastit sipas parimit *beneficium cohaesionis (privilegji i lidhshmërisë),* është dashur që ankesat e z, Burim Miftari dhe z.Adriatik Gashi ti trajtojnë si të afatshme pasi që ata janë gjykuar me të njëjtin Aktgjykim dhe si bashkëkryes të veprave penale me të Gjykuarin z, H.G. ,mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të cilit kishte paraqitur ankesë të afatshme dhe ajo ishte shqyrtuar në pikëpamje të meritës. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkuan që Gjykata Kushtetuese do të duhej të aplikojë masën e përkohshme duke urdhëruar lirimin e parashtruesit nga vuajtja e mëtejme e dënimit sepse sipas tij me këtë do të evitohej dëmi i pariparueshëm për të.

Gjykata përsëriti se nuk është gjykatë e faktit, dhe me këtë rast theksoi se konstatimi i gjendjes faktike të drejtë dhe të plotë është juridiksion i plotë i Gjykatave të rregullta si në rastin konkret i Gjykatës Supreme duke refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të gjykuarve z. Adriatik Gashi dhe z. Burim Miftari, dhe se roli i saj (Gjykatës Kushtuese) është vetëm qe ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykate e shkalës se katërt".

Më tej, Gjykata konstatoi se parashtruesit e kërkesës përpos se ka theksuar se me masën e përkohshme do të evitohej dëmi i pariparueshëm për parashtruesit nuk kanë mbështetur me asnjë fakt këtë kërkesë duke e arsyetuar domosdoshmërinë e aplikimit të kësaj mase. Ata nuk kanë shpjeguar pse dëmi do të ishte i pariparueshëm dhe pse me mos aplikimin e masës së përkohshme do të cenohej interesi publik.

Prandaj, Gjykata vendosi se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij dhe nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar, si të tillë e shpalli kërkesën të papranueshme në tërësi.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
Në
Rastin Nr. KI 85/12 dhe KI86/12
Adriatik Gashi dhe Burim Miftari
Kërkesa për vlerësimin e Kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në Prishtinë Pkl.nr 45/12 të datës 18. 06. 2012, së bashku me kërkesën për aplikimin e masës së përkohshme

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Robert Carolan Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar
Arta Rama – Hajrizi, Gjyqtare

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Adriatik Gashi dhe z. Burim Miftari nga Gjakova tani në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës në Istog.të cilët me autorizim i përfaqëson z Teki Bokshi avokat nga Gjakova(tutje; parashtruesi i Kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik është me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutën e Kosovës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në Prishtinë Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në Prishtinë Pkl.nr 45/12 të datës 18. 06. 2012 me të cilin ishte refuzuar kërkesa e parashtruar për mbrojtje të ligjshmërisë, të cilin sipas pohimit personal parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar me 18 shtator 2012.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) me 24 shtator 2012 është vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në Prishtinë PKL 45/12 të datës 18 06, 2012 me anë të cilit Gjykata Supreme kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e

parashtruesve Burim Miftari e Adriatik Gashi për mbrojtjen ligjshmërisë të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë P.nr *258/2002* të datës 27.10.2011, dhe aktgjykimi të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ap.nr *9/2012* të datës 07.02.2012.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, , dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese pranoi përmes postës kërkesën së bashku me kërkesën për aplikimin e masës së përkohshme të parashtruar nga avokati Teki Bokshi që përfaqëson parashtruesin e kërkesës z. Adriatik Gashi nga Gjakova dhe kjo kërkesë u regjistrua në Gjykatë me nr. KI 85/12.

6. Në po të njëjtën datë Gjykata Kushtetuese e pranoi përmes postës kërkesën së bashku me kërkesën për aplikimin e masës së përkohshme të parashtruar nga avokati Teki Bokshi që përfaqëson parashtruesin e kërkesës z. Burim Miftari nga Gjakova dhe kjo kërkesë u regjistrua në Gjykatë me nr KI 86/12.

7. Më 13 nëntor 2012 Gjykata Kushtetuese i kishte dërguar një shkresë përfaqësuesit të parashtruesve me të cilat kishte kërkuar dokumentacion shtesë të nevojshëm për procedimin e mëtutjeshëm të kërkesave.

8. Më 05 dhjetor 2012 Gjykata përmes postës kishte pranuar dokumentacion shtesë nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dhe më këtë rast kërkesës i ishin bashkangjitur, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale ne Gjakove P.nr. 258/2002 dt, 27.10.2011, Ankesa e të bashkëpandehurit Hajrullah Guta, kundër Aktgjykimit të Gjykatës komunale të Gjakovës dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Ap.nr. 9/2012 të datës 7.02.2012.

9. Më 29 nëntor 2012 Kryetari i Gjykatës kishte nxjerrë urdhrin urdh. Ki 85/12 me të cilin kishte urdhëruar bashkimin e lëndëve Ki 85/12 dhe Ki86/12 duke caktuar njëkohësisht gjyqtar raportues,gjyqtarin Kadri Kryeziu, ndërsa me vendimin, Kolegjin shqyrtues në përbërje : Robert Carolan, Altay Suroy dhe Prof. dr. Enver Hasani.

10. Më 21 janar 2013, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Me 27 tetor 2011 Gjykata Komunale në Gjakovë duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarve Adriatik Gashi, H.G., Burim Miftari dhe Sh.H., që të gjithë nga Gjakova, për shkak se si bashkëkryes kanë kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë, nga neni 253 par. 1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe veprat penale, të vjedhjes së rendë në tentativë, nga neni 253 par. 1 pika 1 lidhur me nenet 20-23 te KPK-së, sipas Aktakuzës PP. nr. *211/2002* të datës 27.06.2002 nxori Aktgjykimin P.nr. 258/2002 me anë të të cilit të akuzuarit i shpalli fajtor dhe i gjykoi me dënimet e mëposhtme:

"Të akuzuarin Adriatik Gashi, me dënim unik me burgim ne kohëzgjatje prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) muajve, në të cilin dënim do te llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 12.04.2002 e deri më datë 09.05.2002.

Të akuzuarin Burim Miftari me dënim unik me burgim ne kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 12.04.2002 e deri me datë 09.05.2002.

Të akuzuarin H.G. me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tete) muajve, me kusht që në afatin prej 2 (dy) viteve te mos kryen vepër penale.

Të akuzuarin Sh.H. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve me kusht që në afatin prej 1 (një) viti të mos kryen vepër penale."

12. Kundër këtij aktgjykimi avokati Teki Bokshi në cilësi të mbrojtësit ligjor sipas detyrës zyrtare të akuzuarit z. H.G. ka paraqitur ankesë për shkak të cenimeve të rënda të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar, përkatësisht jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të ligjit penal, vendimit për sanksionin penal, ndërsa të akuzuarit tashmë të gjykuarit, z Adriatik Gashi dhe z,Burim Miftari kanë paraqitur personalisht ankesa.

13. Më 7 shkurt 2012 Gjykata e Qarkut në Pejë, duke vendosur sipas këtyre ankesave nxori Akgjykimin Ap.nr 9/12 me të cilën ankesën e z. H.G. e refuzoi si të pabazuar ndërsa ankesat e z, Adriatik Gashi dhe z, Burim Miftari i refuzoi si të paafatshme.

14. Në arsyetimin e vendimit Gjykata e Qarkut në Pejë kishte theksuar se Gjykata Komunale në Gjakovë në rastin e z. H.G. e ka vlerësuar drejt dhe të plotë gjendjen faktike dhe se administrimi i provave duke përfshirë edhe fotografitë e vendeve të ngjarjeve ku janë kryer veprat penale, pranimin e pjesërishëm të fajësisë së të akuzuarve, procesverbalin e hetuesisë etj. janë vlerësuar drejt ndërsa masa ndëshkimore është proporcionale me veprat penale të kryera. Ndërsa gjykata komunale kishte marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese për të akuzuarit e veçanërisht për të akuzuarin z. H.G.

15. Gjykata e Qarkut gjithashtu kishte konstatuar se *" Nga shkresat e lëndës rezulton se i akuzuari Adriatik Gashi e ka pranuar personalisht aktgjykimin e shkallës së parë, pasi nga fletedorëzimi për dorëzimin personal shihet qartë se ai e ka nënshkruar personalisht pranimin e aktgjykimit me dt.27.12.2011, ndërsa ankesen e ka ushtruar me dt.23.01.2012, që do të thote se ankesën e ka ushtruar 12 dite pas skadimit të afatit ligjor, ndërsa i akuzuari Burim Miftari aktgjykimin e ka pranuar me dt.23.12.2011 kurse ankese ka ushtruar me dt.23.01.2012, gjithashtu 16 dite pas skadimit të afatit ligjor"* andaj i ka refuzuar si të paafatshme.

16. Kundër këtij aktgjykimi të gjykuarit z, Adriatik Gashi dhe z, Burim Miftari kanë paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë duke pohuar se për veprat penale për të cilat janë gjykuar kishte parashkrim relativ dhe absolut i cili ndjekjen penale e dënimin e shqiptuar ndaj tyre në këto rrethana e bën të paligjshëm.

17. Më 18.06.2012 Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Pkl nr/45/2012 me të cilin *"Rcfuzohen si të pabazuara kërkesat e të gjykuarve Adriatik Gashi dhe Burim Miftari për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë P.nr 258/2002 të datës 27.10.2011, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ap.nr 9/2012 date 07.02.2012*"

18. Gjykata Supreme kishte arsyetuar Aktgjymin e saj me vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike nga gjykata e shkallës më të ultë ndërsa sa i përket parashkrimit relativ e absolut gjykata kishte konstatuar se ky pohim i ankuesve nuk qëndron për faktin se rrjedha e afateve disa herë

ishte ndërprere me veprime procedurale të gjykatës dhe se *"për asnjë vepër penale nuk ka kaluar dyfishi i afatit i paraparë me ligj."*

Pretendimet e parashtruesit për shkeljet kushtetuese

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin janë shkelur: neni 21, par. 2. I cili thekson se "Republika e Kosovës mbron dhe garanton te drejtat dh liritë themelore te njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.", neni 31 - [E Drejta për Gjykim te Drejtë dhe te Paanshëm], Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave).

20. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se gjykatat Ankimore të rastit sipas parimit *beneficium cohaesionis (privilegji i lidhshmërisë),* është dashur që ankesat e z, Burim Miftari dhe z.Adriatik Gashi ti trajtojnë si të afatshme pasi që ata janë gjykuar me të njëjtin Aktgjykim dhe si bashkëkryes të veprave penale me të Gjykuarin z, H.G. ,mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të cilit kishte paraqitur ankesë të afatshme dhe ajo ishte shqyrtuar në pikëpamje të meritës.

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me këtë rast gjykatat e rastit do të duhej të aplikonin nenin 419 të KPPK-së, i cili përcakton se *"Kur me rastin e paraqitjes se ankesës se cilit do të akuzuar, gjykata e shkallës së dytë çmon se arsyet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të akuzuarit, e qe nuk janë të natyrës personale, shkojnë në dobi edhe të ndonjërit nga te bashkakuzuarit i cili nuk ka paraqitur ankesë ose nuk e ka paraqitur ne atë drejtim, vepron sipas detyrës zyrtare sikurse ankesa e tillë te ishte paraqitur nga i bashkakuzuari."*

22. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se Gjykata Kushtetuese do të duhej të aplikojë masën e përkohshme duke urdhëruar lirimin e parashtruesit nga vuajtja e mëtejme e dënimit sepse sipas tij me këtë do të evitohej dëmi i pariparueshëm për të.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës dhe i kërkesës për masë të përkohshme

23. Për te qenë ne gjendje të gjykojë mbi Kërkesën e Parashtruesit , Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë .Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe rregulloren e punës së Gjykatës.

24. Lidhur me këtë i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës ku përcaktohet:"

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

25. Gjykata gjithashtu merr parasysh Rregullin 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
c) Kërkesa është qartas e bazuar."

26. Duke iu referuar kërkesës së parashtruesit dhe shkeljeve të pretenduara të drejtave Kushtetuese Gjykata kushtetuese thekson se: Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e faktit, dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike të drejtë dhe të plotë është juridiksion i plotë i Gjykatave të rregullta si në rastin konkret i Gjykatës Supreme duke refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të gjykuarve z. Adriatik Gashi dhe z. Burim Miftari, dhe se roli i saj (Gjykatës Kushtuese) është vetëm qe ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykate e shkalës se katërt", (shih, *mutatis mutandis,* i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65)

27. Duke marrë në konsideratë atë që u tha më sipër, Gjykata, sipas rregullit të përgjithshëm, nuk do të kundërshtojë konstatimet dhe përfundimet që rrjedhin nga instancat gjyqësore të rregullta si zbatimin e ligjit konkret dhe të drejtës së brendshme, vlerësimin e provave në proces, drejtësinë e rezultatit të një mosmarrëveshje civile apo fajësinë ose jo të një të akuzuari në një çështje penale.

28. Në raste të jashtëzakonshme, Gjykata mund të vërë në dyshim këto konstatime dhe përfundime, nëse ato janë të njollosura nga një arbitraritet flagrant dhe evident, në kundërshtim me drejtësinë dhe me mirëgjykimin, dhe që shkaktojnë shkelje të Kushtetutës apo Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) (*Syssoyeva e të tjerë kundër Letonisë* (çregjistrim) [DHM], § 89).

29. Në këtë drejtim Gjykata Kushtetuese vëren se çështja nëse gjykatat që kanë vendosur lidhur me ankesat e z. Miftari dhe z.Gashi është dashur të aplikojnë nenin 419 të KPPK apo jo, është çështje e aplikimit të Ligjshmërisë dhe e vërtetimit të fakteve lidhur me rastin që kanë

shqyrtuar dhe këto veprime procedurale nuk kanë shkaktuar pasoja të shkeljeve të drejtave të garantuara me Kushtetutë që pretendohen nga parashtruesit e kërkesës.

30. Nëse neni 419 i KPPK-së, duke u mbështetur në parimin juridik *beneficium cohaesionis(privilegji i lidhshmërisë),* do të duhej të aplikohej automatikisht apo sipas çmuarjes së gjykatës është prapë se prapë çështje e aplikimit të drejtë të ligjit dhe kjo është kompetencë e gjykatave të rregullta dhe aq më tepër kur ligji ka paraparë që është Gjykata ajo që : " *çmon se arsyet për te cilat ka marrë vendim në dobi të të akuzuarit, e që nuk janë të natyres personale, shkojnë në dobi edhe të ndonjërit nga te bashkakuzuarit...*"e në rastin konkret Gjykata e Qarkut duke vlerësuar se, mes të tjerash, rrethanat lehtësuese për të gjykuarit në rastin e z. H.G. kishte theksuar janë aplikuar veçanërisht këto rrethana (sepse ai ishte i verbër dhe ishin tepër personale andaj nuk do të mund të aplikoheshin tek të gjykuarit tjerë dhe me gjasë nuk do të shkonin në dobi të të bashkakuzuarve tjerë).

31. Gjykata Kushtetuese gjithashtu thekson se nuk është Gjykata e rregullt ajo që ka pamundësuar " qasjen në drejtësi" dhe apo ka bërë "mohimin e mjetit juridik" për parashtruesit e ankesave por është vonesa e pajustifikueshme e palëve në ushtrimin e të drejtës së garantuar për mjet juridik (ankesa në afatin e paraparë ligjor) ajo që ka shkaktuar pasoja dhe në këtë drejtim. Gjykata Kushtetuese nuk konstaton se procesi gjyqësor në tërësi ka qenë arbitrar dhe që në fund do të rezultonte me shkelje të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë apo me KEDNJ.

Sa i përket masës së përkohshme

32. Çështjes së masave të përkohshme Kushtetuta e Kosovës i referohet në nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] ku në pikën 2 përcaktohet: *" Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të paripërueshme."*

33. Për masat e përkohshme një përcaktim ligjor ka edhe Ligji për Gjykatën kushtetuese (Nr. 2008/03-L-121) i cili në nenin 27 pika 1 parasheh*: " Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa te përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të*

evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik."

34. Si nga përkufizimi Kushtetues ashtu edhe nga përkufizimi ligjor i "institutit juridik" të *masës së përkohshme* konstatohet se për aplikimin e saj janë të nevojshme përmbushja e dy kushteve themelore a) dëmit të pariparueshëm të mundshëm që do ti shkaktohej parashtruesit të kërkesës nëse gjykata nuk e aplikon masën e përkohshme dhe b) në rast se aplikimi i masës së përkohshme do të mbronte interesin publik.

35. Përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës përpos se ka theksuar se me masën e përkohshme do të evitohej dëmi i pariparueshëm për parashtruesit nuk ka mbështetur me asnjë fakt këtë kërkesë duke e arsyetuar domosdoshmërinë e aplikimit të kësaj mase. Ai nuk ka shpjeguar pse dëmi do të ishte i pariparueshëm dhe pse me mos aplikimin e masës së përkohshme do të cenohej interesi publik.

36. Në këto rrethana parashtruesi ankesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij" dhe nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar andaj kërkesën për masë të përkohshme Gjykata duhet ta refuzojë sikur që në përputhje me rregullin 36 paragrafi 2 pika c dhe d , Gjykata gjen se edhe kërkesën në tërësi ta refuzoj si qartazi të pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 27 dhe 46 të Ligjit dhe rregullat 36, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 21 janar 2013, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën pë masë të përkohshme si të pa bazuar;

III. Ky Vendim to ti komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 41/12, Gezim dhe Makfire Kastrati, datë 26 shkurt 2013- Kundër Gjykates Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Rasti KI 41/12, Aktgjykim për Pranueshmëri i 25 janarit 2013

Fjalët kyçe: Gjykata Komunale në Prishtinë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kërkesë individuale, aktgjykim, e drejta për jetën, e drejta për mjete juridike, mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut.

Parashtruesit janë prindërit e të ndjerës D.K. e cila pas disa mosmarrëvesheve që pasuan më kërcënime për jetë nga ish partneri i saj, kishte kërkuar urdhër për mbrojtje emergjente nga Gjykata Komunale në Prishtinë. Gjykata Komunale në Prishtinë nuk i është përgjigjur D.K.-së, duke mos aprovuar e as refuzuar kërkesën e saj. Pas disa ditësh, D.K. kishte humbur jetën tragjikisht si pasojë e plagëve të marra me armë zjarri nga ish partneri i saj.

Parashtruesit paraqitën kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se Gjykata Komunale në Prishtinë nuk ka vepruar sipas Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Sipas prashtruesve shkelja nuk është pasojë e një vendimi gjyqësor, por nga mosveprimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, rrjedhimisht me këtë me mosveprim ka bërë shkelje të nenit 25 [E drejta për jetën] , 31 [E drejta përgjykim të drejtë dhe të paanshëm], 32 [e drejta për mjete juridike] dhe 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Parashtruesit gjithashtu pretendojnë se Këshilli Gjyqësor i Kosovës jo vetëm që nuk adresoi rastin e D. K. dhe shkeljen e të drejtave të saj, mirëpo nuk ofroi mjete juridike për rastet e ardhshme të dhunë së familje kur viktimat kërkojnë veprime nga gjykatat komunale, por ato nuk veprojnë fare.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesve ishte e pranueshme pasi që përmbushte kriteret e pranueshmërisë të paparë me Rregulloren e Punës. Në vlerësimin e meritave të kërkesës së parashtruesve, Gjykata konkludoi se Gjykata Komunale në Prishtinë ishte përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve te parashikuara me Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, dhe se mosveprimi i saj paraqet shkelje të detyrimeve kushtetuese që rrjedhin nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së. Më tej, Gjykata konstatoi se mosveprimi i Gjykatës Komunale në Prishtine në kërkesën e së ndjerës D.K. për lëshimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, si dhe praktika e zhvilluar nga KGJK për adresimin e mosveprimit të gjykatave të rregullta atëherë kur duhet të veprojnë, ka penguar viktimën dhe parashtruesit e kërkesës në realizimin e të drejtave të tyre për mjete efektive juridike, të parapara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së.

AKTGJYKIM
në
Rastin KI41/12
Parashtrues
Gëzim dhe Makfire Kastrati
kundër
Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë prindërit e të ndjerës D. K., z. Gëzim Kastrati dhe znj Makfire Kastrati, me vendbanim në Prishtinë, të përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" sh.p.k., me seli në Prishtinë.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Komunale në Prishtinë nuk ka vepruar sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L-182. Rrjedhimisht, shkelja nuk është pasojë e një vendimi gjyqësor, por e mosveprimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

Baza juridike

3. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); në nenin 21 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 56.1 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

4. Më 17 prill 2012, parashtruesit dorëzuan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Kushtetuese), me pretendimin se Gjykata Komunale në Prishtinë, me mosveprimin e saj, ka bërë shkelje të nenit 25, të nenit 31, të nenit 32 dhe të nenit 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

5. Më 23 prill 2012, Kryetari emëroi gjyqtaren Iliriana Islami, si gjyqtare raportuese, dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

6. Më 4 maj 2012, Gjykata Kushtetuese i dërgoi njoftim parashtruesit të kërkesës dhe kërkoi informacione dhe dokumente shtesë.

7. Më 7 maj 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës përkitazi me kërkesën e parashtruar dhe i ftoi për t'i paraqitur komentet e tyre për pretendimet e ngritura.

8. Më 8 maj 2012 parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese një parashtresë për zgjerimin e kërkesës fillestare, duke kërkuar shqyrtimin e pohimeve për shkelje të së drejtës për jetë, të paraparë me nenin 25 të Kushtetutës, me nenin 3 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, dhe me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

9. Më 11 maj 2012, parashtruesi i kërkesës dorëzoi informacionet dhe dokumentet shtesë, të kërkuara nga Gjykata Kushtetuese, më 4 maj 2012.

10. Më 31 maj 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Komunale në Prishtinë dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KGJK) për zgjerimin e kërkesës fillestare nga parashtruesi i kërkesës dhe, në të njëjtën kohë, kërkoi nga Gjykata Komunale në Prishtinë t'i ofrojë komentet përkitazi me pretendimet e ngritura nga parashtruesi.

11. Në të njëjtën ditë, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Komunale në Prishtinë të dorëzojë dokumentacionin e kompletuar të lëndës së të ndjerës dhe kërkoi nga KGJK-ja të ofrojë informacione për hapat e ndërmarrë në adresimin e rastit të së ndjerës. Deri më tash, nuk është pranuar asnjë përgjigje nga Gjykata Komunale në Prishtinë.

12. Më 7 qershor 2012, Gjykata Kushtetuese pranoi një përgjigje nga KGJK-ja, me të cilën u informua për hapat e ndërmarrë nga KGJK-ja përkitazi me rastin në fjalë.

13. Më 2 korrik 2012, Kryetari zëvendësoi gjyqtaren Iliriana Islami, si gjyqtare raportuese, për shkak të përfundimit të mandatit, me gjyqtarin Altay Suroy.

14. Më 25 janar 2013, pas shqyrtimit të raportit paraprak të gjyqtarit Altay Suroy, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Parashtruesit janë prindërit e D. K., e lindur më 18 shkurt 1984, në Prishtinë, e cila u privua nga jeta më 18 maj 2011. D. K. ka jetuar me familjen e saj deri më 10 shkurt 2000.

16. Gjatë vijimit të shkollës së mesme, D. K. ishte njoftuar me A. J., me të cilin krijoi marrëdhënie personale dhe, më 2 shkurt 2000, bashkë vendosin të themelojnë bashkësi jashtëmartesore.

17. Më 2 gusht 2003, D. K.-së dhe A. J.-së u lind një vajzë.

18. Më 17 janar 2011, D. K. paraqiti padi për shkëputjen e bashkësisë së saj jashtëmartesore me A. J.-në, shkaku i çrregullimit të marrëdhënieve ndërmjet tyre.

19. Pas paraqitjes së padisë, D. K. mori vajzën dhe, së bashku, shkuan të prindërit e saj për të jetuar.

20. Më 26 prill 2011, D. K., me një parashtresë drejtuar Gjykatës Komunale në Prishtinë, bëri precizimin e padisë së 17 janarit 2011, ashtu që, atëbotë, kërkoi që objekt i shqyrtimit të jetë vetëm çështja e besimit në ruajtje, ushqim dhe shkollim të vajzës së tyre.

21. Gjithashtu, më 26 prill 2011, si pasojë e kërcënimeve të vazhdueshme të pretenduara nga A. J. në drejtim të D. K.-së dhe në drejtim të vajzës së tyre, D. K. paraqiti kërkesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë për lëshimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, bazuar në nenin 15 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L182.

22. Më 18 maj 2011, D. K. vdiq pasi mori plagë në qafë, nga armë zjarri, e shkrepur nga A. J. Ndërsa, vajza A. u dërgua te prindërit e A. J.-së, në vendbanimin e tyre në hotelin "AS".

23. Më 30 maj 2011, prindërit e D. K.-së (parashtruesit) paraqitën parashtresë për precizimin e padisë së parashtruar në Gjykatën Komunale në Prishtinë nga D. K.-ja, më 17 janar 2011, në të cilën kërkohet që i padituri të jetë S. J. (babai i A. J.-së).

24. Më 29 korrik 2011, organizata joqeveritare CLARD (Centre for Legal Aid and Regional Development), sipas autorizimit të parashtruesve, i dorëzoi Këshillit Gjyqësor të Kosovës Shkresën 01/031-1031, "kërkesë për efikasitet në zbatimin e Ligjit Kundër Dhunës në Familje", duke u përqendruar në rastin e D. K.-së.

25. Më 29 shtator 2011, organizata joqeveritare CLARD, duke insistuar, dërgoi edhe një herë Shkresën 01/031-1031, nëpërmjet të cilës kërkoi nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës njoftim apo përgjigje në kërkesën e dërguar paraprakisht.

26. Më 07 nëntor 2011, organizata joqeveritare CLARD pranoi përgjigje nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për Shkresën 01/031-1031, në të cilën thuhet se kërkesa do të trajtohet në njërën nga mbledhjet e radhës të Këshillit. Gjithashtu, shkresa sugjeron se, për raste të caktuara, ku CLARD-i konsideron që gjyqtarët e caktuar kanë dështuar të zbatojnë ligjin, të iniciojë hetime në Zyrën e Prokurorit Disiplinor (Ligji mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Kreu VII; neni 43, neni 44 dhe neni 45).

Pohimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Komunale e Prishtinës, me mosveprimin e saj në përputhje me obligimet e saj kushtetuese dhe ligjore për ta trajtuar kërkesën për urdhër për mbrojtje emergjente, ka cenuar të drejtat individuale të D. K.-së dhe, tërthorazi, të parashtruesve të kërkesës, të garantuara me nenin 25, me nenin 31, me nenin 32 dhe me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe me nenin 2, me nenin 6 e me nenin 13 të KEDNJ-së.

28. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pohojnë se Gjykata Kushtetuese duhet ta adresojë këtë çështje, me qëllim të parandalimit të rasteve të njëjta tragjike në të ardhmen, si dhe me qëllim të vetëdijesimit të opinionit publik për urgjencën e funksionalizimit të gjykatave të rregullta.

29. Më tej, parashtruesit theksojnë se "Gjykata Komunale e Prishtinës ka pasur obligim të veprojë brenda njëzetekatër (24) orësh nga momenti kur D. K. ka paraqitur kërkesë për urdhër për mbrojtje emergjente. Ajo gjykatë nuk ka vepruar fare në këtë rast. Shqyrtimi i legjislacionit përkatës tregon se sa i përket mjeteve juridike në rastet e veprimit nga Gjykata Komunale e Prishtinës, kur ajo duhet të veprojë siç i obligon neni 19 i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L-182, mund të konstatohet se nuk ekzistojnë mjete juridike, të cilat mund të përdorë viktima në rastin e mosveprimit të Gjykatës Komunale".

30. Parashtruesit, gjithashtu, theksojnë se "neni 19 i Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L-182, parasheh vetëm procedurat ankimore kundër vendimeve gjyqësore për urdhër për mbrojtje, mirëpo nuk parasheh mjete juridike për paraqitësit e kërkesave për mbrojtje në rastet kur gjykata nuk vepron fare".

31. Për më tepër, sipas parashtruesve, "po ashtu, Ligji për Procedurën Kontestimore, Nr. 03/L-006, parasheh një mori mjetesh juridike – duke përfshirë ankesën, revizionin, përsëritjen e procedurës dhe mbrojtjen e ligjshmërisë – mirëpo, të gjitha këto mjete juridike, nuk adresojnë rastin kur shkeljet e pretenduara kushtetuese janë pasojë e mosveprimit të autoritetit publik (mosekzistimit të vendimit gjyqësor). Njësoj, edhe Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Nr. 03/L-223, në nenet 33-49, parasheh vetëm inicimin e procedurës disiplinore dhe sanksionet kundër gjyqtarëve ose gjyqtarëve porotë për sjellje të pahijshme. Mirëpo, ky ligj nuk parasheh mjete juridike për rrethanat aktuale, kur Gjykata nuk vepron në mbrojtjen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare".

32. Parashtruesit insistojnë që, "në këtë rast, jo vetëm që shterja e mjeteve juridike nuk është efektive, por është e pamundshme, pasi që, në fakt, mjetet juridike nuk ekzistojnë fare".

33. Më tej, parashtruesit pohojnë se, nëpërmjet OJQ-së CLARD, i janë drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke kërkuar zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, me qëllim të parandalimit të neglizhencës nga gjykatat e rregullta, që për pasojë kanë shkeljen e të drejtave individuale të viktimave të tjera. Mirëpo, sipas parashtruesve, ky adresim nuk ka qenë i frytshëm, pasi KGJK-ja fillimisht nuk i është përgjigjur shkresave të dërguara nëpërmjet CLARD-it, e më vonë ka dhënë përgjigje se çështja do të adresohet në mbledhjen e radhës së KGJK-së, mirëpo parashtruesit nuk kanë pranuar asnjë përgjigje për këtë deri më 26 mars 2012.

34. Parashtruesit theksojnë se, më 26 mars 2012, nëpërmjet OJQ-së CLARD, kanë pranuar një shkresë nga KGJK-ja, me të cilën informohen se KGJK-ja u ka dërguar gjykatave komunale vendimin e tij që i udhëzon ato gjykata të zbatojnë Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L-182. Me këtë, sipas parashtruesve, "KGJK jo vetëm që nuk adreson rastin e D. K.-së dhe shkeljen e të drejtave të saj, mirëpo nuk ofron mjete juridike për rastet e ardhshme të dhunës në familje, kur viktimat kërkojnë veprime nga gjykatat komunale, por ato nuk veprojnë fare".

35. Për më tepër, parashtruesit pretendojnë se "vetë mungesa e mjeteve juridike, teorike dhe praktike, në këtë rast, mund të cilësohet si shkelje e të drejtave individuale. Neni 13 i KEDNJ-së dhe neni 32 i Kushtetutës garantojnë të drejtën për mjete juridike. Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L182, nuk parasheh fare mjete juridike për paraqitësit e kërkesave për urdhër për mbrojtje nga dhuna në rastet kur gjykata nuk vepron fare. Prandaj, pamundësia e qasjes në mjete juridike në rastin e paracekur, në vetvete nënkupton shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me konventa".

36. Në shtjellimin e pretendimit të tyre për shkelje të nenit 25 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të KEDNJ-së, parashtruesit i referohen praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) duke theksuar se "kjo gjykatë, në rastin *Osman v. The United Kingdom,* ka vlerësuar se personi që pretendon se i është cenuar e drejta në jetë duhet të dëshmojë se (1) autoriteti e ka ditur ose është dashur ta dijë në atë kohë për ekzistimin e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e një personi ose personave të identifikuar nga veprat kriminale të një pale të tretë dhe (2) ka dështuar të ndërmarrë masat brenda fushëveprimit të fuqive të tij që, të gjykuara arsyeshëm, mund të jenë pritur ta kenë parandaluar atë rrezik. Pra, shteti ka obligim të veprojë kur kushtet e paracekura dëshmohen nga personi, në të kundërtën cilësohet se ia ka cenuar personit të drejtën në jetë".

37. Për më tepër, parashtruesit pohojnë se "GJEDNJ-ja shkon edhe një hap më tutje dhe gjykon se një person, që të mbajë shtetin përgjegjës për shkelje të së drejtës për jetë, duhet vetëm të dëshmojë se autoriteti nuk ka bërë të tërën që mund të pritet nga ai brenda arsyes që të parandalojë një rrezik real dhe të menjëhershëm ndaj jetës për të cilin kanë ose duhet të kenë pasur njohuri".

38. Më tej, parashtruesit theksojnë se "ekziston një mori rastesh ku GJENDJ-ja ka gjykuar se autoriteti publik ka cenuar të drejtën për jetë në rrethana kur ka dështuar të veprojë në mbrojtje të personit, pra në

rrethana shumë të përafërta me ato të D. K.-së. Në rastin *Kontrova v. Slovakia,* policia kishte bindur një grua që të tërheqë denoncimin penal ndaj bashkëshortit kur ai e kishte rrahur me kabllo elektrike. Pas tërheqjes së denoncimit penal, bashkëshorti kishte vrarë djalin e vajzën dhe gruas nuk iu dha kompensim. GJEDNJ-ja gjykoi dhe gjeti shkelje të së drejtës për jetë, specifikisht të nenit 2 të Konventës Evropiane, për arsye se policia kishte dështuar të mbrojë jetët e fëmijëve. Njëherazi, gjykata gjeti edhe cenim të nenit 13 (E Drejta për Mjete Efektive), për shkak të moskompensimit të nënës. Qëndrime të ngjashme për cenim të së drejtës për jetë (neni 2), GJEDNJ-ja ka treguar edhe në raste të tjera, si: *Branko Tomašić and Others v. Croatia* dhe *Opuz v. Turkey*".

Përgjigja nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës

39. Në përgjigjen e KGJK-së, të pranuar më 7 qershor 2012, ndër të tjera theksohet:

"Komisioni Disiplinor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës e ka pranuar më 21 korrik 2011 propozimin ZPD/11/kb/0556 për inicimin e procedurës për suspendimin e gjyqtarit E. Sh., gjyqtar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për sjellje të pahijshme: Dështim për të kryer funksionin e gjyqësorit nga neni 34 par. I pika 1.2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës: b) Shkelje e Kodit Relevant të Etikës neni 34 par. I pika 1.4 të Ligjit dhe atë: I. Parimet e përgjithshme pika I (gjyqtari vepron në çdo kohë në atë mënyrë që të nxit besimin e publikut në dinjitet, integritet dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor); b) Respekton dhe i përmbahet ligjit; c) kryen detyra në mënyrë të kujdesshme; e) kryen detyra konform me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; dhe II Rregulla specifike A. Veprimtaritë Gjykuese, I. Gjatë procedurës Gjyqtari ka për detyrë t'i mbrojë të drejtat dhe liritë e gjithë personave. Komisioni Disiplinor i KGJK-së ka mbajtur seancë për shqyrtimin e kësaj kërkese për suspendim me datë 31.08.2011 dhe ka refuzuar kërkesën për suspendim me pagesë si të pabazë dhe si e tillë është refuzuar për arsye se prej kohës kur është dorëzuar propozimi ka kaluar një kohë e gjatë nga dita kur ka ndodhur rasti tragjik, respektivisht propozimi është dorëzuar me datë 21 korrik 2011, pra kanë kaluar afër dy muaj dhe shqiptimi i kësaj mase nuk do të kishte kurrfarë efekti.

Në bazë të nenit 36 par. I të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Komisioni Disiplinor mori vendim që ndaj E. Sh., gjyqtar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, të iniciohet procedura dhe hetim disiplinor dhe

kjo seancë të mbahet në afatin ligjor kur Zyra e Prokurorit Disiplinor të dërgojë raportin përfundimtar.

Kundër këtij vendimi është bërë ankesë nga ZPD-ja, dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka mbajtur mbledhje dhe e ka shqyrtuar këtë ankesë me datë 31 tetor 2011, ankesën e Zyrës së Prokurorit Disiplinor e ka hedhur poshtë si jolëndore, pasi që komisioni ka mbajtur seancë dhe ka marrë vendim lidhur me këtë çështje. Komisioni Disiplinor në seancën e mbajtur me datë 18.10.2011 me vendimin me numër KD. nr. 40/2011, i ka shqiptuar masën disiplinore Ulje e rrogës për 50% për dy muaj nga paga mujore. Me këtë vendim me numër KD. nr. 40/20 II ka përfunduar procedura kështu që pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, për të cilën do të vendos Këshilli, mirëpo kundër këtij vendimi nuk ka bërë ankesë asnjëra palë".

Ligji i zbatueshëm

40. Dispozitat ligjore relevante përkitazi me shkeljet e pretenduara të parashtruesit janë të definuara në instrumentet e mëposhtme:

Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Nr. 03/L-182:

Neni 1 [Qëllimi i ligjit]

1. *Ky ligj ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktima të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.*

2. *Ky ligj, po ashtu, ka për qëllim trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.*

[...]

Neni 13 [Kërkesat për urdhërmbrojtje ose urdhërmbrojtje emergjente]

1. *Kërkesën për urdhërmbrojtje mund ta paraqesë:*

    1.1. *pala e mbrojtur;*

1.2. përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur;

1.3. mbrojtësi i viktimave me pëlqimin e palës së mbrojtur;

1.4. përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur ka vendbanimin apo vendqëndrimin në rastet kur viktimë është i mituri.

2. Kërkesën për urdhërmbrojtje emergjente mund ta paraqesë:

2.1. pala e mbrojtur;

2.2. përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur;
2.3. mbrojtësi i viktimave me pëlqimin e palës së mbrojtur;

2.4. personi me të cilën pala e mbrojtur ka lidhje familjare;

2.5. përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur e ka vendbanimin apo vendqëndrimin në rastet kur viktimë është i mituri;

2.6. personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një apo më tepër vepra të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur.

3. Kërkesë për urdhërmbrojte ose për urdhërmbrojtje emergjente mund të paraqesin edhe OJQ-të, që janë familjarizuar me problemin e viktimës, që janë njoftuar mirë për trajtimin e tyre.

[...]

Neni 16 [Shqyrtimi i kërkesës për urdhërmbrojtje emergjente]

1. Gjykata vendos përkitazi me kërkesën për urdhërmbrojtje emergjente brenda njëzetekatër (24) orësh pas parashtrimit të kërkesës.

2. Me rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhërmbrojtje emergjente, gjykata duhet të mbajë seancë në të cilën dëgjohen personat në vijim:

2.1. pala e mbrojtur, përfaqësuesi i autorizuar, ose mbrojtësi i viktimave;

2.2. kryerësi i dhunës ose përfaqësuesi i autorizuar;

2.3. parashtruesi i kërkesës; dhe

2.4. çdo dëshmitar, i cili ka njohuri për dhunën në familje.

3. Sipas nevojës, gjykata mund të bëjë dëgjimin dhe shqiptimin e urdhrit mbrojtës në mungesë të kryerësit të dhunës ne familje, duke shfrytëzuar dhe mjetet tjera alternative përfshirë ato elektronike.

Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Nr. 03/L-223:

Neni 34 [Sjellja e pahijshme]

1. Për qëllimet ë këtij ligji, sjellje të pahijshme nga gjyqtari apo gjyqtari porotë përbën:

1.1. dënimi përfundimtar për një vepër penale, përpos kundërvajtjeve siç përkufizohet me ligj;

1.2. neglizhencë në kryerjen , dështimin për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore;

1.3. të dështuarit e kryerjes së funksioneve gjyqësore në mënyrë të pavarur dhe të paanshme;

1.4. shkelja e kodeve të zbatueshme të etikës

2. Komisioni Disiplinor mund të pezullojë gjyqtarin apo gjyqtarin porotë me pagesë gjatë cilësdo fazë të hetimit apo gjatë procedurës disiplinore.

3. Këshilli Gjyqësor nxjerr rregullore që përcakton sjelljet e pahijshme.

[...]

Neni 37 [Masat disiplinore]

1. *Komisioni Disiplinor mund të vendosë sanksionet disiplinore si në vijim:*
    1.1. *qortim;*
    1.2. *qortim me udhëzim për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese;*
    1.3. *ulje të përkohshme të rrogës deri në pesëdhjetë për qind (50%) duke pasur parasysh natyrën e sjelljes së pahijshme; ose*
    1.4. *propozim për largimin nga zyra e gjyqtarit apo gjyqtarit porotë.*

2. *Komisioni vendos një sanksion i cili është në përputhje me rrethanat, nivelin e përgjegjësisë dhe pasojat e sjelljes së pahijshme;*

3. *Komisioni, siç ceket në këtë ligj, i dërgon Këshillit një rekomandim në formë të shkruar për shkarkimin nga detyra të një gjyqtari;*

4. *Nëse gjyqtari apo gjyqtari porotë pas përfundimit të procedurës disiplinore lirohet nga akuzat, ai apo ajo, me vendim të Këshillit, kthehet në zyrën e tij apo saj të mëparshme.*

Neni 38 [Shkarkimi i Gjyqtarëve dhe Gjyqtarëve Porotë]

1. *Bazuar në procedurat disiplinore, Këshilli vendos nëse sjellja e pahijshme e gjyqtarit apo gjyqtarit porotë justifikon shkarkimin. Çdo rekomandim i Këshillit për shkarkimin e një gjyqtari apo gjyqtari porotë përfshin arsyet me shkrim për rekomandimet e tilla si dhe konkluzionet themelore të Komisionit.*

2. *Rekomandimi i Këshillit për shkarkim si parashihet në paragrafin 1. të këtij neni, i dërgohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh Presidentit dhe gjyqtarit apo gjyqtarit porotë në fjalë.*

3. *Presidenti i Republikës së Kosovës vendos për rekomandimin e Këshillit për shkarkim në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me këtë ligj.*

4. *Lidhur me vendimin e Presidentit të Kosovës mbi miratimin apo refuzimin për shkarkim, gjyqtarët apo gjyqtarët porotë njoftohen zyrtarisht nga Këshilli para se një vendim i tillë të zbatohet.*

[...]

Neni 45 [Përgjegjësitë e Prokurorit Disiplinor]

1. *Zyra e Prokurorit Disiplinor është përgjegjëse për inicimin e hetimit ndaj gjyqtarëve apo gjyqtarëve porotë aty ku ekziston bazë e arsyeshme për të besuar që sjellja e pahijshme mund të ketë ndodhur si dhe për ofrimin e rekomandimeve dhe paraqitjes pranë Komisionit Disiplinor të provave në mbështetje të veprimit disiplinor.*

2. *Zyra e Prokurorit Disiplinor inicion hetime në rastet kur:*

    2.1. *pranë Zyrës së Prokurorit Disiplinor ekziston ankesa e paraqitur nga cilido person fizik apo juridik;*

    2.2. *Me vetiniciativë, kur ekziston bazë e arsyeshme për të besuar se një gjyqtar apo gjyqtar porotë mund të jetë përfshirë një sjellje e pahijshme.*

3. *Të gjitha ankesat, pavarësisht origjinës së tyre, dërgohen për hetim në Zyrën e Prokurorit Disiplinor.*

4. *Zyra e Prokurorit Disiplinor heton hollësisht të gjitha çështjet që i referohen, vendos nëse rekomandimet për veprime disiplinore duhet t'i paraqiten Komisionit Disiplinor si dhe njofton me shkrim Komisionin Disiplinor dhe gjyqtarët apo gjyqtarët porotë të dyshuar lidhur me rezultatet e hetimit.*

5. *Zyra e Prokurorit Disiplinor ka të drejtë të thërrasë dëshmitarë si dhe dokumentet e nevojshme për hetim dhe të përcaktojë nëse rekomandimet për veprim disiplinor duhet të paraqiten tek Komisioni Disiplinor.*

6. *Zyra e Prokurorit Disiplinor i paraqet Komisionit Disiplinor rekomandimet për veprimet disiplinore si dhe provat në mbështetje të veprimit disiplinor për sjellje të pahijshme.*

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

41. Për të qenë në gjendje të vlerësojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

42. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parashikon si në vijim:

"*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj";*

si dhe nenit 47 të Ligjit, i cili përcakton:

"Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik";

dhe se:

"*Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi ti ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

43. Gjykata, së pari, shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i përmbushin kushtet e parapara për të qenë palë e autorizuar në përputhje me dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore.

44. Për këtë qëllim, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila, në raste të ngjashme, ka pranuar kërkesa individuale nga individët që konsiderohen si viktima të tërthorta, kur ekziston një lidhje personale dhe specifike ndërmjet viktimës dhe parashtruesit. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja, në një rast, ka pranuar si palë të autorizuar bashkëshorten e të ndjerit (*Shih, McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 18984/91, Aktgjykimi i 27 shtatorit 1995),* ndërsa, në një rast tjetër, nipit të të ndjerit i ka pranuar statusin e palës së autorizuar *(Shih, Yaşa kundër Turqisë, nr. 63/1997/847/1054 , Aktgjykim i 2 shtatorit 1998*).

45. Si rrjedhojë, duke marrë parasysh se parashtruesit e kërkesës janë prindërit e të ndjerës, Gjykata konstaton se parashtruesit mund të

konsiderohen palë e autorizuar në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 47 të Ligjit.

46. Përveç kësaj, Gjykata duhet të konstatojë nëse parashtruesit i kanë shteruar mjetet ekzistuese juridike në kuadër të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës.

47. Gjykata Kushtetuese rikujton se, në Aktgjykimin AGJ63/10 në Rastin KI06/10, Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë, theksoi që, sipas praktikës së mirëfilltë gjyqësore të GJEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës duhet të shterojnë mjetet juridike vendëse, që janë në dispozicion dhe që janë efektive. Për më tepër, ky rregull duhet të zbatohet me një shkallë fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruar. GJEDNJ-ja, më tej, pranoi që rregulli i shterjes së mjeteve juridike nuk është as absolut e as në gjendje të zbatohet në mënyrë automatike. Me rastin e shqyrtimit, nëse ai është zbatuar, është me rëndësi të merren parasysh rrethanat e posaçme të secilit rast individual. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se ai duhet të ketë parasysh jo vetëm ekzistimin e mjeteve zyrtare juridike në sistemin e vendit në fjalë, por edhe kontekstin e përgjithshëm ligjor dhe politik në të cilin veprojnë, si dhe rrethanat personale të parashtruesit të kërkesës (*Shih aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin Akdivar kundër Turqisë*).

48. Gjykata Kushtetuese vëren se, më 26 prill 2010, e ndjera D. K. ka dorëzuar kërkesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë për lëshimin e urdhrit për mbrojtje emergjente.

49. E ndjera nuk ka pasur ndonjë mjet tjetër juridik, pasi ajo nuk ka pranuar asnjë vendim nga Gjykata Komunale në Prishtinë, që do të pranonte apo që do të refuzonte kërkesën e saj.

50. Në anën tjetër, parashtruesit e kërkesës insistojnë se as ata nuk kanë pasur mjete në dispozicion dhe efektive që do të mund t'i ushtronin.

51. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe nga përgjigja me shkrim e KGJK-së, ku përshkruhet procedura disiplinore e zhvilluar për këtë rast, e tëra që kanë mundur të bëjnë parashtruesit, është ankesa drejtuar Zyrës së Prokurorit Disiplinor, ndërsa në fazat e mëtutjeshme në komisionin përkatës në KGJK, dhe se ata nuk kanë pasur mundësi të jetë palë në procedurë.

52. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesit nuk kanë pasur ndonjë mjet juridik efektiv në dispozicion, për t'i mbrojtur të drejtat e tyre.

53. Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kushtet e pranueshmërisë, pasi parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar, pasi ata nuk kanë pasur mjete juridike në dispozicion që do të ishin efektive dhe pasi ata i kanë qartësuar saktësisht shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive.

Vlerësimi i kushtetutshmërisë të kërkesës

I. Sa i përket të drejtës për jetë

54. Parashtruesit ankohen se, si pasojë e mosveprimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, ka ndodhur shkelja e të drejtës për jetë, e paraparë më nenin 25.1 të Kushtetutës.

55. Neni 25.1 i Kushtetutës thekson:

"Secili individ gëzon të drejtën për jetën".

56. Në anën tjetër, neni 2 i KEDNJ-së, thekson:

"E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj".

57. Gjykata Kushtetuese thekson se e drejta për jetën është e drejta më e rëndësishme e të gjitha qenieve njerëzore. Është e drejtë nga e cila rrjedhin të gjitha të drejtat e tjera.

58. Gjykata Kushtetuese rikujton se, në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, është detyrim i saj kushtetues që interpretimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut ta bëjë në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

59. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja thekson se është detyrim i organeve shtetërore që, jo vetëm të përmbahen nga marrja e qëllimshme dhe e paligjshme e jetës, por gjithashtu të ndërmarrin hapat e duhur për mbrojtjen e jetës së individëve brenda juridiksionit të tyre (*Shih, L. C. B. kundër Mbretërisë së Bashkuar, 9 qershor 1998*). Kjo nënkupton detyrimin parësor të shtetit që të sigurojë të drejtën për jetë, duke vendosur dispozita penale efektive për të penguar kryerjen e veprave penale kundër individit, të mbështetura nga mekanizmat e zbatimit të ligjit për parandalimin, për ndëshkimin dhe për shuarjen e shkeljeve të

dispozitave të tilla. Në rrethana të përshtatshme, zgjerohet gjithashtu një detyrim pozitiv për autoritetet që të marrin masa parandaluese operative për të mbrojtur një individ, jeta e të cilit është në rrezik nga veprat penale të një individi tjetër (*Shih, Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar, 28 tetor 1998, i cituar edhe në Kontrova kundër Sllovakisë, 24 shtator 2007, dhe Opuz kundër Turqisë, 9 qershor 2009*).

60. Për më tepër, për t'u ngritur një detyrim pozitiv, duhet të vërtetohet nëse autoritetet kanë ditur apo është dashur të dinë, në kohën e ekzistimit të një rreziku real dhe të menjëhershëm, për jetën e një individi të identifikuar nga veprat kriminale të një pale të tretë dhe që kanë dështuar të ndërmarrin masa brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre që, gjykuar arsyeshëm, do të mund të pritej ta mënjanonin atë rrezik (*Ibid., paragrafi 116*).

61. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se, nga dokumentacioni i deponuar në Gjykatë, mund të konstatohet që autoriteti përgjegjës, në këtë rast Gjykata Komunale në Prishtinë, është dashur të dijë për rrezikun real që ka ekzistuar me rastin e dorëzimit të kërkesës për lëshim të urdhrit për mbrojtje emergjente, pasi D. K.-ja ka shpjeguar në mënyrë kronologjike përkeqësimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre, duke specifikuar edhe kërcënimet me vdekje nga ish-partneri dhe duke ofruar dëshmi për raportimin paraprak në organet policore për kërcënimet e pranuara.

62. Për më tepër, Gjykata Komunale në Prishtinë paraprakisht ka trajtuar një lëndë të iniciuar nga D. K.-ja për shkëputjen e bashkësisë jashtëmartesore dhe për caktimin e kujdestarisë së fëmijës së të ndjerës dhe ish-partnerit të saj, kur edhe kishte filluar shfaqja e problemeve serioze ndërmjet tyre dhe që, më vonë, kishte rezultuar me kërcënime të ndryshme.

63. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se Gjykata Komunale në Prishtinë ishte përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të parashikuara me Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, dhe se mosveprimi i saj paraqet shkelje të detyrimeve kushtetuese që rrjedhin nga neni 25 i Kushtetutës dhe nga neni 2 i KEDNJ-së.

II. Sa i përket të drejtës për mjete efektive juridike

64. Parashtruesit, gjithashtu, ankohen se është shkelur e drejta e tyre për mjete efektive juridike, e garantuar me nenin 32 dhe me nenin 54 të Kushtetutës.

65. Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] thekson:

"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj".

66. Gjithashtu, neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] thekson:

"Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".

67. Për më tepër, neni 13 i KEDNJ-së thekson:

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare".

68. Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykimin e 30 tetorit 2010, në rastin KI06/10, Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë, ka trajtuar çështjen e mjeteve juridike efektive, me ç'rast ka theksuar: *"... që sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë (në nivel kombëtar) të një mjeti juridik për ta zbatuar substancën e të drejtave dhe lirive të parapara me Konventë, në çfarëdo forme që mund të ndodhin për të qenë i siguruar në rendin ligjor të vendit. Qëllimi i nenit 13 është të kërkojë sigurimin e një mjeti juridik vendor për ta trajtuar substancën e një 'pretendimi të diskutueshëm' sipas Konventës dhe për të ofruar mbrojtje përkatëse juridike".* (*Shih Aktgjykimin 63 10, të 30 tetorit 2010, §91*).

69. Më tej, në po të njëjtin aktgjykim, Gjykata theksoi: *"Përmasa e obligimit sipas nenit 13 të Konventës ndryshon varësisht nga natyra e ankesës së parashtruesit të kërkesës; megjithatë, mbrojtja përkatëse juridike që kërkohet me nenin 13 duhet të jetë 'efektive' në praktikë dhe në ligj. 'Efektiviteti' i një 'mjeti juridik' brenda kuptimit të nenit 13 nuk varet nga siguria e një rezultati të favorshëm për parashtruesin e kërkesës. As 'autoriteti' i përmendur në atë dispozitë nuk është medoemos e thënë të jetë autoritet gjyqësor, por nëse nuk është, kompetencat e tij dhe garancitë që i ofron janë përkatëse për të përcaktuar nëse mjeti juridik para tij është efektiv. Gjithashtu, edhe nëse një mjet i vetëm juridik nuk i*

kënaq në tërësi kriteret e nenit 13, tërësia e mjeteve juridike të parapara me ligjin e vendit mund ta bëjë një gjë të tillë (Shih Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Silver dhe të tjerët kundër aktgjykimit të Mbretërisë së Bashkuar, i 25 marsit 1983, Seria A, nr. 61, p. 42, para. 113)". (*Ibid., §92*).

70. Gjithashtu, duhet theksuar se i njëjti aktgjykim shpjegon se *"Rregulli i shterimit të mjeteve juridike bazohet në supozimin e pasqyruar në nenin 13 (me të cilin ka lidhje të ngushtë) se ekziston një mjet efektiv juridik në dispozicion për sa i përket shkeljes së supozuar të të drejtave të individit të parapara me Konventë (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin Kudla kundër Polonisë, 26 tetor 2000).*

71. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se legjislacioni në fuqi: Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nuk ofrojnë mjete efektive juridike për mbrojtjen e të drejtave të parashtruesve.

72. Në fakt, në njërën anë, Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje nuk parasheh masa për adresimin e mosveprimit të institucioneve përgjegjëse në ato raste kur janë të detyruara të veprojnë. Në anën tjetër, siç mund të shihet nga Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, e po ashtu edhe nga përgjigja e KGJK-së, parashtruesit nuk kanë mundësi tjetër përveç ankesës drejtuar Zyrës së Prokurorit Disiplinor, por jo edhe më tutje në faza të tjera të procedurës. Sipas nenit 45.5 të këtij ligji, është e drejtë, por jo edhe detyrim i Zyrës së Prokurorit Disiplinor, "*të thërrasë dëshmitarë si dhe dokumentet e nevojshme për hetim dhe të përcaktojë nëse rekomandimet për veprim disiplinor duhet të paraqiten tek Komisioni Disiplinor".*

73. Gjykata rikujton se institucioni përgjegjës kryesor, Gjykata Komunale në Prishtinë, ka dështuar të ofrojë përgjigje në pyetjet e ngritura nga Gjykata dhe nuk ka ofruar dokumentacionin që posedon për këtë rast.

74. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konkludon se mosveprimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, në kërkesën e të ndjerës D. K. për lëshimin e urdhrit për mbrojtje emergjente, si dhe praktika e zhvilluar nga KGJK-ja për adresimin e mosveprimit të gjykatave të rregullta atëherë kur duhet të veprojnë, ka penguar viktimën dhe parashtruesit e kërkesës në realizimin e të drejtave të tyre për mjete efektive juridike, të parapara me nenin 32 e me nenin 54 të Kushtetutës dhe me nenin 13 të KEDNJ-së.

III. Sa i përket nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së

75. Gjykata nuk e konsideron të nevojshme trajtimin e pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës, duke pasur parasysh që Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 25, të nenit 32 dhe të nenit 54 të Kushtetutës; të nenit 2 e të nenit 13 të KEDNJ-së; dhe për faktin se nuk është zhvilluar ndonjë dëgjim apo seancë gjyqësore për rastin në fjalë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, në bazë të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në bazë të rregullit 56.1 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 janar 2013, njëzëri:

VENDOSI

I. Të shpallë kërkesën të pranueshme;

II. Të gjejë se ka pasur shkelje të së drejtës për jetë, të paraparë me nenin 25 të Kushtetutës dhe me nenin 2 të KEDNJ-së;

III. Të gjejë se ka pasur shkelje të së drejtës për mjete juridike, të paraparë me nenin 32 e me nenin 54 të Kushtetutës dhe me nenin 13 të KEDNJ-së;

IV. Të konsiderojë të panevojshëm trajtimin e pretendimit për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të paraparë me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së;

V. T'ua komunikojë palëve këtë vendim;

VI. Të publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

MENDIM KONKURUES DHE MOSPAJTUES
në

Rastin nr. KI 41/12
Parashtruesit
Gëzim dhe Makfire Kastrati
kundër
Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Në këtë rast, D. K., vajza e parashtruesve, ka dorëzuar një kërkesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për urdhër të mbrojtjes emergjente më 26 prill 2011. Gjykata Komunale në Prishtinë asnjëherë nuk ka vepruar sipas kërkesës së D. K., për të marrë mbrojtje. Fatkeqësisht, 22 ditë më vonë, më 18 maj 2011, D. K. u vra nga personi prej të cilit kërkonte nga gjykata që të kufizohej që të mos lëndohej ajo apo fëmija i saj. Prindërit e saj, parashtruesit në këtë rast, tani kërkojnë nga kjo gjykatë të deklarojë që dështimi i Gjykatës Komunale që të veprojë sipas kërkesës së vajzës së tyre, ka shkelur të drejtat e vajzës së tyre në bazë të Kushtetutës.

Në këtë rast, vajza e parashtruesit ka bërë këtë kërkesë specifike në Gjykatën Komunale në Prishtinë:

Kërkesa: D. K., Rr. "..." Nr. ... P.

Tel. ...

Kundërkërkesa: A.J. Rr. "....." nr... P.

Tel. ...
Tel. ...

<u>Në bazë të Ligjit nr. 03/L-182 për dhunën në familje, paraqes këtë:</u>

<u>Kërkesë për lëshimin e urdhrit për mbrojtje emergjente</u>

Unë, D. K. dhe A.J. kemi qenë në bashkësi jashtëmartesore prej 02.02.2000 deri më 26.11.2010. Nga kjo bashkësi jashtëmartesore, kemi një vajzë, A. J.2, të lindur më 2 gusht 2003 më Prishtinë. Gjatë gjithë kohës në bashkëjetesë kam vuajtur presion dhe dhunë kundër meje, por e kam duruar këtë vetëm për hir të vajzës sonë A., ashtu që ajo të mos mbetet pa prindër, si dhe të mos vuajë trauma të tjera. Gjithashtu, pasi kam lindur vajzën tonë A., ai ka filluar të bëjë

presion dhe të përdorë lloje të ndryshme të dhunës, duke filluar nga lëndimi fizik, ofendime të ndryshme, jo vetëm ndaj meje, por edhe kundër familjes sime. Më vonë, ka filluar të krijojë borxhe, si dhe ka ikur për një kohë nga Kosova, por nuk e kam ditur se ku ka shkuar. Nuk kam pasur kontakt me telefon. Gjatë kohës kur ka qenë jashtë Kosove, më kanë kërcënuar në mënyra të ndryshme njerëzit të cilëve u ka pasur borxh ai, para që as nuk e di se ku i ka çuar. Pas kthimit të tij në Kosovë, ka vazhduar me dhunë e papërgjegjësi ndaj vajzës sonë, si dhe gati gjatë gjithë kohës ka qenë nën ndikimin e alkoolit, si dhe gjithmonë u ka ikur përgjegjësive ndaj familjes së tij dhe duke ikur kohë pas kohe. Dhuna e tij ndaj meje ka qenë edhe më e madhe kur ka insistuar të marrë hua në shumën prej €1500. Jam detyruar të nënshkruaj kontratën e kredisë. Kam inicuar një rast në Gjykatën Komunale (e-75/11) dhe qysh prej 26 nëntorit, nuk jetoj me A.J., për shkak të frikës për më të keqen. Më 19 prill 2011, jam takuar me A.J. dhe prindërit e tij, derisa unë kam shkuar me babain dhe gjyshin për të biseduar në përpjekje për të zgjidhur problemin. Ai nuk ka pranuar ndarjen tonë në asnjë mënyrë, si dhe në prani të të gjithëve, filloi të ofendonte dhe të më kërcënonte në mënyrat më të ulta, i përkrahur edhe nga babai i tij, S.J., si dhe duke më kërcënuar me vrasje dhe duke më fajësuar që kam afera. Për shkak të frikës dhe dhunës fizike kundër meje, e kam raportuar rastin në polici (e palexueshme).

Sjelljet e tilla të ish-partnerit dhe ish-burrit tim po ma vështirësojnë jetën time dhe po ma rrezikojnë jetën. Kjo po e përkeqëson edhe gjendjen emocionale të vajzës sonë. Kështu, në bazë të të thënave si më lart, si dhe në bazë të Ligjit nr. 03/L-182, kërkoj gjithashtu që në bazë të neneve 1, 5, 6 dhe 9 të këtij ligji, që Gjykata Komunale në Prishtinë të shqyrtojë këtë kërkesë emergjente, si dhe propozoj që të mbajë seancë dëgjimi ku do të nxjerrë këtë

VENDIM

LËSHOHET URDHRI mbrojtës, me të cilin personi përgjegjës, A.J. me adresën e tij në rrugën "...", nr. ... në P. ...(tekst i palexueshëm) për kërcënimin që do të ndërmarrë vepër të dhunshme ndaj palës së mbrojtur D. K. me adresën Rr. "..." nr. ... në P. Njëkohësisht, A.J. URDHËROHET t'i lejojë palës së mbrojtur D. K. të vazhdojë jetën e saj pa ndonjë pengesë, bashkë me vajzën e tyre A., si dhe në pajtim me

Ligjin nr. 03/L-182 kundër dhunës në familje, respektivisht të neneve 1, 6, 7 dhe 9 të këtij ligji.

Siç përcaktohet me ligj, ankesa nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Prishtinë, 22.04. 2011

Ligji në fuqi Nr. 03/L-182, për mbrojtjen kundër dhunës në familje, kërkon nga gjykata të mbajë seancën brenda 24 orësh nga pranimi i kërkesës për mbrojtje për të vendusr nëse ka dëshmi të mjaftueshme për të lëshuar një urdhër gjyqësor që urdhëron personin që është pohuar të ketë kryer akte të sjelljes kërcënuese, si dhe që mund të jenë kërcënim i drejtpërdrejtë ndaj kërkuesit apo anëtarëve të familjes së kërkuesit që të kufizohet nga kontaktet me kërkuesin, si dhe të kufizohet nga vizitimi i vendbanimit të kërkuesit dhe vendet e tjera, si vendi i punës, që vizitohen shpesh nga kërkuesi. Shkelja e urdhrit gjyqësor, nëse nxirret një i tillë, është krim. Sipas ligjit, urdhri gjyqësor është mjet shtesë për t'i ndihmuar policisë që të parandalojë personat e caktuar nga kryerja e krimit ndaj kërkuesit, thjesht duke e bërë vepër penale nëse ai person kontakton me kërkuesin. E bën sjellje kriminale që përndryshe nuk do të ishte krim, por gjykata që gjen se sipas dëshmive të marra ka frikë të arsyetuar që personi që duhet kufizuar do ta dëmtojë kërkuesin nëse masat e mëtutjeshme për ta mbrojtur kërkuesin nuk zbatohen. Në fakt, ligji gjithashtu i lejon policisë që të lëshojë një urdhër të tillë të menjëhershëm për deri në 24 orë nëse marrin kërkesën e tillë në kohën kur gjykata nuk mban seancë.

Në këtë rast, edhe pse nuk ka deklaruar qartë se çfarë urdhri ka kërkuar nga Gjykata Komunale që ta lëshojë, ka informuar gjykatën për sjelljet që me arsye i kanë shkaktuar frikën e drejtpërdrejtë për veten dhe për vajzën e saj, si dhe ka kërkuar që ajo të ketë mbrojtje në bazë të ligjit. A është dështimi i gjykatës për të vepruar sipas kërkesës brenda 24 orësh në bazë të ligjit, ose edhe brenda 22 ditësh në vijim, shkelje e të drejtave të saj sipas Kushtetutës?

Neni 54 i Kushtetutës përcakton që:

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën për mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Në këtë rast, D.K. ka pasur të drejtë të ligjshme që kërkesa e saj të shqyrtohet nga Gjykata Komunale. Nëse Gjykata Komunale do ta mbante seancën dhe do

të kishte gjetur dëshmi të mjaftueshme për të lëshuar urdhrin mbrojtës për të, policia do të kishte pasur një mjet shtesë juridik për t'ia mundësuar mbrojtjen nga dëmet e ardhshme. Ajo kurrë nuk ka fituar një urdhër të tillë, e as një seancë dëgjimi për kërkesën e saj të ligjshme për Gjykatën Komunale. Asnjëherë nuk ka marrë një shpjegim me shkrim pse nuk është dhënë kërkesa e saj. Asnjëherë nuk ka gëzuar mjet juridik, të cilin ajo mund ta ketë gëzuar sipas Kushtetutës. Kështu, pajtohem me shumicën që e drejta kushtetuese e D.K.-së për të gëzuar mjetin efektiv juridik është shkelur.

Parashtruesit gjithashtu pretendojnë që janë shkelur edhe të drejtat e D.K.-së në bazë të Nenit 25 të Kushtetutës . Ata gjithashtu pretendojnë se gjykatat dhe institucionet shtetërore kanë shkelur të drejtat e D.K.-së sipas Nenit 25. Neni 25 përcakton që:

1. *Secili individ gëzon të drejtën për jetën.*

2. *Dënimi me vdekje është i ndaluar.*

Nuk ka dyshim që D.K.-së i është mohuar e drejta për jetë. A ia kanë mohuar jetën gjykatat dhe institucionet shtetërore ashtu si përdoret ai term në Kushtetutë?

Është e qartë që Neni 25 i Kushtetutës e ndalon Shtetin që të vendosë dënimin me vdekje ndaj kujtdo që është i dënuar për çfarëdo lloji të krimit. Neni 25 nuk e ndalon Shtetin, e as zyrtarët apo punëtorët e tij që të përdorin forcë vdekjeprurëse për të mbrojtur paqen dhe sigurinë e popullsisë si dhe sigurinë e shtetit. Kapitulli XI i Kushtetutës përmban shumë nene që qartësisht autorizojnë zyrtarët e Shtetit të përdorin forcën, e edhe forcën vdekjeprurëse në situata ekstreme, por të përshtatshme me arsye. Në fakt, nuk është e kontestueshme që policia, nëse është e nevojshme, mund të përdorë forcën vdekjeprurëse për të mbrojtur qytetarët nga forca vdekjeprurëse e drejtpërdrejtë dhe imediate që shkaktohet ndaj qytetarëve të tjerë.

Në këtë rast, parashtruesit e pranojnë që asnjë zyrtar nuk ka bërë gjë për të shkaktuar vdekjen e D.K. Parashtruesit lënë të kuptojnë që pretendojnë se nëse gjyqtari komunal do të kishte vepruar sipas kërkesës së D.K. për urdhër mbrojtës, ajo nuk do të vritej, si dhe që ky mosveprim nga Gjykata Komunale ka shkaktuar vrasjen e saj. Ky është një konkludim i gabueshëm. Urdhri mbrojtës do t'i jepte policisë një vegël shtesë për ta mbajtur vrasësin e D.K.-së larg nga ajo. Por, nuk do të mund të garantonte që ai nuk do ta kryente

krimin, gjë që tragjikisht e ka bërë. Për aq sa mundësia e dënimit të rëndë sipas ligjit që mundet apo duhet të vendoset nëse vrasësi i D.K.-së kapet dhe dënohet për vrasje nuk e ka ndaluar atë në veprën e vrasjes së D.K.-së, është spekulative të supozohet që urdhri gjyqësor për mbrojtje në këtë rast do të ishte i mjaftueshëm që ta ndalonte atë nga kryerja e vrasjes apo që policia do të ishte në gjendje ta kapte në kontaktin e ndaluar me D.K.-në para se ta kryente vrasjen.

Pasi që nuk ka pretendim, e aq më pak dëshmi, që dështimi i gjyqtarit komunal si zyrtar shtetëror, ka qenë shkak i përafërt i vdekjes së D.K.-së apo ka ndihmuar në kryerjen e vrasjes së saj, të drejtat e saj sipas Nenit 25 të Kushtetutës nuk janë shkelur nga shteti apo nga ndonjë zyrtar shtetëror.

Parashtruesit kanë kërkuar nga Gjykata të përdorë autoritetin e veprimit në emër të të drejtave kushtetuese të D.K.-së në bazë të Nenit 113.7 të Kushtetutës. Neni 113.7 përcakton që:

> *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

Nuk ka dyshim që parashtruesit kanë vuajtur personalisht, si dhe do të vazhdojnë të vuajnë për gjithë jetën e tyre një humbje të papërshkrueshme me vdekjen e parakohshme dhe tragjike të vajzës së tyre. Megjithatë, nuk kanë vuajtur nga shkelja e të drejtave të tyre individuale kushtetuese. Kushtetuta nuk i lejon të kërkojnë të drejtat individuale kushtetuese të një personi tjetër. Në anën tjetër, Kushtetuta në mënyrë specifike i lejon zyrtarët e tjerë publik që të parashtrojnë pyetje për interpretimin e Kushtetutës në Gjykatë. Kështu, kërkesa e parashtruesve nuk mund të merret parasysh nga Gjykata në bazë të Nenit 113.7.

Parashtruesit argumentojnë që Neni 53 i Kushtetutës i mundëson secilit individ që pretendon që iu ka shkelur një e drejtë që të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, edhe pse Neni 113.7 i kufizon ato kërkesa vetëm në raste kur pretendohet që e drejta e atij individi është shkelur. Neni 53 përcakton që:

> *Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të*

Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Dispozitat e Kushtetutës që trajtojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë përcaktuar me Kapitullin II (Neni 21 deri në 56) të Kushtetutës. Neni 53 shprehimisht përcakton që kjo gjykatë, në interpretimin e atyre neneve të Kushtetutës, do të kërkojë udhëzime nga vendimet e Gjykatës Europiane për të Drejta të Njeriut. Nuk kërkon nga Gjykata që të zbatojë vendimet e Gjykatës Europiane për të Drejta të Njeriut në lidhje me nenet e tjera të Kushtetutës si ato që kanë të bëjnë me formën e qeverisjes, sigurisë dhe të juridiksionit specifik të kësaj gjykate, siç përcaktohet me Nenin 113 të Kushtetutës. Neni 53 thekson që kjo gjykatë është gjykatë shtetërore, derisa Gjykata Europiane për të Drejta të Njeriut është gjykatë ndërkombëtare, e mandatuar veçanërisht me gjykime në lidhje me Konventën Europiane për të Drejta të Njeriut. Pasi që rolet e dy gjykatave janë të ndryshme, Neni 53 kufizon aplikimin e saj në interpretimin e atyre të drejtave dhe lirive të njeriut në Kushtetutë që do të mund të ishin të ngjashme me ato që përcaktohen me Konventën Europiane për të Drejta të Njeriut. Nuk vlen për interpretimin e Nenit 113 të Kushtetutës. Kështu, parashtruesit nuk kanë autoritet të parashtrojnë kërkesën e tyre në këtë gjykatë.

Dorëzuar me respekt,
Robert Carolan
Gjyqtar

KI 65/11, Holding Corporation "Emin Duraku", datë 28 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit SCC-0041, të datës 27 prill 2011, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

Rasti KI65/11, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntor 2012.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, mos shterje e mjeteve juridike

Parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 25.7 i UA të UNMIK-ut 2008/6 është në shkelje të nenit 5 [Gjuhët]; të nenit 7 [Vlerat; mosdiskriminimi]; të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], të nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut]; të nenit 24 [Barazia Para Ligjit]; të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës; dhe të nenit 6 [E Drejta për Gjykim të Drejtë], në pajtim me nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit] të KEDNJ-së.

Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk është në dijeni të ndonjë rasti në botë, ku pala detyrohet t'i drejtohet gjykatës në një gjuhë jozyrtare. Fakti se kërkesat e paraqitura në gjyq duhet të përkthehen në gjuhën angleze, me shpenzimet e palës që paraqet kërkesat, përkundër dhe krahas gjuhëve zyrtare, është një padrejtësi themelore.

Për më tepër, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 41 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Republika e Kosovës që t'i paguhen 20.000 euro dëmshpërblim për dëmet që parashtruesi i kërkesës pretendon t'i ketë pësuar.

Në rastin aktual, Gjykata gjen se rasti i parashtruesit të kërkesës është ende në pritje në Dhomën e Posaçme dhe se shqyrtimi i rastit është planifikuar për datën 12 tetor 2012

Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet e mundshme nën ligjin e zbatueshëm, siç kërkohet nga neni 113.7 i Kushtetutës dhe nga neni 47 (2) i Ligjit dhe Gjykata shpalle kërkesën si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI65/11
Parashtruesi
Holding Corporation "Emin Duraku"
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit SCC-0041, të datës 27 prill 2011, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Holding Corporation "Emin Duraku" nga Gjakova, përfaqësuar nga z. Myrteza Duli, me banim në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Urdhrin SCC-0041 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme), të datës 27 prill 2011, në pajtim me të cilin parashtruesit i është kërkuar të sigurojë përkthimin në gjuhën angleze të të gjitha dokumenteve.

3. Rrjedhimisht, parashtruesi konteston kushtetutshmërinë e nenit 25.7 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut, Nr. 2008/6, për ndryshimin dhe zëvendësimin e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut, Nr. 2006/17, për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2002/13, Mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi Çështjet që Lidhen me Agjencinë e Mirëbesimit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: UNMIK, UA 2008/6).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) i kushtetutshmërisë së Urdhrit SCC-0041 të Dhomës së Posaçme, të datës 27 prill 2011, i cili ishte i lëshuar në bazë të nenit 25.7 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut, Nr. 2008/6.

5. Gjithashtu, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 41 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës kërkon kompensim në vlerën 20.000 euro.

Baza juridike

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i datës 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 9 maj 2011, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë në Gjykatë.

8. Më 17 gusht 2011, Kryetari emëroi gjykatësin Altay Suroy Gjykatës raportues. Po këtë ditë, Kryetari emëroi edhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

9. Gjithashtu, më 17 gusht 2011, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese e njoftoi Dhomën e Posaçme për kërkesën e parashtruesit.

10. Më 24 shtator 2012, Sekretariati i Gjykatës e pyeti parashtruesin e kërkesës si dhe Dhomën e Posaçme për gjendjen e rastit të parashtruesit të kërkesës në Dhomën e Posaçme.

11. Më 29 shtator 2012, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës informoi Gjykatën se rasti është ende në pritje në Dhomën e Posaçme.

12. Dhoma e Posaçme, nëpërmjet letrës së saj të datës 2 tetor 2012, informoi Gjykatën se seanca për shqyrtimin e rastit të parashtruesit të kërkesës është caktuar për t'u mbajtur më 12 tetor 2012.

13. Më 21 nëntor 2012, Kolegji shqyrtues, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi i kërkesës dhe që mbështeten nga dokumentet, mund të përmblidhen si në vijim:

15. Me datë të pacaktuar parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Dhomën e Posaçme padinë kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP).

16. Më 27 prill 2011, Kolegji gjykues i Dhomës së Posaçme, në bazë të nenit 28.4 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2008/6, në pajtim me nenin 25.7, lëshoi Urdhrin SCC-0041, e datës 27 prill 2011, me të cilin parashtruesit të kërkesës i kërkohet që në afatin kohor 7-ditësh të sigurojë përkthimin në gjuhën angleze të të gjitha dokumenteve, të lutjes së shkruar si dhe të dokumenteve mbështetëse.

17. Më 4 maj 2011, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës paraqiti kërkesë për shtyrjen e afatit kohor 7-ditësh, me arsyetimin se, për shkak të pamundësisë financiare dhe logjistike, parashtruesi i kërkesës është duke hasur në vështirësi për të organizuar përkthimin e dokumenteve.

18. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës gjithashtu arsyetoi se kërkesa e Urdhrit të kontestuar "*është e pakuptueshme dhe e paqartë për arsye se sipas Kushtetutës gjuha shqipe është gjuhë zyrtare në Kosovë,... dhe se një akt i quajtur Urdhëresë Administrative nuk mund të jetë mbi Kushtetutën...*".

19. Sidoqoftë, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës konfirmoi qëllimin e tyre për të plotësuar kërkesën e Urdhrit të kontestuar dhe të dorëzojë dokumentet e përkthyera në Dhomën e Posaçme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 25.7 i UA të UNMIK-ut 2008/6 është në shkelje të nenit 5 [Gjuhët]; të nenit 7 [Vlerat; mosdiskriminimi]; të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], të nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut]; të nenit 24 [Barazia Para Ligjit]; të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës; dhe të nenit 6 [E

Drejta për Gjykim të Drejtë], në pajtim me nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit] të KEDNJ-së.

21. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk është në dijeni të ndonjë rasti në botë, ku pala detyrohet t'i drejtohet gjykatës në një gjuhë jozyrtare. Fakti se kërkesat e paraqitura në gjyq duhet të përkthehen në gjuhën angleze, me shpenzimet e palës që paraqet kërkesat, përkundër dhe krahas gjuhëve zyrtare, është një padrejtësi themelore.

22. Për më tepër, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 41 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Republika e Kosovës që t'i paguhen 20.000 euro dëmshpërblim për dëmet që parashtruesi i kërkesës pretendon t'i ketë pësuar.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

23. Fillimisht, Gjykata do të dëshironte të përsëriste se mund të vendosë për pranueshmërinë e një kërkese vetëm nëse parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në fuqi, të cilat janë në dispozicion nën ligjin e zbatueshëm në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe të nenit 47.2 të Ligjit, që përcaktojnë:

> *neni 113.7 i Kushtetutës: "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"...*
>
> *neni 47.2 i Ligjit: "Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

24. Shkaku themelor për rregullimin e shterimit është që t'u japë mundësi autoriteteve përkatëse, duke përfshirë edhe gjykatat, për të parandaluar apo për të përmirësuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se sistemi juridik i Kosovës do të ofrojë kompensim efikas për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i natyrës plotësuese të Kushtetutës (*Shih, Aktvendim për papranueshmëri: Universiteti AAB-RIINVEST sh.p.k. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI-41/09, i datës 21 janar 2010; dhe, shih, mutatis mutandis, KEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i datës 28 korrik 1999*).

25. Në rastin aktual, Gjykata gjen se rasti i parashtruesit të kërkesës është ende në pritje në Dhomën e Posaçme dhe se shqyrtimi i rastit është planifikuar për datën 12 tetor 2012.

26. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet e mundshme nën ligjin e zbatueshëm, siç kërkohet nga neni 113.7 i Kushtetutës dhe nga neni 47 (2) i Ligjit.

27. Për sa i përket kërkesës së parashtruesit për të shqyrtuar kushtetutshmërinë e UA të UNMIK-ut Nr. 2008/6, Gjykata thekson se vetëm palët e autorizuara sipas nenit 113.2 të Kushtetutës kanë të drejtë të parashtrojnë pyetjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Prandaj, parashtruesi i kërkesës nuk është një palë e autorizuar sipas nenit 113.2 të Kushtetutës (*Shih, Aktvendim për papranueshmëri Sami Burnjaku, Shqyrtimi kushtetues i Vendimit të Kolegjit Gjyqësor të Dhomës së Posaçme, SCC 10-0079, i datës 21 janar 2011 dhe kushtetutshmërisë së Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6..., Rasti nr. KI34/11, i datës 8 dhjetor 2011*).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

I. TA SHPALLË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 91/12, Ali Latifi, datë 28 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit për caktimin si avokat mbrojtës sipas detyrës zyrtare, të lëshuar nga Prokuroria e EULEX-it në Prizren, në rastin HP-155/12

Rasti KI 91/12, Aktvendim për papranueshmëri i datës 30 janar 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesa Individuale, ratione materia, Aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e parashtruar me 10 shtator 2012, kërkon " vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit për caktimin si avokat mbrojtës të parashtruesit të kërkesës, i lëshuar nga Prokuroria e EULEX-it në Prizren, në rastin HP-155/12", parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që t'i tregojë nëse parashtruesi duhet ose jo të jetë avokat mbrojtës i të pandehurit S. P, i cili akuzohet për krime lufte.

Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka ngritur një çështje kushtetuese brenda kornizës juridike të paraparë me nenin 113.7, andaj, në përputhje me nenin 36, par. 3 (f), kërkesa deklarohet e papranueshme për shkak të papajtueshmërisë ratione materiae me Kushtetutën.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI91/12
Parashtruesi
Ali Latifi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit për caktimin si avokat mbrojtës sipas detyrës zyrtare, të lëshuar nga Prokuroria e EULEX-it në Prizren, në rastin HP-155/12

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Ali Latifi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i autoritetit publik, me të cilin pretendohen shkeljet e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, është Vendimi për caktimin si avokat mbrojtës, i lëshuar nga Prokuroria e EULEX-it në Prizren, për të cilin parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar numrin karakteristik, as datën e nxjerrjes dhe as datën e pranimit të tij, ndërsa vendimi ka të bëjë me rastin HP-155/12.

Objekti i çështjes

3. Objekt i lëndës së parashtruar më 10 shtator 2012, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit për caktimin si avokat mbrojtës të parashtruesit të kërkesës, i lëshuar nga Prokuroria e EULEX-it në Prizren, në rastin HP-155/12. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që t'i tregojë nëse parashtruesi duhet ose jo të jetë avokat mbrojtës i të pandehurit S. P, i cili akuzohet për krime lufte.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe neni 29 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 10 shtator 2012, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

6. Më 31 tetor 2012, me Vendimin GJ. R. KI91/12, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 25 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që, në përputhje me nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në përputhje me rregullin 36 të Rregullores, të plotësojë formularin e Gjykatës dhe t'i sjell vendimet gjyqësore, provat dhe dëshmitë e nevojshme, për procedim dhe për shqyrtim të kërkesës.

8. Parashtruesi i kërkesës nuk i është përgjigjur asnjërës kërkesë të parashtruar nga Gjykata.

9. Më 15 nëntor 2012, Gjykata kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës për regjistrim të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 10 shtator 2012, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë kërkesën me vetëm një faqe.

11. Parashtruesi e kishte adresuar të njëjtën kërkesë në këto institucione:

    Oda e Avokatëve të Republikës së Kosovës,

    Ministria e Drejtësisë e Qeverisë së Kosovës,

Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës,

Prokuroria e Shtetit e Kosovës dhe Prokurorët e Qarqeve,

EULEX,

Prokuroria Speciale e Kosovës,

Gjykata Supreme e Kosovës, dhe

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

12. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin për caktimin si avokat mbrojtës, e lëshuar nga Prokuroria e EULEX-it në Prizren, në rastin HP-155/12, ku parashtruesi caktohet si avokat mbrojtës i të pandehurit S. P.

    S. P. ngarkohet për krime të kryera ndaj popullatës civile në Krushë, KK Prizren (Ky vendim nuk gjendet në shkresat e lëndës).

13. Parashtruesi i kërkesës thekson se e ka informuar Prokurorinë e EULEX-it, nëpërmjet Odës së Avokatëve të Kosovës, dhe ka kërkuar të dijë se a mund të jetë i caktuar si avokat mbrojtës për shkak se, siç thekson, "më 20 gusht 1998, në Hagë, dhe më 6 shtator 2003, në Prokurorinë e Kosovës, ka iniciuar procedurën për krimet e luftës ndaj popullatës civile që ka bërë shteti serb ndaj popullatës së Kosovës".

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi i kërkesës nuk ka precizuar se cilat të drejta, të mbrojtura me Kushtetutë, i janë shkelur.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës.

16. Sa i përket kësaj, Gjykata i referohet nenit 113.1 dhe nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura pranë Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. (...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

17. Në rastin konkret, parashtruesi:

    a. nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion mbështetës për shqyrtim të kërkesës së tij, dhe
    b. nuk ka ofruar ndonjë provë se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

18. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh:

    Rregullin 36, par. 3, të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

    "(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:

    f) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën".

19. Gjykata thekson se pajtueshmëria e ndonjë kërkese *ratione materiae* me Kushtetutën rrjedh nga kompetenca substanciale për juridiksionin e Gjykatës, e paraparë me nenin 113 të Kushtetutës, dhe veçanërisht me nenin 113.7, kur bëhet fjalë për kërkesat individuale.

20. Që një kërkesë të jetë e pajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën, e drejta për të cilën pretendohet se i është shkelur parashtruesit të kërkesës duhet të jetë e garantuar dhe e mbrojtur me Kushtetutë.

21. Në këtë drejtim, edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut shqyrton vetëm rastet që ngrihen për shkeljet e supozuara të të drejtave të garantuara me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të Protokolleve të saj, dhe jo edhe të të drejtave të garantuara me instrumente të tjera juridike, apo që janë jashtë juridiksionit të kësaj Gjykate. (*Shih, Peñafiel Salgado kundër Spanjës, Aplikacioni nr.*

65964/01, i 16 prillit 2002, dhe X kundër Holandës, Vendimi i GJEDNJ-së, i 4 tetorit 1976).

22. Z. Latifi nuk kishte përcaktuar në kërkesën e tij se cila nga të drejtat e garantuara me Kushtetutë i është shkelur atij, ndërsa, nga teksti i kërkesës së dërguar, Gjykata nuk mundi të konstatojë se ndonjëra e drejtë që garantohet me Kushtetutën e Kosovës do të mund të ishte objekt i shkeljeve eventuale.

23. Çështja e caktimit si avokat mbrojtës sipas detyrës zyrtare, vetë për vete, nuk është çështje kushtetuese dhe nuk është e përcaktuar me asnjë të drejtë të garantuar me Kushtetutë, në të cilën do të mund të thirrej parashtruesi i kërkesës.

24. Në këto rrethana, parashtruesi i kërkesës nuk ka ngritur një çështje kushtetuese brenda kornizës juridike të paraparë me nenin 113.7, andaj, në përputhje me nenin 36, par. 3 (f), kërkesa deklarohet e papranueshme për shkak të papajtueshmërisë *ratione materiae* me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36.3 pika (f) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 29 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 102/12, Bilall Osmani, datë 28 shkurt 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. Nr. 15/10, të 21 shkurtit 2011

Rasti KI 102/12, Aktvendim për papranueshmëri i 23 janarit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja e pronës, parimi i sigurisë juridike.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar për shkak të vendimeve diametralisht të kundërta të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Parashtruesi, ndër të tjera, pohoi se ishte shkelur e drejta në gjykim të drejtë, e drejta në pronë dhe parimi i sigurisë juridike.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e pafatshme përkatësisht nuk ishte parashtruar në Gjykatë brenda afatit ligjor të përcaktuar me Nenin 49 të Ligjit. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
nëRastin
KI102/12
Parashtruesi
Bilall Osmani
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 15/10, të 21 shkurtit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Bilall Osmani, i përfaqësuar nga z. Adem Vokshi, avokat nga Mitrovica.

Vendimet e kontestuara

2. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 15/10, i 21 shkurtit 2011.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); neni 20, neni 22.7 dhe neni 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Kërkesa ka për objekt vërtetimin e të drejtës pronësore të një lokalit afarist, të blerë nga parashtruesi i kërkesës, bazuar në kontratë për shitblerje, të legalizuar në Gjykatën Komunale të Vushtrrisë.

Procedura në Gjykatë

5. Më 19 tetor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 5 nëntor 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI-102/12, caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI102/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 5 nëntor 2012, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

8. Më 22 janar 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës. Kolegji shqyrtues nuk ishte në përbërje të plotë, mungonte njëri nga tre gjyqtarët, një procedurë e tillë nuk është standarde dhe përbën përjashtim, por është e lejueshme sepse Kolegji shqyrtues nuk ka autoritet vendimmarrës.

Përmbledhje e fakteve, siç janë dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës

9. Më 2 qershor 2003, parashtruesi lidhi kontratë për shitblerjen e lokalit afarist nr. 1, që ndodhet në Vushtrri, në rr. "Bedri Pejani", nr. 30. Lokali ka një sipërfaqe 31.5 m2 dhe shtrihet në ngastrën kadastrale 36/1, në vendin e quajtur "Qytet", që evidencohet në fletën poseduese nr. 1292, KK Vushtrri (Parashtruesi i kërkesës më herët ishte në posedim të lokalit në fjalë si qiramarrës).

10. Kontrata e lartpërmendur u legalizua në Gjykatën Komunale në Vushtrri, me numër Vr. Nr. 749/2003, më 9 qershor 2003. Kontrata *inter alia* përcaktonte se pala shitëse kishte të drejtë që lokalin e shitur të mund ta kthente në pronësi të vet, me kusht që në vitin 2010 t'ia paguante parashtruesit të kërkesës shumën 20.000 euro (çmimi i shitblerjes ishte 15.000 euro, ndërsa pala shitëse, në vitin 2010, duhej t'ia paguante 5.000 euro shtesë parashtruesit të kërkesës, nëse dëshironte të kthente pronësinë e lokalit në fjalë).

11. Parashtruesit të kërkesës i mohohej vërtetimi i të drejtës së pronësisë për lokalin afarist nga një palë e tretë, që pretendonte se kishte blerë lokalin në fjalë, së bashku me shtëpinë ku ndodhej ai.

12. Më 23 dhjetor 2005, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin C. nr. 742/05, vendosi: 1) të refuzojë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, për të vërtetuar se ai është pronar i lokalit afarist, 2) anuloi kontratën e shitblerjes së lokalit afarist, dhe 3) urdhëroi parashtruesin e kërkesës që lokalin afarist t'ia dorëzojë në posedim palës së tretë.

13. Më 10 tetor 2006, pas ankesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Aktvendimin Ac. nr. 43/2006, e prishi në tërësi aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Komunale në Vushtrri, dhe të njëjtës ia ktheu lëndën për rigjykim.

14. Më 7 mars 2008, Gjykata Komunale në Vushtrri, me Aktgjykimin C. nr. 495/06, vendosi: 1) të refuzojë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për të vërtetuar se është pronar i lokalit afarist, 2) vërtetoi shkëputjen e kontratës për shitblerjen e lokalit afarist, 3) obligoi palën shitëse që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë kompensimin siç ishte përcaktuar me kontratën e shitblerjes së lokalit afarist, dhe 4) obligoi parashtruesin e kërkesës që lokalin afarist t'ia dorëzojë në posedim palës së tretë.

15. Më 21 shkurt 2011, pas ankesës së parashtruesit, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me Aktgjykimin Ac. nr. 15/2010, e vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, C. nr. 495/06, të 7 marsit 2008, dhe e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazë.

16. Më 6 mars 2011, parashtruesi i kërkesës ushtroi iniciativë për ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë te Prokurori i Shtetit.

17. Më 15 prill 2011, Prokurori i Shtetit, me shkresën KMLC. nr. 25/2011, e njoftoi parashtruesin e kërkesës se, pas leximit të lëndës, nuk ka gjetur bazë ligjore për të ngritur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me dy vendimet e saj diametralisht të kundërta, ka cenuar rëndë parimin e sigurisë juridike.

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ka blerë lokalin afarist, ka paguar çmimin e shitblerjes, ka hyrë në posedim të pasurisë së blerë, ka

legalizuar kontratën në gjykatë komunale dhe shtron pyetjen se çfarë ka mundur të bëjë më shumë për të pasur siguri juridike.

20. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

a) Të shpallë kërkesën e tij të pranueshme;

b) Të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së;

c) Të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

d) Të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 15/10, e 21 shkurtit 2011;

e) Të kthejë lëndën për rishqyrtim te Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, në pajtim me Aktgjykimin e nxjerrë nga Gjykata Kushtetuese.

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

21. Për të gjykuar kërkesën e parashtruesve, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

22. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".

23. Nga parashtresat shihet që kërkesa është parashtruar më 19 tetor 2012 dhe se parashtruesit i është dorëzuar vendimi i gjykatës së shkallës së fundit më 24 shkurt 2011, që do të thotë se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

24. Rezulton që kërkesa është e paaftshme

25. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme, për shkak të mosrespektimit të afatit ligjor të përcaktuar me menin 49 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 47 të Ligjit; si dhe në pajtim me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 22 janar 2013, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 108/12, Hazir Kadriu, datë 06 mars 2013- Kërkesë për Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 212/2012, të 24 majit 2012

Rasti KI108/12, Aktvendim për papranueshmëri i 18 janarit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kontest civil, e drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, kërkesë qartazi e pabazuar

Parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se Gjykata Supreme, me Aktgjykimin A. nr. 212/2012, të 24 majit 2012, duke ia refuzuar përfundimisht të drejtën për njohjen e statusit të personit me aftësi të kufizuar, shkeli të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

Gjykata, edhe në këtë rast, sikurse dhe në raste të tjera, rikujtoi se nuk është gjykatë e verifikimit të fakteve dhe theksoi se konstatimi i gjendjes faktike, në mënyrë të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, në këtë rast, edhe i organeve administrative. Roli i Gjykatës është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë, prandaj dhe nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt *(Shih, mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).*

Gjykata përfundoi se, parashtruesi i kërkesës nuk e kishte argumentuar mjaftueshëm pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave kushtetuese, andaj, në përputhje me rregullin 36 (2) b) dhe d), Gjykata e deklaroi kërkesës të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI108/12
Parashtruesi
Hazir Kadriu
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 212/2012, të 24 majit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Hazir Kadriu, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar gjyqësor

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik, me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 212/2012, i 24 majit 2012 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të cilin parashtruesi e ka pranuar më 25 gusht 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 212/2012,

të 24 majit 2012, dhe ka të bëjë me të drejtën për pension të personave me aftësi të kufizuar.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 16 dhjetorit 2008, i hyrë në fuqi më 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 28 i Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Ankesa e parashtruesit

5. Parashtruesi i kërkesës ankohet se komisionet mjekësore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS) ia kanë refuzuar në mënyrë joligjore të "drejtën për pension të personave me aftësi të kufizuar", edhe pse parashtruesi pretendon se i kishte plotësuar kushtet për një pension të tillë, ndërsa Gjykata Supreme me Aktgjykimin A. nr. 212/2012, e 24 majit 2012, duke refuzuar padinë e tij përkitazi me këtë çështje, pretendon se e njëjta ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

Procedura në Gjykatë

6. Më 31 tetor 2012, Gjykata pranoi kërkesën e parashtruar nga z. Hazir Kadriu dhe e regjistroi atë me Nr. KI108/12.

7. Më 5 nëntor 2012, Kryetari, me Vendimin GJR. 108/12, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi Gjyqtar raportues. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. 108/12, caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović (anëtar) dhe Prof. dr. Enver Hasani (anëtar).

8. Më 5 dhjetor 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës, gjithashtu dhe Gjykatën Supreme, për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 18 janar 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht Departamenti i Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës (në tekstin e

mëtejmë: DAPK), me Vendimin Nr. dos. 5089422, e 8 qershorit 2011, ia kishte refuzuar parashtruesit të drejtën e përfitimit të pensionit invalidor për persona me aftësi të kufizuar.

11. Parashtruesi ushtroi padi në Gjykatën Supreme kundër Vendimit të DAPK-së, Nr. dos. 5089422, të 8 qershorit 2011. Parashtruesi pohon në padinë e tij se komisionet mjekësore nuk e morën parasysh faktin që gjendja e tij shëndetësore është e rëndë, sepse i njëjti nuk është i aftë për punë dhe se provat e prezantuara nga ai nuk u morën parasysh nga organet administrative, për çfarë edhe gjendja faktike nuk u vërtetua në mënyrë të plotë, ku për pasojë, sipas parashtruesit, ndodhi zbatimi i të drejtës materiale në dëm të tij.

12. Më 24 maj 2012, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin A. nr. 212/2012 dhe refuzoi padinë e ushtruar kundër MPMS-së, përkatësisht DAPK-së, me Nr. dos. 5089422, të 8 qershorit 2011. Gjykata Supreme kishte konstatuar se organet administrative zbatuan drejt dispozitën e nenit 3 të Ligjit për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara, 2003/23, për faktin që komisioni kishte vërtetuar se parashtruesi nuk i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së përfitimit të pensionit invalidor për personat me aftësi të kufizuar.

Pretendimet e parashtruesit

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, me Aktgjykimin A. nr. 212/2012, e 24 majit 2012, duke ia refuzuar përfundimisht të drejtën për njohjen e statusit të personit me aftësi të kufizuar, ka bëre shkelje kushtetuese të të drejtave të tij.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje me Ligj dhe me Rregulloren e punës së Gjykatës.

15. Përkitazi më këtë, Gjykata i referohet rregullit 36.1, pikës (c), të Rregullores së punës, që qartazi përcakton:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) kërkesa është qartazi e bazuar".

16. Gjykata vëren që parashtruesi nuk ka specifikuar saktësisht në kërkesën e tij se me cilën dispozitë kushtetuese i janë shkelur të drejtat e tij (*Shih, neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese*), por që nga parashtresat e lëndës qartazi kuptohet se parashtruesi ankohet për të drejtën në pension për personat me aftësi të kufizuar.

17. Gjykata konstaton se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, sa i përket të drejtës për pension, i referohet vetëm nenit 105 dhe nenit 109 të Kushtetutës, edhe atë duke iu referuar procesit të mandatit dhe riemërimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve "deri në pensionim sipas ligjit". Ato nene nuk përcaktojnë nëse qytetari ose zyrtari ka të drejtë për pension.

18. E vetmja dispozitë kushtetuese që i referohet pensioneve, është paragrafi 2, i nenit 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] i Kushtetutës, i cili parasheh: "Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj". Ajo nuk parasheh që qytetari ka të drejtë për pension apo nuk parasheh se si një person mund të kualifikohet për pension.

19. Sigurimi social për "aftësi të kufizuara, papunësi dhe moshë të shtyrë" rregullohet me Ligj. Në rastin konkret, çështja e pensionit të personave me aftësi të kufizuar është e rregulluar me Ligjin për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, Nr. 2003/23, e aprovuar në Kuvendin e Kosovës, më 6 nëntor 2003.

20. Procedura e aplikimit dhe e plotësimit të kushteve për gëzimin e kësaj të drejte është paraparë me këtë Ligj, sikur edhe e drejta e apelimit të vendimeve kur palët nuk janë të kënaqura me vendimet e autoriteteve publike për sa i përket kërkesave të tyre.

21. Parashtruesi i kërkesës ka dështuar të provojë se Gjykata Supreme nxori vendim me shkeljen e të drejtave kushtetuese të tij. Gjykata Supreme, në Aktgjykimin A. nr. 212/2012, e 24 majit 2012, konstatoi se vendimet e komisioneve administrative, në këtë rast, ishin ligjore.

22. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e verifikimit të fakteve dhe, me këtë rast, dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe, në këtë rast, edhe i organeve administrative. Roli i Gjykatës është vetëm që të

sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë, prandaj dhe nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" *(Shih, mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).*

23. Gjykata konkludon që, në kërkesë, nuk ka asgjë që tregon se Gjykatës Supreme, në rastin konkret, komisioneve të MPMS-së, gjatë ekzaminimit të rastit i mungonte paanshmëria ose që procedura e shqyrtimit të çështjes ishte e padrejtë. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë që të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë *(Shih, mutatis mutandis, Aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).*

24. Nga sa u tha më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk e ka argumentuar mjaftueshëm pretendimin e tij për shkeljen e ndonjë të drejte kushtetuese, andaj, në përputhje me rregullin 36.2, pika (b) dhe pika (d), kërkesa konsiderohet qartazi e pabazuar.

25. Rrjedhimisht, në pajtim ne nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 36.2 (b) e (d) dhe në pajtim me rregullin 56.2 të Rregullores së punës, më 18 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 115/12, Fadil Salihu, datë 06 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së rregullsisë së zgjedhjes së Kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj, më 4 nëntor 2012

Rasti KI-115/12, Aktvendim për papranueshmëri i 25 janarit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, ratione materiae, kompetenca e gjykatës, interpretimi i statutit

Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kërkuar vlerësim të kushtetutshmërisë së zgjedhjes së Kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj, më 4 nëntor 2012, duke kontestuar mënyrën e interpretimit të Statutit të Lëvizjes Vetëvendosje lidhur me zgjedhjen e Kryetarit të kësaj lëvizjeje në Ferizaj.

Parashtruesi pretendon se personi i përmendur (kandidati për kryetar të Lëvizjes) në momentin e zgjedhjeve, nuk ishte i pranishëm në Kosovë dhe nuk kishte marrë pjesë në fushatë, si dhe ishte zgjedhur në postin e kryetarit duke blerë vota.

Parashtruesi thekson një shkelje të pretenduar në lidhje me interpretimin e "Statutit të *Lëvizjes Vetëvendosje." Gjykata kishte konkluduar se Lëvizja Vetëvendosje nuk është një autoritet publik. Prandaj,* kërkesa është *e papajtueshme ratione materiae me* dispozitat e *Kushtetut*ës, *sepse kompetenca e* Gjykatës *Kushtetuese mbulon* mosmarrëveshjet *q*ë *kanë t*ë bëjnë *me shkeljen e* pretenduar *t*ë Kushtetutës *nga ana e autoriteteve publike. Prandaj,* Gjykata shpalli se kërkesa është *e papajtueshme ratione materiae me dispozitat e* Kushtetutës *dhe, si e till*ë, është *e papranueshme.*

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI115/12
Parashtrues
Fadil Salihu
Vlerësimi i rregullsisë së zgjedhjes së Kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj, më 4 nëntor 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Fadil Salihu nga Ferizaj (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi).

Vendim i kontestuar

2. Parashtruesi konteston vendimin për zgjedhjen e Kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj, më 4 nëntor 2012.

Objekti i çështjes

3. Interpretimi i Statutit të Lëvizjes Vetëvendosje përkitazi me zgjedhjen e kryetarit të kësaj lëvizjeje në Ferizaj.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 dhe në nenin 21.4 të Kushtetutës; në nenin 20, në nenin 22.7 dhe në nenin 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 56, paragrafi 2, të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), më 3 dhjetor 2012.

6. Me Vendimin e Kryetarit (Nr. GJR. 115/12, e 6 dhjetorit 2012), gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi është emëruar Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit (Nr. KSH. KI115/12), është caktuar Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Prof. Dr. Enver Hasani.

7. Më 25 janar 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares Arta Rama-Hajrizi , Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Prof. dr. Enver Hasani, i paraqiti Gjykatës, në përbërje të plotë, rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Më 4 nëntor 2012, janë mbajtur zgjedhjet për kryetar të Lëvizjes Vetëvendosje, në Qendrën e kësaj lëvizjeje në Ferizaj.

9. Në të njëjtën ditë, kryetar i Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj, me shumicë votash, u zgjodh personi që edhe më herët kishte kryer funksionin e kryetarit të Qendrës.

Pretendimet e parashtruesit

10. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, në zgjedhjet për kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj, të mbajtura më 4 nëntor 2012, është zgjedhur personi që nuk i plotëson kriteret në bazë të Statutit të Lëvizjes Vetëvendosje, të muajit korrik 2012.

11. Parashtruesi, në veçanti, citon nenin 17 të Statutit të Lëvizjes Vetëvendosje, i cili thotë:

> *"Anëtar i Lëvizjes Vetëvendosje, nuk mund të jetë individi që ka marrë pjesë në akte kompromettuese, që i cenojnë parimet dhe dokumentet themeltare të Lëvizjes Vetëvendosje. Si akte kompromettuese njihen veprat në vijim:*
>
> *a) Bashkëpunimi me shërbime inteligjente/informative të huaja, si dhe me forca ushtarake, paramilitare dhe policore të huaja, që*

kanë ushtruar ose që vazhdojnë të ushtrojnë dhunë fizike dhe psikologjike ndaj qytetarëve".

12. Bazën për pretendimin e tij, parashtruesi e gjen në faktin se personi i përmendur ka qenë i zgjedhur në postin e kryetarit, të cilin e kishte kryer në periudhën paraprake, dhe se, gjatë mandatit të tij paraprak, kanë ndodhur keqpërdorime financiare, të cilat janë evidentuar nga Auditori i Lëvizjes.

13. Parashtruesi pretendon se personi i përmendur (kandidati për kryetar të Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj,) në momentin e zgjedhjeve, nuk ishte i pranishëm në Kosovë dhe nuk kishte marrë pjesë në fushatë, si dhe është zgjedhur në postin e kryetarit duke blerë vota.

14. Parashtruesi thekson në kërkesë *"se i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për shkak se dëshiron të çojë luftë kundër totalitarizmit në praktikë, kundër blerjes së postit, abuzimeve dhe që drejtësia të fitojë".*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të vendosë për kërkesën e parashtruesit, së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet procedurale për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë. Përkitazi me këtë,Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

16. Parashtruesi i kërkesës nuk specifikon se cila e drejtë kushtetuese apo ligjore i është cenuar me zgjedhjen e personit të përmendur kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje në Ferizaj, edhe pse neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese thotë:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

17. Sa i përket kërkesës specifike të parashtruesit të kërkesës, Gjykata i referohet rregullit 36, paragrafi 3, pika f, të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, i cili parasheh:

"Gjykata një kërkesë e konsideron si të papranueshme kur: f) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën".

18. Gjykata ka për detyrë të shqyrtojë nëse ka kompetencë *ratione materiae* në çdo fazë të procedimit. Pajtueshmëria *ratione materiae* e ndonjë kërkese me Kushtetutën dhe me aktet ndërkombëtare, të cilat janë pjesë përbërëse e Kushtetutës, në përputhje me nenin 53 të Kushtetutës, rrjedh nga kompetenca kryesore e Gjykatës. Për të qenë një kërkesë në përputhje *ratione materiae* me Kushtetutën, e drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të jetë e mbrojtur me Kushtetutë.

19. Parashtruesi thekson në një shkelje të dyshuar në lidhje me interpretimin e "Statutit të Lëvizjes Vetëvendosje". Lëvizja Vetëvendosje nuk është një autoritet publik. Prandaj, kërkesa është e papajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën, sepse kompetenca e Gjykatës Kushtetuese e cila mbulon mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me shkeljen e supozuar të Kushtetutës nga ana e autoriteteve publike. Prandaj, kërkesa është e papajtueshme *ratione materiae* me dispozitat e Kushtetutës dhe, si e tillë, është e papranueshme

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 48 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.3.f të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 89/12, Brahim Delijaj, datë 07 mars 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 374/2009 të 2 majit 2012.

KI89/12, Aktvendim për papranueshmëri i datës 29 janar 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë Individuale, qartazi e pabazuar

Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 374/2009 të 2 majit 2012, me të cilin refuzohet revizioni i parashtruar, ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, më saktësisht nenet 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 121 [Prona] të Kushtetutës dhe nenin 6.1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesën që të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. Nr. 374/2009 i 2 majit 2012 dhe të vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. Nr. 83/2008 i 22 prillit 2009.

Sipas fakteve të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë.

Kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36. 2 (b) dhe (d) të Rregullores së Punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI-89/12
Parashtrues i kërkesës
Brahim Delijaj
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 374/2009 të 2 majit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Brahim Delijaj me banim në fshatin Ratish i Poshtëm, komuna e Deçanit.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. Nr. 374/2009 të 2 majit 2012, dorëzuar parashtruesit të kërkesës me datë 18 qershor 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes ka të bëjë me kërkesën e Parashtruesit për anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 374/2009 të 2 majit 2012 dhe vërtetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. Nr. 83/2008 të 22 prillit 2009, lidhur me të drejtën e servitutit të përhershëm.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15

janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56, pika 2, të Rregullores së Punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedurat në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 tetor 2012, Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Me vendimin e Kryetarit Nr. GJR. KI 89/12 të datës 31 tetor 2012, Gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi është caktuar Gjyqtare Raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit për caktimin e kolegjit shqyrtues me Nr. KSH. 15/12, është caktuar Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu (anëtar) dhe Prof. Dr. Enver Hasani (anëtar).

7. Më 19 nëntor 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi Parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës lidhur me regjistrimin e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesi në kërkesën e tij pohon se është pronar i ngastrës kadastrale me nr. 114 në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.08,24 hektar në fshatin Ratish i Poshtëm, komuna e Deçanit. Sipas dokumenteve të bashkëngjitura në kërkesë, në anën lindore kjo ngastër kufizohet me ngastrën kadastrale nr. 111 e evidentuar në emër të të ndjerit Sejd Hasan Delijaj, i ati i Isuf, Përparim dhe Hasan Delijaj, të cilët e kanë në shfrytëzim dhe posedim, njëherit edhe kushërinj të parashtruesit të kërkesës. Në skajin verilindor gjendet dera e oborrit e parashtruesit të kërkesës e cila lidhet me rrugën publike dhe kalon nëpër ngastrën kadastrale nr. 111 në gjatësi prej 8 metrave dhe gjerësi prej 4 metrave, po ashtu në fshatin Ratish i Poshtëm, komuna e Deçanit.

9. Më 18 gusht 2004, parashtruesi i kërkesës në kërkesëpadinë e tij në Gjykatën Komunale të Deçanit ka kërkuar t'i pranohet e drejta e servitutit të përhershëm nëpër ngastrën nr. 111. Parashtruesi i kërkesës, më 5 korrik 2007, në bazë të të dhënave kadastrale ka precizuar parashtresën e tij me pretendimin se është pronar i ngastrës nr. 114/2 në sipërfaqe prej 0.04.12 hektarë.

10. Gjykata Komunale në Deçan me Aktgjykimin e saj C. Nr. 130/06 të 19 dhjetorit 2007 mbi bazë të nenit 59 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Pronësore Juridike ka refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar duke vlerësuar se parashtruesi i kërkesës nuk

është i izoluar, por ka një komunikim dhe lidhje normale me rrugën publike te fshatit. Gjykata Komunale në Deçan ka vlerësuar më tej se parashtruesi i kërkesës në rastin e ndarjes me vëllanë e tij, nuk e ka ushtruar të drejtën e servitutit të kalimit 35 vite dhe, po ashtu, nuk ka siguruar rrugën e kalimit.

11. Parashtruesi i kërkesës ka ushtruar ankesë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Qarkut në Pejë. Gjykata e Qarkut në Pejë me Aktgjykimin e saj AC. Nr. 83/08 të 22 prillit 2009 ka aprovuar kërkesëpadinë e Parashtruesit të kërkesës vetëm në pjesën e vërtetimit të ekzistimit të servitutit të kalimit të përhershëm nëpër pjesën perëndimore të ngastrës kadastrale nr. 111.

12. Gjykata e Qarkut në Pejë me Aktgjykimin e saj AC. Nr. 83/08 të 22 prillit 2009 ka vlerësuar se *" nuk e aprovon si të ligjshëm dhe të rregullt qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë "*. Gjykata e Qarkut më tej ka vlerësuar se [...] " *në këtë çështje juridike është vërtetuar fakti vendimtar për të vendosur se, është ndryshuar vëllimi dhe përmasat e ushtrimit të drejtës së servitutit nga ana e palës paditëse mirëpo, nga kjo nuk rrjedhë vlerësimi se pala paditëse nuk e ka shfrytëzuar rrugën kontestuese për kalim."* dhe në fund ka konstatuar se *[...] në "këtë çështje juridike gabimisht është aplikuar e drejta materiale [...]."*

13. Pala kundërshtare ka parashtruar revizion ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë në Gjykatën Supreme të Kosovës me arsyetimin e shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.

14. Gjykata Supreme me aktgjykimin e saj Rev. Nr. 374/2009 të 2 majit 2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës me 18 qershor 2012, ka pranuar revizionin e parashtruar nga të paditurit si të bazuar, duke ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe vendosur që Aktgjykimi i Gjykatës Komunale të mbetet në fuqi me arsyetimin se Gjykata e Qarkut gabimisht ka zbatuar dispozitat materialo-juridike. Gjykata Supreme, duke ju referuar nenit 49, paragrafit 1, të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore të 30 janarit 1980 më tej ka vlerësuar [...] "*se servituti real është e drejta e pronarit të një pasurie të paluajtshme (prona sunduese) që për nevojat e kësaj pasurie të paluajtshme të kryejë veprimet e caktuara në pasurinë e paluajtshme të pronarit tjetër (prona shërbyese) ose të kërkojë nga pronari i pronës shërbyese që të përmbahet nga kryerja e veprimeve të caktuara që përndryshe do t'i kishte drejtë t'i kryente në pasurinë e vet të paluajtshme, çka nënkupton që personat që nuk janë pronar i pasurisë sunduese nuk kanë të drejtë të kërkojnë me padi mbrojtje*

gjyqësore." Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj në fund konstaton se 'poseduesi i parcelës i cili nuk është pronar, nuk ka të drejtë që me padi të kërkojë vërtetimin e ekzistimit të drejtës servitutit real të rrugës ndaj pronarit të pasurisë shërbyese."

15. Më 7 korrik 2012, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme ka paraqitur propozim për ngritjen e kërkesës për ligjshmëri te Prokurori i Shtetit.

16. Prokurori i Shtetit, më datë 30 korrik 2012, pas shqyrtimit të lëndës, ka refuzuar ngritjen e kërkesës për ligjshmëri. Në njoftimin e tij, Prokurori i Shtetit konsideron se [...] " *në këtë çështje juridiko-civile Gjykata Supreme ka marrë aktgjykim duke vepruar sipas revizionit të paditurve dhe kundër një aktgjykimi të tillë Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë nuk është e lejuar*."

Ligji i aplikueshëm, të cilit i referohet Gjykata Supreme

17. Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji Nr. 03/L-006) në nenin 182, paragrafin 1 dhe 2, si dhe nenin 224, paragrafi 1, përcaktojnë si në vijim:

" 182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në qoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejt ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë.

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;

224.1 Në qoftë se gjykata e revizionit konstaton se e drejta materiale është zbatuar gabimisht, me aktgjykim e aprovon revizionin e paraqitur dhe e ndryshon aktgjykimin e goditur."

18. Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore i 30 janarit 1980 (publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 6/80) nenin 49, paragrafin 1 dhe nenin 59 përcakton:

Neni 49, paragrafi 1

"Servitut real është e drejta e pronarit të një pasurie të paluajtshme *(prona sunduese) që për nevojat e kësaj pasurie të paluajtshme të kryejë veprime të caktuara në pasurinë e paluajtshme të pronarit tjetër (prona shërbyese) ose të kërkojë nga pronari i pronës shërbyese që të përmbahet nga kryerja e veprimeve të caktuara që përndryshe do të kishte drejtë ti kryente në pasurinë e vet të paluajtshme."*

Neni 59

"Në qoftë se pjesëtohet prona sunduese servituti real mbetet në dobi te të gjitha pjesëve të saj.

Pronari i pronës shërbyese mund të kërkojë që servituti real i pronarit të ndonjë pjesë të pronës sunduese të pjesëtuar të pushojë, poqese *servituti real nuk* shërben për nevojat e kësaj pjese.

Në qoftë se është pjesëtuar prona *shërbyese, ser*vituti real mbetet vetëm *mbi pjesët për të cilat është ushtruar."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Siç u tha më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 374/2009 të 2 majit 2012, me të cilin refuzohet revizioni i parashtruar, ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, më saktësisht nenet 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 121 [Prona] të Kushtetutës dhe nenin 6.1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë

dhe të Paanshëm] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

20. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesën që të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. Nr. 374/2009 i 2 majit 2012 dhe të vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. Nr. 83/2008 i 22 prillit 2009.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

22. Gjykata, së pari duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 te Kushtetutës të parashtrojë kërkesë në Gjykatë.

Neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Në lidhje me këtë kërkesë, gjykata vëren se parashtruesi, është person fizik dhe është palë e autorizuar në përputhje me kërkesat e nenit 113.7 [Kërkesat Individuale] të Kushtetutës.

23. Gjykata, po ashtu, duhet të përcaktojë nëse parashtruesi në pajtim me kërkesat e nenit 113 (7) të Kushtetutës dhe nenit 47 (2) të Ligjit ka shteruar të gjitha mjetet juridike.

Në rastin konkret, Gjykata vëren se janë parashtruar ankesa dhe kërkesa për revizion sipas procedurave të përcaktuara me Ligj, përkatësisht në Gjykatën Komunale në Deçan, në Gjykatën e Qarkut në Pejë, si dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës, dhe rrjedhimisht janë shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

24. Parashtruesi gjithashtu duhet të dëshmojë se ai i ka plotësuar kërkesat e nenit 49 të Ligjit në lidhje me parashtrimin e kërkesës brenda afatit ligjor. Nga dosja e lëndës mund të shihet se vendimi i Gjykatës Supreme, parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar me 18 qershor 2012, derisa parashtruesi e paraqiti kërkesën në Gjykatë më 4 tetor 2012, që nënkupton se kërkesa ishte dorëzuar brenda afatit katër mujor, të paparë në Ligj dhe Rregullore të punës.

25. Në lidhje me kërkesën, Gjykata merr po ashtu parasysh Rregullin 36 të Rregullores, ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) Kërkesa është qartazi e bazuar."

26. Bazuar në shkresat e kërkesës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në vendimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata po ashtu ka vërtetuar se procedurat pranë gjykatave të rregullta nuk kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (Shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* Vendimi i GJEDNJ në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

27. Gjykata dëshiron të rikujtojë se Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e fakteve, dhe në këtë rast thekson se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i saj është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente tjera ligjore *(*Shih, *mutatis mutandis,* i.a., *Akdivar kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65*)*.

28. Gjykata po ashtu dëshiron të rikujtojë se Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt, ku shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I, Shih gjithashtu, *Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin nr. 70/11,* Parashtruesit e kërkesës Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima, Vlerësimi i kushtetutshmërisë i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr. 983/08 të 7 shkurtit 2011).

29. Fakti se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e vendimit të Gjykatës Supreme, nuk mund t'i shërbejë atij si e drejtë që të ngrisë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të neneve 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i

Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 121 [Prona] të Kushtetutës dhe nenit 6.1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të KEDNJ-së (Shih, *mutatis mutandis Aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

30. Si përfundim, sipas fakteve të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë (Shih, *mutatis mutandis, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë,* Vendimi i GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99 të 31 majit 2005).

31. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36. 2 (b) dhe (d) të Rregullores së Punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe në përputhshmëri me rregullin 36. 2 (b) dhe (d) të Rregullores së Punës, më 29 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 35/12, Agron Prenaj, datë 07 mars 2013- Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PKL. 11/2012, të 6 shkurtit 2012

Rasti KI 35/12, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, Aktvendim për Papranueshmëri, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dinjiteti i njeriut, procedurë penale.

Gjykata Komunale në Gjakovë e kishte shpallur parashtruesin fajtor për keqpërdorimin e së drejtës së votimit në pajtim me dispozitat përkatëse të Kodit Penal të Kosovës. Parashtruesi kishte apeluar këtë vendim në Gjykatën e Qarkut në Pejë, e më pastaj edhe në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se me vendimin e Gjykatës Supreme PKL. 11/2012, është shkelur dinjiteti i tij në pajtim me nenin 23 të Kushtetutës në lidhje me nenin 31 (4) të së njëjtës, pasi që siç thekson ai është dënuar në bazë të një shakaje të pretenduar

Në këtë rast Gjykata theksoi se nuk është detyrë e saj që të veprojë si një gjykatë apeli, apo gjykatë e shkallës së katërt, në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe material dhe se vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë.

Prandaj, duke i shqyrtuar dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës Gjykata Kushtetuese nuk gjeti se procedurat relevante ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare dhe shpalli kërkesën si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastin nr. KI 35/12
Parashtruesi
Agron Prenaj
Kërkesa për vlerësimin e Kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PKL. 11/2012, të 6 shkurtit 2012.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar
Arta Rama – Hajrizi, Gjyqtare

Parashtruesi i Kërkesës

1 Parashtruesi i kërkesës është z. Agron Prenaj, me vendbanim në fshatin Novesellë- Komuna e Gjakovës, i përfaqësuar nga avokati Mustafë Kastrati nga Peja.

Vendimi i kontestuar

2 Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës PKL. 11/2012, të nxjerrë më 6 shkurt 2012.

Objekti i çështjes

3 Parashtruesi i kërkesës është dënuar për keqpërdorimin e së drejtës së votimit në pajtim me nenin 178 (1) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK).

Baza juridike

4 Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtuese

5 Më 2 prill 2012, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Gjykata").

6 Me vendimin e Kryetarit (Nr. GJR. 35/12 të 11 prillit 2012) Robert Carolan u caktua si Gjyqtar raportues.

7 Në të njëjtën ditë, me vendimin Nr. KSH. 35/12, Kryetari i Gjykatës caktoj Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (Gjyqtar kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.

8 Më 7 qershor 2012, Gjykata Kushtetuese përmes një shkrese e informoi avokatin e parashtruesit të kërkesës se kërkesa e tij ishte regjistruar.

9 Më 8 qershor 2012, Gjykata Kushtetuese, përmes një shkrese e informoi Gjykatën Supreme se parashtruesi i kërkesës kishte aplikuar për shqyrtim të vendimit Pkl. 11/2012, të 6 shkurtit 2011 dhe ia bashkëngjiti një kopje të kërkesës.

10 Më 2 korrik 2012, Kryetari me vendimin GJR. 35/12 e ri-caktoi Kolegjin e ri shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (Gjyqtar kryesues), Mr.Sc. Kadri Kryeziu, është caktuar për ta zëvendësuar Gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj, pasi që mandati i saj si gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese kishte skaduar më 26 qershor 2012, dhe Ivan Čukalović, është caktuar për ta zëvendësuar Gjyqtaren Iliriana Islami sepse mandati i saj si gjyqtare në Gjykatë kishte skaduar më 26 qershor 2012.

11 Më 17 janar 2013, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12 Më 12.12.2010, parashtruesi i kërkesës ishte ngarkuar me detyrën e furnizimit me ushqim dhe ishte regjistruar si Vëzhgues për subjektin politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Qendrën e Votimit nr. 0210 C, në vendvotimin 04 D, në shkollën fillore "Shtjefën Kurti" në fshatin "Novesellë e Epërme", Komuna e Gjakovës.

13 Rreth orës 13:00 ai ndihmoi nënën e tij për të votuar dhe rreth orës 15:00 edhe ai votoi .

14 Pas kësaj, ai shkoi për të ngrënë drekë, në qytetin fqinj dhe ishte kthyer ndërmjet orës 17:30 dhe 18:00.

15 Pas kësaj, ai hyri në dhomën e votimit dhe ishte raportuar të ketë tentuar të votojë për herë të dytë. Ai u tha vëzhguesve dhe komisionarëve "Unë do të votoj dhe ju nuk mund ta më ndaloni ", por u ndalua nga ata. Parashtruesi deklaroi se kjo ishte një shaka, të cilën gjë Gjykata Komunale e kishte refuzuar.

16 Kryesuesi i vendvotimit, MM, ka deklaruar se në përputhje me detyrat e tij, ai e kishte njoftuar atë se ai mund të votojë vetëm një herë, në të cilën gjë parashtruesi tha se ai kishte qenë vetëm në përcjellje.

17 Mundësia se parashtruesi kishte një thikë në dorën e tij kur ai eci drejt kutisë së votimit iu paraqit gjykatës në deklaratën e P.Q., dhe parashtruesi u mbrojt duke thënë se në të vërtetë ata ishin çelësat e veturës.

18 Gjykata Komunale në Gjakovë në aktgjykimin e saj P. nr. 7/2011 të 13 prill 2011, e shpalli parashtruesin fajtor për keqpërdorimin e së drejtës së votimit në pajtim me nenin 178(1) të KPPK. Ai u dënua me një gjobë prej 250 eurove.

19 Prokurori Publik i Qarkut në Pejë ushtroi ankesë kundër aktgjykimit mbi bazën se dënimi ka qenë tepër i butë. Gjykata e Qarkut në Pejë (AP. Nr. 52/11 të 31 dhjetorit, 2011) aprovoi ankesën e prokurorit se rreziku social dhe pasojat e veprës penale të kryer nuk korrespondojnë me dënimin.

20 Gjykata e Qarkut në Pejë gjeti se Gjykata Komunale i kishte marrë në konsiderim vetëm rrethanat lehtësuese dhe jo ato rënduese, siç është fakti se si një vëzhgues parashtruesi i kërkesës është dashur të ketë më tepër përgjegjësi së paku ta mënjanojë keqpërdorimin e votës,. Përveç gjobës, parashtruesi ishte dënuar me tre muaj me burgim.

21 Parashtruesi i kërkesës, i përfaqësuar nga mbrojtësi i tij, ushtori ankesë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut AP. Nr. 52/11 të 31 dhjetorit 2012.

22 Mbrojtësi paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljeve të dispozitave të KPPK (neni 1 (3), neni 7 dhe neni 14), dhe të KPPPK (neni 404 (1.2), neni 157 (1) dhe neni 322 (3)) dhe dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet (neni 51.1 dhe neni 84.2).

23 Me parashtresën e Prokurorit të Shtetit, KMLP. 11. 9/2012 i 24.01.2012, u propozua që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

24 Sa i përket neneve 1 (3), 7 dhe 14 të KPPK, në lidhje me nenin 404 (1.2) të KPPPK, mbrojtësi pohoi se Gjykata e Qarkut nuk e dëshmoi elementin subjektiv të paramendimit të veprës siç ata pohojnë se qëllimi i tij ishte të bënte shaka me ata në vendvotim , e jo të kryejë vepër penale, dhe posaçërisht se kjo vepër nuk ishte aq e rëndë sa që t'i takojë veprave penale të parapara me nenin 7.

25 Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pkl. No. 11/2012, në shpalljen e pretendimeve si të pabazuara, arsyetoi se mbrojtësi nuk i ka kuptuar këto dispozita ligjore dhe është thirrur në bazë të gabuar ligjore, sepse paragrafi 3 i nenit 1 të KPPK ka të bëjë me parandalimin e analogjisë dhe ky rast ka të bëjë me vepër penale, të përcaktuar në mënyrë të qartë në pajtim me parimin e ligjshmërisë. Neni 14 i KPPK ka të bëjë me lidhjen shkakore ndërmjet veprimit dhe pasojave. Në këtë rast nuk kishte asnjë dyshim sa i përket kësaj lidhjeje (neni 178 i KPPK dikton se veprimi konsiderohet si i kryer në përpjekjen e thjeshtë për të votuar).

26 Mbrojtësi pohoi se Gjykata i ka shkelur nenet 157(1) dhe 322 (3) të KPPPK pasi që ata e dënuan të akuzuarin duke u bazuar vetëm në dëshminë e P.Q., një vëzhgues i OJQ-së BIRN (Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese) dhe nuk i detyruan dy dëshmitarët tjerë, të cilët e injoruan ftesën e Gjykatës për të dëshmuar. Por, parashtruesi nuk ka treguar cila provë kritike nuk është pranuar nga gjykata e rregullt, ashtu që është shkelur e drejta e tij kushtetuese për gjykim të drejtë.

27 Ata gjithashtu pretendojnë se është shkelur neni 51.1 i Ligjit për Zgjedhjet, sepse ankesa është dashur t'i adresohet Komisionit të Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) dhe Gjykata nuk e siguroi këtë provë. Gjithashtu, është pretenduar një shkelje e ngjashme e nenit 84.2 pasi që Lista Zgjedhore nuk u paraqit si provë dhe nuk u kërkua ndihma e menjëhershme e policisë.

28 Gjykata Supreme konsideron se KPPK (neni 451) në mënyrë eksplicite përcakton bazën ligjore për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe shkelja e Ligjit për Zgjedhjet nuk është njëra nga këto baza ligjore.

29 Gjykata Supreme theksoi se ajo nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se përpjekjet mbrojtësit që të ri-adresojë -për shembull- disponueshmërinë e dëshmitarit dhe peshën e vënë në deklaratat e tyre nuk do të (ri) shqyrtohet nga ana e Gjykatës.

30 Gjykata Supreme shqyrtoi dosjen e lëndës në pajtim me nenin 454 (1) në lidhje me nenin 355 (1) të KPPPK dhe e shpalli kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar.

Pretendimet e Parashtruesit

31 Parashtruesi thekson se me vetë faktin që i akuzuari është dënuar në bazë të një shakaje të pretenduar është shkelur dinjiteti i tij në pajtim me nenin 23 të Kushtetutës në lidhje me nenin 31 (4) të së njëjtës.

32 Për më tepër, Parashtruesi pretendon se faktet dhe situatat e caktuara nuk janë sqaruar nga gjykatat, siç janë: se a kanë qenë në të vërtetë çelësat apo thika në dorën, se a ka votuar ai në të vërtetë me nënën e tij herën e parë dhe në çfarë cilësie ka qenë ai kur ka marrë pjesë, a ka qenë furnizues i ushqimit apo vëzhgues. Pra, ai pretendon se dënimi është marrë mbi supozimet të thjeshta, e jo në dëshmi.

33 Me paraqitjen e kërkesës në këtë Gjykatë, parashtruesi dëshiron të realizojë një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

34 Parashtruesi pretendon se ai ishte dënuar vetëm në bazë të dëshmisë të dëshmitarit të incidentit, P.Q., një vëzhgues i OJQ BIRN.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

35 Edhe pse Parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore për të realizuar të drejtën e të pretenduar për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës, ai nuk ka paraqitur ndonjë provë apo fakt relevant me të cilin do të mbështesë konkluzionin e tij se "autoritetet administrative apo gjyqësore kanë bërë shkelje të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë" (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i pranueshmërisë së GJEDNJ në rastin nr. 53363 të 31 majit 2005).

36 Gjykata Kushtetuese përsërit se nuk është detyrë e saj që të veprojë si një gjykatë apeli, apo gjykatë e shkallës së katërt, në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih: *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

37 Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

38 Prandaj, duke i shqyrtuar dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës Gjykata Kushtetuese nuk gjen se procedurat relevante ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i pranueshmërisë së GJEDNJ në rastin nr. 53363 të 31 majit 2005).3

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 46 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 17 janar 2013, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim to ti komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 103/11, Gani Morina, datë 07 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, AP. Nr. 90/10, të 8 prillit 2011.

Rasti KI 103/11, Aktvendim për papranueshmëri i 23 janarit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, *ratione temporis*, bastisje e paligjshme, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar me veprimet e gabuara të policisë së Kosovës dhe me vendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë. Parashtruesi ndër të tjera pretendonte shkelje të së drejtës në jetë private e familjare dhe të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Përkitazi me pretendimet e ngritura nga parashtruesi, Gjykata së pari përcaktoi juridiksionin kohor të saj dhe pastaj konstatoi se pretendimet e ngritura nga parashtruesi ishin të lidhura në një periudhë kohore ku Gjykata nuk kishte juridiksion kohor, përkatësisht ndërhyrjet e pretenduara në të drejtat e parashtruesit kishin ndodhur para se Kushtetuta e Kosovës të hynte në fuqi. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (3) h) të Rregullores së punës vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI103/11
Parashtruesi
Gani Morina
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, AP. Nr. 90/10, të 8 prillit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Gani Morina, avokat nga komuna e Klinës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, AP. Nr. 90/10, i 8 prillit 2011, që i është dorëzuar parashtruesit më 25 prill 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është ankesa e parashtruesit të kërkesës përkitazi me ekzekutimin e gabueshëm të urdhrit për bastisje në shtëpinë e tij, më 17 prill 2007, ku ai është arrestuar dhe i janë vënë prangat, traumat e shkaktuara atij dhe gruas së tij me rastin e ndërhyrjes në shtëpinë e tij dhe cenimi i privatësisë.

4. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata Kushtetuese mos ta bëjë të ditur identitetin e tij.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 25 korrik 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 17 gusht 2011, Kryetari e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Iliriana Islami.

8. Më 22 shtator dhe tetor 2011, Gjykata kërkoi informata nga Prokurori Publik i Kosovës. Gjykata mori përgjigje nga Prokurori Publik më 11 nëntor 2011.

9. Më 14 tetor 2011, Gjykata pranoi dokumentacionin shtesë nga parashtruesi i kërkesës, me një shkresë të 26 korrikut 2011.

10. Më 8 dhjetor 2011, më tej, Gjykata kërkoi nga parashtruesi informatë përkitazi me kërkesën. Më 23 dhjetor 2011, Gjykata mori nga parashtruesi i kërkesës një përgjigje të datës 15 dhjetor 2011.

11. Më 26 nëntor 2012, Kryetari, me vendimin (Nr. GJR. KI103/11) e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues, pasi mandati i gjyqtares Gjyljeta Mushkolaj, si gjyqtare e Gjykatës, kishte skaduar. Të njëjtën datë, Kryetari, me vendimin (Nr. KSH. KI103/11), caktoi Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović, pasi mandati i Gjyqtares Iliriana Islami si gjyqtare e Gjykatës kishte skaduar.

12. Më 17 janar 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve, siç dëshmohet nga dokumentet e ofruara nga parashtruesi

13. Më 16 prill 2007, është lëshuar një urdhër për bastisje nga një gjyqtar ndërkombëtar nga Gjykata e Qarkut në Prizren, me të cilin autorizohej bastisja në tri lokale të ndryshme që kishte të bënte me hetimet për tregti me drogë. Njëri nga objektet pretendohej të ketë qenë në pronësi të S. S. dhe të H. S., një shtëpi trekatëshe në rrugën "Bajram Curri", në Klinë. Koha, brenda së cilës do të duhej të kryhej bastisja, ishte ndërmjet orës 06:00 dhe 22:00.

14. Ky urdhër ishte ekzekutuar më 17 prill 2007, nga disa policë në Klinë. Raporti i policisë, i përgatitur më 2 maj 2007, tregonte se, sipas informatave në dispozicion të policisë, shtëpia në rrugën "Bajram Curri" kishte dy hyrje, të ndara në anën e përparme. Dyshohej se dy të dyshuarit S. S. dhe H. S. kanë jetuar atje dhe, nëse hyrja në anën e prapme, ku jetonin dy njerëz të moshuar, nuk kishte lidhje me hyrjen e parë, pjesa e prapme nuk duhej të bastisej. Bastisja filloi në orën 05:50, në një shtëpi pa numër. Përpiluesi i raportit të policisë theksoi se të dy hyrjet lidheshin me një hyrje të përbashkët, që nënkuptonte se mund të lëvizej nga hyrja e parë në hyrjen e dytë. Parashtruesi i kërkesës, Gani Morina, avokat, ishte arrestuar aty, i ishin vënë prangat për 2-3 minuta dhe pastaj policët ia kishin hequr prangat.

15. Atje, gjithashtu, ishte edhe një femër, gruaja e parashtruesit, tani e ndjerë. Një police i ishte caktuar asaj dhe asaj nuk i ishin vënë prangat. Parashtruesit i ishin vënë prangat për 2-3 minuta. Urdhri për bastisje i ishte lexuar atij në gjuhën angleze. Gjatë bastisjes, u kontaktua komandanti fushor, i cili konfirmoi se bastisja po kryhej në vendin e duhur. Bastisja vazhdoi dhe përfundimisht u krye në orën 07:06.

16. Më 20 prill 2007, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Prokurorinë e Qarkut në Prizren përkitazi me zbatimin e urdhrit për bastisje, të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Prizren, të datës 16 prill 2007. Megjithatë, ai nuk mori asnjë përgjigje.

17. Më 21 prill 2007, parashtruesi iu drejtua Prokurorisë Komunale në Pejë, duke ngritur akuza në bazë të nenit 166 (1) dhe (3) (vepra penale e cenimit të paprekshmërisë së banesave); në bazë të nenit 167 (vepra penale e kontrollimit të kundërligjshëm); dhe në bazë të nenit 304 (1) dhe (2) (vepra penale e moslajmërimit të veprës penale apo moslajmërimit të kryerësve të veprës penale) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK). Parashtruesi i ngriti

këto akuza, sepse ai pretendonte se F. H., R. F., S. H. dhe D. V. kishin bërë shkelje të dispozitave të nenit 240 (5), të nenit 242 (1), (2), (3) dhe (4), si dhe të nenit 245 (5) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPPK).

18. Më 11 qershor 2007, Prokurori Publik Komunal në Pejë i dëgjoi dëshmitarët e bastisjes së kontestuar. Ai erdhi në përfundim se kishte hapësirë për procedurë dhe për përgjegjësi të atyre që e kryen bastisjen. Këtij konkluzioni iu dha shenja e protokollit PPN. nr. 64/02, më 16 korrik 2007.

19. Më 24 gusht 2007, parashtruesi i shkroi një letër Prokurorit Publik Komunal në Pejë dhe u ankua për reduktimin e akuzës. Megjithatë, ai nuk mori asnjë përgjigje.

20. Më 15 nëntor 2007, Prokurori Publik Komunal në Pejë i prezantoi akuzat e propozuara me një urdhër ndëshkimor PP. nr. 1853/2007 kundër të pandehurve R. F., S. H. dhe D. V., por jo kundër F. H., i cili ishte personi kryesor, përgjegjës për lëshimin e urdhrit për bastisje, dhe as kundër E. I., i cili, përveç se ishte anëtar i ekipit të bastisjes, ishte dëgjuar vetëm në cilësi të dëshmitarit. Akuzat kundër R. F., S. H. dhe D. V. u reduktuan në veprën penale të kontrollimit të kundërligjshëm nga neni 167 i KPPK-së.

21. Më 22 nëntor 2007, parashtruesi i shkroi Prokurorit Publik Komunal, duke kërkuar ndryshimin dhe zgjerimin e akuzave të propozuara për të përfshirë bastisjen e përsëritur, për të cilën parashtruesi pretendon se është kryer pa praninë e dëshmitarëve dhe pa dijen e pronarit. Parashtruesi pretendon se kjo ishte shkelje e dispozitave të nenit 243 (7) të KPPPK-së. Parashtruesi nuk mori përgjigje ndaj kësaj parashtrese.

22. Më 14 dhjetor 2007, Gjykata Komunale në Klinë nxori aktgjykimin P. nr. 162/2007 dhe konstatoi se R. F., S. H. dhe D. V. ishin fajtorë për kryerjen e veprës penale të kontrollimit të kundërligjshëm, nga neni 167 (1) në lidhje me nenin 23 të KPPK-së, dhe dënoi secilin veç e veç me gjobë në shumën 250 euro dhe me shpenzimet procedurale.

23. Gjykata Komunale theksoi në arsyetimin e saj se e kishte marrë vendimin bazuar në provat e bashkangjitura propozimit për lëshimin e urdhrit, siç janë: akuzat penale të ngritura nga parashtruesi, urdhri për bastisje i 16 prillit 2007, raporti i bastisjes, artikulli që parashtruesi e kishte botuar në të përditshmen “Epoka e re”, raportet e mjekut për

bashkëshorten e parashtruesit dhe dokumentet e tjera në dosjen e lëndës.

24. Më 10 janar 2008, R. F., S. H. dhe D. V. ushtruan ankesë ndaj Vendimit P. nr. 162/07. Ata pretenduan se urdhri ndëshkimor është lëshuar bazuar në provat e gabuara. Ata kërkuan të refuzohet propozimi i Prokurorit për lëshimin e urdhrit dhe Gjykata Komunale të caktojë një shqyrtim kryesor për rastin.

25. Më 18 shkurt 2010, pas nxjerrjes së provave në fjalën e tij përfundimtare, Prokurori Publik në Pejë i tërhoqi akuzat e propozuara kundër R. F., S. H. dhe D. V. për shkak të mungesës së dëshmitarëve. Megjithatë, parashtruesi e vazhdoi rastin si një paditës subsidiar.

26. Më 22 shkurt 2010, Gjykata Komunale në Klinë, me Aktgjykimin P. nr. 162/07, liroi R. F., S. H. dhe D. V. nga akuzat e propozuara.

27. Gjykata Komunale, bazuar në provat e vërtetuara nga shqyrtimi kryesor dhe bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve, në urdhrin për bastisje dhe në dëgjimin e R. F., S. H. dhe D.V., erdhi në përfundim se në sjelljen e R. F., S. H. dhe D. V. nuk kishte as elemente, e as tipare, të veprës penale të kontrollimit të kundërligjshëm. Prandaj, Gjykata Komunale liroi R. F., S. H. dhe D. V. nga akuzat e propozuara, pasi edhe Prokurori Publik i Pejës, në fjalën e tij përfundimtare, u tërhoq nga ndjekja penale e R. F., S. H. dhe D. V., për shkak të mungesës së provave.

28. Më 25 maj 2010, parashtruesi ushtroi ankesë ndaj Aktgjykimit P. nr. 162/07. Parashtruesi pretendon se në aktgjykim kishte: shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje e interpretim të gabuar të së drejtës materiale.

29. Më 8 prill 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë nxori Aktgjykimin Ap. nr. 90/10, me të cilin e vërtetoi Vendimin e Gjykatës Komunale në Klinë, P. nr. 162/07.

30. Më 6 maj 2011, parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës.

31. Më 12 maj 2011, Prokurori i Shtetit i Kosovës e refuzoi kërkesën e parashtruesit. Ai theksoi se, pas shqyrtimit të detajuar të propozimit të parashtruesit, nuk u gjet asnjë arsye e bazuar nga neni 451 dhe nga neni 452 i KPPPK-së për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit]; neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]; dhe neni 55.5 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], i Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendon shkeljen e nenit 1 – Detyrimi për të Respektuar të Drejtat e Njeriut, dhe të nenit 8 – E Drejta për Respektimin e Jetës Private dhe Familjare të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa).

33. Parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, mëton

- që urdhri për bastisje ka qenë në gjuhën të cilën ai nuk e ka kuptuar,
- që nuk ka përmbajtur as emrin e tij e as të ndonjë anëtari të familjes,
- që raporti i policisë thekson se shtëpia ka qenë dykatëshe dhe jo trekatëshe,
- që shtëpia e tij e ka pasur numrin 13 në pjesën e jashtme,
- që nuk është gjetur drogë e as bunker në oborrin e tij,
- që bastisja është përsëritur pas orës 09:00 me qentë e trajnuar, pa prani të dëshmitarëve apo të pronarit dhe për këtë nuk ekziston asnjë raport i përgatitur.

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se shumë prej dispozitave të KPPK-së, të KPPPK-së, të Ligjit për Policinë dhe të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, ishin shkelur në kohën e bastisjes dhe gjatë procedurave vijuese gjyqësore.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

35. Në mënyrë që të mund të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregulloren e punës.

36. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) (h), i cili thotë:

> *"Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:*
>
> *h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën".*

37. Për të përcaktuar juridiksionin kohor të Gjykatës, është qenësore të identifikohet në secilin rast konkret koha e saktë e shkeljes së pretenduar. Duke vepruar ashtu, Gjykata duhet të marrë parasysh faktet për të cilat ankohet parashtruesi dhe shtrirjen e të drejtës kushtetuese që pretendohet se është cenuar (*Shih, mutatis mutandis, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i Dhomës në rastin Blečič kundër Kroacisë, Kërkesa nr. 59532/0, e 8 marsit 2006, paragrafi 82*).

38. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ankohet ndaj zbatimit të gabueshëm të urdhrit për bastisje të gabuar në banesën e tij, më 17 prill 2007, nga Policia e Kosovës.

39. Kjo do të thotë se shkelja e pretenduar e të drejtave të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me Kushtetutë, ka ndodhur para 15 qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe nga e cila datë Gjykata ka juridiksion kohor.

40. Gjykata ngjashëm ka vendosur në rastin KI100/10, Aktvendim për papranueshmëri, parashtruesi i kërkesës Eduard Thaqi (gjithashtu i njohur si Sokol Thaqi) – Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Policisë së Kosovës, Nr. 398-SHPK-2002, të 22 tetorit 2002.

41. Për më tepër, Gjykata refuzon kërkesën e parashtruesit për moszbulimin e identitetit të tij, në bazë të asaj se ai nuk e ka arsyetuar miratimin e asaj kërkese.

42. Rezulton që kërkesa e parashtruesit nuk është *ratione temporis* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 20 të Ligjit; dhe në përputhje me rregullin 36 (3) (h) të Rregullores së punës, më 17 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'iu komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 90/12, Ramadan Kastrati, datë 07 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit SCC-04-0100 të Dhomës së Posaçme së Gjykatës Supreme të Kosovës, të 18 gushtit 2004

Rasti KI 90/12, Aktvendim për papranueshmëri i 23 janarit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, *ratione temporis*, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta në pronë, lista poseduese

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar me vendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Parashtruesi ndër të tjera pretendonte se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme nuk e kishte informuar atë përkitazi me marrjen e vendimit.

Përkitazi me pretendimet e ngritura nga parashtruesi, Gjykata së pari përcaktoi juridiksionin kohor të saj dhe pastaj konstatoi se pretendimet e ngritura nga parashtruesi ishin të lidhura në një periudhë kohore ku Gjykata nuk kishte juridiksion kohor, përkatësisht ndërhyrjet e pretenduara në të drejtat e parashtruesit kishin ndodhur para se Kushtetuta e Kosovës të hynte në fuqi. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (3) h) të Rregullores së punës vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI90/12
Parashtruesi
Ramadan Kastrati
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit SCC-04-0100 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 18 gushtit 2004

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Ramadan Kastrati (përfaqësues ligjor i babait të ndjerë, Q. K.), i përfaqësuar nga Isak Islami, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e Urdhrit SCC-04-0100 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS), të 18 gushtit 2004.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është ndalimi i shitjes së lokalit afarist nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) për të cilin parashtruesi pretendon se është në pronësi të tij.

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2010 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 36 (3) (h) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 10 shtator 2012, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës ((në tekstin e mëtejmë: Gjykata)

6. Më 13 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që t'i sqarojë disa aspekte të kërkesës së tij.

7. Më 31 tetor 2012, Gjykata Kushtetuese e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi edhe një herë nga parashtruesi që të sqarojë kërkesën e tij.

8. Më 2 nëntor 2012, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy, kryesues, Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 27 nëntor 2012, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

10. Më 17 janar 2012, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve, siç dëshmohet nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi

11. Më 27 qershor 1984, Komuna e Gjilanit e lëshoi Vërtetimin nr. 04-431/31, me të cilin vërtetohet se Q. K. (babai i ndjerë i parashtruesit) është pronar i lokalit afarist që gjendet në Gjilan, që nga viti 1966.

12. Më 8 maj 1985, Q. K. ka lidhur një marrëveshje me shkrim për kompensim me Sekretariatin për Punë Komunale-Banesore dhe Pronësoro-Ligjore në Gjilan, me të cilën Sekretariati detyrohet t'ia japë Q. K. një lokal afarist prej 30 metrash katrorë si kompensim për tokën dhe për ndërtesat e shpronësuara.

13. Sipas marrëveshjes së lartpërmendur, detyrimi që t'ia japë Q. K. një lokal afarist është dashur të kryhet nga Fabrika e Baterive në Gjilan, e cila, në tokën e shpronësuar kishte ndërtuar ndërtesa për banim, për nevoja të veta, duke i përfshirë lokalet afariste.

14. Më 7 mars 1988, Q. K. paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Gjilan, duke kërkuar që kjo gjykatë t'i detyrojë të paditurit (Komunën e Gjilanit dhe Fabrikën e Baterive në Gjilan) që t'ia japin Q. K. lokalin afarist,

sipas marrëveshjes së bërë me shkrim për kompensim, të 8 majit 1985. Rezultati i kësaj padie është i panjohur për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe/ose për shkak të faktit se disa dokumente në këtë kërkesë janë të palexueshme.

15. Më 14 mars 1988, Q. K. e dorëzoi një parashtresë në Këshillin Ekzekutiv të KK në Gjilan, me të cilën shpjegonte se ai ishte dëmtuar në mënyrë drastike nga Fabrika e Baterive në Gjilan, sepse lokali afarist që i ishte dhënë atij "nuk është aspak i përshtatshëm për punë, por për depo".

16. Më 9 tetor 2003, Gjykata Komunale në Gjilan, me Vendimin C. nr. 529/03, pas propozimit për vendosjen e masave të përkohshme nga paditësi Q. K. (babai i ndjerë i parashtruesit) për shpronësimin e pronës së patundshme (lokali afarist), vendosi: 1) të vendosë masën e përkohshme, dhe 2) t'i ndalojë të padituri, Komunën e Gjilanit dhe Fabrikën e Baterive në Gjilan, ta shesin lokalin afarist me sipërfaqe prej 40 m2 derisa nuk zgjidhet përfundimisht kontesti i pronësisë.

17. Më 28 qershor 2004, parashtruesi paraqiti një padi në DHPGJS kundër Komunës së Gjilanit dhe Fabrikës së Baterive në Gjilan, duke kërkuar që të mos e vendosin në shitje lokalin e lartpërmendur afarist.

18. Më 18 gusht 2004, DHPGJS lëshoi një urdhër detyrues për rastin SCC 04-0100, duke deklaruar:

> "*Kjo padi kërkon kompensim që rrjedh nga një urdhër shpronësimi dhe një kërkesë për anulimin e të njëjtit urdhër shpronësimi nëse kërkesa për shpronësim nuk do të miratohet". Në pajtim me nenet 52 dhe 53 të Ligjit mbi Shpronësimet lexuar me nenin 139 të Ligjit mbi Procedurën Jashtëkontestimore kjo Dhomë ia dërgon vendimin mbi të drejtën e sasisë dhe kompensimit Gjykatës Komunale. Kështu, sipas nenit 17.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK – ut 2003/13, kjo Gjykatë ia përcjell lëndën gjykatës përkatëse vendore. Nëse do të depozitohet ndonjë apelim, ajo duhet të depozitohet në Dhomën e Posaçme.*
>
> *Ky urdhër është detyrues për palët dhe gjykatën së cilës i është përcjellë lënda".*

19. Më 28 maj 2012, Gjykata Komunale në Gjilan, pas padisë së paditësit Q. K. kundër të paditurave: Komunës së Gjilanit dhe Fabrikës së Baterive në Gjilan, për verifikimin e pasurisë së lartpërmendur, shpalli: (1) veten jokompetente për të vendosur në procedurën e përmendur

kontestimore; dhe (2) shkresat e lëndës do t'i dërgohen DHPGJS-së për të vazhduar më tej si gjykatë kompetente.

20. Më 27 gusht 2012, parashtruesi kërkoi nga AKP-ja që të mos e përfshijë lokalin afarist në valën e privatizimit.

21. Më 11 shtator 2012, parashtruesi dorëzoi një parashtresë në DHPGJS kundër AKP-së përkitazi me kërkesën e tij për mospërfshirjen e lokalit afarist në valën e privatizimit.

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi pretendon se AKP-ja nuk e ka shqyrtuar listën poseduese dhe kopjen e planit të lokalit afarist, të regjistruar nën emrin e Q. K. (babait të ndjerë të parashtruesit).

23. Parashtruesi pretendon se AKP-ja nuk e ka shqyrtuar aktvendimin e DHPGJS (Urdhri SCC 04-0100), e as Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Gjilan (Vendimi C. nr. 529/03, të 9 tetorit 2003).

24. Parashtruesi pretendon se ai ka paraqitur kërkesë në Gjykatë për mbrojtjen e ligjshmërisë për rastin nr. SCC-04-0100, të 28 qershorit 2004, DHPGJS-së dhe AKP-së për ndalimin dhe për mospërfshirjen e lokaleve afariste në valën e privatizimit.

25. Parashtruesi pretendon shkeljen e nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës, sepse DHPGJS-ja ka marrë një aktvendim pa e informuar as pronarin dhe as përfaqësuesin e tij të autorizuar me shkrim. Për më tepër, parashtruesi e konsideron veprimin e mësipërm nga DHPGJS-ja si një shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut sa i përket sundimit të ligjit.

Vlerësimi i pranueshmërisë

26. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës.

27. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) (h) të Rregullores, i cili thotë:

> "*Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:*

(h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën".

28. Në mënyrë që të përcaktohet juridiksioni kohori Gjykatës, është esenciale që të identifikohet, në çdo rast specifik, koha e saktë e ndërhyrjes së pretenduar. Duke vepruar kështu, Gjykata duhet të marrë parasysh faktet për të cilat ankohet parashtruesi dhe shtrirjen e të drejtës kushtetuese që pretendohet se është shkelur (*Shih, mutatis mutandis, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i Dhomës së Madhe në rastin Blečič kundër Kroacisë, Parashtresa nr. 59532/0, e 8 marsit 2006, paragrafi 82*).

29. Gjykata vëren se parashtruesi ankohet se është shkelur e drejta pronësore e tij, e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, parashtruesi kërkon një vlerësim të Urdhrit të DHPGJS-së, Nr. 04-0100, të 18 gushtit 2004.

30. Kjo do të thotë se, ndërhyrja e pretenduar me të drejtën e parashtruesit të garantuar me Kushtetutë, kishte ndodhur para 15 qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe nga e cila datë Gjykata ka juridiksion kohor.

31. Gjykata kishte vendosur ngjashëm në Rastin KI100/10, Aktvendim për papranueshmëri, të parashtruesit Eduard Thaqi (gjithashtu i njohur si Sokol Thaqi) – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Policisë së Kosovës, Nr. 398-KPS-2002, të 22 tetorit 2002.

32. Rrjedhimisht kërkesa e parashtruesit është *ratione temporis* e papajtueshme me dispozitat e Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36 (3) h të Rregullores së punës, më 17 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 82/12, Milorad Rajović, datë 12 mars 2013- Kërkesë për Vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë së zbatimit të Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2000/4, dhe të Ligjit të Republikës së Kosovës, Nr. 2008/03 - L033

Rasti KI-82/12, Aktvendim për papranueshmëri i 25 janarit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, vlerësimi abstrakt i kushtetutshmërisë së ligjit, e drejta për mjete juridike, imuniteti, mbrojtja e pronës, palë e autorizuar.

Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese vlerësim të kushtetutshmërisë së Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2000/47, "për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tij në Kosovë", si dhe të Ligjit 2008/03-L033 të Republikës së Kosovës "për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovë dhe praninë ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e saj."

Parashtruesi i kërkesës e konteston mënyrën në të cilën Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (në tekstin e mëtejmë: OSBE) interpreton dhe zbaton Rregulloren e UNMIK-ut, Nr. 2000/4 si dhe Ligjin Nr. 2008/03 - L033, duke konsideruar se me interpretim të gabuar, ata nxjerrin përfitime që rrjedhin nga statusi, imuniteti dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personeli në Kosovë.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se këto ligje kanë shkelur të drejtat e tij pronësore, të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të drejtat dhe liritë e parapara me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit Milorad Rajović, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se individët mund të iniciojnë procedurë nëse të drejtat dhe liritë e tyre, të garantuara me këtë Kushtetutë janë shkelur nga autoritetet publike, por parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për të kërkuar interpretimin e Rregullores së UNMIK –ut, Nr. 2000/47 dhe të Ligjit 2008/03-033 në mënyrë abstrakte. Për këtë arsye, kjo kërkesë duhet të shpallet e papranueshme, sepse është parashtruar nga pala e paautorizuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI82/12
Parashtruesi
Milorad Rajović
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë së zbatimit të Rregullores së UNMIK-it, Nr. 2000/4, dhe të Ligjit të Republikës së Kosovës, Nr. 2008/03 – L033

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Milorad Rajović, pronar i N. P. "Udarnik Komerc" në Mitrovicë, të cilin e përfaqëson avokati Avni Q. Vula nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet kushtetutshmëria e zbatimit të Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2000/4, "për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tij" (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/4), si dhe Ligji Nr. 2008/03 – L033 "për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovë dhe praninë ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e saj" (në tekstin e mëtejmë: Ligji Nr. 2008/03 – L033)

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës e konteston mënyrën në të cilën Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (në tekstin e mëtejmë: OSBE) interpreton dhe zbaton Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/4 si dhe Ligjin Nr. 2008/03 – L033. Ai pretendon se ato ligje kanë shkelur të

drejtat e tij pronësore, të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të drejtat dhe liritë e parapara me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 dhe në nenin 21.4 të Kushtetutës; në nenin 20, në nenin 22.7 dhe në nenin 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56, paragrafi 2, të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 7 shtator 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Me Vendimin e Kryetarit (Nr. GJR. KI82/12, të 5 tetorit 2012), gjyqtari Robert Carolan është caktuar Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me vendimin e Kryetarit (Nr. KSH. KI82/12) është caktuar Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajziri.

7. Më 25 janar 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Robert Carolan, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi, i paraqiti Gjykatës, në përbërje të plotë, rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Z. Milorad Rajović, pronar i N.P. “Udarnik Komerc”, tash me seli në Mitrovicë, pretendon se është pronar i pakontestueshëm i lokalit afarist, me një sipërfaqe të përgjithshme 1.078 m², i cili gjendet në Pejë, në adresën “Ndërtesa për banim Tarolit II“.

9. Kjo ndërmarrje ka fituar të drejtat pronësore për lokalet e lartpërmendura afariste, në bazë të kontratës së shitblerjes, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë, C. nr. 224/94, të 13 marsit 1994, siç është konfirmuar me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë, C. nr. 224/94, të 13 prill 1994.

10. Nga mesi i vitit 1999, ky lokal afarist ishte zënë nga Misioni i OSBE-së, pa marrëveshje paraprake gjegjësisht pa dijeni të pronarit të lokalit afarist.

11. Pasi ka mësuar se në lokalet e tij është vendosur Qendra Rajonale e Misionit të OSBE- së në Kosovë, z. Milorad Rajović, në vitin 1999, i është drejtuar Misionit të OSBE-së, duke kërkuar lidhjen e kontratës për shfrytëzimin e objekteve të tij dhe pagesën e qirasë përkatëse. Megjithatë, kërkesat e tij nuk janë marrë në konsideratë dhe as nuk janë pranuar.

12. Ndërmjet viteve 1999 dhe 2007, parashtruesi i dërgoi Misionit të OSBE-së një numër të madh të shkresave, duke kërkuar respektimin e të drejtave të tij pronësore dhe lidhjen e një kontrate për qiranë e objektit të lartpërmendur. Megjithatë, përveç përgjigjes me shkrim dërguar parashtruesit, Misioni i OSBE-së nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret për ta zgjidhur këtë problem.

13. Më 28 dhjetor 2007, parashtruesi ushtroi ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit.

14. Më 3 mars 2008, Avokati i Popullit nxori Vendimin Nr. 2355/07, me të cilin e shpall të papranueshme ankesën e parashtruesit, sepse nuk ishte në përputhje me *ratione personae* në bazë të Rregullores së punës.

15. Më 15 janar 2008 u mbajt një takim ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe përfaqësuesit të Misionit të OSBE-së. Në atë takim, parashtruesi i kërkesës, për herë të parë, mori një ofertë konkrete nga Misioni i OSBE-së për pagesën e qirasë. Oferta, të cilën e kishte paraqitur përfaqësuesi i Misionit të OSBE-së, mbulonte vetëm periudhën pas 1 korrikut 2007, në kohëzgjatje për një vit, me mundësi të zgjatjes.

16. Parashtruesi i kërkesës pohoi se, pas disa orë negociatash, "*nën presion dhe kërcënim*" nga përfaqësuesi i Misionit të OSBE-së, ai pranoi ofertën dhe nënshkroi kontratën e qirasë, me një marrëveshje gojore që zgjidhja e borxhit të qirasë për periudhën 1999 – 1 nëntor 2007, do të vazhdonte pas nënshkrimit të kontratës së ofruar.

17. Më 20 shkurt 2008, parashtruesi i kërkesës ia dërgoi shkresën e parë përfaqësuesit të Misionit të OSBE-së, z. John Fennessy, me kërkesë për fillimin e zgjidhjes së çështjes së borxhit të mbetur për periudhën 1999 – 1 nëntor 2007.

18. Më 25 shkurt 2008, Departamenti i Administratës së Misionit të OSBE-së (John Fennessy) e informoi parashtruesin e kërkesës se kërkesa e tij për pagesën e qirasë për periudhën 1999 – 1 nëntor 2007 ishte dërguar në selinë e Misionit të OSBE-së në Vjenë, se selia e Misionit e kishte diskutuar këtë çështje dhe se është duke u pritur qëndrimi i tyre.

19. Parashtruesi i kërkesës, në periudhën prej vitit 2009 e deri më 2011, ia dërgoi tri (3) shkresa të tjera Misionit të OSBE-së.

20. Misioni i OSBE-së, në të gjitha shkresat e parashtruesit të kërkesës, dërgoi përgjigje me përmbajtje të ngjashme, "*se rasti i parashtruesit i kërkesës është me selinë e OSBE-së në Vjenë, dhe që Misioni i OSBE-së do ta informojë parashtruesin e kërkesës në lidhje me vendimin dhe qëndrimin e Qendrës, posa qëndrimi i tyre të jetë i njohur*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Misioni i OSBE-së qëllimisht i ishte shmangur detyrimit ndaj tij, duke qenë i vetëdijshëm për pozitën e tij, siç parashihet me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000 /47.

22. Në mbështetje të pretendimit të tij, parashtruesi i kërkesës citon rastin e Bankës Kreditore të Prishtinës kundër Misionit OSBE-së, në vitin 2011, ku Gjykata Komunale në Prishtinë, me aktvendimin EDA. nr. 2553/2011, të 30 dhjetorit 2011, lejoi ekzekutimin kundër Misionit të OSBE-së për qiranë e papaguar për shfrytëzimin e lokaleve afariste të Bankës.

23. Më 30 prill 2012, Misioni i OSBE-së, me parashtresën HOM/54/12, e kontestoi këtë ekzekutim, duke u thirrur në imunitetin e tij të paraparë me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2000/47.

24. Në bazë të parashtresës së Misionit të OSBE-së, HOM/54/12, Gjykata Komunale në Prishtinë pastaj e anuloi Aktvendimin EDA. nr. 2553/2011.

25. Gjykata Komunale theksoi se një kreditor mund të zgjidhë këtë çështje duke iu drejtuar Komisionit për kërkesa, i cili ishte themeluar nga KFOR-i dhe UNMIK-u, në pajtim me nenin 7 të Rregullores UNMIK/RREG 2000/47, të 18 gushtit 2000.

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me shkresën e 10 shtatorit 2009, ai i ishte drejtuar "Panelit Këshillimor për të Drejtat e Njeriut", përkatësisht Komisionit të kërkesave, dhe se nga ky Këshill ka pranuar

vetëm një shkresë, e cila është regjistruar me Nr. 308/09, me të cilën ata e informojnë se kërkesa e tij është pranuar dhe se është caktuar personi që do të marrë rastin.

27. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendon *"që për disa vite nuk kishte marrë asnjë shkresë nga Paneli Këshillimor për të Drejtat e Njeriut"*.

28. Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij, pretendon se iu ka mohuar e drejta për mjet juridik për t'i mbrojtur të drejtat e tij pronësore. Bazë për pretendimin e parashtruesit është Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/47, si dhe Ligji 2008/03-033. Neni 2.1 i këtij Ligji parasheh: "UNMIK-u (në këtë rast OSBE-ja), prona e tij, fondet dhe asetet, janë të përjashtuara nga çdo proces ligjor".

29. Parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesat e mëposhtme:

"Që kjo Gjykatë të hapë dhe zhvillon procedurën përkatëse gjyqësore në pajtim me dispozitat e nenit 46 të Ligjit nr. 03/L-121 "Për Gjykatën Kushtetuese të Republikës Kosovës" dhe gjatë zhvillimit të kësaj procedure të benë vlerësimin juridik të fakteve dhe argumenteve të prezantuara, të benë ekzaminimin e provave dhe që, në bazë dispozitave Kushtetuese dhe dispozitave përkatëse ligjore vendore e ndërkombëtare, të benë vlerësimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë se dispozitave të larte përmendura të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 "Mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tyre" dhe të Ligjit nr. Nga aspekti i mbrojtjes se të drejtave dhe lirive themelore dhe të pacenueshme të qytetareve të Kosovës dhe pastaj, në bazë të dispozitave përkatëse Kushtetuese, akteve juridike vendore e ndërkombëtare veçanërisht të theksuara me nenin 22/31 e lidhur me nenin 46 të kësaj Kushtetute, nenit 6.1 të Konventës Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut".

"Të shpallë të gabuara, të pabazuara, jo të drejta, kundër-kushtetuese dhe të kundërligjshme interpretimet e dispozitave mbi imunitetin e përcaktuara me Rregulloren se UNMIK-ut nr. 2000/47 "Mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tyre dhe me Ligjin nr 2008/03-L033 për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovë dhe pranin ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e saj"; për rastet e cenimit dhe shkeljes

së të drejtave pronësore te qytetareve të Kosovës si të drejta dhe liri të pacenueshme, të patjetërsueshme e themelore të njeriut përkatësisht qytetareve në Kosovë dhe për rastet e kërkesave materiale - financiare të qytetareve të Kosovës, borxheve e dëmshpërblimeve civile lidhur me shfrytëzimin e shërbimeve dhe pronës private të qytetareve të Kosovës apo të dëmtimeve të tyre".

"Të cakton si kompetente Gjykatën Ekonomike në Prishtinë apo Gjykatën Supreme të

Kosovës - Dhoma e Veçantë në Prishtinë që të vendosë lidhur me kërkesat e Ndërmarrjes Private "UDARNIK KOMERC" në emër të qirasë së papaguar për shfrytëzimin e lokaleve të saj afariste nga ana e Misionit të OSBE-se - Qendra Regjionale Pejë në periudhën Korrik 1999 - 01.11.2007".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Për të gjykuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

31. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 1 dhe paragrafi 7, të Kushtetutës.

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

"7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

32. Në këtë rast, parashtruesi kërkon "vlerësimin e kushtetutshmërisë së Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2000/47, për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tij në Kosovë, si dhe të Ligjit 2008/03-033 të Republikës së Kosovës për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovë dhe praninë ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e saj", dhe, në këtë mënyrë, Kushtetuta në mënyrë shumë të qartë e përcakton

në nenin 113 se kush mund të kërkojë vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit.

33. Një kërkesë e tillë për "vlerësimin e kushtetutshmërisë së Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/47 dhe Ligjit 2008/03-033", është kontestim abstrakt i Rregullores dhe Ligjit të lartpërmendur. Në qoftë se ky është qëllimi i parashtruesit të kërkesës si individ, atëherë ai nuk mund të konsiderohet si palë e autorizuar.

34. Neni 113.2, neni 113.6 dhe neni 113.8 të Kushtetutës shprehimisht parashohin se cilat janë palë të autorizuara që mund t'i drejtohen Gjykatës për çështjen e vlerësimit abstrakt të kushtetutshmërisë të ligjit.

35. Gjykata vëren se, në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i mungon "pozicioni" ose autoriteti në Gjykatë, sepse parashtruesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kërkesat e nenit 113.1 të Kushtetutës. Përveç kësaj, sistemi kushtetues juridik i Kosovës nuk parasheh *actio popularis,* që është modalitet i kërkesave individuale që ia siguron çdo individi, i cili dëshiron të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, mundësinë për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese përkitazi me atë shkelje, edhe pse ai/ajo nuk e ka statusin e viktimës.

36. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për të kërkuar interpretimin e Rregullores së UNMIK -ut Nr. 2000/47 dhe të Ligjit 2008/03-033. Dhe, kjo kërkesë duhet të shpallet e papranueshme, sepse është parashtruar nga pala e paautorizuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 46, me nenin 47 dhe me nenin 48 të Ligjit; si dhe me rregullin 36.1.a dhe 36.3.c të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 97/11, Mon Nushi, datë 14 mars 2013- Kërkesë për Vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në Prishtinë, Rev. nr. 87/12, e 21 marsit 2011.

Rasti KI 97/11, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 janarit 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar

Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me aktgjykimin në fjalë, është shkelur neni 31 i Kushtetutës (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) dhe neni 6.1 i KEPDNJ-së, së bashku me protokollet e saj. Parashtruesi më tej thekson se, gjithashtu, janë shkelur edhe nenet: 7, 21, 22, 31, 46, 53 dhe 121 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 87/12, e 21 marsit 2011, nuk gjeti elemente të arbitraritetit dhe as shkelje të supozuar të të drejtave të njeriut, sikur kishte pretenduar parashtruesi i kërkesës.

Në këto rrethana, parashtruesi i ankesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij" dhe nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar, andaj Gjykata, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika c dhe pika d, gjen se kërkesën duhet të refuzohet si qartazi e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI97/11
Mon Nushi
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në Prishtinë, Rev. nr. 87/12, e 21 marsit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Mon Nushi, nga fshati Vraniq, komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson avokati Rexhep Gjikolli nga Gjakova (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në Prishtinë, Rev. nr. 87/12, i 21 marsit 2011, të cilin, sipas pohimit personal, parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 7 prill 2011.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), më 19 korrik 2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme në Prishtinë, Rev. nr. 87/12, të 21 marsit 2011, me anë të të cilit Gjykata Supreme kishte refuzuar si të pabazuar revizionin e përfaqësuesve të autorizuar të parashtruesit të kërkesës dhe të vetë parashtruesit të kërkesës, z. Mon Nushi, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 404/2003, të 15 nëntorit 2006.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës; neni 22 dhe neni 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009; dhe rregulli 54, rregulli 55 e rregulli 56.2, të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 19 korrik 2011, Gjykata pranoi nëpërmjet postës kërkesën e parashtruar nga avokati Rexhep Gjikolli, që përfaqëson parashtruesin e kërkesës, z. Mon Nushi nga Gjakova, dhe kjo kërkesë u regjistrua në Gjykatë me Nr. KI97/11.

6. Më 14 nëntor 2011, Gjykata i dërgoi shkresë përfaqësuesit të parashtruesit, me të cilën kërkoi dokumentacion shtesë, të nevojshëm për procedimin e mëtutjeshëm të kërkesës.

7. Më 22 nëntor 2011, Gjykata, nëpërmjet postës, pranoi dokumentacion shtesë nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dhe, me këtë rast, kërkesës i ishin bashkëngjitur Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, C. nr. 57/83, i 20 majit 1987, dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 4040/03, i 15 nëntorit 2006.

8. Më 17 gusht 2012, me vendimin GJR. KI97/11, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy si Gjyqtar raportues, ndërsa, me vendimin KSH97/11, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Gjyljeta Mushkolaj.

9. Më 26 nëntor 2012, Kryetari i Gjykatës nxori vendimin për zëvendësimin e vendimit KSH97/11 ashtu që, në pikën 1, për shkak të skadimit të mandatit të saj si gjyqtare, në vend të ish-gjyqtares Gjyljeta Mushkolaj emëroi në Kolegj shqyrtues gjyqtarin Kadri Kryeziu.

10. Më 17 janar 2013 Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 18 shtator 1981, sipas pohimeve të përfaqësuesit të kërkesës, z. Mon Nushi, në cilësinë e blerësit, ai kishte lidhur kontratë për shitblerje me z. Mušović Arif nga Gjakova, në cilësinë e shitësit, me objekt kontrate: "Shitblerja e pronës së paluajtshme – shtëpi e oborr, e cila gjendej në Gjakovë, rruga 'Miloš Gilić' nr. 139".

12. Kjo kontratë e pohuar nuk është paraqitur së bashku me kërkesën dhe ekzistencën e saj nuk e kanë vërtetuar as gjykatat e rregullta në procedurat e mëvonshme gjyqësore.

13. Në fakt, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktgjykimin P. nr. 57/83, kishte konstatuar se një kontratë e tillë e pohuar nga parashtruesi i kërkesës nuk ka vlerë juridike, sepse ishte e lidhur në kundërshtim me dispozitat juridike në fuqi të asaj kohe, por megjithatë, duke vërtetuar faktin se z. Mon Nushi i kishte paguar një shumë të hollash z. Mušović, gjykata e përmendur kishte konstatuar se ai është dëmtuar, andaj, me aktgjykim, urdhëroi zhdëmtimin e tij në shumën prej 1.950.000 dinarësh të atëhershëm, me 7.5% interes, duke filluar nga 18 janari 1983.

14. Më 19 shkurt 2002, Gjykata Komunale në Gjakovë nxori Aktgjykimin C. nr. 3004/2000, me të cilin refuzoi si **të pabazuar** padinë e paditësit Mon (Nue) Nushi nga fshati Vraniq, komuna e Gjakovës, me të cilën kishte kërkuar nga Gjykata që i padituri Arif (Amri) Mušović TË DETYROHET **të lidhë dhe të vërtetojë** kontratën për shitblerjen e patundshmërisë, me të cilën i padituri i shet paditësit paluajtshmërinë që evidencohet në ngastrën kadastrale nr. 305/4, me kulturë shtëpi, në sipërfaqe prej 0,01.15 ha, dhe me kulturë oborr, në sipërfaqe prej 0.02.14 ha, sipas fletës së posedimit nr. 1133, KK-Gjakovë-qytet.

15. Në arsyetimin e Aktgjykimit, Gjykata Komunale në Gjakovë kishte konstatuar se, nga shkresat e lëndës, vërtetohet si i pakontestueshëm fakti që prona e paluajtshme, e cila është objekt kontesti, në dokumentacionin kadastral të Gjakovës evidencohet si pronë e të padituri Mušović. Gjykata, gjithashtu, kishte konstatuar se asnjëherë nuk ka pasur një kontratë formale, të përpiluar e të vërtetuar në gjykatë, sipas legjislacionit në fuqi, ndërmjet palëve që tash janë në kontest dhe se, sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Civ. 57/83, vërtetohet se i padituri, pra z. Mušović, ka qenë i obliguar që paditësit, z. Mon Nushi, t'ia kthejë shumën prej 1.950.000 dinarësh të asaj kohe.

16. Në po të njëjtin aktgjykim, Gjykata Komunale në Gjakovë ka potencuar faktin se paditësi asnjëherë nuk kishte hyrë në posedim të pronës që pretendon se e ka blerë.

17. Kundër këtij aktgjykimi, z. Mon Nushi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, avokatit Teki Bokshi, kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

18. Më 15 nëntor 2006, Gjykata e Qarkut në Pejë refuzoi ankesën e paditësit z. Mon Nushi, si ankesë e përfaqësuesit të tij, avokatit Teki Bokshi, duke vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjakovë, C. Nr. 3004/2000, e 19 shkurtit 2002.

19. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, Gjykata e Qarkut theksoi se, duke shqyrtuar ankesat e parashtruara të paditësit dhe të përfaqësuesit të tij, ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, "me nxjerrjen e provave të nevojshme, drejt dhe në mënyrë të plotë, ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe me vlerësimin e drejtë të provave, drejt ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia është e pabazuar dhe në arsyetim ka dhënë arsye të mjaftueshme juridike dhe faktike për faktet relevante të rëndësishme për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështje, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë".

20. Kundër këtij aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës, z. Mon Nushi, ka paraqitur revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

21. Më 21 mars 2011, Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë Aktgjykimin Rev. nr. 87/2008, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar revizionet e dy përfaqësuesve të autorizuar të z. Mon Nushi, si dhe të vetë paditësit, z. Nushi, të paraqitura kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 404/2003, të 15 nëntorit 2006.

22. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi thuhet që "Gjykata Supreme ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar".

Pretendimet e parashtruesit për shkeljet kushtetuese

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me aktgjykimin në fjalë, është shkelur neni 31 i Kushtetutës (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) dhe neni 6.1 i KEPDNJ-së, së bashku me protokollet e saj. Parashtruesi më tej thekson se, gjithashtu, janë shkelur edhe nenet: 7, 21, 22, 31, 46, 53 dhe 121 të Kushtetutës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore.

25. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

26. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, që përcakton:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *c) Kërkesa është qartazi e bazuar".*

27. Duke iu referuar kërkesës së parashtruesit dhe shkeljeve të pretenduara të të drejtave kushtetuese, Gjykata thekson:

28. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e faktit dhe, me këtë rast, dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, në rastin konkret i Gjykatës Supreme, duke refuzuar revizionin e paditësit dhe të përfaqësuesve të tij dhe duke lënë në fuqi Aktgjykimin Gjykatës së Qarkut në Pejë. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore dhe, prandaj, ajo nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt (*Shih, mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).*

29. Duke marrë në konsideratë atë që u tha më sipër, Gjykata, sipas rregullit të përgjithshëm, nuk do të kontestojë konstatimet dhe përfundimet që rrjedhin nga instancat e rregullta gjyqësore, si: zbatimin e të drejtës së brendshme, vlerësimin e provave në proces, drejtësinë e rezultatit të një mosmarrëveshje civile apo fajësinë ose jo të një të akuzuari në një çështje penale.

30. Në raste të jashtëzakonshme, Gjykata mund të vërë në dyshim këto konstatime dhe përfundime, nëse ato janë të njollosura nga një arbitraritet flagrant dhe evident, në kundërshtim me drejtësinë dhe me mirëgjykimin, dhe që shkaktojnë shkelje të Kushtetutës apo të KEDNJ-së (*Syssoyeva e të tjerë kundër Letonisë (çregjistrim) [DHM], § 89*), e

që, gjatë shqyrtimit të kërkesës së z. Nushi, Gjykata nuk ka gjetur elemente të arbitraritetit në vendimet e kontestuara.

31. Fakti se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (*Shih, mutatis mutandis, Aktgjykimi ECHR, Appl. No. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, aktgjykimi i 26 korrikut 2005, ose Tengerakis v. Qipro, nr. 35698/03, vendimi i 9 nëntorit 2006, § 74*).

32. Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 87/12, e 21 marsit 2011, nuk gjeti elemente të arbitraritetit dhe as shkelje të supozuar të të drejtave të njeriut, sikur kishte pretenduar parashtruesi i kërkesës.

33. Në këto rrethana, parashtruesi i ankesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij" dhe nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar, andaj Gjykata, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika c dhe pika d, gjen se kërkesën duhet të refuzohet si qartazi e pabazuar dhe, rrjedhimisht,

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36, paragrafi 2, pika c dhe pika d, të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 17 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 49/11, Ibrahim Sokoli, datë 14 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 362/2009, të 4 shkurtit 2011.

Rasti KI 49/11, Aktvendim për papranueshmëri i 15 janarit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar me vendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Parashtruesi ndër të tjera pretendonte punëdhënësi i tij padrejtësisht dhe pa bazë ligjore e kishte urdhëruar atë në pushim pa pagesë, kurse Gjykata Supreme kishte vendosur në dobi të punëdhënësit dhe në dëm të parashtruesit.

Gjykata konstatoi se parashtruesi nuk kishte mbështetur pretendimet e tij, dhe se Gjykata Supreme kishte arsyetuar mjaftueshëm vendimin e saj duke shtjelluar ndër të tjera dhe marrëdhëniet detyrimore ndërmjet parashtruesit dhe punëdhënësit të tij. Gjykata po ashtu ripërsëriti se çështjet e fakteve dhe të ligjit janë në kuadër të juridiksionit të gjykatave të rregullta dhe se Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë apeli apo gjykatë e shkallës së katërt. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI49/11
Parashtruesi
Ibrahim Sokoli
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 362/2009, të 4 shkurtit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Ibrahim Sokoli, me banim në Kaçanik.

Vendimet e kontestuara

2. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 362/2009, i 4 shkurtit 2011.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Kërkesa ka për objekt ndërrimin e vendit të punës së parashtruesit nga punëdhënësi i tij gojarisht, pa kurrfarë vendimi me shkrim, si dhe ofrimi

i vendit të ri të punës që nuk përputhet me përvojën dhe me kualifikimet profesionale të parashtruesit.

Procedura në Gjykatë

5. Më 14 prill 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 19 prill 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI-49/11, caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI-49/11, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 25 janar 2012, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Komunës së Kaçanikut, Gjykatës Komunale në Kaçanik dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.

8. Më 5 dhjetor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve siç janë dorëzuar nga parashtruesi

9. Parashtruesi ka qenë në marrëdhënie pune në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kaçanik (në tekstin e mëtejmë: QKMF), si teknik i dhëmbëve, që nga viti 1977.

10. Nga janari i vitit 2007, për shkak të sistematizimit të ri, QKMF në Kaçanik gojarisht, pa vendim me shkrim, njoftoi parashtruesin se do t'i ndërrohet vendi i punës. Parashtruesi u ankua në Këshillin drejtues të QKMF-së në Kaçanik.

11. Më 20 shkurt 2007, Këshilli drejtues i QKMF-së në Kaçanik, me Vendimin nr. 180, refuzoi kërkesën e parashtruesit dhe i ofroi atij që të zgjedhë njërin prej këtyre vendeve të punës: 1) asistent i stomatologut; 2) punëtor në sistemin operativ të informimit; dhe 3) vozitës.

12. Më 1 prill 2007, parashtruesit, pa vendim me shkrim, iu ndaluan të ardhurat si dhe në listat e punëtorëve, në rubrikën ku duhej të figuronte emri i tij, ishte shënuar me germa të mëdha PP, që nënkuptonte pushimin pa pagesë. Ndaj këtyre veprimeve, parashtruesi u ankua te Komisioni për ankesa në KK të Kaçanikut.

13. Komisioni për ankesa i KK të Kaçanikut nuk iu përgjigj parashtruesit brenda afateve të parapara ligjore. Parashtruesi paraqiti ankesë te Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK).

14. Më 18 shtator 2007, KPMK-ja, me Vendimin 2081/07/07, *inter alia* përcaktoi: 1) aprovimin e pjesshëm të ankesës së parashtruesit të kërkesës, 2) kthimin e lëndës në rishqyrtim te Komisioni i Ankesave i KK të Kaçanikut, dhe 3) obligimin për Kryeshefin Ekzekutiv në KK të Kaçanikut për autorizimin e Komisionit për ankesa për vendosje në lëndën e parashtruesit të kërkesës.

15. Më 9 nëntor 2007, Komisioni Komunal për Ankesa, me Vendimin nr. 566/07, miratoi kërkesën e parashtruesit dhe e sistematizoi atë në pozitën e re, si teknik i mirëmbajtjes së makinave stomatologjike, që i përgjigjej përgatitjes profesionale së parashtruesit, porse vendimi në fjalë nuk u ekzekutua nga organi kompetent i KK të Kaçanikut.

16. Më 8 shkurt 2008, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Kaçanik, që (Aktgjykimi C. nr. 32/08, i 30 majit 2008) *inter alia* përcaktoi: 1) miratimin në tërësi të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës, 2) detyrim për KK të Kaçanikut që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vend të punës sipas përgatitjes profesionale, dhe 3) detyrimin për KK të Kaçanikut që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë të ardhurat personale duke filluar nga data 1 prill 2007.

17. Komuna e Kaçanikut paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër aktgjykimit të lartpërmendur. Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi Ac. nr. 1014/2008, i 12 marsit 2009) refuzoi si të pabazë ankesën e KK të Kaçanikut dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Kaçanik.

18. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, Komuna e Kaçanikut parashtroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila (Aktgjykimi Rev. nr. 362/2009, i 4 shkurtit 2011) pranoi revizionin e KK të Kaçanikut dhe ndryshoi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, gjegjësisht të Gjykatës Komunale në Kaçanik.

19. Gjykata Supreme *inter alia* arsyetoi:

> *"... nga shkresat e lëndës del se paditësi (Parashtruesi) ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura që nga viti 1973, dhe nga janari i vitit 2007, për shkak të sistematizimit të ri gojarisht i është treguar se do t'i ndërrohet vendi i punës pa kurrfarë vendimi me*

shkrim...paditësit i është ofruar vendi i punës asistent i stomatologjisë në sistemin operativ të operimit ose vozitës, ashtu që Drejtori i QKMF-së ka marrë vendim dhe paditësit ia kanë ndërruar vendin e punës si teknik i dhëmbëve duke marrë parasysh mundësitë buxhetore të cilat kanë lidhje me mbulesën e të ardhurave personale".

"...nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike por gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit (Parashtruesit) është e bazuar. Kjo ngase ndërrimi i vendit të punës së paditësit është bërë sipas mundësive buxhetore lidhur me mbulesën e të ardhurave personale. Përveç kësaj nga provat që gjenden në shkresat e lëndës del se vendi i punës asistent i stomatologjisë ose punëtor në sistemin operativ të informimit të cilat vende i janë ofruar paditësit, niveli i pagës është i njëjtë me pagën e mëparshme në vendin e punës të paditësit në të cilin ka punuar dhe është në përputhje me dispozitën e nenit 11.1 të Urdhëresës Administrative nr. 2003/2 zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi shërbimin civil".
"... pos këtyre fakteve paditësi (Parashtruesi) ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të caktuar gjer më 31.12.2006, të cilit janë paguar të ardhurat personale gjer më 01.04.2007, me ofrimin e vendeve të punës, nuk ka pranuar të nënshkruajë edhe kontratën e re 3-vjeçare për vazhdimin e marrëdhënies së punës pas përfundimit të kontratës së parë me pagë të njëjtë dhe sipas aftësisë profesionale të tij".

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas revizionit të të paditurës (KK Kaçanik), ka ndryshuar vendimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe kësisoj ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

21. Parashtruesi pretendon se, në mënyrë arbitrare, pa kurrfarë vendimi me shkrim dhe pa mbështetje ligjore, atij i janë ndalur të ardhurat dhe në listat e punëtorëve, në rubrikën me emrin e parashtruesit, ishte shënuar me germa të mëdha PP, që nënkupton pushim pa pagesë.

22. Për më tepër, parashtruesi pretendon se vendet alternative të punës, që i janë ofruar nga organi punëdhënës, nuk i përgjigjen përgatitjes së tij profesionale.

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

23. Për të gjykuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

24. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

25. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, që përcakton:

> *(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *c) Kërkesa është qartazi e bazuar*

26. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

27. Gjykata vëren se parashtruesi kishte iniciuar procedurë administrative dhe se KPMK-ja kishte miratuar pjesërisht kërkesën e tij, ndërsa Komisioni për Ankesa i Komunës së Kaçanikut, po ashtu, kishte miratuar kërkesën e parashtruesit, porse vendimi i Komisionit për Ankesa nuk ishte zbatuar nga Komuna e Kaçanikut.

28. Gjykata vëren se parashtruesi kishte iniciuar procedurë kontestimore, duke paraqitur padi në Gjykatën Komunale të Kaçanikut, e cila dha vendim të favorshëm për parashtruesin. Vendimi i Gjykatës Komunale në Kaçanik u vërtetua nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, pas ankesës së palës së paditur, gjegjësisht KK të Kaçanikut.

29. Gjykata, po ashtu, vëren se Gjykata Supreme e Kosovës ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, me ç'rast konkludoi se gjykatat e instancës më të ulët kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale, sepse ndërrimi i vendit të punës së parashtruesit është bërë sipas mundësive buxhetore dhe se të njëjtit i janë ofruar vende të reja të

punës me nivel të njëjtë me pagën e mëparshme, mirëpo parashtruesi nuk kishte pranuar të nënshkruante kontratën e re.

30. Në rastin konkret, nga dokumentet e dorëzuara, Gjykata konkludon se Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar lëndën si nga aspekti i çështjes së fakteve, ashtu edhe nga aspekti i të drejtës materiale. Po ashtu, Gjykata Supreme e Kosovës ka shtjelluar raportin ndërmjet punëdhënësit dhe punonjësit, si dhe ka dhënë interpretimin e saj të dispozitave ligjore që rregullojnë raportin ndërmjet punëdhënësit dhe punonjësit.

31. Përkitazi me këtë, parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij, duke shpjeguar se si dhe pse është kryer ndonjë shkelje, ose duke ofruar dëshmi për të vërtetuar se i është shkelur ndonjë e drejtë e garantuar me Kushtetutë.

32. Gjykata, në mënyrë të ngjashme, ka vendosur në Rastin KI127/11, parashtrues i kërkesës Ardian Hasani, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 219/2009, të 10 qershorit 2011, të dhënë nga Gjykata më 24 maj 2012.

33. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve. Gjykata Kushtetuese edhe me këtë rast thekson se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i saj është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" *(Shih, mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).*

34. Për më tepër, kërkesa nuk tregon se Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo në mënyrë të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me ato të gjykatave të rregullta. Si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë dëshmitë para vetes. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato dëshmi, *(Shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, App. Nr 13071/87,* Edwards *kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 3, të 10 korrikut 1991).*

35. Fakti se parashtruesi nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk mund t'i shërbejë atij si e drejtë për të ngritur një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të

Kushtetutës *(Shih, mutatis mutandis, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, Appl. nr. 5503/02, MezoturTiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).*

36. Në këto rrethana, parashtruesi nuk ka mbështetur me prova pretendimet e tij dhe as shkeljen e nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk tregojnë se Gjykata Supreme ia ka mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

37. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hedhet poshtë si e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, si dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 5 dhjetor 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 113/12, Haki Gjocaj, datë 18 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, P. nr. 791/2012, të 5 tetorit 2012, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 175/12, të 6 nëntorit 2012

Rasti KI 113/12, Aktvendim për papranueshmëri i 25 janarit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë e parakohshme, masa të përkohshme, mos shterje e mjeteve juridike, prokurori publik, trajtim i detyrueshëm psikiatrik, e drejta e lirisë dhe sigurisë, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtja shëndetësore dhe sociale, kufizimi i lirive dhe të drejtave themelore

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar me vendimet e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Parashtruesi ndër të tjera pretendonte se për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, ai duhej të lirohej nga paraburgimi dhe të zhvendosej nga pavijoni psikiatrik i institucionit korrektues tek institucioni shëndetësorë civil. Gjykata Supreme kishte përcaktuar se parashtruesi duhej të mbetej në paraburgim derisa çështja të zgjidhej nga gjykata e instancës më të ulët.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e parakohshme sepse Gjykata Supreme kishte urdhëruar që rasti i parashtruesit të gjykohej sërish nga gjykatat e instancës më të ulët. Gjykata, më tej, shtjelloi parimin e subsidiaritetit dhe të shterjes së mjeteve juridike dhe njëkohësisht refuzoi kërkesën e parashtruesit për masë të përkohshme. Gjykata po ashtu ripërsëriti se çështjet e fakteve dhe të ligjit janë në kuadër të juridiksionit të gjykatave të rregullta dhe se ato janë të pavarura në interpretimin e atyre çështjeve. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI113/12
Parashtrues
Haki Gjocaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, P. nr. 791/2012, të 5 tetorit 2012, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 175/12, të 6 nëntorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Haki Gjocaj, i përfaqësuar nga Hilmi Zhitija, avokat nga Prishtina.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës Supreme, P. nr. 791/2012, të 5 tetorit 2012, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 175/12, të 6 nëntorit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa e parashtruesit për t'u liruar nga pavijoni psikiatrik i institucionit korrektues dhe për t'u vendosur në një institucion civil shëndetësor.

4. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu, propozon vendosjen e masës së përkohshme për lirimin e tij nga pavijoni psikiatrik i institucionit korrektues dhe vendosjen e tij në një institucion civil shëndetësor, ku ai mund të shërohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shëndetësinë, siç përcaktohet me nenin 9.4 të Rregullores së UNMIK-ut 34/2004.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenin 20 dhe në nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 8 nëntor 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 5 dhjetor 2012, parashtruesi i bashkëngjiti kërkesës dokumente shtesë.

8. Më 6 dhjetor 2012, Kryetari e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese, si dhe caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

9. Më 28 dhjetor 2012, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 18 dhe 25 janar 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve, siç provohen me dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës

11. Më 16 shkurt 2011, Prokurori Publik në Pejë paraqiti Aktakuzën PP. nr. 283/10 ndaj parashtruesit të kërkesës në Gjykatën e Qarkut në Pejë, me ç'rast propozoi shqiptimin e trajtimit të obligueshëm psikiatrik në një institucion shëndetësor, në bazë të dyshimit për kryerjen e veprës penale – vrasje, nga neni 147, pika 4, në lidhje me nenin 24, dhe për mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK)

12. Më 21 nëntor 2011, Prokurori, para fillimit të gjykimit, ndryshoi aktakuzën ndaj parashtruesit të kërkesës, duke e akuzuar atë për veprën penale – vrasje, nga neni 147, pika 4, në lidhje me nenin 24, dhe për mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas KPPK-së, me ç'rast propozoi që parashtruesi i kërkesës të shpallet fajtor dhe të dënohet në pajtim me

ligjin. Pretendohet se ndryshimi i aktakuzës u bë pas kryerjes së ekspertizës psikiatrike në Spitalin rajonal në Pejë, më 14 tetor 2011.

13. Më 9 korrik 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë nxori Vendimin P. nr. 137/11, duke pushuar procedurën penale.

14. Gjykata e Qarkut në Pejë vendosi:

"Se i akuzuari Haki Gjocaj nuk ka aftësi për t'iu nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në lëndën penale nr. 137/11".

"Konform nenit 9, paragrafi 1 të Rregullores 34/2004, të datës 24.08.2004, mbi procedurën penale, ku përfshihen kryes me çrregullime mendore, për shkak të paaftësisë së të akuzuarit për t'iu nënshtruar gjykimit, si dhe për shkak të sëmundjes së tij të përhershme, PUSHOHET PROCEDURA PENALE ndaj të akuzuarit Haki Gjocaj".

"Procedura ndaj të njëjtit rifillon me kërkesën e paditësit të autorizuar, për sa të pushojnë së ekzistuari arsyet për marrjen e aktvendimit të tij".

15. Gjykata e Qarkut në Pejë, në Aktvendimin e saj P. nr. 137/11, më tutje, arsyeton:

"Prokurori Publik i Qarkut në Pejë, në këtë gjykatë, ka ngritur aktakuzën PP. nr. 283/10 të datës 16.02.2011, kundër të akuzuarve F. D., për shkak të veprës penale: Shtytje në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 147, pika 4 e lidhur me nenin 24 të KPK-së, F. D. dhe F. Gj., për shkak se si bashkë-kryes kanë kryer vepër penale: Vrasje në tentative nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së, dhe kundër të akuzuarit Haki Gjocaj për shkak të veprave penale: Vrasje e rëndë nga neni 147 pika 4 të KPK-së dhe vepër penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve nga neni 328, par 2 të KPK-së".

"Me urdhër të kësaj gjykate PPQ nr. 86/10, të datës 11.10.2011, në mbështetje të nenit 6, paragrafi 1, pika a dhe b, të Rregullores së UNMIK-ut 2004/34, të datës 24.08.2004, e që ka të bëjë me procedurën penale ku përfshihen kryes me çrregullime mendore, është urdhëruar që në QKUK, në Klinikën e Psikiatrisë, Reparti i Forenzikës, të bëhet ekzaminimi dhe observimi psikiatrik klinik i të akuzuarit Haki Gjocaj".

16. Pas propozimit të Prokurorit të Qarkut në Pejë, më 28 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Vendimin P. nr. 297/12, ia vazhdoi paraburgimin parashtruesit të kërkesës në pavijonin psikiatrik të institucionit korrektues.

17. Gjykata e Qarkut në Pejë, në aktvendimin e saj P. nr. 297/12, arsyeton më tutje:

"Gjykata e Qarkut në Pejë, me aktvendimin P. nr. 297/2012 datës 28.09.2012, të akuzuarit Haki Gjocaj, për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 147 pika 4 të të KPK si dhe veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK, konform nenit 286 par. 3 lidhur me nenin 7 par. 7.1 pika a, b, c, par. 7.2, 7.3, 7.4, 7.5 dhe 7.6 të Rregullores nr. 34/2004 të datës 24.08.2004 Mbi procedurën penale ku përfshihen kryes me çrregullime mendore, i është vazhduar paraburgimi të akuzuarit Haki Gjocaj edhe për 2 (dy) muaj, ashtu që sipas këtij aktvendimi paraburgimi do të zgjasë deri me datën 28.11.2012 e me qenë se i akuzuari aktualisht ndodhet në gjendje me çrregullime mendore, është urdhëruar që paraburgimi të mbahet në Institucionin e Kujdesit Shëndetësor".

Ligji

Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 34/2004 (Vendimi i Gjykatës së Qarkut P. nr. 297/12, të datës 28 shtator 2012)

"Neni 7
Paraburgimi i personave me çrregullime mendore

7.1 Përveç rasteve sipas nenit 281 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, ku paraburgimi mund të urdhërohet, gjykata mund të urdhërojë paraburgimin e një personi, nëse:

(a) Ekziston dyshimi i bazuar që ai person ka kryer vepër penale;

(b) Sipas një kontrolli psikiatrik të urdhëruar sipas nenit 6.1, personi ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore apo kapacitetit të zvogëluar mendor në kohën e kryerjes së veprës penale; si dhe

(c) Personi aktualisht ka çrregullim mendor dhe si rezultat i kësaj, ka baza për të dyshuar që ai/ajo mund të rrezikojë jetën apo shëndetin e një personi tjetër.

7.2 Paraburgimi në bazë të paragrafit 1 të këtij neni mund të urdhërohet vetëm nëse prokurori publik ka parashtruar kërkesë, sipas nenit 10 të kësaj Rregulloreje. Ky paraburgim do të mbahet në një institucion shëndetësor, si dhe mund të zgjasë për aq gjatë derisa i pandehuri është i rrezikshëm, por nuk mund të kalojë periudhat e përshkruara kohore për paraburgim të përcaktuara me nenin 284 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale.

7.3 Nëse i pandehuri është tanimë në paraburgim, si dhe më vonë përcaktohet të ketë qenë në gjendje të paaftësisë mendore në kohën e kryerjes së veprës penale, gjykata urdhëron paraburgimin e të pandehurit në një institucion shëndetësor, nëse ai apo ajo aktualisht ka çrregullime mendore.

7.4 Gjykata nxjerr vendimin në bazë të paragrafit 1 ose 3 të këtij neni vetëm pas dëgjimit të prokurorit publik, avokatit mbrojtës dhe të pandehurit, nëse gjendja e tij apo e saj e mundëson këtë, si dhe pas marrjes së mendimit të një eksperti. Vendimi i tillë i lëshohet prokurorit publik, të pandehurit dhe avokatit të tij/saj mbrojtës, institucionit shëndetësor dhe institucionit korrektues. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrit.

7.5 Institucioni shëndetësor vendos mbi masat për sigurimin e rendit publik dhe sigurisë e mbrojtjes së të pandehurit pas konsultimit me autoritetin kompetent të mbajtjes, duke marrë parasysh nevojat e sigurisë dhe ato terapeutike.

7.6 Dispozitat e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale për paraburgim zbatohen mutatis mutandis për paraburgimin e vuajtur në institucion shëndetësor.
Dispozitat e përmendura të Rregullores së UNMIK-ut 34/2004 (Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 137/11, të datës 9 korrik 2012), Neni 9 Ndërprerja apo pezullimi i procedurës për shkak të vendimit për paaftësi të paraqitjes në gjykim.

9.1 Nëse gjykata vendos që i pandehuri është i paaftë të paraqitet në gjykim gjatë procedurës, për shkak të çrregullimit të përhershëm mendor, gjykata nxjerr vendimin për ndërprerje të procedurës.

9.4 Nëse gjykata vendos që i pandehuri është i paaftë të paraqitet në gjykim, sipas këtij neni, ajo mund të kërkojë inicimin e procedurës për vendosjen e tij apo saj në një institucion

shëndetësor, në bazë të Ligjit të zbatueshëm për Procedurën Jokontestimore.

Në këtë rast, gjykata mund të vendosë që i pandehuri të mbahet në një institucion shëndetësor për një periudhë maksimale prej 72 orësh, deri në inicimin e procedurës për mbajtje në institucion shëndetësor sipas Ligjit të zbatueshëm për Procedurën Jokontestimore, nëse si rezultat i çrregullimit mendor të personit, ka baza për të besuar që ai apo ajo do të rrezikojë jetën apo shëndetin e një personi tjetër".

18. Parashtruesi u ankua ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut, si dhe, më 5 tetor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Vendimin P. nr. 791/2012, duke vendosur që:

"Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit Haki Gjocaj, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut Pejë, P. nr. 297/2012, datë 28.09.2012".

19. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, si dhe, më 6 nëntor 2012, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin e saj Pkl. nr. 175/12, miratoi pjesërisht kërkesën e parashtruesit, duke vendosur si në vijim:

"Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, të mbrojtjes së të pandehurit Haki Gjocaj, anulohet vendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë P. nr. 297/2012, i datës 28.09.2012, si dhe vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, Pn. nr. 791/2012, ndërsa çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rishqyrtim".

"I pandehuri mbetet në paraburgim deri në marrjen e vendimit të ri".

20. Gjykata Supreme më tej arsyetoi:

"Prokurori publik ka paraqitur këtë propozim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, edhe pse eksperti kishte deklaruar se i pandehuri Haki Gjocaj në kohën e kryerjes së veprës penale ishte i llogaritshëm por me aftësi të zvogëluar mendore. Pas vërejtjeve të Gjykatës Supreme se ndaj personit të përgjegjshëm nuk mund të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, prokurori publik ndërron aktin akuzues nga propozimi në aktakuzë dhe ndaj të pandehurit Haki Gjocaj vijon procedurën sipas dispozitave të KPPK, deri në momentin kur

mjeku psikiatër është deklaruar se i pandehuri nuk është në gjendje të përcjell gjykimin. Më pastaj, trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut në Pejë me datën 09.07.2012. ka marrë aktvendim me numër P. nr. 137/2011 me të cilin ka vendosur që të pushohet procedura ndaj të pandehurit Haki Gjocaj, konform nenit 7. të Rregullores nr. 2004/34 mbi procedurën penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore, e cila do të rifilloje posa pushojnë së ekzistuari arsyet për marrjen e vendimit të këtillë".

"... për të dalë nga kjo situatë gjykata e shkallës së parë duhet të urdhërojë një observim psikiatrik ndaj të pandehurit me qëllim të konstatimit të përgjegjësisë ose jo përgjegjësisë së tij në kohën e kryerjes së veprës penale dhe gjendjen e tanishme të tij për t'u qartësuar së cila procedurë duhet të aplikohet - procedura e rregullt apo procedurë e posaçme sipas Rregullores së 2004/34. Duhet theksuar se për tani i pandehuri po trajtohet si person me paaftësi mendore pa një mendim të ekspertit kompetent nga se konstatimi se i pandehuri nuk është në gjendje ta përcjell gjykimin nuk e ka zgjidhe çështjen se ai ishte i përgjegjshëm në kohën e kryerjes së veprës penale dhe nuk është përgjigje së kjo paaftësi është e përkohshme apo e përhershme".

21. Raportet mjekësore përmenden vetëm në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të rregullta. Parashtruesi i kërkesës nuk i ka bashkëngjitur ato në kërkesë. Përmenden disa raporte mjekësore kundërthënëse për gjendjen mjekësore të parashtruesit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ka shkelje të nenit 29 [E drejta e Lirisë dhe e Sigurisë]; të nenit 31, paragrafi 1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; të nenit 51, paragrafi 2 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale]; dhe të nenit 55 [Kufizimi i Lirive dhe të Drejtave Themelore], të Kushtetutës.

23. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu, konsideron se ka shkelje të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe të Protokolleve të saj.

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se shkeljet e sipërpërmendura kanë ndodhur për shkak se ekziston një vendim gjyqësor i formës së prerë për pushimin e procedurës penale për shkak të sëmundjes së përhershme

mendore dhe, prapëseprapë, ai gjendet në pavijonin psikiatrik të institucionit korrektues.

25. Parashtruesi i kërkesës pohon se, në bazë të nenit 4, paragrafi 1, të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, në rastet kur pushohet procedura penale me vendim gjyqësor të formës së prerë, nuk mund të ketë ndjekje penale. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu, pohon se janë shkelur edhe disa nene të tjera të KPPK-së nga ana e gjykatave të rregullta.

26. Parashtruesi i kërkesës mëton se gjykatat e rregullta është dashur të zbatonin nenin 9.4 të Rregullores 34/2004, që parashikon se gjykata inicion procedurën për të dërguar një person me çrregullime mendore në institucion shëndetësor në bazë të dispozitave të procedurës jokontestimore, në mënyrë që ai të trajtohet në pajtim me Ligjin për Shëndetësi. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu, pretendon se gjendet në pavijonin psikiatrik të institucionit korrektues që nga 23 gushti 2010 dhe se shëndeti i tij mendor vetëm se do të përkeqësohet përderisa është atje.

27. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës i kërkon Gjykatës që të konstatoj shkeljet e lartpërmendura të dispozitave të Kushtetutës, si dhe të anulojë vendimin e shkallës së parë, P. nr. 297/12, të 28 shtatorit 2012, të anulojë vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pn. nr. 791, të 5 tetorit 2012, si dhe të lirohet nga paraburgimi, ashtu që Gjykata të iniciojë procedurë jokontestimore për ta vendosur në institucion shëndetësor, ashtu siç përcaktohet me nenin 9.4 të Rregullores së UNMIK-ut 34/2004.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë

28. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Pkl. nr. 175/12, i 6 nëntorit 2012), pas kërkesës së

parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, urdhëroi që gjykatat e shkallëve më të ulëta të veprojnë në pajtim me udhëzimet e Gjykatës Supreme, si dhe të përcaktojnë se cila nga KPPK-ja apo Rregullorja e UNMIK-ut 34/2004 janë të zbatueshme në rastin e parashtruesit të kërkesës.

31. Gjykata vëren se Gjykata Supreme e Kosovës ka shqyrtuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë dhe ka konstatuar se ka ekzistuar një situatë e paqartësisë ligjore dhe e ktheu rastin në gjykatat më të ulëta për rivendosje, me ç'rast, po ashtu, vendosi që parashtruesi i kërkesës të mbetej në pavijonin psikiatrik të institucionit korrektues deri sa të nxirrej një vendim për këtë çështje.

32. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, sepse Gjykata Supreme ka kthyer rastin për rivendosje, që do të thotë se rasti i parashtruesit të kërkesës është ende në shqyrtim e sipër në procedurë të rregullt gjyqësore.

33. Përveç kësaj, Gjykata rithekson se Gjykata Supreme e Kosovës, si dhe gjykatat e tjera të rregullta, janë të pavarura në ushtrimin e pushtetit të tyre gjyqësor dhe se është obligim dhe prerogativë e tyre kushtetuese që të interpretojnë çështjet e faktit dhe të ligjit përkitazi me rastet e ngritura para tyre.

34. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që autoriteteve kompetente, duke përfshirë gjykatat, t'u ofrohet mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (*Shih, Aktvendimi për papranueshmëri: AAB-RIINVEST L.L.C. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI41/09, i 21 janarit 2010, dhe shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25 803/94, vendim i 28 korrikut 1999*).

35. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi *prima facie* dhe as që ka mbështetur me prova kërkesën për vendosjen e masës së përkohshme në pajtim me nenin 27 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar se *si* dhe *përse* vendosja e masës së përkohshme do të parandalonte një situatë të dëmit të pariparueshëm dhe në asnjë mënyrë nuk ka treguar se një gjë e tillë është në interesin publik.

36. Duke marrë parasysh të gjitha që u thanë më lart, Gjykata hedh poshtë kërkesën e parashtruesit për vendosje të masës së përkohshme.

37. Rrjedhimisht kërkesa nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenet 27 e 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 20 dhe me nenin 27 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, më 25 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme;

III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 124/11, Ljubiša Živić, datë 18 mars 2013- Vlerësim i procedurave ankimore në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, K66/09, e 25 majit 2010 (stërzgjatje e procedurës).

Rasti KI124/11, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntor 2012.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pa bazuar

Objekt i çështjes së kërkesës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese, nga parashtruesi, është pretendimi për zgjatje të paarsyeshme të procedurave ankimore penale kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, K66/2009, të 25 majit 2010. Ajo procedurë penale ishte iniciuar ndaj të akuzuarit D. D. Parashtruesi është palë e interesuar në procedurë.

Parashtruesi konsideron se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 dhe me nenin 4 [Barazia para Ligjit]; me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]; si dhe me nenin 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme], të Kushtetutës.

Gjykata vëren se, në këtë rast, parashtruesi i kërkesës nuk provon "statusin e viktimës të shkaktuar nga autoriteti publik", siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 34 Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut .

Gjykata rikujton se viktimë konsiderohet personi fizik ose juridik. Personi që nuk është prekur në këtë mënyrë, nuk e ka statusin e viktimës, pasi që Kushtetuta nuk parasheh *actio popularis*.

Rrjedhimisht, në pajtim me rregullin 36. 2. c të Rregullores së punës, Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI124/11
Parashtruesi
Ljubiša Živić
Kërkesë për vlerësimin e procedurave ankimore në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, K66/09, e 25 majit 2010 (stërzgjatje e procedurës)

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Ljubiša Živić, me vendbanim në Graçanicë.

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së kërkesës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese, nga parashtruesi, është pretendimi për zgjatje të paarsyeshme të procedurave ankimore penale kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, K66/2009, të 25 majit 2010. Ajo procedurë penale ishte iniciuar ndaj të akuzuarit D.D. Parashtruesi është palë e interesuar në procedurë.

3. Parashtruesi konsideron se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 dhe me nenin 4 [Barazia para Ligjit]; me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]; si dhe me nenin 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme], të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 19 shtator 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

6. Më 7 shkurt 2012, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj.

7. Më 18 janar 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin, Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë dhe Gjykatën Komunale në Vushtrri, për kërkesën.

8. Më 12 nëntor 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu për të zëvendësuar gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj.

9. Më 21 nëntor 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

10. Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon: "Edhe pse kanë kaluar 16 muaj, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë nuk ka caktuar seancë për rastin me numër K66/09, me ç'rast ka shkelur të drejtat tona kushtetuese dhe të drejtën për gjykim të drejtë".

11. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që "të caktojë procedurën në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë dhe të sigurojë marrjen e vendimit final për rastin".

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi nuk ka specifikuar ndonjë fakt të rastit, përveç pretendimeve të theksuara më lart.

13. Nga dokumentet e dorëzuara në mbështetje të kërkesës, mund të vërehen faktet që janë në vijim.

14. Më 25 maj 2010, Gjykata Komunale në Vushtrri nxori Aktgjykimin K66/09, në procedurën penale kundër të akuzuarit D. D., i cili u shpall fajtor për veprën penale prezantim i rremë, nga neni 325 i Kodit Penal të

Kosovës (KPK); për veprën penale rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nga neni 333.4 i KPK-së; dhe për veprën penale mashtrim në votime nga neni 180 i KPK-së.

15. Nga aktgjykimi vërehet se i akuzuari D. D. ishte dënuar me 12 (dymbëdhjetë) muaj burgim dhe ishte gjobitur me 1.300 (një mijë e treqind) euro.

16. Gjithashtu, vërehet nga Aktgjykimi K66/99 i Gjykatës Komunale në Vushtrri, se parashtruesi ishte përmendur si palë e dëmtuar në procedurën penale.

17. Në një datë të pacaktuar, avokati mbrojtës i të akuzuarit D. D. ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, duke pretenduar shkeljen e të drejtës penale materiale dhe procedurale.

18. Nga dokumentacioni i dorëzuar nga parashtruesi, më tej, vërehet se ai nuk ka dorëzuar ndonjë parashtresë me shkrim apo gojarisht për procedurën penale kundër të akuzuarit D. D.

Ligji i zbatueshëm

19. Neni 151 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK, Ligji Nr. 2003/26), në Kapitullin XVIII përshkruan kuptimin e shprehjes juridike të termit "pala e dëmtuar" si vijon: *"Sipas këtij Kodi: 'I dëmtuar' është personi të cilit çfarëdo e drejte personale ose pasurore i është shkelur".*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

22. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, që përcakton:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) kërkesa është qartazi e pabazuar".

23. Ashtu siç është përmendur më herët, argumenti kryesor i parashtruesit është se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë, sepse kanë kaluar 16 muaj dhe Gjykata e Qarkut në Mitrovicë nuk ka caktuar seancë për rastin penal me numër K66/09 ndaj D. D.-së.

24. Gjykata vëren se, në këtë rast, parashtruesi i kërkesës nuk provon "statusin e viktimës të shkaktuar nga autoriteti publik", siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 34 Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (*Shih, mutatis mutandis, Lindsay kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 31699/96, Vendimi i Komisionit i 17 janarit 1997, 23 E. H. R. R.; Agrotexim dhe të tjerët kundër Greqisë, Aktgjykimi i 24 tetorit 1995, Seria A, nr. 330-A, pp. 22-26, §§ 59-72; dhe Aktvendim për papranueshmëri në Rastin Nr. KO43/10, parashtrues të kërkesës LDK-AAK-LDD, Vlerësim i kushtetutshmërisë së akteve juridike të nxjerra nga Kryetari i Prizrenit, i 25 tetorit 2011*).

25. Gjykata rikujton se viktimë konsiderohet personi fizik ose juridik (*Shih rastin Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti Nr. KI41/09*), të cilit personalisht ose drejtpërdrejt i preken të drejtat e njeriut nga masat apo nga aktet e autoriteteve publike. Personi që nuk është prekur në këtë mënyrë, nuk e ka statusin e viktimës, pasi që Kushtetuta nuk parasheh *actio popularis*.

26. Rrjedhimisht, në pajtim me rregullin 36.2.c të Rregullores së punës, Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar "*nëse bindet se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë*".

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe në mbështetje të rregullit 36.2.c të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme,

II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Prof. dr. Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 24/11, Ali Buzhala, datë 18 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 593/2010, të 20 janarit 2011.

Rasti KI24/11, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 korrik 2012.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, mos shterje e mjeteve juridike

Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 593/2010, të 20 janarit 2011, me të cilin iu refuzua, si e pabazuar, ankesa në çështjen juridike përmbarimore përkitazi me përmbarimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (KPM).

Parashtruesi i kërkesës pohon se është shkelur neni 49, pika 1 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] i Kushtetutës; dhe neni 6, në lidhje me nenin 13, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata gjen se kërkesa nuk i plotëson kushtet nga neni 113.7 i Kushtetutës; nga neni 47.2 i Ligjit; dhe nga rregulli 36. 1. a i Rregullores së punës; dhe, si e tillë, është e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI24/11
Parashtrues
Ali Buzhala
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut
në Prizren,
Ac. nr. 593/2010, të 20 janarit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar

Kërkesa

1. Kërkesën e ka parashtruar Ali Buzhala, nga fshati Budakovë, komuna e Suharekës (parashtruesi i kërkesës). Në procedurë, në Gjykatë, parashtruesin e kërkesës e përfaqëson Gafurr Elshani, avokat nga Prishtina.

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 593/2010, të 20 janarit 2011, me të cilin iu refuzua, si e pabazuar, ankesa në çështjen juridike përmbarimore përkitazi me përmbarimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (KPM).

3. Parashtruesi i kërkesës pohon se është shkelur neni 49, pika 1 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm] i Kushtetutës; dhe neni 6, në lidhje me nenin 13, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-121), të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 56.2 të

Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 24 shkurt 2011, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 2 mars 2011, Kryetari e emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues, si dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj.

7. Më 24 gusht 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren u përgjigj duke dorëzuar në Gjykatë disa dokumente, që të gjitha këto dokumente tashmë ishin të bashkëngjitura në kërkesë.

8. Më 9 nëntor 2011, Gjykata e njoftoi KPM-në për kërkesën.

9. Më 23 nëntor 2011, KPM-ja iu përgjigj Gjykatës duke theksuar faktet procedurale dhe historikun e rastit, si dhe ia dorëzoi Gjykatës disa dokumente, të cilat po ashtu tashmë i ishin bashkëngjitur kërkesës.

10. Më 9 dhjetor 2011, Gjykata kërkoi informata shtesë nga përfaqësuesi i parashtruesit, përkitazi me "padinë e parashtruar në Gjykatën Supreme të Kosovës, nr. 193/7, të 8 qershorit 2010". Më 1 shkurt 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesi "që të dorëzonte në Gjykatën Kushtetuese një kopje të kërkesës, si dhe çdo dokumentacion tjetër gjyqësor që ndërlidhet me procedurën në Gjykatën Supreme".

11. Më 11 maj 2012, Gjykata kërkoi informata nga Gjykata Supreme, përkitazi me statusin e procedurës në Gjykatën Supreme të rastit Nr. 193/07.

12. Më 30 maj 2012, Gjykata Supreme informoi se "sipas regjistrave të kësaj Gjykate, nuk figuron se z. Buzhala ka lëndë në këtë Gjykatë me Nr. 139/07".

13. Më 4 korrik 2012, KPM-ja u përgjigj për herën e dytë dhe i ofroi Gjykatës dokumente që i kishte bashkëngjitur edhe në përgjigjen e parë.

14. Më 4 korrik 2012, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia Pyjore e Kosovës, i dërgoi Gjykatës Kushtetuese tërë dosjen e lëndës përkitazi me kontestin e z. Ali Buzhalës.

15. Më 15 korrik 2012, Kryetari e emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova anëtare të Kolegjit shqyrtues, në zëvendësim të gjyqtares Gjyljeta Mushkolaj.

16. Më 12 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandim për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Kontrata e punësimit

17. Më 19 nëntor 2008, parashtruesi i kërkesës filloi marrëdhënien e punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (në tekstin e mëtejmë: MBPZHR), si drejtor i Drejtorisë Koordinuese në Prizren. Kontrata e punësimit ishte e vlefshme për një vit, pra deri më 19 nëntor 2009.

18. Më 11 qershor 2009, MBPZHR (Vendimi KE-344/09), për shkak të "shkeljeve të rënda të detyrave dhe dispozitave ligjore", e suspendoi parashtruesin e kërkesës "me pagesë (...) deri sa të merrej një vendim tjetër nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural".

19. Më 18 qershor 2009, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij vendimi (KE-344/09, të 11 qershorit 2009) te Kryeshefi Ekzekutiv i MBPZHR-së, për shkak "të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes dhe të fakteve, si dhe për shkak të shkeljes së dispozitave materiale", duke propozuar "anulimin e vendimit të kundërshtuar".

20. Më 21 gusht 2009, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë (Nr. 02/178/2009) në KPM, duke kundërshtuar vendimin për suspendim dhe duke pohuar se vendimi ishte arbitrar, drastik dhe i nxjerrë në kundërshtim me ligjin.

Vendimet në procedurën administrative

21. Më 8 shtator 2009, KPM nxori Vendim (A 02/178/2009) me të cilin e obligoi MBPZHR-në që të fillonte procedurën disiplinore ndaj parashtruesit të kërkesës, ashtu siç theksohet në Vendimin për suspendim KE-344/09, e 11 qershorit 2009.

22. Më 13 tetor 2009, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë të re (Nr. 02/216/09) në KPM kundër Vendimit (nr. ref. KE-344/09, të 11 qershorit 2009) për suspendim nga puna.

23. Më 4 dhjetor 2009, KPM-ja e miratoi ankesën e parashtruesit (Vendimi A. 02/216/2009), me ç'rast "e anuloi Vendimin e Organit të Punësimit nr. KE-344/09, e 11 qershorit 2009" dhe "e obligoi Organin e Punësimit që t'ia mundësojë ankuesit kthimin në punë dhe realizimin e të gjitha të drejtave nga marrëdhënia e punës, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit".

24. Ndërkohë, më 30 nëntor 2009, Komisioni Disiplinor i MBPZHR-së nxori Vendim (Nr. 1541/09) me të cilin e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe ia shqiptoi masën disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës.

25. Më 22 dhjetor 2009, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Komisionin e Ankesave të MBPZHR-së kundër vendimit të Komisionit disiplinor.

26. Më 28 prill 2010 dhe, sërish, më 4 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës u ankua sërish në KPM, pasi që MBPZHR-ja nuk e kishte përmbaruar vendimin e KPM-së për kthimin e tij në vendin e punës.

27. Më 30 prill 2010, KPM-ja e njoftoi parashtruesin e kërkesës se e kishte informuar Kuvendin e Republikës së Kosovës se vendimi i KPM-së nuk po përmbarohej dhe e udhëzoi parashtruesin që të shfrytëzonte procedurat gjyqësore për përmbarimin e vendimit të saj.

Procedura në Gjykatën Komunale në Prizren

28. Më 6 maj 2010, parashtruesi paraqiti kërkesë në Gjykatën Komunale në Prizren për përmbarimin e vendimit të KPM-së.

29. Më 21 maj 2010, Gjykata Komunale në Prizren mori vendim për lejimin e përmbarimit të kërkuar.

30. Më 16 korrik 2010, MBPZHR-ja parashtroi kundërshtim "ndaj aktvendimit E. nr. 942/10 të Gjykatës Komunale në Prizren, të 21 majit 2010".

31. Më 27 korrik 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi përgjigje në kundërshtimin e MBPZHR-së, duke propozuar që "Gjykata të hedhë

poshtë kundërshtimin e debitorit si të pabazuar dhe të lë në fuqi vendimin përmbarimor".

32. Më 2 shtator 2010, Gjykata Komunale në Prizren (E. nr. 942/2010) nxori vendim me të cilin "e miratoi si të bazuar kundërshtimin e debitorit Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencisë Pyjore të Kosovës, Drejtorisë Koordinuese në Prizren, të parashtruar kundër aktvendimit të gjykatës për lejimin e përmbarimit të Aktvendimit E. nr. 942/10, të 21 majit 2010" dhe "pezulloi procedurën lidhur me këtë çështje juridike dhe aktvendimin e Gjykatës për lejimin e përmbarimit të Aktvendimit E. nr. 942/10, të 21 majit 2010, si dhe të gjitha veprimet e tjera procedurale të ndërmarra deri më tani në këtë çështje juridike".

Procedura në Gjykatën e Qarkut në Prizren

33. Më 18 tetor 2010, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër vendimit të Gjykatës Komunale, "për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale".

34. Më 20 janar 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren nxori vendim me të cilin "e hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e ushtruar nga ankuesi, Ali Buzhala (...) dhe e vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, E. nr. 492/2010, e 2 shtatorit 2010".

35. Më 4 shkurt 2011, parashtruesi i kërkesës i paraqiti kërkesë Prokurorit Publik të Kosovës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimit përmbarimor të Gjykatës Komunale në Prizren, E. nr. 942/10, të 2 shtatorit 2010, dhe aktvendimit përmbarimor të shkallës së dytë, të nxjerrë nga Gjykata e Qarkut në Prizren, Ac. nr. 593/2010, të 20 janarit 2011.

36. Më 9 shkurt 2001, Zyra e Prokurorit "vërtetoi se nuk gjeti bazë ligjore për të ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë (...)".

Rasti në procedurë e sipër në Gjykatën Supreme

37. Më 15 dhjetor 2011, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e informoi Gjykatën se "Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka vendosur ende në lëndën nr. 193/07".

38. Më 14 shkurt 2012, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës u përgjigj se "lënda në Gjykatën Supreme, me numër të lartcekur, ka të bëjë me çështje dhe vendime që janë ngritur pas titullit përmbarues".

39. Më 7 korrik 2012, Agjencia Pyjore e Kosovës i dorëzoi Gjykatës një kopje të përgjigjes përkitazi me lëndën nr. 193/7, të 8 qershorit 2010, ku parashtruesi i kërkesës është paditës në procedurë në Gjykatën Supreme.

40. Dokumentacioni i dorëzuar tregon se procedura e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Supreme ende nuk ka përfunduar.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë

41. Kushtet e pranueshmërisë janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

42. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parashikon:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

43. Nga ana tjetër, neni 47.2 i Ligjit, po ashtu, përcakton:

> *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

44. Përveç kësaj, rregulli 36.1.a i Rregullores, parasheh:

> *"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar".*

45. Në këtë rast, vërehet se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, pasi që ende nuk ka përfunduar procedura në Gjykatën Supreme.

46. Në të vërtetë, siç u përmend më lart, avokati i parashtruesit të kërkesës, më 15 dhjetor 2011, e informoi Gjykatën se procedura në Gjykatën

Supreme, në çështjen e parashtruesit të kërkesës përkitazi me të drejtën e punës, ende nuk ka përfunduar.

47. Prandaj, në këto rrethana, kur një çështje është në procedurë e sipër në Gjykatën Supreme, Gjykata Kushtetuese nuk është në gjendje të procedojë më tej me vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës. Rezulton që kërkesa e parashtruesit është e parakohshme.

Përfundim

48. Nga sa u tha më lart, Gjykata gjen se kërkesa nuk i plotëson kushtet nga neni 113.7 i Kushtetutës; nga neni 47.2 i Ligjit; dhe nga rregulli 36.1.a i Rregullores së punës; dhe, si e tillë, është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës; në mbështetje të nenit 47.2 të Ligjit; dhe në mbështetje të rregullit 36.1.a të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 162/11, Behxhet Makolli, datë 18 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Mlc. nr. 13/2010, të 9 nëntorit 2011

Rasti KI-162/11, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, qartazi e pabazuar, masa e përkohshme

Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Mlc. nr. 13/2010, të 9 nëntorit 2011, me të cilin është zgjidhur kontesti pronësoro-juridik, i krijuar me kërkesën për vërtetimin e pronësisë mbi paluajtshmërinë kontestuese në mes të parashtruesit të kërkesës dhe personave të tretë.

Parashtruesi i kërkesës konsideron se me këtë rast i janë shkelur të drejtat kushtetuese nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 i Konventës për të Drejtat e Njeriut, sepse ai nuk ishte ftuar në procedurë, dhe me këtë rast i ishte mohuar e drejta për gjykim të drejtë. Në të njëjtën kohë, ai kërkoi vendosjen e masës së përkohshme, meqenëse ekzekutimi dhe largimi i pronës kontestuese (lokalit) ishte caktuar për 28 dhjetor 2011. Në të njëjtën kohë ai kërkoi shqyrtimin e kërkesës me procedurë urgjente.

Parashtruesi i kërkesës konsideron se janë shkelur neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) dhe neni 6. (E Drejta për një Poces të Rregullt) i Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit Behxhet Makolli, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk kishte gjetur se procedurat përkatëse në gjykatat e rregullta ishin në ndonjë mënyrë të padrejta ose arbitrare. Prandaj, Gjykata konkludoi se kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse faktet e paraqitura nuk e arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese.

Në të njëjtën kohë, Gjykata e refuzoi kërkesën për masë të përkohshme, me arsyetim se i njëjti nuk kishte paraqitur asnjë provë bindëse, e cila kishte për ta justifikuar caktimin e masës së përkohshme si të nevojshme, për të shmangur një dëm të pariparueshëm, ose dëshmi që një masë e tillë është në interes publik.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI162/11
Parashtruesi
Behxhet Makolli
Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Mlc. nr. 13/2010 të 9 nëntor 2011.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare,
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Behxhet Makolli nga Prishtina, të cilin në Gjykatën Kushtetuese e përfaqëson Jehona Makolli nga Prishtina.

Vendim i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Mlc. nr. 13/2010 të 09 nëntorit 2011, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i shtetit të Kosovës kundër aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 625/2010 të 30 gushtit 2010 dhe aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë E. nr. 994/2009 të 04 majit 2010.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është kontesti pronësoro-juridik midis parashtruesit të kërkesës dhe personave të tretë në lidhje me pronësinë mbi paluajtshmërinë (lokalin), i cili gjendet në ish rrugën „M. Tito“ nr. 43, tani rr. Nëna Terezë“ nr. 43, i ndërtuar në ngastrën kadastrale nr. 7122/3 KZ Prishtinë, fleta poseduese nr. 4093 në sipërfaqe prej 203 m² dhe bodrumi në sipërfaqe prej 51 m², në sipërfaqe totale prej 254 m².

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenet 113.7 i 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 i 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese së Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009. (në tekstin e mëtejmë: „Ligji“) dhe rregullin 56. paragrafi 2. Rregullorja e punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullore).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: „Gjykata“) më 20 dhjetor 2011. Në të njëjtën kohë parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese caktimin e masës së përkohshme, sepse si ditë e ekzekutimit dhe e largimit nga lokali është caktuar data e 28 dhjetorit 2011.

6. Me vendimin e Kryetarit (nr. GJR. 162/11 të 17 janarit 2012), gjyqtarja Snezhana Botusharova është emëruar si Gjyqtare Raportuese. Të njëjtën ditë, me vendimin e Kryetarit nr. KSH. 162/11 është emëruar Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (Kryesues), Kadri Kryeziu dhe prof. dr. Enver Hasani.

7. Më 17 janar 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Kushtetuese dokumentet shtesë.

8. Më 17 janar 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares Snezhana Botusharova, Kolegji Shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (Kryesues), Kadri Kryeziu dhe Prof. Dr. Enver Hasani, i ka rekomanduar Gjykatës në përbërje të plot për papranueshmërinë e kërkesës.

9. Njëkohësisht, Kolegji shqyrtues, i propozoj Gjykatës në përbërje të plotë të refuzojë kërkesën e parashtruesit për masë të përkohshme, me arsyetim se i njëjti nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi bindëse për të justifikuar caktimin e masës së përkohshme, si të nevojshme për të shmangur një dëm të pariparueshëm, ose dëshmi që një masë e tillë është në interesin publik.

Përmbledhja e fakteve

10. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në një ditë të pacaktuar është lidhur kontrata për shitblerjen e paluajtshmërisë ndërmjet NSH "JUGOPLASTIKA" nga Beogradi dhe parashtruesit të kërkesës.

11. Objekti i kontratës së lidhur është paluajtshmëria (lokali afarist), i cili gjendet në Prishtinë, rr. ish Marshal Tito nr. 43. me sipërfaqe prej 203 m2, bodrumi shtesë në sipërfaqe prej 51 m2, me mallra dhe mjete themelore të cilat gjenden në atë lokal afarist.

12. Me rastin e nënshkrimit të kontratës, shitësi NSH "JUGOPLASTIKA" nga Beogradi ia ka dorëzuar blerësit në pronësi dhe në dispozicion të lirë lokalin afarist, mallrat dhe mjetet themelore.

13. Më 27 shtator 1999, shitësi dhe blerësi nënshkruajnë aneksin e kontratës me të cilin e përcaktojnë çmimin prej 540.000 DM (270.000 EURO), me kusht që blerësi është i detyruar që të paguaj shitësit gjysmën e shumës të çmimit të kontratës e cila ka qenë 540.000 DM, dhe shitësi në afat prej 30 ditësh nga dita e nënshkrimit të aneksit të kontratës është i detyruar t'i plotësojë kërkesat ligjore për vërtetimin e kontratës dhe bartjen e drejtës pronësore mbi paluajtshmërinë lëndore.

14. Pasi që shitësi nuk ka pasur mundësi të sigurojë kërkesat ligjore për vërtetimin e kontratës të 27 shatorit 1999, sepse shitësi nuk ka pasur dokumente të nevojshme, bartja e të drejtës pronësore ndërmjet shitësit dhe blerësit nuk është realizuar.

15. Njëherësh më 16 nëntor 1999, me kontratën e shitblerjes nr. 11236/99 e cila është lidhur dhe vërtetuar tek noteri në Split ndërmjet SH.A. „D." nga Spliti si shitës dhe Z.Al., Z. A. dhe S.R. si blerës, palujtshmëria (lokali afarist), i cili gjendet në Prishtinë, rr. ish Marshal Tita nr. 43. në sipërfaqe prej 203 m2, plus bodrumi në sipërfaqe prej 51 m2, behët pronë e përbashkët e blerësve të lart përmendur.

16. Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin C. br. 182/2002 të 10 marsit 2008 aprovon kërkesëpadinë e paditëseve: Z. Al., Z. A., që të dy nga fshati Reqicë Komuna e Tetovës dhe S. R. nga Shtipske – Tetovë, sipas së cilës është vërtetuar që paditësit në bazë të kontratës së shitblerjes të lidhur më 16 nëntor 1999 ndërmjet të padituës SH.A. „D." nga Spliti si shitës dhe paditësit si blerës, kontrata e vërtetuar të noteri në Split më 16 nëntor 1999 me nr. 11236/99, paditësit kanë fituar të drejtën pronësore, bashkëpronësi mbi palujtshmerinë e cila gjendet në rr. ish „M. Tito" nr. 43, tani rr. "Nëna Terezë" nr. 43, lokalin afarist në

sipërfaqe prej 203 m² dhe bodrum në sipërfaqe prej 51 m², në sipërfaqe totale prej 254 m², të ndërtuar në ngastrën kadastrale nr. 7122/3 ZK Prishtinë, lista poseduese nr. 4093.

17. Kundër këtij aktgjykimi, e paditura SH.A. „D.“ nga Spliti nuk ka paraqitur ankesë dhe Aktgjykimi mori formë të prerë më 11 mars 2008.

18. Paditësit në cilësinë e kreditorit më 23 nëntor 2009, paraqitën propozimin për ekzekutimin e Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 182/2002 të 10 marsit 2008, kundër debitorit SH.A. „D.“ nga Spliti.

19. Më 02 janar 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë nxjerrë Aktvendimin për ekzekutim E. nr. 334/09 dhe lejon ekzekutimin dhe e detyron debitorin që kreditorëve t'ua dorëzoj në posedim lokalin afarist siç është përshkruar më lart.

20. Më 27 janar 2010, Gjykata Komunale sjell edhe konkluzionin sipas të cilit përcakton ekzekutimin ndaj debitorit dhe më këtë konkluzion vendoset që të bëhet lirimi i lokalit nga njerëzit, sendet dhe nga pala e tretë.

21. Kundër Aktvendimit për lejimin e ekzekutimit SH.A. „D.“ nga Spliti nuk ka paraqitur kundërshtim.

22. Më 15 shkurt 2010, lajmërohet pala e tretë me emër Bedrije Makolli dhe kundërshton lejimin e ekzekutimit me arsyetim se ekzekutimi i Aktvendimit është i palejueshëm dhe papërshtatshëm, sepse ajo e ka në posedim këtë lokal.

23. Nga 15 shkurti 2010, lajmërohen edhe 2 persona të palës së tretë, SH.A. „Jugoplastika“ nga Beogradi dhe Behxhet Makolli nga Prishtina të cilët i përfaqëson - avokati M. R., të cilët e kundërshtojnë lejimin e ekzekutimit.

24. Gjykata Komunale në Prishtinë më 04 maj 2010, nxjerrë Aktvendimin E. nr. 994/09 sipas të cilit Aktvendim, kundërshtimin e palës së tretë Bedrije Makolli nga Prishtina e refuzon si të palejueshëm, ndërsa kundërshtimin e Jugoplastikës dhe Behxhet Makollit e refuzon si të pabazuar.

25. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, duke vendosur sipas kundërshtimeve të palës së tretë Bedrije Makolli, Jugoplastikës nga Beogradi dhe Behxhet

Makollit nga Prishtina ia refuzon ankesat e tyre si të pabazuara dhe e vërteton Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë.

26. Palët e treta SH.A. „Jugoplastika“ nga Beogradi dhe Behxhet Makolli nga Prishtina, të pakënaqur me procedurën e përfunduar ndaj tyre, më 30 nëntor 2010 i janë drejtuar Prokurorisë së shtetit të Kosovës me kërkesë që Prokurori të paraqet kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

27. Më 15 dhjetor 2010, Prokuroria e shtetit të Kosovës me parashtresën KMLC. nr. 63/2010 paraqet ankesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktvendimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë E. nr. 994/09 të 08 janarit 2010, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, në të cilën mes tjerash thuhet:

“Aktvendimi përmbarimor i formës së prerë i Gjykatës Komunale në Prishtinë E. nr. 994/09 i 08 janarit 2010, është i papërshtatshëm për ekzekutim, në të cilin rast gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, meqenëse gjykata e shkallës së dytë e ka mbështetur këtë vendim, atëherë rezulton se edhe gjykata e shkallës se dytë gabimisht e ka aplikuar të drejtën materiale.“

“*Aktvendimi me të cilin lejohet përmbarimi nuk ka te bëje asgjë me aktgjykimin e formës se prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 182/2002 sepse me ketë aktgjykim nuk është vendosur që lokali afarist kontestues t’iu dorëzohet kreditoreve.*“

“Gjendja faktike në teren është ndryshe sepse debitori SH.A. „D.“ nga Spliti, kundër të cilit kërkohet përmbarimi nuk është në posedim të lokalit afarist, përkundrazi, në posedim dhe mbajtje janë krejtësisht persona tjerë fizik dhe në rastin konkret Bedrije Makolli e cila qysh në vitin 1999 ka hyrë në mënyrë të paligjshme dhe e ka mbajtur në posedim, e cila më vonë ia jep me qira personit të tretë me emrin Behxhet Makolli. Tani, lokali afarist që nga viti 1999 e tutje, është në posedim të këtyre personave të cilët vërtetë nuk kanë bazë ligjore për të mbajtur lokalin afarist për të cilin pretendojnë se kanë të drejtë.“

“Mirëpo, meqenëse kundër tyre nuk është zhvilluar asnjë procedurë kontestimore për t’i larguar nga posedimi, ndaj tyre nuk ekziston ndonjë vendim i formës së prerë që ata me dhunë ta lëshojnë lokalin afarist dhe mendojmë se gjykata civile ka gabuar kur e ka gjykuar lëndën civile C. nr. 182/2002 dhe nuk i ka përfshirë në cilësinë e palëve ndërgjyqëse në kuptim të nenit 269.1 në të cilën procedurë do të kishin qenë të përfshire në cilësinë e të paditurve.“

"Meqenëse aktgjykimi i formës së prerë C. nr. 182/2002 prodhon efekt juridik vetëm ndaj palëve që kanë qenë në kontest dhe jo edhe ndaj personave të tretë, atëherë aktvendimi përmbarimor i Gjykatës Komunale në Prishtinë E. nr. 994/09 është i papërshtatshëm për ekzekutim."

"*Gjykata Komunale në Prishtinë ka gabuar kur çështjen e ka vendosur në procedurën përmbarimore dhe nuk ka vendosë me konkluzion të veçante që personat e tretë të cilët pretendojnë se kanë ndonjë të drejtë t'i udhëzojë në procedurën kontestimore."*

"Vendimi përmbarimor i Gjykatës Komunale në Prishtinë E. nr. 994/09 nuk mund te ekzekutohet kundër personave të tretë kundër të të cilëve nuk është marrë ndonjë vendim i formës së prerë për largimin e tyre dhe të sendeve nga lokali afarist dhe për dorëzimin e lokalit afariste kreditoreve. Një detyrim të këtillë nuk e përmban aktgjykimi i formës së prerë."

28. Me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Mlc. nr. 13/2010 të 9 nëntorit 2011, refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga ana e Prokurorit të shtetit të Kosovës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 625/2010 të 30 gushtit 2010, dhe Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë E. nr. 994/2009 të 4 majit 2010, me arsyetimin:

"Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi si te pabazuara thëniet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë se aktgjykimi i formës së prerë C. nr. 182/2002 prodhon efekt juridik vetëm ndaj palëve qe kane qenë ne kontest dhe jo edhe ndaj personave te trete, ashtu qe aktvendimi është i papërshtatshëm, nga se ne rastin konkret kemi te bëjmë me aktgjykimin për vërtetimin e pronësisë ne bazë të kontratës për shitblerje, me të cilin është vërtetuar që kreditoret janë pronar të lokalit i cili aktgjykim është i formës së prerë dhe ekziston titulli përmbarues me të cilin kërkon dorëzimin si pronar i lokalit, ndërsa personat të tretë pa kurrfarë baze ligjore posedojnë dhe shfrytëzojnë lokalin, ashtu që ndaj personave të tretë nuk kërkohet ekzekutimi por dorëzimi i objektit nga debitori. Edhe thëniet e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë lidhur me nenin 39.1 të LPP, qe propozimi për përmbarimin, përmban "diçka tjetër", ndërsa me ketë nën taksativisht parashikohet përmbajtja e propozimit, janë të pabazuara sepse në rastin konkret propozimi përmban të gjitha elementet përmbaruese në baze të cilit është lejuar përmbarimi sipas nenit 39. të LPP dhe janë plotësuar kushtet ligjore për lejimin e përmbarimit ne baze të titullit përmbarues."

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 31. i Kushtetueses së Kosovës dhe neni 6 i Konventës për të Drejtat e Njeriut janë shkelur me këtë Aktvendim të Gjykatës Supreme dhe pretendon:

"Dihet se të gjitha të drejtat e qytetarëve garantohen me ligj dhe Kushtetutë. Prandaj, duke vlerësuar se në këtë rast na janë shkelur të drejtat kushtetuese nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 i Konventës për të Drejtat e Njeriut, dhe kjo është evidente se ka ndodhur në këtë rast. Sepse, nuk kemi qenë të ftuar në procedurë dhe me këtë rast na është mohuar e drejta në gjykim të drejtë."

30. Parashtruesit i kërkesës i drejtohen Gjykatës Kushtetuese me këtë kërkesë:

"Përmes kësaj kërkese dëshirojmë të shqyrtohet kjo çështje tejet e rëndësishme për ne dhe të vendoset drejtë dhe në mënyrë të paanshme e jo siç është vepruar deri më tani ku na është cenuar e drejta në gjykim të drejtë që është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovë, por edhe me Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, ku e drejta në gjykim të drejtë është njëra ndër të drejtat themelore..."

"Meqë si datë e ekzekutimit dhe largimit nga lokali është caktuar dt. 28 dhjetor 2011, konsiderojmë se do ta shqyrtoni në mënyrë sa më urgjente kërkesën tonë".

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

31. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë në lidhje me parashtresën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata së pari duhet të vërteton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmerisë të parashikuara me Kushtetutën, të arsyetuara më tej në mënyrë të detajuar në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës.

32. Neni 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili

është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj..“

33. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të procedurës dhe të drejtës materiale (shih: *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28., Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

34. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë provë *prima facie* që tregon cenimin e të drejtave të tij kushtetuese (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi GJEDNJ në lidhje me pranueshmerinë e kërkesës nr. 53363/99 të 31 majit 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk përcakton se si neni 31. i Kushtetueses dhe neni 6 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut e mbështesin kërkesën e tij, siç parashikohet në nenin 113.7. te Kushtetutës dhe nenit 48. të Ligjit.

35. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës ka mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tij dhe të kundërshtojë interpretimin e ligjit në procedurën kontestimore dhe gjithashtu të provojë se ai është pronar i palujtshmerisë lëndore, në rastin konkret, Bedrije Makolli, e cila që nga viti 1999 ka hyrë në mënyrë të paligjshme dhe ka mbajtur në posedim palujtshmerinë lëndore, e cila më vonë ia ka dhënë palujtshmerinë me qira parashtruesit të kërkesës, nuk mund të konsiderohet si palë. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se proceduarat e duhura në ndonjë mënyrë kanë qenë të padrejta ose arbitrare. (shih: *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi GJEDNJ në lidhje me pranueshmerinë e kërkesës nr. 17064/06 të 30 qershorit 2009).

36. Krejt në fund, kushtet për pranueshmerinë nuk janë plotësuar në këtë parashtresë. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të cekë dhe të mbështetë me dëshmi se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese.

37. Nga kjo rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës e cili parashikon *„Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese,“*.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48. të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, më 17 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TË HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TË HEDHË POSHTË kërkesën për caktimin e masës së përkohshme;

III. Ky vendim do t'iu komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 17/13, Bujar Bukoshi, datë 20 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ka, Nr. 562/12 të 8 tetorit 2012

Rasti KI 17/13, vendim për kërkesën për masë të përkoshme i 14 marsit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, imuniteti i anëtarëve qeverisë, dinjiteti i njeriut

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se për të gjitha veprimet dhe vendimet të cilat ai i mori si Ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës kishte imunitet funksional dhe ato ishin në pajtim me ligjin e aplikueshëm në Kosovë. Prandaj, ai nuk mund të ndiqet penalisht. Gjithashtu parashtruesi pretendon se se konfirmimi i aktakuzës ishte bërë publik dhe kjo e kishte dëmtuar reputacionin e tij, duke shkelur kështu dinjitetin e tij njerëzor. Për më temër parashtruesi kërkon nga Gjykata të vendosë masa të përkohshme për suspendimin e procedurës penale kundër tij në gjykata të rregullta, deri në gjykimin përfundimtar të kërkesës.

Gjykata me këtë rast konstatoi se në këtë fazë të është kompetencë e gjykatave të rregullta që mbledhin dhe vlerësojnë provat dhe të vendosin nëse veprimet dhe vendimet ishin brenda fushëveprimit të Ministrit të Shëndetësisë, i cili mbrohet me imunitet funksional dhe të gjykohet në mënyrë përkatëse. Prandaj, pa paragjykim ndaj ndonjë vendimi të mëtejshëm që do të nxirret nga Gjykata për pranueshmërinë ose meritat në të ardhmen, vendosi të refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.

VENDIM PËR KËRKESËN PËR MASË TË PËRKOHSHME
në
Rastin Nr. KI17/13
Parashtruesi
Bujar Bukoshi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë,
Ka, Nr. 562/12 të 8 tetorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përberë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Bujar Bukoshi, ish-Ministër i Shëndetësisë, me vendbanim në Prishtinë, i përfaqësuar nga Besnik R. Berisha, avokat nga Prishtina.

Vendimi kontestuar

2. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) ta shqyrtojë vendimin, Ka. Nr. 265/12, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të nxjerrë më 8 tetor 2012, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 10 tetor 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit, Ka. Nr. 265/12, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, i cili e konfirmoi aktakuzën kundër parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi thekson se pretendimet kundër tij në aktakuzë janë antikushtetuese, pasi që veprimet dhe vendimi që ka marrë ishin brenda fushëveprimit të kompetencave të Ministrit së Shëndetësisë.

4. Parashtruesi më tutje kërkon nga Gjykata që të vendosë masa të përkohshme për suspendimin e hetimeve penale kundër tij, derisa Gjykata ta merr vendimin përfundimtar.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 22, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: "Ligji") dhe Rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Rregullorja e punës").

Procedura në Gjykatë

6. Më 11 shkurt 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 13 shkurt 2013, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

8. Më 25 shkurt 2013, Kryetari i Gjykatës me Vendimin Nr. GJR. KI. 17/13, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese. Në të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH. KI. 17/13, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Kadri Kryeziu.

9. Më 8 mars 2013, Gjykata Kushtetuese, përmes një shkrese e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

10. Në të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Gjykatës së Apelit në Prishtinë, si pasardhëse e Gjykatës së Qarkut në Prishtinës.

Përmbledhja e fakteve sipas parashtruesit të kërkesës

11. Më 16 korrik 2012, Prokurori Special i EULEX-it e dorëzoi aktakuzën e ndryshuar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, PPS Nr: 64/11, 465/09 dhe 424/09, sipas së cilës parashtruesi i kërkesës akuzohej për veprën penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimeve, e dënueshme me nenin 339, paragrafët 1 dhe 3, në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës, për të cilën parashikohet dënimi prej 1 deri 8 vite burgim.

12. Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 3 dhe 5 shtator 2012 mbajti seanca për konfirmimin e aktakuzës. Gjatë seancës së 3 shtatorit, avokati mbrojtës i parashtruesit të kërkesës e ngriti çështjen e imunitetit funksional gjatë mandatit të parashtruesit të kërkesës si Ministër i Shëndetësisë.

13. Më 11 shtator 2012, gjykatësi përgjegjës për konfirmimin e aktakuzës, me Vendimin Ka.No.562/12, e refuzoi kërkesën e avokatit mbrojtës për ta marrë në konsiderim mbrojtjen e ofruar nga neni 98 i Kushtetutës. Gjyqtari arsyetoi se akuza për shpërdorimin e detyrës zyrtare nuk ishte brenda fushëveprimit të përgjegjësisë si Ministër i Shëndetësisë.

14. Më 14 shtator 2012, avokati mbrojtës i parashtruesit të kërkesës ushtroi ankesë kundër vendimit të lartpërmendur në Kolegjin penal prej tre gjyqtarëve. Parashtruesi argumentoi se aktet dhe vendimet që ai mori, për të cilat ai ishte akuzuar, ishin në cilësinë e Ministrit së Shëndetësisë.

15. Më 18 shtator 2012, Kolegji i Gjykatës së Qarkut, me Vendimin Ka.Nr.562/12, e refuzoi Ankesën si të pabazuar në lidhje me imunitetin e parashtruesit të kërkesës si ish-Ministër i Shëndetësisë.

16. Më 8 tetor 2012, gjyqtari përgjegjës për konfirmimin e aktakuzës nxori Vendimin KA. Nr. 265/12, që konfirmoi aktakuzën e Prokurorit Special dhe gjykimi filloi.

Argumentet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se neni 98 dhe neni 23 të Kushtetutës janë shkelur.

18. Neni 98 [Imuniteti] i Kushtetutës parasheh se:

> *"Anëtarët e Qeverisë së Kosovës gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si anëtarë të Qeverisë."*

19. Në lidhje me këtë, parashtruesi pretendon se ai kishte imunitet funksional për të gjitha veprimet dhe vendimet të cilat ai i mori si Ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe ato ishin në pajtim me ligjin e aplikueshëm në Kosovë. Prandaj, ai nuk mund të ndiqet penalisht.

20. Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut] i Kushtetutës ofron mbrojtje të dinjitetit njerëzor të individit, duke përcaktuar se:

> *"Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themeloretë njeriut."*

21. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se konfirmimi i aktakuzës ishte bërë publik dhe kjo e kishte dëmtuar reputacionin e tij, duke shkelur kështu dinjitetin e tij njerëzor.

Kërkesa për masë të përkohshme

22. Në këtë rast, parashtruesi kërkon nga Gjykata të vendosë masa të përkohshme për suspendimin e procedurës penale kundër tij në gjykata të rregullta, deri në gjykimin përfundimtar të kërkesës.

23. Në lidhje me këtë, Gjykata merr në konsiderim se, në pajtim me rregullin 55 (1) të Rregullores, *"Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut" dhe gjithashtu rregulli* 55 (6) *"[...]Rekomandimi i Kolegjit shqyrtues për aplikimin e masës së përkohshme bëhet vendim i Gjykatës, përveç; nëse një ose me shumë gjyqtarë ia paraqesin ndonjë vërejtje Sekretarit te Përgjithshëm brenda tri (3) ditësh. [...]".*

24. Neni 116.2 [Efekti Juridik i Vendimeve] i Kushetutës përcakton:

2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të paripërueshme."

25. Neni 27 i Ligjit gjithashtu parasheh:

> *"Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa te përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të paripërueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik."*

26. Për më tepër, në mënyrë që Gjykata të vendosë masë të përkohshme sipas rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, duhet pra të vlerësojë se:

> *(a) pala qe kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmerinë e saj, rastin prima facie për pranueshmerinë e kërkesës;*

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do te pësojë dëme te paripareushme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(..)

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do te rekomandojë refuzimin e kërkesës."

27. Gjykata vëren se rasti është nën shqyrtim nga gjykata e rregullt, ku parashtruesi do të jetë në gjendje të ushtrojë ankesat e tij për shkeljen e pretenduar të drejtave të tij.

28. Gjykata Kushtetuese përsërit se nuk është gjykatë e faktit dhe se është kompetencë e gjykatave të rregullta që në këtë fazë të mbledhin dhe vlerësojnë provat dhe të vendosin nëse veprimet dhe vendimet ishin brenda fushëveprimit të Ministrit të Shëndetësisë, i cili mbrohet me imunitet funksional dhe të gjykohet në mënyrë përkatëse.

29. Prandaj, Gjykata Kushtetuese, pa paragjykim ndaj ndonjë vendimi të mëtejshëm që do të nxirret nga Gjykata për pranueshmërinë ose meritat në të ardhmen, më 14 mars 2013, me shumicë votash

VENDOSI

I. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme

II. Ky Vendim do tu komunikohet palëve; dhe

III. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 120/10, Zyma Berisha, datë 27 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 308/2007, të 10 qershorit 2010

Rasti KI 120/10, aktgjykim i 29 janarit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kontest civil, e drejta për gjykim te drejte, barazia para ligjit, kërkesë e pranueshme, kërkesa qartazi e bazuar, shkelje e nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. nr. 308/2007, e 10 qershorit 2010, e ka vënë atë në pozitë të pabarabartë *vis-a-vis* ish-kolegëve, të cilët kanë qenë në situatë të njëjtë me të, gjegjësisht që kanë pasur statusin e punësimit të përhershëm në kompaninë e njëjtë dhe kanë fituar rastin në Gjykatën Supreme, më pas janë kthyer në vendet e tyre të mëparshme të punës.

Parashtruesja e kërkesës argumenton se vetëm në rastin e saj është vendosur ndryshe në Gjykatën Supreme, dhe kështu ajo ka rënë viktimë e padrejtësisë dhe e diskriminimit. Fillimisht, ajo i ka bashkangjitur kërkesës së saj dy aktgjykimet e Gjykatës Supreme, të dyja janë nxjerrë më 17 janar 2008 (Rev. nr. 126/2007 dhe Rev. nr. 177/2007), të cilat kanë të bëjnë me dy ish-kolegët e saj, me ç'rast, në parashtresën e saj me shkrim të 26 shtatorit 2011, parashtruesja i kishte përmendur emrat e 6 ish-kolegëve të saj që e kishin fituar rastin në Gjykatën Supreme (duke përfshirë emrat e dy kolegëve, aktgjykimet e të cilëve tashmë i ka dorëzuar).

Megjithatë, sipas opinionit të Gjykatës Kushtetuese, aktgjykimi i Gjykatës Supreme, duke neglizhuar vlerësimin e duhur të argumenteve të parashtrueses përkitazi me statusin e përhershëm të punësimit, edhe pse ato ishin specifike, relevante dhe të rëndësishme, nuk i plotësoi detyrimet e Gjykatës Supreme sipas nenit 6.1 të KEDNJ-së për të plotësuar detyrimet e cekjes së arsyeve (*Shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Aktgjykimi i 18 korrikut 2006, në rastin Pronina kundër Ukrainës, Kërkesa nr.* 63566/*00; Shih, gjithashtu, Aktgjykimin e Gjykatës në Rastin Nr. KI*40/*09, Imer Ibrahimi dhe 48 punonjës të tjerë të KEK-ut, gjegjësisht "Aktgjykimi i KEK-ut"*).

Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, në Aktgjykimin Rev. nr. 154/2008, e 7 shkurtit 2011, gjegjësisht 7 muaj pas aktvendimit të saj në rastin e parashtrueses, nuk përsëriti gjetjet e veta në rastin e parashtrueses, por përsëri vendosi në po të njëjtën mënyrë, siç kishte vepruar në katër rastet para rastit të parashtrueses së kërkesës, duke konsideruar konfirmimin e statusit të përhershëm të punësimit si objekt të çështjes së kontesteve dhe duke përdorur

arsyetime të ngjashme voluminoze dhe të detajuara për të refuzuar revizionin e paraqitur nga "Kosova e re".

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese gjen se Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë të dukshme arbitrare në rastin e parashtrueses së kërkesës, në kundërshtim me parimet e shtjelluara nga GJEDNJ-ja në aktgjykimin e vet, të përmendur më lart, në rastin *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë* [GC], nr. 13279/05, 20 tetor 2011.

Prandaj, Gjykata konkludon se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

AKTGJYKIM
në
Rastin Nr. KI120/10
Parashtruese
Zyma Berisha
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 308/2007, të 10 qershorit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar,
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesja e kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Zyma Berisha (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesja), me vendbanim në Pejë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 308/2007, i 10 qershorit 2010, pranuar nga parashtruesja më 13 shtator 2010.

Objekti i çështjes

3. Kërkesa e parashtrueses ka të bëjë me shkeljen e pretenduar të të drejtave të njeriut, që i janë bërë asaj, nga nenet 3.2 [Barazia para Ligjit] dhe 24.1 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, me Aktgjykimin Rev. nr. 308/2007 e Gjykatës Supreme, e 10 qershorit 2012. Nëpërmjet këtij aktgjykimi, ishin anuluar vendimet e gjykatave të instancave të rregullta në favor të parashtrueses së kërkesës, dhe ishte mbështetur kërkesa për revizion, që kishte iniciuar Kompania e sigurimit "Kosova e re" (në tekstin e mëtejmë: "Kosova e re"). Objekt i kësaj procedure civile ishte konfirmimi i statusit të punonjësit të përhershëm të parashtrueses së kërkesës, nga "Kosova e re", dhe, si rezultat, rikthimi i saj në vendin e

mëparshëm të punës. Kjo procedurë kishte ndërprerë më 10 qershor 2012, kur Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin e kontestuar Rev. nr. 308/2007.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56.1 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 3 dhjetor 2010, parashtruesja dorëzoi kërkesë në Gjykatë.

6. Më 27 janar 2011, Gjykata njoftoi parashtruesen dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.

7. Më 2 qershor 2011, Kryetari caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues. Po të njëjtën ditë, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Butosharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.

8. Më 21 shtator 2011, Gjykata kërkoi nga parashtruesja të dorëzonte dokumentacion shtesë përkitazi me çështjen e saj.

9. Më 26 shtator 2011, parashtruesja dorëzoi në Gjykatë dokumentacionin shtesë të kërkuar dhe, më tutje, e specifikoi kërkesën.

10. Më 24 maj 2012, parashtruesja i dorëzoi me shkrim parashtresat shtesë në Gjykatë.

11. Më 19 qershor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues.

12. Më 2 korrik 2012, Kryetari emëroi gjyqtarin Altay Suroy anëtar të Kolegjit shqyrtues, në vend të gjyqtares Iliriana Islami, pasi mandati i saj si gjyqtare e Gjykatës kishte përfunduar më 26 qershor 2012, dhe zëvendësoi gjyqtaren Snezhana Botusharova.

13. Më 13 shtator 2012, parashtruesja e kërkesës i dorëzoi Gjykatës materiale shtesë me shkrim.

14. Më 6 dhjetor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues.

15. Më 7 dhjetor 2012, Gjykata pranoi dokumente shtesë.

16. Më 29 janar 2013, Gjykata, në përbërje të plotë, shqyrtoi rastin në një seancë të mbyllur.

Përmbledhja e fakteve

17. Parashtruesja e kërkesës, që nga viti 1986, ka qenë punëtore në Bashkësinë e Sigurimit të Pasurisë dhe të Sigurimeve "Kosova" në Prishtinë, në bazë të "marrëdhënies së punës me kohë të pacaktuar", d.m.th. kishte punësim të përhershëm. Ajo ishte në postin e përkthyeses në Njësinë afariste të Shërbimeve të Përbashkëta në Kompaninë e sigurimit "Kosova", e cila kompani më vonë është tjetërsuar dhe është transformuar në Kompaninë e sigurimit "Kosova e re". Pas këtij transformimi, me një Marrëveshje kolektive, të arritur ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të "Kosova e re" dhe Kryetarit të Sindikatës, ndër të tjera, ishte paraparë që punëtorët e Kompanisë së transformuar të mbeteshin në marrëdhënie të njëjtë pune në subjektin e ri.

18. Më 13 shtator 2000, "Kosova e re", me Vendimin nr. 345, e caktoi parashtruesen në vendin e punës: Lektore–Arkiviste dhe përcjellëse e medieve, pozitë kjo në të cilën parashtruesja punoi derisa u transferua, sipas marrëveshjes për bartjen e profilit ndërmjet Kompanisë së sigurimit "Kosova" dhe "Kurum Comerce Group", e njohur si "Kurum".

19. Më pastaj, "Kosova e re", me kontratën e re, parashtrueses ia ndryshoi statusin: nga marrëdhënia e punës me kohë të pacaktuar, në marrëdhënie pune me kohë të caktuar, duke ia vazhduar kontratën e re disa herë me radhë gjatë periudhës 2001-2004.

20. Më 25 tetor 2002, parashtrueses iu dorëzua vendimi për largim të përkohshëm nga puna.

21. Më 18 shtator 2003, parashtruesja pranoi kontratën njëmujore të punës, nr. 1523/8.9.2003, për kohë të caktuar, e vlefshme prej 1 shtatorit 2003 e deri më 31 shtator 2003, për të cilën u ankua po në të njëjtën datë dhe ku pohoi: *"Kontratën po e pranoj, por pa dëshirën time, sepse një gjë e tillë po me imponohet për të siguruar mjete për jetesë"*.

22. Më 1 janar 2004, parashtruesja e kërkesës edhe një herë pranoi kontratë të punës vetëm për një muaj, prej 1 janarit 2004 e deri më 31 janar 2004.

23. Më 9 janar 2004, parashtruesja iu drejtua me ankesë Drejtorit të Përgjithshëm të "Kosova e re", duke kundërshtuar kontratën njëmujore dhe kërkoi të respektohet Marrëveshja kolektive. Parashtruesja pohoi se kontratën e ka nënshkruar nën presion dhe pa vullnetin e saj, nga frika se do të mbetej pa punë.

24. Më 3 shkurt 2004, parashtruesja, nëpërmjet Njoftimit nr. 9 është njoftuar se, duke filluar nga 4 shkurti 2004, më nuk është e obliguar të paraqitet në punë, për shkak të ndërprerjes së kontratës me kohë të caktuar. Në Njoftim nuk ishin dhënë arsye për shkakun e shkëputjes së marrëdhënies së punës me kompaninë.

25. Në të njëjtën datë, parashtruesja, së bashku me dy kolegët e saj të punës (S. B. dhe R. B.), të cilët ishin në situatë identike me të, ushtruan ankesë kundër Njoftimit.

26. Më 5 shkurt 2004, parashtruesja paraqiti rastin e saj në Inspektoratin e Punës në Prishtinë, organ ky i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe kërkoi nga i njëjti ndërmarrjen e veprimeve juridike për mbrojtjen e të drejtave të saj nga marrëdhënia e punës.

27. Më 23 shkurt 2004, Inspektorati i Punës iu përgjigj parashtrueses dhe dy kolegëve të saj, S. B. dhe R. B., si në vijim:

"Neni 16 i Marrëveshjes kolektive të Kompanisë 'Kosova e re'... qartë parasheh se marrëdhënia e punës me kohë të caktuar mund të themelohet në rastet në vijim: të zëvendësimit të punëtorit i cili mungon nga puna, rritjes së përkohshme të vëllimit të punës, punësimit të praktikantit për një kohë të caktuar dhe rastet e tjera të parapara me Marrëveshje kolektive. Nuk është e diskutueshme se ankuesit ishin në marrëdhënie të pacaktuar të punës në ish-Kompaninë e sigurimit 'Kosova', prandaj, në pajtim me dispozitat përkatëse të cekura më lart, marrëdhëniet e punës në fjalë ishin themeluar për kohë të PACAKTUAR... në këto rrethana, punëdhënësi ishte i obliguar të nënshkruajë një kontratë të punës në kohë të pacaktuar me punonjës...".

28. Në mars 2004, parashtruesja dhe dy kolegët e saj kërkuan nga Këshilli Drejtues i "Kosova e re" që t'i zbatojë konkluzionet e Inspektoratit të Punës dhe t'i kthejë ata në vendet e tyre të punës.

29. Pasi kërkesa e lartpërmendur nuk u plotësua, parashtruesja paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër "Kosova e re".

30. Në padinë e saj, parashtruesja kërkoi që Gjykata ta konfirmojë statusin e saj të përhershëm të punës dhe të urdhërojë të paditurën, "Kosova e re", ta kthejë atë në vendin e saj e punës.

31. Më 20 shtator 2004, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C1. nr. 31/04, aprovoi padinë e parashtrueses si të bazuar dhe konfirmoi se parashtruesja gëzon statusin e punonjësit të "Kosova e re" në Prishtinë për një kohë të pacaktuar, gjegjësisht gëzon statusin e përhershëm të punës me të gjitha të drejtat që rrjedhin nga ai status. Për më tepër, Gjykata urdhëroi të paditurën që parashtruesen ta kthejë në punë dhe në detyra të punës, sipas kualifikimeve dhe aftësive të saj, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, në afat 8-ditësh nga data e aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit me forcë.

32. Gjykata Komunale, në arsyetimin e saj, ndër të tjera, konstatoi:

"Gjykata, pas analizimit të provave të administruara sipas nenit 8 të LPK-së dhe në bazë të fakteve të vërtetuara, konstatoi se padia e paditëses është e bazuar.

Në rastin konkret, prej fillimit të marrëdhënies së punës, paditësja ka pasur cilësinë e punëtores me kohë të pacaktuar dhe të njëjtës, pa pëlqim paraprak, nuk ka mundur t'i transferohet kjo marrëdhënie pune me kohë të caktuar, për çka vërtetohet se paditësja tërë kohën ka ushtruar ankesa lidhur me këtë status të saj te e paditura.

Në mbështetje të këtij vlerësimi të Gjykatës, është edhe konstatimi i Inspeksionit të Punës, të dt. 15 tetor 2003, si dhe kushtet nga Tenderi i BPK-së, të dt. 07 shkurt 2002, ku gjithashtu është theksuar se punëtorët ekzistues të kompanisë së mëparshme të sigurimeve do të transferohen në Kompaninë e tashme të sigurimeve 'Kosova e re'.

... në bazë të provave te nxjerra, Gjykata vërtetoi se e paditura 'Kosova e Re' ka bërë shkelje të procedurës së përcaktuar me Ligj dhe, për këtë arsye, paditëses duhet t'i njihet statusi i punëtorit me kohë të pacaktuar, në vazhdimësi, meqë punët të cilat i ka kryer nuk kanë karakter të përkohshëm as sipas Ligjit apo aktit të paditëses, ndërsa punët e tilla nuk janë shuar e as që është zvogëluar vëllimi i tyre, dhe, për më tepër, punën e mëparshme të paditëses tash e kryen një

punëtore e re, për çka paditësja ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 të Rregullores së Ligjit Themelor të Punës, 2001/27.
Po ashtu, Gjykata ka vërtetuar se me marrëveshjen kolektive në fuqi, e cila vlen për të gjithë punëtorët e kësaj kompanie të sigurimeve, nuk është paraparë mundësia e pushimit të marrëdhënies së punës sipas mënyrës siç ka vepruar e paditura".

33. Më 29 mars 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, pas ushtrimit të ankesës nga "Kosova e re", me Aktgjykimin Ac. nr. 234/2005, vendosi ta hedhë poshtë si të pabazuar ankesën e së njëjtës dhe vërtetoi si të drejtë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C1. nr. 31/2004, e 29 shtatorit 2004.

34. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në Aktgjykimin Ac. nr. 234/2005, ndër të tjera, arsyeton:

"Sipas vlerësimit të kolegjit, janë të pabazuara thëniet ankimore të të paditurës (Kompania e sigurimeve 'Kosova e re') se nga gjykata e shkallës së parë është bërë zbatim i gabuar i së drejtës materiale, këtë sepse me dispozitat e nenit 16 të Marrëveshjes kolektive janë paraparë në mënyrë numerike rastet kur themelohet marrëdhënia e punës me punëtorë me kohë të caktuar te e paditura. Me të njëjtën marrëveshje k është paraparë mënyra e themelimit të marrëdhënies së punës me punëtorët e transferuar dhe ndryshimi i statusit juridik të punëtorëve të transferuar, sikurse ka vepruar e paditura. Kolegji vlerëson se paditësja, si punëtore e transferuar te e paditura, mbi bazën e marrëveshjes së cituar gëzon statusin e njëjtë juridik sikurse punëtorët e tjerë të të paditurës dhe ndryshimi i statusit të marrëdhënies së punës së paditëses prej marrëdhënies së punës me kohë të pacaktuar në marrëdhënie pune me kohë të caktuar, në rastin konkret, nga e paditura është bërë në mënyrë joligjore dhe, me të drejtë, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se paditësja gëzon të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës te e paditura, duke filluar prej 4.2.2004, e deri te kthimi në punë dhe në detyra të mëparshme të punës".

35. Më 10 qershor 2010, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, pas revizionit të ushtruar nga KS "Kosova e re", me Aktgjykimin Rev. nr. 308/2007, aprovoi si të bazuar revizionin dhe vendosi të ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 234/2005, e 29 marsit 2007, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C1. n3. 31/2004, e 29 shtatorit 2004.

36. Gjykata Supreme, ndër të tjera, konstatoi:

"Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se, gjykatat e instancës më të ulët, drejt dhe në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike që ka të bëjë me faktet vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, por, në bazë të gjendjes së tillë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar. Kjo, ngase paditëses, me kontratën e fundit të cilën e ka nënshkruar personalisht, iu ka vazhduar marrëdhënia e punës me kohë të caktuar prej 1.1.2004 gjer më 31.1.2004, e cila skadon me kalimin e kohës së caktuar, sipas dispozitës së nenit 11.1 (d) të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë. E paditura, në bazë të dispozitës së nenit 11.5 (a) të ligjit të lartpërmendur, ka njoftuar me shkrim nr. 9, të 3.2.2004, paditësen për shkëputjen e kontratës, ashtu që vlerësimi i gjykatave të instancës më të ulët, se kontrata e punës me kohë të caktuar për periudhën prej datës 1.1.2004 gjer më 31.1.2004, është i kundërligjshëm, sipas vlerësimit të kësaj gjykate është i pabazuar.

Qëndrimi juridik i gjykatave të instancës më të ulët se paditëses është dashur t'i vazhdohet kontrata e punës meqë vendi i punës në të cilin ajo ka punuar ekziston sipas akteve normative të të padituës, sipas vlerësimit të kësaj gjykate është në kundërshtim me dispozitat e ligjit të lartpërmendur, duke pasur parasysh që kontrata për vazhdimin e marrëdhënies së punës mund të lidhet me pëlqimin e punëdhënësit dhe punonjësit, nëse nuk është në kundërshtim me ligjin dhe me aktet normative, prandaj paditëses i është shkëputur kontrata e punës me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit".

37. Më 8 nëntor 2010, parashtruesja i dorëzoi një letër të hapur Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (në tekstin e mëtejmë: EULEX), ku pretendohet shkelja e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, para së gjithash e drejta për trajtim të barabartë.

38. Parashtruesja thekson si në vijim: *"Para meje kam tri aktgjykime: Rev. nr. 126/2007, Rev. nr. 177/2007 dhe Rev. nr. 308/2007. Ky i fundit është revizioni i lëndës sime. Dy revizionet e lartpërmendura dhe 3-4 të tjerë të ish-kolegëve janë gjykuar në Gjykatën Supreme të Kosovës në dobi të ish-kolegëve të mi dhe e paditura Kompania e sigurimit 'Kosova e re' është detyruar t'i kthejë ata në punë dhe t'ua kompensojë dëmin material që ua ka shkaktuar. Arsyetimi në të dy aktgjykimet e revizioneve të lartpërmendura është i plotë dhe vërteton drejtësinë e aktgjykimeve të instancave të tjera gjyqësore të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë. Krejt e kundërta ndodh në aktgjykimin e revizionit të*

lëndës sime që është jogjithëpërfshirës, i paplotë, i cunguar dhe që i mungojnë elementet relevante".

[...]

39. Parashtruesja, me tej, vazhdon: "Me dispozitat e nenit 11 dhe nenit 12 të Ligjit Themelor të Punës dhe të neneve 89-95 të Marrëveshjes kolektive, për marrëdhëniet e punës së të paditurës janë caktuar bazat juridike për shuarjen e punësimit, por nga shkresat e lëndës nuk rezulton se është përmbushur ndonjë nga bazat ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, prandaj njoftimi i të paditurës, me të cilin paditësit iu ka bërë me dije mosvazhdimi i kontratës nuk mund të jetë me ndikim ligjor në shuarjen e marrëdhënies së punës të paditëses. Pikërisht kjo i mungon arsyetimit në aktgjykimin e revizionit tim".

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

40. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. nr. 308/2007, e 10 qershorit 2010, e ka vënë atë në pozitë të pabarabartë *vis-a-vis* ish-kolegëve, të cilët kanë qenë në situatë të njëjtë me të, gjegjësisht që kanë pasur statusin e punësimit të përhershëm në kompaninë e njëjtë dhe kanë fituar rastin në Gjykatën Supreme, më pas janë kthyer në vendet e tyre të mëparshme të punës.

41. Parashtruesja e kërkesës argumenton se vetëm në rastin e saj është vendosur ndryshe në Gjykatën Supreme, dhe kështu ajo ka rënë viktimë e padrejtësisë dhe e diskriminimit. Fillimisht, ajo i ka bashkangjitur kërkesës së saj dy aktgjykimet e Gjykatës Supreme, të dyja janë nxjerrë më 17 janar 2008 (Rev. nr. 126/2007 dhe Rev. nr. 177/2007), të cilat kanë të bëjnë me dy ish-kolegët e saj, me ç'rast, në parashtresën e saj me shkrim të 26 shtatorit 2011, parashtruesja i kishte përmendur emrat e 6 ish-kolegëve të saj që e kishin fituar rastin në Gjykatën Supreme (duke përfshirë emrat e dy kolegëve, aktgjykimet e të cilëve tashmë i ka dorëzuar).

42. Parashtruesja pretendon shkelje të nenit 3.2 [Barazia para Ligjit] dhe shkelje të nenit 24.1 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

Dispozita të rëndësishme ligjore

Dispozita të rëndësishme të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2001/27, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë

Neni 10, Kontrata e punës:

10.1 Kontrata e punës mund të lidhet:

(a) për një kohë të pacaktuar ose

(b) për një kohë të caktuar.

Neni 11, Shkëputja e kontratës së punës:

11.1 Kontrata e punës shkëputet:

(a) me rastin e vdekjes së punonjësit;

(b) me marrëveshje me shkrim ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit;

(c) në rastet e rënda të sjelljes së keqe nga punonjësit;

(ç) për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga ana e punonjësit;

(d) me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit; dhe

(dh) sipas fuqisë ligjore.

11.2 Kontrata e punës shkëputet nga punëdhënësi në rastet e rënda të sjelljes së keqe ose të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga punonjësi.

11.5 Në rastet kur zbatohet neni 11.2:

(a) punëdhënësi do ta njoftojë punonjësin me shkrim për qëllimin e tij për ta ndërprerë kontratën e punës. Ai njoftim përfshin edhe shkaqet për shkëputjen e kontratës së punës; dhe

(b) punëdhënësi do ta mbajë një takim me punonjësin me ç'rast punëdhënësi ia shpjegon me gojë punonjësit shkaqet e shkëputjes së kontratës. Në rast se punonjësi është anëtar i ndonjë sindikate, ka të drejtë që në atë takim të jetë i pranishëm edhe një përfaqësues i sindikatës.

Neni 12, Shkëputja e kontratës së punës për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale në ndërmarrje:

12.1 Kontrata e punës mund të shkëputet nga punëdhënësi për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale në ndërmarrje. Ndryshimet e tilla paraqesin rastet kur punëdhënësi bën ndryshime në prodhim, në programim, në organizim, në strukturë dhe në teknologji, të cilat kërkojnë zvogëlim të numrit të punonjësve. Në rastet kur për këtë arsye largohen nga puna të paktën 50 punonjës konsiderohet se largimi nga puna është i shkallës së gjerë.

Dispozita të rëndësishme të Marrëveshjes kolektive me KS "Kosova e re", nr. 686, e 7 tetorit 2002

"Neni 1

Me këtë marrëveshje përcaktohen të drejtat dhe detyrimet në mes të Kompanisë së sigurimeve 'Kosova e re', me seli në Prishtinë, në tekstin e mëtejmë punëdhënësi, dhe të të punësuarve të kësaj kompanie në pajtim me ligjin, me Marrëveshjen kolektive në nivel të Kosovës, në nivel të sektorit dhe të akteve të tjera juridike.

Neni 2
Të drejtat dhe detyrimet e tjera, të cilat nuk janë përfshirë me këtë marrëveshje, realizohen në bazë të ligjit dhe marrëveshjeve të tjera kolektive.

[...]

Neni 15

Marrëdhënia e punës mund të themelohet, me kohë të pacaktuar dhe me kohë të caktuar.

Neni 16

Marrëdhënia e punës me kohë të caktuar mund të themelohet në këto raste:

- të zëvendësimit të të punësuarit, i cili mungon nga puna;

- të rritjes së përkohshme të vëllimit të punës;

- për praktikantët në kohë të caktuar;

[...]

Neni 103

Kjo kontratë do të jetë në fuqi tri vjet.

Neni 104

Kjo marrëveshje hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit dhe regjistrimit të saj".

Dispozita të rëndësishme të Tenderit të BPK-së

IV. "BPK-ja parasheh që kompania ofertuese e suksesshme do të bëjë transferin punësuarve të kompanisë në Kompaninë 'Kosova e re'".

Vlerësimi

43. Në mënyrë që të jetë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtrueses, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje me Ligj dhe me Rregullore të punës të Gjykatës.

44. Gjykata, po ashtu, duhet të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në Gjykatë, në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës. Parashtruesja është person fizik dhe është palë e autorizuar, në përputhje me kërkesat e nenit 113.7 (Kërkesat individuale) të Kushtetutës.

45. Gjykata, po ashtu, duhet të përcaktojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kërkesat e shterjes së mjeteve juridike vendëse, të përcaktuara me nenin 113.7 dhe me nenin 47.2 të Ligjit, që thotë: "[.. .] *Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*".

46. Përkitazi me këtë, Gjykata dëshiron t'i referohet Rastit KI41/09, të vetë kësaj gjykate, ku thuhet:

"Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi mbi kërkesën e shterimit, siç është interpretuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih nenin 53 të Kushtetutës), është që t'ju ofrojnë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se korniza ligjore e Kosovës do të sigurojë mjete efektive për mbrojte nga shkelja e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i

karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih, mutatis mutandis, ECHR, Selmouni v. France, nr. 25803/94, Vendim i datës 28 korrik 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të ceken në mënyrë eksplicite gjatë procedurës në fjalë. Derisa kjo çështje është cekur në mënyrë absolute ose substanciale, kërkesa mbi shterimin e mjeteve është plotësuar (Shih, mutatis mutandis, ECHR, Azinass v. Cyprus, nr. 56679/00, Vendimi i datës 28 prill 2004)".

Për sa i përket kësaj, Gjykata dëshiron të theksojë se parashtruesve të kërkesës ju kërkohet që të shterin vetëm mjetet juridike, të cilat janë efektive dhe në dispozicion. Mjetet diskrecionale ose te jashtëzakonshme nuk duhet të shteren, për shembull të kërkosh nga gjykata që të rishqyrtojë aktvendimin e saj (Shih, mutatis mutandis, ECHR, Cinar v. Turkey, nr. 28602/95, Vendimi i datës 13 nëntor 2003).

Kur parashtruesi i kërkesës ka provuar një prej mjeteve juridike, të cilin Gjykata e konsideron si të papërshtatshëm, kohëzgjatja e veprimit nuk e ndërpret rrjedhën e afatit kohor katërmuajsh (neni 49, Afatet, i Ligjit), e cila mund të rezultojë në refuzimin e kërkesës si jashtë afatit (Shih, mutatis mutandis, ECHR, Prystavka, Rezgui v. France, nr. 49859/99, Vendimi i datës 7 nëntor 2000).

47. Në këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesja e konteston aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin kjo e fundit lejoi reviziononinin e parashtruar nga "Kosova e re" kundër aktgjykimeve të gjykatave të instancave më të ulët. Dhe, në mungesë të ndonjë mjeti tjetër të disponueshëm ligjor, në rrethanat e këtij rasti, Gjykata konkludon se parashtruesja e ka plotësuar kushtin e shterimit të mjeteve.

48. Po ashtu, pasi kërkesa është qartazi e bazuar, Gjykata Kushtetuese vendos se kërkesa e parashtrueses është e pranueshme.

Meritat

49. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi Rev. nr. 308/2007 i Gjykatës Supreme, i 10 qershorit 2012, shkel të drejtat e saj, që janë shkelje të drejtave të njeriut, të garantuara me nenin 3.2 [Barazia para Ligjit] dhe me nenin 24.1 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

50. Përkitazi me të drejtat e kërkuara nga parashtruesja, Gjykata rikujton se "*është autoriteti përfundimtar për karakterizimin që do të jepet në ligjin përkitazi me faktet e rastit dhe nuk është i lidhur me*

karakterizimin dhënë një parashtruesi ose një qeverie. Një ankesë është e karakterizuar nga faktet e pretenduara në të dhe jo thjesht nga bazat ligjore apo argumentet në të cilat mbështetet". (*Shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së në Rastin Ştefanica dhe të tjerët kundër Rumanisë, i 2 nëntorit 2010, para. 23*).

51. Prandaj, Gjykata do të analizojë ankesat e parashtrueses së kërkesës sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së [E Drejta për Proces të Drejtë]; sipas nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit]; dhe sipas nenit 6.1 të KEDNJ-së.

Praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme sa i përket ish-kolegëve të parashtrueses

52. Parashtruesja e kërkesës argumenton se të gjithë ish-kolegët e saj të punës, që kishin qenë në të njëjtën pozitë, kishin fituar rastet e tyre në Gjykatën Supreme dhe se, rrjedhimisht, ajo ishte viktimë e diskriminimit.

53. Në këtë drejtim, Gjykata, më 7 dhjetor 2012, i pranoi kopjet e vërtetuara të gjashtë aktgjykimeve të Gjykatës Supreme. Tri aktgjykimet e para janë marrë më 17 janar 2010 (Rev. nr. 126/2007, Rev. nr. 177/2007 dhe Rev. nr. 183/2007); një aktgjykim është marrë më 28 janar 2008 (Rev. nr. 180/2006); aktgjykimi i pestë është marrë në rastin e parashtrueses më 10 qershor 2010 (Rev. nr. 308/2007); dhe, i gjashti, është marrë më 7 shkurt 2011 (Rev. nr. 154/2008), gjegjësisht 7 muaj pas aktgjykimit të rastit të parashtrueses.

54. Gjykata vëren se, në të gjitha rastet para Gjykatës Supreme, pala e paditur ka qenë e njëjtë, respektivisht "Kosova e re", porse Gjykata Supreme konsideronte se objekti i çështjes, në rastin e parashtrueses, ishte tjetër nga rastet e kolegëve të saj.

55. Kështu që, përderisa në rastet e ish-kolegëve të parashtrueses së kërkesës Gjykata Supreme kishte cilësuar si objekt të çështjes konfirmimin e statusit të punësimit të përhershëm dhe kthimit të tyre në vendet e punës në "Kosova e re", në rastin e parashtrueses Gjykata Supreme konsideroi se objekti i çështjes kishte të bënte me vazhdimin e kontratës së saj me "Kosova e re".

56. Gjykata, gjithashtu, vëren se në pjesën operative të aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, në rastin e ish-kolegëve të parashtrueses, thuhet:

"Refuzohet si i pabazuar revizioni i të pandehurit, parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë...".

57. Gjykata, më tej, vëren se arsyetimet e Gjykatës Supreme, të dhëna në këto raste, në thelb janë të njëjta dhe konsideron se është me rëndësi të citohet, si shembull, një pjesë e rëndësishme e aktgjykimit të Gjykatës Supreme, i marrë më 7 shkurt 2011 (Rev. nr. 54/2008), gjegjësisht 7 muaj pas aktgjykimit në rastin e parashtrueses së kërkesës:

"Për faktin se punët të cilat i ka kryer paditësja në vendin e punës në të cilin është sistematizuar nuk janë të natyrës së përkohshme apo të kohëpaskohshme, por të natyrës së përhershme, rezulton se paditësja ka themeluar marrëdhënie të punës me kohë të pacaktuar. Ky lloj i marrëdhënies së punës është themeluar në pajtim me dispozitën e nenit 10.1, pika (a), e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2001/27, për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë dhe me nenin 15 të Marrëveshjes kolektive, të të padituës, për marrëdhëniet e punës, sepse sipas dispozitës së nenit 16 të kësaj rregulloreje marrëdhënia e punës me kohë të caktuar mund të themelohet në këto raste: të zëvendësimit të punëtorit i cili mungon nga puna, të rritjes së përkohshme të vëllimit te punës, të praktikantit, dhe në rastet e tjera të parapara me ligj dhe me marrëveshje kolektive. Përkundër faktit se e paditura, me kontratat e sipërpërmendura, i ka vazhduar paditëses marrëdhënien e punës për kohë të caktuar, gjykatat e instancës më të ulët kanë konkluduar drejt se kontratat e tilla janë në kundërshtim me dispozitat c sipërpërmendura ligjore, ngase detyrat nga vendi i punës kanë qenë të natyrës së përhershme dhe se një kontratë e tillë është në kundërshtim jo vetëm me dispozitat e përmendura juridike, por edhe me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë - bona fide, kur katër vjet vazhdimisht paditësja mbahet në një gjendje pasigurie juridike, prandaj gjykatat e instancës më të ulët kanë konkluduar drejt se paditësja ka statusin e marrëdhënies së punës me kohë të pacaktuar.

Me dispozitat e nenit 11 dhe të nenit 12 të ligjit të përmendur të punës dhe të neneve 89-95 të Marrëveshjes kolektive mbi marrëdhëniet e punës së të padituës janë caktuar bazat juridike për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, por nga shkresat e lëndës nuk rezulton se është përmbushur ndonjë nga bazat ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, prandaj njoftimi i të padituës me të cilën paditëses iu ka bërë me dije mosvazhdimi i kontratës nuk mund të jetë me ndikim ligjor në ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditëses".

Sa i përket nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

58. Parashtruesja i ka shprehur ankesat e saj sipas Kushtetutës dhe KEDNJ-së, si në vijim: *"Arsyetimi në të dy aktgjykimet për revizionin e lartpërmendur është i plotë dhe konfirmon drejtësinë e aktgjykimeve të gjykatave të instancave më të ulëta. Megjithatë, e kundërta ndodh vetëm në gjykimin e revizionit në rastin tim, që është ekskluzive, e njëanshme dhe që i mungojnë elementet e rëndësishme".*

59. Parashtruesja pohon se Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtat e saj, pasi që, në rastin e saj, mori aktgjykim, i cili ishte i ndryshëm nga aktgjykimet e nxjerra nga e njëjta Gjykatë, në rastet e ish-kolegëve të saj, të cilët e paditën të njëjtën të paditur ("Kosova e re") dhe se objekti i çështjes së kërkesave të tyre ishte i njëjtë (konfirmimi i statusit të tyre të përhershëm të punës).

60. Përkitazi me këtë, Gjykata thirret në dispozitat vijuese ligjore:

Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës:

"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës parasheh si në vijim:

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike".

Dhe, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut parasheh:

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, ... nga një gjykatë ...në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij...".

61. Gjykata Kushtetuese përsërit se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si një gjykatë e apelit, apo gjykatë e instancës së katërt, sa i përket vendimeve të marra nga gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe Gjykatën Supreme. Në përgjithësi, *"Gjykatat gjykojnë në bazë në Kushtetutës dhe ligjit" (Neni 102 i Kushtetutës).* Më saktësisht, është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis*

mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ], 1999-1).

Parimet e përgjithshme përkitazi me vendimet gjyqësore kundërthënëse

62. Për të kuptuar më mirë këto parime të përgjithshme, Gjykata i referohet aktgjykimit të kohëve të fundit, të Dhomës së Madhe, në rastin e Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë ([GC], nr. 13279/05, 20 tetor 2011), ku GJEDNJ-ja përsëriti parimet kryesore, të zbatueshme në rastet kur ka vendime gjyqësore kundërthënëse. Këto mund të përmblidhen si më poshtë:

"(i) Nuk është detyrë e gjykatës që të trajtojë gabimet e fakteve apo të ligjit, që pretendohen të jenë kryer nga gjykatat vendëse, përpos nëse dhe përderisa nuk i shkel të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Konventë (Shih, Garcia Ruiz v. Spain [GC], nr. 30544/96, para. 28, GJEDNJ, 1999-1). Gjithashtu, nuk është funksioni i saj, përveç në rast të arbitraritetit të qartë, të krahasojë vendimet e ndryshme të gjykatave vendëse, madje edhe nëse merren në procedurë në dukje të ngjashme, pasi pavarësia e këtyre gjykatave duhet të respektohet (Shih, Ādamsons v. Letonisë, nr. 3669/03, *§ 118, 24 qershor 2008);*
(ii) Mundësia e vendimeve gjyqësore në konflikt është një tipar i natyrshëm i çdo sistemi gjyqësor, i cili është bazuar në një rrjet gjyqësor dhe gjykatave të apelit me autoritet mbi fushën e juridiksionit të tyre territorial. Divergjenca të tilla gjithashtu mund të lindin brenda të njëjtës gjykatë. Kjo, në vetvete, nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me Konventën (Shih, Santos Pinto kundër Portugalisë, nr. 39005/04, *paragrafi 41, 20 maj 2008, dhe Tudor Tudor, cituar më lart, paragraqfi 29).;*
(iii) Kriteret që udhëheqin vlerësimin e Gjykatës së kushteve në të cilat vendimet kontradiktore të gjykatave të ndryshme të brendshme që vendosin në instancën e fundit janë në shkelje të kërkesave të gjykimit të drejtë të parashikuara në nenin 6, paragrafi 1, të Konventës konsistojnë në vendosjen nëse '*dallimet e thella dhe në kohë të gjatë' ekzistojnë në praktikën gjyqësore të gjykatave vendëse, nëse ligji vendës parashikon makineri për tejkalimin e këtyre mospërputhjeve, nëse kjo makineri është zbatuar dhe, nëse është e nevojshme, deri në çfarë ndikimi (Shih, Iordan Iordanov dhe të tjerë, cituar më lart, paragrafët 49 e 50; Shih, gjithashtu, Beian* (*nr. 1), cituar më lart, paragrafët 34 e 40; Stefan dhe Stef v Rumani, nr.* 24428/03 *dhe nr.* 26977/03, *paragrafët 33 e 36, 27 janar 2009; Schwarzkopf dhe Taussik, cituar më lart, 2 dhjetor 2008; Tudor Tudor, cituar më lart, paragrafi 31, dhe Ştefănică dhe të tjerë, cituar më lart, paragrafi 36);*

(iv) Vlerësimi i Gjykatës gjithashtu ka qenë gjithmonë i bazuar në parimin e sigurisë juridike e cila është e nënkuptuar në të gjitha nenet e Konventës dhe përbën një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit (shih, ndër autoritetet tjera, Beian (nr. 1), cituar më lart, paragrafi 39; Iordan Iordanov dhe të tjerë, cituar më lart, § 47, dhe Ştefănică dhe të tjerë, cituar më lart, paragrafi 31);
(v) Parimi i sigurisë juridike, garanton, ndër të tjera, një stabilitet të caktuar në situata ligjore dhe kontribuon në besimin e publikut në gjykata. Qëndrueshmëria e vendimeve gjyqësore në konflikt, nga ana tjetër, mund të krijojë një gjendje të paqartësisë ligjore dhe ka të ngjarë të zvogëlojë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, ndërsa besimi i tillë qartë është një nga komponentet thelbësore të një shteti të bazuar në sundimin e ligjit (Shih, Paduraru v Rumanisë, paragrafi 98, nr. 63252/00, KEDNJ 2005-XII (ekstrakte); Vinčić dhe të tjerët kundër Serbisë, nr. 44698/06, paragrafi 56, 1 dhjetor 2009; dhe Ştefănică dhe të tjerët, të cituar më lart, paragrafi 38);
(vi) Megjithatë, kërkesat e sigurisë ligjore dhe të ruajtjes së besimit legjitim të publikut nuk ofrojnë një të drejtë të fituar në konsistencën e praktikës gjyqësore (Shih. Unédic kundër Francës, nr. 20153/04, paragrafi 74, 18 dhjetor 2008). Zhvillimi i praktikës gjyqësore nuk është, në vetvete, në kundërshtim me administrimin e duhur të drejtësisë, pasi që dështimi për të mbajtur një qëndrim dinamik dhe zhvillues do të rrezikonte për të penguar reformën apo përmirësimin (Shih, Atanasovski v "ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë", nr. 36.815 /03, paragrafi 38, 14 janar 2010)".

Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rastin e tanishëm

63. Në mënyrë që të zbatojë testin nga aktgjykimi i GJEDNJ-së, i cekur më lart në vendimin e Gjykatës Supreme për rastin e parashtrueses së kërkesës dhe atyre të lëshuara në pesë rastet e tjera identike me rastin e parashtrueses, Gjykata duhet të analizojë nëse, në rastin e parashtrueses së kërkesës, Gjykata Supreme ka dhënë arsye të mjaftueshme për refuzimin e argumenteve të parashtrueses, ose nëse aktgjykimi i saj tregon "arbitraritet të dukshëm".

64. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet praktikës së vet gjyqësore, tashmë të vendosur mirë përkitazi me detyrimet e gjykatave të rregullta për të ofruar arsye për aktgjykimet e tyre, për shembull në rastin e saj, "KEK, Aktgjykimi i I-rë", si dhe në aktgjykimin e saj të kohëve të fundit, të miratuar më 7 dhjetor 2012, në Rastin KI72/12, Veton Berisha dhe Ifete Haziri, Vlerësim i kushtetutash,ërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 1053/2008, të 31 majit 2012, ku Gjykata konstatoi

shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

65. Në Aktgjykimin e vet të I-rë të KEK-ut, Gjykata kujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, si në vijim:

"Neni 6.1 i KEDNJ-së i obligon gjykatat të japin arsye për aktgjykimet e tyre. Megjithatë, kjo nuk nënkupton të kërkuarit e përgjigjes së detajuar në çdo argument apo pyetje. Masa, deri në të cilën aplikohet obligimi për të dhënë arsye, mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit. Për më tepër, është e nevojshme të merret parasysh, inter alia, shumëllojshmëria e parashtresave që pala mund të sjellë para gjykatave dhe dallimet që ekzistojnë në Shtetet Kontraktuese në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, opinionin ligjor dhe prezantimin dhe hartimin e aktgjykimeve. Kështu, çështja nëse një gjykatë ka dështuar të përmbushë detyrimin të japë arsyet, që kërkohen nga neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm në dritën e rrethanave të rastit (Shih, Ruiz Torija kundër Spanjës, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, Seria A, nr. 303-*A, paragrafi 29).*

66. Në Rastin KI72/12, Veton Berisha dhe Ifete Haziri, Gjykata theksoi më tej: *"GJEDNJ-ja konsideron se, derisa autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar se sistemet e tyre gjyqësore janë në përputhje me kërkesat e nenit 6(1) të Konventës, gjykatat e tyre duhet 't'i tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazat mbi të cilat e kishin bazuar vendimin e tyre'". (Shih, Hadjianastassiou vs. Greqisë, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33)· Në një aktgjykim të kohëve të fundit, GJEDNJ-ja përsëriti se "aktgjykimet e gjykatave dhe të tribunaleve duhet t'i theksojnë në mënyrë adekuate arsyet në të cilat ata bazohen". (Shih, Tatishvili vs. Rusisë, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58).*

67. Rrjedhimisht, nëse parashtresa është thelbësore për rezultatin e rastit, siç është në ketë rast – statusi i përhershëm i punësimit të parashtrueses së kërkesës, gjykata pastaj duhet të merret posaçërisht me të në gjykimin e saj.

68. Në Rastin KI 72/12, Veton Berisha dhe Ifete Haziri, Gjykata theksoi më tej: *"Në rastin Hiro Balani vs. Spanjës, parashtruesi kishte paraqitur parashtresë në gjykatë, me të cilën kërkonte përgjigje të veçantë dhe të qartë. Gjykata dështoi ta japë atë përgjigje, duke e bërë të pamundur*

konstatimin se nëse ajo thjesht e kishte lënë pas dore të merrej me çështjen, ose e kishte ndërmend ta refuzonte dhe, nëse është ashtu, cilat ishin arsyet për refuzimin e saj. Nga GJEDNJ-ja u gjet se kjo ishte shkelje e nenit 6 (1) të Konventës. Rrjedhimisht, deklarata e arsyeve duhet t'i mundësojë personit, të cilit i drejtohet vendimi dhe opinionit në përgjithësi, për ta ndjekur arsyetimin, i cili e çoi gjykatën të marrë vendimin konkret. Prandaj, arsyetimi i vendimit duhet ta theksojë raportin ndërmjet gjetjeve të meritave dhe reflektimit, kur t'i shqyrtojë provat e propozuara nga një anë dhe konkluzionet ligjore nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do ta shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, nëse arsyetimi i dhënë dështon të përmbajë fakte të vërtetuara dhe dispozita ligjore si dhe marrëdhënien logjike ndërmjet tyre".

69. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës kërkoi nga gjykatat e rregullta ta konfirmojnë statusin e saj të përhershëm të punësimit në të njëjtën mënyrë siç kanë vepruar në rastet e ish-kolegëve të saj. Ajo iu referua, në veçanti, dispozitave të Marrëveshjes kolektive në fuqi, përkitazi me statusin e saj të punësimit, si dhe dispozitave përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut për Ligjit Themelor të Punës në Kosovë. Gjithashtu, ajo paraqiti prova se kishte të drejtë të gëzonte të gjitha të drejtat nga statusi i punësimit të përhershëm, siç kishin konfirmuar gjetjet e Inspektoratit të Punës. Sa i përket aktgjykimeve të Gjykatës Supreme në rastet identike të ish-kolegëve të saj, në bazë të fakteve të ngjashme me ato të rastit të parashtrueses, parashtruesja e kërkesës në mënyrë legjitime mund të priste refuzimin e revizionit të iniciuar nga "Kosova e re".

70. Megjithatë, edhe pse Gjykata Supreme, siç shihet nga teksti i aktgjykimit të kontestuar, gjeti se gjykatat e instancës më të ulët kanë konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike për faktet vendimtare për një gjykim të drejtë të rastit, kjo, me sa duket, nuk ka analizuar pretendimin e parashtrueses së kërkesës në të njëjtën mënyrë siç ka vepruar në rastet e ish-kolegëve të saj dhe siç kishte vepruar gjykata e instancës më të ulët në rastin e parashtrueses. Në vend të kësaj, pikëpamja e Gjykatës Supreme, përkundër parashtresave të parashtrueses, si objekt të çështjes në rastin e saj ka konsideruar vazhdimin e kontratës me kohë të caktuar dhe aspak nuk ka marrë parasysh argumentet dhe provat e parashtrueses sa i përket pretendimeve të saj se ka të drejtë për status të përhershëm të punësimit dhe për kthim në vendin e saj të punës.

71. Kështu që, edhe pse parashtruesja në mënyrë të qartë kishte ngritur çështjen e statusit të përhershëm të punësimit në po të njëjtën mënyrë si

edhe ish-kolegët e saj para Gjykatës Supreme, Gjykata Supreme e konsideroi ankesën e saj vetëm si çështje të vazhdimit të kontratës.

72. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme, në aktgjykimin për rastin e parashtrueses së kërkesës, vendosi ndryshe nga rastet e tjera identike të ish-kolegëve të parashtrueses. Në vend të gjetjeve të atyre rasteve se gjykatat e instancave më të ulëta *"kanë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar",* në rastin e parashtrueses, Gjykata Supreme gjeti se gjykatat e instancave më të ulëta "*gabimisht kishin zbatuar të drejtën materiale kur gjetën se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar".*

73. Gjykata Supreme, më tej, konstatoi: "*Qëndrimi juridik i gjykatave të instancës më të ulët se paditëses është dashur t'i vazhdohet kontrata e punës meqë vendi i punës në të cilin ajo ka punuar ekziston sipas akteve normative të të padituës, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, është në kundërshtim me dispozitat e ligjit të lartpërmendur, duke pasur parasysh që kontrata për vazhdimin e marrëdhënies së punës mund të lidhet me pëlqimin e punëdhënësit dhe të punonjësit, nëse nuk është në kundërshtim me ligjin dhe me aktet normative, prandaj paditëses i është shkëputur kontrata e punës me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit".*

74. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të vendosë se cila do të ishte mënyra më e përshtatshme për Gjykatën Supreme që të merrej me argumentet e parashtrueses përkitazi me statusin e saj të punësimit të përhershëm në bazë të marrëveshjes së përmendur kolektive dhe ligjit në fuqi.

75. Megjithatë, sipas opinionit të Gjykatës Kushtetuese, aktgjykimi i Gjykatës Supreme, duke neglizhuar vlerësimin e duhur të argumenteve të parashtrueses përkitazi me statusin e përhershëm të punësimit, edhe pse ato ishin specifike, relevante dhe të rëndësishme, nuk i plotësoi detyrimet e Gjykatës Supreme sipas nenit 6.1 të KEDNJ-së për të plotësuar detyrimet e cekjes së arsyeve (*Shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Aktgjykimi i 18 korrikut 2006, në rastin Pronina kundër Ukrainës, Kërkesa nr.* 63566/*00; Shih, gjithashtu, Aktgjykimin e Gjykatës në Rastin Nr. KI*40/*09, Imer Ibrahimi dhe 48 punonjës të tjerë të KEK-ut, gjegjësisht "Aktgjykimi i KEK-ut"*).

76. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, në Aktgjykimin Rev. nr. 154/2008, e 7 shkurtit 2011, gjegjësisht 7 muaj pas aktvendimit të saj

në rastin e parashtrueses, nuk përsëriti gjetjet e veta në rastin e parashtrueses, por përsëri vendosi në po të njëjtën mënyrë, siç kishte vepruar në katër rastet para rastit të parashtrueses së kërkesës, duke konsideruar konfirmimin e statusit të përhershëm të punësimit si objekt të çështjes së kontesteve dhe duke përdorur arsyetime të ngjashme voluminoze dhe të detajuara për të refuzuar revizionin e paraqitur nga "Kosova e re".

77. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese gjen se Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë të dukshme arbitrare në rastin e parashtrueses së kërkesës, në kundërshtim me parimet e shtjelluara nga GJEDNJ-ja në aktgjykimin e vet, të përmendur më lart, në rastin *Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë* [GC], nr. 13279/05, 20 tetor 2011.

78. Prandaj, Gjykata konkludon se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

Sa i përket shkeljeve të pretenduara të nenit 3.2 dhe të nenit 24.1 të Kushtetutës

79. Gjykata vëren se parashtruesja, po ashtu, ka argumentuar që Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. nr. 308/2007, e 10 qershorit 2010, e ka vendosur atë në një pozitë të pabarabartë *vis-a-vis* ish-kolegëve të saj. Po ashtu, parashtruesja pretendon shkelje të nenit 3.2 [Barazia para Ligjit] dhe të nenit 24.1 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

80. Për sa u përket gjetjeve të cekura më lart, përkitazi me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata konsideron se nuk është e nevojshme të vazhdohet me analizimin e kësaj ankese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në seancën e saj të mbajtur më 29 janar 2013, me shumicë votash:

I. SHPALL kërkesën të pranueshme;

II. KONSTATON se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. SHPALL të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 308/2007, e 10 qershorit 2010;

IV. KTHEN Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për rivendosje, në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese;

V. MBETET e përkushtuar ndaj çështjes, në pritje të respektimit të këtij urdhri;

VI. URDHËRON që ky aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;

VII. DEKLARON se ky aktgjykim është efektiv menjëherë.

Gjyqtari raportues
Prof. dr. Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

Rasti nr. KI 120/10
Parashtruesja
Zyma Berisha
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. 308/2007, të datës 10 qershor 2010

MENDIMI MOSPAJTUES I GJYQTARIT

Robert Carolan

Kërkesa

Parashtruesja, në kërkesën e saj, pretendon që Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me aktgjykimin Rev. Nr. 308/2007 të datës 10 qershor 2010, ka shkelur parimin e barazisë para ligjit, të garantuar me Nenin 24, paragrafi 1 të Kushtetutës.

Në mbështetje të pretendimit të saj, parashtruesja thekson që aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës dallon nga aktgjykimet e Gjykatës Supreme në pesë raste të tjera (Aktgjykimi Rev. Nr. 126/2007 i datës 17 janar 2008, si dhe aktgjykimi Rev. Nr. 177/2007 i datës 17 janar 2008, si dhe tre të tjerë). Parashtruesja pretendon që gjendja e saj është identike me atë të palëve në ato raste të tjera.

Faktet

Faktet e këtij rasti kanë të bëjnë me parashtruesen, e cila ka qenë e punësuar qysh prej vitit 1986 në kompaninë e sigurimeve "Kosova", me kontratë punësimi me kohëzgjatje të pacaktuar. Në vitin 2000, kjo kompani u riorganizua, ose ndryshe u transferuan pasuritë dhe detyrimet e saj, te një kompani e re sigurimesh e quajtur "Kosova e Re". Pjesë e kësaj bartjeje ishin edhe anëtarët e personelit të kompanisë së vjetër, ashtu siç ishte përcaktuar me marrëveshjen e transferit në mes të dy kompanive.

Parashtruesja kishte vazhduar punën me kompaninë e re të sigurimeve, por në baza të një numri kontratash me afat të caktuar. Edhe funksionet e saj brenda kompanisë kishin ndryshuar, nga të qenit përkthyese në funksione të tjera. Fillimisht, kishte marrë kontratë punësimi me kompaninë "Kosova e Re", me kohëzgjatje të pacaktuar. Vijimisht, kishte nënshkruar kontrata me afat të caktuar. Kjo situatë vazhdoi derisa parashtruesja mori njoftimin për ndërprerjen e punësimit të saj më 4 shkurt 2004.

Parashtruesja thekson që ka ekzistuar më herët një Marrëveshje Kolektive (nr. 686 e 7 tetorit 2002) mes punëdhënësit fillestar dhe personelit të kompanisë

së sigurimeve "Kosova", e cila përcaktonte punët që do të mund të konsideroheshin ekskluzivisht si «punësim me afat të pakufizuar». Pohohet që kjo Marrëveshje Kolektive ishte pjesë e transferimit të aseteve dhe detyrimeve nga kompania e vjetër te kompania e re "Kosova e Re". Parashtruesja pohon që ajo kishte pranuar t'i nënshkruante në vazhdimësi kontratat me afat të caktuar nën presion, pasi që donte të vazhdonte punësimin dhe kishte nevojë për të ardhura. Ajo pretendon që priste gjithmonë nga kompania "Kosova e Re" që të njihte të drejtën e saj për kontratë me afat të pacaktuar, sipas dispozitave të Marrëveshjes Kolektive.

Pas shkarkimit të saj përfundimtar më 2004, parashtruesja kishte iniciuar procedurën në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar që Gjykata ta obligonte kompaninë "Kosova e Re" që ta rikthente atë si punëtore me kontratë me afat të pakufizuar. Kjo gjykatë, me aktgjykimin C1. Nr. 31/03, të datës 20 shtator 2004, kishte vendosur që Marrëveshja Kolektive ishte obligative për kompaninë "Kosova e Re", si dhe në bazë të ligjit të punës në fuqi, kjo kompani ishte e obliguar ta rikthente parashtruesen në vendin e punës. Kompania e paditur "Kosova e Re" u ankua në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e cila me aktgjykimin Ac. Nr. 234/2005, të datës 29 mars 2007, vërtetoi gjetjet dhe vendimin e Gjykatës Komunale.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme

Vijimisht, kompania e paditur "Kosova e Re" parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar që Gjykata e Qarkut gabimisht kishte zbatuar të drejtën materiale. Gjykata Supreme, me aktgjykimin e saj Rev. Nr. 308/2007, të datës 10 qershor 2010, e shpalli revizionin të bazuar. Gjykata Supreme vendosi që *"gjykatat e shkallës më të ulët e kanë vlerësuar drejt dhe plotësisht gjendjen faktike në lidhje me faktet vendimtare për gjykimin e drejtë të rastit, por në bazë të kësaj gjendjeje, [...] kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale duke vendosur që kërkesë-padia ishte e bazuar."* Veçanërisht, Gjykata Supreme arsyetonte që:

> *"Qëndrimi juridik i gjykatave të shkallës më të ulët që paditëses duhej t'i zgjatej kontrata, sepse pozita e saj e punës ekziston në aktet normative të të padituës, për qëndrimin e kësaj gjykate, është me shkelje të dispozitave të ligjit, duke marrë parasysh që kontrata e zgjatur e punësimit mund të nënshkruhet me pëlqimin e punëtorit dhe punëdhënësit, nëse nuk është në kundërshtim me ligjin dhe aktet normative, si dhe kështu, kontrata e punës së paditëses është ndërprerë me përfundimin e kohëzgjatjes së kontratës."*

Nga procedurat e lartpërmendura mund të shihet që gjykatat e shkallës më të ulët i kishin vlerësuar drejt dhe plotësisht faktet e padisë së parashtrueses, ashtu si edhe Gjykata Supreme në revizionin e saj. Dallimi qenësor gjendet tek interpretimi juridik që i jepet statusit të Marrëveshjes Kolektive në lidhje me punësimin në kompanitë përkatëse të sigurimeve "Kosova", si dhe pas transferimit, "Kosova e Re". Në anën tjetër, gjykatat e shkallës më të ulët kishin përcaktuar që kjo Marrëveshje Kolektive ishte obligative për kompaninë "Kosova e Re", si dhe ishte në pajtim me të drejtën materiale, Gjykata Supreme kishte gjetur që palët kishin përfituar nga liria juridike e hyrjes në kontratë, si dhe duket të ketë përcaktuar që Marrëveshja Kolektive ishte në kundërshtim me të drejtën materiale. Ne theksojmë që fraza *"sepse pozita e saj e punës ekziston në aktet normative të të paditurës"* nuk është plotësisht e qartë në atë nëse i referohet apo jo Marrëveshjes Kolektive. Përndryshe, mund t'i referohet thjesht titullit dhe funksioneve të punës, të cilat i ushtronte parashtruesja.

Megjithatë, në cilindo interpretim që i bëhet konkludimit të Gjykatës Supreme, është e qartë që ajo kishte vendosur në bazë të së drejtës materiale në fuqi, që është plotësisht brenda kompetencës së saj. Në fakt, nuk është kompetencë e Gjykatës Kushtetuese që të bëjë konkludimet e veta mbi të drejtën materiale. Në pajtim me jurisprudencën e qartë të Gjykatës Kushtetuese, ajo nuk është gjykatë e shkallës së katërt. Si e tillë, nuk është kompetencë e Gjykatës Kushtetuese që të vërë në pikëpyetje vlerësimin e të drejtës materiale të dhënë nga Gjykata Supreme në gjykimin e rastit të parashtrueses.

Aktgjykimet e mëhershme të Gjykatës Supreme

Parashtruesja iu referohet pesë vendimeve të tjera të Gjykatës Supreme, ku kolegët e saj kanë fituar aktgjykime ndryshe nga aktgjykimi që ajo kishte marrë, si dhe pohon që si rezultat i kësaj, nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë me kolegët e saj. Dy nga këto aktgjykime të Gjykatës Supreme ishin nxjerrë 17 muaj më herët, më 17 janar 2008, nga një kolegj shumë ndryshe i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme[1]. Në ato aktgjykime, ai kolegj i Gjykatës Supreme kishte përcaktuar që:

> *"Në bazë të provave të shqyrtuara, gjykata e shkallës së parë kishte vlerësuar që paditësi, në bazë të kontratës nr. 240, të datës 27.06.2002, kishte hyrë në marrëdhënie pune me të paditurin, kontratë kjo që nuk përcaktonte kohëzgjatjen e punësimit. Për shkak të faktit që detyrat e bartura nga*

paditësja, në pozitën e punës që mbante, nuk janë të natyrës së përkohshme apo sporadike, por janë të përhershme, mund të vlerësohet që paditësja kishte hyrë në marrëdhënie pune për një periudhë të pacaktuar kohore. Ky lloj i marrëdhënieve të punës përcaktohet në pajtim me Nenin 10.1, pika (a) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27 për shpalljen e Ligjit bazë të punës në Kosovë, si dhe Nenin 15 të Marrëveshjes Kolektive të të padituës për marrëdhënie pune, sepse sipas Nenit 16 të kësaj Marrëveshjeje, marrëdhënia e punës me afat të caktuar mund të vendoset vetëm në këto raste: zëvendësimi i një punëtori në mungesë, rritja e përkohshme e intensitetit të aktiviteteve, praktikës, si dhe rastet e tjera të përcaktuara me ligj dhe me marrëveshje kolektive. Përkundër faktit që i padituri kishte zgjatur marrëdhëniet e punës me të padituën sipas kontratave të përmendura më lart, me afat të caktuar, gjykatat e shkallës më të ulët me të drejtë kanë vendosur që ato kontrata janë në kundërshtim me dispozitat e lartpërmendura, sepse detyrat e pozitës së punës janë të natyrës së përhershme, si dhe kontrata e tillë jo vetëm që është me shkelje të dispozitave ligjore, por edhe me shkelje të parimeve të ndërgjegjshmërisë dhe nderit – bona fide, me të cilat paditësja është mbajtur në situatë të pasigurisë juridike, si dhe në vend të saj, është punësuar një punëtor tjetër, dhe kështu, gjykatat e shkallës më të ulët me të drejtë kanë vendosur që paditësja gëzonte statusin e punëtorit me afat të pacaktuar."

Gjykata Supreme e Kosovës, në dy aktgjykimet e tjera të nxjerra më 17 janar 2008, ku punëtoret që ankoheshin ishin gra, si edhe parashtruesja, kishte vendosur që ligji kërkonte që kontratat të ishin me afat të pacaktuar, për shkak të natyrës së punës që kryhej nga punëtorët përkatës. Gjykata Supreme në ato raste asnjëherë nuk kishte adresuar çështjen nëse punëtorët dhe punëdhënësi i tyre do të mund të pajtoheshin së bashku për të ndryshuar atë kontratë punësimi, për këto lloje pozitash, nga kontrata me afat të pacaktuar në kontratë pune me afat të caktuar. 17 muaj më vonë, një kolegj tejet ndryshe i Gjykatës Supreme, në rastin e parashtrueses, adresoi këtë çështje dhe qartësoi, për herë të parë në Kosovë, që një punëtor me pozitë pune me natyrë të përhershme do të mundte që ligjërisht të pajtohej me ndryshimin e statusit të tij të punësimit në një emërim për një periudhë të caktuar kohore.[2]

[2] Një prej gjyqtarëve në kolegjin pesëanëtarësh të Gjykatës Supreme në rastin e parashtrueses ka qenë po ashtu anëtar në kolegjet e tjera gjyqësore pesëanëtarëshe të Gjykatës Supreme në rastet e përmendura nga parashtruesja.

E drejta për gjykim të drejtë

Shumica thekson që parashtruesja pohon shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, siç garantohet me Nenin 31, paragrafi 1 të Kushtetutës. Kjo dispozitë përcakton që:

> *1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

Në pajtim me Nenin 53 të Kushtetutës, ky nen duhet interpretuar në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni ekuivalent në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) është Neni 6, paragrafi 1, i cili përcakton që:

> *1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për [...] të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile [...].*

Nuk është e kontestueshme që konfliktet në lidhje me punëdhënësit dhe punëtorët janë brenda fushëveprimit të «*të drejtave dhe detyrimeve civile*» (*Shih p.sh.* Buchholz kundër Gjermanisë, Nr. 7759/77, para. 46). Gjithashtu, nuk është e kontestueshme që procedurat e ndryshme gjyqësore kanë pasur të bëjnë me konteste për këto të drejta civile, duke marrë parasysh që çështja ka qenë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, që ka pasur ndikim te parashtruesja, të cilat janë "të mirëfillta dhe serioze" (*Shih p.sh.* Benthem kundër Holandës, Nr. 8848/80, para. 32-33).

Deri në masën që renditja e aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, në rastin e parashtrueses, ka qenë në fakt, si dhe sipas ligjit, "drejtpërdrejt vendimtare për të drejtat civile në fjalë", mund të konkludohet që procedurat e ndryshme gjyqësore kanë pasur të bëjnë me një «përcaktim» të të drejtave dhe detyrimeve civile të parashtrueses (*Shih p.sh.* Le Comte, Van Leuven dhe De Meyere, Nr. 6878/75 dhe 7238/75, para. 47).

Nuk është e kontestueshme që gjykatat e rregullta në instancë komunale, të qarkut dhe asaj Supreme, janë të themeluara në bazë të ligjit dhe përbëjnë «tribunale» në kuptimin e Nenit 6 të KEDNJ-së. Gjithashtu, nuk kontestohet kohëzgjatja e procedurave të përmendura në këtë kërkesë, të cilat fillojnë me parashtrimin e padisë në Gjykatën Komunale diku në gjysmën e parë të vitit

2004, si dhe përfundojnë me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, të dorëzuar te palët më 13 shtator 2010. Përveç këtyre, parashtruesja nuk pretendon që gjykatat e ndryshme nuk kanë qenë të pavarura apo të paanshme.

Mbetet të konsiderohet masa në të cilën parashtruesja ka përfituar nga garancitë procedurale të një gjykimi të drejtë. Parashtruesja ka pasur qasje efektive në të tri nivelet e juridiksionit në sistemin gjyqësor të Kosovës. Parashtruesja ka gëzuar përfaqësimin nga një avokat i kualifikuar në të tri nivelet e gjykatave. Në këtë gjendje, «qasja e parashtruesit në gjykata» nuk mund të vihet në pikëpyetje (*Shih p.sh.* Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 4451/70, para. 36). Përveç kësaj, duke marrë parasysh që nuk duket të ketë pasur ndonjë aspekt të provave të paraqitura që nuk janë marrë parasysh nga gjykatat (shih, mes të tjerash, si më poshtë), e kombinuar kjo me ndihmën e avokatit të kualifikuar për parashtruesen në të gjitha fazat, mund të konkludohet që parashtruesja ka gëzuar plotësisht «barazinë e palëve» me palën e paditur në procedurë.

Ato që mbeten të merren parasysh janë mënyra në të cilën gjykatat e rregullta kanë shqyrtuar rastin e parashtrueses, si dhe masa në të cilën kanë ofruar arsyetime adekuate për të vërtetuar vendimet e tyre. Në aktgjykimet e tyre, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë ofruar përshkrime gjithëpërfshirëse të fakteve në rastin e parashtrueses. Përveç kësaj, të dyja gjykatat e shkallës më të ulët qartësisht e paraqesin të drejtën materiale në fuqi, si dhe shprehimisht e theksojnë vlefshmërinë e vazhdueshme të Marrëveshjes Kolektive. Gjykata Komunale ofron një referencë ndaj vlerësimit të vlefshmërisë së Marrëveshjes Kolektive të bërë nga Inspektorati i Punës, që duket të jetë ofruar në një raport të datës 15 tetor 2003.

Si të tilla, procedurat në Gjykatën Komunale dhe Gjykatën e Qarkut si gjykatë apeli, mund të konsiderohen të kenë shqyrtuar të gjitha faktet vendimtare të rastit, si dhe i kanë vlerësuar drejt argumentet e parashtrueses (*Shih p.sh.* Tatishvili kundër Rusisë, nr. 1509/02, para. 58-63). Rrjedhimisht, nuk duket të ketë pasur baza për të dyshuar në rregullsinë e procedurave në gjykatën e shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë. Gjithsesi, parashtruesja nuk ka bërë ndonjë ankesë sa i përket rregullsisë së kësaj faze të procedurës.

Ajo që mbetet të merret parasysh është rregullsia e procedurës në Gjykatën Supreme, si dhe për të vlerësuar ndikimin e saj në rregullsinë e procedurës si të tërë. Në veçanti, nëse të gjitha elementet e tjera të gjykimit të rregullt janë përmbushur, mbetet të shihet në çfarë mase Gjykata Supreme i ka shqyrtuar drejt të gjitha elementet e rastit, si dhe nëse ky shqyrtim është reflektuar në një aktgjykim me arsyetim të mirëfilltë.

Përcaktimi i të drejtave civile të parashtrueses në këtë rast varet nga Marrëveshja Kolektive e vitit 2002, si dhe zbatimi i saj te marrëdhënia e punës së parashtrueses pas transferimit nga kompania e sigurimeve "Kosova" në kompaninë e sigurimeve "Kosova e Re". Nuk mund të thuhet që Gjykata Supreme nuk ka pasur njohuri të mjaftueshme për ekzistencën e kësaj Marrëveshjeje Kolektive, pasi që ajo përmendet me emër e me datë në të dyja vendimet, vendimin e Gjykatës Komunale dhe vendimin e Gjykatës së Qarkut, sipas ankesës. Revizioni ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut është parashtruar nga kompania e paditur "Kosova e Re", si dhe pa marrë parasysh nëse përfaqësuesi i autorizuar i parashtrueses e ka ngritur prapë çështjen e Marrëveshjes Kolektive apo jo, mund të konsiderohet të ketë qenë pjesë e shkresave të rastit në Gjykatën Supreme.

Në aktgjykim në bazë të revizionit, Gjykata Supreme nuk përmend Marrëveshjen Kolektive si emër të përveçëm. Por, mund të thuhet që i referohet asaj në frazën *"sepse pozita e saj e punës ekziston në aktet normative të të paditurës"*, si dhe qëndrimi i Gjykatës Supreme që *"qëndrimi juridik i gjykatave të shkallës së ulët [në bazë të këtyre akteve normative] është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit [...]",* që Gjykata Supreme ka pasur njohuri për Marrëveshjen Kolektive, si dhe i është referuar asaj përgjithësisht me termin «aktet normative të të paditurës».

Arsyetimi përfundimtar i Gjykatës Supreme që, *"[...] kontrata për zgjatjen e marrëdhënies së punës mund të nënshkruhet me pëlqimin e punëdhënësit dhe punëtorit, nëse nuk është në kundërshtim me ligjin dhe aktet normative, si dhe kështu, kontrata e punës së paditëses është ndërprerë me skadimin e afatit të kontratës."* Tregon që qëllimi i Gjykatës Kushtetuese ka qenë mjaftueshëm i qartë në kuptimin e përjashtimit të vlefshmërisë së Marrëveshjes Kolektive në rastin e marrëdhënies së punës së parashtrueses me kompaninë e paditur "Kosova e Re", edhe nëse nuk e ka përmendur Marrëveshjen Kolektive me emër.

Në këto rrethana, Gjykata Supreme ka përmbushur në masë të mirëfilltë obligimet e saj për shqyrtimin e plotë të të gjitha argumenteve të padisë së parashtrueses, si dhe nxjerrjen e një aktgjykimi të arsyetuar mirë. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të së drejtës së parashtrueses për gjykim të rregullt sipas Nenit 31, para. 1, të Kushtetutës, si dhe Nenit 6, para. 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Çështja kushtetuese e parashtruar në Gjykatë

A është ky sqarim i thjeshtë i Gjykatës Supreme për ligjin e zbatueshëm shkelje kushtetuese?

Në arritjen e përfundimit të saj, shumica në Gjykatën Kushtetuese është bazuar në interpretimin e ofruar të fakteve dhe të drejtës në aktgjykimet e Gjykatës Supreme në rastet e pesë personave të tjerë, ku gjendja e fakteve pretendohet të jetë identike me atë të parashtrueses (Rev. Nr. 126/2007 dhe Rev. Nr. 177/2007, të dyja të datës 17 janar 2008, si dhe tri aktgjykime të tjera). Shumica ka konsideruar që ky dallim mes aktgjykimit në rastin e parashtrueses, *kundrejt* aktgjykimeve në ato pesë raste të tjera, përbën trajtim të pabarabartë para ligjit, në kundërshtim të Nenit 24, para. 1, të Kushtetutës.

Në pajtim me praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, i mbetet parashtruesit të vërtetojë mënyrën në të cilën është trajtuar ndryshe, si dhe në çfarë bazash ka ndodhur ky dallim i pretenduar në trajtim (*p.sh.* Fredin kundër Suedisë (Nr. 1), Nr. 12033/86, 18 shkurt 1991, para. 60-61). Vetëm pasi të vërtetohet dallimi në trajtim, si dhe pasi të përcaktohet natyra e shkaqeve të këtij dallimi në trajtim, atëherë mund të testohet justifikimi për këtë trajtim ndryshe për arsyeshmëri dhe objektivitet.

Shumica ka bazuar vendimin e saj mbi aktgjykimet kundërthënëse të Gjykatës Supreme në gjashtë raste, që është pohuar të jetë e dukshme. Në arritjen e këtij përfundimi, shumica është bazuar tek aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Beian kundër Rumanisë (Nr. 1) (Nr. 30658/05, 6 dhjetor 2007).

Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Ne theksojmë që Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, në raste të ndryshme, ka vendosur mbi implikimet e vendimeve kundërthënëse gjyqësore tek e drejta për gjykim të drejtë. Në disa nga këto raste, vendimet kundërthënëse gjyqësore kanë ardhur nga gjykata apo juridiksione të ndryshme, derisa në raste të tjera, kanë pasur të bëjnë me vendime të ndryshme të nxjerra nga e njëjta gjykatë, në procedura dukshëm të ngjashme. Një numër rastesh ka pasur të bëjë me vendime kundërthënëse të Gjykatave Supreme të vendeve, siç është rasti me të cilin kemi të bëjmë me këtë kërkesë.
Në rastin e Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë, nr. 13279/05 të datës 20 tetor 2011, Dhoma e Madhe e Gjykatës ka përcaktuar parimet e përgjithshme që vlejnë në ato raste (para. 49-58). GJEDNJ-ja ka theksuar, mes të tjerash:

> *"50. [...] përveç në rast të arbitraritetit të dukshëm, nuk është roli i Gjykatës që të vërë në pikëpyetje interpretimin e të drejtës vendore nga gjykatat shtetërore (shih, për shembull Ādamsons kundër Letonisë, nr. 3669/03, para. 118, 10 maj 2007). Ngjashëm, në këtë kuptim, parimisht*

nuk është funksioni i saj që të krahasojë vendimet e ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse janë nxjerrë në procedura dukshëm të ngjashme; gjykata duhet të respektojë pavarësinë e atyre gjykatave (shih Engel dhe të tjerët kundër Holandës, 8 qershor 1976, para. 103, Seria A nr. 22; Gregório de Andrade kundër Portugalisë, nr. 41537/02, para. 36, 14 nëntor 2006; dhe Ādamsons, cituar si më lart, para. 118).

52. Gjykatës i është kërkuar disa herë që të shqyrtojë rastet në lidhje me vendime kundërthënëse gjyqësore [...] si dhe kështu ka pasur mundësinë që të nxjerrë aktgjykime mbi kushtet në të cilat vendimet kundërthënëse të gjykatave supreme vendore janë marrë me shkelje të dispozitës për gjykim të rregullt, të përligjur me Nenin 6. para. 1, të Konventës (shih Perez Arias kundër Spanjës, nr. 32978/03, para. 25, 28 qershor 2007; Beian kundër Rumanisë (nr. 1), 30658/05, para. 34-40, 6 dhjetor 2007; Ştefan dhe Ştef kundër Rumanisë, nr. 24428/03 dhe 26977/03, para. 33-36, 27 janar 2009; Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë, nr. 23530/02, para. 48-49, 2 korrik 2009; si dhe Schwarzkopf dhe Taussik kundër Republikës Çeke (dec.), nr. 42162/02, 2 dhjetor 2008).

53. Në këtë drejtim, Gjykata ka shpjeguar kriteret që kanë udhëzuar vlerësimin e saj, i cili konsiston në përcaktimin nëse ekzistojnë «dallime të thella dhe të largëta» në praktikën gjyqësore të një gjykate supreme, nëse ligji vendor siguron mekanizmat për tejkalimin e këtyre kundërthënieve, nëse ata mekanizma janë aplikuar, si dhe nëse duhet, me çfarë efekti (shih Iordan Iordanov dhe të tjerët, cituar më lart, para. 49-50).

56. Vlerësimi i saj për rrethanat që janë parashtruar te gjykata për vlerësim gjithashtu është bazuar gjithmonë te parimi i sigurisë juridike, i cili nënkuptohet në të gjitha nenet e Konventës, si dhe përbën njërin prej aspekteve themelore të sundimit të së drejtës [...]

57. Në këtë kuptim, Gjykata gjithashtu rithekson që e drejta për proces të rregullt gjyqësor duhet interpretuar në frymën e Preambulës së Konventës, e cila e deklaron sundimin e së drejtës si pjesë të trashëgimisë së përbashkët të shteteve kontraktuese. Tani, një prej aspekteve themelore të sundimit

> *të ligjit është parimi i sigurisë juridike (shih Brumărescu kundër Rumanisë [GC], n. 28342/95, para. 61, 28 tetor 1999), i cili, inter alia, garanton një stabilitet të caktuar në situatat ligjore si dhe kontribuon në ndërtimin e besimit publik në gjykata [...]. Vazhdimësia e vendimeve kundërthënëse gjyqësore, në anën tjetër, mund të krijojë një gjendje të pasigurisë juridike, që ka gjasë të humbë besimin publik te sistemi gjyqësor, derisa besimi i tillë është sigurisht një prej elementeve më qenësore të një shteti të së drejtës [...].*
>
> *58. Megjithatë, Gjykata thekson që dispozitat e sigurisë juridike dhe mbrojtjes së besimit legjitim publik nuk përbëjnë të drejtë të fituar ndaj konsistencës së praktikës gjyqësore (shih Unédic kundër Francës, nr. 20153/04, para. 74, 18 dhjetor 2008). [...]"*

Parimi kryesor që vlen në rastet e dallimeve mes vendimeve të Gjykatës Supreme te rastet që duken të ngjashme është nëse ekzistojnë apo jo "dallime të thella dhe të largëta" në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme (*shih* Nejdat Sahin dhe Perihan Sahin, cituar më lart, para. 53). Në rastin e parashtrueses, vendimi i Gjykatës Supreme në bazë të revizionit krahasohet vetëm me pesë raste të tjera të Gjykatës Supreme, në pesë raste të tjera që kanë të bëjnë me ato që duken si fakte e ligje të ngjashme. Është e vështirë të kuptohet se si, në bazë vetëm të gjashtë vendimeve të Gjykatës Supreme, mund të konkludohet që ka «dallime të thella dhe të largëta» në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, të cilat cenojnë parimin e sigurisë juridike dhe si pasojë, cenojnë sundimin e ligjit.

Në të kundërtën, rasti Beian kundër Rumanisë ka të bëjë me përcaktimin e të drejtës për beneficione të veçanta sociale të ofruara me një ligj të ri për personat që ishin detyruar të kryenin një shërbim të detyrueshëm publik joushtarak në vitet '50. Ligji përcaktonte që përfitues ishin personat që ishin angazhuar në shërbimin e detyrueshëm nën autoritetin e një agjencie të caktuar të quajtur DGT. Parashtruesi në atë rast kishte kryer shërbimin e detyrueshëm, por jo nën autoritetin e DGT-së. Gjatë periudhës 2003-2006, Gjykata Supreme e Rumanisë ishte ftuar të vendoste nëse personat që kishin kryer shërbimin e detyrueshëm, jo nën autoritetin e DGT-së, kualifikoheshin gjithsesi për beneficionet e përcaktuara me ligj. Gjatë kësaj periudhe kohore, Gjykata Supreme e Rumanisë kishte vendosur 18 herë në të mirë të personave që nuk ishin nën autoritetin e DGT-së, si dhe 17 herë në dëm të atyre personave. Nganjëherë, vendimet kundërthënëse nxirreshin gjatë të njëjtës ditë. GJEDNJ-ja ishte veçanërisht e brengosur që Gjykata Supreme vetë ishte kthyer në burim të pasigurisë juridike, duke marrë parasysh rëndësinë e rolit

të Gjykatës Supreme në zgjidhjen e kundërthënieve në interpretimet gjyqësore.

Rasti Beian kundër Rumanisë ka të bëjë me një numër qenësor të vendimeve kundërthënëse të nxjerra nga Gjykata Supreme për një periudhë prej më shumë se tri vjet, të cilat kalojnë pa dallim nga njëri interpretim në tjetrin. Numri i madh i rasteve në një periudhë të konsiderueshme kohore, me mungesë të plotë të konsistencës, janë faktorët që çojnë në gjetjen e arbitraritetit të dukshëm në atë rast. Mu kjo gjetje e arbitraritetit të dukshëm është ajo që çon në gjetjen e shkeljes së Nenit 6, para. 1, të Konventës.

Dallimi me rastin aktual në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese është i konsiderueshëm. Vetëm gjashtë raste të Gjykatës Supreme janë parashtruar, prej të cilëve dy raste janë vendosur më 17 janar 2008, derisa rasti i parashtrueses është vendosur më 10 qershor 2010. Interpretimi i të drejtës materiale nga Gjykata Supreme ka qenë ndryshe në dy rastet e para në krahasim me të tretin. As numri i aktgjykimeve të pohuara si kundërthënëse, e as periudha kohore brenda së cilës janë nxjerrë këto aktgjykime, nuk arrijnë nivelin e peshës apo pasigurinë juridike, të cilat do të tërhiqnin përfundimin e arbitraritetit të dukshëm.

Përfundim

Rrjedhimisht, dallimi i interpretimeve ligjore i parë në vendimin e Gjykatës Supreme në rastin e parashtrueses, *vis-à-vis* pesë rasteve të tjera nuk vërteton "dallimin e thellë dhe të largët" sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme.

Gjykata Supreme është interpretuesja përfundimtare e aplikimit korrekt të ligjit në Republikën e Kosovës. Edhe pse në bazë të Nenit 102, paragrafi 3 të Kushtetutës të gjitha gjykatat në Kosovë duhet të zbatojnë Kushtetutën në aktvendimet dhe aktgjykimet e tyre, Gjykata Kushtetuese është interpretuesja përfundimtare e Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese nuk ka autoritetin të shërbejë si autoriteti përfundimtar interpretues i aplikimit të duhur të ligjit në Kosovë, edhe nëse Gjykata Kushtetuese nuk pajtohet me interpretimin ligjor të Gjykatës Supreme, përveç nëse ai interpretim është shkelje e Kushtetutës. Rrjedhimisht, kjo gjykatë duhet të vendosë nëse aktgjykimi i Gjykatës Supreme në rastin e parashtrueses ka shkelur Kushtetutën, pa marrë parasysh nëse Gjykata beson që Gjykata Supreme ka zbatuar ligjin e duhur në rastin e parashtrueses apo jo.

Në këtë rast, parashtruesja pretendon që Gjykata Supreme e Kosovës e ka trajtuar atë ndryshe nga pesë punëtorët e tjerë me pozita të ndryshme te një punëdhënës i vetëm, në kuptimin e vendosjes nëse statusi i saj i punësimit ishte i përhershëm apo me afat të caktuar. Vendimet e Gjykatës Supreme te të

cilat ajo bazohet kanë të bëjnë me punëtorë të tjerë të të njëjtit punëdhënës, por me detyra të tjera pune. Disa nga këto vendime janë nxjerrë 17 muaj më herët, nga gjyqtarë tejet të ndryshëm të Gjykatës Supreme që kanë interpretuar Ligjin e punës të Kosovës, por nuk kanë adresuar veçanërisht çështjen juridike nëse punëtori mundet në mënyrë të ligjshme të pajtohet që të mos trajtohet si punëtor me kontratë të përhershme. 17 muaj më vonë, Gjykata Supreme, në rastin e parashtrueses, ka shqyrtuar çështjen juridike, si dhe ka arritur te përfundimi që është e ligjshme që një punëtor me kontratë të përhershme, si parashtruesja, të pajtohet të jetë punëtor me afat të caktuar. Gjykata Supreme thjesht e ka shqyrtuar këtë çështje në mënyrë racionale dhe objektive në rastin e parashtrueses. Nuk ka prova në shkresa, apo në këtë gjykatë, që parashtruesja është trajtuar ndryshe për ndonjë arsye tjetër. Nuk ka prova që parashtruesja është trajtuar ndryshe për shkak të gjinisë apo përkatësisë së saj etnike.

Kushtetuta e Kosovës përcakton që secili të ketë mbrojtje të barabartë para ligjit. Nuk kërkon që secili të trajtohet absolutisht njëjtë. Përndryshe, secili, që nga Presidenti i Republikës e deri te një zyrtar i mirëmbajtjes së rrugëve, do të duheshin të pranonin kompensime të barabarta, si dhe beneficione plotësisht të barabarta, pa marrë parasysh aftësitë dhe detyrat e ndryshme në punë. Nuk përcakton që secili vendim gjyqësor, ku gjyqtarët, qofshin ata gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese apo të gjykatave të rregullta, duhet të kenë interpretimin e njëjtë të ligjit të zbatueshëm. Thjesht ndalon trajtimin e pabarabartë të njerëzve nëse trajtimi i tillë bëhet vetëm për shkak të gjinisë apo etnisë së tyre, apo në baza të tjera të mbrojtura, të përcaktuara me paragrafin 2 të Nenit 24. Në këtë rast, nuk ka absolutisht asnjë provë që aktgjykimi i Gjykatës Supreme në rastin e parashtrueses është nxjerrë për arsye të tjera përveç asaj që është sqaruar nga vetë Gjykata për ligjin e zbatueshëm, apo për shkak të gjinisë apo përkatësisë etnike të saj. Nuk ka pasur shkelje të të drejtave të parashtrueses për mbrojtje të barabartë para ligjit, siç përcaktohet me Nenin 24 të Kushtetutës apo të gjykimit të drejtë, siç përcaktohet me Nenin 31 të Kushtetutës, si dhe Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për rrjedhojë, kërkesa e parashtrueses duhet refuzuar.

Dorëzuar me respekt,

Robert Carolan
Gjyqtar

Mendimi i përbashkët mospajtues
i
Gjyqtarëve Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova
Rasti nr. KI 120/10
Parashtruesja
Zyma Berisha
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. 308/2007, të 10 qershorit 2010

Ne marrim parasysh gjykimin e Shumicës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (më tej në tekst: Shumica). Megjithatë, nuk mund të pajtohemi me të për arsyet në vijim.

Parashtruesja, në kërkesën e saj, ka pretenduar që Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me aktgjykimin Rev. Nr. 308/2007 të datës 10 qershor 2010, kishte shkelur parimin e barazisë para ligjit, të garantuar me Nenin 24, paragrafi 1 të Kushtetutës.

Në mbështetje të pretendimit të saj, parashtruesja thekson që aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës dallon nga aktgjykimet e Gjykatës Supreme në dy raste të mëhershme (Aktgjykimi Rev. Nr. 126/2007 i datës 17 janar 2008, si dhe aktgjykimi Rev. Nr. 177/2007 i datës 17 janar 2008). Parashtruesja gjithashtu i referohet katër rasteve të tjera, ku aktgjykimet nga Gjykata Supreme kishte ndjekur arsyetimi e dy rasteve të përmendura. pretendon që gjendja e saj është identike me atë të paditësve në të gjashtë rastet tjera.

Ne pajtohemi me interpretimin e dhënë nga Shumica e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese që "*ankesa karakterizohet nga faktet e pretenduara në të, e jo vetëm nga bazat apo argumentet juridike të përdorura*" (shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së në rastin Ştefanica dhe të tjerë kundër Rumanisë, 2 nëntor 2010, para 23). Si të tillë, ne pranojmë qëndrimin që ankesat e Parashtrueses duhen shqyrtuar sipas nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të Konventës, si dhe nenit 24 të Kushtetutës, marrë në lidhje me nenin 14 dhe nenin 6.1 të Konventës.

Faktet e këtij rasti kanë të bëjnë me parashtruesen, e cila ka qenë e punësuar qysh prej vitit 1986 në kompaninë e sigurimeve "Kosova", me kontratë punësimi me kohëzgjatje të pacaktuar. Në vitin 2000, kjo kompani u riorganizua, ose ndryshe u transferuan pasuritë dhe detyrimet e saj, te një kompani e re sigurimesh e quajtur "Kosova e Re". Pjesë e kësaj bartjeje ishin edhe anëtarët e personelit të kompanisë së vjetër, ashtu siç ishte përcaktuar me marrëveshjen e transferit në mes të dy kompanive.

Parashtruesja kishte vazhduar punën me kompaninë e re të sigurimeve, por në baza të një numri kontratash me afat të caktuar. Edhe funksionet e saj brenda kompanisë kishin ndryshuar, nga të qenit përkthyese në funksione të tjera. Fillimisht, kishte marrë kontratë punësimi me kompaninë "Kosova e Re", me kohëzgjatje të pacaktuar. Vijimisht, kishte nënshkruar kontrata me afat të caktuar. Kjo situatë vazhdoi derisa parashtruesja mori njoftimin për ndërprerjen e punësimit të saj më 4 shkurt 2004.

Parashtruesja thekson që ka ekzistuar më herët një Marrëveshje Kolektive (nr. 686 e 7 tetorit 2002) mes punëdhënësit fillestar dhe personelit të kompanisë së sigurimeve "Kosova", e cila përcaktonte punët që do të mund të konsideroheshin ekskluzivisht si «punësim me afat të pakufizuar». Pohohet që kjo Marrëveshje Kolektive ishte pjesë e transferimit të aseteve dhe detyrimeve nga kompania e vjetër te kompania e re "Kosova e Re". Parashtruesja pohon që ajo kishte pranuar t'i nënshkruante në vazhdimësi kontratat me afat të caktuar nën presion, pasi që donte të vazhdonte punësimin dhe kishte nevojë për të ardhura. Ajo pretendon që priste gjithmonë nga kompania "Kosova e Re" që të njihte të drejtën e saj për kontratë me afat të pacaktuar, sipas dispozitave të Marrëveshjes Kolektive.

Pas shkarkimit të saj përfundimtar më 2004, parashtruesja kishte iniciuar procedurën kontestimore në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar që Gjykata ta obligonte kompaninë "Kosova e Re" që ta rikthente atë si punëtore me kontratë me afat të pakufizuar. Kjo gjykatë, me aktgjykimin C1. Nr. 31/03, të datës 20 shtator 2004, kishte vendosur që Marrëveshja Kolektive ishte obligative për kompaninë "Kosova e Re", si dhe në bazë të ligjit të punës në fuqi, kjo kompani ishte e obliguar ta rikthente parashtruesen në vendin e punës. Kompania e paditur "Kosova e Re" u ankua në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e cila me aktgjykimin Ac. Nr. 234/2005, të datës 29 mars 2007, vërtetoi gjetjet dhe vendimin e Gjykatës Komunale.

Vijimisht, kompania e paditur "Kosova e Re" parashtroi revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar që Gjykata e Qarkut gabimisht kishte zbatuar të drejtën materiale. Gjykata Supreme, me aktgjykimin e saj Rev. Nr. 308/2007, të datës 10 qershor 2010, e shpalli revizionin të bazuar. Gjykata Supreme vendosi që *"gjykatat e shkallës më të ulët e kanë vlerësuar drejt dhe plotësisht gjendjen faktike në lidhje me faktet vendimtare për gjykimin e drejtë të rastit, por në bazë të kësaj gjendjeje, [...] kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale duke vendosur që kërkesë-padia ishte e bazuar."* Veçanërisht, Gjykata Supreme arsyetonte që:

> *"Qëndrimi juridik i gjykatave të shkallës më të ulët që paditëses duhej t'i zgjatej kontrata, sepse pozita e saj e punës ekziston në aktet normative të të padituës, për qëndrimin e kësaj gjykate, është me*

shkelje të dispozitave të ligjit, duke marrë parasysh që kontrata e zgjatur e punësimit mund të nënshkruhet me pëlqimin e punëtorit dhe punëdhënësit, nëse nuk është në kundërshtim me ligjin dhe aktet normative, si dhe kështu, kontrata e punës së paditëses është ndërprerë me përfundimin e kohëzgjatjes së kontratës."

Nga procedurat e lartpërmendura mund të shihet që gjykatat e shkallës më të ulët i kishin vlerësuar drejt dhe plotësisht faktet e padisë së parashtrueses, ashtu si edhe Gjykata Supreme në revizionin e saj. Dallimi qenësor gjendet tek interpretimi juridik që i jepet statusit të Marrëveshjes Kolektive në lidhje me punësimin në kompanitë përkatëse të sigurimeve "Kosova", si dhe pas transferimit, "Kosova e Re". Në anën tjetër, gjykatat e shkallës më të ulët kishin përcaktuar që kjo Marrëveshje Kolektive ishte obligative për kompaninë "Kosova e Re", si dhe ishte në pajtim me të drejtën materiale, në rastin e parashtrueses, Gjykata Supreme kishte gjetur që palët kishin përfituar nga liria juridike e hyrjes në kontratë, si dhe duket të ketë përcaktuar që Marrëveshja Kolektive ishte në kundërshtim me të drejtën materiale. Ne theksojmë që fraza *"sepse pozita e saj e punës ekziston në aktet normative të të padituës"* nuk është plotësisht e qartë në atë nëse i referohet apo jo Marrëveshjes Kolektive. Përndryshe, mund t'i referohet thjesht titullit dhe funksioneve të punës, të cilat i ushtronte parashtruesja.

Megjithatë, në cilindo interpretim që i bëhet konkludimit të Gjykatës Supreme, është e qartë që ajo kishte vendosur në bazë të së drejtës materiale në fuqi, që është plotësisht brenda kompetencës së saj. Në fakt, nuk është kompetencë e Gjykatës Kushtetuese që të bëjë konkludimet e veta mbi të drejtën materiale. Në pajtim me jurisprudencën e qartë të Gjykatës Kushtetuese, ajo nuk është gjykatë e shkallës së katërt si dhe nuk zëvendëson vlerësimin e vet të fakteve dhe interpretimin e të drejtës materiale me atë të gjykatave të rregullta. Si e tillë, nuk është kompetencë e Gjykatës Kushtetuese që të vërë në pikëpyetje vlerësimin e të drejtës materiale të dhënë nga Gjykata Supreme në gjykimin e rastit të parashtrueses.

Kërkesa ngre çështje në lidhje me shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë, siç garantohet me Nenin 31, paragrafi 1 të Kushtetutës. Kjo dispozitë përcakton që:

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

Në pajtim me Nenin 53 të Kushtetutës, ky nen duhet interpretuar në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni

ekuivalent në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) është Neni 6, paragrafi 1, i cili përcakton që:

1. *Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për [...] të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile [...].*

Nuk është e kontestueshme që konfliktet në lidhje me punëdhënësit dhe punëtorët janë brenda fushëveprimit të «*të drejtave dhe detyrimeve civile*» (*Shih p.sh.* Buchholz kundër Gjermanisë, Nr. 7759/77, para. 46). Gjithashtu, nuk është e kontestueshme që procedurat e ndryshme gjyqësore kanë pasur të bëjnë me konteste për këto të drejta civile, duke marrë parasysh që çështja ka qenë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, që ka pasur ndikim te parashtruesja, të cilat janë "të mirëfillta dhe serioze" (*Shih p.sh.* Benthem kundër Holandës, Nr. 8848/80, para. 32-33).

Deri në masën që renditja e aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, në rastin e parashtrueses, ka qenë në fakt, si dhe sipas ligjit, "drejtpërdrejt vendimtare për të drejtat civile në fjalë", mund të konkludohet që procedurat e ndryshme gjyqësore kanë pasur të bëjnë me një «përcaktim» të të drejtave dhe detyrimeve civile të parashtrueses (*Shih p.sh.* Le Comte, Van Leuven dhe De Meyere, Nr. 6878/75 dhe 7238/75, para. 47).

Kështu, ne konkludojmë që rasti i parashtrueses bën pjesë në fushëveprimin e nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ, si dhe të nenit 31, paragrafi 1 të Kushtetutës. Kështu, parashtruesja ka pasur të drejtë të gëzojë garantimin e "një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm, nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i themeluar me ligj."

Nuk është e kontestueshme që gjykatat e rregullta në instancë komunale, të qarkut dhe asaj Supreme, janë të themeluara në bazë të ligjit dhe përbëjnë «tribunale» në kuptimin e Nenit 6 të KEDNJ-së. Gjithashtu, nuk kontestohet kohëzgjatja e procedurave të përmendura në këtë kërkesë, të cilat fillojnë me parashtrimin e padisë në Gjykatën Komunale diku në gjysmën e parë të vitit 2004, si dhe përfundojnë me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, të dorëzuar te palët më 13 shtator 2010. Përveç këtyre, parashtruesja nuk pretendon që gjykatat e ndryshme nuk kanë qenë të pavarura apo të paanshme.

Mbetet të konsiderohet masa në të cilën parashtruesja ka përfituar nga garancitë procedurale të një gjykimi të drejtë. Parashtruesja ka pasur qasje efektive në të tri nivelet e juridiksionit në sistemin gjyqësor të Kosovës. Parashtruesja ka gëzuar përfaqësimin nga një avokat i kualifikuar në të tri nivelet e gjykatave. Në këtë gjendje, «qasja e parashtruesit në gjykata» nuk

mund të vihet në pikëpyetje (*Shih p.sh.* Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 4451/70, para. 36). Përveç kësaj, duke marrë parasysh që nuk duket të ketë pasur ndonjë aspekt të provave të paraqitura që nuk janë marrë parasysh nga gjykatat (shih, mes të tjerash, si më poshtë), e kombinuar kjo me ndihmën e avokatit të kualifikuar për parashtruesen në të gjitha fazat, mund të konkludohet që parashtruesja ka gëzuar plotësisht «barazinë e palëve» me palën e paditur në procedurë.

Ato që mbeten të merren parasysh janë mënyra në të cilën gjykatat e rregullta kanë shqyrtuar rastin e parashtrueses, si dhe masa në të cilën kanë ofruar arsyetime adekuate për të vërtetuar vendimet e tyre. Në aktgjykimet e tyre, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë ofruar përshkrime gjithëpërfshirëse të fakteve në rastin e parashtrueses. Përveç kësaj, të dyja gjykatat e shkallës më të ulët qartësisht e paraqesin të drejtën materiale në fuqi, si dhe shprehimisht e theksojnë vlefshmërinë e vazhdueshme të Marrëveshjes Kolektive. Gjykata Komunale ofron një referencë ndaj vlerësimit të vlefshmërisë së Marrëveshjes Kolektive të bërë nga Inspektorati i Punës, që duket të jetë ofruar në një raport të datës 15 tetor 2003. Të dyja gjykatat kanë gjetur që kompania e paditur "Kosova e Re", në procedurat e shkarkimit ndaj parashtrueses, kishte shkelur procedurat e përcaktuara me ligj, duke marrë parasysh kushtet e bashkëngjitura nga rregullorja e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, në lidhje me transferimin e personelit ekzistues të ish-kompanisë "Kosova", si dhe dispozitat e Marrëveshjes Kolektive.

Si të tilla, procedurat në Gjykatën Komunale dhe Gjykatën e Qarkut si gjykatë apeli, mund të konsiderohen të kenë shqyrtuar të gjitha faktet vendimtare të rastit, si dhe i kanë vlerësuar drejt argumentet e parashtrueses (*Shih p.sh.* Tatishvili kundër Rusisë, nr. 1509/02, para. 58-63). Rrjedhimisht, nuk duket të ketë pasur baza për të dyshuar në rregullsinë e procedurave në gjykatën e shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë. Gjithsesi, parashtruesja nuk ka bërë ndonjë ankesë sa i përket rregullsisë së kësaj faze të procedurës.

Ajo që mbetet të merret parasysh është rregullsia e procedurës në Gjykatën Supreme, si dhe për të vlerësuar ndikimin e saj në rregullsinë e procedurës si të tërë. Në veçanti, nëse të gjitha elementet e tjera të gjykimit të rregullt janë përmbushur, mbetet të shihet në çfarë mase Gjykata Supreme i ka shqyrtuar drejt të gjitha elementet e rastit, si dhe nëse ky shqyrtim është reflektuar në një aktgjykim me arsyetim të mirëfilltë.

Përcaktimi i të drejtave civile të parashtrueses në këtë rast varet nga Marrëveshja Kolektive e vitit 2002, si dhe zbatimi i saj te marrëdhënia e punës së parashtrueses pas transferimit nga kompania e sigurimeve "Kosova" në kompaninë e sigurimeve "Kosova e Re". Nuk mund të thuhet që Gjykata Supreme nuk ka pasur njohuri të mjaftueshme për ekzistencën e kësaj

Marrëveshjeje Kolektive, pasi që ajo përmendet me emër e me datë në të dyja vendimet, vendimin e Gjykatës Komunale dhe vendimin e Gjykatës së Qarkut, sipas ankesës. Revizioni ndaj vendimit të Gjykatës së Qarkut është parashtruar nga kompania e paditur "Kosova e Re", si dhe pa marrë parasysh nëse përfaqësuesi i autorizuar i parashtrueses e ka ngritur prapë çështjen e Marrëveshjes Kolektive apo jo, mund të konsiderohet të ketë qenë pjesë e shkresave të rastit në Gjykatën Supreme.

Ne vërejmë që, në aktgjykimin e saj në bazë të revizionit, Gjykata Supreme nuk përmend Marrëveshjen Kolektive si emër të përveçëm. Por, mund të thuhet që i referohet asaj në frazën *"sepse pozita e saj e punës ekziston në aktet normative të të paditurës"*, si dhe qëndrimi i Gjykatës Supreme që *"qëndrimi juridik i gjykatave të shkallës së ulët [në bazë të këtyre akteve normative] është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit [...]"*, që Gjykata Supreme ka pasur njohuri për Marrëveshjen Kolektive, si dhe i është referuar asaj përgjithësisht me termin «aktet normative të të paditurës».

Arsyetimi përfundimtar i Gjykatës Supreme që, *"[...] kontrata për zgjatjen e marrëdhënies së punës mund të nënshkruhet me pëlqimin e punëdhënësit dhe punëtorit, nëse nuk është në kundërshtim me ligjin dhe aktet normative, si dhe kështu, kontrata e punës së paditëses është ndërprerë me skadimin e afatit të kontratës."* Tregon që qëllimi i Gjykatës Kushtetuese ka qenë mjaftueshëm i qartë në kuptimin e përjashtimit të vlefshmërisë së Marrëveshjes Kolektive në rastin e marrëdhënies së punës së parashtrueses me kompaninë e paditur "Kosova e Re", edhe nëse nuk e ka përmendur Marrëveshjen Kolektive me emër.

Në këto rrethana, ne gjejmë që Gjykata Supreme ka përmbushur në masë të mirëfilltë obligimet e saj për shqyrtimin e plotë të të gjitha argumenteve të padisë së parashtrueses, si dhe nxjerrjen e një aktgjykimi të arsyetuar mirë. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të të drejtës së parashtrueses për gjykim të rregullt sipas Nenit 31, para. 1, të Kushtetutës, si dhe Nenit 6, para. 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në arritjen e përfundimit të saj, shumica në Gjykatën Kushtetuese është bazuar në interpretimin e ofruar të fakteve dhe të drejtës në aktgjykimet e Gjykatës Supreme në rastet e gjashtë personave të tjerë, ku gjendja e fakteve pretendohet të jetë identike me atë të parashtrueses.

Teksti i aktgjykimit të Shumicës rreshton pesë aktgjykime të tjera të Gjykatës Supreme: tri aktgjykime të nxjerra më 17 janar 2008 (Rev. Nr. 126/2007 dhe Rev. Nr. 177/2007, Rev.nr. 177/2007), i katërti i nxjerrë më 28 janar 2008 (Rev.nr. 180/2006), si dhe i pesti i nxjerrë më 7 shkurt 2011 (Rev.nr. 154/2008). Bashkë me aktgjykimin e Gjykatës Supreme në rastin e

parashtrueses (Rev 308/2007 i datës 10 qershor 2010), kështu bëhen gjithsej gjashtë aktgjykime të Gjykatës Supreme në rrethana që pohohen të jenë identike.

Shumica ka konsideruar që ky dallim mes aktgjykimit në rastin e parashtrueses, *kundrejt* aktgjykimeve në ato pesë raste të tjera, përbën trajtim të pabarabartë para ligjit, në kundërshtim të Nenit 24, para. 1, të Kushtetutës.

Në pajtim me praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, i mbetet parashtruesit të vërtetojë mënyrën në të cilën është trajtuar ndryshe, si dhe në çfarë bazash ka ndodhur ky dallim i pretenduar në trajtim (*p.sh.* Fredin kundër Suedisë (Nr. 1), Nr. 12033/86, 18 shkurt 1991, para. 60-61). Vetëm pasi të vërtetohet dallimi në trajtim, si dhe pasi të përcaktohet natyra e shkaqeve të këtij dallimi në trajtim, atëherë mund të testohet justifikimi për këtë trajtim ndryshe për arsyeshmëri dhe objektivitet.

Megjithatë, ne kuptojmë që shumica ka bazuar vendimin e saj mbi aktgjykimet kundërthënëse të Gjykatës Supreme në gjashtë raste, që është pohuar të jetë e dukshme. Në arritjen e këtij përfundimi, shumica është bazuar tek aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Beian kundër Rumanisë (Nr. 1) (Nr. 30658/05, 6 dhjetor 2007).

Ne theksojmë që Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, në raste të ndryshme, ka vendosur mbi implikimet e vendimeve kundërthënëse gjyqësore tek e drejta për gjykim të drejtë. Në disa nga këto raste, vendimet kundërthënëse gjyqësore kanë ardhur nga gjykata apo juridiksione të ndryshme, derisa në raste të tjera, kanë pasur të bëjnë me vendime të ndryshme të nxjerra nga e njëjta gjykatë, në procedura dukshëm të ngjashme. Një numër rastesh ka pasur të bëjë me vendime kundërthënëse të Gjykatave Supreme të vendeve, siç është rasti me të cilin kemi të bëjmë me këtë kërkesë.

Në rastin e Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë, nr. 13279/05 të datës 20 tetor 2011, Dhoma e Madhe e Gjykatës ka përcaktuar parimet e përgjithshme që vlejnë në ato raste (para. 49-58). GJEDNJ-ja ka theksuar, mes të tjerash:

> *"50. [...] përveç në rast të arbitraritetit të dukshëm, nuk është roli i Gjykatës që të vërë në pikëpyetje interpretimin e të drejtës vendore nga gjykatat shtetërore (shih, për shembull Ādamsons kundër Letonisë, nr. 3669/03, para. 118, 10 maj 2007). Ngjashëm, në këtë kuptim, parimisht nuk është funksioni i saj që të krahasojë vendimet e ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse janë nxjerrë në procedura dukshëm të ngjashme; gjykata duhet të respektojë pavarësinë e atyre gjykatave (shih Engel dhe të tjerët kundër*

Holandës, 8 qershor 1976, para. 103, Seria A nr. 22; Gregório de Andrade kundër Portugalisë, nr. 41537/02, para. 36, 14 nëntor 2006; dhe Ādamsons, cituar si më lart, para. 118).

52. Gjykatës i është kërkuar disa herë që të shqyrtojë rastet në lidhje me vendime kundërthënëse gjyqësore [...] si dhe kështu ka pasur mundësinë që të nxjerrë aktgjykime mbi kushtet në të cilat vendimet kundërthënëse të gjykatave supreme vendore janë marrë me shkelje të dispozitës për gjykim të rregullt, të përligjur me Nenin 6. para. 1, të Konventës (shih Perez Arias kundër Spanjës, nr. 32978/03, para. 25, 28 qershor 2007; Beian kundër Rumanisë (nr. 1), 30658/05, para. 34-40, 6 dhjetor 2007; Ştefan dhe Ştef kundër Rumanisë, nr. 24428/03 dhe 26977/03, para. 33-36, 27 janar 2009; Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë, nr. 23530/02, para. 48-49, 2 korrik 2009; si dhe Schëarzkopf dhe Taussik kundër Republikës Çeke (dec.), nr. 42162/02, 2 dhjetor 2008).

53. Në këtë drejtim, Gjykata ka shpjeguar kriteret që kanë udhëzuar vlerësimin e saj, i cili konsiston në përcaktimin nëse ekzistojnë «dallime të thella dhe të largëta» në praktikën gjyqësore të një gjykate supreme, nëse ligji vendor siguron mekanizmat për tejkalimin e këtyre kundërthënieve, nëse ata mekanizma janë aplikuar, si dhe nëse duhet, me çfarë efekti (shih Iordan Iordanov dhe të tjerët, cituar më lart, para. 49-50).

56. Vlerësimi i saj për rrethanat që janë parashtruar te gjykata për vlerësim gjithashtu është bazuar gjithmonë te parimi i sigurisë juridike, i cili nënkuptohet në të gjitha nenet e Konventës, si dhe përbën njërin prej aspekteve themelore të sundimit të së drejtës [...]

57. Në këtë kuptim, Gjykata gjithashtu rithekson që e drejta për proces të rregullt gjyqësor duhet interpretuar në frymën e Preambulës së Konventës, e cila e deklaron sundimin e së drejtës si pjesë të trashëgimisë së përbashkët të shteteve kontraktuese. Tani, një prej aspekteve themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike (shih Brumărescu kundër Rumanisë [GC], n. 28342/95, para. 61, 28 tetor 1999), i cili, inter alia, garanton një stabilitet të caktuar në situatat ligjore si dhe kontribuon në ndërtimin e besimit publik në gjykata [...]. Vazhdimësia e vendimeve kundërthënëse gjyqësore, në anën tjetër, mund të krijojë një gjendje të pasigurisë juridike, që ka gjasë të humbë besimin publik te sistemi gjyqësor, derisa besimi i tillë është sigurisht një prej elementeve më qenësore të një shteti të së drejtës [...].

58. Megjithatë, Gjykata thekson që dispozitat e sigurisë juridike dhe mbrojtjes së besimit legjitim publik nuk përbëjnë të drejtë të fituar ndaj konsistencës së praktikës gjyqësore (shih Unédic kundër Francës, nr. 20153/04, para. 74, 18 dhjetor 2008). [...]"

Ne vërejmë që parimi kryesor që vlen në rastet e dallimeve mes vendimeve të Gjykatës Supreme te rastet që duken të ngjashme është nëse ekzistojnë apo jo "dallime të thella dhe të largëta" në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme (*shih* Nejdat Sahin dhe Perihan Sahin, cituar më lart, para. 53). Në rastin e parashtrueses, vendimi i Gjykatës Supreme në bazë të revizionit krahasohet vetëm me pesë raste të tjera të Gjykatës Supreme, në pesë raste të tjera që kanë të bëjnë me ato që duken si fakte e ligje të ngjashme. Është e vështirë të kuptohet se si, në bazë vetëm të gjashtë vendimeve të Gjykatës Supreme, mund të konkludohet që ka «dallime të thella dhe të largëta» në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, të cilat cenojnë parimin e sigurisë juridike dhe si pasojë, cenojnë sundimin e ligjit.

Në të kundërtën, rasti Beian kundër Rumanisë ka të bëjë me përcaktimin e të drejtës për beneficione të veçanta sociale të ofruara me një ligj të ri për personat që ishin detyruar të kryenin një shërbim të detyrueshëm publik joushtarak në vitet '50. Ligji përcaktonte që përfitues ishin personat që ishin angazhuar në shërbimin e detyrueshëm nën autoritetin e një agjencie të caktuar të quajtur DGT. Parashtruesi në atë rast kishte kryer shërbimin e detyrueshëm, por jo nën autoritetin e DGT-së. Gjatë periudhës 2003-2006, Gjykata Supreme e Rumanisë ishte ftuar të vendoste nëse personat që kishin kryer shërbimin e detyrueshëm, jo nën autoritetin e DGT-së, kualifikoheshin gjithsesi për beneficionet e përcaktuara me ligj. Gjatë kësaj periudhe kohore, Gjykata Supreme e Rumanisë kishte vendosur 18 herë në të mirë të personave që nuk ishin nën autoritetin e DGT-së, si dhe 17 herë në dëm të atyre personave. Nganjëherë, vendimet kundërthënëse nxirreshin gjatë të njëjtës ditë. GJEDNJ-ja ishte veçanërisht e brengosur që Gjykata Supreme vetë ishte kthyer në burim të pasigurisë juridike, duke marrë parasysh rëndësinë e rolit të Gjykatës Supreme në zgjidhjen e kundërthënieve në interpretimet gjyqësore.

Rasti Beian kundër Rumanisë ka të bëjë me një numër qenësor të vendimeve kundërthënëse të nxjerra nga Gjykata Supreme për një periudhë prej më shumë se tri vjet, të cilat kalojnë pa dallim nga njëri interpretim në tjetrin. Numri i madh i rasteve në një periudhë të konsiderueshme kohore, me mungesë të plotë të konsistencës, janë faktorët që çojnë në gjetjen e arbitraritetit të dukshëm në atë rast. Mu kjo gjetje e arbitraritetit të dukshëm është ajo që çon në gjetjen e shkeljes së Nenit 6, para. 1, të Konventës.
Dallimi me rastin aktual në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese është i konsiderueshëm. Vetëm gjashtë raste të Gjykatës Supreme janë parashtruar,

prej të cilëve tre raste janë vendosur më 17 janar 2008, derisa rasti i katërt është vendosur më 28 janar 2008, rasti i pestë është vendosur më 10 qershor 2010, derisa rasti i gjashtë është vendosur më 7 shkurt 2011. Afati kohor brenda të cilit këto aktgjykime të Gjykatës Supreme që pohohen të jenë të mospërputhshme janë nxjerrë, përbëhet nga një periudhë prej rreth tri vitesh.

Interpretimi i të drejtës materiale nga Gjykata Supreme ka qenë ndryshe në dy rastet e para në krahasim me të tretin. As numri i aktgjykimeve të pohuara si kundërthënëse, e as periudha kohore brenda së cilës janë nxjerrë këto aktgjykime, nuk arrijnë nivelin e peshës apo pasigurinë juridike, të cilat do të tërhiqnin përfundimin e arbitraritetit të dukshëm.

Rrjedhimisht, ne theksojmë që nuk mund të pajtohemi që dallimi i interpretimeve ligjore i parë në vendimin e Gjykatës Supreme në rastin e parashtrueses, *vis-à-vis* pesë rasteve të tjera nuk vërteton "dallimin e thellë dhe të largët" sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme.

Kështu, ne theksojmë që nuk mund të pajtohemi me përfundimin e Shumicës që shkelja e të drejtës për gjykim të drejtë për shkak të trajtimit të pabarabartë, si dhe konkludojmë që nuk ka pasur shkelje të të "drejtës për barazi para ligjit", siç përcaktohet me nenin 24, paragrafi 1 të Kushtetutës.

Dorëzuar me respekt,
Gjyqtari Almiro Rodrigues Gjyqtarja Snezhana Botusharova

KI 19/13, Mark Duhanaj, datë 27 mars 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 274/2008, të 2 majit 2012, dhe aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, AP. nr. 316/2012, të 23 gushtit 2012, dhe Pkl. nr. 184/2012, të 17 dhjetorit 2012

Rasti KI19/13, Aktvendim për papranueshmëri i 12 marsit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, kontest civil, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për proces të rregullt gjyqësor, kërkesë qartazi e pabazuar

Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimet e gjykatave të rregullta, është shkelur neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) i Kushtetutës, si dhe janë shkelur neni 6 e neni 13 të KEDNJ-së.

Në këtë rast, Gjykata vërejti se, Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 278/2008, i 2 majit 2012,ishte arsyetuar dhe se kjo gjykatë nuk ka vërejtur që, gjatë procedurës së gjykimit të çështjes, ka pasur shkelje procedurale që do të rezultonin me shkeljen e të drejtave themelore të parashtruesit, të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Parashtruesit i është pranuar kërkesa për dëgjimin e dëshmitarëve, është dëgjuar përfaqësuesi i tij i autorizuar, i janë dhënë atij të gjitha mundësitë për mbrojtje gjatë gjithë procesit të gjykimit të rastit.

Prandaj, Gjykata gjeti se parashtruesi i kërkesës as nuk ka ndërtuar, e as nuk ka dëshmuar një rast *prima facie,* qoftë mbi bazën e meritave apo të pranueshmërisë së kërkesës. Në tërësi, Gjykata konstaton se kërkesa është e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

Gjykata, më tutje, konstaton se pasi kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, kërkesa për masë të përkohshme nuk mund të jetë më objekt i shqyrtimit, prandaj dhe është refuzuar.

VENDIM PËR KËRKESËN PËR MASË TË PËRKOHSHME DHE AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI19/13
Parashtrues
Mark Duhanaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.nr.274/2008, të 2 majit 2012, dhe aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, AP.nr.316/2012, të 23 gushtit 2012, dhe Pkl.nr.184/2012, të 17 dhjetorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Mark Duhanaj, me vendbanim në Radulloc, komuna e Klinës, i përfaqësuar nga z. Gjergj Skeli dhe Zeqir Berdynaj, avokatë.

Vendimet e kontestuara

2. Vendime të kontestuara gjyqësore janë: Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.n.274/2008, i 2 majit 2012, dhe aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) AP. nr. 316/2012, i 23 gushtit 2012, dhe Pkl.nr.184/2012, i 17 dhjetorit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të lartcekura, me të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

4. Parashtruesi, gjithashtu, kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të lëshojë masë të përkohshme për shtyrjen e vuajtjes së dënimit, derisa Gjykata të marrë vendim meritor për çështjen.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); në nenin 27 e në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 28 e në rregullin 54 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 21 shkurt 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatë.

7. Më 26 shkurt 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 28 shkurt 2013, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës dhe e informoi Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Apelit në Prishtinë, për regjistrimin e kërkesës me Nr. KI19/13 në regjistrin përkatës të Gjykatës.

9. Më 12 mars 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 30 janar 2006, karabinierët bastisën shtëpinë e babait të parashtruesit (Zef Duhanaj), më ç'rast konfiskuan pesë (5) armë të ndryshme në dhomat e shtëpisë.

11. Më 3 shkurt 2006, Prokuroria publike e Qarkut në Pejë, ngriti aktakuzë kundër parashtruesit për posedim dhe për mbajtje pa leje të armëve të konfiskuara nga karabinierët.

12. Më 29 janar 2007, Gjykata e Qarkut në Pejë nxori Aktgjykimin P.nr.111/2006, me të cilin u shpallën fajtorë parashtruesi dhe babai i tij,

për veprën penale për të cilën ishin akuzuar, pasi që të njëjtit e kishin pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës penale. Gjykata në fjalë konstatoi se pranimi i fajësisë është bërë në përputhje me ligjin, duke u bazuar në provat e prezantuara me akuzë.

13. Parashtruesi ushtroi të drejtën e ankesës kundër Aktgjykimit P.nr.111/2006, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për masën e dënimit.

14. Më 5 gusht 2007, Gjykata Supreme refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë.

15. Më 25 shkurt 2008, parashtruesi ushtroi kërkesë për rishikimin e procedurës penale, për shkak të paraqitjes së fakteve të reja.

16. Më 12 qershor 2008, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktvendimin P.nr.116/2006, pranoi kërkesën e parashtruesit për rishikimin e procedurës penale përkitazi me aktgjykimin e formës së prerë P.nr.111/2006, nga shkaku se vëllezërit e parashtruesit kishin deklaruar se armët e konfiskuara në shtëpinë e përbashkët, me përjashtim të një revoleje, ishin të tyre dhe jo të parashtruesit, siç është vërtetuar me aktgjykimin e formës së prerë. Me deklaratat e këtyre dëshmitarëve, Gjykata e Qarkut në Pejë konstatoi se ishin plotësuar të gjitha kushtet për rishikimin e procedurës penale. Gjykata në fjalë e kishte shtyrë vendimin për ekzekutimin e dënimit, derisa të përfundonte rishikimi i procedurës penale.

17. Më 2 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë nxori Aktgjykimin P.nr.278/2008 dhe shpalli fajtor parashtruesin, për mbajtje në pronësi, në kontroll, apo në përdorim të paautorizuar të armës, nga neni 328, par. 2, i KPK-së dhe e dënoi atë me dënim me burg në kohëzgjatje 1 vit, dënim të cilin ai do ta vuajë pasi ky aktgjykim të bëhej i formës së prerë. Arsyetimi i aktgjykimit në fjalë, ndër të tjera, është ky:

> *"Bazuar në këto prova, gjykata ka vërtetuar në mënyrë të padyshimtë se, mbrojtja e të akuzuarit, se armët kanë qenë të vëllezërve të tij, me përjashtim të revoles TT, është vetëm një përpjekje e vonuar për shmangie të përgjegjësisë penale, pasi që ai, gjatë gjithë procedurës, ka pasur mundësi të propozojë dëgjimin e këtyre dëshmitarëve, të cilët i ka vëllezër, dhe ai, nga momenti i parë, ka mundur të deklarojë se armët janë të tyre, nëse do të ishte kështu siç pretendon i akuzuari dhe dëshmitarët Jozë e Mihill Duhani. Ai madje ka treguar edhe vendin dhe mënyrën e blerjes së disave nga këto armë. Arsyet e paraqitura nga i akuzuari, se ai e*

ka pranuar fajësinë që t'i mbrojë kunatat e tij (gratë e vëllezërve) nga arrestimi i mundshëm dhe pastaj që të mos i inkriminojë vëllezërit e tij, për shkak se ata jetonin dhe punonin në botën e jashtme dhe ndjekja penale kundër tyre do të kishte rezultuar me deportimin e tyre nga vendet ku janë duke jetuar dhe punuar, janë të paqëndrueshme dhe jologjike".

[...]

"Gjykata, duke u bazuar në arsyet e theksuara si më lart, ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se i akuzuari i kishte në pronësi, në posedim dhe në kontroll të tij në mënyrë të paautorizuar të gjitha armët e përshkruara në diapozitiv të aktgjykimit dhe, në këtë mënyrë, ka realizuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale nga nenin 328, par. 2, të KPPK-së".

18. Kundër Aktgjykimit P.nr.278/2008, të 2 majit 2012, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme.

19. Më 23 gusht 2012, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Ap.nr.316/2012) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit. Gjykata Supreme, pasi kishte dëgjuar pohimet e përfaqësuesit të autorizuar të parashtruesit dhe deklarimin e vetë parashtruesit, si dhe pasi kishte shqyrtuar të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridike-penale, vlerësoi se ankesa ishte e pabazuar për shkak se aktgjykimi i ankimuar nuk përmbante shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç pretendohej në ankesë.

20. Më 8 mars 2012, parashtruesi bëri kërkesë në Gjykatën Supreme, për mbrojtjen e ligjshmërisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPPK-së dhe për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave të KPP-së, me propozim që të vërtetohet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, si e bazuar, dhe aktgjykimet e kontestuara (P.nr.278/2008, i 2 majit 2012, dhe Ap.nr.316/2012, i 23 gushtit 2012) të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim.

21. Më 17 dhjetor 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pkl.nr.184/2012) refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, ushtruar nga parashtruesi kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.nr.278/2008, të 2 majit 2012, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap.nr.316/2012, të 23 gushtit 2012. Gjykata Supreme konstatoi se, çështjet e ngritura në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nga përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesit për shkelje të ligjit në dëm të të gjykuarit, nuk ishin të bazuara.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimet e gjykatave të rregullta është shkelur neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) i Kushtetutës, si dhe janë shkelur neni 6 e neni 13 të KEDNJ-së.

Kërkesa për masë të përkohshme

23. Parashtruesi, gjithashtu, kërkon nga Gjykata të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e ekzekutimit të dënimit të caktuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë (P.nr.278/2008, të 2 majit 2012), të vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës (Ap.nr.316/2012, të 23 gushtit 2012), derisa kjo çështje të përfundojë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.2 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të paripërueshme".*

25. Gjykata, gjithashtu, merr në konsideratë nenin 27 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Gjykata Kushtetuese, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës, mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të paripërueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik".*

26. Për më tepër, rregulli 54.1 i Rregullores së punës, parasheh:

> "*Në çfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës se përkohshme*".

27. Së fundi, rregulli 55.1 i Rregullores së punës, thotë:

"Kërkesa për masë të përkohshme do të shqyrtohet me shpejtësi nga Gjykata dhe do t'i jepet përparësi para të gjitha kërkesave te tjera".

28. Në mënyrë që Gjykata të vendosë masën e përkohshme, duhet që, në pajtim me rregullin 55.4 të Rregullores së punës, të gjejë se:

"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të paripareshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(c) masa e përkohshme është me interes publik.

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

Pranueshmëria e kërkesës

29. Në këtë rast, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës që përcakton:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

...

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

30. Neni 47.2 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, gjithashtu, parasheh:
"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

31. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që, në kërkesën e tij, të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë

cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

32. Për më tepër, rregulli 36.1 (a), (b) dhe c) i Rregullores, parasheh:

"*(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar;

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi; ose

c) kërkesa është qartazi e bazuar".

33. Gjykata Kushtetuese konsideron se parashtruesi i është përmbajtur afatit të përcaktuar katërmuajsh, të numëruar prej ditës kur atij i është dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës Supreme; se e ka arsyetuar kërkesën me fakte relevante dhe me një referencë të qartë për shkeljet e pretenduara; ai posaçërisht konteston aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe aktgjykimet e Gjykatës Supreme si akte të autoriteteve publike; se e ka theksuar në mënyrë të qartë mbrojtjen e kërkuar juridike dhe se i ka bashkëngjitur vendimet e ndryshme dhe informatat e dokumentet e tjera mbështetëse.

34. Parashtruesi kryesisht pretendon se, me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe me aktgjykimet e shkallës së dytë, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 të Kushtetutës (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), si dhe të drejtat e garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, përkatësisht me nenin 6 e me nenin 13 të KEDNJ-së.

35. Parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, "*për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim ose të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënimi i kushtëzuar".*

36. Gjykata Supreme, pas analizës së tërësishme të bazave të ankesës, gjeti se *"pretendimet e ankimuara të lartpërmendura janë të pabazuara".*

37. Parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme, *"për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPPK-së dhe për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave të KPP-së me propozim që të vërtetohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë si e bazuar dhe aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim"*. Gjykata Supreme (Pkl.nr.184/2012, i 17 dhjetorit 2012), pas shqyrtimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se kërkesa është e pabazuar.

38. Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë (P.nr.278/2008, i 2 majit 2012) është arsyetuar dhe se kjo Gjykatë nuk ka vërejtur që, gjatë procedurës së gjykimit të çështjes, ka pasur shkelje procedurale që do të rezultonin me shkeljen e të drejtave themelore të parashtruesit, të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Parashtruesit i është pranuar kërkesa për dëgjimin e dëshmitarëve, është dëgjuar përfaqësuesi i tij i autorizuar, i janë dhënë atij të gjitha mundësitë për mbrojtje gjatë gjithë procesit të gjykimit të rastit.

39. Gjykata vëren se bazat e ankesës ndaj Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe ndaj Gjykatës Supreme, përmbajnë pretendime që kanë të bëjnë me shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale, të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, të shkeljes së ligjit penal dhe të vendimit për sanksionet penale.

40. Gjykata Kushtetuese konsideron se ato pretendime mund të jenë të fushës së ligjshmërisë.

41. Gjykata Kushtetuese, më tej, vëren se në Gjykatën e Qarkut në Pejë dhe në Gjykatën Supreme, nga parashtruesi i kërkesës nuk është bërë asnjë pretendim mbi bazën e kushtetutshmërisë, qoftë në mënyrë implicite, qoftë në substancë, që do ngrinte shkeljen e pretenduar të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore të parashtruesit, të garantuara me Kushtetutë.

42. Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane (*Shih rastin Fressoz dhe Roire kundër Francës, Kërkesa nr. 29183/95, Aktgjykimi i 21 janarit 1999*) ritheksoi, *mutatis mutandis*, se "qëllimi i rregullit [Rregullit për shterimin], i referuar më lart, është që t'u jepet mundësia shteteve kontraktuese që të parandalojnë ose të korrigjojnë – zakonisht nëpërmjet gjykatave – shkeljet e pretenduara kundër tyre, para se këto pretendime të ngrihen në Gjykatë. Ky rregull duhet të zbatohet me 'me një shkallë fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruar'; mjafton që ankesat që mendohet të paraqiten më vonë në Strasburg të jenë ngritur

‘të paktën në substancë dhe në pajtim me kërkesat formale dhe afatet kohore të përcaktuara në ligjin nacional’, pranë autoriteteve nacionale” (*Shih, Castells kundër Spanjës, Aktgjykimi i 23 prillit 1992, seria A, nr. 236, § 19, § 27,* dhe *The Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, Raportet 1996-IV, fq. 1210-11, §§ 65 e 69*)”.

43. Në pajtim me parimin e subsidiaritetit, parashtruesi i kërkesës është i detyruar të shterë të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në dispozita të tjera ligjore, të cilat u përmendën më lart.

44. Në të vërtetë, qëllimi i rregullit të shterimit është që, në këtë rast, t'i ofrohet Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe Gjykatës Supreme mundësia e korrigjimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës. Rregulli i shterimit është i ndërthurur në mënyrë funksionale me karakterin e subsidiaritetit të kornizës procedurale të drejtësisë kushtetuese. (*Shih, mutatis mutandis, Selmouni kundër Francës [GCl, § 74; Kudla kundër Polonisë [GCl, § 152; Andrashik dhe të tjerët kundër Sllovakisë [dec.]).*

45. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Ndryshe, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës, kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo nëse dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Ai dështim do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për të kundërshtuar më tej shkeljen dhe për t’u ankuar. *(Shih, Aktvendimi në rastin Kl07/09, Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl.nr.61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18).*

46. Kurdo që kontestohet një vendim në bazë të një qëndrimi juridik, që është i papranueshëm nga pikëvështrimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, gjykatave të rregullta që sollën vendimin duhet t’u ofrohet mundësia e rishqyrtimit të vendimit të kontestuar. Kjo do të thotë se, çdoherë, kur pretendohet shkelja e të drejtave të njeriut, nuk është e thënë që ky pretendim të arrijë në Gjykatën Kushtetuese, para se të shqyrtohet paraprakisht nga gjykatat e rregullta.

47. Parashtruesi i kërkesës, në këtë rast, do të duhej të ishte ankuar në mënyrë implicite, apo në substancë, në Gjykatën e Qarkut në Pejë dhe në Gjykatën Supreme kundër shkeljes së pretenduar të së drejtës së tij për

gjykim të drejtë, pasi që ato gjykata "gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit" (neni 102.3 i Kushtetutës).

48. Në praktikë, asgjë nuk e ndaloi parashtruesin e kërkesës të ankohej në Gjykatën e Qarkut në Pejë dhe në Gjykatën Supreme për shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij për gjykim të drejtë. Nëse ato gjykata do ta merrnin në shqyrtim shkeljen dhe do ta korrigjonin atë, kjo do të përfundonte; nëse ato nuk do ta rregullonin shkeljen, apo nuk do ta shqyrtonin atë, parashtruesi i kërkesës do t'i kishte plotësuar kushtet e pranueshmërisë për shterimin e mjeteve, në kuptimin që këtyre gjykatave u është ofruar mundësia e korrigjimit të shkeljes së pretenduar.

49. Në fakt, kjo analizë është në përputhshmëri me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane, e cila parasheh që parashtruesit vetëm duhet shteruar mjetet vendore që i kanë në dispozicion në teori dhe në praktikë në kohën përkatëse, që do të thotë që janë të arritshme, që janë në gjendje të sigurojnë zgjidhje përkitazi me ankesat e tyre dhe që ofrojnë mundësi të arsyeshme për sukses (*Shih, Sejdovic kundër Italisë [GCl, nr. 56581/00, KEDNJ 2006-IJ, § 46)*. Duhet vlerësuar, në të gjitha rrethanat e rastit, nëse parashtruesi i kërkesës ka bërë gjithçka që me arsye pritet prej tij, ose prej saj, për të shteruar mjetet vendore *(Shih, D. H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke [GCl, §§ 11622)*.

50. Gjykata Kushtetuese, gjithashtu, aplikoi arsyetimin e njëjtë kur nxori aktvendimet për papranueshmëri në bazë të mosshterjes së mjeteve juridike: më 4 dhjetor 2012, në Rastin Nr. KI120/11, Ministria e Shëndetësisë - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme A.nr.551; më 27 janar 2010, në Rastin Nr. KI49/09, Universiteti AAB RIINVEST SH.P.K. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës; dhe, më 23 mars 2010, në vendimin e saj në Rastin Nr.73/09, Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor.

51. Parimisht, dhe në fakt, parashtruesi i kërkesës nuk mund të ankohet drejtpërdrejt në Gjykatë Kushtetuese për shkelje të pretenduar të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, pa e ngritur një shkelje të tillë të pretenduar në mënyrë implicite, apo në substancë, në gjykatat e rregullta.

52. Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese konsideron që faktet e rastit nuk lejojnë një konkludim bindës, se bazat e ankesës: "*shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, shkelje e ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin*

penal", të pretenduara në Gjykatën Supreme, e kalojnë testin e Gjykatës Evropiane. Rrjedhimisht, nuk ka nevojë të shqyrtohet çështja në këto rrethana të rastit.

53. Për më tepër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka argumentuar dhe nuk e ka mbështetur me prova shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij nga Gjykata e Qarkut në Pejë dhe nga Gjykata Supreme.

54. Në fakt, pretendimi i parashtruesit për shkeljen e të drejtave kushtetuese nuk paraqet bazë të mjaftueshme *prima facie* për ngritjen e rastit në Gjykatë. Pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me vendimin e gjykatave të rregullta nuk mund të jetë bazë kushtetuese për t'u ankuar në Gjykatë Kushtetuese.

55. Për më tepër, Gjykata vëren se, për të pasur një rast *prima facie* që përmbush kriteret e pranueshmërisë së kërkesës, parashtruesi duhet të dëshmojë se procedurat në Gjykatën e Qarkut në Pejë dhe në Gjykatën Supreme, shikuar në tërësinë e tyre, nuk janë zbatuar në mënyrë të tillë që parashtruesi të ketë pasur një gjykim të padrejtë, apo që shkeljet e tjera të të drejtave kushtetuese mund të jenë kryer nga gjykatat e rregullta gjatë procesit të gjykimit.

56. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet rregullit 36.1 (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton: *"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) Kërkesa është qartazi e bazuar".*

57. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të trajtojë gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përderisa ato nuk i shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

58. Andaj, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së tretë, në rastin konkret, kur shqyrton vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe të së drejtës materiale (*Shih, mutatis mutandis, García Ruiz vs. Spain [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I*).

59. Sidoqoftë, parashtruesi nuk shpjegon pse dhe si janë shkelur të drejtat e tij, ai nuk e mbështet pretendimin *prima facie* mbi baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se nga gjykatat e rregullta i janë shkelur

të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 e me nenin 13 të KEDNJ-së.

60. Gjykata Kushtetuese nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse në Gjykatën e Qarkut në Pejë dhe në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (*Shih, mutatis mutandis, Shub vs. Lithuania, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009*).

61. Në fakt, parashtruesi nuk ka provuar *prima facie* pse dhe si i ka shkelur Gjykata e Qarkut në Pejë dhe Gjykata Supreme të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], me nenin 6 e me nenin 13 të KEDNJ-së.

62. Prandaj, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës as nuk ka ndërtuar, e as nuk ka dëshmuar një rast *prima facie,* qoftë mbi bazën e meritave apo të pranueshmërisë së kërkesës.

63. Në tërësi, Gjykata konstaton se kërkesa është e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

64. Gjykata, më tutje, konstaton se pasi kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, kërkesa për masë të përkohshme nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit, prandaj duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 116.2 të Kushtetutës; në bazë të nenit 27 dhe të nenit 48 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.1 (c), me rregullin 55 e me rregullin 56.2 të Rregullores, më 12 mars 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 19/10, SHpk "Syri", datë 27 mars 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit të nxjerrë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, SCA-09-0041, të 9 shkurtit 2010.

Rasti KI19/10, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 nëntor 2012.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, mos shterje e mjeteve juridike.

Parashtruesi e konteston kushtetutshmërinë e Urdhrit të lëshuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme), SCA -09-0041, të 9 shkurtit 2010 (në tekstin e mëtejmë: Urdhri i 9 shkurtit 2010), sipas të cilit, parashtruesit, si paditës në procedurën civile në Dhomën e Posaçme, i kërkohej t'i dërgonte përkthimet e të gjitha parashtresave dhe dokumenteve përkatëse në gjuhën angleze në shpenzime të tij.

Parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese të konstatojë shkelje të të drejtave të njeriut dhe të kërkojë nga Dhoma e Posaçme që ta përkthejë dokumentacionin me shpenzime të veta.

Gjykata konstaton se kërkesa nuk i përmbush kriteret e nenit 113.7 të Kushtetutës, nuk i përmbush kriteret e nenit 47.2 të Ligjit dhe nuk i përmbush kriteret e rregullit 36.1 (a) të Rregullores, dhe si e tillë është e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin KI19/10
Parashtrues
Sh.P.K. "Syri"
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit të nxjerrë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, SCA-09-0041, të 9 shkurtit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović,
Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtrues

1. Parashtrues është Sh.P.K. "Syri" nga Gjakova, përfaqësuar nga z. Enver Mulliqi nga Gjakova.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi e konteston kushtetutshmërinë e Urdhrit të lëshuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme), SCA -09-0041, të 9 shkurtit 2010 (në tekstin e mëtejmë: Urdhri i 9 shkurtit 2010), sipas të cilit, parashtruesit, si paditës në procedurën civile në Dhomën e Posaçme, i kërkohej t'i dërgonte përkthimet e të gjitha parashtresave dhe dokumenteve përkatëse në gjuhën angleze në shpenzime të tij.

3. Më pas, parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e nenit 25.7 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6, për ndryshimin dhe zëvendësimin e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2006/17, për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13 për Themelimin e Dhomës së Posaçme të Kosovës për

Çështjet që Ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: UA i UNMIK-ut 2008/6).

4. Parashtruesi pohon që Urdhri i kontestuar i 9 shkurtit 2010, që u nxor në përputhje me nenin 25.7 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6, shkel nenin 5 [Gjuhët], nenin 23 [Dinjiteti Njerëzor], nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6, nenin 14 dhe nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Parashtruesi më tej pohon se *"gjyqtarët e EULEX-it nuk do të duhej ta aplikojnë asnjë dispozitë e cila i cenon të drejtat elementare të njeriut, e posaçërisht dispozitën që quhet Urdhër administrativ, që në fakt është akt nënligjor"*.

5. Neni i kontestuar i Urdhëresës Administrative Nr. 2008/6 është neni 25.7 dhe ai parashikon gjuhën në të cilën duhet të dorëzohen rastet në Dhomën e Posaçme dhe thotë me sa vijon:

> *25.7 Parashtresat dhe dokumentet përcjellëse mund të paraqiten në gjuhën shqipe, serbe ose angleze. Por, nëse paraqiten në gjuhën shqipe ose serbe, duhet të sigurohet edhe përkthimi i të gjitha parashtresave dhe dokumenteve përcjellëse edhe në gjuhën angleze. Shpenzimet e përkthimit i heq pala.*

6. Parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese të konstatojë shkelje të të drejtave të njeriut dhe të kërkojë nga Dhoma e Posaçme që ta përkthejë dokumentacionin me shpenzime të veta.

Baza juridike

7. Neni 113, paragrafi 1 dhe paragrafi 7, i Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); neni 20 i Ligjit dhe rregulli 36 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

8. Më 1 mars 2010, parashtruesi e parashtroi kërkesën e tij në Gjykatë.

9. Më 17 mars 2010, Kryetari i Gjykatës e caktoi Zëvendëskryetarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe caktoi edhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.

10. Më 24 gusht 2010, Gjykata ia dërgoi kërkesën Dhomës së Posaçme dhe kërkoi komentet dhe/ose vërejtjet e tyre përkitazi me këtë kërkesë.

11. Dhoma e Posaçme u përgjigj më 10 nëntor 2010. Përgjigja e tyre do të trajtohet më poshtë.

12. Më 10 mars 2011, Sekretaria e Gjykatës Kushtetuese ia dërgoi parashtruesit përgjigjen e Dhomës së Posaçme dhe kërkoi komentet e tij. Gjykata, gjithashtu, kërkoi nga Gjykata Ekonomike e Qarkut kopje të dokumenteve shtesë përkitazi me rastin e parashtruesit të kërkesës.

13. Më 23 mars 2011, parashtruesi iu përgjigj Gjykatës. Ai e informoi Gjykatën se, meqë *"moszbatimi sipas urdhrit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me AKM-në paraqiste rrezik për hedhje poshtë të ankesës, paditësi ka paguar përkthimin dhe ka dërguar aktgjykimin e përkthyer, ankesën dhe provat mbështetëse. Duhet cekur se shpenzimet e përkthimit janë relativisht të mëdha, një faqe kushton 10 euro"*.

14. Parashtruesi më tej shtoi: *"Urdhëresa administrative në fjalë është në kundërshtim me nenin 6 – e Drejta për Proces të Drejtë, me nenin 14 – Ndalimi i Diskriminimit, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, dhe nenin 1, të Protokollit 1 të Konventës, në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe dispozitat dhe garancitë kushtetuese me nenet 5, 23, 24, 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gjyqtarët e EULEX-it nuk do të duhej ta aplikojnë asnjë dispozitë e cila i cenon të drejtat elementare të njeriut, e posaçërisht dispozitën që quhet Urdhër administrativ, që në fakt është akt nënligjor"*. Parashtruesi gjithashtu bashkëngjiti ankesën kundër aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, që ishte objekt i çështjes së parashtruar në Dhomën e Posaçme.

15. Më 2 korrik 2012, Kryetari caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), që zëvendësoi gjyqtaren Iliriana Islami, sepse mandati i saj në Gjykatë përfundoi më 26 qershor 2012, Snezhana Botusharova dhe Enver Hasani (anëtarë).

16. Gjithashtu, më 2 qershor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues duke e shtyrë për shqyrtim të mëtejshëm.

17. Më 24 shtator 2012, Sekretariati i Gjykatës kërkoi nga parashtruesi i kërkesës dhe nga Dhoma e Posaçme që ta njoftojnë përkitazi me statusin e rastit të parashtruesit të kërkesës para Dhomës së Posaçme.

18. Gjykata nuk ka pranuar ndonjë përgjigje të parashtruesit të kërkesës ndaj shkresës së 24 shtatorit 2012.

19. As Dhoma e Posaçme nuk ka dorëzuar ndonjë përgjigje ndaj shkresës së Gjykatës, të 24 shtatorit 2012.

20. Më 27 nëntor 2012, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

21. Në vazhdim është përmbledhja e fakteve nga dokumentet që kanë paraqitur palët e përfshira në procedurë.

22. Gjykata Ekonomike e Qarkut, më 19 qershor 2008, hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër të paditurës – Korporatës Energjetike të Kosovës – Rrjeti shpërndarës, Rajoni i Gjakovës, për, gjoja, një borxh në shumën 28.689,85 euro.

23. Më 6 prill 2009, parashtruesi kishte ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut, I. C. nr. 198/2007, të 19 qershorit 2008.

24. Ankesa dhe dokumentet përcjellëse, d.m.th. teksti i aktgjykimit të kontestuar, ishte përpiluar në gjuhën shqipe dhe nuk ishte dorëzuar në Dhomën e Posaçme me përkthimin në gjuhën angleze.

25. Më 9 shkurt 2010, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës nxori një urdhër me të cilin kërkonte që parashtruesi në këtë kërkesë, brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, të dorëzonte me sa vijon:

Urdhër

"*Kërkohet nga Paditësi/Ankuesi që brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh nga dita e pranimit të këtij Urdhri të dorëzojë:*

1. *Në pajtim me nenin 58.2 dhe 25.4 të Urdhëresës Administrative (UA) të UNMIK-ut 2008/6 dëshmia e*

autorizimit me të cilin autorizohet t'i përfaqësojë paditësit në procedurat pranë Dhomës së Posaçme (duke përfshirë emrin, mbiemrin dhe adresën e avokatit, së bashku me përkthimin në gjuhën angleze):

2. *Në pajtim me nenin 60.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6 kopjen e aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut I. C. nr. 198/2007, kundër të cilit është ushtruar ankesa së bashku me përkthimin në gjuhën angleze.*

3. *Në pajtim me nenin 58.2 dhe 25.7 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 përkthimin në gjuhën angleze të ankesës si dhe të gjitha dokumentet e tjera mbështetëse.*

4. *Sipas nenit 25.7 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6: "Parashtresat dhe dokumentet përcjellëse mund të paraqiten në gjuhën shqipe, serbe ose angleze. Por, nëse paraqiten në gjuhën shqipe apo serbe, duhet të sigurohet edhe përkthimi i të gjitha parashtresave dhe dokumenteve përcjellëse edhe në gjuhën angleze. Shpenzimet e përkthimit heq pala". Në lidhje me nenin 58.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6, neni 25.7 i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 është i aplikueshëm edhe në procedurën e ankesës.*

5. *Nëse Paditësit/Ankuesit nuk i parashtrojnë ankesën e kompletuar apo të korrigjuar e cila i plotëson kërkesat e parapara me nenin 28.2 (f) të UD të UNMIK-ut brenda katërmbëdhjetë (14) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, atëherë Dhoma e Posaçme do të refuzojë Ankesën/Padinë mbi bazat e papranueshmërisë".*

26. Ky urdhër i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme u nënshkrua nga një gjyqtare e EULEX-it. Pas lëshimit të këtij urdhri, më 9 shkurt 2010, kërkesa u parashtrua në Gjykatën Kushtetuese më 1 mars 2010.

27. Megjithatë, më 29 mars 2010, parashtruesi i kërkesës veproi në përputhje me Urdhrin brenda afatit të paraparë 14-ditësh dhe ofroi përkthimin e dokumenteve të kërkuara.

Komentet e Dhomës së Posaçme

28. Më 10 nëntor 2010, Dhoma e Posaçme iu përgjigj njoftimit të Gjykatës Kushtetuese, të cilin e kishin marrë më 25 gusht 2010.

29. Në përgjigjen e dërguar, Dhoma e Posaçme thekson: *"Paditësi, Sh.P.K. 'Syri', në Gjakovë, më 6 prill 2009 ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut I. C. nr. 198/2007, të 19 qershorit 2008. Pasi ankesa e parashtruar nga parashtruesi ...ishte dorëzuar vetëm në gjuhën shqipe, gjyqtari përgjegjës lëshoi një urdhër për paditësin/ankuesin Sh.P.K. 'Syri' përmes të cilit kërkonte nga paditësi që ta dorëzonte aktgjykimin kundër të cilit ishte parashtruar ankesa dhe përkthimin në gjuhën angleze të ankesës dhe të dokumenteve përcjellëse gjithashtu në përputhje me nenin 25.7 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut (UA e UNMIK-ut) 2008/6 në lidhje me nenin 58.2 të UA të UNMIK-ut. ...Neni 58.2 i Urdhëresës Administrative 2008/6 parashikon që 'rregullorja e punës dhe dëshmitë që e udhëheqin procedurën e paneleve gjykuese vlejnë përshtatshmërisht (mutatis mutandis) për procedurën e panelit të ankesave'. Në anën tjetër, neni 60.2 i Urdhëresës Administrative 2008/6 kërkon që 'vendimi i Panelit Gjyqësor apo gjykatës kundër vendimit të së cilës ushtrohet ankesa i bashkëngjitet ankesës'. Pasi parashtruesi nuk e ofroi vendimin dhe përkthimin në gjuhën angleze të ankesës dhe të vendimit kundër të cilit ishte ushtruar ankesa, paditësi u urdhërua t'i siguronte ato. Kjo ishte praktikë e përgjithshme e Gjykatës në përputhje me Urdhëresën Administrative 2008/6, e cila zbatohet për të gjitha paditë/ankesat e parashtruara në Dhomën e Posaçme pasi gjuha në të cilën Gjykata punon është anglishtja. Vlen të përmendet që nëse paditësi/ankuesi është person fizik, atij/asaj i rikujtohet mundësia se mund të kërkojë ndihmë në përkthim. Më 29 mars 2010, paditësi/parashtruesi i kërkesës veproi në përputhshmëri me urdhrin e lartpërmendur dhe i dorëzoi Dhomës së Posaçme dokumentet dhe përkthimin e kërkuar".*

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

30. Kriteret e pranueshmërisë janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

32. Në anën tjetër, neni 47.2 i Ligjit, gjithashtu, përcakton:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

33. Për më tepër, rregulli 36.1 (a) parasheh:

"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar".

34. Siç u përmend më lartë, Gjykata nuk ka marrë përgjigje ndaj shkresës ku kërkoheshin informata përkitazi me statusin e rastit që ishte në procedurë e sipër para Dhomës së Posaçme, as nga parashtruesi e as nga Dhoma e Posaçme.

35. Me sa duket, në këtë rast, parashtruesi nuk ka arritur të shterojë të gjitha mjetet juridike në dispozicion, pasi rasti është ende në procedurë e sipër para Dhomës së Posaçme.

36. Prandaj, në rrethanat kur një rast është në procedurë e sipër në Dhomën e Posaçme, Gjykata Kushtetuese nuk është në gjendje të vazhdojë më tej për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës. Duket se kërkesa është e parakohshme.

37. Me sa u tha, Gjykata konstaton se kërkesa nuk i përmbush kriteret e nenit 113.7 të Kushtetutës, nuk i përmbush kriteret e nenit 47.2 të Ligjit dhe nuk i përmbush kriteret e rregullit 36.1 (a) të Rregullores, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 47 të Ligjit; si dhe në pajtim me rregullin 36.1 (a) (b) të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'U KOMUNIKOHET ky palëve ky vendim;

III. TË PUBLIKOHET në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 10/13, Enver Zeneli, datë 27 mars 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl.nr.125/2012, i datës 30 nëntor 2012

Rasti KI 10/13, Aktvendim për papranueshmëri i 12 mars 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, qartazi e pabazuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe te paanashëm

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se është cënuar e drejta e tij kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushetetutës. Parashtruesi më tutje kërkon, edhe pse jo shprehimisht, nga Gjykata Kushtetuese që të vendosë masën e përkohshme në rastin e tij, duke ndalimin e ekzekutimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës sëparë në Prishtinë, identifikuar në shkresa.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrueses ishte e papranueshme bazuar në Rregullin 56.2 të Rregullores së Punës për shkak se Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të të drejtës procedurale dhe materiale. Më tej, duke marrë parasysh që kërkesa është shpallur e papranueshme, Gjykata vendosi të refuzojë kërkesën për mast ë përkohshme, pasiqë Parashtruesi thjesht kërkon nga Gjykata të vendosë masën e përkohshme, pa ofruar ndonjë argument apo dokumente relevante shtesë që mbështesin kërkesën e tij.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
Në
Rasti nr. KI 10/13
Parashtruesi
Enver Zeneli
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl.nr.125/2012, i datës 30 nëntor 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, Gjyqtare

Kërkesa

1. Kërkesa është parashtruar nga Enver Zeneli, me banim në fshatin Malishevë, Komuna e Gjilanit (më tej në tekst: Parashtruesi), përfaqësuar me autorizim nga Z. Shemsedin Piraj.

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pkl.nr.125/2012, të datës 30 nëntor 2012 (më tej në tekst: Aktgjykimi).

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit, si dhe Rregullat 30 dhe 75 të Rregullores.

Procedura në Gjykatë

4. Më 25 janar 2013, Parashtruesi ka dorëzuar Kërkesën e tij në Gjykatë.

5. Më 3 shkurt 2012, Kryetari emëroi Gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar Raportues, si dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga Gjyqtarët Altay Suroy (Kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

6. Më 27 shkurt 2013, Gjykata informoi Gjykatën Supreme të Kosovës për Kërkesën.

7. Më 27 shkurt 2013, Gjykata i dërgoi letër Parashtruesit, duke i kërkuar atij të plotësojë formularin zyrtar të kërkesës, si dhe të bashkëngjesë edhe autorizimin e avokatit të tij.

8. Më 4 mars 2013, avokati i Parashtruesit dorëzoi dokumentet e kërkuara shtesë.

9. Më 12 mars, 2013, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmeri të kërkesës, dhe të refuzojë kërkesën p%r masë të përkohshme.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 6 prill 2006, Gjykata Komunale në Prishtinë e shpalli (P.nr.210/2005) Parashtruesin fajtor për akuzën e vjedhjes së rëndë [neni 253 i KPK-së] dhe falsifikimin e dokumenteve [neni 332 i KPK-së] si dhe e dënoi atë me 6 muaj burgim dhe gjobë prej 1000 € (një mijë Euro).

11. Më 17 qershor 2006, Parashtruesi bëri ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër atij Aktgjykimit, duke e kontestuar atë, me propozim të anulimit të aktgjykimit dhe rigjykimit të tij.

12. Më 21 nëntor 2008, Gjykata e Qarkut pjesërisht aprovoi (AP.nr.452/06) ankesën e Parashtruesit, si dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, duke e konfirmuar burgimin për gjashtë (6) muaj, si dhe duke ndryshuar shumën e gjobës nga 1000 € (njëmijë euro) në 800 (tetëqind euro).

13. Më 13 korrik 2012, Parashtruesi dorëzoi në Gjykatën Supreme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, sepse «unë si i akuzuar nuk kam mundur të paraqes mbrojtjen time, pra e drejta ime për t'u mbrojtur në këtë fazë të procedurës është shkelur, si dhe ka qenë e rëndësishme për dhënien e një aktgjykimi të drejtë dhe ligjor”.

14. Më 22 mars 2010, Gjykata Supreme e shpalli (Pkl.nr.15/2010) kërkesën të bazuar, si dhe anuloi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, si dhe obligoi rigjykimin e rastit, pasi që Gjykata e Qarkut në Prishtinë kishte shkelur dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që rregullojnë pjesëmarrjen e palëve në seanca gjyqësore.

15. Më 6 maj 2010, Gjykata e Qarkut hodhi poshtë (Ap.nr.152/2010) ankesën e Parashtruesit, si dhe konfirmoi aktgjykimin (P.nr.210/2005) e Gjykatës Komunale.

16. Më 13 korrik 2012, Parashtruesi edhe një herë i kërkoi Gjykatës Supreme mbrojtjen e ligjshmërisë.

17. Më 30 nëntor 2012, Gjykata Supreme e hodhi poshtë (Pkl.no.125/2012), kërkesën si të pabazuar, duke theksuar që:

"...shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale që janë pohuar nuk janë të bazuara, siç theksohet në arsyetimin e këtij aktgjykimi, dispozitivi është i kuptueshëm i qartë dhe nuk ka kundërthënie me vetveten apo me arsyetimin".

Pretendimet e Parashtruesit

18. Parashtruesi pretendon që "*gjykata e shkallës së parë, për arsye të panjohura për mua, i ka hequr vetes mundësinë që në këtë rast, të vlerësojë gjendjen faktike që prej krahasimit të mundshëm të këtyre të dhënave të këtyre dy mjeteve, do të mund të arrinte lehtësisht tek përfundimi që kemi të bëjmë me dy mjete që janë tërësisht të ndryshme në kuptimin e të dhënave të tyre teknike...*".

19. Përveç kësaj, Parashtruesi pretendon që *"në mungesë të ofrimit të provave të propozuara materiale nga eksperti i fushës përkatëse – makinerisë, ekspertizë që është propozuar nga përfaqësuesi i mbrojtjes, gjendja faktike nuk është vërtetuar"*.

20. Në përgjithësi, Parashtruesi ankohet që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës.

21. Parashtruesi përfundon duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që të nxjerrë një aktgjykim i cili do të:

"SHPALLËtë pranueshme kërkesën e parashtruesit Enver Zeneli nga fshati Malisheva, Komuna e Gjilanit.

HEDHË POSHTË gjitha vendimet e gjykatës dhe të kthejë rastin në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

REKOMANDOJË gjykatës së shkallës së parë që të sigurojë provat e nevojshme materiale nga ekspertiza e një eksperti të fushës

përkatëse – makineria, e cila është propozuar nga avokati i mbrojtjes dhe parashtruesi i kësaj kërkese".

22. Parashtruesi më tutje kërkon, edhe pse jo shprehimisht, nga Gjykata Kushtetuese që të vendosë masën e përkohshme në rastin e tij, duke kërkuar që:

" TË URDHËROJË ndalimin e ekzekutimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës sëparë në Prishtinë, identifikuar në shkresa".

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së Kërkesës

23. Më së pari, Gjykata vlerëson nëse Parashtruesi ka përmbushur kërkesat e pranueshmërisë të caktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe Rregullore.

24. Gjykata vëren se Parashtruesi ka argumentuar kërkesën me fakte të cilat i konsideron relevante dhe një referencë të nënkuptuar ndaj shkeljes së pohuar; shprehimisht kontestohet Aktgjykimi si akt konkret i autoritetit publik që i nënshtrohet shqyrtimit; thekson zgjidhjen e kërkuar; si dhe përmban vendimet e ndryshme dhe informatat e dokumentet tjera përkatëse.

25. Megjithatë, Gjykata vëren që Rregulli 36 (1).c) i Rregullores së Punës përcakton që:

"Gjykata mund të merret me Kërkesat vetëm nëse: c) Kërkesa nuk është qartazi e pabazuar."

26. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe palët e autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton që:

"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

27. Pretendimi kryesor i Parashtruesit ka të bëjë me pohimin për vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të provave materiale nga gjykatat e rregullta.

28. Gjykata rikujton që nuk është detyra e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet faktike apo ligjore (ligjshmërinë) që pohohen të jenë kryer nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe deri në atë masë sa

këto mund të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

29. Kështu, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të të drejtës procedurale dhe materiale (shih, mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

30. Pra, Gjykata mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë që procedurat në përgjithësi, të shikuara në plotëninë e tyre, janë ndërmarrë në atë mënyrë që t'i sigurojnë Parashtruesit gjykim të drejtë (shih, mes burimeve tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Ap. Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

31. Për më tepër, Parashtruesi thjesht konteston faktin nëse Gjykata Supreme ka zbatuar plotësisht ligjin në fuqi, si dhe nuk pajtohet me gjetjet faktike të gjykatave në lidhje me rastin e tij.

32. Sa për faktet, Parashtruesi nuk ka vërtetuar pohimet e tij në baza kushtetuese, si dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë cenuar nga Gjykata Supreme.

33. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konkludojë që procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejtura apo të njollosura me arbitraritet (shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e aplikacionit nr. 17064/06 të datës 30 qershor 2009).

34. Për më tepër, Gjykata thekson që aktgjykimet e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Qarkut kanë qenë shumë mirë të argumentuara dhe thellësisht të arsyetuara, si dhe rikujton edhe një herë që nuk i përket juridiksionit të vlerësimit të kushtetutshmërisë që të shqyrtojë vlerësimin e provave që bëhet nga gjykatat e rregullta.

35. Pra, rrjedh që në bazë të nenit 113 (1) të Kushtetutës, si dhe Rregullit 36 (1.c) të Rregullores, Kërkesa është e papranueshme dhe qartazi e pabazuar.

Kërkesa për masë të përkohshme

36. Neni 27 i Ligjit, si dhe në veçanti Rregulli 54 (1) i Rregullores së Punës, përcaktojnë që «në çfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës, si dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme».

37. Megjithatë, duke marrë parasysh që Kërkesa është shpallur e papranueshme, Parashtruesi nuk ka të drejtë, sipas Rregullit 54 (1) të Rregullores së Punës, që të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme.

38. Për më tepër, Parashtruesi thjesht kërkon nga Gjykata të vendosë masën e përkohshme, pa ofruar ndonjë argument apo dokumente relevante shtesë që mbështesin kërkesën e tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 27 të Ligjit dhe rregullin 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 12 mars 2013, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme;

III. TU KOMUNIKOJË këtë Vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;

V. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 81/10, datë 27 mars 2013- Aktvendim për përmirësimin e gabimeve teknike në Aktvendimin për papranueshmëri, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për Rastin KI81/10, të datës 15 shtator 2012.

Rasti KI 81/10, Vendim, i 4 marsit 2013.

Fjalë kyçe: Vendim për përmirësim të gabimeve teknike

Gjykata Kushtetuese, me qëllim që teksti i Aktvendimit për papranueshmëri, për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012, të reflektojë në tërësi vendimin meritor të kësaj gjykate përkitazi me kërkesën e parashtruar nga pala e autorizuar dhe për të evituar paqartësitë e mundshme që mund të shfaqen si pasojë e gabimeve teknike të publikuara në Aktvendimin për papranueshmëri, për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 61 (1.1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 mars 2013.

Gjykata njëzëri vendosi të aprovoj EX OFFICIO përmirësimet në Aktvendimin për papranueshmëri, për rastin KI81/10, e 15 shtatorit 2012.

Në bazë të nenit 11.1 (1.4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009, dhe në bazë të rregullit 61 (1.1) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, e 14 dhjetorit 2012), me qëllim të përmirësimit të gabimeve teknike në Aktvendimin për papranueshmëri për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012, Gjykata Kushtetuese, *ex officio*, më 4 mars 2013, merr:

AKTVENDIM

PËR PËRMIRËSIMIN E GABIMEVE TEKNIKE NË AKTVENDIMIN PËR PAPRANUESHMËRI, TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR RASTIN KI81/10, të 15 shtatorit 2012

I. **PËRMIRËSOHET** Aktvendimi për papranueshmëri, për rastin KI81/10, i 15 shtatorit 2012, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ashtu që, në paragrafin 1, emri i parashtruesit të kërkesës shkruhet z. NAZIF REKA, në vend të emrit Ramadan Rrahmani.

II. **PËRMIRËSOHET** Aktvendimi për papranueshmëri, për rastin KI81/10, i 15 shtatorit 2012, në paragrafin 13, ashtu që, në rreshtin e tretë FSHIHET tërësisht shprehja "e apelit", e cila është e radhitur pas tekstit "Gjykatën Komunale si dhe Gjykatën e Qarkut në Prishtinë".

III. **PËRMIRËSIMET** e bëra sipas këtij aktvendimi vlejnë për të tri versionet gjuhësore të Aktvendimit për papranueshmëri, për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012, ndërsa pjesa e tjetër e tekstit të Aktvendimit për papranueshmëri, për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012, mbetet e pandryshuar dhe mbetet në fuqi.

IV. Ky aktvendim është pjesë përbërëse e Aktvendimit për papranueshmëri, për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012, dhe bëhet publik, si dhe u komunikohet palëve në mënyrë të njëjtë sikurse edhe në Aktvendimin për papranueshmëri, për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, me qëllim që teksti i Aktvendimit për papranueshmëri, për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012, të reflektojë në tërësi vendimin meritor të kësaj gjykate përkitazi me kërkesën e parashtruar nga pala e autorizuar dhe për të evituar paqartësitë e mundshme që mund të shfaqen si pasojë e gabimeve teknike të publikuara në Aktvendimin për papranueshmëri, për rastin KI81/10, të 15 shtatorit 2012, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 61 (1.1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 mars 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TË APROVOJË *EX OFFICIO* përmirësimet në Aktvendimin për papranueshmëri, për rastin KI81/10, e 15 shtatorit 2012;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 37/12, Murtez Gashi dhe Shehide Gashi, datë 28 mars 2013- Kontestim i kushtetutshmërisë së vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të 29 nëntorit 2011.

Rasti KI 37/12 Vendim, i 19 shtator 2012.

Fjalë kyçe: Vendim për heqjen e kërkesës nga lista

Parashtruesit pohojnë se nuk u është siguruar e drejta për barna falas, të përfshira në listën falas sipas Ligjit për Shëndetësi, dhe kjo përbën diskriminim, pasi ata janë anëtarë të një komuniteti të rrezikuar dhe të një grupi të margjinalizuar, d.m.th. të komunitetit shkali.

Për më tepër, parashtruesit pohojnë se Strategjia Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të vjetra nuk është në përputhshmëri me politikën e prioriteteve dhe me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjë që përbën shkelje të nenit 53 të Kushtetutës dhe, si e tillë, duhet të shpallet jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

Për të vendosur se çfarë hapash të tjerë duhet ndërmarrë pas komunikimit me përfaqësuesin e parashtruesve, Gjykata i referohet rregullit 32 të Rregullores së Punës të Gjykatës, i cili përcakton Tërheqjen e kërkesës dhe përgjigjes.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 32 të Rregullores së Punës, njëzëri vendosi Ta heqë kërkesën nga lista.

VENDIM PËR HEQJEN E KËRKESËS NGA LISTA
në
Rastin Nr. KI37/12
Parashtrues
Murtez Gashi dhe Shehide Gashi
Kontestim i kushtetutshmërisë së vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të 29 nëntorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë Murtez dhe Shehide Gashi, nga Fushë-Kosova, të përfaqësuar nga Bahtir Troshupa, për Qendrën Evropiane për Çështje të Minoriteteve, Kosovë.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesit pohojnë se nuk u është siguruar e drejta për barna falas, të përfshira në listën falas sipas Ligjit për Shëndetësi, dhe kjo përbën diskriminim, pasi ata janë anëtarë të një komuniteti të rrezikuar dhe të një grupi të margjinalizuar, d.m.th. të komunitetit ashkali.

3. Për më tepër, parashtruesit pohojnë se Strategjia Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra nuk është në përputhshmëri me politikën e prioriteteve dhe me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjë që përbën shkelje të nenit 53 të Kushtetutës dhe, si e tillë, duhet të shpallet jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 32 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Përmbledhje e fakteve, bazuar në dokumentet e paraqitura nga parashtruesit

5. Më 16 shtator 2009, parashtruesit dorëzuan kërkesë me shkrim në Departamentin Komunal të Shëndetësisë në Fushë-Kosovë. Në kërkesën në fjalë, autoriteteve lokale u janë bërë me dije të drejtat e parashtruesve sipas nenit 22.1 të Ligjit për Shëndetësi, që ka të bëjë me barnat esenciale të përfshira në listën falas, si dhe përgjegjësinë e Republikës së Kosovës për t'u siguruar komuniteteve të cenueshme dhe grupeve të margjinalizuara qasje të barabartë në shërbime shëndetësore pa diskriminim, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve.

6. Më 4 nëntor 2009, kërkesa e parashtruesve është vënë në vëmendje të Njësisë për të Drejtat e Njeriut të Ministrisë së Shëndetësisë. Udhëheqësi i Njësisë, përgjegjës për monitorimin e rasteve diskriminuese në sektorin shëndetësor, nuk ka ndërmarrë ndonjë hetim për të konfirmuar ndonjë diskriminim potencial, siç kishte premtuar fillimisht.

7. Më 12 mars 2010, parashtruesit parashtruan padi kundër Qeverisë së Kosovës, e evidencuar si Rasti nr. 565/2010.

8. Më 29 korrik 2011, parashtruesit i shkruan Kryetarit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, duke kërkuar që t'i japë prioritet rastit të tyre. Ata nuk morën ndonjë përgjigje.

9. Më 28 tetor 2011, parashtruesit i shkruan Kryetarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke kërkuar që t'i japë prioritet rastit të tyre, sepse vonesa në shqyrtimin e rastit do të ishte e dëmshme për shëndetin e parashtruesve.

10. Më 29 nëntor 2011, parashtruesit pranuan një përgjigje nga Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me ç'rast u informuan se lënda për të cilën kishin ngritur padi nuk hynte në kategorinë e rasteve me prioritet në bazë të Strategjisë Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra.

Procedura në Gjykatë

11. Më 29 mars 2012, nëpërmjet Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve, Kosovë, parashtruesit dorëzuan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

12. Më 20 prill 2012, Gjykata kërkoi sqarim përkitazi me autorizimin e Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve, Kosovë, për ta parashtruar kërkesën në emër të parashtruesve.

13. Përfaqësuesi i parashtruesve u përgjigj, duke theksuar se, për shkak të sëmundjes së njërit prej parashtruesve, ata nuk ishin në gjendje ta siguronin autorizimin në atë kohë.

14. Më 22 maj 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari e caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Gjyljeta Mushkolaj.

15. Më 25 maj 2012, përfaqësuesi i parashtruesve e njoftoi Gjykatën se ishin paraqitur rrethana të reja, të cilat tregonin se parashtruesit nuk ishin në gjendje të vazhdonin tutje me kërkesën.

16. Më 2 korrik 2012, Kryetari, me Vendimin (Nr. K.SH. KI37/12) caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues, pasi mandati i gjyqtares Gjyljeta Mushkolaj, si gjyqtare e Gjykatës, kishte përfunduar.

Vlerësimi i Gjykatës

17. Për të vendosur se çfarë hapash të tjerë duhet ndërmarrë pas komunikimit me përfaqësuesin e parashtruesve, Gjykata i referohet rregullit 32 të Rregullores së punës të Gjykatës.

18. Rregulli 32, i Rregullores së punës përcakton:

"Rregulli 32

Tërheqja e kërkesës dhe e përgjigjes

(1) Pala mund të tërheqë kërkesën, ose përgjigjen e parashtruar për atë kërkesë, në çdo kohë para fillimit të seancës dëgjimore, ose në çdo kohë para marrjes së vendimit nga Gjykata, nëse vendimi merret pa seancë dëgjimore.

(2) Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë në lidhje me të.

(3) Në rast të tillë, Gjykata vendos pa seancë dëgjimore, duke u bazuar vetëm në kërkesë, në përgjigjet e parashtruara dhe në çfarëdo dokumentesh të bashkëngjitura asaj.

(4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme, ose që nuk përfaqësojnë një rast ose kontest.

(5) Sekretariati njofton të gjitha palët me shkrim për çfarëdo tërheqje, për çfarëdo vendimi të Gjykatës për të vendosur në lidhje me kërkesën, pavarësisht tërheqjes së saj, dhe për çfarëdo vendimi për ta hedhur poshtë kërkesën para vendimit përfundimtar."

19. Më 19 shtator 2012, duke marrë parasysh zhvillimet e sipërpërmendura, Gjyqtarja raportuese, Snezhana Botusharova, i rekomandoi Kolegjit shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović, që të ndërpresë shqyrtimin e mëtejmë të kërkesës. Pasi dëgjoi propozimin e Gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues u pajtua se nuk ekzistojnë rrethana të posaçme përkitazi me mbrojtjen e të drejtave të njeriut të parashtruesve, të cilat do të kërkonin shqyrtim të mëtejmë të kërkesës dhe, po të njëjtën datë, ia përcolli rekomandimin e vet Gjykatës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 32 të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEQË kërkesën nga lista;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 141/11, Ramadan Rrahmani, datë 04 prill 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 5017415 të Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës, i 26 shkurtit 2009

Rasti KI 141/11, Aktvendim për papranueshmëri i 19 marsit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme, epërsia e kushtetutës, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, pension invalidor.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar për shkak se Administrata Pensionale e Republikës së Kosovës, ia ka mohuar atij të drejtën në pension. Parashtruesi, ndër të tjera, pohoi se ishte shkelur e drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e pafatshme përkatësisht nuk ishte parashtruar në Gjykatë brenda afatit ligjor të përcaktuar me Nenin 49 të Ligjit. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI141/11
Parashtrues
Ramadan Rrahmani
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 5017415 të Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës, i 26 shkurtit 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Ramadan Rrahmani, me banim në Fushë-Kosovë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi nr. 5017415 i Departamentit të Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: DAPK-MPMS), i 26 shkurtit 2009.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës; nenet: 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes ka të bëjë me të drejtat e parashtruesit për pension invalidor, si dhe me kompensimin për dëmtimet trupore që kishte pësuar parashtruesi gjatë orarit të punës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 31 tetor 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 17 janar 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI141/11, caktoi gjyqtaren Iliriana Islami Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI141/11, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Gjyljeta Mushkolaj.

7. Më 18 prill 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe, po ashtu, kërkoi nga ai që të saktësonte kërkesën.

8. Më 16 maj 2012, parashtruesi iu përgjigj kërkesës së Gjykatës.

9. Më 5 nëntor 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI141/11, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi Gjyqtare raportuese, pas përfundimit të mandatit të gjyqtares Iliriana Islami si gjyqtare e Gjykatës. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI141/11, caktoi Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Kadri Kryeziu, pas përfundimit të mandatit të gjyqtares Gjyljeta Mushkolaj si gjyqtare e Gjykatës.

10. Më 12 nëntor 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të sqaronte disa aspekte të tjera të kërkesës së tij. Parashtruesi i kërkesës nuk u përgjigj.

11. Më 5 dhjetor 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve, siç janë dorëzuar nga parashtruesi

12. Më 5 maj 1984, Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit (BVI) e Sigurimit Pensional e Invalidor të Kosovës, me Vendimin P. nr. 20714, përcaktoi se parashtruesit, i cili radhitet në kategorinë e parë të invaliditetit, i pranohet e drejta për pension invalidor, duke filluar prej ditës së

ndërprerjes së pranimit të të ardhurave personale. Gjithashtu, krahas pensionit i pranohet edhe e drejta për shtesë mbrojtëse.

13. Më 24 dhjetor 1986, Gjykata Themelore e Punës së Bashkuar në Prishtinë, me Vendimin Np. br. 903/82, përcaktoi që N. SH. "Ramiz Sadiku", kompania e transportit dhe makinerisë në Prishtinë, t'i japë parashtruesit kompensim për zvogëlimin e aftësisë punuese për shkak të lëndimit në punë, brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së atij vendimi. Njëkohësisht, N. SH. "Ramiz Sadiku" u obligua që parashtruesit, për çdo muaj, t'ia paguajë RENTËN në emër të kompensimit për zvogëlimin e aftësisë punuese, si dhe t'ia paguajë shpenzimet e procedurës.

14. Më 1 shtator 2004, parashtruesi paraqiti kërkesë për pension për persona me aftësi të kufizuar në Ministri të Punës dhe Mirëqenies Sociale.

15. Më 26 shkurt 2009, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale njoftoi parashtruesin që Komisioni mjekësor kishte vlerësuar se parashtruesi i plotëson kushtet e parapara me Ligjin Nr. 2003/23, për përzgjedhshmëri për pension për persona me aftësi të kufizuar, dhe se e drejta e parashtruesit në pension vazhdohet nga data 1 janar 2009. Shuma mujore që do të pranonte parashtruesi për pension invalidor ishte 45 euro. Parashtruesi, po ashtu, u njoftua se vendimin në fjalë mund ta kontestojë në DAPK-MPMS.

16. Në shkresat e kërkesës nuk ekziston asnjë dëshmi se parashtruesi është ankuar kundër vendimit të lartpërmendur të DAPK-MPMS-së.

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi pretendon shkelje në dëm të tij të nenit 16 [Epërsia e Kushtetutës], paragrafi 3, "Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare", dhe t[nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

18. Parashtruesi pretendon se Qendra Pensionale e Personave me Aftësi të Kufizuar nuk i ka respektuar vendimet e mëhershme të gjykatave, në bazë të të cilave ai duhet të gëzojë të drejtën në dallim page (rentën) deri në moshën e pensionimit, që nënkupton të drejtën në realizimin e pensionit bazë në vlerë 80 € (dhe jo shumën e akorduar 45 €), qysh nga fillimi i realizimit të pensionit nga 1 maji 2004.

19. Parashtruesi pretendon se i është mohuar realizimi i rentës, gjegjësisht se i është mohuar dallimi ndërmjet pagës bazë të punëtorit dhe pensionit invalidor qysh prej fillimit të marrjes së pensionit, nga 1 maji 2004, ashtu sikurse është caktuar me vendimet e mëhershme të gjykatave të ndryshme, e të paraqitura si dëshmi.

20. Parashtruesi pretendon se i është mohuar e drejta për realizimin e mjeteve ortopedike, se i është mohuar rehabilitimi nëpër banja dhe vazhdimi i shërimit të tij nëpër institucione jashtë vendit.

21. Përfundimisht, parashtruesi, për të mbështetur pohimet e tij, ofron këto dëshmi:

    a) Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 1120/83, e 19 janarit 1984;

    b) Vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 2202/92, e 28 janarit 1993;

    c) Vendimin e Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, Np. br. 903/82, e 24 dhjetorit 1986.

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

22. Për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

23. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

    "Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".

24. Nga parashtresat shihet që kërkesa është parashtruar më 31 tetor 2011 dhe se parashtruesit i është dorëzuar vendimi i DAPK-MPMS-së më 26 shkurt 2009, që do të thotë se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

25. Rezulton që kërkesa është e paafatshme.

26. Prandaj, kërkesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme, për shkak të mosrespektimit të afatit ligjor, të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 49 të Ligjit; si dhe në pajtim me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 5 dhjetor 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 14/13, Komuna e Podujevës, 04 prill 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 50/2011, të 22 nëntorit 2012

Rasti KI 14/13, Aktvendim për papranueshmëri i 12 marsit 2013

Fjalë kyçe: kërkesë individuale, masë e përkohshme, qartazi e pabazuar, mbrojtja e pronës, shkelja e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi, Komuna e Podujevës, e parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 50/2011, të 22 nëntorit 2012, i cili pretendon t'i ketë shkelur të drejtat e tij, të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] së Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit 1 [Mbrojtja e Pronës] së KEDNJ-së, sepse "në pajtim me [...] Aktvendimin nr. 04-466-765/3 të 28 korrikut 1980, prona është eksproprijuar me kompensim dhe paraardhësi i paditësve është kompensuar, ku i njëjti aktvendim e ka marrë formën e prerë më 22.12.1982 dhe Shtëpia e Kulturës është ndërtuar në pronën e lartpërmendur." Për më tepër, parashtruesi kërkoi nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme për të ndaluar ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme.

Sa i përket çështjes së pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme sepse parashtruesi kishte dështuar të paraqesë prova se procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Në këtë mënyrë, Gjykata konkludoi se kërkesa ishte qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës. Për më tepër, sa i përket kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata konstatoi se, duke pasur parasysh se kërkesa u gjet si e papranueshme, parashtruesi i kërkesës nuk ka të drejtë, sipas rregullit 54.1 të Rregullores së punës, të kërkojë masë të përkohshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI14/13
Parashtrues
Komuna e Podujevës
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 50/2011, të 22 nëntorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Kërkesa është parashtruar nga Komuna e Podujevës (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi), përfaqësuar nga z. Faik Rama.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 50/2011, të 22 nëntorit 2012, që iu dorëzua parashtruesit më 26 dhjetor 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se aktgjykimi i lartpërmendur ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 46 [Mbrojtja e Pronës], dhe të drejtën e garantuar nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), respektivisht nenin 1 të Protokollit 1 (Mbrojtja e Pronës).

4. Më tej, parashtruesi kërkoi vendosjen e masës së përkohshme *"për të ndaluar ekzekutimin e Aktgjykimit Rev. nr. 50/2011 të Gjykatës Supreme, sepse ekziston rreziku që paditësi të kërkojë ekzekutimin e*

detyrueshëm të Aktgjykimit Rev. nr. 50/2011 dhe, në këtë mënyrë, të shkaktojë dëme të paripërueshme ndaj të padituri dhe të cenojë interesin publik".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenin 22 e në nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); si dhe rregullin 54, rregullin 55 dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 5 shkurt 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 25 shkurt 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. GJR. KI14/13, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. KSH. KI4/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

8. Më 26 janar 2013, Gjykata kërkoi nga z. Faik Rama të dorëzojë një autorizim, të cilin ai e dorëzoi në Gjykatë.

9. Më 27 janar 2013, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme.

10. Më 12 mars 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

11. Më 28 korrik 1980, Seksioni pronësor-juridik i Kuvendit Komunal të Podujevës, mori Vendimin nr. 04-466-765/3 për eksproprijimin e pronës së paluajtshme të pronarëve privatë për nevoja dhe për interesa të Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI), për të ndërtuar një shtëpi të kulturës në Podujevë. Një nga pronat e eksproprijuara i përkiste Z. (Xh.) A.

12. Më 11 gusht 1980, Z. (Xh.) A. u ankua në Drejtorinë Krahinore për Çështje Pronësore-Juridike në Prishtinë, kundër vendimit për ekspropriji m.

13. Më 27 tetor 1980, Sekretariati për Ekonomi i Kuvendit Komunal të Podujevës (Vendimi nr. 04-360-547) ia ndau Z. (Xh.) A. një banesë dydhomëshe.

14. Më 27 tetor 1980, Banka Themelore në Prishtinë nxori një garanci me të cilën Kuvendi Komunal i Podujevës garanton se ka siguruar mjetet për ekspropriji min e tokës për ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës.

15. Më 31 tetor 1980, u lidh një marrëveshje ndërmjet Z. (Xh.) A. dhe Seksionit pronësor-juridik të Kuvendit Komunal në Podujevë për lëshimin e ndërtesës së ekspropriju ar, si dhe për ndarjen e truallit dhe të lokalit për veprimtari private, ndërkaq nuk u arrit asnjë marrëveshje për çmimin e kompensimit.

16. Më 5 nëntor 1980, Seksioni pronësor-juridik i Kuvendit Komunal të Podujevës nxori një konkludim për lejimin e ekzekutimit të Vendimit të plotfuqishëm nr. 04-466-765/3, të 28 korrikut 1980.

17. Më 6 nëntor 1980, Seksioni pronësor-juridik i KK të Podujevës nxori një vendim (Vendimi nr. 04-4784) për lejimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 04-466-765/3, të 28 korrikut 1980.

18. Më 25 nëntor 1980, Seksioni pronësor-juridik i KK të Podujevës mbajti një shqyrtim me gojë, përkitazi me caktimin e çmimit të kompensimit.

19. Më 9 janar 1981, Sekretariati për Ekonomi i KK të Podujevës (Vendimi nr. 04-351-4919) miratoi kërkesën e Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI), për të filluar ndërtimin e Shtëpisë së Kulturës.

20. Më 9 maj 1981, Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit (BVI) nxori një garanci, ku garanton se ka siguruar mjetet për investim.

21. Më 21 maj 1981, Seksioni pronësor-juridik i KK të Podujevës (Vendimi nr. 04-466-765/3) nxori një konkludim për të urdhëruar Z. (Xh.) A. që të lëshojë pronën e ekspropriju ar dhe të shpërngulet në banesën dydhomëshe që i ishte ndarë. Kundër këtij vendimi Z. (Xh.) A. u ankua në Drejtorinë Krahinore për Çështje Pronësore-Juridike në Prishtinë.

22. Më 22 maj 1981, Seksioni pronësor-juridik i KK të Podujevës (Vendimi nr. 04-360-204) ndau një banesë njëdhomëshe për Z. (Xh.) A.

23. Më 22 dhjetor 1982, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike në Prishtinë (Vendimi nr. 03-466-576/82) hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e Z. (Xh.) A., sepse atij i ishte ndarë një banesë dhe ishte arritur marrëveshja për kompensim.

24. Më 4 maj 1983, Kuvendi Komunal në Podujevë dhe Z. (Xh.) A. lidhën një marrëveshje, me të cilën Kuvendi Komunal i Podujevës u obligua të sigurojë lokalin për Z. (Xh.) A. për të udhëhequr veprimtarinë.

25. Më 21 korrik 1995, Kuvendi Komunal i Podujevës nxori një vendim për përcaktimin e përmbajtjes së aktvendimit të plotfuqishëm për ekzekutimin, për eksproprijimin dhe për marrjen e pronësisë së pronës së paluajtshme dhe konfirmoi që ngastrat: 554, 555 dhe 556, kishin kaluar në pronësi të Komunës si pronë shoqërore.

26. Në prill të vitit 2001, ngastrat e kontestuara: 554, 555 dhe 556, ishin regjistruar në emër të Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI), në bazë të Vendimit të plotfuqishëm të Seksionit pronësor-juridik të KK të Podujevës, Vendimi nr. 04-466-765/3, i 28 korrikut 1980.

27. Në vitin 2003, ngastrat e kontestuara: 554, 555 dhe 556, u regjistruan në pronësi të Komunës së Podujevës.

28. Më 15 mars 2006, trashëgimtarët e Z. (Xh.) A. parashtruan një padi në Gjykatën Komunale në Podujevë kundër Komunës së Podujevës për vërtetimin e pronësisë mbi ngastrat: 554, 555 dhe 556, e cila ishte pronare e këtyre ngastrave në bazë të listës poseduese të vitit 2001. Trashëgimtarët pohonin se këto ngastra gjenden në një zonë ku ishte një ndërtesë e papërfunduar dhe Komuna e Podujevës ua kishte pamundësuar posedimin dhe shfrytëzimin e tyre.

29. Më 2 korrik 2007, Gjykata Komunale e Podujevës (Aktgjykimi C. nr. 122/2006) hodhi poshtë ankesën e trashëgimtarëve si të pabazuar. Gjykata Komunale konstatoi se:

- Më 28 korrik 1980, Seksioni pronësor-juridik i KK të Podujevës nxori Vendimin nr. 04-466-765/3, për eksproprijim;

- Në vitin 2001, ngastrat e eksproprijuara u regjistruan në emër të Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI) dhe, në vitin 2003, Komuna e Podujevës u regjistrua si pronare e ngastrave.

Kështu, Gjykata Komunale vendosi që ankesa e trashëgimtarëve ishte e pabazuar. Ndaj këtij aktvendimi, trashëgimtarët u ankuan në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

30. Më 22 tetor 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Vendimi Ac. nr. 821/2007) anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Podujevë dhe e ktheu për rigjykim. Gjykata e Qarkut konstatoi se Gjykata Komunale duhet të konfirmojë si në vijim:

- Sipas cilës bazë juridike është regjistruar në vitin 2001 prona e paluajtshme e kontestuar në pronësi të Z. (Xh.) A.;
- Në çfarë baze juridike ishte regjistruar pastaj prona e paluajtshme në pronësi të Komunës së Podujevës; dhe

- A ishte transferuar prona e paluajtshme e kontestuar, në pronësi dhe në shfrytëzim të përfituesve të pronës së ekspropriuar, pas aktgjykimit të plotfuqishëm për shpronësimin në bazë të qëllimit të ekspropriimit.

31. Më 24 shkurt 2010, Gjykata Komunale e Podujevës (Aktgjykimi C. nr. 879/2008) miratoi ankesën e trashëgimtarëve dhe konfirmoi se ata janë pronarë të ngastrave të kontestuara. Gjykata Komunale konstatoi: *"Ishte konfirmuar fakti se qëllimi i ekspropriimit nuk ishte arritur, sepse ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës kishte filluar, por nuk kishte përfunduar ende dhe ky ndërtim nuk i shërbente të paditurit për qëllimin që ishte ekspropriuar"*. Gjykata Komunale, po ashtu, konstatoi se, në bazë të dëshmive të dëshmitarëve, paraardhësit e trashëgimtarëve kurrë nuk ishin kompensuar për ekspropriimin. Ndaj këtij aktgjykimi, parashtruesi u ankua në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

32. Më 31 janar 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi Ac. nr. 490/2010) aprovoi ankesën e parashtruesit dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Podujevë, duke i dhënë të drejtë parashtruesit si pronar i ngastrës së kontestuar. Gjykata e Qarkut konstatoi: *"[...] Gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë lëndë kontestimore ka marrë qëndrim të gabuar përkitazi me vlerësimin e fakteve të paraqitura dhe si pasojë e saj aktgjykimi ankimor është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale". Gjykata e Qarkut më tej konstatoi se në bazë të Vendimit nr. 04-466-7653/3 të 28 korrikut 1980 prona është ekspropriuar me kompensim parathënësit të paditësve ku i njëjti aktvendim e ka marrë formën e prerë më datën 22 dhjetor 1982 dhe objekti Shtëpia e Kulturës është ndërtuar në pronën e lartpërmendur. Gjykata e Qarkut gjithashtu ka vërtetuar se trashëgimtarët nuk kanë*

bërë kërkesë për eksproprijim e as kërkesë për anulimin e aktvendimit për eksproprijim. Trashëgimtarët kanë parashtruar një kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër këtij aktgjykimi".

33. Më 22 nëntor 2012, Gjykata Supreme aprovoi kërkesën për revizion dhe ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut si dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 24 shkurtit 2010. Gjykata Supreme konstatoi: "*[...] Qëndrimi juridik i shkallës së parë është i drejtë, ngase aktvendimi mbi eksproprijimin është marrë në vitin 1980, ndërsa vendimi mbi vërtetimin e plotfuqishmërisë së aktvendimit për eksproprijimin është i datës 21 korrik 1995, që do të thotë se gjykata e shkallës së dytë gabimisht konstaton se aktvendimi mbi eksproprijimin ka marrë formën e prerë më 22 dhjetor 1982. Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vërtetuar faktin me administrimin e provave – me dëgjimin e dëshmitarëve që paraardhësit të paditësve nuk i është paguar kurrfarë kompensimi për ngastrat e eksproprijuara , sepse pas 23 viteve këto ngastra janë regjistruar si pronë shoqërore. Në këtë rast fakti relevant është që e paditura nuk ka prezantuar as nuk ka provuar me asnjë provë që paraardhësit të paditësve i është kompensuar prona për eksproprijim". Më tej, Gjykata Supreme konstatoi se parashtruesi nuk ka dorëzuar/paraqitur asnjë provë se prona e eksproprijuar ishte shfrytëzuar për qëllimin për të cilin ishte eksproprijuar".*

Pretendimet e parashtruesit

34. Parashtruesi pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe me aktgjykimin e Gjykatës Komunale ishin bërë shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së.

Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, është e domosdoshme që së pari të vlerësohet nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

36. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet rregullit 36.1 (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton që *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar".*

37. Gjykata thekson që nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet faktike apo juridike (ligjshmëria), që pohohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç dhe deri në masën që mund të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kështu që, kjo Gjykatë nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur trajton vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I*).

38. Me fjalë të tjera, Gjykata mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë prezantuar në atë mënyrë që, procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë ndërmarrë në atë lloj mënyre që parashtruesi të ketë gëzuar një gjykim të drejtë (*Shih, ndër dokumente të tjera, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991*).

39. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës thjesht konteston nëse Gjykata Supreme ka zbatuar tërësisht ligjin e aplikueshëm dhe nuk pajtohet me gjetjet faktike të gjykatave përkitazi me rastin e tij.

40. Në këtë kuptim, parashtruesi nuk ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese, si dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë cenuar nga autorit publik. Kështu që, Gjykata Kushtetuese nuk gjen bazë për të vendosur që procedurat përkatëse kanë qenë në një mënyrë, apo në mënyrën tjetër, të padrejta apo arbitrare (*Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009*).

41. Kështu, parashtruesi nuk ka dëshmuar se pse dhe si janë shkelur nga Gjykata Supreme të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë. Gjykata vëren se aktgjykimet e Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës Komunale, të 24 shkurtit 2010, ishin mirë të argumentuara dhe të arsyetuara.

42. Rrjedhimisht, kërkesa është e papranueshme, sepse është qartazi e pabazuar, në bazë të rregullit 36.1 (c) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

43. Neni 27 i Ligjit dhe, në veçanti, rregulli 54.1 i Rregullores së punës, parasheh: "Në çfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para

Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës se përkohshme".

44. Megjithatë, duke pasur parasysh se kërkesa u gjet si e papranueshme, parashtruesi i kërkesës nuk ka të drejtë, sipas rregullit 54.1 të Rregullores së punës, të kërkojë masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të rregullit 36.1 (c), të rregullit 54 dhe të rregullit 56. 2 të Rregullores së punës, më 12 mars 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. T'ua komunikojë vendimin palëve dhe ta publikojë vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtare raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 103/12, "Integral" SHPK, datë 04 prill 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0056-A0001, të 7 qershorit 2012.

Rasti KI103/12, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 mars 2012.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me aktgjykimin e kontestuar të Dhomës së Posaçme, i janë cenuar të drejtat e pronës, të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, apo KEDNJ).

Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të anulojë aktgjykimin e kontestuar dhe ta kthejë çështjen për rishqyrtim në Dhomën e Posaçme.

Gjykata, në pajtim me rregullin 36.2 (c) të Rregullores së punës, shpallë kërkesën si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI103/12
Parashtrues
"INTEGRAL", Sh.p.k.
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0056-A0001, të 7 qershorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Kompania "Integral", një kompani private nga Prishtina, të cilën e përfaqëson Agim Aliu, drejtor.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme), me nr. ASC-11-0056-A0001, i nxjerrë më 7 qershor 2012, e që i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 5 korrik 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me aktgjykimin e kontestuar të Dhomës së Posaçme, i janë cenuar të drejtat e pronës, të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës dhe me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, apo KEDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të anulojë aktgjykimin e kontestuar dhe ta kthejë çështjen për rishqyrtim në Dhomën e Posaçme.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet: 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 19 tetor 2012, parashtruesi paraqiti kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 31 tetor 2012, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi Gjyqtare raportuese si dhe, me Vendimin KSH.103/12, e datës së njëjtë, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

8. Më 13 mars 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 7 shtator 2006, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM) dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), me të cilën kërkoi vërtetimin e pronësisë mbi patundshmërinë, një lokal afarist që gjendet në Prishtinë, rruga "UÇK", nr. 2 (ish-rruga "APJ", më vonë rruga "Kral Millutini"), me sipërfaqe të përgjithshme 814.00 m². Parashtruesi i kërkesës e kishte bazuar padinë në kontratën e shitblerjes, të lidhur ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe Investbank, Sh.a. (në procedurë të falimentimit) në Beograd. Kontrata e shitblerjes ishte vërtetuar në Gjykatën e Parë Komunale në Beograd, me nr. 900/61, më 19 prill 2006.

10. Më 15 mars 2007, AKM-ja dërgoi përgjigje në padinë e parashtruesit, duke theksuar, *inter alia*, se prona e kontestuar i përket Bankës së Kosovës, e njohur si Bankkos, Banka Themelore në Prishtinë, e cila

është pjesë e Bankës së Kosovës Sh.a. (në tekstin e mëtejmë: Banka). AKM-ja, po ashtu, deklaroi se kishte kryer hetime dhe kishte vërtetuar se Banka ishte themeluar nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh.) dhe se asetet e saj ishin pronë shoqërore.

11. Më 13 prill 2011, Trupi gjykues nxori aktgjykimin SCC-06-0394, me të cilin refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit.

12. Trupi gjykues, në arsyetim, theksoi si në vijim: *"Pasi që Gjykata konstatoi se paditësi (pra parashtruesi i kërkesës) nuk posedon prova për titullin juridik,* kontesti pronësor *mbetet në mes të Investbank-ës dhe Bankkos-it (siç administrohet ose jo nga AKM-ja), për çka nuk ka përcaktime në këtë dosje. Kjo është arsyeja pse titulli i paraqitur nga paditësi nuk mund të përbëjë një arsye të vlefshme për padinë.*"

13. Më 23 maj 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të fakteve dhe të zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

14. Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin e kontestuar, nr. ASC-11-0056-10001, më 7 qershor 2012, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme, të 13 prillit 2011, SCC-06-0394.

15. Në arsyetimin ligjor, Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme, theksoi: "*Trupi gjykues i DHPGJS-së ka theksuar mjaft qartë në arsyetim* ...se '*paditësi nuk posedon asnjë provë për titullin juridik*'".

16. Kolegji i ankesave vërtetoi mendimin e Trupit gjykues se "*transferimi i të drejtës së paditësit për pronësinë nëpërmjet 'titullit të pronësisë', që ai e kishte poseduar, nuk është kryer në mënyrë ligjore*". Kolegji i ankesave, po ashtu, konfirmoi se asetet e kontestuara "*janë pronë shoqërore*".

17. Përveç kësaj, Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme, theksoi: "*Transferimi i të drejtës së pronësisë për pasuritë e kontestuara është bërë në bazë të një kontrate të lidhur në Beograd, e cila nuk i ka përmbushur kërkesat ligjore të ligjit të zbatueshëm në Kosovë. Prandaj, kjo kontratë nuk paraqet veprim të ligjshëm të ligjit të zbatueshëm në Kosovë, dhe e njëjta nuk përbën provë të titullit juridik*

që do të lejonte paditësin të bëjë transferimin dhe regjistrimin pa pengesë të së drejtës së pronës për pasuritë e blera".

18. Për më tepër, Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme vërejti se, pasi pasuritë e blera nga parashtruesi i kërkesës gjenden në Prishtinë, ndërsa kontrata e shitblerjes është vërtetuar në gjykatë në Beograd, si i tillë, ky veprim juridik nuk prodhon efekt juridik.

19. Përfundimisht, Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme gjeti se "*ky veprim ligjor ishte në kundërshtim edhe me nenin 4 të Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme ...një dispozitë që ndalon tjetërsimin e pasurive të paluajtshme në pronësi shoqërore tek personat privatë*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese, parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë cenuar të drejtat e njeriut, të garantuara me Kushtetutë, pasi Dhoma e Posaçme *"pa të drejtë pretendon se paditësi nuk posedon asnjë dëshmi lidhur me titullin ligjor për të vërtetuar të drejtën e vet pronësore në lokalin afarist*". Parashtruesi i kërkesës pretendon se "*banka, si institucion financiar, nuk mund të trajtohet si ndërmarrje shoqërore apo publike*". Parashtruesi i kërkesës vëren se "*Investbanka Sh.p.k., në pajtim me ligjin ka zbatuar procedurën e falimentimit, vendimin për shitjen e pasurisë jo vetëm në Kosovë por edhe në vende tjera të ish-Jugosllavisë...*". Parashtruesi i kërkesës konsideron se kontrata e shitblerjes ishte lidhur dhe ishte vërtetuar në gjykatën kompetente në Beograd, në pajtim me ligjin e aplikueshëm.

21. Rrjedhimisht, parashtruesi kërkon që "*çdo pretendim, qoftë nga gjykata apo nga ndonjë institucion tjetër, për t'ia mohuar Integral sh.p.k. të drejtat pronësore lidhur me lokalin e blerë, duke e kontestuar titullin ligjor për bartjen e të drejtës së pronësisë, është e kundërligjshme dhe është shkelje e dispozitave kushtetuese, më konkretisht e nenit 22 dhe atij 46 të Kushtetutës së Republikës se Kosovës".*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Në mënyrë që të mund të vendosë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata, së pari, duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit, parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

24. Gjykata, më tej, vëren se parashtruesi e ka parashtruar kërkesën brenda afatit kohor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

25. Gjykata, po ashtu, duhet të shqyrtojë nëse kërkesa e parashtruesit i plotëson kriteret e tjera të pranueshmërisë, të përcaktuara me rregullin 36.2 të Rregullores së punës, ku thuhet:

> *"Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:*
>
> *a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*
> *c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose*
> *d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

26. Gjykata Kushtetuese rikujton se ajo nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I*).

27. Gjykata Kushtetuese vëren, nga faktet e paraqitura në kërkesë, se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi që në faza të ndryshme të procedurës të parashtrojë argumentet për të cilat ka konsideruar se janë relevante për rastin. Arsyetimi faktik dhe ligjor për vendimin e shkallës së parë, me të cilin u refuzua padia e parashtruesit, është shtjelluar gjerësisht. Në aktgjykimin gjatë fazës ankimore, Kolegji i ankesave e pranoi deklaratën e fakteve dhe arsyetimin ligjor të dhënë në aktgjykimin e Trupit gjykues, në kuptimin që ato nuk ishin në kundërshtim me të gjeturat e tij. Rrjedhimisht, edhe Trupi gjykues e edhe Kolegji i ankesave i Dhomës së Posaçme morën parasysh dhe me të vërtetë iu përgjigjën ankesave të parashtruesit përkitazi me çështjet e ligjit.

28. Gjykata rithekson se ka kompetencë të kufizuar për të trajtuar gabimet e pretenduara në fakte, apo në ligj, të bëra nga gjykatat e rregullta, dhe se nuk mund të zëvendësojë këndvështrimin e gjykatave të rregullta përkitazi me pronësinë e parashtruesit mbi lokalin afarist me këndvështrimin e vet (*Shih, Jantner kundër Sllovakisë, nr. 39050/97, paragrafi 32, Aktgjykimi i 4 marsit 2003 i GJEDNJ-së*).

29. Rrjedhimisht, edhe nëse supozojmë se aktgjykimet e Dhomës së Posaçme kanë ndërhyrë në të drejtën e parashtruesit në pronë, ato ishin të bazuara në ligj dhe në proporcion me interesin publik për mbrojtjen e të drejtave të pronarëve të vërtetë (*Shih, mutatis mutandis, Čadek dhe të tjerët kundër Republikës Çeke, paragrafi 51, aktgjykimi i 21 nëntorit 2012 i GJEDNJ-së*). Prandaj, këto ankesa janë qartazi të pabazuara.

30. Prandaj, Gjykata, në pajtim me rregullin 36.2 (c) të Rregullores së punës, hedh poshtë kërkesën si qartazi të pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe në mbështetje të rregullit 36.2 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Arta Rama-Hajrizi

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 77/12, Rifat Hamiti, datë 11 prill 2013- Vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I nr. 89/2011, të 5 marsit 2012

Rasti KI-77/12, Aktvendim për papranueshmëri i 6 marsit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, e drejta për mbrojtje gjyqësore, qartazi e pabazuar, Ne bis in idem.

Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. i nr. 89/2011, të 5 marsit 2012, me të cilin është zgjidhur kontesti pronësoro-juridik, në mes të parashtruesit të kërkesës dhe personave të tretë lidhur me të drejtën e shfrytëzimit të banesës.

Parshtruesi i kërkesës konsideroi se është shkelur parimi themelor i procesit gjyqësor *„nuk gjykohet dy herë për të njëjtën çështje" (Ne bis in idem),* sepse paditësi në të njëjtën gjykatë me lëndën C. Nr. 146/ 2001, kishte iniciuar procedurë gjyqësore kundër parashtruesit të kërkesës si i paditur, ndërsa me aktvendimin e së njëjtës gjykatë, C. nr. 146/2001, të 8 majit 2002, padia u hodh poshtë si e palejueshme.

Nga ajo që u theksua më lart, parashtruesi i kërkesës konsideroi se Gjykata Komunale në Therandë kishte shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën e përdorimit të mjetit juridik, për shkak se Gjykata Komunale në Therandë ka vendosur për një çështje që ka qenë e gjykuar më parë me aktgjykim dhe aktvendim. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, gjykata e ka shkelur ndalesën se s'ka dy herë gjykim për të njëjtën çështje (*Ne bis in idem*), dhe pastaj duke i caktuar përfaqësues të përkohshëm parashtruesit të kërkesës pa u plotësuar kushtet ligjore nga LPK-ja, ia ka bërë të pamundur parashtruesit të kërkesës pjesëmarrjen në shqyrtim.

Nga ajo që u theksua më lart, parashtruesi i kërkesës konsideroi se janë shkelur neni 21 (Parimet e Përgjithshme) 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), 32 (E Drejta për Mjete Juridike) dhe neni 54. (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6 (Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut).

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit Rifat Hamiti, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk kishte gjetur se procedurat përkatëse në gjykatat e rregullta ishin në ndonjë mënyrë të padrejta ose arbitrare. Prandaj, Gjykata konkludoi se kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse faktet e paraqitura nuk e arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI77/12
Parashtrues
Rifat Hamiti
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Rev. I nr. 89/2011, të 5 marsit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Rifat Hamiti, nga fshati Mushtisht, komuna e Therandës, të cilin para Gjykatës e përfaqëson Ekrem Agushi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I nr. 89/2011, i 5 marsit 2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 26 prill 2012, e me të cilin është refuzuar revizioni i Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Therandë, C. nr. 211/02, të 17 dhjetorit 2007, dhe i Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, AC. nr. 48/08, të 20 janarit 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kontesti pronësor-juridik ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe palës së tretë, përkitazi me të drejtën e shfrytëzimit të banesës, që ka përfunduar me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. I 89/2011, e 5 marsit 2012, i cili i është dorëzuar

parashtruesit të kërkesës më 26 prill 2012, e me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, është shkelur një numër i madh nenesh të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe në nenin 21.4 të Kushtetutës; në nenin 20, në nenin 22.7 dhe në nenin 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës, më 17 gusht 2012, i parashtroi kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Me Vendimin e Kryetarit (Nr. GJR. 77/12, të 4 shtatorit 2012), gjyqtarja Snezhana Botusharova u caktua Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit (Nr. KSH. 77/12) u caktua Kolegji shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

7. Më 24 shtator 2012, Gjykata iu drejtua parashtruesit me kërkesën që të plotësojë dokumentacionin. Që Gjykata të mund të vendosë në mënyrë meritore për kërkesën e parashtruesit, ai duhet t'i dorëzojë Gjykatës këto dokumente:
   - ✓ Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I nr. 89/2011, e 5 marsit 2012;
   - ✓ Autorizimin me të cilin ai autorizon avokatin Ilaz Kadolli që ta përfaqësojë në Gjykatë; dhe
   - ✓ Aktgjykimin e Gjykatën Komunale në Therandë, nr. 164/01, e 1 gushtit 2002.

8. Më 4 tetor 2012, Posta dhe Telekomi i Kosovës njoftoi Gjykatën se letra, që kjo e fundit i kishte drejtuar parashtruesit të kërkesës, nuk i është dorëzuar atij, sepse parashtruesi i kërkesës gjendet jashtë vendit.

9. Më 23 tetor 2012, Gjykata përsëri iu drejtua parashtruesit të kërkesës dhe avokatit të tij, me kërkesë për plotësimin e dokumentacionit, që Gjykata të mund të vendoste në mënyrë meritore për kërkesën e parashtruesit të kërkesës.

10. Më 9 nëntor 2012, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi Gjykatës dokumentet që ia kishte kërkuar Gjykata, si dhe autorizimin me të cilin ndërroi avokatin që do ta përfaqësonte në Gjykatë.

11. Më 23 janar 2013, Gjykata kërkoi nga Gjykata Komunale në Therandë dhe nga Gjykata e Qarkut në Prizren të sjellin këto dokumente:

- ✓ Dosjen e plotë të lëndës me nr. C nr. 94/2004, të 20 marsit 2006, të Gjykatës Komunale në Therandë;
- ✓ Dosjen e plotë të lëndës: Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, me nr. Rev. I nr. 89/2011, i 5 marsit 2012, me të cilin është refuzuar revizioni i Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Therandë, C. nr. 211/02, të 17 dhjetorit 2007; dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, AC. nr. 48/08, i 20 janarit 2011; dhe
- ✓ Dosjen e plotë të lëndës së Gjykatës Komunale në Therandë, C. nr. 146/2001, të 8 majit 2002.

12. Më 4 shkurt 2013, Gjykata Komunale në Therandë dhe Gjykata e Qarkut në Prizren dorëzuan dosjet e plota të lëndëve, sipas kërkesës së Gjykatës.

13. Më 6 mars 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtares raportuese Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović., i propozoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

14. Në bazë të kontratës për ndërtimin e banesave, A. Sh. nga Mushtishti, me pëlqimin e dhënësit të banesës, Komuna e Therandës dhe Kuvendi i Kosovës, fitoi të drejtën e banimit në banesën në rrugën "M. Tito", tash "Dëshmorët e Kombit", dhe atë – banesën nr. 1, hyrja nr. 1, kati i parë; e cila përbëhet nga dy dhoma, një kuzhinë, një banjë dhe një WC, e cila është e nënshkruar nga dhënësi i banesës dhe ka numër 04. Nr. 360-84, në emër të Komunës së Therandës, përderisa në Prishtinë ka nr. 05 Nr. 360-120/82, më 24 prill 1982.

15. Parashtruesi i kërkesës dhe A. Sh. lidhën kontratë për qiradhënien e banesës shoqërore, Vr. nr. 319/84, më 12 prill 1984, e cila është vërtetuar në gjykatë.

16. Më 23 prill 1984, personat e njëjtë kanë lidhur edhe një kontratë për shitblerjen e të njëjtës patundshmëri, e cila nuk është vërtetuar në gjykatë.

17. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, kjo kontratë me shkrim, e pavërtetuar në gjykatë, është përmbushur plotësisht nga kontraktuesit, sepse shitësi, A. Sh., ia dorëzoi blerësit banesën e shitur në posedim.

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, ndërmjet tij, si blerës, dhe A. Sh., si shitës, ekziston kontrata plotësuese, e përpiluar më 3 janar 1988, në prani të dëshmitarëve: S. H., S. A., S. A., Sh. Sh. dhe A. J., që të gjithë nga fshati Mushtisht, në bazë të së cilës parashtruesi i kërkesës dhe shitësi A. Sh. u pajtuan të kryenin obligimet e njërit ndaj tjetrit sipas marrëveshjes dhe që shitësi A. Sh. të marrë për obligim të tërheqë padinë e ngritur më parë në Gjykatën Komunale në Therandë kundër parashtruesit të kërkesës.

Procedura në gjykatë përkitazi me kërkesën për largim nga banesa (lirimin e banesës)

A. Kërkesëpadia e parë

19. Bartësi i të drejtës së banimit (paditësi), A. Sh., ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Therandë, me të cilën kërkoi që *"të obligojë të paditurin R. A. që në afat prej 15 ditësh të lirojë banesën, e cila gjendet në rrugën 'M. Tito', tani 'Dëshmorët e Kombit', dhe atë banesa nr. 1, hyrja nr. 1, kati i parë, dhe të njëjtin t'ia dorëzojë paditësit"*. Megjithatë, në procedurë e sipër, paditësi A. Sh. tërhoqi kërkesëpadinë.

20. Për shkak të një situate të tillë faktike, Gjykata Komunale në Therandë nxori Aktvendimin C. Nr. 419/87, e 6 janarit 1988, në pjesën operative të të cilit thuhet: *"Padia dhe kërkesëpadia e paditësit A. R. Sh., nga fshati Mushtisht, kundër të paditurit Rifat Hamiti... konsiderohet e tërhequr"*, me arsyetimin: *"... pasi që për këtë çështje janë marrë vesh me të paditurin për këtë mënyrë të shfrytëzimit të banesës"*.

B. Kërkesëpadia e dytë

21. Bartësi i të drejtës së banimit (paditësi), A. Sh., më 9 maj 2004, parashtroi kërkesëpadinë e dytë me përmbajtje identike në Gjykatën Komunale në Therandë, me të cilën kërkoi që *"të obligojë të paditurin R. A. që në afat prej 15 ditësh të lirojë banesën, e cila gjendet në*

rrugën 'M. Tito', tani 'Dëshmorët e Kombit', dhe atë banesa nr. 1, hyrja nr. 1, kati i parë, dhe të njëjtën t'ia dorëzojë paditësit".

22. Kjo procedurë kontestimore kundër parashtruesit të kërkesës, si i paditur, përmbyllet me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Therandë, C. Nr. 94/2004, e 20 marsit 2006, me të cilin gjykata hodhi poshtë padinë si të papranueshme, me këtë arsyetim:

"Hidhet padia dhe kërkesëpadia e paditësit, sepse paditësi më dt. 06.01.1988 ka hequr dorë nga padia dhe nga kërkesëpadia për të njëjtën çështje".

"Sipas lëndës C. nr. 490/87, dhe shikimit në shkresat civile në lëndë, shihet se paditësi më dt. 17.04.1987 pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi për lirimin e banesës ndaj po të njëjtit të paditur, Rifat Hamiti nga Suhareka. Në procesverbalin e dt. 06.01.1988 shihet se paditësi ka deklaruar se ka hequr dorë nga padia dhe kërkesëpadia, ashtu që gjykata ka marrë Aktvendim C. Nr. 490/87, ku është tërhequr padia dhe kërkesëpadia e paditësit dhe ky aktvendim është i plotfuqishëm më dt. 01.03.1988".

Procedura në gjykatë përkitazi me kërkesën për konfirmim të së drejtës së banimit

C. Kërkesëpadia e tretë

23. Bartësi i të drejtës së banimit (paditësi), A. Sh., ushtroi kërkesëpadi të re në Gjykatën Komunale në Therandë, me të cilën kërkoi që të *"KONFIRMOHET se paditësi është titullar i të drejtës së banimit për banesën e cila ndodhet në rrugën 'M. Tito' 1/1 në Therandë, me sipërfaqe prej 50,28 m2 në bazë të kontratës për ndërrimin e banesave, të 20 prillit 1984…".*

24. Duke vendosur për padinë e bartësit të së drejtës së banimit (paditësit), A. Sh., Gjykata Komunale në Therandë nxori Aktvendimin C. nr. 146/2001, e 8 majit 2002, me të cilin hodhi poshtë padinë si të papranueshme, me arsyetimin:

"Në shiqimin paraprak të padisë në bazë të shkresave të bashkangjitura të kësaj lënde gjykata ka konstatuar se sipas aktvendimit të plotfuqishëm gjyqësor C. nr. 419/87 në mes palëve të njëjtë në procedurë dhe për çështjen e njëjtë juridike është konsideruar se është tërheqë padia dhe kërkesëpadia e paditësit".

"Pasi sipas nenit 193 të LPC që aplikohet sipas rregullores së UNMIK-ut nr. 24/99 është paraparë se kur paditësi e tërheqë kërkesëpadinë, nuk mundet që për çështjen e njëjtë përsëri të parashtrohet padi, prandaj gjykata në bazë të kësaj rregulle dhe me aplikim të nenit 288 al. 1 të LPC e hodhi padinë e paditësit si të palejueshme dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi".

25. Më 22 maj 2002, bartësi i të drejtës së banimit (paditësi), A. Sh., i paraqiti ankesë Gjykatës së Qarkut në Prizren ndaj Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Therandë, C. nr. 146/2001, të 8 majit 2002.

26. Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktvendimin Ac. nr. 167/02, e 21 tetorit 2002, miratoi ankesën e paditësit dhe anuloi Aktvendimin Gjykatës Komunale në Therandë, C. nr. 146/2001, e 8 majit 2002, dhe konstatoi se lënda duhet të kthehet për rivendosje, me arsyetimin:

"Në të vërtetë, gjykata hodhi poshtë padinë ngase konsideroi se për të njëjtën çështje kishte vendosur paraprakisht dhe se paditësi kishte tërhequr padinë lidhur me lëndën C. nr. 419/87, por kjo gjykatë nuk mund të pranojë këtë përfundim si të drejtë për shkak se në lëndën C. nr. 419/87 është kërkuar lirimi i banesës, përderisa në padi kërkohet konfirmimi i të drejtës së banimit, ku sipas vlerësimit të kësaj gjykate kemi të bëjmë me një bazë juridike të një natyre plotësisht tjetër nga ajo e mëhershmja…".

27. Në procedurën e përsëritur në Gjykatën Komunale në Therandë, me Aktvendimin C. nr. 211/02, e 21 marsit 2007, në përputhshmëri me nenin 84, paragrafi 4, dhe me nenin 287, paragrafi 1, të LPK-së, parashtruesit të kërkesës përkohësisht i është caktuar avokati i autorizuar B. N. nga Prizreni, pasi parashtruesi i kërkesës nuk ndodhej në adresën e cekur në padi.

28. Përfaqësuesi i përkohshëm i parashtruesit të kërkesës, avokati B. N. nga Prizreni, kontestoi në parim padinë dhe kërkesëpadinë, duke shtuar se i padituri, në bazë të kontratës për shitblerje të banesës shtetërore, të 13 prillit 1984, është pronar i banesës së kontestuar, kontratë kjo e paraprirë nga kontrata për shitblerjen e makinës.

29. Në kuptimin e nenit 8 të LPK-së, Gjykata kreu administrimin e të gjitha provave të regjistruara dhe të kontratës për shkëmbimin e banesave, 04 Nr. 360-84, të 20 prillit 1982; të kontratës për shitblerjen e banesës shtetërore, të përpiluar më 13 prill 1984, e cila është kopje dhe nuk është vërtetuar në gjykatë; pastaj të kontratës për

shitblerjen e makinës, të 12 prillit 1984, e cila është kopje porse shihet qartë se është vërtetuar në gjykatë me numër V. Nr. 336/84; dhe, pas vlerësimit të secilës prej tyre, veçmas dhe bashkë, Gjykata Komunale në Therandë, me Aktgjykimin C. Nr. 211/02, e 17 dhjetorit 2007, vendosi: **"Aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e bazuar"**, për këto arsye:

"*Ligji mbi marrëdhëniet banesore, i cili është në fuqi, nuk e njeh kategorinë e blerjes së të drejtës së shfrytëzimit si kategori ligjore, dhe në bazë të po këtij ligji paditësi është shfrytëzues i banesës dhe kjo e drejtë është e patjetërsueshme. Tjetërsimi i banesës në pronësi shoqërore i njihet vetëm pronarit të banesës – dhënësit në shfrytëzim të banesës, në rastin konkret paditësi nuk e ka të drejtën e tjetërsimit të banesës, sepse i njëjti është shfrytëzues i saj, dhe se është e ndaluar të shitet përkatësisht të blihet, ose në mënyrë tjetër në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji të bartet përkatësisht të fitohet e drejta në pronësi të banesës.*

Tezën e të autorizuarit të përkohshëm për të padituri, gjykata e vlerësoi gjithanshëm por, si të tillë, e refuzoi si të pabazë, meqenëse kontrata mbi shitblerjen e banesës e dt. 13.04.84 nuk prodhon efekt juridik, sepse e njëjta nuk është vërtetuar në gjykatë, ndërkaq kontrata mbi shitblerjen e automjetit, e përpiluar më dt. 12.04.1984, nuk është lëndore për kërkesën e padisë".

30. Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Therandë, C. Nr. 211/02, i 17 dhjetorit 2007, u vërtetua me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, AC. Nr. 48 /08, e 20 janarit 2011, me arsyetimin:

"Gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur ka aprovuar kërkesëpadinë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Një konkludim i tillë rezulton nga provat e administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe atë kontratës mbi ndërrimin e banesës, 04. nr. 360-84, të datës 20.04.1982, kontratës mbi shitblerjen e banesës shoqërore, të datës 13.04.1984, e pavërtetuar në gjykatë, kontrata mbi shitblerjen e automjetit V. nr. 336/84. Nga provat e administruara rezulton pa mëdyshje se paditësi, sipas kontratës mbi ndërrimin, është bartës i së drejtës së shfrytëzimit të banesës të theksuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar dhe se, sipas dispozitave të Ligjit mbi marrëdhëniet banesore, shfrytëzuesit të banesës nuk i lejohet shitblerja e banesës, sepse paditësi është vetëm shfrytëzues, por jo edhe pronar".

31. Kërkesa për revizion të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, AC. Nr. 48/08, të 20 janarit 2011, u hodh poshtë si e palejueshme me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I nr. 89/2011, e 5 marsit 2012, me arsyetimin se palët në procedurë kanë cekur se vlera e kontestit është 200 marka gjermane.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon me sa vijon:

> *"Shitësi – paditësi A. Sh., për banesën e cila ka qenë lëndë e kontratës ose marrëveshjes së cekur në Gjykatën Komunale në Therandë, ka paraqitur padi lidhur me të cilën është formuar lënda civile C. nr. 419/87 dhe, gjatë zhvillimit të procedurës, paditësi A. Sh. ka hequr dorë nga kërkesëpadia. Heqjen dorë nga kërkesëpadia e provon Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Therandë, C. nr. 419/87, i dt. 06.01.1988".*
>
> *"Lidhur me të njëjtën kërkesë, shitësi A. Sh., si paditës në të njëjtën Gjykatë, sipas lëndës C. nr. 146/2011, ka filluar procedurë kontestimore kundër paraqitësit të kërkesës si i paditur, e cila me aktvendimin e të njëjtës gjykatë, C. nr. 146/2011, të dt. 08.02.2002, padia është hedhur si e palejuar (kemi të bëjmë me çështje të gjykuar/res judicata)".*
>
> *"Parashtruesi i kërkesës konsideron se është shkelur parimi bazë i procedurës kontestimore 'S'ka dy herë gjykim për të njëjtën çështje' (**Ne bis in idem)** sepse paditësi në të njëjtën Gjykatë me lëndën C. NR. 146/ 2001 ka iniciuar procedurën kontestimore kundër parashtruesit të kërkesës si të paditur, me aktvendimin e të njëjtës gjykatë, C. BR. 146/2001, të 8 majit 2002, është hedhur poshtë padia si e palejueshme (ka bashkangjitur Aktvendimin C. NR. 146/2001, të 8 majit 2002)".*

33. Më tej, parashtruesi i kërkesës konsideron:

> *"... se, nga Gjykata Komunale në Therandë, i janë shkelur të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe përdorim të mjetit juridik, sepse Gjykata Komunale në Therandë ka vendosur për një (çështje e cila ka qenë e gjykuar më parë me aktgjykim dhe aktvendimin e cituar në pikën II të kërkesës, pra gjykata ka shkelur ndalesën –s'ka dy herë gjykim për të njëjtën çështje (Ne bis in idem), pastaj gjykata, duke i caktuar përfaqësues të përkohshëm paraqitësit të kërkesës pa u plotësuar kushtet ligjore nga LPK-ja, ia*

ka bërë të pamundur paraqitësit të kërkesës pjesëmarrjen në shqyrtim. Për këto shkelje të rënda procedurale janë paraqitur arsye në revizionin e paraqitësit të kërkesës";

"... se, gjatë procedurës së zhvilluar në Gjykatën Komunale në Therandë, janë shkelur të drejtat e tij të parapara me dispozitat e nenit 21 (Parimet Themelore), të nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), të nenit 32 (E Drejta për Mjete Juridike), të nenit 54 (E Drejta për Mbrojtje Gjyqësore) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 6 (Të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut)".

34. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me këtë kërkesë:

"*... që aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Therandë, C. Nr. 211/02, i dt. 17.12.2007, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, AC. Nr. 48/08, i dt. 20.01.2011, të anulohen".*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

35. Parashtruesi i kërkesës pohon se bazë për kërkesën e tij janë: neni *21* (Parimet e Përgjithshme); neni 31 (E drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm); neni 32 (E Drejta për Mjete Juridike); neni 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

36. Neni 48, i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që, në kërkesën e tij, të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

37. Sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të veprojë si gjykatë e apelit me rastin e shqyrtimit të vendimeve të nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta ta interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I*).

38. Parashtruesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (*Shih, Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005*). Parashtruesi nuk thekson se si e mbështesin neni 31 dhe neni 32 ankesën e tij, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 48 të Ligjit.

39. Parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i janë shkelur të drejtat me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe me zbatimin e ligjit nga gjykatat e rregullta, duke theksuar se *"gjykata nuk respektoi ndalesën se nuk gjykohet dy herë për të njëjtën çështje (**Ne bis in idem**) si dhe me Aktvendimin e të njëjtës gjykatë, C. nr. 146/2001, e 8 majit 2002, u hodh poshtë padia si e palejueshme (kemi të bëjmë me çështje të vendosur/res judicata)"*.

40. Nga dosja e lëndës shihet qartë se Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Therandë, C. nr. 146/2001, i 8 majit 2002, për të cilin parashtruesi i kërkesës pohon se është anuluar *res judicata* me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 167/02, e 21 tetorit 2002, në arsyetim, me detaje arsyeton se nuk kemi të bëjmë me gjykimin e dytë të së njëjtës çështje, *Ne bis in idem,* siç pretendon parashtruesi i kërkesës, si bazë për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

41. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tij dhe për të kontestuar interpretimin e ligjit, për të cilin mendon se nuk është i saktë, në Gjykatën Komunale në Therandë, në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat ishin të padrejta, apo arbitrare (*Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009*).

42. Përfundimisht, kjo kërkesë nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të cekë dhe të mbështesë me prova se, me vendimin e kontestuar, atij i janë shkelur liritë dhe të drejtat kushtetuese.

43. Nga kjo rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar, në përputhshmëri me rregullin 36.2. (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh: "*Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: ... b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese"*.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës; në përputhje me nenin 48 të Ligjit; dhe në përputhje me rregullin 36.2 (b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 6 mars 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'ua komunikojë vendimin palëve dhe ta publikojë vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 20/13, Rifat Osmani, datë 11 prill 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 10/2013 të 22 janarit 2013

KI 20/13, Aktvendim për papranueshmëri i datës 12 mars 2013

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, paraburgimi, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për liri dhe siguri, qartazi e pabazuar

Parashtruesi përveç kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 10/2013 të datës 22 janar 2013, i cili vërteton vendimet e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë për vazhdimin e paraburgimit, gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës që të vendosë masën e përkohshme, gjegjësisht lirimin e parashtruesit të kërkesës nga paraburgimi.

Parashtruesi i kërkesës pohon që [...] "*Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme në Prishtinë, si autoritete publike, me mos-përfilljen dhe zvarritjen e procedurës hetimore dhe gjyqësore*" kanë shkelur të drejtat e tij individuale të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, nenet 5.3 dhe 5.4 [E Drejta për Liri dhe Siguri] dhe nenin 6.1 [E Drejta për Proces të Rregullt Gjyqësor] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj.

Në kërkesën konkrete, arsyetimet e prokurorisë dhe gjykatave për vazhdimin e paraburgimit i referohen peshës së veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës, gjakftohtësisë së të akuzuarit, si dhe kështu, edhe rrezikut të ikjes apo përsëritjes së veprës, apo kryerjes së ndonjë vepre të ngjashme. Këto rrethana duken që i atribuohen ndërlikueshmërisë së rastit, duke i pamundësuar kësaj Gjykate të vlerësojë që kohëzgjatja e procedurave është e paarsyeshme.

Gjykata konstatoi se faktet e prezantuara nga parashtruesi i kërkesës nuk arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, si dhe që parashtruesi nuk ka dëshmuar që të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

Gjykata po ashtu vëren që parashtruesi nuk ka dëshmuar se si interesat e tij do të vuanin dëme të paripërueshme nëse masa e përkohshme nuk vendoset, dhe si rrjedhojë nuk e miratoi kërkesën për masë të përkohshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI 20/13
Parashtruesi
Rifat Osmani
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 10/2013, të datës 22 janar 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Rifat Osmani (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi i kërkesës), përfaqësuar nga Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" SHPK.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 10/2013 të datës 22 janar 2013, dorëzuar Parashtruesit të kërkesës më 20 shkurt 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 10/2013 të datës 22 janar 2013.

4. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) që të vendosë masën e përkohshme, gjegjësisht lirimin e Parashtruesit të kërkesës nga paraburgimi.

Baza ligjore

5. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe Rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 22 shkurt 2013, Parashtruesi dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë.

7. Më 25 shkurt 2013, Kryetari emëroi Gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare Raportuese, si dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga Gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Surroy (anëtar) dhe Ivan Cukalovic (anëtar).

8. Më 26 shkurt 2013, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e Parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi kopjet e aktvendimeve të nxjerra nga gjykatat e rregullta, të cilat janë përmendur nga Parashtruesi në kërkesën e tij. Në të njëjtën datë, Gjykata gjithashtu njoftoi Gjykatën Supreme që kërkesa është regjistruar me numrin KI 20/13.

9. Më 27 shkurt 2013, përfaqësuesi ligjor i Parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese aktvendimet e kërkuara për vazhdimin e paraburgimit, të nxjerrë nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Themelore në Prishtinë, duke përfshirë këto vendime të Gjykatës Supreme: Pn. Nr. 228/2010 (7 maj 2010); Pn. Nr. 737/2010 (28 dhjetor 2010); Pn. Nr. 730/2011 (29 dhjetor 2011); Pn. Nr. 475/2012 (26 qershor 2012); Pn. Nr. 659/2012 (22 gusht 2012); si dhe Pn. Nr. 854/2012 (22 tetor 2012).

Faktet e rastit

10. Më 24 maj 2009, Policia e Kosovës bëri Kallëzimin Penal në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë, për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar që Parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën penale të ndihmës në vrasje të rëndë, në bazë të nenit 147, paragrafi 1, pika 9, në lidhje me nenin 25 të Kodit të vjetër Penal të Kosovës.

11. Në të njëjtën datë, gjyqtari i procedurës paraprake, me vendimin GJPP. Nr. 136/2009, të datës 24 maj 2009, caktoi paraburgimin ndaj

Parashtruesit të kërkesës për një (1) muaj, përkatësisht deri më 22 qershor 2009.

12. Më 13 gusht 2009, Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë ngriti Aktakuzën PP. Nr. 465-6/2009 për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar që Parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën penale të ndihmës në vrasje të rëndë, të përcaktuar me nenin 147, paragrafi 1, pika 9, në lidhje me nenin 25 të Kodit të vjetër Penal të Kosovës.

13. Më 5 tetor 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me aktvendimin e saj KA. Nr. 348/09 konfirmoi Aktakuzën PP. Nr. 465-6/2009 kundër Parashtruesit të kërkesës, për veprën penale të ndihmës në vrasje të rëndë. Në aktvendimin e lartcekur, Gjyqtari kompetent për konfirmimin e Aktakuzës vendosi që Aktakuza ishte ushtruar në pajtim me ligjin, si dhe që vepra penale me të cilën ishte akuzuar Parashtruesi i kërkesës përmbante elementet e veprës penale të përcaktuar me nenin 147, paragrafi 1, pika 9, në lidhje me nenin 25 të Kodit të vjetër Penal të Kosovës, si dhe kishte theksuar që [...]"*nuk ekzistojnë rrethanat që përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurëve, dhe që pengojnë ndjekjen penale të tyre*."

14. Sipas dokumenteve të dorëzuara nga Parashtruesi i kërkesës, në bazë të obligimit të gjykatës për të nxjerrë një aktvendim në lidhje me vazhdimin apo ndërprerjen e paraburgimit çdo dy muaj, nga qershori 2009 deri në shkurt të vitit 2013, tetëmbëdhjetë (18) aktvendime për vazhdimin e paraburgimit janë nxjerrë nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë. Aktvendimi i fundit, gjegjësisht Aktvendimi P. No. 383/09 për vazhdimin e paraburgimit është nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë më 13 shkurt 2013. Për gjashtë (6) aktvendime të Gjykatës së Qarkut nga Parashtruesi i kërkesës është parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme. Gjykata Supreme ka konfirmuar pesë (5) nga këto aktvendime.

15. Në bazë të dokumenteve të dorëzuara bashkë me kërkesën, gjegjësisht procesverbalet e seancave në Gjykatë, disa seanca janë mbajtur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Ngjashëm, një numër dëshmitarësh, duke përfshirë edhe ekspertët, janë ftuar të paraqiten në Gjykatë. Megjithatë, dokumentacioni i dorëzuar nga Parashtruesi i kërkesës përmban referenca për procedurat e kësaj Gjykate vetëm për vitin 2011.

16. Kundër aktvendimeve të kolegjit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.Nr. 383/2009, të datës 12 tetor 2012, si dhe vendimeve të Gjykatës Supreme, Pn. Nr. 854/2012, të datës 22 tetor 2012, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale, përfaqësuesit e Parashtruesit të kërkesës kanë dorëzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, duke propozuar që Gjykata Supreme [...]"*të ndryshojë aktvendimin e kundërshtuar, ashtu që të akuzuarit ti ndërpritet paraburgimi apo ti caktohet ndonjë masë alternative.*"

17. Më 22 janar 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin e saj Pkl. Nr. 10/2013 hodhi poshtë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, duke theksuar që aktvendimet e kontestuara me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë nuk ishin më në fuqi, për arsyen që në bazë të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, paraburgimi është zgjatur deri më 17 dhjetor 2012, derisa kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është pranuar më 18 janar 2013.

18. Gjykata Supreme, në aktgjykimin e saj gjithashtu thekson që [...]" *sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare për bazën ligjore për të cilën i është vazhduar paraburgimi, si dhe drejt ka vepruar kur të akuzuarit ia ka vazhduar paraburgimin sipas dispozitës së nenit 281, paragrafi 1, nën-paragrafët 1 dhe 2, pika (i) të KKPK, sepse, i akuzuari mund të iki apo arratiset nga përgjegjësia penale për shkak të peshës së veprës penale dhe dënimit eventual që do të mund t'i shqiptohet nëse shpallet fajtor, andaj me gjetjen e tij në liri ekziston rreziku se ai do të arratiset dhe do të pengojë sigurimin e prezencës së tij në procedurën e mëtejme penale".*

19. Në të njëjtin aktgjykim Pkl. Nr. 10/2013, Gjykata Supreme thekson më tutje që [...]*"sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ia ka zgjatur vazhduar masën e paraburgimit, në përputhje me dispozitat e nenit 281, paragrafi 1, nën-paragrafët 1 dhe 2, pika (iii) e KPPK-së, duke pasur parasysh peshën e veprës penale si dhe nga mënyra tejet e vrazhdë - e ka pritur në veturë të akuzuarin tjetër i cili e ka vrarë mikun në oborrin e xhamisë, andaj gjakftohtësia e treguar nga ana e të akuzuarit duke e planifikuar dhe përgatitur kryerjen e veprës penale, janë fakte që tregojnë rrezikun se me lënien në liri i njëjti do të mund ta përsërisë apo të kryejë vepër penale të ngjashme".*

Pretendimet e Parashtruesit

20. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës në veçanti konteston Aktgjykimin e fundit të Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 10/2013 të datës 22 janar 2013, në lidhje me refuzimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, duke e kontestuar në të gjitha pjesët e tij për shkak të jo-ligjshmërisë dhe mungesës së argumenteve.

21. Parashtruesi i kërkesës më tutje pohon që [...] "*Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme në Prishtinë, si autoritete publike, me mos-përfilljen dhe zvarritjen e procedurës hetimore dhe gjyqësore*" kanë shkelur të drejtat e tij individuale të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, nenet 5.3 dhe 5.4 [E Drejta për Liri dhe Siguri] dhe nenin 6.1 [E Drejta për Proces të Rregullt Gjyqësor] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe Protokollet e saj.

22. Parashtruesi i kërkesës i kërkon Gjykatës Kushtetuese të përcaktojë nëse të drejtat e tij kushtetuese, të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], si dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, si dhe nenet 5.3 dhe 5.4 [E Drejta për Liri dhe Siguri] të KEDNJ-së dhe Protokollet e saj, janë cenuar si rezultat i jo-kushtetutshmërisë dhe jo-ligjshmërisë së zgjatjes së paraburgimit.

23. Parashtruesi më tutje kërkon nga Gjykata Kushtetuese të përcaktojë nëse "*është cenuar e drejta kushtetuese për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të shpejtë, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolleve të saj si rezultat i dështimit të respektimit të neneve të sipër-përmendura.*"

24. Përveç kërkesave të lartpërmendura nga Parashtruesi, është parashtruar edhe kërkesa për vendosje të masës së përkohshme. Në kërkesën e tij për masë të përkohshme, Parashtruesi kërkon lirimin e tij nga paraburgimi.

Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesës

25. Para së gjithash, për të shqyrtuar kërkesën e Parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës ka përmbushur të gjitha

kërkesat e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë dhe specifikohen më tej me Ligj dhe Rregullore të Punës.

26. Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në Gjykatë, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

Neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Në lidhje me kërkesën, Gjykata vëren që Parashtruesi i kërkesës është person fizik, si dhe është palë e autorizuar në pajtim me nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

27. Gjykata gjithashtu duhet të përcaktojë nëse Parashtruesi i kërkesës, në pajtim me kërkesat e nenit 113 (7) të Kushtetutës, si dhe nenin 47 (2) të Ligjit, ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Në rastin aktual, vendimi përfundimtar në rastin e Parashtruesit të kërkesës, është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 10/2013, i datës 22 janar 2013. Si rrjedhojë, Parashtruesi ka dëshmuar që ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjeve në fuqi.

28. Parashtruesi gjithashtu duhet të dëshmojë se ka përmbushur kërkesat e nenit 49 të Ligjit, në lidhje me dorëzimin e kërkesës brenda afatit kohor. Nga shkresat e lëndës, mund të shihet që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pkl. Nr. 10/2013 është dorëzuar tek Parashtruesit më 20 shkurt 2013, derisa Parashtruesi ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë më 22 shkurt 2013, që do të thotë se kërkesa është dorëzuar brenda afatit katërmujor, të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të Punës.

29. Në lidhje me kërkesën, Gjykata gjithashtu merr parasysh Rregullin 36 të Rregullores së Punës, i cili përcakton që:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar."

30. Në rastin konkret, sa i përket procedurave në gjykatat e rregullta, Gjykata i referohet Konfirmimit të Aktakuzës, të datës 5 tetor 2009, si dhe aktvendimeve të nxjerra nga Gjykata e Qarkut që prej vitit 2009, duke përfshirë aktvendimin e fundit të Gjykatës Themelore të datës 13

shkurt 2013 për vazhdimin e paraburgimit. Në të gjitha vendimet e saj për vazhdimin e paraburgimit, Gjykata e Qarkut ka vlerësuar që në bazë të rrethanave në të cilat është kryer vepra penale, si dhe peshën e veprës penale, ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit. Ky arsyetim është konfirmuar nga Gjykata Supreme në aktvendimet e saj, me të cilët ka hedhur poshtë ankesat e Parashtruesit si të pabazuara.

31. Gjykata më tutje vëren që Gjykata Supreme e Kosovës, në aktgjykimin e saj Pkl. Nr. 10/2013 ka hedhur poshtë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, duke konfirmuar kështu që gjykata e shkallës së parë ka ofruar arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare mbi bazën ligjore të vazhdimit të paraburgimit, si dhe që ka vepruar drejt kur ka vazhduar paraburgimin e Parashtruesit të kërkesës.

32. Në këtë kontekst, u mbetet gjykatave të përcaktojnë nëse, në bazë të rrethanave të rastit, kohëzgjatja e paraburgimit ka tejkaluar kufirin e arsyeshëm. Me fjalë tjera, gjykatat kanë diskrecion të vendosin se çfarë është e arsyeshme në rrethanat e caktuara (Shih, *mutatis mutandis Wemhoff kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, 7 GJEDNJ (ser. A) tek 23, 1968). Në kërkesën konkrete, arsyetimet e prokurorisë dhe gjykatave për vazhdimin e paraburgimit i referohen peshës së veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës, gjakftohtësisë së të akuzuarit, si dhe kështu, edhe rrezikut të ikjes apo përsëritjes së veprës, apo kryerjes së ndonjë vepre të ngjashme. Këto rrethana duken që i atribuohen ndërlikueshmërisë së rastit, duke i pamundësuar kësaj Gjykate të vlerësojë që kohëzgjatja e procedurave është e paarsyeshme (Shih *mutatis mutandis, Boddaert kundër Belgjikës*, Ap. Nr. 12919/87, miratuar më 12 tetor 1992).

33. Për më tepër, sa i përket veprimeve të prokurorisë dhe gjykatës së shkallës së parë, nuk ka prova të tilla që paraburgimi është vazhduar pa arsye, apo që gjykata ka qenë plotësisht pasive apo pasive për një periudhë të gjatë kohore (Shih *mutatis mutandis, Arsov kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë,* Ap. Nr. 44208/02, miratuar më 19 tetor 2006).

34. Gjithsesi, Gjykata vetëm se mund të marrë parasysh nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrën që t'i sigurohet Parashtruesit gjykimi i drejtë (Shih, mes burimeve tjera, *Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Ap. Nr. 13071/87,* miratuar më 10 korrik 1991).

35. Më tej, Gjykata rithekson që Gjykata Supreme e Kosovës, si dhe gjykatat tjera të rregullta, janë të pavarura në ushtrimin e pushtetit të tyre gjyqësor.

36. Për të gjitha arsyet e lartpërmendura, Gjykata është e bindur që faktet e prezantuara nga Parashtruesi i kërkesës nuk arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, si dhe që Parashtruesi nuk ka dëshmuar që të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

Kërkesa për masë të përkohshme

37. Neni 27 i Ligjit, dhenë veçanti Rregulli 54 (1) i Rregullores së Punës, përcaktojnë që *"në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme."*

38. Megjithatë, duke marrë parasysh që Kërkesa është shpallur e papranueshme, Parashtruesi nuk ka të drejtë, sipas Rregullit 54 (1) të Rregullores së Punës, që të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme.

39. Për më tepër, Gjykata vëren që Parashtruesi nuk ka dëshmuar se si interesat e tij do të vuanin dëme të pariparueshme nëse masa e përkohshme nuk vendoset. Në fakt, sa i përket kërkesës së Parashtruesit për lirim nga paraburgimi, kjo Gjykatë nuk e konsideron si kompetencë të vetën që t'i ofrojë këtë mbrojtje Parashtruesit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 27 të Ligjit dhe në përputhshmëri me rregullat 36, 54, 55 dhe 56 të Rregullores së Punës, më 12 mars 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 114/12, Kastriot Hasi, datë 16 prill 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Konkluzionit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjakovës, nr. 07/351-8460, të 24 janarit 2011.

Rasti KI 114/12, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 marsit 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë Individuale, kërkesë e parakohshme.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se me konkluzionet e Komunës së Gjakovës dhe me njoftimet e Gjykatës Komunale të Gjakovës, atij i është mohuar e drejta e ndërtimit në pronën e tij, edhe pse nuk ka specifikuar drejtpërdrejti se cila e drejtë kushtetuese i është shkelur.

Në këto rrethana, parashtruesi ankesës nuk ka dëshmuar se i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe të parapara me ligj, andaj Gjykata, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 1, pika a, të Rregullores, gjen se kërkesën duhet ta refuzojë si të parakohshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI114/12
Parashtrues
Kastriot Hasi
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Konkluzionit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gjakovës, nr. 07/351-8460, të 24 janarit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan,gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Kastriot Hasi, nga Gjakova, me banim në Gjakovë, Rr. "A. Mojsiu", p. n.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar i autoritetit publik është Konkluzioni i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit i Komunës së Gjakovës, nr. 07/351-8460, i 24 janarit 2011, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar në një datë të paspecifikuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së parashtruar në kërkesën e parashtruesit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), më 8 nëntor 2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Konkluzionit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit të Komunës së Gjakovës, nr. 07/351-8460, i 24 janarit 2011, me të cilin parashtruesi i kërkesës njoftohet se kjo drejtori ka ndërprerë procedurën për dhënien e lejes për ndërtim të objektit të banimit të lartë kolektiv në ngastrën

kadastrale nr. 382/2 dhe në ngastrën kadastrale nr. 382/4, në Zonën Kadastrale Gjakovë-qytet, e që ishte iniciuar me kërkesën e vet z. Hasi.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës; neni 22 dhe neni 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009; dhe rregullat: 54, 55 dhe 56 (2), të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 8 nëntor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë, dhe e njëjta u regjistrua në regjistrin përkatës të Gjykatës, me Nr. KI114/12.

6. Më 11 dhjetor 2012, me Vendimin GJ.R. KI114/12, Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtar raportues gjyqtarin Kadri Kryeziu, ndërsa me Vendimin KSH 114/12, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe prof. dr. Enver Hasani (anëtarë).

7. Më 11 dhjetor 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.

8. Më 20 dhjetor 2012, Gjykata Kushtetuese pranoi, nëpërmjet postës, dokumentacionin shtesë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, i cili dokumentacion përbëhej nga kopje të planit dhe skica të punuara të parcelave ku parashihej ndërtimi, si dhe të objektit që kishte për qëllim të ndërtonte parashtruesi i kërkesës.

9. Më 6 mars 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 29 maj 2008, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit e Komunës së Gjakovës, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Kastriot Hasi për leje urbanistike dhe të ndërtimit të lartë në qytetin e Gjakovës, nxori Njoftimin nr. 07-351-1956, me të cilin z. Hasi njoftohej se në zonën kadastrale ku ai kishte kërkuar ndërtim të lartë, sipas planit ideor të Komunës, të aprovuar më 29 gusht 2001, në ngastrat kadastrale pronar i të cilave ishte ai, lejohej "ndërtimi i objektit ekzistues plus një etazh". Por, meqenëse z. Hasi kishte kërkuar leje për ndërtim të lartë,

Komuna kërkoi nga parashtruesi i asaj kërkese plotësim të lëndës: pëlqimin nga fqinjët për ndërtimin e objektit të tij.

11. Komuna kërkoi nga z. Hasi marrjen dhe dërgimin në Komunë të katër pëlqimeve nga fqinjët, dhe atë: 1) Pëlqimin nga Gjykata Komunale në Gjakovë, e cila ishte pronare e ngastrave: nr. 382/1 dhe nr. 383/1, Zona Kadastrale Gjakovë-qytet, dhe që kufizoheshin me parcelën ku z. Hasi mendonte të ndërtonte objektin e tij shumëkatësh; 2) Pëlqimin nga fqinji, i cili është pronar i ngastrës kadastrale nr. 382/3; 3) Pëlqimin nga fqinji perëndimor; dhe 4) Pëlqimin nga fqinji verior, z. Selim Tolaj.

12. Komuna theksoi se marrja dhe prezantimi i këtyre "pëlqimeve me shkrim është kusht primar për shqyrtimin dhe për analizimin e lëndës për vazhdimin e procedurës për dhënien urbanistike dhe lejes së ndërtimit". Më tej, Komuna theksoi se mosprezantimi i këtyre pëlqimeve do të ndikonte që leja e kërkuar të mos jepej.

13. Më 29 maj 2008, z. Hasi kërkoi me shkrim pëlqimin për ndërtim nga fqinji kufizues, Gjykata Komunale në Gjakovë, por mori përgjigje negative me arsyetimin se, sipas planit ideor të qytetit, në ato ngastra nuk lejohet ndërtimi i lartë.

14. Më 30 qershor 2008, Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, nxori Konkluzionin nr. 07/351-1956, me të cilin ndërpritej procedura e iniciuar sipas kërkesës së z. Kastriot Hasi nga Gjakova, për dhënien e lejes për ndërtim kolektiv (të lartë) në Gjakovë, sepse, konform kërkesës së Komunës për plotësim të kërkesës, parashtruesi nuk kishte prezantuar pëlqimet me shkrim për ndërtimin nga fqinjët: Gjykata Komunale në Gjakovë, fqinji perëndimor dhe ai verior, sipas kushteve të cekura në kërkesën e Komunës për plotësim të lëndës.

15. Në Konkluzion u theksua se, në rast të përmbushjes eventuale të kushteve të parashtruara nga Komuna, z. Hasi mund të riaplikojë për leje ndërtimi.

16. Më 6 dhjetor 2010, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit e Komunës së Gjakovës, pas shqyrtimit të kërkesës së përsëritur nga z. Kastriot Hasi për leje urbanistike dhe të ndërtimit të lartë në qytetin e Gjakovës, nxori Njoftimin nr. 07-351-8460, me të cilën nga parashtruesi i asaj kërkese kërkoi plotësim të lëndës: pëlqim nga fqinjët për ndërtimin e objektit të tij, të njëjta sikur ato që u përmendën në paragrafin 11 të këtij aktvendimi.

17. Më 8 dhjetor 2010, z. Hasi paraqiti kërkesë me shkrim në Gjykatën Komunale në Gjakovë, duke kërkuar pëlqimin me shkrim për ndërtimin e objektit të ndërtimit të lartë, sipas kushteve që ia kishte kërkuar Komuna e Gjakovës, dhe prapë mori përgjigje negative me të njëjtin arsyetim se nuk lejohet ndërtimi i lartë në ngastrat ku ai kishte planifikuar ndërtimin.

18. Më 24 janar 2011, për pasojë të mungesës së prezantimit të pëlqimit nga Gjykata Komunale (sepse ndërkohë z. Hasi kishte marrë pëlqimet me shkrim nga fqinjët e tjerë), Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, nxori Konkluzionin nr. 07/351-8460, me të cilin përsëri ndërpritej procedura e iniciuar sipas kërkesës së z. Kastriot Hasi nga Gjakova për dhënien e lejes për ndërtim kolektiv (të lartë) në Gjakovë, sepse parashtruesi i saj nuk kishte vepruar konform kërkesës së Komunës për plotësim të lëndës, duke dështuar të prezantojë pëlqimin me shkrim për ndërtim nga fqinji Gjykata Komunale në Gjakovë.

19. Në udhëzimin juridik të Konkluzionit theksohet se pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, kundër këtij konkluzioni, në afatin 30 ditë nga dita e pranimit të tij.

20. Më 15 nëntor 2012, z. Hasi mori një përgjigje nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor, në të cilën përsëritej se Gjykata Komunale në Gjakovë dhe Këshilli Gjyqësor, në emër të saj, nuk mund të japin pëlqim pozitiv për ndërtimin e objektit të lartë të kërkuar nga z. Hasi, përderisa Komuna e Gjakovës nuk ka një plan të detajuar urbanistik, e plani ideor në fuqi i Komunës në ngastrat kadastrale ku planifikohet ndërtimi nuk lejon ndërtim të lartë, andaj as Gjykata Komunale e as Këshilli Gjyqësor nuk mund të dalin përtej ligjit.

Pretendimet e parashtruesit për shkeljet kushtetuese

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me konkluzionet e Komunës së Gjakovës dhe me njoftimet e Gjykatës Komunale të Gjakovës, atij i është mohuar e drejta e ndërtimit në pronën e tij, edhe pse nuk ka specifikuar drejtpërdrejti se cila e drejtë kushtetuese i është shkelur.

22. Parashtruesi, më tej, thekson se ai e ndien veten viktimë të mospajtimit ndërmjet Gjykatës Komunale në Gjakovë dhe Komunës së Gjakovës, sepse, për pasojë të hedhjes së përgjegjësisë prej njërit organ te tjetri, ai nuk mund ta ndërtojë objektin sikur e kishte planifikuar.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Për të qenë ne gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata paraprakisht duhet të vlerësojë nëse pala i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës të Gjykatës.

24. Përkitazi me këtë, i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku përcaktohet:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

25. Në këtë drejtim, Gjykata konkludon se z. Hasi është qytetar i Kosovës, është individ dhe pretendon se, me konkluzionet e Komunës dhe me njoftimet e Gjykatës Komunale, atij i janë cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Së këndejmi, Gjykata do ta trajtojë kërkesën e tij brenda kornizave juridike të nenit 113.7 (kërkesat individuale) të Kushtetutës së Kosovës.

26. Rrjedhimisht, në përputhshmëri me paragrafin e mësipërm, z. Hasi, para se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese, do të duhej t'i kishte shteruar të gjitha mjetet juridik në dispozicion dhe të parapara me ligj.

27. Gjithmonë duke marrë për bazë shkresat e lëndës, të ofruara nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vëren se pëlqimet e kërkuara nga Gjykata Komunale në Gjakovë janë "dokumentacion i kërkuar në funksion të përmbushjes së kushteve për marrjen e lejes së ndërtimit", andaj është qartë se kërkesa bazë e parashtruesit ka të bëjë me "LEJEN PËR NDËRTIM" që, sipas legjislacionit në fuqi, e lëshon Komuna.

28. Për të konstatuar faktin nëse parashtruesi i kërkesës i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, e që janë në lidhmëni me objektin e çështjes së shtruar në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata merr parasysh legjislacionin në fuqi dhe veçanërisht:

Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale (Nr. 03/L-040)

Neni 17

Kompetencat vetanake

Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:

(.....)
d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit.

Neni 74

Objektivat e shqyrtimit administrativ

Shqyrtimi administrativ i komunave ka objektivat vijues:

...

b) të sigurojë ligjshmëri të aktiviteteve të organeve të vetëqeverisjes lokale.

Neni 76

Autoritet mbikëqyrëse

76.1 Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale është autoriteti mbikëqyrës, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e komunave nuk i jepet me ligj ministrisë përgjegjëse apo institucionit që ka të bëjë me lëmi të posaçme.

Statuti i Komunës së Gjakovës

29. Statuti i Komunës së Gjakovës, gjithashtu, përmban dispozita relevante për këtë çështje dhe sidomos përmban dispozitat në vijim:

Neni 1

Statuti i Komunës së Gjakovës (në tekstin e mëtejmë do të njihet si "Statuti") është akti më i lartë juridik i Komunës që miratohet nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me nenin 12, pika 3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Neni 55

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Kjo drejtori është përgjegjëse për:

(.....)

i) përpunimin e kërkesave për lëshimin e lejeve ndërtimore dhe përcaktimin e
kushteve urbanistike për zbatimin e PZHK, PZHU, Planeve Rregulluese dhe Planeve tjera të miratuara në Kuvend;

j) të japë shënime mbi madhësinë dhe destinimin e ngastrës së caktuar ndërtimore, ose kompleksit të tokës dhe karakteristikat e parashtruara të ndërtimit – jep pëlqime urbanistike dhe leje urbanistike;

k) lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe përdorimit.

30. Nga dispozitat juridike, të cituara qartë më sipër, Gjykata arrin në përfundim:

a) Leje të ndërtimit lëshohen nga Komuna (Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit);

b) Leja e ndërtimit është akt administrativ, i lëshuar nga organi kompetent, me procedurë administrative;

c) Në rast të refuzimit të lejes, apo të ndërprerjes së procedurës me konkluzion, sikur në rastin konkret, ka mjet juridik të ankimit;

d) Mjeti juridik, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ushtrohet në ministrinë përkatëse, e në rastin konkret, sipas udhëzimit juridik të Komunës, në Konkluzionin nr. 07/351-8460, e 24 janarit 2011, do të duhej të ushtrohej në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejmë: MMPH).

31. Për më tepër, në rast të marrjes së përgjigjes negative edhe nga MMPH-ja, pala e pakënaqur mund të hapë procedurë për konflikt administrativ në gjykatën kompetente, ku do të shqyrtohej ligjshmëria e akteve administrative.

32. Nga shkresat e dorëzuara në Gjykatë nga parashtruesi, Gjykata nuk vë në dyshim faktin se këto mjete juridike në dispozicion dhe të parapara me ligj nuk i ka përdorur parashtruesi i kërkesës, z. Hasi, por, në vend të tyre, ka ushtruar kërkesa e ankesa në gjykatë dhe pastaj në Këshillin Gjyqësor, duke insistuar në pëlqimin për ndërtim të objektit nga Gjykata Komunale, sikur i ishte kërkuar nga Komuna e Gjakovës.

33. Gjykata thekson se qëllimi i rregullit të shterimit të mjeteve juridike, i paraparë me ligj, përpos që është obligim kushtetues i dalë nga përkufizimi juridik i nenit 113.7 të Kushtetutës, është gjithashtu edhe që t'u mundësojë autoriteteve vendore, dhe para të gjithash gjykatave apo edhe organeve administrative, për të parandaluar ose për të riformuluar shkeljet e ankimuara të Kushtetutës. Një qëndrim të tillë e mban edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe kjo bazohet mbi hipotezën e pasqyruar në nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas së cilës rendi juridik i brendshëm do të sigurojë një mjet ankimimi efektiv kundër shkeljeve të të drejtave të sanksionuara me Konventë (*Selmouni kundër Francës [DHM], § 74 ; Kudła kundër Polonisë [DHM], § 152 ; Andrášik e të tjerë kundër Sllovakisë [gjyk]*).

34, Gjykata Kushtetuese ka rol subsidiar, krahasuar me sistemet e rregullta vendëse gjyqësore apo edhe administrative dhe është e dëshirueshme që gjykatat kombëtare, ose organet kompetente administrative me kompetenca të vendimmarrjes efektive, të kenë fillimisht mundësinë të vendosin për çështjet e pajtueshmërisë të së drejtës së brendshme me Kushtetutën (*Shih vendimin e GJEDNJ-së - A, B dhe C kundër Irlandës [DHM], § 142*).

35. Në këto rrethana, parashtruesi ankesës nuk ka dëshmuar se i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe të parapara me ligj, andaj Gjykata, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 1, pika a, të Rregullores, gjen se kërkesën duhet ta refuzojë si të parakohshme, dhe:

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës; në mbështetje të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe në mbështetje të rregullit 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 6 mars 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 130/12, Xhymshit Xhymshiti, datë 16 prill 2013-Vlerësim i kushtetutshmërisë së njoftimit të Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim Prokurorial, ZZVP/12/123, të 23 nëntorit 2012

Rasti KI 130/12, Aktvendim për papranueshmëri i 18 marsit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë papranueshme, konflikt administrativ, mosshterje e mjeteve juridike, e drejta në punë

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar me vendimet e Panelit Vlerësues të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Parashtruesi, ndër të tjera, pohoi se ishte shkelur e drejta në punë dhe e drejta për përfaqësim në punësim në institucionet publike për shkak se ai nuk ishte rekomanduar për pozitën e prokurorit në Gjilan dhe në Ferizaj.

Gjykata konstatoi se parashtruesi nuk kishte shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me Nenin 113.7 të Kushtetutës. Gjykata, më tej, arsyetoi se rregulli i shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrohet autoriteteve kompetente, përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI130/12
Parashtrues
Xhymshit Xhymshiti
Vlerësim i kushtetutshmërisë së njoftimit të Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim Prokurorial, ZZVP/12/123, të 23 nëntorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Xhymshit Xhymshiti, avokat nga Gjilani.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi i kërkesës konteston njoftimin ZZVP/12/213 e Panelit Vlerësues të Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim Prokurorial, e 23 nëntorit 2012, dorëzuar parashtruesit më 24 nëntor 2012, dhe vendimin e Panelit për Rikonsiderim të Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK/82, e 30 nëntorit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është shkelja e pretenduar e të drejtës në punë nga Paneli Vlerësues i Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim Prokurorial, si dhe interpretimi kushtetues i përvojës 25-vjeçare të parashtruesit të kërkesës në gjyqësinë kosovare.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenin 20 dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës,

Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 36.1 (a) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 18 dhjetor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 10 janar 2013, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI130/12, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me vendimin Nr. KSH. KI130/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Enver Hasani.

7. Më 1 shkurt 2013, parashtruesi dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.

8. Më 28 shkurt 2013, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin, Zyrën për Vlerësim dhe Verifikim Prokurorial dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës për regjistrimin e kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.

9. Më 13 mars 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 22 maj 2012, Këshilli Prokurorial i Kosovës shpalli konkurs për vende të lira pune për prokurorë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe prokuroritë komunale të Gjilanit dhe të Ferizajt.

11. Parashtruesi aplikoi për pozitën e prokurorit në prokuroritë komunale të Gjilanit dhe të Ferizajt dhe, më 24 nëntor 2012, u njoftua nga Paneli Vlerësues i Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim Prokurorial se nuk ishte rekomanduar për pozitën që kishte aplikuar dhe se kandidatët e tjerë ishin treguar më të suksesshëm.

12. Parashtruesi i paraqiti kërkesë Panelit për Rikonsiderim të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe, më 4 dhjetor 2012, paneli në fjalë refuzoi kërkesën e parashtruesit për rikonsiderim, duke arsyetuar se është vërtetuar se parashtruesi ka pasur më pak pikë se kandidatët e tjerë, të rekomanduar nga Paneli Vlerësues.

Pretendimet e parashtruesit

13. Parashtruesi pretendon se Paneli Vlerësues dhe Paneli për Rikonsiderim, të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me njoftimet, përkatësisht me vendimet e tyre, duke mos e rekomanduar parashtruesin për pozitën e prokurorit në Gjilan dhe në Ferizaj, kanë shkelur të drejtën e tij për punë si dhe nenin 61 [Përfaqësimi në Punësim në Institucionet Publike] të Kushtetutës.

14. Parashtruesi pretendon se kërkesa e tij ka bazë kushtetuese, sepse, gjatë aplikimit për pozitën e prokurorit, ka ofruar fakte dhe dokumente të vërtetuara përkitazi me përvojën e tij 25-vjeçare në gjyqësinë kosovare.

15. Parashtruesi kërkon që Gjykata të bëjë interpretimin e përvojës së tij 25-vjeçare në gjyqësinë kosovare, si dhe të konstatojë shkeljen e të drejtave të tij nga Paneli Vlerësues dhe nga Paneli për Rikonsiderim, kur kanë vlerësuar se parashtruesi nuk ka arritur numrin e nevojshëm të pikëve për t'u rekomanduar për pozitën e prokurorit komunal në prokurorinë komunale në Gjilan apo në Ferizaj.

16. Parashtruesi, në kërkesën e tij në këtë Gjykatë, ka ofruar dëshmi për përvojën e tij si jurist në gjyqësinë kosovare, duke përfshirë edhe përvojën e tij si prokuror dhe gjyqtar.

17. Për më tepër, parashtruesi pretendon që *"është shumë e vërtetë se kandidatët e propozuar nuk kanë asnjë vit pune eksperiencë në prokurori"*.

Vlerësimi i pranueshmërisë

18. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës.

19. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës:

> *"Individët janë autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

20. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 10.1 dhe nenit 11 të Ligjit për Konfliktet Administrative, Nr. 03/L-202, ku përcaktohet:

> *"Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor".*
>
> *"Konflikti administrativ, sipas padisë [3], zgjidhet nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës".*

21. Nga dokumentet e dorëzuara shihet qartë se parashtruesi nuk ka iniciuar konflikt administrativ, bazuar në legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe, si rrjedhojë, nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

22. Arsyetimi mbi rregullin e shterimit është që t'u ofrohet autoriteteve kompetente, duke përfshirë gjykatat, mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (*Shih, Aktvendimi për papranueshmëri: AAB-RIINVEST L.L.C. Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI41/09, i 21 janarit 2010; dhe shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25 803/94, vendim i 28 korrikut 1999*).

23. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ngjashme, më 18 maj 2011, në Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin Nr. KI114/10, Parashtruese Vahide Badivuku, Vlerësim i kushtetutshmërisë të Njoftimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për riemërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, Nr. 01/118-713, i 27 tetorit 2010.

24. Rrjedhimisht, kërkesa është e papranueshme për shkak të mosshterjes së të gjitha mjeteve juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës; në mbështetje të nenit 47 të Ligjit; si dhe në pajtim me rregullin 36.1 (a) të Rregullores së punës, më 13 mars 2013, njëzëri

---

[3] Ligji Nr.03/L-202 për Konfliket Administrative e përdorë termin "aktpadi".

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KO 131/12 , Dr.Shaip Muja dhe 11 depuetet të tjerë, datë 18 prill 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012.

Rasti KO 131/12, Aktgjykimi i 6 marsit 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë Institucionale, masë e përkohshme, mbajtja e seancës dëgjimore, E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit.

Parashtruesit kontestojnë kushtetutshmërinë e neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 13 dhjetor 2012.

Në kërkesën e tyre, parashtruesit kontestojnë nenin 41 të Ligjit për Shëndetësi, i cili, në paragrafin 1, e ndalon çdo profesionist shëndetësor, të punësuar në çfarëdo institucioni të shëndetit publik, përfshirë edhe ata me orar të pjesshëm, të punojnë në institucion privat.

Parashtruesi ka kërkuar aplikimin e masës së përkohshme të pezullimit të zbatimit të Ligjit, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës përkitazi me këtë kërkesë.

Më 24 dhjetor 2012, Gjykata miratoi kërkesën e parashtruesve për Masë të përkohshme dhe PEZULLOI zbatimin e neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi deri më 31 janar 2013.

Më 7 mars 2013, Gjykata mbajti seancë dëgjimore, ku u ftuan parashtruesi dhe palët në procedurë.

Duke marrë parasysh argumentet e paraqitura nga palët në procedurë dhe pas shqyrtimit të dispozitave të kontestuara të nenit 18 dhe 19 *vis-à-vis* këtyre argumenteve, Gjykata gjeti se parashtruesit nuk e kanë mbështetur pretendimin e tyre mbi papajtueshmërinë e pretenduar të neneve 18 dhe 19 me Kushtetutë, Gjykata nuk ka gjetur asgjë që do të nënkuptonte se ka cenim të Kushtetutës.

Sa i përket nenit 60 të Ligjit për Shëndetësi, Gjykata vëren, pasi ka mbajtur dëgjimin publik, se pretendimet e ngritura nga parashtruesit janë të bazuara në tekstin e nenit 60 të Projektligjit që rrjedhimisht u ndryshua. Prandaj, Gjykata konstaton se nuk janë relevante argumentet e parashtruesve sa i përket papajtueshmërisë së pretenduar të nenit 60 të Kushtetutës.

Nga sa u tha më lart, Gjykata gjen se nenet 18, 19 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, të miratuar nga Kuvendi më 13 dhjetor 2012, janë në pajtueshmëri me Kushtetutën.

Gjykata, më 15 mars 2013, vendosi të shpallë kërkesën të pranueshme, nenet 18, 19 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të 13 dhjetorit 2012, janë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës; neni 41, paragrafët 1, 5 dhe 6 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të 13 dhjetorit 2012, janë në mospërputhje me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; neni 41, paragrafët 1, 5 dhe 6 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të 13 dhjetorit 2012, është i pavlefshëm;

Konsideron se Vendimi i Gjykatës për zgjatjen e Masës së përkohshme, i 24 janarit 2013, për pezullimin e zbatimit të neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të 13 dhjetorit 2012, pushon me hyrjen në fuqi të këtij aktgjykimi;

AKTGJYKIM
në
Rastin Nr. KO131/12
Parashtrues
Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës
Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës: Dr. Shaip Muja, Nait Hasani, Ramiz Lladrovci, Petar Miletić, Azem Syla, Time Kadrijaj, Xhevdet Neziraj, Kymete Bajraktari, Kurtan Kajtazi, Hydajet Hyseni, Saša Milosavljević dhe Sala Berisha.

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesit kontestojnë kushtetutshmërinë e neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 13 dhjetor 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi nga Gjykata i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të 13 dhjetorit 2012 (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Shëndetësi).

4. Më tej, parashtruesi ka kërkuar vendosjen e masës së përkohshme të pezullimit të zbatimit të Ligjit për Shëndetësi, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës përkitazi me këtë kërkesë.

Baza juridike

5. Neni 113.5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); nenet 22, 27 dhe 42 e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); si dhe rregullat 54, 55, 56, 62, 64 dhe 65 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 20 dhjetor 2012, nëpërmjet postës, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Në mbështetje të kërkesës, parashtruesit kanë dërguar në Gjykatë edhe kopjen e Ligjit të Punës (Nr. 03/L-212); kopjen e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Nr. 02/L-133); dhe kopjen e Ligjit Kundër Diskriminimit (Nr. 2004/3), për të cilat parashtruesi thekson se janë relevantë për vlerësimin e kushtetutshmërisë.

7. Më 20 dhjetor 2012, Kryetari i Gjykatës e caktoi Gjyqtar raportues Zëvendëskryetarin e Gjykatës, dr. Ivan Čukalović, dhe, në të njëjtën ditë, emëroi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 21 dhjetor 2012, Gjykata ia komunikoi kërkesën Kuvendit të Republikës së Kosovës.

9. Më 21 dhjetor 2012, Gjykata, nëpërmjet postës zyrtare, mori një kopje të Ligjit për Shëndetësi, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

10. Më 24 dhjetor 2012, Gjykata miratoi kërkesën e parashtruesve për Masë të përkohshme dhe PEZULLOI zbatimin e neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi deri më 31 janar 2013.

11. Më 26 dhjetor 2012, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës i dorëzoi Gjykatës dokumentet në vijim:

    a. Ligji për Shëndetësi, i miratuar nga Kuvendi;

b. Raporti me rekomandimin e Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për Projektligjin për Shëndetësi;

c. Rekomandimet e tjera të paraqitura nga Komisionet e tjera të Kuvendit.

12. Më 10 janar 2013, ministri i Shëndetësisë dërgoi në Gjykatë një shkresë me këto kërkesa:

a. Që t'i lejohet statusi i palës së interesuar në procedurë, dhe
b. Në rast se kërkesa e lartpërmendur refuzohet, atëherë t'i jepet mundësia për të paraqitur me shkrim një parashtresë *amicus curiae*.

13. Më 11 janar 2013, Gjykata e njoftoi Ministrinë e Shëndetësisë (në tekstin e mëtejmë: MSH) se kërkesa e saj do të shqyrtohet nga Gjykata.

14. Më 14 janar 2013 Gjykata Kushtetuese pranoi komentet për Ligjin për Shëndetësi, të dërguara me vetiniciativë nga Shoqata Kosovare e të Shurdhërve. Në këto komente, Shoqata përshkruan pozitën e personave të shurdhër në Kosovë, si dhe potencon faktin se ata kanë qenë pjesë aktive në procesin e draftimit të Projektligjit dhe se, me iniciativën e tyre, në Projektligj ka qenë një dispozitë e veçantë që ka mundësuar qasjen e plotë mjekësore të personave të shurdhër në institucionet shëndetësore nëpërmjet gjuhës së shenjave. Më vonë, kjo dispozitë është hequr nga Komisioni Funksional parlamentar. Shoqata kërkoi që kjo dispozitë të rikthehet në Ligj, sepse ndryshe do t'i diskriminonte personat e shurdhër në realizimin e të drejtës për qasje në institucione shëndetësore. Për më tepër, Shoqata potencoi faktin se, me vendimin e Qeverisë, Nr. 06/146, të 29 shtatorit 2010, të nënshkruar nga Kryeministri i Kosovës, është bërë zyrtarizimi i gjuhës së shenjave.

15. Më 24 janar 2013, përfaqësuesi i parashtruesve i dorëzoi Gjykatës kopjet e letërnjoftimeve të parashtruesve, si dhe një kopje të nënshkruar të autorizimit.

16. Të njëjtën ditë, Gjykata pranoi një parashtresë me shkrim *amicus curiae* nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: FSSHK).

17. Në po të njëjtën ditë, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, si dhe i paraqiti rekomandim Gjykatës, në përbërje të plotë, përkitazi me:

a. Vendimin për vazhdimin e Masës së përkohshme, të vendosur nga Gjykata në vendimin e saj fillestar të 24 dhjetorit 2012, për një periudhë shtesë tremujore, deri më 30 prill 2013;

b. Vendimin përkitazi me kërkesën për të lejuar parashtrimin e parashtresës *amicus curiae*;

c. Vendimin për të mbajtur dëgjim publik më 7 mars 2013.

18. Më 24 janar 2013, Gjykata, në përbërje të plotë, njëzëri miratoi rekomandimet e Kolegjit shqyrtues.

19. Më 7 mars 2013, Gjykata mbajti seancë dëgjimore, ku u ftuan dhe ishin të pranishëm dhe u dëgjuan:

a) Përfaqësuesi i parashtruesve, Dr. Shaip Muja;

b) Përfaqësuesi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Xheladin Hoxha;

c) Ministria e Shëndetësisë, përfaqësuar nga ministri Ferid Agani;

d) Sindikata e Shëndetësisë e Kosovës, përfaqësuar nga kryetari i saj, z. Blerim Syla; si dhe

e) Avokati i Popullit, përfaqësuar nga z. Isa Hasani.

20. Përfaqësuesi i Kuvendit, gjatë seancës dëgjimore, i ofroi Gjykatës këto dokumente:

a) Vendimin për miratimin e Ligjit për Shëndetësi, të 13 dhjetorit 2012;

b) Raportin për rekomandimin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për Projektligjin e 13 dhjetorit 2012; si dhe

c) Ligjin për Shëndetësi.

21. Përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë, gjatë seancës dëgjimore, i dorëzoi Gjykatës komentet e Bankës Botërore për Projektligjin e rishikuar të Shëndetësisë, të 28 shtatorit 2011.

22. Përfaqësuesi i Federatës Sindikale të Shëndetësisë të Kosovës, gjatë seancës dëgjimore, i dorëzoi Gjykatës këto dokumente:

    a. Propozimin me amendamentet në Projektligjin për Shëndetësi; si dhe

    b. Letrën e përkrahjes për këtë federatë, të dërguar nga Federata Evropiane e Sindikatave të Shërbimit Publik (në tekstin e mëtejmë: EPSU).

23. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, gjatë seancës dëgjimore, i dorëzoi Gjykatës me shkrim mendimin e Avokatit të Popullit përkitazi me nenet e kontestuara të Ligjit për Shëndetësi.

24. Më 8 mars 2013, Kuvendi dorëzoi në Gjykatë transkriptin e seancës plenare, ku u miratua Ligji për Shëndetësi.

25. Më 15 mars 2013, Gjykata mbajti seancën e këshillimit dhe të votimit për rastin.

Përmbledhja e fakteve

26. Projektligji për Shëndetësi u sponsorizua nga Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe Qeveria e Kosovës ia propozoi Kuvendit të Kosovës. Kuvendi i Kosovës e miratoi atë në lexim të parë, më 28 qershor 2012.

27. Më 9 korrik 2012, në Prishtinë u organizua një dëgjim publik për Projektligjin.

28. Më 6 nëntor 2012, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve i dorëzoi Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale të Kuvendit të Kosovës një rekomandim sipas të cilit ky projektligj nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

29. Përveç kësaj, më 12 nëntor 2012, Komisioni për Integrime Evropiane konstatoi se Projektligji është në përputhje me a*cquis communautaire*. Po ashtu, Komisioni për Buxhet e Financa paraqiti koston buxhetore të Projektligjit për vitin 2013 dhe 2014.

30. Më 27 nëntor 2012, Komisioni për Legjislacion i Kuvendit të Kosovës dërgoi rekomandimet (04/3239/L-125) dhe paraqiti qëndrimin e vet se Projektligji për Shëndetësi nuk mund të procedohet për shqyrtim të mëtejmë dhe, rrjedhimisht, i sugjeroi Komisionit Funksional për

Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale rishikimin e amendamenteve 1, 3, 12, 48, 49, 50, 51 dhe 52.

31. Më 3 dhjetor 2012, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale shqyrtoi komentet e Komisionit për Legjislacion të Kuvendit të Kosovës dhe "me shumicë votash miratoi raportin përfundimtar për Projektligjin për Shëndetësi".

32. Më 7 dhjetor 2012, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dorëzoi në Kuvend raportin-rekomandim për Projektligjin për Shëndetësi.

33. Më 13 dhjetor 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës debatoi në leximin e dytë për Projektligjin për Shëndetësi dhe miratoi amendamentet e mëposhtme të Projektligjit: 2, 3A, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30A, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50A, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59 dhe 60.

34. Rrjedhimisht, Projektligji ishte miratuar me 43 (dyzet e tri) vota për, 18 (tetëmbëdhjetë) vota kundër dhe 3 (tri) abstenime.

35. Më 17 dhjetor 2012, Federata e Sindikatave të Shëndetësisë e Kosovës, i dërgoi Avokatit të Popullit kërkesë për inicimin e procedurës së vlerësimit të kushtetutshmërisë së nenit 41 të Ligjit për Shëndetësi, të miratuar më 13 dhjetor 2012, duke pretenduar se neni 41 bie ndesh me Kushtetutën dhe veçanërisht me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

36. Më 21 dhjetor 2012, Kryetari i Kuvendit i dorëzoi Presidentit të Republikës për shpallje Ligjin e miratuar për Shëndetësi.

Pretendimet e parashtruesit

a) Parashtresat me shkrim

37. Në kërkesën e tyre, parashtruesit kontestojnë nenin 41 të Ligjit për Shëndetësi, i cili, në paragrafin 1, e ndalon çdo profesionist shëndetësor, të punësuar në çfarëdo institucioni të shëndetit publik, përfshirë edhe ata me orar të pjesshëm, të punojnë në institucion privat.

38. Neni 41 i Ligjit për Shëndetësi, me titull "*Parandalimi i konfliktit të interesit",* thotë:

Neni 41

"1. Profesionistët shëndetësorë të punësuar në sektorin publik, me orar të plotë ose të pjesërishëm të punës, nuk kanë të drejtë të punojnë në institucionet private të kujdesit shëndetësor.

2. Është rreptësisht e ndaluar që të referohen pacientët nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor tek institucionet private të kujdesit shëndetësor për shkaqe të cilat nuk mund të arsyetohen me argumente mjekësore, pavarësisht nga lista e pritjes.

3. Ndalohet rreptësisht çfarëdo shpërblimi formal ose joformal, financiar ose i llojit tjetër i profesionistit shëndetësor përfshirë shpërblimin për referimin e qytetarit ose banorit nga sektori publik në sektorin privat të shëndetësisë, dhe marrëdhëniet profitabile me industrinë farmaceutike.

4. Shkelësit e dispozitave të këtij neni do të jenë subjekt i dënimeve ose veprimeve ligjore të përcaktuara me këtë ligj dhe aktin e veçantë nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria.

5. Institucionet publike shëndetësore kanë të drejtë që t'ua mundësojnë profesionistëve shëndetësorë të punësuar në to, që të ushtrojnë veprimtari private shëndetësore brenda vet institucionit publik shëndetësor.

6. Veprimtaria private shëndetësore nga paragrafi 5 i këtij neni do të zbatohet në bazë të aktit të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministria".

39. Përkitazi me nenin 41 të kontestuar, parashtruesit pretendojnë "*se neni 41 i Projektligjit për Shëndetësi [...], është në kundërshtim të plotë me konventat evropiane për të drejtat e njeriut që janë drejtpërsëdrejti të aplikueshme në Kosovë (neni 22 i Kushtetutës)".* Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesit nuk i kanë specifikuar konventat.

40. Parashtruesit, më tutje, argumentojnë se, në të njëjtën kohë, Ligji për Shëndetësi shkel nenin 49 të Kushtetutës, i cili thotë:

"Neni 49 i Kushtetutës [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës".

41. Për më tepër, parashtruesit gjithashtu i kontestojnë nenet 18 dhe 19 të Ligjit për Shëndetësi, duke argumentuar se ato dispozita janë në kundërshtim me tekstin e thjeshtë të Ligjit, por gjithashtu edhe me Ligjin për Partneritetin Publiko-Privat.

42. Neni 18 i Ligjit për Shëndetësi, me titull *"Kujdesi parësor shëndetësor"*, thekson si në vijim:

"1. Kujdesi parësor shëndetësor sigurohet në pajtim me politikat, planet, dhe standardet e përcaktuara me aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

2. Kujdesi parësor shëndetësor përfshin:

2.1. Promovimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, mjekimin, dhe rehabilitimin, që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet, përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;

2.2. Mbrojtjen parandaluese nëpërmjet programeve të promovimit të shëndetit dhe vizitave sistematike të fëmijëve dhe të rinjve në shkollat fillore, të mesme, dhe të larta në territorin e Komunës.

2.3. Ruajtjen dhe përparimin e shëndetit publik, përfshirë sero-profilaksinë, vaksino-profilaksinë, dhe kimio-profilaksinë në pajtim me ligjin, si dhe arsimimin dhe edukimin sistematik shëndetësor të popullatës;

2.4. Promovimin e shëndetit oral dhe kujdesit për shëndetin e dhëmbëve;

2.5. Diagnostikimin e hershëm dhe trajtimin e tuberkulozës;

2.6. Organizimin e shërbimeve të urgjencës dhe emergjencës mjekësore si pjesë e sistemit unik të shërbimeve në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor;

2.7. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për nëna dhe fëmijë dhe shërbimet e planifikimit familjar;

2.8. Shërbimet e shëndetit mendor.

3. Komunat janë përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre.

4. Komunat obligohen të zbatojnë me prioritet masat prioritare të promovimit dhe parandalimit në kujdesin shëndetësor.

5. Kujdesi parësor shëndetësor sigurohet dhe zbatohet brenda kornizës së shërbimeve të mjekësisë familjare, në pajtim me aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

6. Përbërja e ekipit të mjekësisë familjare përcaktohet me aktin nënligjor nga paragrafi 1 i këtij neni.

7. Çdo qytetar dhe banor me vështirësi shëndetësore është i obliguar të lajmërohet fillimisht tek mjeku familjar, me përjashtim të rasteve emergjente.

8. Prej çdo qytetari dhe banori do të kërkohet të përcaktohet për një mjek familjar.

9. Çdo qytetar dhe banor ka të drejtë të përzgjedhë mjekun familjar në komunën ku jeton, brenda zonës së përfshirjes të përcaktuar nga komuna, dhe ka të drejtë ta ndërrojë atë.

10. Profesionistët në kujdesin parësor shëndetësor do të bashkëpunojnë me profesionistët shëndetësorë në nivelin dytësor dhe tretësor, në pajtim me këtë ligj.

11. Me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore, institucionet në nivel parësor të kujdesit shëndetësor do të sigurojnë bashkëpunimin ndërsektorial me shërbimet e mirëqenies sociale, me shërbimet edukativo arsimore dhe organet e sigurisë publike, me organizatat e veçanta profesionale, si dhe me organizatat humanitare qeveritare e joqeveritare.

12. Standardet e organizimit dhe funksionimit të shërbimit të mjekësisë familjare, përcaktohen me aktin nën-ligjor nga paragrafi 1 i këtij neni.

13. Me qëllim të mbështetjes së shërbimeve të mjekësisë familjare, Ministria mbikëqyr dhe rregullon shërbimet e integruara të kujdesit parësor shëndetësor, në pajtim me këtë ligj".

43. Neni 19 i Ligjit për Shëndetësi, me titull *"Kujdesi dytësor shëndetësor",* thekson si në vijim:

> *"1. Kujdesi dytësor shëndetësor përfshin: shërbimet spitalore, shërbimet jashtëspitalore: diagnostike, terapeutike, rehabilituese, transportin emergjent, si dhe shërbimet e shëndetësisë publike.*
>
> *2. Organizimi dhe veprimtaria e institucioneve shëndetësore nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohet me akte nënligjore të nxjerra nga Ministria".*

44. Së fundi, parashtruesit kontestojnë nenin 60 të Ligjit për Shëndetësi, i cili, sipas tyre, bie ndesh me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, pasi ai i definon institucionet e kujdesit shëndetësor si institucione jofitimprurëse.

45. Neni 60 i Ligjit për Shëndetësi, me titull "*Financimi i institucioneve të kujdesit shëndetësor",* thekson:

> *"1. Institucionet shëndetësore dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë, të cilët ushtrojnë veprimtari shëndetësore, janë të obliguara, që për çdo pacient të dokumentojnë shpenzimet si edhe llojin, vëllimin, cilësinë dhe çmimin e shërbimeve.*
>
> *2. Institucionet shëndetësore dhe organizatat që marrin fonde publike për zbatimin e kujdesit shëndetësor, janë të detyruara të mbajnë llogaritë dhe evidencat në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe të sigurojnë informata të nevojshme për organet e autorizuara".*

46. Parashtruesit pohojnë më tej se Ligji për Shëndetësi përmban dispozita të cilat i vënë në pozita të pabarabarta punonjësit e kujdesit shëndetësor me punonjësit e institucioneve të tjera publike.

b) Pretendimet e parashtruesve gjatë dëgjimit publik

47. Përfaqësuesi i parashtruesve, në seancë dëgjimore, ngriti çështjen se procedura për miratimin e Ligjit për Shëndetësi nuk është ndjekur gjatë leximit të dytë të Projektligjit. Përfaqësuesi i parashtruesve theksoi se Komisioni për Legjislacion i kishte bërë disa ndryshime në Projektligjin për Shëndetësi, të cilat pretendohet të mos jenë marrë parasysh.

48. Përfaqësuesi i parashtruesve më tutje argumentoi se Ligji i miratuar për Shëndetësi do ta shkatërrojë sistemin publik të shëndetësisë. Ai theksoi se praktika që e paraqet Ligji për Shëndetësi nuk ekziston askund në rajon ose më gjerë.

49. Ai konsideroi se çështja e keqpërdorimit nga disa profesionistë shëndetësorë të punësuar në sektorin publik, të cilët i kishin referuar pacientët në institucionet private shëndetësore në mënyrë që të kenë përfitim personal, duhet të adresohet me masa më kufizuese të ndërmarra nga udhëheqësit.

50. Përfaqësuesi i parashtruesve shtoi gjithashtu se jo të gjithë punonjësit shëndetësorë e kishin keqpërdorur pozitën e tyre, si dhe se ata nuk mund të jenë përgjegjës për problemet në sistemin publik shëndetësor.

51. Sipas tij, ka nevojë për zhvillimin e një monitorimi të duhur dhe të një procedure të vlerësimit. Përfaqësuesi i parashtruesve konsideroi se një strategji e re shëndetësore, që do të prezantojë një sistem të informimit shëndetësor, do t'i korrigjojë keqpërdorimet deri në vitin 2015.

52. Për më tepër, përfaqësuesi i parashtruesve gjithashtu deklaroi se paragrafi 5 i nenit 41 të Ligjit për Shëndetësi, është kontradiktor me vetveten, sepse i lejon punëtorët shëndetësorë, që punojnë në sektorin publik, të bëjnë punë shtesë privatisht, brenda institucionit publik të kujdesit shëndetësor, por në të njëjtën kohë ata nuk lejohen të ushtrojnë praktikë private mjekësore jashtë spitaleve publike. Ai theksoi më tej se nuk është e mundur të zbatohet paragrafi 5 i nenit 41, për shkak të natyrës së institucioneve publike shëndetësore, të cilat punojnë 24 orë në ditë.

53. Përfaqësuesi i parashtruesve nuk i ofroi përgjigje të qartë Gjykatës se çfarë janë duke kontestuar sa i përket paragrafëve 2, 3 dhe 4, të nenit 41, të Ligjit për Shëndetësi.

54. Në vend të kësaj, ai theksoi se neni 41 i Ligjit për Shëndetësi në tërësi është në papajtueshmëri me nenin 49 të Kushtetutës. Përveç kësaj, përfaqësuesi i parashtruesve deklaroi se Ligji i Punës nuk i ndalon punonjësit për të bërë punë shtesë.

55. Sa i përket asaj se pse parashtruesit i konsiderojnë nenet 18, 19 dhe 60 antikushtetues, përfaqësuesi i parashtruesve nuk i ofroi Gjykatës përgjigje të qartë. Ai iu referua çështjeve që kanë të bëjnë me këto nene, që ishin në Projektligjin për Shëndetësi.

Përgjigjja nga Ministria e Shëndetësisë

a) Parashtresa me shkrim

56. Në parashtresën e saj me shkrim, të 24 janarit 2013, MSH-ja i rekomandoi Gjykatës ta refuzojë kërkesën e parashtruesve si të pabazuar, me arsye të përmbledhura si më poshtë.

57. Sa i përket argumentit të parashtruesve se neni 41 i Ligjit për Shëndetësi e cenon nenin 49 të Kushtetutës, MSH-ja deklaroi se *"të drejtat e garantuara me Kushtetutë nuk janë të drejta absolute, dhe mund të kufizohen në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 55 të Kushtetutës"*. (Neni 55, i cituar më poshtë në tekstin e këtij aktgjykimi).

58. MSH-ja konsideroi se neni 41 i Ligjit për Shëndetësi nuk ndërhyn në të drejtat e garantuara me nenin 49 të Kushtetutës, sepse ai nuk e ndalon asnjë mjek të ushtrojë profesionin e tij.

59. Edhe duke supozuar se ka pasur ndërhyrje në të drejtat e garantuara me nenin 49 të Kushtetutës, MSH-ja konsideroi se ndërhyrja e tillë justifikohet me nenin 55 të Kushtetutës.

60. Në përpunimin e testit të proporcionalitetit, MSH-ja theksoi se "*qëllimi legjitim i ndalimit të punësimit të njëkohshëm të profesionistëve të kujdesit shëndetësor në sektorin publik dhe privat është gëzimi i të drejtave të qytetarëve në kujdesin shëndetësor, të parashikuara me nenin 51.1 të Kushtetutës [...]"*.

61. MSH-ja, më tej, argumentoi se "*punësimi i njëkohshëm i profesionistëve të kujdesit shëndetësor në sektorin publik dhe privat është dëshmuar të jetë i dëmshëm për interesin e qytetarëve"*. Kështu, sipas MSH-së, "*qëllimi i detyrimit të zgjedhin në mes të punësimit në sektorin publik dhe privat është të eliminojnë këtë lloj të keqpërdorimit të pozitës së punës në sektorin publik për përfitime personale, duke i referuar pacientët nga sektori publik në atë privat, i cili në vetvete është në kundërshtim me të drejtat e pacientëve për të zgjedhur në mes të shërbimeve publike dhe private të kujdesit shëndetësor"*.

62. Për sa i përket nevojës, MSH-ja, *inter alia,* argumentoi se "*qytetari nuk mund të presë derisa një mjek ta përfundojë orarin e punës së tij/saj në sektorin publik dhe vetëm pastaj t'i shfrytëzojë shërbimet e tij/saj si një mjek në sektorin privat"*. MSH-ja, më tej, shtoi se, pasi shërbimi shëndetësor është kryesisht në interes publik, kujdesi shëndetësor për qytetarët, si një vlerë normative në nivel kushtetues, në mënyrë

normative gëzon epërsi ndaj lirisë së një profesionisti të kujdesit shëndetësor për të marrë përfitim material dhe të ushtrojë profesionin e tij/saj.

63. MSH-ja tutje shtoi se kufizimi në fjalë nuk është absolut, pasi neni 41.5 i Ligjit për Shëndetësi do t'i lejojë profesionistët e kujdesit shëndetësor të punësuar të ushtrojnë kujdes shëndetësor privat. MSH-ja argumentoi se "*kjo ka për qëllim eliminimin e shfaqjes së kthimit nga klinikat private me qëllim të përfitimit të përfitimit materiale*".

64. Prandaj, MSH-ja konsideroi se, nëse Gjykata gjen se neni 41 i Ligjit për Shëndetësi ndërhyn në nenin 49 të Kushtetutës, kjo ndërhyrje arsyetohet në pajtim me nenin 55 të Kushtetutës.

65. MSH-ja, më tej, kundërshtoi argumentin e parashtruesve se Ligji për Shëndetësi përmban dispozita që vënë profesionistët e kujdesit shëndetësor në pozitë të pabarabartë *vis-à-vis* punonjësve në institucione të tjera publike.

66. Për më tepër, MSH-ja kundërshtoi argumentet e parashtruesve se nenet 18, 19 dhe 60 janë në konflikt me legjislacionin në fuqi. MSH-ja, në veçanti, theksoi se detyra e Gjykatës është të bëjë vlerësimin kushtetues të çdo ligji, por jo vlerësimin e ligjit që është në konflikt me ligjet që janë në fuqi.

b) Përgjigjja në seancë dëgjimore

67. Sa i përket pretendimeve të parashtruesve përkitazi me nenet 18, 19 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, ministri i MSH-së deklaroi se kundërshtimet e parashtruesve kanë të bëjnë me tekstet e mëparshme të këtyre neneve, që kishin ekzistuar në Projektligj, por përmbajtja e atyre neneve është ndryshuar nga Komisioni Funksional dhe Kuvendi e aprovoi versionin e ndryshuar të neneve 18, 19 dhe 60. Në kundërshtim me pretendimet e parashtruesve, askund në tekstin e aprovuar të Ligjit për Shëndetësi, nuk janë përdorur termat, siç janë: "Organizatat Publike Jofitimprurëse", ose "Këshilli Udhëheqës".

68. Sa i përket nenit 41 të Ligjit për Shëndetësi, ministri i Shëndetësisë theksoi se, derisa ndalimi i praktikës së dyfishtë mjekësore mund të duket i ashpër, nuk kishte asnjë mundësi tjetër për ta parandaluar konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrimin e profesionit mjekësor.

69. Në përgjigje të Gjykatës për masat e tjera që janë marrë parasysh për të parandaluar konfliktin e mundshëm të interesit, ministri i MSH-së theksoi se, për shkak të buxhetit të kufizuar dhe për shkak të mungesës së mekanizmit monitorues të përshtatshëm për parandalimin e praktikës mjekësore të dyfishtë, përshkruar në nenin 41.1 të Ligjit, ndalimi i ushtrimit të dyfishtë të profesionit ishte opsioni i vetëm për të shmangur humbjen financiare nga qytetarët. Ai shtoi se masat e tilla të tjera, siç janë masat disiplinore për ata që keqpërdorin profesionin, janë joadekuate për shkak të mungesës së inspektorëve mjekësorë, pasi në gjithë vendin ka vetëm 12 inspektorë.

70. Ministri i Shëndetësisë përsëriti se neni 41 i Ligjit për Shëndetësi nuk e shkel Kushtetutën, sepse nuk ia kufizon personit të drejtën të punojë, por vetëm ka për qëllim t'i rregullojë marrëdhëniet e punës brenda sektorit publik të përkujdesjes shëndetësore. Edhe nëse ky nen mund të shihet si një kufizim i të drejtës për punë, ky kufizim është në pajtim me nenin 55 të Kushtetutës.

71. Sa i përket paragrafit 5, të nenit 41, të Ligjit për Shëndetësi, ministri i Shëndetësisë deklaroi se praktika e njëjtë përdoret në Mbretërinë e Bashkuar dhe Ministria e Shëndetësisë ka vlerësuar se është shumë më lehtë të kontrollohen punëtorët shëndetësorë që punojnë në sektorin e përkujdesjes publike shëndetësore, edhe nëse do të kishin punuar privatisht brenda.

72. Sa i përket pretendimeve të parashtruesve se nuk është ndjekur procedura për miratimin e Ligjit, ministri i Shëndetësisë theksoi se parashtruesit nuk e kanë ngritur këtë çështje në kërkesën e tyre. Pavarësisht kësaj, ai theksoi se të gjitha rekomandimet e Komisionit për Legjislacion janë shqyrtuar dhe janë miratuar nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, para leximit të dytë në Kuvend.

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë e Kosovës

a) Parashtresa me shkrim

73. Në parashtresën e tyre me shkrim, të 24 janarit 2013, Federata e Sindikatave të Shëndetësisë e Kosovës theksoi, ndër të tjera, se procesi që i ka paraprirë miratimit të Ligjit për Shëndetësi nuk ka qenë transparent.

74. Federata e Sindikatave të Shëndetësisë e Kosovës theksoi, më tej, se miratimi i Ligjit për Sigurim Shëndetësor është më i rëndësishëm, pasi Kosova ka Ligjin për Shëndetësi që nga viti 2004.

75. Federata e Sindikatave të Shëndetësisë e Kosovës theksoi se ata morën parasysh përvojën nga rajoni, sa i përket praktikës së dyfishtë mjekësore, dhe se ata kishin bërë disa propozime për ndryshime në Projektligjin për Shëndetësi (duke përfshirë dispozitat e kontestuara të neneve 18, 19, 41 dhe 60).

76. Federata e Sindikatave të Shëndetësisë e Kosovës i kishte dorëzuar Presidentit dhe Avokatit të Popullit një peticion me 6.000 nënshkrime kundër Projektligjit për Shëndetësi. Federata e Sindikatave të Shëndetësisë e Kosovës u kishte dorëzuar, gjithashtu, letra 120 deputetëve të Kuvendit të Kosovës, duke i informuar ata për kundërshtimet e tyre ndaj Projektligjit.

77. Federata e Sindikatave të Shëndetësisë e Kosovës, gjithashtu, përmendi se Ligji për Shëndetësi hap mundësinë e privatizimit të institucioneve publike shëndetësore.

78. Sipas FSSHK-së, Ligji për Shëndetësi hap mundësinë për paraqitjen e korrupsionit brenda institucioneve të shëndetit publik. Në të njëjtën kohë, ai dëmton politikat shtetërore shëndetësore, duke shkaktuar ikjen e ekspertëve nga institucionet publike shëndetësore në institucionet private të kujdesit shëndetësor. Ata, gjithashtu, theksuan se Ligji shkel të drejtat e punëtorëve shëndetësorë, duke lënë të kuptohet se ata shkaktuan dështimin e sistemit shëndetësor publik.

b) Argumentet e prezantuara gjatë seancës dëgjimore

79. Përfaqësuesi i FSSHK-së, gjatë seancës dëgjimore, deklaroi se vendet në rajon nuk e ndalojnë punën shtesë në sektorin privat dhe se Ligji i Punës i Kosovës nuk e parashikon një ndalim të tillë.

80. Përfaqësuesi i FSSHK-së, gjithashtu, deklaroi se ky ligj do të krijojë më shumë shpenzime për popullatën e përgjithshme dhe do të pengojë qasjen në sektorin publik shëndetësor.

81. Se a është përfshirë FSSHK-ja në procedurën e miratimit të Ligjit për Shëndetësi, përfaqësuesi i tyre deklaroi se ata ishin ftuar vetëm një herë publikisht të konsultoheshin në Kuvend dhe se ata kanë shprehur edhe shqetësimet e tyre nëpërmjet protestave dhe parashtresave me shkrim, dorëzuar në institucione të ndryshme.

Kuvendi i Republikës së Kosovës

82. Përfaqësuesi i Kuvendit deklaroi se Ligji për Shëndetësi është miratuar në përputhje me procedurat e kërkuara me Kushtetutë dhe me Rregullore të punës së Kuvendit.

83. Megjithatë, përfaqësuesi i Kuvendit nuk i ofroi Gjykatës një përgjigje nëse Kuvendi mori parasysh ndonjë masë tjetër që do të parandalonte konfliktin e pretenduar të interesit në ushtrimin e praktikës mjekësore, e as nëse Kuvendi kishte marrë parasysh se si e kishin rregulluar këtë çështje shtetet në rajon.

84. Përfaqësuesi i Kuvendit deklaroi se ai është i autorizuar nga Kuvendi për t'iu përgjigjur pyetjes që ka të bëjë me procedurën e ndjekur nga Kuvendi dhe përkitazi me përmbajtjen e Ligjit. Në çdo rast, pasi 90% të dispozitave të propozuara nga Qeveria (respektivisht nga MSH-ja) u miratuan pa asnjë ndryshim, pyetjet, që lidhen me masat alternative në adresimin e konfliktit të interesit dhe/ose çështjen e praktikave rajonale, duhet të marrin përgjigje nga MSH-ja dhe nga Qeveria, e jo nga Kuvendi.

Avokati i Popullit

85. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, gjatë seancës, deklaroi se Avokati i Popullit nuk ka gjetur shkelje të Kushtetutës në nenet e kontestuara të Ligjit për Shëndetësi. Arsyeja për këtë është se ata kanë pranuar disa ankesa nga qytetarët përkitazi me keqpërdorimin e pozitës, kur punonjësit shëndetësorë i kanë referuar qytetarët nga institucioni publik i kujdesit shëndetësor në sektorin privat të kujdesit shëndetësor. Megjithatë, ai deklaroi se Avokati i Popullit mirëpret ligjin që rregullon keqpërdorimet e tanishme.

86. Se a ka pranuar Avokati i Popullit ndonjë kërkesë për kontestimin e Ligjit për Shëndetësi, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, gjatë seancës, deklaroi gojarisht se ata kanë marrë një kërkesë nga FSSHK-ja për të kontestuar Ligjin për Shëndetësi në Gjykatë, por, megjithatë, Avokati i Popullit nuk konsideron se ka shkelje të Kushtetutës në ligjin në fjalë.

<u>Historiku përkatës</u>

87. Në Kosovë, para aprovimit të Ligjit për Shëndetësi, në dhjetor të vitit 2012, ishte në fuqi Ligji për Shëndetësi i Kosovës, Nr. 2004/4.

88. Neni 96 i Ligjit për Shëndetësi parashikonte se punëtorët shëndetësorë mund të punojnë në mënyrë të pavarur në një nga institucionet e licencuara të kujdesit shëndetësor nëse janë anëtarë të Këshillit të

Përgjithshëm Shëndetësor dhe nëse janë licencuar për aktivitetin e caktuar shëndetësor.

89. Është e vlefshme të kujtohet neni 98, me titull *"Kujdesi Privat Shëndetësor"*, i cili thotë si në vijim:

Neni 98

"98.1. Punëtori shëndetësor nga neni 96 mund të jetë themelues i vetëm një institucioni privat shëndetësor.

98.2. Punëtori shëndetësor nga neni 86 i punësuar në orar të plotë të punës në institucionin publik shëndetësor mund të zbatojë veprimtari private në kujdesin shëndetësor, vetëm pas orarit të rregullt të punës.

98.3. Institucioni publik shëndetësor, pas përfundimit të orarit të rregullt të punës, me qëllim zbatimi të veprimtarisë private në kujdesin shëndetësor, mund të japë me qera hapësirat dhe pajisjet e tij, në pajtim me aktin nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë".

90. Gjatë procedurës në Gjykatë, në disa raste, është përmendur praktika e vendeve në rajon.

91. Gjykata vëren se, në entitetin e Bosnje dhe Hercegovinës, Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, në bazë të autorizimit të dhënë nga Ligji për Shëndetësi (Gazeta Zyrtare 46/10), ministri i Shëndetësisë nxori "Rregullore për metodën, procedurat dhe kushtet e organizimit të punës shtesë të punonjësve të kujdesit shëndetësor në institucionin shëndetësor ose institucionet private" dhe kjo rregullore u botua në Gazetën Zyrtare të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, nr. 60, më 13 korrik 2012.

92. Kjo rregullore, në nenin 2, parashikon që punonjësi shëndetësor mund të kryejë punë shtesë në rast se ai ka titullin e specialistit dhe, të paktën, 10 vjet përvojë si specialist në këtë fushë. Punëtorët shëndetësorë, të përcaktuar me nenin 2 të Rregullores, mund të kryejnë punë shtesë në institucionin shëndetësor ku ata janë të punësuar, në një institucion tjetër shëndetësor në çdo formë të pronësisë, ose me një tjetër punonjës shëndetësor të specializimit të njëjtë, i cili kryen veprimtari të regjistruar private të kujdesit shëndetësor.

93. Në Republikën e Kroacisë, në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Shëndetësore të Kroacisë (Gazeta Zyrtare, 150/08, 71/10, 139/10), ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të Republikës së

Kroacisë publikoi "Rregullore mbi kushtet e lëshimit të lejes për punëtorët shëndetësorë për të ushtruar punë shtesë".

94. Sipas kësaj rregulloreje, në nenin 2, është paraparë që kjo leje mund të lëshohet vetëm për ata punonjës që kanë titullin e specialistit dhe vetëm në institucionet shëndetësore që kanë kontrata me institucionet e sigurimit shëndetësor. Kjo leje mund të lëshohet në maksimum për gjysmën e profesionistëve të kujdesit shëndetësor të së njëjtës veprimtari.

95. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kroacisë, me vendimet e saj (Nr. U-II-787/1994, U-II-290/1995 dhe U-II-120/1998, të 17 marsit 2000), e kishte adresuar çështjen e trajtimit të pabarabartë të profesionistëve shëndetësorë të specializimeve të njëjta, bazuar në nivel të arsimit në ushtrimin e të drejtës për të kryer punë shtesë në institucionet private shëndetësore. Gjykata konstatoi shkelje të nenit 54 të Kushtetutës së Kroacisë, që garanton të drejtën për punë dhe lirinë në punësim.

96. Ligji për Shëndetësi i Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 43/12, e 23 marsit 2012), në nenin 222, përcakton kushtet dhe kriteret për punë shtesë të punonjësve të kujdesit shëndetësor: *"Punonjësit e kujdesit shëndetësor-specialistë të punësuar në institucion shëndetësor për të kryer veprimtarinë e konsultimeve-specialistike shëndetësore, mund të ofrojnë shërbime shëndetësore si punë shtesë në maksimum prej 8 orësh në javë, pas përfundimit të orarit të rregullt të punës në përputhje me licencën e punës së institucionit ku ai është i punësuar ose në institucione të tjera shëndetësore që janë të regjistruara për të njëjtën veprimtari".*

97. Nuk është çështje e Gjykatës të shqyrtojë përshtatshmërinë e ndonjë praktike, apo të mekanizmave rregullatorë, në adresimin e çështjes së praktikës së dyfishtë në sektorin e shëndetësisë. Ndërsa, hulumtimi i thjeshtë tregon se ka shumë shembuj të praktikave të mira në rregullimin e çështjes së praktikës së dyfishtë mjekësore në vendet me zhvillim të ulët, të mesëm dhe në vendet e zhvilluara. Por, kjo çështje është jashtë sferës së juridiksionit të Gjykatës.

Pranueshmëria e kërkesës

98. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi ka përmbushur kriteret e parapara për pranueshmëri, me Kushtetutën e Kosovës dhe të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës të Gjykatës.

99. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese i referohet nenit 113.1 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, ku përcaktohet*: "Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".*

100. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 113.5 të Kushtetutës, i cili shprehimisht parasheh: "*Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur*".

101. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa është dorëzuar nga 12 deputetë të Kuvendit, që kërkojnë vlerësimin e pajtueshmërisë së Ligjit për Shëndetësi me Kushtetutën, vetëm në thelbin e saj.

102. Gjykata vëren se, parashtruesit, në kërkesën e tyre, nuk kanë ngritur asnjë argument për shkeljen e pretenduar në procedurën e miratimit të Ligjit. Gjithashtu, përfaqësuesi i parashtruesve kishte dështuar në mbështetjen e argumenteve të tyre përkitazi me shkeljen e pretenduar të procedurës gjatë dëgjimit publik të mbajtur në Gjykatë.

103. Gjykata gjithashtu vëren se, bazuar në dokumentet e dorëzuara, Ligji për Shëndetësi është miratuar në Kuvend më 13 dhjetor 2012 dhe kërkesa në Gjykatë është paraqitur më 20 dhjetor 2012. Prandaj, kërkesa është paraqitur brenda afatit të paparë me Kushtetutë.

104. Pasi parashtruesit janë palë e autorizuar, kanë respektuar afatin e nevojshëm për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, si dhe kanë përshkruar saktë shkeljen e pretenduar të Kushtetutës, duke përfshirë ligjin e kontestuar të Kuvendit, Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesve është në pajtueshmëri me kriteret e pranueshmërisë.

105. Kjo do të thotë se Gjykata është në gjendje të shqyrtojë meritat e ankesës së përcaktuar në kërkesë. Shtrirja e meritave do të jetë e kufizuar në kompetencat sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, respektivisht për të vendosur nëse nenet e kontestuara të Ligjit, të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, janë kushtetuese.

Vlerësimi kushtetues i kërkesës

106. Gjatë vlerësimit të kësaj kërkese, Gjykata duhet të ketë parasysh se, në përgjithësi, i tërë legjislacioni supozohet të jetë kushtetues, derisa të

provohet e kundërta. Mandati i Gjykatës është vetëm shqyrtimi i kushtetutshmërisë së një vendimi, ose të një akti legjislativ, dhe jo shqyrtimi i ligjshmërisë së tij, ose nëse ai është mbështetur nga politika e mirë publike.

107. Për të vlerësuar nëse një ligj shkel Kushtetutën, Gjykata duhet t'i marrë parasysh këto dispozita të Kushtetutës:

a. Neni 16 [Epërsia e Kushtetutës] i Kushtetutës

"1. Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.

2. Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.

3. Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare.

4. Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës".

b. Neni 4.2 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] i Kushtetutës

"*Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ".*

c. Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit] i Kushtetutës

"Kuvendi i Republikës së Kosovës:
(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme"...

d. Neni 74 [Ushtrimi i Funksionit] i Kushtetutës

"*Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit".*

I. Për nenet 18, 19 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi

108. Parashtruesit theksojnë se, dispozitat e kontestuara të neneve 18 dhe 19, janë në kundërshtim me tekstin e thjeshtë të Ligjit për Shëndetësi dhe me Ligjin për Partneritetin Publiko-Privat.

109. MSH-ja i kundërshtoi argumentet e parashtruesve. MSH-ja theksoi në veçanti se detyrë e Gjykatës është të shqyrtojë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji, por jo konfliktin e ligjeve që janë në fuqi.

110. Gjykata vëren se parashtruesit nuk kanë përpunuar asnjë argument se pse ata konsiderojnë që këto dispozita nuk janë në përputhje me Kushtetutën.

111. Për më tepër, parashtruesit, në parashtresën e tyre me shkrim dhe me gojë, nuk kanë përmendur ose nuk kanë lënë të nënkuptohet se cila dispozitë kushtetuese nuk është respektuar me miratimin e neneve 18 dhe 19 të Ligjit për Shëndetësi.

112. Përkitazi me papajtueshmërinë e pretenduar të nenit 60 të Ligjit për Shëndetësi me Kushtetutën, Gjykata vëren se argumenti kryesor i parashtruesve ishte që kjo dispozitë është në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.

113. MSH-ja i kundërshtoi argumentet e parashtruesve në nenin 60 të Ligjit. Ministri argumentoi në seancë se kundërshtimet e parashtruesve lidhen me tekstin e mëparshëm të neneve të kontestuara që ekzistonin në Projektligj, por përmbajtja e këtyre neneve është ndryshuar nga Komisioni Funksional dhe Kuvendi e miratoi versionin e ndryshuar të neneve 18, 19 dhe 60. Ministri i MSH-së, gjithashtu, argumentoi se askund në tekstin e miratuar të Ligjit për Shëndetësi nuk janë përdorur nocionet, si: "Organizatat Jofitimprurëse Publike", ose "Këshilli Udhëheqës".

114. Në përgjithësi, duke marrë parasysh argumentet e paraqitura nga palët në procedurë dhe pas shqyrtimit të dispozitave të kontestuara të nenit 18 dhe 19 *vis-à-vis* këtyre argumenteve, Gjykata gjeti se parashtruesit nuk e kanë mbështetur pretendimin e tyre mbi papajtueshmërinë e pretenduar të neneve 18 dhe 19 me Kushtetutë.

115. Duke analizuar nenet 18 dhe 19 të Ligjit për Shëndetësi, Gjykata nuk ka gjetur asgjë që do të nënkuptonte se ka cenim të Kushtetutës.

116. Sa i përket nenit 60 të Ligjit për Shëndetësi, Gjykata vëren, pasi ka mbajtur dëgjimin publik, se pretendimet e ngritura nga parashtruesit janë të bazuara në tekstin e nenit 60 të Projektligjit që rrjedhimisht u ndryshua. Prandaj, Gjykata konstaton se nuk janë relevante argumentet e parashtruesve sa i përket papajtueshmërisë së pretenduar të nenit 60 të Kushtetutës.

117. Nga sa u tha më lart, Gjykata gjen se nenet 18, 19 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, të miratuar nga Kuvendi më 13 dhjetor 2012, janë në pajtueshmëri me Kushtetutën.

II. Sa i përket nenit 41 të Ligjit për Shëndetësi

Në përgjithësi

118. Në fillim, Gjykata vëren se përfaqësuesi i parashtruesve argumentoi në përgjithësi që neni 41 i Ligjit për Shëndetësi është në kundërshtim me instrumentet ndërkombëtare që, sipas nenit 22 të Kushtetutës, janë drejtpërdrejt të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe, në rast të konfliktit, kanë prioritet në krahasim me dispozitat e ligjeve dhe të akteve të tjera të institucioneve publike.

119. Përderisa parashtruesit nuk i referohen ndonjë marrëveshjeje të veçantë dhe ndonjë instrumenti, Gjykata vëren se neni 23 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut thekson, me sa vijon:

Neni 23

1. *Secili ka të drejtë të punojë, të zgjedhë lirisht punën, të ketë kushte të kënaqshme dhe të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia.*

2. *Secili, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë rrogë të barabartë.*

3. *Secili që punon ka të drejtë për një shpërblim të drejtë dhe të favorshëm, në mënyrë që t'i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe që, po qe se është e nevojshme, do të plotësohet me mjete të tjera të mbrojtjes sociale.*

4. *Secili ka të drejtë të formojë e t'u bashkohet sindikatave për mbrojtjen e interesave të tij.*

120. Sipas mendimit të Gjykatës, përderisa e drejta për punë është e garantuar me të drejtën ndërkombëtare, ajo nuk duhet të kuptohet si një e drejtë absolute dhe e pakushtëzuar për të fituar punë. Megjithatë, ekziston një supozim i fortë se masat e marra regresive, sa i përket të drejtës për të punuar, nuk janë të lejueshme.

121. Për më tepër, përderisa Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) nuk e mbron në mënyrë eksplicite të drejtën

për të punuar, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbron aspekte të caktuara të kësaj të drejte, përfshirë edhe raste të veçanta të së drejtës së pronës, siç garantohet nga neni 1, i Protokollit 1, i KEDNJ-së.

122. Gjykata, gjatë vlerësimit të përputhshmërisë së nenit 41 të kontestuar të Ligjit për Shëndetësi me Kushtetutën, do t'i marrë parasysh dispozitat e instrumenteve ndërkombëtare.

123. Siç u përmend më herët, parashtruesit theksojnë më tej se neni 41 i Ligjit për Shëndetësi nuk është në papajtueshmëri me nenin 49 të Kushtetutës.

124. MSH-ja thekson se neni 49 i Kushtetutës nuk është një e drejtë absolute dhe që mund të kufizohet në pajtim me kufizimet e përcaktuara në nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.

125. Në këtë aspekt, Gjykata pajtohet me këtë argument të MSH-së.

126. Në këtë drejtim, Gjykata e sheh të nevojshme të merret parasysh shkelja e pretenduar e nenit 49 të Kushtetutës që ka të bëjë me kufizimet e përcaktuara në nenin 55 të Kushtetutës.

Vlerësimi i shkeljes së pretenduar të nenit 49 të Kushtetutës përkitazi me nenin 55 të Kushtetutës:

127. Gjykata vëren se, kur një ligj, si në këtë rast Ligji për Shëndetësi, i kufizon të drejtat kushtetuese, siç është këtu e drejta e garantuar me nenin 49, një kufizim i tillë është kushtetues, në qoftë se ai është proporcional. Testi i proporcionalitetit është përshkruar në nenin 55 të Kushtetutës.

128. Neni 55 i Kushtetutës është i dyfishtë: ai ofron arsyetim për kufizimin e të drejtave kushtetuese, por në të njëjtën kohë ofron edhe kufijtë e kufizimit të tillë.

129. Neni 55 i Kushtetutës thotë:

Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]

"1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.

2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.

3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.

4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar".

130. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vëren se kufizimi i pretenduar për të drejtën për punë është përfshirë në një ligj të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, i cili është institucion shtetëror i veshur me pushtet legjislativ nga Kushtetuta. Si i tillë, kufizimi përputhet me kërkesën që kufizimi është dhënë nga ligji, siç përshkruhet në paragrafin 1 të nenit 55.

131. Sipas paragrafit 2, të nenit 55, kufizimet mund të vendosen mbi të drejtat e parashikuara nga neni 49 i Kushtetutës, por vetëm "*[...] në masën e nevojshme për përmbushjen e qëllimit të kufizimit në një shoqëri të hapur demokratike".*

132. Nocioni i termit "*e nevojshme [...] në një shoqëri të hapur dhe demokratike",* duhet të lexohet në lidhje me kërkesat specifike të dhëna në paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 55. Secilës nga këto kërkesa duhet t'i rishikohet ana tjetër. Kërkesat janë të renditura si më poshtë:

a. Thelbi i së drejtës kushtetuese;

b. Rëndësia e qëllimit të kufizimit;

c. Natyra dhe shkalla e kufizimit;

d. Lidhja ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që duhet të arrihet; dhe
e. Mundësia e arritjes së atij qëllimi me kufizim më të vogël.

Sa i përket esencës së të drejtës kushtetuese

133. Gjykata rikujton se neni 49 i Kushtetutës thotë:

Neni 49 i Kushtetutës [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

"1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës".

134. Kjo dispozitë duhet të lexohet në lidhje me instrumentet ndërkombëtare të
zbatueshme në Kosovë.

135. Është e qartë nga teksti i paragrafit 2, të nenit 49, se Kushtetuta garanton edhe lirinë për të zgjedhur punën, edhe lirinë për të zgjedhur profesionin.

136. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se neni 41.1 i Ligjit për Shëndetësi nuk vendos asnjë kufizim ndaj profesionistëve të shëndetit publik për të zgjedhur profesionin.

137. Ata që janë bërë profesionistë shëndetësorë e kanë bërë zgjedhjen e tyre në momentin kur janë regjistruar në Universitet dhe në institucione të tjera arsimore.

138. Megjithatë, kur shteti vendosi të ndalonte punën shtesë të profesionistëve publikë shëndetësorë në sektorin privat (përfshirë edhe ata që kanë një kontratë me orar të shkurtër), atëherë është e nevojshme të merret parasysh nëse ka pasur një ndërhyrje në lirinë për të ushtruar dhe në lirinë për të zgjedhur profesionin/vendin e punës, siç garantohet me nenin 49.2 të Kushtetutës.

139. Kjo është edhe më tepër relevante nëse, në rastin konkret, një kufizim i tillë nuk është paraparë në legjislacionin e mëhershëm, që ishte në fuqi për më shumë se tetë vjet.

Sa i përket qëllimit të kufizimit

140. Neni 41 i Ligjit është emërtuar në mënyrë specifike në Ligj me qëllim të "*parandalimit të konfliktit të interesit*". Qëllimi i Ligjit për Shëndetësi, si i tërë, është i përcaktuar në nenin 1 të tij, i cili thotë:

"*Ky ligj ka për qëllim sigurimin e bazës ligjore për rregullimin dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese, dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor*".

141. Siç u përmend më herët në bazë të MSH-së, "*punësimi i njëkohshëm i profesionistëve të kujdesit shëndetësor në sektorin publik dhe privat është dëshmuar të jetë i dëmshëm për interesin e qytetarëve*". Kështu, sipas MSH-së, "*qëllimi i detyrimit të zgjedhjes së punësimit midis sektorit publik dhe privat është që të eliminohet ky lloj i keqpërdorimit të pozitës së punës në sektorin publik për përfitime personale, duke i referuar pacientët nga sektori publik në sektorin privat, i cili në vetvete është në kundërshtim me të drejtat e pacientëve për të zgjedhur mes të shërbimeve të sektorit publik dhe privat të kujdesit shëndetësor*".

142. Gjykata vëren se përfaqësuesi i parashtruesve nuk e ka kontestuar legjitimitetin e kufizimit, por theksoi se qëllimi ishte në gjendje të arrihej me masa të pak të rrepta.

143. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se, edhe pse qëllimi i kufizimit të përcaktuar me nenin 41 të Ligjit synon ndalimin e interesit të konflikt në mbrojtjen e fushës shëndetësore, ky përkufizim shërben në qëllimin e përgjithshëm të legjislacionit, duke synuar mbrojtjen e një interesi të rëndësishëm publik, përkatësisht duke siguruar një shërbim gjithëpërfshirës dhe një shëndetësi kualitative në sektorin publik.

Sa i përket natyrës dhe shkallës së kufizimit

144. Neni 41 i Ligjit për Shëndetësi titullohet "*Parandalimi i konfliktit të interesit*". Paragrafët 1, 5 dhe 6 të këtij neni thonë:

"1. Profesionistët shëndetësorë të punësuar në sektorin publik, me orar të plotë ose të pjesërishëm të punës, nuk kanë të drejtë të punojnë në institucionet private të kujdesit shëndetësor.

[...]

5. Institucionet publike shëndetësore kanë të drejtë që t'ua mundësojnë profesionistëve shëndetësorë të punësuar në to, që të ushtrojnë veprimtari private shëndetësore brenda vetë institucionit publik shëndetësor.

6. Veprimtaria private shëndetësore nga paragrafi 5 i këtij neni do të zbatohet në bazë të aktit të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministria".

145. Në përmbledhje, neni 41.1 i ndalon të gjithë profesionistët e kujdesit shëndetësor, të punësuar në sektorin publik shëndetësor, nga ndonjë punësim dhe nga të gjitha punësimet në ndonjë institucion të kujdesit shëndetësor privat. Kjo vlen nëse profesionisti i kujdesit shëndetësor është i punësuar me orar të plotë, ose të pjesshëm, në sektorin publik shëndetësor.

146. Nga ana tjetër, neni 41.5 i lejon profesionistët e kujdesit shëndetësor, që punojnë në sektorin e kujdesit shëndetësor publik, të ushtrojnë veprimtari private shëndetësore në institucionin e kujdesit shëndetësor publik, në pajtim me autorizimin paraprak nga udhëheqësi i institucionit publik. Çështja se kur dhe si mund të jepen autorizimet e tilla, duhet të rregullohet edhe më tej me akte nënligjore që do të nxirren nga MSH-ja.

147. Gjykata vëren më tej se, ndalimet e parashikuara në nenin 41.1, kufizojnë ashpër mundësitë për profesionistët e kujdesit shëndetësor, që punojnë në sektorin publik shëndetësor, për të plotësuar të ardhurat e tyre nëpërmjet punësimit ose lidhjes me ndonjë institucion privat të kujdesit shëndetësor, apo me ndonjë biznes.

148. Përderisa ata mund të autorizohen për të kryer veprimtari private shëndetësore në sektorin e kujdesit shëndetësor publik, mënyra dhe masa në të cilën mund të autorizohet kjo, nuk është përcaktuar ende me ligj.

149. Gjykata rikujton se, përderisa dispozita e mëhershme e nenit 98.2 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 2004/4, të vitit 2004, ka lejuar mundësinë që institucioni publik shëndetësor t'ia japë me qira objektet dhe pajisjet e veta për përdorim pas orarit të rregullt të punës çdo institucioni privat shëndetësor, kjo nuk është më kështu.

150. Si e tillë, Gjykata konstaton se natyra dhe shkalla e kufizimit, e përcaktuar me nenin 41, është që rrënjësisht të kufizojë ushtrimin e

profesionit të kujdesit shëndetësor të profesionistit, qoftë në sektorin publik ose në sektorin privat.

151. Gjykata është e mendimit se natyra dhe shkalla e kufizimit kufizojnë në mënyrë të ashpër të drejtat e profesionistëve shëndetësorë, që ata kanë pasur.

152. Mundësia e krijuar nga neni 41, për të qenë i autorizuar të ushtrojë veprimtari private shëndetësore brenda një institucioni publik shëndetësor, ende nuk është definuar, por nuk duket se do të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme natyrën dhe shkallën e këtij kufizimi.

Sa i përket raportit ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet

153. Natyra e kufizimeve të të drejtave dhe lirive themelore, siç janë të përcaktuara me nenin 55 të Kushtetutës, është e krahasueshme me natyrën e kufizimeve të të drejtave të parashikuara në nenet 8-11 të KEDNJ-së.

154. Për më tepër, Gjykata Evropiane ka deklaruar se "*[...] është e qenësishme në tërë Konventën një kërkim për një ekuilibër të drejtë ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të individit*" (*Shih, Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 14038/88, 7 korrik 1989, paragrafi 89*).

155. Edhe pse e drejta për punë nuk është një e drejtë e mbrojtur sipas KEDNJ-së, testi i "*domosdoshmërisë në një shoqëri demokratike*" mund të kuptohet në mënyrë analoge me këtë test si kryhet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Parimet e përgjithshme që duhet të zbatohen për nocionin e "*domosdoshmërisë në një shoqëri demokratike*" dhe natyra e "*ekuilibrit të drejtë*" duhet të arrihet ndërmjet interesit të përgjithshëm dhe të drejtave individuale, thuhet në vendimin e Gjykatës Evropiane në rastin Silver dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (Kërkesat nr. 5947/72, nr. 6205/73, nr. 7052/75, nr. 7061/75, nr. 7107/75, nr. 7113/75, nr. 7136/75, e 25 marsit 1983, paragrafi 97):

"*97. Në një numër rastesh, Gjykata e ka deklaruar kuptimin e saj të frazës 'e nevojshme në një shoqëri demokratike', natyrën e funksioneve të saj në shqyrtimin e çështjeve të kthyera në atë frazë dhe mënyrën në të cilën ajo do të kryejë këto funksione. Mjafton këtu të përmblidhen disa parime të caktuara:*

(a) mbiemri 'e nevojshme' nuk është sinonim me 'domosdoshme', as nuk e ka fleksibilitetin e shprehjeve të tilla si 'të pranueshme', 'të zakonshme', 'të dobishme', 'të arsyeshme' ose 'të dëshirueshme' (Shih aktgjykimin e Handyside, 7 dhjetor 1976, Seria A nr 24, fq. 22, § 48);

(b) Shtetet kontraktuese gëzojnë një margjinë të caktuar, por jo të pakufizuar të vlerësimit në çështjen e vendosjes së kufizimeve, por Gjykata e jep vendimin përfundimtar nëse ato janë në përputhje me Konventën (ibid., fq. 23, § 49);

(c) fraza 'e nevojshme në një shoqëri demokratike' do të thotë se, të jetë në përputhje me Konventën, ndërhyrja duhet, inter alia, të korrespondojë me një 'nevojë të ngutshme sociale' dhe të jetë 'në përpjesëtim me qëllimin legjitim të ndjekur' (ibid., fq. 22-23, § § 48-49);

(d) ata paragrafë të neneve të Konventës që parashikojnë një përjashtim për një të drejtë të garantuar duhet të interpretohen ngushtë (Shih aktgjykimin e lartpërmendur, Klass dhe të tjerë, Akgjykimi Seria A, nr. 28, fq. 21, § 42)".

156. Për sa i përket asaj se a është i domosdoshëm kufizimi, Gjykata vëren se MSH-ja e kishte argumentuar në parashtresën e vet me shkrim se "*qytetari nuk mund të presë derisa një mjek të përfundojë orarin e tij/saj të punës në sektorin publik dhe pastaj të shfrytëzojë shërbimet e tij/saj si një mjek në sektorin privat*".

157. Parimi që duhet të aplikohet në interpretimin e kuptimit "*e nevojshme në një shoqëri demokratike*" është se kufizimi i një të drejte themelore duhet të korrespondojë me një "*nevojë të ngutshme sociale*" dhe se kufizimi duhet të jetë "*në përpjesëtim me qëllimin legjitim të ndjekur*".

158. Në aplikimin e këtyre parimeve të përgjithshme të kërkesës, Gjykata duhet të përcaktojë nëse ekziston një ekuilibër i drejtë ndërmjet interesave të individëve në gëzimin e së drejtës së tyre për të punuar dhe lirisë për të zgjedhur profesionin e tyre dhe interesin legjitim të shoqërisë në sigurimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit gjithëpërfshirës dhe me cilësi të shëndetit publik. Gjykata duhet të sigurojë se natyra e kufizimit, e paraparë me Ligjin për Shëndetësi, në nenin 41, është në proporcion me qëllimin e arritjes së kujdesit shëndetësor të plotë dhe me cilësi.

159. Gjykata vëren se ndalimi për punësim në institucionet private të kujdesit shëndetësor për profesionistët e kujdesit shëndetësor, të punësuar në sistemin e kujdesit shëndetësor publik, nuk synon parandalimin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor që ata të punojnë në dy vende të punës njëkohësisht. Në të vërtetë, një ndalim i tillë tashmë ekziston në kuadër të detyrimeve kontraktuese të profesionistëve të kujdesit shëndetësor. Në vend të kësaj, dispozitat e nenit 41 të Ligjit ndalojnë punësimin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor jashtë orarit të punës të punësimit të tyre brenda institucionit publik shëndetësor.

160. Gjykata konstaton se nuk është demonstruar mënyra se si do të kontribuonte një ndalim i tillë në qëllimin e kujdesit shëndetësor gjithëpërfshirës dhe kualitativ në sektorin publik. Siç u tha më lartë, është e qartë se qëllimi i ndalimit nuk është të parandalojë profesionistët e kujdesit shëndetësor, të punësuar në institucione të shëndetit publik, të kenë dy ose më shumë vende të punës. Marrëdhënia ndërmjet këtij ndalimi dhe qëllimit të deklaruar është e tëra më e paqartë, sepse neni 41 lejon profesionistët e kujdesit shëndetësor të angazhohen në aktivitete private të kujdesit shëndetësor në institucionet publike shëndetësore, ku ata janë të punësuar.

161. A është qëllimi i këtyre kufizimeve ndaj punës së dyfishtë të profesionistëve, të punësuar në institucionet publike, dhe i referimeve të pajustifikuara të pacientëve në institucionet private shëndetësore, të dizajnuara për të parandaluar profesionistët e kujdesit shëndetësor nga përfitimi prej sistemit të kujdesit shëndetësor publik, duke ua mohuar shërbimin pacientëve të sektorit publik në favor të ofrimit ndaj pacientëve të njëjtë shërbimet mjekësore me çmime të konsiderueshme në institucionet e sektorit privat? Në këtë rast, kjo do të ishte çështje e menaxhimit të duhur dhe të qëndrueshëm të sektorit publik të profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe të mbajtjes së disiplinës së mirë profesionale në kuadër të sektorit.

162. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se ndalimi i gjerë i punësimit të profesionistëve të kujdesit shëndetësor publik në të dy institucionet shëndetësore të kujdesit, publike dhe private, është një mjet i papërshtatshëm për arritjen e qëllimit të dëshiruar publik të Ligjit për Shëndetësi.

163. Në këtë drejtim, Gjykata vë në dukje një vendim të Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë (Vendimi 21/1994, 16 prill 1994) për lirinë e ndërmarrjes dhe për licencimin e taksive. Në këtë vendim, gjykata hungareze shpalli si antikushtetuese një dispozitë të statutit, duke ua

mundësuar qeverive lokale të kufizojnë numrin e licencave të taksive. Gjykata Kushtetuese e Hungarisë konsideroi:

"Kjo rregullore është antikushtetuese në shumë baza.

(a) Gjykata Kushtetuese nuk arriti të zbulojë një të drejtë të tillë kushtetuese ose interesat që mund ta kenë bërë kufizimin objektiv në zgjedhjen e profesionit të nevojshëm dhe proporcional në industrinë e taksive. Arsyetimet e ofertave nga legjislatura janë veçanërisht të pamjaftueshme për të kënaqur kërkesat e kufizimit kushtetues të një të drejte themelore. 'Zgjerimi padëshiruar për furnizimin e saj, përkeqësimi i cilësisë së shërbimit, krijimi i një çmimi të nivelit më të lartë për shërbimin, mungesa e likuiditetit dhe falimentimi i shumicës së sipërmarrësve, mospagesa e tatimeve dhe tarifave të shërbimeve'; 'eliminimi dhe mbrojtja e konsumatorit - duke pasur parasysh mungesën e një mekanizmi vetërregullues në tregun e taksive - kërkon ndërhyrje të fortë', - shkroi ministri i Transportit, Komunikacionit dhe Ujit. Por, ky 'intervenim' nuk mund të përbëjë shkelje të përmbajtjes thelbësore të një të drejte themelore kushtetuese. Kufizimi në të drejtën e ndërmarrjes me numerus clausus nuk është një instrument kushtetues i rregullimit të konkurrencës, ai nuk mund të përdoret për të rritur cilësinë e shërbimit, për të mos përmendur përdorimin e tij si një zëvendësim për mbledhjen e tatimeve. Anomalia e tregut të taksive - presioni nga konkurrentët, etj - mund dhe duhet të sulmohet dhe të zgjidhet duke përdorur mjete të tjera administrative. (Për shembull, pagesa e tarifave të përbashkëta duhet të rregullohet në bazë të një recete të lëshimit të detyrueshëm të arkëtimeve dhe instalimin e njehsorëve në taksi, dhe jo duke kufizuar hyrjen në profesion, siç ka qenë rasti.) Administrata publike nuk mund të lirohet nga barra e saj në kurriz të një kufizimi të tillë të të drejtave themelore;

(b) rregullimi statutor që autorizon qeveritë lokale për të kufizuar me dekret numrin e taksive gjithashtu është antikushtetues, sepse ky autorizim nuk përmban asnjë kriter për dhënien e kufizimeve. (Kjo situatë është pasojë logjike e faktit se kufizimi madje nuk ka asnjë bazë kushtetuese - shih paragrafin [a] më sipër). Një kufizim i drejtpërdrejtë dhe i rëndësishëm i një të drejte themelore mund të sigurohet vetëm me ligj (dhjetor 64, 1991 [XII., 17], AB [MK 1991/139]). Dhënia e një autorizimi carte blanche qeverive lokale për një kufizim të tillë përjashtohet me kushtetutë. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi s. 1 (2) Aktin LXXVIII e 1992, duke ndryshuar 19 i Aktit I të 1988".

Sa i përket mundësisë së realizimit të qëllimit me një kufizim më të vogël

164. Gjykata rikujton se dëgjimi i përfaqësuesit të Kuvendit nuk i ka ofruar Gjykatës një përgjigje nëse Kuvendi, gjatë procedurës së miratimit të Ligjit, kishte shqyrtuar mundësinë e arritjes së qëllimit të legjislacionit, respektivisht duke siguruar shëndetësi gjithëpërfshirëse dhe kualitative në sektorin publik me vendosjen e një kufizimi më të vogël se ai i paraparë me nenin 41.1 të Ligjit për Shëndetësi.

165. Duke iu përgjigjur Gjykatës në pyetjen e njëjtë, përfaqësuesi i MSH-së deklaroi se, për shkak të buxhetit të kufizuar dhe për shkak të mungesës së mekanizmit monitorues të përshtatshëm, parandalimi i praktikës së dyfishtë mjekësore, të përshkruar në nenin 41.1 të Ligjit, ishte opsioni i vetëm, me qëllim të evitimit të humbjes financiare nga qytetarët.

166. Siç u përmend më herët, ministri i MSH-së konsideroi se masat e tjera, siç janë masat disiplinore për ata që e keqpërdorin profesionin, janë të papërshtatshme për shkak të mungesës së inspektorëve mjekësorë (Në tërë vendin ka vetëm 12 inspektorë).

167. Nga ana tjetër, përfaqësuesi i parashtruesve konsideroi se duhet të merren masa më të rrepta kundër atyre që abuzojnë me profesionin e tyre publik shëndetësor, në vend të një ndalimi bosh të praktikës së dyfishtë.

168. Edhe përfaqësuesi i parashtruesve dhe ministri i MSH-së u pajtuan se, një strategji e re shëndetësore që do të prezantonte monitorimin e duhur të punës së profesionistëve të kujdesit shëndetësor, do të ishte e dobishme në shmangien e keqpërdorimeve të mundshme të ushtrimit të profesionit nga profesionistët shëndetësorë.

169. Përderisa nuk i përket Gjykatës të këshillojë se cilat masa duhet të përdoren për të siguruar një kufizim më të vogël, Gjykata vëren se masat e tjera nuk janë marrë fare parasysh.

170. Në këtë drejtim, Gjykata vë në dukje se neni 85 i Ligjit të Punës parashikon masat disiplinore në rast të shkeljes së detyrave të punës. Neni 86 i të njëjtit ligj parasheh shqiptimin e masave.

171. Gjykata nuk është e bindur nga argumenti i MSH-së se, për shkak të mungesës së fondeve dhe të inspektorëve të kujdesit shëndetësor, legjislacioni ekzistues, i cili mund të aplikohet në parandalimin e konfliktit të interesit, është joadekuat.

172. Gjykata konsideron se dispozitat e Ligjit të Punës mund të arrijnë synimin e dëshiruar, pa pasur nevojë që në mënyrë specifike të ndalohen profesionistët e kujdesit shëndetësor, të punësuar në sektorin publik të shëndetësisë, që të angazhohen në aktivitete të mëtejshme të kujdesit shëndetësor privat në kohën e tyre të lirë.

173. Ky mjet alternativ lehtësisht mund të jetë i barabartë, për nga efikasiteti, me mjetet e zgjedhura nga ligjvënësi për arritjen e qëllimit të duhur.

174. Si përfundim, Gjykata konstaton se neni 41 nuk arrin një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave të individëve në lirinë për të zgjedhur profesionin e tyre dhe interesit publik në sigurimin e një kujdesi të plotë dhe kualitativ shëndetësor. Në veçanti, Gjykata konstaton se, ndalimi i punësimit në institucione private të kujdesit shëndetësor, nuk është një mjet në proporcion me qëllimin e arritjes së sigurimit të ofrimit gjithëpërfshirës dhe me cilësi të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, drejt qëllimit të mbrojtjes dhe të përmirësimit të shëndetit të qytetarëve të Kosovës.

175. Gjykata konstaton se dispozitat e nenit 41 të Ligjit për Shëndetësi kufizojnë të drejtën për punë, siç parashihet me nenin 49 të Kushtetutës, dhe këto kufizime nuk janë në përputhje me natyrën e kufizimeve të autorizuara sipas nenit 55 të Kushtetutës. Prandaj, neni 41 i Ligjit për Shëndetësi është në papajtueshmëri me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.5 të Kushtetutës; në bazë të neneve 20 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe në bazë të rregullave 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës, më 15 mars 2013,

VENDOSI

I. Njëzëri, TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. Njëzëri, SHPALL se nenet 18, 19 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të 13 dhjetorit 2012, janë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;

III. Me shumicë, SHPALL se neni 41, paragrafët 1, 5 dhe 6 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të 13 dhjetorit 2012, janë në mospërputhje me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

IV. Konsideron se neni 41, paragrafët 1, 5 dhe 6 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të 13 dhjetorit 2012, është i pavlefshëm;

V. Konsideron se Vendimi i Gjykatës për zgjatjen e Masës së përkohshme, i 24 janarit 2013, për pezullimin e zbatimit të neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të 13 dhjetorit 2012, pushon me hyrjen në fuqi të këtij aktgjykimi;

VI. Urdhëron që ky aktgjykim t'u dërgohet palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare; dhe,

VII. Deklaron që ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese Prof. dr. Enver Hasani

Mendimi i përbashkët mospajtues
i Gjyqtarëve Robert Carolan dhe Almiro Rodrigues
në
Rastin Nr. KO131/12
Parashtruesi
Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, miratuar nga Kuvendi më 13 dhjetor 2012

Në këtë rast, Parashtruesit pretendojnë që nenet 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, nr. 04/L-125, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 13 dhjetor 2012, nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Shumica e kësaj Gjykate ka vlerësuar që nenet 18, 19 dhe 60 të këtij Ligji janë në përputhje me Kushtetutën, por ka vlerësuar që neni 41 nuk është në përputhje me Kushtetutën. Shumica ka gjetur që neni 41 i këtij Ligji cenon nenin 49 të Kushtetutës. Ky qëndrim bazohet në interpretim të gabueshëm të Kushtetutës.

Neni 41 i ligjit të kontestuar përcakton se:

1. *Profesionisti shëndetësor i punësuar në sektorin publik, me orar të plotë ose të pjesshëm të punës, nuk ka të drejtë të punojë në institucionet private të kujdesit shëndetësor.*

2. *Është rreptësisht e ndaluar që të referohen pacientët nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor tek institucionet private të kujdesit shëndetësor për shkaqe të cilat nuk mund të arsyetohen me argumente mjekësore, pavarësisht nga lista e pritjes.*

3. *Ndalohet rreptësisht çfarëdo shpërblimi formal ose joformal, financiar ose i llojit tjetër i profesionistit shëndetësor përfshirë shpërblimin për referimin e qytetarit ose banorit nga sektori publik në sektorin privat të shëndetësisë, dhe marrëdhëniet profitabile me industrinë farmaceutike.*

4. *Shkelësit e dispozitave të këtij neni do të jenë subjekt i dënimeve ose veprimeve ligjore të përcaktuara me këtë ligj dhe aktin e veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministria.*

5. *Institucionet publike shëndetësore kanë të drejtë t'i lejojnë punëtorët e tyre shëndetësorë të ushtrojnë aktivitetet e tyre private shëndetësore brenda institucionit publik shëndetësor.*

6. *Aktiviteti privat shëndetësor nga paragrafi 5 i këtij neni do të implementohet në bazë të një akti të veçantë nënligjor që nxirret nga Ministria.*

Edhe pse neni 41 përcakton disa kufizime për profesionistët shëndetësorë që punojnë në institucion publik, ai në mënyrë specifike i lejon profesionistët shëndetësorë që të ushtrojnë aktivitete private shëndetësore në një institucion publik.

Neni 41 vendos tri kufizime për profesionistët publikë të shëndetësisë:

(1) Nëse jeni profesionist shëndetësor i punësuar në sektorin publik, nuk lejoheni të punoni në institucion privat shëndetësor;

(2) Nëse doni t'i referoni pacientët nga institucioni shëndetësor publik i kujdesit dytësor dhe tretësor tek një institucion shëndetësor privat, duhet t'i artikuloni arsyet e bazuara mjekësore për një referim të tillë;

(3) Nuk mund të merrni kompensim financiar për referimin e pacientit tek një institucion privat shëndetësor.

Parashtruesit pohojnë se ky nen cenon nenin 49 të Kushtetutës, në lidhje me të drejtën për punë dhe ushtrim të profesionit. Neni 49 përcakton se:

"1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës."

Çështja në këtë Gjykatë është nëse neni 41 i Ligjit privon ndonjë qytetar nga e "drejta për punë" apo e drejta "për zgjedhjen e profesionit dhe vendit të punës". Nuk e privon askënd nga e drejta për të punuar apo për të zgjedhur lirisht profesionin dhe vendin e punës.

Neni 41 nuk e ndalon askënd që është i kualifikuar përshtatshmërisht sipas arsimimit, trajnimit dhe testimit që të shërbejë si profesionist shëndetësor, ose në sektorin publik ose në atë privat. Në fakt, në përputhje me nenin 51 të Kushtetutës, ky ligj përmbush mandatin e Kushtetutës që kujdesi shëndetësor rregullohet me ligj. Ligji e bën këtë duke provuar të ndalojë punësimin e njëkohshëm në të dy sektorët, ashtu që të mos ketë as konflikt interesash, e as paraqitje të konfliktit të interesave në anën e profesionistëve shëndetësorë, si dhe ashtu që cilësia e kujdesit shëndetësor e ofruar në sektorin privat dhe atë publik të mund të jetë relativisht e njëjtë.

Secili punëdhënës ka të drejtë të vendosë kufizime ndaj të punësuarve të vet në kuptimin e asaj se si punëtorët kryejnë detyrat e veta për punëdhënësin, si dhe nëse ata mund të kenë punësim shtesë të njëkohshëm. Për shembull, zyrtarët publikë të policisë mund të ndalohen nga ushtrimi i profesionit të zyrtarit privat të sigurisë, sepse ato role të njëkohshme mund të jenë në konflikt mes vete. Gjyqtarët e kanë të ndaluar të angazhohen në shumë lloje tjera të punëve derisa shërbejnë si gjyqtarë. Në fakt, vetë Kushtetuta i ndalon kandidatëve për deputetë në Kuvend të mbajnë vende të ndryshme të tjera të punës. Neni 73 përcakton se:

"1. Nuk mund të kandidohen dhe as të zgjidhen deputetë të Kuvendit, pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre:

(1) gjyqtarët dhe prokurorët;

(2) pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës;

(3) pjesëtarët e Policisë së Kosovës;

(4) pjesëtarët e Doganave të Kosovës;

(5) pjesëtarët e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;

(6) udhëheqësit e agjencive të pavarura;

(7) përfaqësuesit diplomatikë;

(8) kryetarët dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

2. Nuk mund të kandidohen për deputetë personat e privuar nga zotësia juridike për të vepruar, me vendim përfundimtar të gjykatës.

3. Kryetarët dhe zyrtarët tjerë, të cilët mbajnë përgjegjësi ekzekutive në nivel komune, nuk mund të zgjidhen si deputetë të Kuvendit pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre."

Asnjë prej këtyre kufizimeve nuk e privon askënd nga e drejta për të punuar ose për të zgjedhur profesionin e tij/saj të punës. Ato thjesht përcaktojnë disa prej kualifikimeve për kryerjen e punës. Neni 41 thjesht provon të minimizojë në mënyrë proporcionale secilin konflikt interesi apo paraqitjen si të tillë të një profesionisti shëndetësor që zgjedh të punojë në sektorin publik. Ai gjithashtu tenton ta bëjë më të barabartë cilësinë e shërbimeve shëndetësore që ofrohen nga sektori publik dhe ai privat. Gjykata nuk mund ta përcaktojë nëse nëse neni 41 do të përmbushë ato synime. Ai funksion është përgjegjësi e vetme e deputetëve të Kuvendit që zgjidhen nga qytetarët e Kosovës. Gjykata Kushtetuese vetëm duhet të vendosë nëse neni 41 cenon nenin 49 të Kushtetutës. Nuk e cenon.

Dorëzuar me respekt

Gjyqtari Robert Carolan Gjyqtari Almiro Rodrigues

KO 97/12, Avokati i Popullit, datë 18 prill 2013-Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 90, 95 (1.6), 110, 11 dhe 116 të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012

Rasti KO 97/12, Aktgjykim i 12 prillit 2013

Fjalët kyçe: ekonomia, masë e përkohshme, liria e asociimit, ligj i papajtueshëm me Kushtetutën, mbrojtja e pronës

Parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.2 (1) të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar kushtetutshmërinë e neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012, sepse "[...] Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, kryesisht në kapitullin II të tij, lejon OJQ-të institucione mikrofinanciare, të transformohen në shoqëri aksionare, gjegjësisht në subjekte private, në kundërshtim me qëllimin e themelimit të tyre. Si i tillë, ky ligj shkel parimet kushtetuese, shkel parimet ndërkombëtare të ligjit joprofitabil dhe është në kundërshtim me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë që rregullon lirinë e asociimit në OJQ, dhe vë në rrezik të ardhmen e sektorit të shoqërisë civile në përgjithësi".

Pasi parashtruesi ishte palë e autorizuar, e ka përmbushur afatin e nevojshëm kohor për të parashtruar kërkesë në Gjykatë dhe me saktësi ka përshkruar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës, duke përfshirë ligjin e kontestuar të Kuvendit, Gjykata i vlerësoi meritat e kërkesës.

Në këtë drejtim, Gjykata vendosi që nenet 90, 95 (1.6), 110, 111 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012, nuk janë në përputhje me nenin 10 [Ekonomia], me nenin 44 [Liria e Asociimit] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; sepse transformimi i OJQ-ve në një shoqëri aksionare do të devijojë qëllimin fillestar të ekzistencës së OJQ-ve dhe mund të dëmtojë seriozisht një nga elementet themelore të demokracisë.

AKTGJYKIM
në
Rastin Nr. KO97/12
Parashtrues
Avokati i Popullit
Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të anulojë nenet: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, e Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi, nga Gjykata, i kushtetutshmërisë së neneve: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012.

4. Parashtruesi, më tej, kërkon që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme për pezullimin e zbatimit të Ligjit për Bankat, Institucionet

Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012.

Baza juridike

5. Neni 113.2 (1) i Kushtetutës; nenet: 22, 27, 29 dhe 30, të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe rregullat: 54, 55, 56, 62, 64, të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 11 tetor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatë.

7. Më 31 tetor 2012, Kryetari, me vendimin Nr. GJR. KO97/12, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me vendimin Nr. KSH. KO97/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 14 dhjetor 2012, kërkesa iu komunikua Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe Qeverisë.

9. Të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Komisionit parlamentar për Legjislacion (në tekstin e mëtejmë: Komisioni për Legjislacion), Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: BQK), Ministrisë së Financave (në tekstin e mëtejmë: MF), Ministrisë së Administratës Publike – Departamenti i Regjistrimit dhe Ndërlidhjes me OJQ, dhe Gjykata kërkoi nga këto institucione të paraqisnin komentet e tyre. Deri më tash, vetëm Komisioni për Legjislacion nuk është përgjigjur.

10. Më 24 dhjetor 2012, Gjykata lejoi Masën e përkohshme, sipas kërkesës së parashtruesit, me kohëzgjatje deri më 31 janar 2013.

11. Më 10 janar 2013, Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" sh. p. k., Prishtinë, duke përfaqësuar Asociacionin e Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: AIMK), dorëzoi një kërkesë për informata dhe për shkresat e lëndës në Rastin Nr. KO97/12, në mënyrë që të përgatisë: (i) Kërkesë për lejim të dorëzimit të parashtresës *Amicus Curiae*; dhe (ii) Parashtresë *Amicus Curiae*.

12. Më 14 janar 2013, Gjykata iu përgjigj Shoqërisë së Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" sh. p. k., Prishtinë, duke theksuar:

> *"Duke marrë parasysh rregullin 53 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, i cili parasheh që 'Gjykata, nëse e konsideron të nevojshme për qëllim të analizave të duhura dhe për të vendosur për rastin, mund të thërrasë ose t'i sigurojë leje një organizate ose një personi për t'u paraqitur para saj dhe për të dhënë deklaratë me gojë ose me shkrim për ndonjë çështje të specifikuar nga Gjykata', si dhe duke marrë në konsideratë pikat: 1, 6 dhe 7, të Udhëzimit për praktikat mbi udhëzimet dhe procedurat për paraqitjen e parashtresave të Amicus Curiae, Nr. 01/2012, ju njoftojmë se kërkesa juaj është pranuar dhe është regjistruar, ndërsa, në pajtim me dispozitat juridike të cekura më lart, e njëjta i është përcjellë Gjykatës në përbërje të plotë, e cila, brenda afateve të përcaktuara ligjore, do të marrë vendim përkitazi me kërkesën tuaj dhe ju do të njoftoheni menjëherë sapo të merret vendimi. Duke marrë parasysh interesin tuaj për sa i përket kërkesës, si dhe duke marrë parasysh dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fuqi, Gjykata do t'ju njoftojë me kohë edhe për të gjitha veprimet vijuese që do t'i ndërmarrë, e që mund të kenë lidhje me kërkesën tuaj".*

13. Më 18 janar 2013, Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" sh. p. k., Prishtinë, që përfaqëson Asociacionin e Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës, paraqiti një kërkesë për lejimin e paraqitjes së parashtresës *Amicus Curiae*, dhe vetë parashtresën *Amicus Curiae*. Për më tepër, Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" sh.p.k., Prishtinë, kërkoi nga Gjykata që të mos e shqyrtojë kërkesën e tyre më 10 janar 2013 në këtë Gjykatë, "*pasi që marrja e dokumenteve të mësipërme nuk kërkon përgjigje ndaj parashtresës*".

14. Më 24 janar 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, që të marrë këto vendime:

    a) Të zgjasë Masën e përkohshme, të caktuar nga Gjykata në vendimin fillestar të 24 dhjetorit 2012, edhe për një periudhë tremujore, deri më 30 prill 2013;

    b) Të kërkojë *Amicus Curiae*; dhe

    c) Të mbajë një dëgjim publik më 5 mars 2013.

15. Të njëjtën ditë, Gjykata, në përbërje të plotë, njëzëri miratoi rekomandimet e Kolegjit shqyrtues.

16. Më 25 janar 2013, Gjykata kërkoi nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës këto informata shtesë:

    a. *A mund t'ia dorëzoni Gjykatës transkriptin e seancës kur është miratuar Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, duke përfshirë edhe regjistrin elektronik të votimit?*

    b. *A mund të qartësoni dhe të konfirmoni nëse ka ekzistuar kuorumi i nevojshëm në seancë, ashtu siç përcaktohet me nenet: 69 dhe 80, të Kushtetutës?*

    c. *A mund t'i dorëzoni Gjykatës informata mbi hyrjen në fuqi të këtij ligji, duke përfshirë datën e shpalljes nga Presidentja e Republikës dhe datën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës?*

17. Më 30 janar 2013, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës iu përgjigj Gjykatës, duke ofruar:

    a) *Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare të 12 prillit 2012, ka miratuar Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093.*

    b) *Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, u dërgua për shpallje te Presidentja e Republikës së Kosovës, më 18 prill 2012.*

    c) *Presidentja e Republikës së Kosovës nuk mori vendim brenda tetë (8) ditësh për të shpallur apo për të kthyer Ligjin. Kështu, në bazë të nenit 80.5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligji konsiderohet të jetë i shpallur pa nënshkrimin e Presidentes dhe u publikua në Gazetën Zyrtare më 30 prill 2012.*

    d) *Neni 118 i Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-09, përcakton që ky ligj hyn në fuqi më 12 prill 2012 (Shih faqen 21 të transkriptit).*

e) Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për më tepër, i ofroi Gjykatës këtë dokumentacion shtesë: 1.) Transkriptin dhe procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 12 prill 2012; 2.) Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-333, të 12 prillit 2012 për miratimin e Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-09; si dhe 3.) Regjistrin elektronik të votimit për Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-09.

18. Më 31 janar 2013, Gjykata, në bazë të rregullit 53 të Rregullores së punës, i dërgoi ftesë firmës "Pallaska & Associates" sh.p.k., z. Dastid Pallaska, avokat, që të parashtrojë një parashtresë me shkrim *Amicus Curiae* në Gjykatë, me përmbajtjen e qëndrimit të tij ligjor përkitazi me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-09.

19. Më 5 mars 2013, Gjykata mbajti seancë dëgjimore publike.

20. Më 6 mars 2013, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës kërkoi nga Gjykata që të marrë transkriptin e seancës dëgjimore publike.

21. Më 7 mars 2013, z. Dastid Pallaska i dorëzoi Gjykatës parashtresën e tij me shkrim *Amicus Curiae*.

22. Më 14 mars 2013, Gjykata e shqyrtoi rastin dhe votoi për të.

Përmbledhje e fakteve

23. Më 12 prill 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi), miratoi Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, me 55 (pesëdhjetë e pesë) vota për, 0 (zero) vota kundër, dhe 4 (katër) abstenime.

24. Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, ka hyrë në fuqi më 12 prill 2012, në pajtim me nenin 118 të këtij Ligji.

25. Më 19 prill 2012, organizatat joqeveritare: Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Lëvizja FOL, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe 55 OJQ të tjera mbështetëse, i drejtuan një letër Kryetarit të

Republikës së Kosovës, duke kërkuar që ligji të mos shpallet, si dhe të kthehet në Kuvend për rishqyrtim.

26. Më 11 maj 2012, Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 80.5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

27. Më 11 maj 2012, Institucioni i Avokatit të Popullit mori një parashtresë nga disa OJQ: Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Lëvizja FOL, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe 55 OJQ të tjera mbështetëse, të cilat, së bashku, iu drejtuan Institucionit të Avokatit të Popullit, duke kërkuar që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në përputhje me detyrat dhe me përgjegjësitë e dhëna me ligj, të vlerësojë kushtetutshmërinë e neneve: 90, 95, (1.6), 110, 111 dhe 116, të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093.

28. OJQ-të e lartpërmendura konsiderojnë se këto nene përbëjnë shkelje të Kushtetutës dhe kërkuan pezullimin e zbatimit të Ligjit, derisa Gjykata të nxjerr një vendim meritor përkitazi me këtë çështje.

29. OJQ-të e lartpërmendura konsiderojnë se dispozitat e neneve: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, shkelin nenin 44 [Liria e Asociimit], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 10 [Ekonomia], të Kushtetutës, parimet ndërkombëtare të OJQ-ve jofitimprurëse dhe legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë, që rregullon fushën e lirisë së asociimit në OJQ.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesi, në kërkesën e tij, i referohet mekanizmit të zbatueshëm juridik, si në vijim, përkitazi me objektin e çështjes në Gjykatë:

31. Neni 44 [Liria e Asociimit] i Kushtetutës përcakton se liria e asociimit është e garantuar dhe e rregulluar me ligj:

> *"1. Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen në vete të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.*

2. Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. [...]".

32. Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës garanton në mënyrë specifike mbrojtjen e pronës:

"1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. [...]".

33. Neni 10 [Ekonomia] i Kushtetutës ka të bëjë me rregullimin ekonomik të Republikës së Kosovës:

"Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës".

34. Neni 1 i Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Nr. 04/L-057, përcakton:

"Ky ligj rregullon themelimin, regjistrimin, udhëheqjen e brendshme, veprimtarinë, shuarjen dhe çregjistrimin e personave juridikë, të organizuar si organizata joqeveritare në Kosovë".

35. Sipas nenit 4 të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Nr. 04/L-057:

"1. OJQ-ja nuk shpërndan të ardhura neto ose fitime për asnjë person.

2. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e një OJQ-je përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të përcaktuara për organizatën.

3. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e një OJQ-je nuk mund të përdoren për të sjellë drejtpërdrejt ose tërthorazi përfitime, për ndonjë themelues, drejtor, zyrtar, anëtar, punonjës ose donator të OJQ-së, përveç pagesës apo kompensimit të arsyeshëm për personat që kryejnë punë për organizatën".

36. Neni 5 i Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Nr. 04/L-057, në mënyrë të qartë përcakton nocionin dhe qëllimin e themelimit të një OJQ-je në Kosovë:

"1. OJQ-ja vendore është shoqatë ose fondacion i themeluar në Kosovë për realizimin e qëllimit bazuar në ligj, për përfitim publik ose për interes të ndërsjellë. [...]".

37. Neni 11.1 i Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Nr. 04/L-057, përcakton:

"1. OJQ-ja vendore ka statusin e personit juridik me regjistrim në përputhje me këtë ligj".

38. Neni 20 i Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Nr. 04/L-057, përcakton kushtet për shuarjen e një OJQ-je:

"1. OJQ-ja shuhet:

1.1. me vendim vullnetar për shuarjen e OJQ-së, të marrë nga organi më i lartë udhëheqës në pajtim me statutin e saj;

1.2. kur OJQ-ja bëhet josolvente sipas ligjit në fuqi;

1.3. me kalimin e afatit për të cilin është themeluar, nëse një afat i tillë është i përcaktuar në aktin themelues;

1.4. në bazë të vendimit të plotfuqishëm gjyqësor".

39. Neni 21 i Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Nr. 04/L-057, përcakton mënyrën dhe organet kompetente për çregjistrim dhe mënyrën e menaxhimit të pasurive të OJQ-së:

"3. Në rast të shuarjes ose çregjistrimit të OJQ-së, e cila ka shfrytëzuar lehtësi tatimore ose fiskale, donacione publike ose grante nga Qeveria, e gjithë pasuria e mbetur pas shlyerjes së borxheve të OJQ-së i jepet OJQ-së tjetër me qëllime të njëjta apo të ngjashme. Kjo OJQ identifikohet në bazë të statutit të OJQ-së, ose me propozim të organit më të lartë udhëheqës të OJQ-së. Ministria themelon Komisionin për Shpërndarjen e Pasurisë së mbetur të OJQ-së së shuar dhe të çregjistruar me përfaqësues edhe të OJQ-ve, duke u bazuar në aktin nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.

4. Në të gjitha rastet e tjera, çdo pasuri e mbetur pas pagesës së borxheve shpërndahet në bazë të statutit apo të vendimit të organit më të lartë udhëheqës, dhe në të gjitha rastet në përputhshmëri me nenin 4 të këtij ligji".

40. Në këtë drejtim, parashtruesi pohon se *"[...] Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, kryesisht në Kapitullin II të tij, lejon OJQ-të institucione mikrofinanciare, të transformohen në shoqëri aksionare, gjegjësisht në subjekte private në kundërshtim me qëllimin e themelimit të tyre. Si i tillë, ky ligj shkel parimet kushtetuese, shkel parimet ndërkombëtare të ligjit joprofitabil dhe është në kundërshtim me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë që rregullon lirinë e asociimit në OJQ, dhe vë në rrezik të ardhmen e sektorit të shoqërisë civile në përgjithësi".*

41. Më tej, parashtruesi pretendon se OJQ-të institucione mikrofinanciare, janë themeluar dhe janë regjistruar në pajtim me të drejtën për asociim, të garantuar me nenin 44 të Kushtetutës dhe me Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ, Nr. 04/L-057. Megjithatë, siç pretendohet, Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, me ndryshimin e subjektivitetit juridik të OJQ-ve institucione mikrofinanciare dhe duke lejuar transformimin e tyre në shoqëri aksionare, i largon ato prej fushëveprimit të nenit 44 të Kushtetutës, derisa Ligji për Lirinë e Asociimit në OJQ pengon të drejtën e tyre për të vepruar në bazë të së drejtës për asociim.

42. Për më tepër, pretendohet se Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, synon të rregullojë veprimtarinë e OJQ-ve institucione mikrofinanciare nëpërmjet rregullimit të parimeve dhe të procedurave të menaxhimit. Megjithatë, dispozitat e Ligjit adresojnë çështjet e subjektivitetit juridik të OJQ-ve institucione mikrofinanciare, duke lejuar kështu transformimin e tyre nga statusi i OJQ-ve në një subjekt juridik – shoqëri aksionare.

43. Parashtruesi pretendon se "*Ligji për Lirinë e Asociimit në OJQ, në nenin 4, paragrafët 2 dhe 3, nuk lejon një OJQ të transformohet në një subjekt tjetër juridik, aq më pak në një subjekt juridik profitabil. Një OJQ mund të pushojë së ekzistuari (gjegjësisht të anulojë statusin e saj juridik si OJQ) vetëm me ndërprerje, dhe në asnjë mënyrë me transformim. Duke qenë e themeluar dhe e regjistruar në përputhje me këtë ligj (dhe rregulloret dhe ligjet e mëparshme të ligjit të tanishëm), statusi juridik i të gjitha OJQ-ve (duke përfshirë OJQ IMF) është i rregulluar ekskluzivisht me Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ, dhe çdo rregullim i statusit juridik të institucioneve të tilla nga ligjet e tjera është i kundërligjshëm*".

44. Më tej, parashtruesi pohon se "*disa vende nuk lejojnë mundësi ligjore për transformim të tillë (siç është rasti në Kosovë), ndërsa të tjerat në mënyrë eksplicite ndalojnë transformimin e tillë me ligjet përkatëse, siç janë Ligji i Republikës së Bullgarisë për subjektet jofitimprurëse, neni 12, neni 42; Ligji i Republikës së Maqedonisë për shoqata dhe fondacione, neni 6.2; dhe Ligji i Republikës së Estonisë për fondacione, neni 1.3*".

45. Sipas parashtruesit, parimi themelor universal për sektorin jofitimprurës është: "*Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e një OJQ-je nuk mund të përdoren për të sjellë përfitime, për ndonjë themelues, drejtor, zyrtar, anëtar, punonjës ose donator të OJQ-së, përveç pagesës apo kompensimit të arsyeshëm për personat që kryejnë punë për organizatën*". Pretendohet se, *"ky parim nënkupton që OJQ-ja nuk ka ndonjë pronar, dhe prandaj pronat e saj nuk mund të trajtohen si pronë private. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e një OJQ-je përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të përcaktuara për organizatën"*, përderisa në rastin e ndërprerjes së një OJQ-je, *"pasuritë e asaj OJQ-je shpërndahen në një tjetër OJQ me qëllime të njëjta ose të ngjashme"*.

46. Duke u bazuar në atë që u tha më lart, parashtruesi pretendon se "*këto dispozita sigurojnë që në asnjë mënyrë, qoftë gjatë veprimtarisë së tyre, ose edhe pas ndërprerjes së tyre, pasuritë e një OJQ-je nuk mund të transferohen në subjekte fitimprurëse. Në të kundërtën, Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, duke lejuar OJQ IMF të transformohen në shoqëri aksionare, lejon pasuritë e OJQ-së të transformohen në aksione/prona private*".

47. Sipas nenit 46 të Kushtetutës, askush nuk do të privohet arbitrarisht nga prona e tij, duke përfshirë pronën e personave juridikë. Rrjedhimisht, parashtruesi pohon se "*ky nen mbron pasurinë e organizatave joqeveritare. OJQ-të janë persona juridikë të themeluar në pajtim me të drejtat jofitimprurëse dhe, si të tilla, ato nuk janë në pronësi. Pasuritë e OJQ-së menaxhohen nga organet e menaxhimit të OJQ-së, por gjithmonë në bazë të parimit universal për mosshpërndarjen e fitimit. Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, duke lejuar transformimin e OJQ institucione mikrofinanciare në shoqëri aksionare, në mënyrë arbitrare tjetërson pasuritë e OJQ-së, duke transferuar pasuritë nga OJQ-ja te persona të tjerë juridikë apo fizikë për aksione*".

48. Sipas parashtruesit, "*Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, duke lejuar transformimin e OJQ IMF në shoqëri aksionare, lejon që kapitali i fituar pa pagesën e tatimeve të injektohet në konkurrencën e tregut komercial në mes të bankave dhe institucioneve të tjera financiare, të cilat janë të detyruara të paguajnë taksa që nga themelimi i tyre*". Kjo pretendohet të jetë në kundërshtim me nenin 10 të Kushtetutës, që parasheh se *"ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë për rregullimin ekonomik të Republikës së Kosovës"*.

49. Sipas mendimit të parashtruesit, *"Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare është gjithashtu në kundërshtim me Rekomandimin CM/Rec (2007) 14, të Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës për statusin juridik të OJQ-ve në Evropë, si dhe me Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ, Nr. 04/L-057, një ligj themelor, i cili përcakton krijimin dhe ndërprerjen e veprimtarisë së të gjitha OJQ-ve në Kosovë"*.

Përgjigje nga BQK-ja

50. Më 28 dhjetor 2012, BQK-ja iu përgjigj Gjykatës, duke cekur se *"qëllimi i Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare është regjistrimi, rregullimi dhe mbikëqyrja e këtyre institucioneve nga BQK-ja. Prandaj, ky ligj u mundëson edhe të gjitha OJQ-ve, të cilat shprehin dëshirën që të ushtrojnë aktivitet financiar të përcaktuar sipas këtij ligji, të regjistrohen, të rregullohen dhe të mbikëqyren nga BQK-ja, duke mos bërë asnjë dallim ndërmjet OJQ-ve, pavarësisht qëllimit të tyre për të cilin ato janë themeluar"*.

51. Për më tepër, BQK-ja cek: *"Pretendimet e parashtruesit të kërkesës se neni 90, neni 95 (1.6), neni 110, neni 111 dhe neni 116 i Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, janë në papajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe se janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi që e rregullon fushën e lirisë së asociimit në OJQ, janë të pabazuara [...]"*.

52. Në këtë drejtim, sipas nenit 90, BQK-ja pohon: *"Të gjitha institucionet mikrofinanciare, në momentin e regjistrimit në BQK si 'institucion mikrofinanciar', qoftë si OJQ, qoftë si shoqëri aksionare, i nënshtrohen kornizës ligjore dhe kërkesave mbikëqyrëse të BQK-së. Prandaj, dispozita e këtij neni në mënyrë të qartë thekson se një OJQ nuk lejohet të shesë ose të transferojë veprimtarinë e saj, të bashkohet ose të ndryshojë strukturën e saj, e as nuk lejohet të shpërndajë ose në ndonjë mënyrë të paguajë fitimet, suficitin e kapitalit, dividendat ose ndonjë*

nga aktivat e saj, përveç asaj që është në përputhje me këtë ligj. Është plotësisht e pakontestueshme se Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, nuk i detyron apo inkurajon OJQ-të ekzistuese të transformohen në shoqëri aksionare. Është vendim autonom i tyre se a dëshirojnë të vazhdojnë veprimtarinë e tyre ashtu siç janë, apo të transformohen në shoqëri aksionare".

53. Për më tepër, sipas nenit 95 (1.6), BQK-ja pohon se, *"ashtu siç u cek më lart, të gjitha institucionet mikrofinanciare dhe jobankare, pa marrë parasysh statusin e tyre juridik, qoftë si OJQ, apo shoqëri aksionare, në momentin e regjistrimit të tyre në BQK për të kryer aktivitete financiare (aktivitet të kredidhënies apo aktivitet tjetër financiar), rregullohen dhe mbikëqyren nga ana e BQK-së. Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare ka për objekt rregullimi institucionet financiare të cilat ushtrojnë aktivitet financiar dhe i vetmi rregullator i institucioneve të cilat ushtrojnë aktivitet financiar në Kosovë është BQK-ja, dhe në asnjë mënyrë dispozitat e këtij ligji nuk kërkojnë apo inkurajojnë asnjë OJQ apo IMF të shuhet apo të krijojë një IMF shoqëri aksionare. Çdo institucion mikrofinanciar OJQ, që vendos të përfundojë aktivitetet e veta, duhet t'i përmbahet Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe ligjeve të tjera të aplikueshme. Ky ligj thekson në mënyrë të qartë se profitet dhe mjetet nuk mund të shpërndahen apo të transferohen përveç për qëllime bamirësie, në përputhje me Ligjin për OJQ-të. Të gjitha institucionet financiare, qofshin institucione mikrofinanciare, banka apo institucione financiare jobankare, si dhe atëherë kur institucioni mikrofinanciar është një OJQ, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose shoqëri aksionare, duhet të zbatojnë rregullativën dhe mbikëqyrjen e BQK-së për çështjet e ndërmjetësimit financiar".*

54. Më tej, sipas nenit 110, BQK-ja pohon që *"është e rëndësishme të ceket se paragrafi 1 i këtij neni në mënyrë të qartë thekson se 'kapitali i dhuruar dhe suficiti i kapitalit do të shpërndahet për qëllime bamirësie sipas ligjeve ne fuqi', që në mënyrë të qartë nënkupton zbatimin e ligjeve të aplikueshme, i cili përfshin edhe Ligjin për OJQ-të dhe qëllimi i këtij paragrafi është që Ligji i OJQ-ve do të aplikohet në rastet e tilla. Gjithashtu, ky paragraf thotë: 'Dhe planit të miratuar nga BQK-ja', por meqenëse institucioni mikrofinanciar OJQ është institucion financiar, dhe se BQK-ja mbikëqyr të gjitha institucionet financiare, atëherë është plotësisht e qartë se BQK-ja, në këtë mënyrë, vetëm siguron stabilitetin e sektorit financiar, si një ndër objektivat kryesore të saj, dhe siguron se zgjidhja e institucioneve financiare është bërë ashtu siç duhet dhe me*

një interferim minimal të sektorit, të klientëve dhe të publikut. Paragrafi i dytë i këtij neni e bën të qartë faktin që BQK-ja nuk mundet në asnjë mënyrë të përfitojë nga zgjidhja e institucionit mikrofinanciar OJQ dhe nga shpërndarja e kapitalit të dhuruar apo nga suficiti i kapitalit".

55. Përkitazi me nenin 111, BQK-j pohon: *"Sipas këtij neni dhe ashtu siç përcaktohet me këtë ligj, është e qartë se kapitali i dhuruar nuk duhet të përdoret për asnjë qëllim tjetër përveç për qëllime bamirësie për faktin se donatori e ka ofruar këtë për qëllim bamirësie. Ky nen përcakton që nëse një institucion mikrofinanciar OJQ vendos të regjistrohet si shoqëri aksionare, atëherë ky institucion duhet të zbatojë dispozitat e nenit 110 dhe të nenit 112 vetëm sa i përket kapitalit të dhuruar, që nënkupton se kapitali i dhuruar duhet t'u kthehet donatorëve fillestarë ose të shpërndahet për qëllime bamirësie siç përcaktohet me dispozitat e këtyre neneve, respektivisht sipas Ligjit për OJQ-të, ashtu siç përcaktohet në nenin 110, i cili në mënyrë të qartë potencon se 'kapitali i dhuruar dhe suficiti i kapitalit do të shpërndahet për qëllime bamirësie sipas ligjeve në fuqi [...]"*. Pra, e tërë kjo nënkupton se kapitali i dhuruar dhe suficiti i kapitalit duhet të shfrytëzohen për qëllime bamirësie dhe atë sipas Ligjit për OJQ-të dhe, nëse do të kishte ndonjë shfrytëzim tjetër, atëherë ajo do të jetë subjekt tatimi, mirëpo në asnjë mënyrë Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare nuk i detyron apo inkurajon për ndonjë mënyrë tjetër të shfrytëzimit të kapitalit të dhuruar dhe suficitit të kapitalit. Kështu që, institucionit mikrofinanciar OJQ, që regjistrohet si shoqëri aksionare, me vetë faktin se ai ndërpret veprimtarinë e vet bamirëse, i hiqet statusi për lirim nga tatimi si OJQ.

56. Sipas nenit 116, BQK-ja pohon se *"[...] ky nen nuk ka të bëjë asgjë me regjistrimin e OJQ-ve, të cilat vazhdojnë të regjistrohen dhe të mbikëqyren nga Ministria e Administratës Publike, por vetëm me ato institucione mikrofinanciare OJQ, të cilat zhvillojnë aktivitete financiare"*.

57. Më tej, BQK-ja thotë: *"Për më tepër, BQK-ja konsideron se pikërisht ky ligj sjell vlerë të shtuar sa i përket zhvillimit të ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë"*.

Përgjigje nga Ministria e Financave

58. Më 28 dhjetor 2012, Ministria e Financave iu përgjigj Gjykatës, duke cekur që pretendimet e parashtruesit se Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare është në

papajtueshmëri me Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ. Nga Ministria u theksuan disa arsye për mbështetjen e argumenteve të tyre, nuk qëndrojnë.

59. Në këtë drejtim, Ministria e Financave pohon: *"Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, Nr. 04/L-057, nuk e rregullon të drejtën e organizatave joqeveritare për të vepruar (regjistruar) si institucione mikrofinanciare. Ky ligj për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare rregullon themelimin, regjistrimin, udhëheqjen e brendshme, veprimtarinë, shuarjen dhe regjistrimin e personave juridikë të organizuar si OJQ, por me asnjë dispozitë veprimtarinë e institucioneve mikrofinanciare OJQ".*

60. Për më tepër, Ministria e Financave pohon: "*[...] Parashtruesi sikur i ka harrur parimet e drejtësisë, parimet Lex Temporis dhe Lex Specialis. Ligji për Lirinë e Asociimit në OJQ është ligj i përgjithshëm për të gjitha OJQ-të, ndërsa Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, pjesa e institucioneve mikrofinanciare i OJQ-ve, është i veçantë, andaj edhe si i tillë ka prioritet në aplikim".*

61. Sipas nenit 90, Ministria e Financave pohon që rregullon vetëm termat se çfarë kuptimi kanë formulimet *"në rrjedhën logjike e rregullon edhe termin institucionin mikrofinanciar OJQ dhe tregon se cilat janë obligimet, të drejtat dhe përgjegjësitë e institucioneve mikrofinanciare, duke u bazuar në Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093. Andaj, nuk ka bazë ligjore për të pretenduar se neni 90 i këtij ligji është në kundërshtim me Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ".*

62. Për më tepër, sipas nenit 95, Ministria e Financave pohon: *"Kjo dispozitë ka dy pjesë. Pjesa e parë ka për qëllim të mos lejojë që shitja ose transferimi i veprimtarisë, bashkimi, ndarja e strukturës apo misionit, t'i sjell përfitim ndonjë themeluesi, drejtori, zyrtari, anëtari etj. Kjo pjesë është edhe në përputhje me nenin 4 të Ligjit për Lirinë e Asociimit në OJQ [...]. Pjesa e dytë e dispozitës është përjashtuese nga kufizimi që ka pjesa e parë, kur përveç kur i nënshtrohet likuidimit vullnetar dhe likuidimit të detyruar ose administrimit zyrtar siç parashihet me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093. Një dispozitë identike e njeh edhe Ligji për Lirinë e Asociimit në OJQ, ku neni 20 thotë: OJQ-ja shuhet me vendim vullnetar, në bazë të vendimit të plotfuqishëm të gjyqësorit, kur OJQ-ja bëhet josolvente sipas ligjit në fuqi, andaj, siç shihet nga këto dispozita, nuk ka papajtueshmëri [...]".*

63. Përkitazi me nenin 110, Ministria e Financave pohon: *"Qëllimi i kësaj dispozite është që, në rast të likuidimit vullnetar apo të detyruar të një institucioni mikrofinanciar OJQ, kapitali i dhuruar në fillim nga donatori përkatës për themelimin e institucionit mikrofinanciar OJQ, sipas ligjeve të lartshënuara, ta njoftojë donatorin fillestar dhe t'i ofrohet mundësia për ta marrë kapitalin e dhuruar me qëllim që ta përdorë për qëllime të tjera humanitare. Në rast se donatori fillestar nuk e kthen (merr) kapitalin e dhuruar, atëherë kapitali i dhuruar dhe suficiti shpërndahen për qëllime bamirësie sipas ligjeve në fuqi. Këtu hyjnë edhe Ligji për Lirinë e Asociimit në OJQ, sipas planit të miratuar nga BQK-ja. Roli i BQK-së është vetëm për ta mbikëqyrur stabilitetin financiar".*

64. Sipas nenit 111, Ministria e Financave pohon: *"Qëllimi i këtij neni është që kapitali i dhuruar nuk duhet të përdoret për asnjë qellim tjetër përveç për qëllime bamirësie. Nëse një institucion mikrofinanciar OJQ vendos në bazë të vullnetit të vet, por në asnjë mënyrë ligji nuk e parasheh në mënyrë obligative, por vetëm në bazë të vullnetit të shfaqur të OJQ-ve, që të regjistrohet si shoqëri aksionare, atëherë ky institucion duhet të zbatojë dispozitat e nenit 110 dhe të nenit 112 të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L- 093. Kapitali i dhuruar dhe suficiti i kapitalit duhet të shfrytëzohen vetëm për qëllime bamirësie dhe atë sipas Ligjit për OJQ dhe, nëse do të kishte ndonjë shfrytëzim tjetër, atëherë ajo do të jetë subjekt tatimi, mirëpo në asnjë mënyrë Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare nuk i detyron apo inkurajon ndonjë mënyrë tjetër të shfrytëzimit të kapitalit të dhuruar dhe suficitit të kapitalit. Siç shihet, këtu kemi një ndryshim të statutit nga OJQ mikrofinanciare në institucion mikrofinanciar shoqëri aksionare. Ligji vetëm e njeh edhe një mundësi më shumë ligjore".*

65. Duke pasur parasysh nenin 116, Ministria e Financave pohon se ky nen vetëm rregullon obligimet e institucioneve mikrofinanciare për të vepruar në përputhje me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, dhe me asgjë nuk ka të bëjë me OJQ-të që rregullohen me Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ.

Përgjigje nga Ministria e Administratës Publike - Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të

66. Më 31 dhjetor 2012, Ministria e Administratës Publike - Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të, iu përgjigj Gjykatës duke theksuar:

"...

a) Meqenëse Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare prek edhe çështjen e institucioneve mikrofinanciare të regjistruara si OJQ, konsiderojmë se është dashur të konsultohemi me rastin e hartimit të këtij ligji, bazuar në mandatin që e kemi sipas legjislacionit në fuqi;

b) Sa i përket pretendimeve në kërkesën e parashtruar, është fakt se dispozitat, të cilat kontestohen në ligj, konsiderojmë se janë në kolizion me dispozitat e Ligjit për Lirinë e Asociimit në OJQ në Republikën e Kosovës dhe, si të tilla, paraqesin konfuzion në zbatimin e tyre.

..."

Seanca dëgjimore publike

67. Më 5 mars 2013, Gjykata mbajti një seancë dëgjimore, ku ishin të pranishme dhe u dëgjuan këto palë:

a) Parashtruesi, i përfaqësuar nga znj. Shqipe Malaj, Zëvendësavokate e Popullit;

b) Komisioni për Legjislacion, i përfaqësuar nga z. Arben Gashi, kryetar i Komisionit;

c) Ministria e Financave, e përfaqësuar nga z. Lulzim Rafuna;

d) Banka Qendrore, e përfaqësuar nga z. Skënder Kllokoqi; dhe

e) Ministria e Administratës Publike - Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të, e përfaqësuar nga z. Muhamet Dabiçaj.

68. Komisioni për Legjislacion, gjatë seancës dëgjimore, ka dorëzuar në Gjykatë dokumentet në vijim:

a) Procesverbalin e takimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, të 18 janarit 2012 (Nr. 44/12);

b) Procesverbalin e takimit të Komisionit për Buxhet e Financa, të 22 marsit 2012 (Nr. 53/11);

c) Procesverbalin e takimit të Komisionit për Buxhet e Financa, të 4 prillit 2012 (Nr. 57/12); dhe

d) Procesverbalin e takimit të Komisionit për Legjislacion, të 5 prillit 2012 (Nr. 42).

69. Ministria e Financave, gjatë seancës dëgjimore, ka dorëzuar këto dokumente:

a) Transkripti i dëgjimit publik në Komisionin për Buxhet e Financa, i 8 shkurtit 2012; dhe

b) Transkripti i seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i 12 prillit 2012.

Për më tepër, Gjykata, seancës dëgjimore, me kërkesën e përfaqësuesit të MF-së, gjithashtu dëgjoi z. Jacques Boribond, si ekspert të fushës.

70. Përveç këtyre, Gjykata dëgjoi edhe z. Dastid Pallaska në cilësinë e tij si *amicus curiae*.

Parashtruesi

71. Parashtruesi, përveç kërkesës së tij, gjatë seancës dëgjimore, gojarisht pohoi: *"Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare është gjithashtu në kundërshtim me Rekomandimin CM/Rec (2007) 14, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, sepse neni 9 i këtij rekomandimi përcakton që OJQ-të nuk mund t'i shpërndajnë fitimet që mund të lindin nga aktivitetet e tyre tek anëtarët apo themeluesit e tyre, por mund t'i përdorin ato sërish për përmbushjen e synimeve të tyre"*.

72. Për më tepër, parashtruesi, gjatë seancës dëgjimore, gojarisht pohoi edhe këtë: *"Neni 9 i këtij rekomandimi qartësisht thekson që OJQ-të me subjektivitet ligjor mund të përcaktojnë një trashëgimtar për të marrë pasuritë e saj në rast të ndërprerjes së punës së saj, por vetëm pasi të jenë spastruar detyrimet dhe pasi të jenë përmbushur të drejtat e donatorëve për kthim të parave. Megjithatë, në rast se nuk ka*

trashëgimtarë të përcaktuar, nga OJQ-ja në fjalë, që ka përfituar së voni nga financat publike apo nga ndonjë formë tjetër e përkrahjes, mund të kërkohet që pasuria ose t'i transferohet një OJQ-je tjetër, ose një personi juridik që më së afërmi i përputhet synimeve të saj. Në të kundërtën, synimet e saj i vendos shteti. Për më tepër, shteti mund të jetë trashëgimtar në rastet kur synimet apo mjetet e përdorura nga OJQ-ja për t'i përmbushur ato synime janë gjetur të jenë të papranueshme".

73. Parashtruesi, gjatë seancës dëgjimore, gojarisht theksoi: *"Qëllimi i një numri të OJQ institucione mikrofinanciare për t'u transformuar në biznese, kryesisht në formë të shoqërive aksionare, është një përpjekje e hershme dhe e dokumentuar së paku që prej vitit 2004, fillimisht nëpërmjet rregulloreve të UNMIK-ut. Përpjekjet për të transformuar OJQ-të mikrofinanciare në shoqëri aksionare nga aktorët e ndryshëm nuk janë ndalur, si dhe kanë qenë të dukshme, më 2010, gjatë procesit të ndryshimit të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare. Raporti i Avokatit të Popullit, më 2010, kishte rekomanduar që gjatë procesit të shqyrtimit të ndryshimeve në Ligjin për Liri të Asocimiit në OJQ, komisionet parlamentare të marrin parasysh komentet dhe sugjerimet që dalin nga shoqëria civile, ashtu që ndryshimet dhe plotësimet në Ligj të jenë transparente dhe, si përfundim, Ligji të jetë në përputhje me standardet evropiane. Përkundër faktit që procesi i hartimit të Ligjit kishte kaluar sfida të shumta, shoqëria civile, me përkushtim dhe në bashkëpunim intensiv me bashkësinë ndërkombëtare në Kosovë, ka arritur të ndalojë futjen e elementeve që dëmtojnë kredibilitetin e shoqërisë civile në Ligjin për Liri të Asociimit në OJQ, i cili është miratuar nga Kuvendi në gusht të vitit 2011".*

74. Parashtruesi, gjatë seancës dëgjimore, gojarisht deklaroi edhe këtë: *"Edhe pse Avokati i Popullit konteston nenet e lartpërmendura në lidhje me përmbajtjen e tyre, është gjithashtu me rëndësi të theksohet që procesi i miratimit të këtij ligji është bërë në kundërshtim me Rregulloren e punës të Kuvendit dhe në kundërshtim me nenin 69.3 të Kushtetutës. Përkatësisht, neni 57 i Rregullores së punës së Kuvendit përcakton që, pas miratimit të projektligjit në lexim të parë, Kuvendi obligon që, përveç Komisionit funksional, katër komisione të tjera të përhershme duhet ta shqyrtojnë projektligjin. Megjithatë, ky projektligj nuk është shqyrtuar apo miratuar nga Komisioni parlamentar për Legjislacion i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në vend të kësaj, pas leximit dhe pas miratimit nga Komisioni për Buxhet e Financa, ka shkuar drejtpërdrejt në Kuvend për miratim. Për më tepër, sa i përket nenit 69.3 të Kushtetutës, i cili përcakton kuorumin e Kuvendit, Avokati*

i Popullit thekson që, në bazë të dokumenteve zyrtare nga Kuvendi, 58 deputetë kanë qenë të pranishëm dhe se, nga këta 58 deputetë, 54 deputetë kanë votuar për, 4 kanë abstenuar dhe asnjë nuk ka votuar kundër. Përveç kësaj, pohohet që një deputet ka informuar se ai nuk ka mundur të votojë në mënyrë elektronike, që e ngrit numrin e deputetëve të pranishëm në 59. Kjo është në kundërshtim me kuorumin e kërkuar prej 61 deputetësh të pranishëm". Gjykata thekson se kjo çështje nuk është përmendur nga parashtruesi në kërkesë.

75. Parashtruesi theksoi gojarisht, gjithashtu gjatë seancës dëgjimore: *"Të ardhurat e shoqërisë civile, për të ndërmarrë aktivitetet e tyre, vijnë kryesisht nga donatorët. Në Kosovë, rreth 80% e financimit të sektorit joqeveritar vjen nga donatorët ndërkombëtarë. Të gjithë këta donatorë japin fonde për OJQ-të, në bazë të garancive ligjore që donacionet e tyre nuk mund të përdoren për përfitime private. Lejimi i transformimit të OJQ-ve institucione mikrofinanciare do të paraqiste precedent të madh, si dhe drejtpërdrejt do të kërcënonte vazhdimësinë e përkrahjes nga donatorët për OJQ-të në Kosovë, për shkak të rrezikut që secila OJQ, në bazë të këtij precedenti, do të mund të transformohej dhe do të mund të ndërronte pronësinë e fondeve të donatorëve, duke i transformuar OJQ-të në kompani private".*

76. Gjykata thekson se, nga prezantimet që bënë palët, perceptimi është që ekzistojnë dy lloje të OJQ-ve: OJQ-të dhe OJQ-të institucione mikrofinanciare. Parashtruesi, gjatë dëgjimit, gojarisht theksoi që Ligji për Liri të Asociimit në OJQ njeh vetëm një lloj të OJQ-ve, por fushëveprimi i aktiviteteve të OJQ-ve dallon. Fushëveprimi i këtyre OJQ-ve të tjera rregullohet me ligje të veçanta.

77. Sa i përket faktit nëse Kuvendi ka pasur kuorum gjatë miratimit të ligjit të kontestuar, parashtruesi, gjatë seancës dëgjimore, theksoi gojarisht që 54 deputetë kanë votuar për, 4 deputetë kanë abstenuar, asnjë nga deputetët nuk ka votuar kundër, dhe një deputet nuk ka mundur të votojë në mënyrë elektronike. Pra, parashtruesi pohon se në seancë ka pasur 59 deputetë të pranishëm. Për më tepër, parashtruesi vazhdoi të theksojë gojarisht se thelbi i kërkesës ka të bëjë me kushtetutshmërinë e neneve të kontestuara të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.

Komisioni për Legjislacion

78. Komisioni për Legjislacion është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, për të shpjeguar në Gjykatë procedurat që janë ndjekur për

miratimin e neneve të kontestuara të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare.

79. Sipas procesverbalit të dorëzuar në Gjykatë, nga mbledhja e Komisionit për Buxhet e Financa, të 18 janarit 2012 (Nr. 44/12), Gjykata vëren që Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare është shqyrtuar nga ky komision, si dhe i është dhënë rekomandimi Kuvendit që ta miratojë këtë ligj në parim.

80. Kryetarja e Komisionit për Buxhet e Financa, sipas procesverbalit të lartpërmendur, thekson që projektligji në fjalë synon të rregullojë infrastrukturën ligjore të institucioneve bankare, institucioneve mikrofinanciare, si dhe institucioneve financiare jobankare, në kuptimin e licencimit, të mbikëqyrjes dhe të çështjeve të tjera.

81. Sipas këtij procesverbali, Ministri i Financave i asaj kohe gjithashtu kishte theksuar që Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare është harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me Bankën Botërore, si dhe është në përputhje me praktikën ndërkombëtare dhe me direktivat e Bashkimit Evropian. Është theksuar më tutje në procesverbal se ky ligj ka për qëllim shfuqizimin e rregulloreve të UNMIK-ut, që rregullojnë këtë fushë, si dhe do të përforcojë kornizën institucionale, qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e sektorit financiar. Për më tepër, sipas procesverbalit, ky ligj gjithashtu synon të përmirësojë standardet për qeverisje dhe të kufizojë mundësinë e kredive për banka dhe për persona privatë, duke i dhënë mundësi Bankës Qendrore të Kosovës të gjobisë apo të marrë masa nëse ato janë me shkelje.

82. Sipas procesverbalit të dorëzuar në Gjykatë, nga mbledhja e Komisionit për Buxhet e Financa, e 22 marsit 2012 (Nr. 53/11), Gjykata vëren që amendamentet në Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare janë miratuar nga ky komision, si dhe i është dhënë rekomandim Kuvendit për shqyrtim dhe për miratim në procedura të mëtutjeshme.

83. Gjykata vëren se, sipas procesverbalit të dorëzuar, amendamentet kanë qenë të një natyre teknike.

84. Sipas procesverbalit të dorëzuar në Gjykatë, nga mbledhja e Komisionit për Buxhet e Financa, e 4 prillit 2012 (Nr. 57/12), Gjykata vëren që OJQ BIRN ka propozuar një amendament për Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, një dispozitë që thekson se ky ligj nuk vlen për OJQ-të që nuk kanë

aktivitete financiare, pasi kjo OJQ brengosej që donatorët nuk do të dhuronin para nëse OJQ-të do të mund të transformoheshin në shoqëri aksionare. Janë ngritur edhe zëra të tjerë në mbledhjen e Komisionit për Buxhet e Financa, ku janë shtruar pyetjet: a) Kush do të jetë aksionar kur OJQ-ja transformohet në shoqëri aksionare; dhe, b) Nëse paratë e donatorëve dhe kapitali i mbetur do të shpërndahet për bamirësi, atëherë prej nga vjen kapitali i mbetur për të blerë 25% të aksioneve të bankës? Kështu, pretendimi ishte që OJQ-të mikrofinanciare nuk duhet të jenë në gjendje të transformohen në shoqëri aksionare. Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare është në konflikt me Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ, si dhe që OJQ-të mikrofinanciare duhen rregulluar me ligj të veçantë. Megjithatë, sipas procesverbalit, këto amendamente nuk janë marrë parasysh.

85. Sa i përket faktit nëse Kuvendi ka pasur kuorum në miratimin e ligjit të kontestuar, përfaqësuesi i Komisionit për Legjislacion ka theksuar gojarisht gjatë dëgjimit që nuk e di, pasi e ka braktisur seancën plenare të asaj dite.

86. Sa i përket rrethanave në vijim: 1) Cilat ishin procedurat që janë ndjekur për hyrjen në fuqi të këtij ligji; 2) Cila ka qenë data e shpalljes së këtij ligji nga Presidentja e Republikës së Kosovës; dhe, 3) Cila ka qenë data e publikimit të këtij ligji në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës; përfaqësuesi i Komisionit për Legjislacion ka theksuar gojarisht gjatë dëgjimit se nuk janë ndjekur procedurat e rregullta, pa ofruar ndonjë dokument tjetër mbështetës, dhe për pikat 2 e 3 u përgjigj se nuk e di.

Ministria e Financave

87. Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, përveç përgjigjes me shkrim, të dorëzuar në Gjykatë më 28 dhjetor 2012, theksoi gojarisht gjatë seancës dëgjimore: *"[...] Ligji për bankat nuk rregullon të drejtën e asociimit për persona në Kosovë, si dhe nuk shfuqizon asnjë nga dispozitat e Ligjit për Lirinë e Asociimit në OJQ"*.

88. Për më tepër, përfaqësuesi i Ministrisë së Financave theksoi gojarisht gjatë seancës dëgjimore: *"Neni 111 i Ligjit për bankat kërkon që secili institucion mikrofinanciar OJQ së pari të regjistrohet në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë dhe në Bankën Qendrore të Kosovës si sh. a., e pastaj institucioni mikrofinanciar OJQ duhet të trajtojë suficitin dhe kapitalin e dhuruar sipas neneve 110 dhe 112 të këtij ligji. Kjo kërkon që kapitali suficit t'i nënshtrohet tatimit, derisa kapitali i dhuruar duhet t'i kthehet donatorit, para se të formohet shoqëria aksionare. Kjo*

qartësisht do të thotë që nuk është transferim i autoritetit, por është regjistrim tërësisht i ri i një subjekti të ri juridik si shoqëri aksionare. Kështu, deklarata e parashtruesve që kompetenca e OJQ-së transferohet, nuk është në përputhje me dispozitat e Ligjit për bankat. Nuk ka dispozitë në Ligjin për banka që heq të drejtën e pasurisë, si dhe asnjë dispozitë e këtij ligji nuk është në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës. Në fakt, neni 110 i Ligjit për bankat, në mënyrë të veçantë njeh të drejtën e pronarit ndaj pasurisë së tij në të gjitha rastet. Vetëm në rastet kur nuk ka pronar, nuk ka donator dhe nuk ka qeverisje korporative, BQK-ja ndërhyn dhe harton planin për shpërndarje të pasurive. Më tutje, edhe nëse institucioni mikrofinanciar OJQ vendos të krijojë një SHA, Ligji për bankat nuk kërkon që OJQ-ja MFI të mbyllet, por shprehimisht e lejon të vazhdojë ekzistimin e tij dhe të mbajë kapitalin e dhuruar dhe kapitalin suficit, për aq sa vazhdon të jetë në përputhje me kërkesat e regjistrimit dhe rregullimit nga BQK-ja. Ky vendim për vazhdim bëhet vetëm nga menaxhmenti/pronari i OJQ-së IMF. Duhet përfunduar që neni 110 i Ligjit për bankat nuk cenon të drejtën e pronës apo lirinë e asociimit. Në fakt, ai ofron më shumë hapësirë për shpërndarje të drejtë dhe të barabartë të pasurive te llojet e tjera të OJQ-ve bamirëse me qëllim të përgjithshëm".

89. Përveç këtyre, përfaqësuesi i Ministrisë së Financave ka theksuar gojarisht gjatë seancës dëgjimore se *"OJQ-të mikrofinanciare vazhdimisht kanë qenë të rregulluara nga UNMIK-u që prej vitit 1999. Prej 1999-ës gjithmonë ka pasur ligje e rregullore të veçanta për institucionet mikrofinanciare, edhe pse kanë qenë OJQ, si Rregullorja e UNMIK-ut 1999/13, që është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 2008/28 në qershor të vitit 2008. Kjo rregullore tashmë është shfuqizuar me Ligjin për bankat".*

90. Sa i përket faktit nëse Kuvendi ka pasur kuorum kur është miratuar ligji i kontestuar, përfaqësuesi i Ministrisë së Financave, gjatë seancës dëgjimore, gojarisht ka theksuar thjesht se 61 deputetë kanë qenë të pranishëm në seancë, ndërsa 59 kanë votuar.

91. Sa i përket pyetjes se cila ka qenë baza ligjore për OJQ-të Institucione Mikrofinanciare para miratimit të ligjit të kontestuar, përfaqësuesi i MF-së theksoi gojarisht gjatë seancës dëgjimore se bazë ligjore ka qenë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/13 për licencimin e institucioneve mikrofinanciare jobankare në Kosovë; Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/28 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/13 për regjistrimin, licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve mikrofinanciare; si dhe tash Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare. Për më tepër,

përfaqësuesi i MF-së gjithashtu gojarisht theksoi gjatë seancës dëgjimore se *"ligji për ndryshimin e Ligjit mbi shoqëritë tregtare thekson që OJQ-ja nuk mund të regjistrohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, por ky ligj nuk e ndalon OJQ-në që të regjistrohet si shoqëri aksionare"*. Megjithatë, Gjykata vëren se Ligji nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, në nenin 22, vetëm përcakton që *"Neni 84 i Ligjit riformulohet me tekstin në vijim: Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të ketë si themelues dhe aksionar një apo më shumë persona fizikë apo juridikë, duke përjashtuar OJQ-të"*. Askund në Ligj nuk përcaktohet që OJQ-ja mund të regjistrohet si shoqëri aksionare.

92. Sa i përket çështjes se çfarë ndodh me një OJQ-në Institucion Mikrofinanciar kur transformohet në shoqëri aksionare, përfaqësuesi i Ministrisë së Financave theksoi gojarisht gjatë dëgjimit që ekzistojnë tri mundësi:

a) Mund të vazhdojë të ekzistojë si OJQ;

b) Mund të shpërbëhet; dhe

c) Mund të bëhet pjesë e bankës me deri në 25% të aksioneve.

Banka Qendrore

93. Përfaqësuesi i Bankës Qendrore konfirmoi gojarisht gjatë dëgjimit se qëndron prapa asaj që është dorëzuar me shkrim dhe është thënë gojarisht gjatë dëgjimit nga përfaqësuesi i Ministrisë së Financave.

Ministria e Administratës Publike - Departamenti i Regjistrimit dhe Ndërlidhjes me OJQ-të

94. Ministria e Administratës Publike - Departamenti i Regjistrimit dhe Ndërlidhjes me OJQ-të, edhe një herë theksoi gojarisht gjatë dëgjimit se ata nuk janë konsultuar gjatë përgatitjes së këtij ligji asnjëherë, si dhe, për pasojë, Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare është në kundërshtim me Ligjin për Liri të Asociimit në OJQ.

Parashtresa *Amicus Curiae*

95. Përkitazi me parashtresën *Amicus Curiae*, Gjykata përsërit se, në pajtim me rregullin 53 të Rregullores së punës, "*Gjykata, nëse e konsideron të*

nevojshme për qëllim të analizave të duhura dhe për të vendosur për rastin, mund të thërrasë ose t'i sigurojë leje një organizate ose personi për t'u paraqitur para saj, dhe për të bërë parashtresë me gojë ose me shkrim për ndonjë çështje të specifikuar nga Gjykata". Sidoqoftë, Gjykata vëren se parashtresa *Amicus Curiae* duhet të jenë në përputhje me Udhëzimin mbi Praktikat mbi Udhëzimet dhe Procedurat për Paraqitjen e Parashtresave të *Amicus Curiae*, Nr. 01/2012, të nxjerrë më 5 mars 2012.

96. Në këtë drejtim, më 18 janar 2013, Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" sh. p. k., Prishtinë, që përfaqëson AIMK, me vetiniciativë paraqiti me shkrim parashtresën *Amicus Curiae* (*Shih paragrafin 13 të këtij Aktgjykimi*). Megjithatë, Gjykata konsideron se kjo parashtresë *Amicus Curiae* nuk është e nevojshme për qëllim të analizave të duhura dhe për të vendosur për rastin që është në procedurë e sipër në këtë gjykatë, prandaj, në pajtim me rregullin 53 të Rregullores së punës dhe në pajtim me Udhëzimin mbi Praktikat mbi Udhëzimet dhe Procedurat për Paraqitjen e Parashtresave të *Amicus Curiae*, Nr. 01/2012, nuk do ta lejojë parashtrimin e së njëjtës.

97. Më 31 janar 2013, Gjykata, në pajtim me rregullin 53 të Rregullores së punës, dërgoi një ftesë për "Pallaska & Associates" sh. p. k., z. Dastid Pallaska, avokat, për t'ia paraqitur Gjykatës parashtresën *Amicus Curiae* me shkrim, që përmban qëndrimin e tij juridik për çështjet e ngritura në kërkesë përkitazi me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-09.

98. Më 7 mars 2013, z. Dastid Pallaska dorëzoi me shkrim parashtresën *Amicus Curiae*, përkitazi me vlerësimin për faktin nëse nenet: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, të ligjit të kontestuar, janë në përputhje me Kushtetutën.

99. Në këtë drejtim, *"Sipas Rekomandimit CM/Rec (2007) 14 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për statusin juridik të organizatave joqeveritare në Evropë, 'OJQ-të janë organe apo organizata vetëqeverisëse vullnetare të themeluara për të arritur synimet në thelb jofitimprurëse të themeluesve apo të anëtarëve të saj. Ato nuk përfshijnë partitë politike'. Për më tepër, sipas nenit 1(9) të Rekomandimit CM/Rec (2007) 14 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për statusin juridik të organizatave joqeveritare në Evropë, 'OJQ-të nuk duhet të shpërndajnë asnjë nga fitimet që mund të lindin nga aktivitetet e tyre tek anëtarët apo themeluesit e tyre, por mund t'i përdorin ato për përmbushjen e synimeve të tyre'. Kjo ndalesë përsëritet dhe përforcohet në nenin B(54) të Rekomandimit CM/Rec*

(2007) 14 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për statusin juridik të organizatave joqeveritare në Evropë, i cili thotë që 'OJQ-të me subjektivitet juridik nuk duhet të shfrytëzojnë pasurinë e fituar në baza të liruara prej tatimit për qëllime që nuk janë të liruara nga tatimi'. Parimet e lartpërmendura të Rekomandimit të CM/Rec (2007) 14 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për statusin juridik të organizatave joqeveritare në Evropë janë të mishëruara në Ligjin për OJQ".

100. Për më tepër, parashtresa me shkrim shpjegon: *"Përveç asaj që u tha më lart, duhet theksuar që Ligji për OJQ në nenin 16.3 gjithashtu përcakton që 'OJQ-ja mund të ketë pronë dhe të menaxhojë prona e pasuri për arritjen e qëllimeve të veta jofitimprurëse'. Parimet e definuara më lart tregojnë qartë që, përveç nëse specifikohet ndryshe me ligj, OJQ-të kanë të drejtë të jenë pronare të pronës së luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të pasurive të tjera, por, në asnjë rrethanë, ato pasuri e përfitime të një OJQ-je nuk mund të përdoren për të siguruar përfitime, të drejtpërdrejta apo të tërthorta, për asnjë themelues, drejtor, zyrtar, anëtar, punëtor, apo donator të OJQ-së, përveç pagesës së kompensimeve të arsyeshme për ata persona për punën e kryer për organizatën".*

101. Përveç këtyre, parashtresa me shkrim thekson: *"Ligji për OJQ është i vetmi ligj në Kosovë që rregullon themelimin e OJQ-ve, qeverisjen e tyre, të drejtat ligjore dhe obligimet, si dhe shpërbërjen e vullnetshme të OJQ-ve. Në këtë drejtim, Ligji për OJQ-të përfaqëson të vetmin ligj në Kosovë në lidhje me këtë fushë. Kur thuhet kjo, duhet theksuar që rregullatori i sektorit financiar dhe ushtrimi i aktiviteteve financiare është Banka Qendrore e Kosovës, e përmendur më tutje si BQK, e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe për rregullimin e sektorit financiar". "Megjithatë, derisa BQK-ja me ligjin e kontestuar mbetet rregullatori i aktivitetit të licencuar financiar që mund të ushtrohet nga një OJQ dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen, menaxhimin dhe rregullimin e administrimit të detyruar dhe likuidimin e një OJQ-je të tillë, BQK-ja në asnjë formë as mënyrë nuk e zëvendëson autoritetin e Departamentit për Regjistrim të OJQ-ve në Ministrinë e Administratës Publike. Kështu, këto dy funksione nuk duhet përzier, si dhe fakti që OJQ-ja ka një licencë për ushtrim të aktivitetit financiar nga BQK-ja nuk do të thotë në asnjë mënyrë apo formë që kjo ndikon apo ndryshon statusin juridik të një OJQ-je të tillë".*

102. Sipas parashtresës me shkrim, *"neni 111 është në konflikt me natyrën jofitimprurëse dhe me qëllimin e OJQ-ve, të përcaktuar me Ligjin e OJQ-ve, si dhe me dispozitat e tjera të ligjit të kontestuar, duke*

përfshirë nenet: 90, 95 (1.6) dhe 110, si dhe, si rezultati i kësaj, cenon nenin 44 dhe nenin 46 të Kushtetutës". "Gjegjësisht, neni 111 përcakton që për regjistrimin e një OJQ-je institucion mikrofinanciar si shoqëri aksionare në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë dhe BQK-së, një institucion i tillë mikrofinanciar OJQ duhet të respektojë kërkesat e parapara me nenet: 110 dhe 112, të ligjit të kontestuar, në lidhje me kapitalin e dhuruar. Sipas nenit 111, "çdo përdorim i kapitalit të dhuruar apo kapitalit suficit i nënshtrohet tatimit nga Administrata Tatimore e Kosovës".

103. Siç shpjegon parashtresa me shkrim, *"fjalia e dytë e nenit 111 të ligjit të kontestuar, e cila thotë që 'çdo përdorim i kapitalit të dhuruar apo kapitalit suficit i nënshtrohet tatimit nga Administrata Tatimore e Kosovës', është në kundërthënie të qartë me nenet: 90, 95 (1.6) dhe 110 të ligjit të kontestuar. Pra, kjo fjali nënkupton që kapitali i dhuruar mund të përdoret për një aktivitet që nuk është brenda fushëveprimit të natyrës jofitimprurëse të OJQ-së, që ndalohet rreptësisht nga nenet: 90, 95 (1.6) si dhe 110 të ligjit të kontestuar".*

104. Më tej, sipas parashtresës me shkrim, *"[...] transformimi i një OJQ-je institucion mikrofinanciar në shoqëri aksionare përbën shkelje të rëndë të neneve: 90, 95 (1.6) dhe 110 të ligjit të kontestuar; të nenit 4 të Ligjit për OJQ-të; si dhe të neneve: 44 e 46, të Kushtetutës, sepse prona dhe pasuritë e krijuara nga aktivitetet e liruara nga tatimi të një OJQ-je i transferohen kompanive private profitabile".*

105. Për më tepër, sipas parashtresës me shkrim, *"[...] neni 111 i ligjit të kontestuar nuk specifikon se kush janë apo kush do të ishin titullarët e të drejtave pronësore në shoqëritë aksionare të themeluara që do të merrnin fondet nga OJQ-të institucione mikrofinanciare. Kjo do të thotë që fondet nga një OJQ institucion mikrofinanciar, pas tatimimit, mund të përdoren për çfarëdo qëllimi dhe do të transferohen në pronësi të kompanive fitimprurëse, pronarët e të cilave janë të panjohur".*

106. Në këtë drejtim, parashtresa me shkrim më tutje thekson se, *"përveç këtyre si më lart, aplikimi i nenit 111 të ligjit të kontestuar, duke lejuar bartjen e të ardhurave dhe pasurive të një OJQ-je institucion mikrofinanciar tek organizatat afariste fitimprurëse, privon OJQ-në nga të drejtat e pronës që ajo OJQ do t'i përfitonte nga shpërndarja e suficitit të mbetur pas shpërbërjes së vullnetshme apo të pavullnetshme të OJQ-së institucion mikrofinanciar".*

Pranueshmëria e kërkesës

107. Përkitazi me kërkesën e parashtruesit që nenet: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, e Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012, janë jokushtetuese, Gjykata vëren se, për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

108. Gjykata, së pari, duhet të përcaktojë nëse parashtruesi mund të konsiderohet palë e autorizuar, në pajtim me nenin 113.2 të Kushtetutës:

"Kuvendi i Kosovës, Kryetari i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) Çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutë;"

dhe në pajtim me nenin 135.4 të Kushtetutës, që përcakton:

"Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj kushtetute".

109. Në kërkesën konkrete, Avokati i Popullit konteston kushtetutshmërinë e neneve: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012. Prandaj, parashtruesi është palë e autorizuar, e caktuar të referojë këtë rast në Gjykatë, në bazë të nenit 113. 2 dhe të nenit 135.4 të Kushtetutës.

110. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Kushtetuta i jep Avokatit të Popullit autorizim për të iniciuar kërkesa në Gjykatë Kushtetuese "përkitazi me përputhshmërinë e ligjeve, të dekreteve të Presidentit dhe të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë me Kushtetutën". Ngjashëm me këtë, nënparagrafi (b), i nenit 113.2, përcakton se Avokati i Popullit është gjithashtu i autorizuar të iniciojë kërkesa për "harmonizimin e statutit të Komunës me Kushtetutën". Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se gjuha e nenit 113.2 të Kushtetutës është e qartë dhe pa ekuivoke, se autorizimi i Avokatit të Popullit për të iniciuar kërkesa në Gjykatë Kushtetuese nuk është i kufizuar sipas Kapitullit II të Kushtetutës.

111. Për më tepër, sipas kërkesës së mëtejme të nenit 30 të Ligjit se parashtruesi duhet të ketë dorëzuar kërkesë "brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar", Gjykata përcakton që Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, ka hyrë në fuqi më 12 prill 2012, ndërsa parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën në Gjykatë më 11 tetor 2012. Parashtruesi, prandaj, e ka përmbushur afatin e nevojshëm kohor për të parashtruar kërkesë në Gjykatë, siç parashikohet me nenin 30 të Kushtetutës.

112. Pasi parashtruesi është palë e autorizuar, e ka përmbushur afatin e nevojshëm kohor për të parashtruar kërkesë në Gjykatë dhe me saktësi ka përshkruar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës, duke përfshirë ligjin e kontestuar të Kuvendit, Gjykata konstaton se parashtruesi i është përmbajtur kriterit të pranueshmërisë.

Vlerësimi kushtetutshmërisë së kërkesës

113. Gjatë vlerësimit të kësaj kërkese, Gjykata duhet të marrë parasysh, në përgjithësi, se i tërë legjislacioni supozohet të jetë kushtetues, derisa nuk dëshmohet e kundërta. Mandati i Gjykatës është vetëm të shqyrtojë kushtetutshmërinë e një vendimi ose të një akti legjislativ dhe jo të shqyrtojë ligjshmërinë e tij, apo nëse është mbështetur me politika të mira publike.

I. Sa i përket përmbajtjes së neneve të kontestuara të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093

114. Në Republikën e Kosovës dhe në pjesët e tjera të botës, organizatat joqeveritare japin një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin dhe për realizimin e demokracisë dhe të të drejtave të njeriut, në veçanti nëpërmjet promovimit të vetëdijes publike, pjesëmarrjes në jetën publike dhe sigurimit të transparencës e të përgjegjësisë së autoriteteve publike.

115. Kjo rëndësi është e reflektuar, gjithashtu, edhe me nenin 44 [Liria e Asociimit] të Kushtetutës, duke garantuar të drejtën për lirinë e asociimit. Neni 44 [Liria e Asociimit] i Kushtetutës përcakton: "*Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate*", për aq kohë sa organizatat

ose veprimtaritë nuk cenojnë rendin kushtetues, nuk shkelin të drejtat e njeriut ose nuk nxisin urrejtje racore, kombëtare, etnike apo fetare.

116. Për më tepër, organizatat joqeveritare janë të rregulluara edhe me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, Nr. 04/L-057, që përcakton themelimin, regjistrimin, menaxhimin e brendshëm, veprimtarinë, shpërbërjen dhe heqjen nga regjistri i personave juridikë të organizuar si OJQ në Kosovë.

117. Përveç Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Kuvendi miratoi/adoptoi edhe Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, e 12 prillit 2012, për të nxitur dhe për të mbajtur stabil një sistem financiar, nëpërmjet promovimit të shëndoshë dhe të matur të menaxhimit të bankave, të institucioneve mikrofinanciare dhe të institucioneve të tjera jofinanciare dhe nëpërmjet sigurimit të një niveli të përshtatshëm të mbrojtjes për interesin e depozituesve.

118. Përkitazi me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, e 12 prillit 2012, parashtruesi konteston nenet të cilat parashohin që institucionet mikrofinanciare OJQ mund të transformohen në shoqëri aksionare.

119. Neni 90 i Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, përcakton që një OJQ Institucion Mikrofinanciar është një institucion mikrofinanciar që është regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike për qëllimet e lirimit nga taksat, si dhe në BQK si një organizatë joqeveritare që ka për mision të saj qëllimin bamirës. Një institucion mikrofinanciar OJQ nuk lejohet të shesë ose të transferojë veprimtarinë e vet, të bashkohet ose të ndryshojë strukturën e vet, e as nuk lejohet të shpërndajë ose në ndonjë mënyrë të paguajë fitimet, suficitin e kapitalit, dividentat ose ndonjë nga aktivat e saj, përveç asaj që është në përputhje me këtë ligj.

120. Neni 95 (1.6) i Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, përcakton që një institucion mikrofinanciar OJQ nuk lejohet të shesë ose të transferojë veprimtarinë e vet, të bashkojë, të ndajë ose të ndryshojë në ndonjë mënyrë tjetër strukturën, misionin ose pronësinë e tij, përveç në përputhje me dispozitat për likuidim vullnetar dhe likuidim të detyruar ose administrim zyrtar, siç parashihet me këtë ligj dhe me miratimin me shkrim të BQK-së.

121. Përveç kësaj, neni 110 i Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, përcakton: *"Në rast të likuidimit vullnetar, likuidimit të detyruar të një institucioni mikrofinanciar OJQ, çdo kapital i mbetur i dhuruar ose suficit i kapitalit duhet t'iu kthehet donatorëve fillestarë ose të shpërndahet për qëllime bamirësie në Kosovë, siç mund të kërkohet nga donatorët fillestarë. Nëse kapitali fillestar i donatorit nuk kthehet, kapitali i dhuruar dhe suficiti i kapitalit do të shpërndahet për qëllime bamirësie sipas ligjeve në fuqi dhe planit të miratuar nga BQK-ja".* Në këtë drejtim, *"As BQK-ja, e as anëtarët e organeve vendimmarrëse të BQK-së, ose personat e lidhur me BQK-në, nuk lejohen të përfitojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga ndonjë plan i shpërndarjes për bamirësi të kapitalit të dhuruar dhe suficit të kapitalit".*

122. Neni 111 i Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare përcakton procedurat që duhet ndjekur një institucion mikrofinanciar OJQ për t'u regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë dhe në BQK, si një institucion mikrofinanciar shoqëri aksionare.

"...

Neni 111 - Procedurat

1. *Çdo institucion mikrofinanciar OJQ, për t'u regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë dhe në BQK si institucion mikrofinanciar shoqëri aksionare, duhet të zbatojë dispozitat e nenit 110 dhe të nenit 112 të këtij ligji për kapital të dhuruar. Çdo shfrytëzim i kapitalit të dhuruar ose suficitit të kapitalit i nënshtrohet vendosjes së taksave nga Administrata Tatimore e Kosovës. Dëshmia e pajtueshmërisë me Administratën Tatimore të Kosovës duhet t'i paraqitet Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë ose pasardhësit të saj si pjesë e regjistrimit si shoqëri aksionare dhe po ashtu duhet t'i paraqitet BQK-së. Pas regjistrimit si shoqëri aksionare në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë, regjistrimi institucion mikrofinanciar OJQ në BQK duhet të pushojë dhe regjistrimi i ri i institucionit mikrofinanciar si shoqëri aksionare duhet të kompletohet dhe dorëzohet në BQK brenda dy (2) javësh.*

2. *Regjistrimi si institucion mikrofinanciar OJQ mbetet në fuqi deri në pushimin e tij, megjithatë është përgjegjësi e institucionit mikrofinanciar që t'ia paraqesë BQK-së kërkesën për regjistrim të institucionit mikrofinanciar si shoqëri aksionare.*

3. *Institucioni mikrofinanciar gjithashtu kërkohet që ta njoftojë Ministrinë e Administratës Publike me qëllim të heqjes së statusit për lirimin nga tatimi si OJQ.*

...".

123. Neni 116 i Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare parasheh:

"...

Neni 116 - Dispozitat kalimtare për institucionet mikrofinanciare

1. *Të gjitha institucionet ekzistuese mikrofinanciare duhet t'i plotësojnë kërkesat e këtij ligji së bashku me të gjitha rregulloret dhe urdhëresat në fuqi të BQK-së gjatë veprimtarive të tyre dhe kërkohen të aplikojnë për regjistrim të ri jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.*

2. *Pas paraqitjes së aplikacionit dhe kompletimit të regjistrimit në BQK sipas këtij ligji, institucionet mikrofinanciare OJQ nuk do të rregullohen më tej nga Ministria e Administratës Publike.*

...".

124. Në këtë kërkesë, parashtruesi ankohet se nenet e lartpërmendura të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare janë në kundërshtim me nenin 44 [Liria e Asociimit] të Kushtetutës, sepse, duke lejuar institucionet mikrofinanciare OJQ për t'u transformuar në një institucion mikrofinanciar shoqëri aksionare, do të bien jashtë fushëveprimit të nenit 44 të Kushtetutës dhe do të pengohet e drejta e tyre për të vepruar në bazë të së drejtës së shoqatës.

125. Parashtruesi pretendon më tej se, duke lejuar një institucion mikrofinanciar OJQ të shndërrohet në një institucion mikrofinanciar shoqëri aksionare, kjo nuk është në përputhje me ligjin e zbatueshëm në Kosovë dhe me parimet ndërkombëtare të ligjit jofitimprurës. Përkitazi me këtë, parashtruesi i kërkesës pohon se Ligji për Lirinë e Asociimit në OJQ (ka hyrë në fuqi më 24 shtator 2011), neni 4, paragrafi 2 dhe paragrafi 3; neni 11 dhe neni 20, nuk lejon që një OJQ të shndërrohet në një entitet tjetër juridik. Ligji për Liri të Asociimit në OJQ është ligji i vetëm në Kosovë që rregullon themelimin e OJQ-ve, qeverisjen e tyre, të

drejtat ligjore dhe obligimet, si dhe shpërbërjen vullnetare të OJQ-ve. Sa i përket kësaj, ky ligj është ligji i vetëm për këtë objekt të çështjes.

126. Gjykata rikujton se parimi i sigurisë juridike është një nga parimet themelore të rendit kushtetuese të Republikës së Kosovës (*Shih rastet KO29/12 dhe KO48/12, Amendamentet e propozuara të Kushtetutës, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe më 4 maj 2012, Aktgjykimi i 20 korrikut 2012*).

127. Në këtë drejtim, Gjykata është shprehur në rastin e saj KO61/12 se, "[...] në pajtim me nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës, '*Kuvendi i Republikës së Kosovës: (l) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme'. Pyetja, pra, lind nëse një ligj për amnisti mund të caktojë një listë të 'personave të caktuar me emër', pasi një ligj duhet të posedojë cilësinë e një norme të përgjithshme, abstrakt në natyrë, me qëllimin që synon të rregullojë dhe të jetë i arritshëm dhe i parashikueshëm në zbatimin dhe pasojat e tij për të gjithë personat. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ku kërkesat për klasifikim si një ligj kanë qenë të krijuara në lidhje me ankesat në bazë të këtyre neneve të KEDNJ-së dhe të protokolleve të saj, të cilat përfshijnë kërkesat e 'ligjshmërisë': nenet 5 (1), 7, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNJ-së, neni 1 i Protokollit nr. 1, neni 2 i Protokollit nr. 4 dhe neni 1 i Protokollit nr. 7. Këto kërkesa janë riparaqitur shumë herë në një formulë që, deri tani, është bërë standarde dhe është përsëritur kohët e fundit në Centro Europa 7 S.R.L. dhe në Rastin di Stefano kundër Italisë ([GC] nr. 38433/09, paragrafët 141-142, 7 qershor 2012.): '[...] një normë nuk mund të konsiderohet si një 'ligj' përveç nëse është formuluar me përpikëri të mjaftueshme për të mundësuar qytetarit që të rregullojë sjelljen e tij: ai duhet të jetë në gjendje, në rast nevoje me këshillimin e duhur – që të parashikojë, deri në një shkallë që është e arsyeshme sipas rrethanave, pasojat që një veprim i caktuar mund të shkaktojë. Këto pasoja nuk duhet të jenë të parashikueshme me siguri absolute: përvoja tregon që kjo të jetë e paarritshme. Përsëri, përderisa siguria është shumë e dëshirueshme, ajo mund të sjellë në rrjedhën e vet rigorozitet të tepruar dhe ligji duhet të jetë në gjendje të ecë në hap me rrethanat që ndryshojnë. Prandaj, shumë ligje janë shtrirë në mënyrë të pashmangshme, në kuptimin që, në një masë më të madhe ose më të vogël, janë të paqarta dhe interpretimi dhe zbatimi i të cilave është çështje e praktikës. Niveli i saktësisë që kërkohet nga legjislacioni vendas - që nuk mundet në çdo rast të sigurohet për çdo eventualitet - varet në një masë të konsiderueshme nga përmbajtja e ligjit në fjalë, fusha është projektuar për të mbuluar edhe numrin edhe statusin e atyre të cilëve u është adresuar. Gjykata vlerëson se, në qoftë se një listë e personave 'të*

caktuar me emër' është themeluar me ligj, një ligj i tillë nuk do të kënaqë standardin e cituar më lart të GJEDNJ-së, pasi pasojat e tij nuk do të jenë të parashikueshme në një shkallë që është e arsyeshme nga rrethanat'. (Shih Rastin KO61/12, Konfirmim i ndryshimeve të propozuara kushtetuese, të parashtruara nga ana e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 22 qershor 2012, me anë të letrës nr. 04- DO-1095, Aktgjykimi i 31 tetorit 2012).

128. Gjykata është e vetëdijshme për ekzistencën e parimit të *Lex Specialis*, që nënkupton se ligji special ka përparësi ndaj ligjit të përgjithshëm dhe, në këtë drejtim, një ligj i ri nuk mund të anulojë dispozitat e një ligji ekzistues pa ndryshuar dispozitat relevante, të cilat përbëjnë parimet e përgjithshme, të drejtat dhe obligimet e OJQ-ve, sepse kjo do të vinte në rrezik parimet e sigurisë juridike dhe sundimin e ligjit.

129. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare është një ligj i përgjithshëm, që rregullon sektorin bankar dhe financiar, ndërsa Ligji për Lirinë e Asociimit në OJQ rregullon në mënyrë specifike të drejtat dhe detyrimet e OJQ-ve.

130. Përveç kësaj, Gjykata rikujton se autoritetet kanë një detyrim kushtetues për të siguruar zbatimin uniform të ligjeve; prandaj ky detyrim kushtetues mund të pengohet duke futur dispozita të cilat kundërshtojnë plotësisht dispozitat ekzistuese përkatëse të ligjit për OJQ-të, pa i ndryshuar ato dispozita në të njëjtën kohë (*Shih paragrafin 126 dhe 127).*

131. Parashtruesi, më tej, vazhdon pohimet e tij, duke iu referuar nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Ankohet se nenet e kontestuara të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare janë në kundërshtim me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, sepse, duke i lejuar institucionet mikrofinanciare OJQ të transformohen në një shoqëri aksionare, në mënyrë arbitrare tjetërsohen pasuritë e OJQ-ve, duke transferuar mjetet nga OJQ-të te persona të tjerë juridikë apo fizikë për aksione, që do të thotë se prona dhe pasuria që krijohen nga aktivitetet që janë të liruara nga tatimet e një OJQ-je u transferohen kompanive private fitimprurëse.

132. Gjykata rikujton se pasuritë që janë pronë e OJQ-ve mund të shfrytëzohen vetëm në funksion të përmbushjes së qëllimeve dhe të objektivave mbi të cilat janë themeluar OJQ-të në përputhje me parimin e shpërndarjes jofitimprurëse. Prandaj, transferimi i pronësisë mbi

pasuritë e OJQ-ve për çdo person fizik apo juridik, do të jetë kundër këtij parimi.

133. Për më tepër, Gjykata rithekson se OJQ-të janë konsideruar të jenë një aktor shumë i rëndësishëm dhe të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e zhvillimit të shoqërive demokratike dhe në promovimin e të drejtave të njeriut. Prandaj, transformimi i OJQ-ve në një shoqëri aksionare, do të devijojë qëllimin fillestar të ekzistencës së OJQ-ve dhe mund të dëmtojë seriozisht një nga elementet themelorë të demokracisë.

134. Parashtruesi, gjithashtu, ankohet se, në kundërshtim me nenin 10 [Ekonomia] të Kushtetutës, Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, lejon që kapitali i fituar pa pagesë të taksave të injektohet në konkurrencën e tregut komercial ndërmjet bankave dhe institucioneve të tjera financiare, të cilat janë të detyruara të paguajnë taksa që nga themelimi i tyre.

135. Në këtë drejtim, pasi OJQ-të mikrofinanciare rrisin fondet e tyre dhe rrisin pasuritë e tyre kryesisht nëpërmjet marrjes së granteve nga donatorët, qoftë nga brenda apo nga jashtë vendit, për arsye se ata nuk janë të detyruar të paguajnë taksat, nga transformimi prej një OJQ-je në një shoqëri aksionare, kjo i vë në disavantazh komercial institucionet e tjera që paguajnë rregullisht taksa, në përputhje me ligjet në fuqi.

136. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pohon se nenet e kontestuara të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare janë në kundërshtim me Rekomandimin CM/Rec (2007) 14 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për statusin ligjor të organizatave joqeveritare në Evropë (miratuar më 10 tetor 2007).

137. Gjykata vëren se ky rekomandim nuk është një instrument detyrues juridik, por vetëm një rekomandim. Megjithatë, përmban parimet universale demokratike, të cilave duhet t'i përmbahen OJQ-të, e të cilat janë respektuar dhe janë zbatuar gjerësisht në shoqëritë demokratike.

II. Sa i përket procedurës së ndjekur në miratimin e neneve të kontestuara të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093

138. Gjykata vëren se, në bazë të kërkesës së dorëzuar, parashtruesi nuk e ka ngritur çështjen e aspektit procedural të miratimit të këtij ligji.

Megjithatë, gjatë seancës dëgjimore publike, aspekti procedural i miratimit të këtij ligji ishte ngritur nga parashtruesi i kërkesës. Përkatësisht, parashtruesi pretendoi se ka munguar kuorumi i kërkuar për miratimin e këtij ligji.

139. Për këtë, Gjykata i referohet nenit 69.3 [Orari i Seancave dhe Kuorumi] të Kushtetutës, i cili parasheh: "*Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve të Kuvendit*".

140. Për më tepër, neni 51 i Rregullores së punës të Kuvendit, parasheh qartë: *"Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit"* dhe *"Vendimet e mbledhjeve të Kuvendit janë të vlefshme, në qoftë se në kohën kur ato janë marrë, në sallë kanë qenë më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit"*. Ky nen i Rregullores së punës të Kuvendit parasheh edhe: *"Ligjet, vendimet dhe aktet e tjera të Kuvendit konsiderohen të miratuara nëse për to votojnë shumica e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë"*.

141. Sa i përket kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së vet gjyqësore, në veçanti Rastit KO29/11, Sabri Hamiti dhe deputetët e tjerë – Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 04-V-04, përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, të 22 shkurtit 2011, ku është vendosur se *"[...] deputetët e Kuvendit janë përfaqësuesit e popullit dhe do të kenë të drejta të barabarta dhe obligim që të marrin pjesë plotësisht në procedurat e Kuvendit dhe do t'i ndjekin detyrat si përfaqësues të njerëzve të Kosovës në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe Rregulloren e punës së Kuvendit. Kjo do të thotë, duke marrë votën e qytetarëve, deputetët kanë obligime ndaj atyre, inter alia, siç përcaktohet në nenin 40 [Obligimet] të Ligjit për deputetë, duke qenë të obliguar të marrin pjesë në seancat plenare [...]"* dhe *[...] "të gjithë 120 deputetët e Kuvendit duhet të ndjehen të obliguar sipas Kushtetutës, Ligjit për deputetët, Rregullores së punës së Kuvendit dhe Kodit të sjelljes të marrin pjese në seancat plenare të Kuvendit dhe të përkrahin procedurat që parashihen aty",* që do të thotë se deputeti konsiderohet se është duke marrë pjesë në seancë vetëm nëse ai/ajo i plotëson të gjitha obligimet e lartpërmendura, që nënkupton hedhjen e votës: qoftë për, qoftë kundër, qoftë abstenim.

142. Përveç kësaj, Gjykata vëren se procedura e kërkuar për hyrjen në fuqi të një ligji të Kuvendit duhet t'i përmbahet nenit 80.6 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës.

143. Në rastin e tanishëm, Gjykata vëren që neni 118 i Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare përcakton se ky ligj hyn në fuqi në datën e njëjtë në të cilën është miratuar nga Kuvendi, d.m.th., më 12 prill 2012.

144. Sa i përket kësaj, Gjykata vëren se, sipas nenit 80.6 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës, *"Ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse me vetë ligjin nuk përcaktohet ndryshe"*. Periudha prej 15 ditësh, siç parashihet me këtë nen, mund të shkurtohet nëse përcaktohet ndryshe nga vetë ligji, por kjo nuk mund të jetë periudhë më e shkurtër sesa parashihet në formën e publikuar në Gazetën Zyrtare. Qëllimi i publikimit të një ligji është një kusht i detyrueshëm për të vetëdijesuar shoqërinë se cilat rregulla duhet ndjekur dhe për të përshtatur sjelljen dhe veprimet konform atij ligji. Kjo është një kërkesë bazë dhe e domosdoshme për sundimin e ligjit.

145. Për me tepër, sipas nenit 80.2 të Kushtetutës, ligjet e miratuara nga Kuvendi do të shpallen pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda tetë (8) ditësh pasi Presidenti të ketë marrë ligjin. E, Presidenti i Republikës së Kosovës e shpalli këtë ligj më 30 prill 2012. Prandaj, në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit, në kundërshtim me parimin e sigurisë ligjore dhe në kundërshtim me procedurat e lartpërmendura, Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare kishte hyrë në fuqi në ditën kur ende nuk ishte bërë ligj, sepse ligji nuk ishte shpallur nga Presidenti i Republikës së Kosovës deri më 30 prill 2012.

146. Përfundimisht, Gjykata rithekson se parashtruesi i kërkesës, në bazë të nenit 29.3 të Ligjit, ka një detyrim në kërkesë "*të specifikojë kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar"*. Megjithatë, parashtruesi ka dështuar të përmbushë bindshëm këtë kërkesë dhe nuk ka dorëzuar asnjë prej dokumenteve mbështetëse për ta mbështetur këtë kërkesë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim të nenit 113.2 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 20 dhe me nenin 27 të Ligjit; si dhe në pajtim me rregullin 54, me rregullin 55 dhe me rregullin 56 të Rregullores së punës, më 14 mars 2013,

VENDOSI

I. Njëzëri, TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. Me shumicë, TË SHPALLË që nenet: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, e Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012, nuk janë në përputhje me nenin 10 [Ekonomia], me nenin 44 [Liria e Asociimit] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

III. Vendos që nenet: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, e Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012, janë të pavlefshme;

IV. Vendos që Vendimi i Gjykatës për zgjatjen e Masës së përkohshme, i 24 janarit 2013, Nr. ref.: MP354/13, për pezullimin dhe zbatimin e neneve: 90, 95 (1.6), 110 dhe 116 të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, i 12 prillit 2012, përfundon pas hyrjes në fuqi të këtij aktgjykimi;

V. URDHËRON që ky aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare; dhe,

VI. TË SHPALLË se ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

MENDIM MOSPAJTUES
në
Rastin Nr. KO97/12
Parashtrues
Avokati i Popullit
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për Ligjit për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012

Shumica kanë deklaruar se nenet 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare janë në mospërputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, duke sugjeruar se këto nene të ligjit nuk janë në përputhje me nenet 10, 44 dhe 46 të Kushtetutës. Konkludimi i shumicës bazohet në interpretimin e gabueshëm të Kushtetutës.

Ligji i aplikueshëm

Neni 90 i ligjit përkufizon: "Kapital;" "Kapital aksionar;" "Kapital i dhuruar;" "Hua;" "Kufijtë e huas;" "Amvisëria me të hyra të ulëta;" "Individi me të hyra të ulëta;" "Institucioni mikrofinanciar OJQ;" "SNRF;" dhe "Suficiti i kapitalit." Ai gjithashtu parasheh:

> *Një institucion mikrofinanciar OJQ nuk lejohet të shesë ose transferojë veprimtarinë e saj, të bashkohet ose të ndryshojë strukturën e saj, e as nuk lejohet të shpërndajë ose në ndonjë mënyrë të paguajë fitimet, suficitin e kapitalit, dividentat ose ndonjë nga aktivat e saj, përveç asaj që është në përputhje me këtë ligj.*

Neni 95(1.6) i këtij ligji parasheh:

> Institucioni mikrofinanciar OJQ nuk lejohet të shesë ose transferojë veprimtarinë e tij, të bashkojë, ndajë ose ndryshojë në ndonjë mënyrë tjetër strukturën, misionin ose pronësinë e tij, përveç në përputhje me dispozitat për likuidim vullnetar dhe likuidim të detyruar ose administrimi zyrtar, siç parashihet me në këtë ligj dhe me miratimin me shkrim të BQK-së;

Neni 110 i këtij ligji parasheh:

1. Në rast të likuidimit vullnetar, likuidimit të detyruar të një institucion mikrofinanciar OJQ, çdo kapital i mbetur i dhuruar ose suficit i kapitalit duhet t'iu kthehet donatorëve fillestar ose të shpërndahet për qëllime bamirësie në Kosovë siç mund të kërkohet nga donatorët fillestar. Nëse kapitali fillestar i donatorit nuk kthehet, kapitali i dhuruar dhe suficiti i kapitalit do të shpërndahet për qëllime bamirësie sipas ligjeve në fuqi dhe planit të miratuar nga BQK-ja.
2. As BQK-ja, e as anëtarët e organeve vendim-marrëse të BQK-së, ose personat e lidhur me BQK-në, nuk lejohen të përfitojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga ndonjë plan i shpërndarjes për bamirësi të kapitalit të dhuruar dhe suficitit të kapitalit.

Neni 111 i këtij ligji parasheh:

1. Çdo institucion mikrofinanciar OJQ për tu regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe në BQK si institucion mikrofinanciar shoqëri aksionare duhet të zbatoj dispozitat e nenit 110 dhe të nenit 112 të këtij ligji për kapital të dhuruar. Çdo shfrytëzim i kapitalit të dhuruar ose suficitit të kapitalit i nënshtrohet vendosjes së taksave nga Administrata Tatimore e Kosovë. Dëshmia e pajtueshmërisë me Administratën Tatimore të Kosovës duhet t'i paraqitet Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë ose pasardhësit të saj si pjesë e regjistrimit si shoqëri aksionare dhe po ashtu duhet t'i paraqitet BQK-së. Pas regjistrimit si shoqëri aksionare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, regjistrimit institucioni mikrofinanciar OJQ në BQK duhet të pushojë dhe regjistrimi i ri i institucionit mikrofinanciar si shoqëri aksionare duhet të kompletohet dhe dorëzohet në BQK brenda dy (2)javësh.
2. Regjistrimi si institucioni mikrofinanciar OJQ mbetet në fuqi deri në pushimin e tij, megjithatë është përgjegjësi e institucionit mikrofinanciar që t'ia paraqes BQK-së kërkesën për regjistrim të institucionit mikrofinanciar si shoqëri aksionare.

Neni 116 i këtij ligji parasheh:

> *1. Të gjitha institucionet ekzistuese mikrofinanciare duhet t'i plotësojnë kërkesat e këtij ligji së bashku me të gjitha rregulloret dhe urdhëresat në fuqi të BQK-së gjatë veprimtarive të tyre dhe kërkohen të aplikojnë për regjistrim të ri jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.*
>
> *2. Pas paraqitjes së aplikacionit dhe kompletimit të regjistrimit në BQK sipas këtij ligji, institucionet mikrofinanciare OJQ nuk do të rregullohen më tej nga Ministria e Administratës Publike.*

Sipas këtij ligji, nëse një institucion mikrofinanciar OJQ vullnetarisht likuidon pasurinë e saj, ose në qoftë se ajo është e detyruar në falimentim, në pajtim me zbatimin e një ligji, çdo kapital i mbetur që ajo mund të ketë pas kësaj duhet që: (1) ose tu kthehet donatorëve fillestarë, ose, (2) të shpërndahet në organizata përkatëse bamirësie sipas udhëzimeve nga donatorët fillestarë. A do të bëjë Banka Qendrore e Kosovës shpërndarjen e duhur të bamirësisë si OJQ-të e tjera vetëm në ato situata ku suficiti i kapitalit nuk është kthyer ose shpërndarë në një organizatë përkatëse bamirëse. Ky ligj nuk merr pronë nga askush apo nga ndonjë subjekt juridik, përveç nëse ata zgjedhin që tu merret në këtë mënyrë duke dështuar të caktojnë ku do të transferohet teprica e tij ose kapitali i tepërt.

Ky ligj thjesht rregullon çdo subjekt ligjor, duke përfshirë institucionet mikrofinanciare, të cilat tentojnë të veprojnë si banka ose i kryejnë punët e ngjashme me banka në shumë aspekte. Nëse një OJQ vullnetarisht vendos të veprojë në atë mënyrë, atëherë ky ligj kërkon që ato OJQ t'i nënshtrohen juridiksionit të Bankës Qendrore të Kosovës dhe t'i përmbahen rregullave të tyre në lidhje me atë se si bankat dhe institucionet që veprojnë si banka duhet të bëjnë biznes në Kosovë.

Ky ligj nuk e ndalon askënd që të themelojë një OJQ. Ai nuk e ndalon askënd që të merr pjesë ose të investojë në një OJQ. Ai nuk e ndalon askënd që të themelojë një OJQ me vendosjen e kufizimeve mbi mënyrën se si do të përdoren, shpërndahen apo kthehen donatorëve pasuria e OJQ-së, nëse OJQ-ja duhet të ristrukturohet ose tentojë të ndërrojë pronësinë. Ai nuk e ndalon asnjë subjekt ose person që të merr pjesë lirisht në një OJQ ose me ndonjë person apo subjekt ligjor.

Sfida

Avokati i Popullit pretendon se ky ligj, duke lejuar përdorimin e pronës dhe aktiveve të fituara në bazë të përjashtimeve tatimore nga një OJQ të cilat më pas do të përdoren për qëllime të mos-përjashtimeve tatimore, privon dikë nga e drejta e pronës, e mbrojtur me nenin 46 të Kushtetutës . Avokati i Popullit pohon se OJQ-të e tjera, të cilët mund të kenë pasur të drejtë të marrin disa ose të tërë pasurinë e OJQ-së që vendos të shpërbëhet dhe të bëhet një kompani aksionare, janë të privuar nga e drejta në atë pronë. Avokati i Popullit pastaj pretendon se pa marrjen e këtij transferimi potencial të pronës në OJQ-të që mund të jetë përfituesi i këtyre aktiveve, u është mohuar e drejta e tyre për lirinë e shoqërimit. E meta e këtij arsyetimi qëndron në atë se ai supozon se OJQ-të e tjera kanë të drejtën e pronës që kurrë nuk u kishte takuar atyre dhe mund të mos u përket kurrë atyre në të ardhmen. Sipas ligjit ekzistues, kjo është e mundur vetëm atëherë, dhe jo sigurt, se nëse një OJQ shpërbëhet ose ndryshon identitetin e saj ligjor, një tjetër OJQ e paemërtuar do të merr disa ose të gjitha aktivet e kësaj OJQ-je. Mundësia, megjithëse e largët, e pronësisë së mundshme të pasurisë në të ardhmen nuk është e njëjtë si pronësia aktuale e pronës. Kushtetuta mbron të drejtat ekzistuese të pronës, e jo thjesht mundësinë se mund të fitohet prona në të ardhmen.

Kushtetuta

Neni 46 i Kushtetutës parasheh:

> *1. E drejta e pronës është e garantuar.*
> *2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
> *3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.*
> *4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*
> *5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.*

Kjo dispozitë e Kushtetutës në mënyrë specifike: (1) autorizon Qeverinë të rregullojë pronësinë në pajtim me interesin publik; dhe,
(2) kërkon që askush të mos privohet në mënyrë arbitrare nga e drejta e pronës së tyre. Ky ligj rregullon përdorimin e pronës së caktuar nëse individët ose subjektet ligjore, siç janë institucionet mikrofinanciare, vendosin të angazhohen në aktivitete të caktuara bankare. Nuk e merr pronën në mënyrë arbitrare nga askush. Nuk kërkon që aktivitet e caktuara për profit bankar tani të tatimohen në mënyrë të njëjtë si ato aktivitete bankare të bankave dhe institucioneve tjera financiare tani të tatimohen ashtu që të gjitha subjektet e angazhuara në aktivitete të njëjta biznesi të trajtohen barabartë.

Neni 44 i Kushtetutës parasheh:

> *1. Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.*
> *2. Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve. - 14 -*
> *3. Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente.*

Edhe liria e asociimit në Kushtetutë nuk është pa kufizime, siç mund të parashihet me kufizimet në këtë liri, të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni. Ligji i kontestuar nuk e ndalon askënd që ti përkasë ndonjë organizate. Ai vetëm rregullon, "interesin publik" siç kërkohet me nenin 46 të Kushtetutës, se si individët e caktuar ose subjektet ligjore duhet të zhvillojnë biznesin e tyre, nëse ata do të angazhohen në aktivitete bankare.

Neni 10 i Kushtetutës parasheh:

> *Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës..*

Duke kërkuar që të gjitha subjektet ligjore, duke përfshirë institucionet mikrofinanciare OJQ, që veprojnë si banka në Kosovë, të punojnë sipas

rregullave të njëjta, ligji nxit dhe promovon ekonominë e tregut me konkurrencë të lirë. Në të vërtetë, i sjell jetën reale në këtë dispozitë të Kushtetutës, duke kërkuar që konkurrenca e tregut të jetë e barabartë dhe e drejtë .

Konkludim në lidhje me meritat

Për shkak të këtyre arsyeve, se ligji i kontestuar, nenet 90, 95(1.6), 110, 111 dhe 116 Ligjit për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare është në përputhje me Kushtetutën dhe ushtrimin legjitim të së drejtës dhe obligimit të Qeverisë, është në interes publik që të rregullohet ky lloj i aktivitetit financiar.

A ka pasur parregullsi procedurale në miratimin e Ligjit?

Edhe pse nuk është trajtuar në mënyrë specifike në pjesën operative të aktgjykimit të Gjykatës, në arsyet e artikuluara në opinionin e shumicës, është sugjeruar se ky ligj nuk u miratua në përputhje me Kushtetutën. Ai arsyetim është i gabuar.

Supozohet se ligjet e miratuara nga Kuvendi janë miratuar në mënyrë të ligjshme. Në të vërtetë, as parashtruesi e as ndonjë palë tjetër, të cilët tani mund ligjërisht të ngrenë këtë çështje në Gjykatë, nuk e kanë vënë në pikëpyetje nëse ky ligj u miratua nga Kuvendi në mënyrën e duhur. Prandaj, pyetja nëse ky ligj u miratua në mënyrën e duhur nuk shtrohen në këtë Gjykatë. Edhe në qoftë se është kontestuar nëse ky ligj ishte miratuar në mënyrën duhur, në pajtim me ligjet e Kosovës, vetëm gjykatat e rregullta, jo kjo Gjykatë, e kanë autoritetin për të interpretuar atë çështje, sepse kjo Gjykatë nuk është dhe nuk mund të shërbejë si një gjykatë e shkallës së katërt për shqyrtimin e ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

Edhe në qoftë se pyetja nëse ky ligj u miratua në një mënyrë që nuk ishte në përputhje me Kushtetutën ishte shtruar para kësaj Gjykate, Gjykata do të ishte e detyruar të gjejë se nuk ka pasur shkelje të Kushtetutës në miratimin e këtij ligji. Në analizimin e kësaj çështjeje, të paktën tre nene të veçanta të Kushtetutës duhet të lexohen dhe interpretohen në një mënyrë të tillë ashtu që të tri dispozitat e Kushtetutës të jenë përputhje, në qoftë se kjo do të jetë e mundur.

Neni 69. 3 i Kushtetutës parasheh:

> *The Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve të Kuvendit.*

Ky nen i trajton kërkesat kushtetuese në mënyrë që Kuvendi të ketë kuorum, në mënyrë që të jenë në gjendje të zhvillojnë biznes. Ky është një nen i veçantë dhe i ndryshëm nga neni 80 i Kushtetutës, i cili trajton numrin e kërkuar të votave të anëtarëve të Kuvendit për ta miratuar një ligj.

neni 80.1 i Kushtetutës parasheh:

> *Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë. (Theks i shtuar)*

Ky nen e ndalon votimin përmes autorizimit. Anëtari i Kuvendit duhet edhe të jetë edhe prezent edhe të votojë në Kuvend, në mënyrë që të numërohet vota e tij në lidhje me miratimin e një propozimi specifik legjislativ. Ai nuk e përjashton anëtarin e Kuvendit të jetë "prezent" për qëllime të kuorumit, por jo as të votojë formalisht, e as të pranojë zyrtarisht prezencën e tij në Kuvend kur një pjesë e posaçme e legjislacionit të votohet. Numërimi zyrtar i votave të atyre që kanë votuar dhe të atyre që vetveten e kanë regjistruar si "prezent" nuk është domosdoshmërisht numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit prezent për qëllime të "kuorumit" për shkak se disa anëtarë të Kuvendit mund të zgjedhin as mos të votojnë e as të regjistrohen si "prezent" kur votimi për një pjesë të caktuar të legjislacionit procedohet. Prandaj, mund të jetë një supozim i gabuar nëse kjo Gjykatë konkludon se kur ky ligj është aprovuar, kjo është bërë pa kuorum, nëse e ka bazuar konkluzionin e saj vetëm numërimin zyrtar të votave të atyre të regjistruar "që kanë votuar " dhe të atyre të regjistruar si "prezent."

Është cekur se neni 118 i këtij Ligji, edhe pse jo i kontestuar nga asnjë prej palëve në këtë kërkesë, thekson se ligji do të hyjë në fuqi më 12 prill 2012, në ditën që është aprovuar nga Kuvendi. Neni 80 i Kushtetutës parasheh se Presidenti i Republikës ka 8 ditë, nga data e pranimit të ligjit prej Kryetarit të Kuvendit, ta kthejë këtë ligj në Kuvend për shqyrtim të mëtutjeshëm. Gjithashtu ceket se, sipas Kushtetutës, në përgjithësi ligjet nuk hyjnë në fuqi deri 15 ditë pas publikimit të tyre në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Sidoqoftë, Kushtetuta,i lejon Kuvendit në rrethana të caktuara, të caktojë një datë tjetër në të cilën ligji do të hyjë në fuqi.

Neni 80.6 i Kushtetutës parasheh:

> *Ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse, me vetë ligj nuk përcaktohet ndryshe.* (Theks i shtuar)

Fakti se Kuvendi ka vendosur që ky ligj të hyjë në fuqi, ditën që ka kaluar në Kuvend dhe jo 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare nuk e bënë të pavlefshëm në pikëpamje kushtetuese. Në rastin më të keq, data e hyrjes në fuqi shtyhet 15 ditë pas publikimit zyrtar në Gazetën Zyrtare.

Konkluzioni mbi procedurën

Prandaj, nenet 90, 95(1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare, No. 04/L-093 ishte miratuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Dorëzoi me respekt,

_____

Robert Carolan
Gjyqtar

Rasti Nr. KO 97/12
Parashtrues
Avokati i Popullit
Vlerësimi i kushtetutshmërisë
së neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116
të Ligjit Nr. 04/L-093
për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, të 12 prillit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
MENDIM MOSPAJTUES
i Gjyqtarit Almiro Rodrigues

Shumica kanë deklaruar se nenet 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116_të Ligjit për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare (në tekstin e mëtejmë, Ligji) janë në mospërputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në atë se këto nene të Ligjit janë në kundërshtim me nenet 10, 44 dhe 46 të Kushtetutës.

Sidoqoftë, sipas pikëpamjes sonë dhe me gjithë respektin, shumica duhet të ketë marrë parasysh një aspekt thelbësor paraprak në lidhje me procesin legjislativ, që është: rendi i organizuar i hapave të përcaktuar me Kushtetutë dhe të dizajnuar për miratimin e një ligji të peshuar me kujdes dhe të shqyrtuar mirë.

Në fakt, gjatë shqyrtimit gojor në rastin Nr. KO 97/12, Avokati i Popullit ngriti pyetje procedurale përkatëse për procesin legjislativ të Ligjit në shqyrtim.

Së pari, Avokati i Popullit përmendi se Ligji ishte shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional i Kuvendit, dhe të përcjellë drejtpërdrejt në seancën plenare, ku ai u miratua si i tillë pa qenë ndonjëherë i shqyrtuar dhe miratuar nga Komiteti i përhershëm për Legjislacion.

Së dyti, Avokati i Popullit përmendi se nuk ishte respektuar kuorumi i nevojshëm për të miratuar një ligj. Avokati i Popullit thirret në nenin 69.3 të Kushtetutës dhe në nenin 51 të Rregullores së Punës së Kuvendit. Të dy nenet përcaktojnë se "*Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve të Kuvendit.*"

Avokati i Popullit theksoi se të dhënat zyrtare të paraqitura në faqen e internetit të Kuvendit të Kosovës, tregojnë se 54 deputetë votuan në favor të miratimit të Ligjit, 4 abstenuan, dhe një deputet kishte njoftuar se, për shkak të arsyeve teknike, ai nuk ishte në gjendje për të votuar. Kështu, numri i

përgjithshëm i deputetëve të pranishëm dhe që kanë votuar në seancën plenare ishte 59.

Sipas nenit 64.1 të Kushtetutës, *"Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura."* Prandaj numri i nevojshëm i deputetëve që të ketë kuorum është 61, ose më shumë se gjysma (1/2) siç parashihet me nenin 69.3 të Kushtetutës.

Në anën tjetër, neni 80 [Miratimi i Ligjeve] i Kushtetutës parasheh:

"Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.
[...]."

Kështu, përsëri duke u bazuar në të dhënat zyrtare të Kuvendit të Kosovës, në ditën e miratimit të Ligjit, 59 deputetë ishin të pranishëm dhe që votojnë, që nuk e plotëson numrin e deputetëve të kërkuar.

Konkluzioni është se procedura për miratimin e Ligjit nuk ishte vëzhguar dhe as nuk ishin plotësuar kërkesat procedurale për të pasur një kuorum siç përcaktohet shprehimisht në dispozitat e kombinuara kushtetuese të neneve 64.1, 69.3 dhe 80.1 të Kushtetutës. Si pasojë e kësaj, Ligji nuk mund të konsiderohet të ketë qenë i miratuar në përputhje me këto nene dhe, prandaj, nuk është i vlefshëm.

Së treti, madje edhe duke supozuar se ligji u miratua siç duhet, ai nuk mund të ketë hyrë në fuqi në të njëjtën ditë, kur edhe u miratua, respektivisht më 12 prill 2012. Në këtë drejtim, dy dispozita kushtetuese hyjnë në lojë: në nenin 80.2 dhe 80.6 dhe nenet 84.5 dhe 84.6 të Kushtetutës.

Neni 80 [Miratimi i Ligjeve] i Kushtetutës
"[...]
2. Ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pasi ta ketë nënshkruar brenda tetë (8) ditësh pasi të ketë marrë ligjin.

[...]
6 "Ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse, me vetë ligj nuk përcaktohet ndryshe.."

Neni 84 [[Kompetencat e Presidentit] i Kushtetutës

"Presidenti i Republikës së Kosovës:
[...]
(5) shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;

(6) ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë
të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë
komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një
herë; [...]."

Kjo do të thotë se Ligji ka hyrë në fuqi duke mos i përfillur kompetencat e Presidentit të Republikës, të parapara me Nenin 84 të Kushtetutës, pra pa i ndjekur kërkesat e domosdoshme procedurale të parashikuara me Kushtetutë.

Në përfundim, Ligji nuk i ka përmbushur kërkesat e kuorumit siç përcaktohet me dispozitat e kombinuara kushtetuese të neneve 64.1, 69.3 dhe 80. 1 të Kushtetutës; madje edhe duke supozuar se kjo ka ndodhur, Ligji nuk mund të ketë hyrë në fuqi pa u shpallur dhe shqyrtuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës; dhe Ligji nuk mund të ketë hyrë në fuqi para se të jetë publikuar në Gazetën Zyrtare .

Edhe pse dështimet e lartpërmendura janë të natyrës procedurale, ato prodhojnë pasoja substanciale, sepse ato ndikojnë mbi parimet të cilat janë themelet e Republikës së Kosovës.

<u>Në këtë aspekt</u>, neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] parasheh:

"1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë."

2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.

3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.
[...].
6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën
interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.
[...]."

Në këndvështrimin tonë, kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve përbëhet prej shqyrtimit të përputhshmërisë së tyre me Kushtetutën si dhe verifikimin e pajtimit të tyre me kërkesat formale dhe materiale. Kushtetuta kërkon që ligjet duhet të jenë të përgatitura dhe të miratuara në një mënyrë të caktuar dhe me një përmbajtje të caktuar. Në këtë mënyrë, do të ketë anti-kushtetutshmëri, në qoftë se një akt i dhënë normativ është prodhuar pa procedurat e duhura të procesit legjislativ, siç është përcaktuara me Kushtetutë.

Dështimet në procedurat në lidhje miratimin, shpalljen dhe publikimin e Ligjit e pengojnë "*kontrollet dhe balancimin në mes tyre [pushteteve] siç është përcaktuar me këtë Kushtetutë"* dhe kompetencën e Presidentit të Republikës për të vepruar si "*garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë*". Prandaj, këto dështime bien nën juridiksionin e Gjykatës kur mbrohet kushtetutshmëria e akteve normative.

Kurdo që një çështje kushtetuese është ngritur në Gjykatë, në lidhje me kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së akteve normative, Gjykata duhet të ndjekë një procedurë prej tre hapave, para se të hyn në shqyrtimin substancial të këtyre akteve. Kjo procedurë prej tre hapave përfshin si në vijim: shqyrtimi i kompetencave të autoriteteve publike për të nxjerrë një akt normativ; shqyrtimin e procedurës për lëshimin e një akti normativ dhe, më në fund, shqyrtimi i përputhshmërisë substanciale të aktit normativ me Kushtetutën.[4]

Në rastin në fjalë, nuk është kontestuese kompetenca e Kuvendit për të ushtruar "*pushtetin legjislativ*" për të nxjerrë Ligjin.

Megjithatë, procesi i ndjekur legjislativ për nxjerrjen e Ligjit, i cili është në shqyrtim është vërtet kontestuese, pasi që ai ishte karakterizuar me mangësi të shumta në disa nivele, siç u tha më sipër. Sipas këndvështrimit tonë, shumica është dashur t'i marrë ato parasysh.

Në përfundim, duke mos respektuar procedurat e përcaktuara në Kushtetutë janë rrezikuar demokracia, sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut. Miratimi i Ligjit pa kuorumin e kërkuar kushtetues e shkel parimin demokratik; hyrja në fuqi e Ligjit në ditën e miratimit të tij pa shpalljen e kërkuar kushtetuese nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës dhe të publikimit në Gazetën Zyrtare, nuk është vetëm në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit dhe balancimit të parashikuara me Kushtetutë, por edhe me të

[4] Shih Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut), 30 qershor – 1 korrik 2005 Vilnius Lituania, RAPORT "Ekzaminimi i fakteve në rastet e kontrollit abstrakt të akteve normative " nga Marek Safjan, President, Gjykata Kushtetuese, Poloni.

drejtën e qytetarëve për siguri dhe parashikueshmëri juridike si aspekte qendrore të parimit të sundimit të ligjit. Publikimi është një kërkesë thelbësore në mënyrë që njerëzit, të cilët obligohen nga ligji, ta kenë të njohur atë.

Duke pasur parasysh si më sipër, Gjykata Kushtetuese si organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe interpretimit përfundimtar të Kushtetutës (neni 4. 6 i Kushtetutës) duhet të ketë ndërhyrë dhe përforcuar epërsinë e pushtetit të saj të rregullt kushtetues.

Kështu, shqyrtimi i përputhshmërisë substanciale të këtij Ligji me Kushtetutën nuk duhet të ketë qenë ndërmarrë nga Gjykata, pa shqyrtimin paraprak të dështimeve procedurale të kontestuara në miratimin e Ligjit nën shqyrtim.

Prandaj, Gjykata nuk duhet të jetë ndalur në dispozitat e kontestuara të Ligjit, sepse shkeljet thelbësore procedurale e bëjnë pjesën tjetër të kërkesës pa pasoja.

Dorëzoi me respekt
Almiro Rodrigues, Gjyqtar

KI 95/12, Daut Jemin Hoxha, datë 02 maj 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit C-III-12-274 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 23 gushtit 2012.

Rasti KI95/12, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 mars 2012.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, mos shterje e mjeteve juridike.

Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese "të interpretojë nëse Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka të drejtë të hedhë poshtë padinë tonë për shkak se nuk kemi mjetet financiare e materiale për të bërë përkthimin e kërkuar në gjuhën angleze".

Në rastin konkret, pavarësisht se në cilat të drejta kushtetuese thirret, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk e ka fituar statusin e viktimës së një shkeljeje nga një autoritet publik, për shkak se autoriteti publik në fjalë nuk ka ndërmarrë ende çfarëdo veprimi që mund të thuhet se shkel të drejtat e parashtruesit dhe Gjykata shpallë kërkesën si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI95/12
Parashtrues
Daut Jemin Hoxha
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit C-III-12-274 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 23 gushtit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues i kërkesës është Daut Jemin Hoxha, me banim në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Urdhrin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme), C-III-12-274, e 23 gushtit 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese "*të interpretojë nëse Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka të drejtë të hedhë poshtë padinë tonë për shkak se nuk kemi mjetet financiare e materiale për të bërë përkthimin e kërkuar në gjuhën angleze*".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të datës 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe rregullin 56.2 të

Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 25 shtator 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë.

6. Më 1 tetor 2012, Sekretariati i Gjykatës kërkoi nga parashtruesi të plotësojë kërkesën e tij, si dhe ta informojë Gjykatën nëse kishte përmbushur kërkesat e nenit 25.9 dhe të nenit 25.10 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme (Ligji Nr. 04/L-033). Parashtruesi nuk dorëzoi ndonjë përgjigje në Gjykatë.

7. Më 31 tetor 2012, Kryetari emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues, si dhe emëroi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

8. Më 14 nëntor 2012, Sekretariati e njoftoi parashtruesin se kërkesa e tij ishte regjistruar në regjistrin përkatës të Gjykatës, si dhe e njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës lidhur me kërkesën e parashtruesit.

9. Më 6 mars 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 23 gusht 2012, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme nxori Urdhrin C-III-12, i cili, në pjesën përkatëse, thekson:

> *"Paditësi(t) urdhërohet(n) që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dorëzimi i këtij urdhri, të dorëzojnë dokumentet si në vijim:*
>
> 1. *Përkthimin në anglisht të dosjes së rastit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 618/11/II.*
> 2. *Kërkesëpadinë e plotësuar dhe të rishikuar, të dorëzuar në Dhomën e Posaçme, në pajtim me nenet 25, 27 dhe 28 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme (Ligji Nr. 04/L-033), pas njoftimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për parashtrimin e kërkesëpadisë kundër të paditurit, në pajtim me nenin 29.1 të Ligjit për AKP-në (Ligji Nr. 04/L-034).*

3. *Përkthimi në anglisht i kërkesëpadisë së re, siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij Urdhri, si dhe të dokumenteve të tjera përcjellëse.*
4. *Vërtetimin që AKP-ja është njoftuar para parashtrimit të kërkesëpadisë së re në Dhomën e Posaçme, si dhe përkthimin e tij në gjuhën angleze.*
5. *Listën e provave që paditësi(t) dëshirojnë të parashtrojnë, si dhe përkthimin e tyre në gjuhën angleze".*

11. I njëjti urdhër, më tutje, thekson dispozitën e nenit 25.9 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Nr. 04/L-033, si në vijim:

> *"9. Një person fizik mund t'i paraqesë kërkesë Kryesuesit të Kolegjit për ndihmë rreth përkthimit në gjuhën angleze të lutjeve dhe të dokumenteve përcjellëse. Kjo kërkesë duhet të dorëzohet bashkë me parashtresat dhe duhet të përfshijë një pasqyrë financiare të mjeteve të palës dhe çfarëdo dëshmie mbështetëse që pala dëshiron që Kryesuesi të marrë parasysh".*

Pretendimet e parashtruesit

12. Parashtruesi nuk paraqet ndonjë pretendim, përveç pyetjes bazike "*nëse Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka të drejtë të hedhë poshtë padinë tonë për shkak se nuk kemi mjetet financiare e materiale për të bërë përkthimin e kërkuar në gjuhën angleze*".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

13. Gjykata para së gjithash vlerëson nëse parashtruesi ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, si dhe të specifikuara më tutje me Ligj dhe me Rregullore të punës.

14. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se mund të vendosë për pranueshmëri të kërkesës vetëm nëse parashtruesi dëshmon se ai/ajo ka shteruar të gjitha mjetet efektive juridike në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit, që parasheh:

> *Neni 113.7 i Kushtetutës: "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre*

individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 47.2 i Ligjit: "Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

15. Arsyetimi për kërkesën e shterimit është që t'iu ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshire gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (*Shih, Aktvendim për papranueshmëri, Universiteti AAB-RIINVEST sh.p.k. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI41/09, i 21 janarit 2010,* dhe *shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999*).

16. Në rastin konkret, Gjykata gjen se parashtruesi ka dështuar të tregojë se çfarë hapash, nëse ka pasur ndonjë, ka ndërmarrë për të kërkuar zhdëmtim për shkeljen e supozuar të Kushtetutës.

17. Gjykata vëren se parashtruesi, me sa duket, nuk i ka dorëzuar kërkesë gjyqtarit kryesues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, për të kërkuar ndihmë për të kryer përkthimin në gjuhën angleze të parashtresave dhe të dokumenteve mbështetëse.

18. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi, me sa duket, nuk ka dorëzuar ankesë kundër Urdhrit të Dhomës së Posaçme C-III-12, të 23 gushtit 2012, të Kolegjit Ankimor të Dhomës së Posaçme, duke u ankuar se, sipas nenit 5 të Kushtetutës, gjuhët zyrtare në Kosovë janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe se ai nuk është i obliguar të përkthejë dokumentet në gjuhën angleze.

19. Nëse një kërkesë e tillë drejtuar Kolegjit Ankimor nuk do të ishte e suksesshme, atëherë parashtruesi do të mund të paraqiste kërkesë në këtë Gjykatë.

20. Nga kjo del se parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të zbatueshëm, siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 47.2 të Ligjit.

21. Në kuptim të përgjithshëm, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës, që parasheh: "*Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për*

rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

22. Megjithatë, edhe nëse supozohet se parashtruesi i ka shfrytëzuar mjetet juridike në dispozicion për sa i përket pretendimeve të tij, Gjykata vëren se parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese *"të interpretojë nëse Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka të drejtë të refuzojë padinë tonë, sepse ne nuk kemi as mjetet financiare as materiale për të kryer përkthimet e kërkuara në gjuhën angleze".*

23. Parashtruesi nuk ka pohuar se padia e tij, në fakt, është hedhur poshtë, qoftë për shkak të dështimit për të siguruar dokumentet në gjuhën angleze, ose për ndonjë arsye tjetër. Në vend të kësaj, Gjykata gjen se parashtruesi kërkon përcaktimin në abstrakt nëse Dhoma e Posaçme "ka të drejtë të hedhë poshtë" një padi, sepse ka dështuar të sigurojë dokumentet në gjuhën angleze.

24. Kërkesa e Dhomës së Posaçme që të gjitha dokumentet e dosjes të dorëzohen të përkthyera në gjuhën angleze bazohet në aneksin e Ligjit Nr. 04/L-033, siç autorizohet me nenin 7, paragrafi 1, i Ligjit. Si e tillë, kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese mund të nënkuptohet si kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-033, me të cilat kërkohet nga personat që paraqesin padi në Dhomën e Posaçme të sigurojnë përkthimin e të gjitha dokumenteve në gjuhën angleze.

25. Gjykata rikujton se neni 113, paragrafi 2(1), paragrafi 4, paragrafi 5 dhe paragrafi 8, specifikon se cilat palë janë të autorizuara të dorëzojnë kërkesa në Gjykatë përkitazi me përputhshmërinë e dispozitave të legjislacionit me Kushtetutën. Ky autoritet nuk u njihet individëve.

26. Në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, "*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë [...]".*

27. Në bazë të rregullit 36.2 (c), Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar kur: "Gjykata *të vërtetojë që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë*".

28. Në rastin konkret, pavarësisht se në cilat të drejta kushtetuese thirret, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk e ka fituar statusin e viktimës së një shkeljeje nga një autoritet publik, për shkak se autoriteti publik në

fjalë nuk ka ndërmarrë ende çfarëdo veprimi që mund të thuhet se shkel të drejtat e parashtruesit.

29. Në fakt, Dhoma e Posaçme, thjesht, e ka informuar parashtruesin për kërkesën procedurale dhe nuk është (ende) e mundur të përcaktohet nëse ka, ose do të ketë, ndonjë efekt të padëshirueshëm për parashtruesin dhe për gëzimin e të drejtave të tij kushtetuese.

30. Rrjedhimisht, për arsyet e lartcekura, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës; në përputhje me nenin 47.2 të Ligjit; dhe në përputhje me rregullin 36.1 (a) të Rregullores së punës, më 6 mars 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'ua komunikojë vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 111/12, Mit'hat Lozhani, datë 02 maj 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit të Lirimit me Kusht, MD/PLK No. 02/12, të 29 majit 2012.

Rasti KI111/12, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 mars 2012.

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Objekt i çështjes është vlerësimi, nga Gjykata Kushtetuese, i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, MD/PLK nr. 02/12, i 29 majit 2012, me të cilin është hedhur poshtë kërkesa e parashtruesit për lirim me kusht.

Në kërkesën e tij, parashtruesi i ka propozuar Gjykatës Kushtetuese që të ndryshojë vendimin e Panelit për Lirim me Kusht, MD/PLK nr. 02/12, e 29 majit 2012, si dhe të miratojë kërkesën e tij për lirim me kusht.

Në përfundim, parashtruesi as nuk e ka ndërtuar rastin e tij mbi ndonjë shkelje të ndonjë të drejte të tij të garantuar me Kushtetutë, e as nuk ka dorëzuar prova *prima facie* për një shkelje të tillë.

Kjo Gjykatë nuk mund të shërbejë si interpretuese e zbatimit të duhur të ligjit vendas.

Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36.1. (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton: "(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar".

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI111/12
Parashtruesi
Mit'hat Lozhani
Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Panelit të Lirimit me Kusht, MD/PLK No. 02/12, të 29 majit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues është Mit'hat Lozhani, aktualisht në vuajtje të dënimit në Burgun e Gjilanit.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është Aktvendimi i Panelit të Ministrisë së Drejtësisë për Lirimin me Kusht, MD/PLK nr. 02/12, i 29 majit 2012.

3. Për më tepër, më 26 korrik 2012, parashtruesi u njoftua nga Gjykata Supreme e Kosovës se "Gjykata nuk ka kompetencë për të shqyrtuar kërkesën e tij, pasi Paneli për Lirimin me Kusht është organ i pavarur dhe vendimet e tij janë të plotfuqishme".

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi, nga Gjykata Kushtetuese, i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, MD/PLK nr. 02/12, i 29 majit 2012, me të cilin është hedhur poshtë kërkesa e parashtruesit për lirim me kusht.

5. Në kërkesën e tij, parashtruesi i ka propozuar Gjykatës Kushtetuese që të ndryshojë vendimin e Panelit për Lirim me Kusht, MD/PLK nr. 02/12, e 29 majit 2012, si dhe të miratojë kërkesën e tij për lirim me kusht.

Baza juridike

6. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet: 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit, si dhe në Rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

7. Më 5 nëntor 2012, parashtruesi dorëzoi Kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese.

8. Më 6 dhjetor 2012, Kryetari i Gjykatës emëroi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues, si dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.

9. Më 10 dhjetor 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Panelin për Lirim me Kusht për regjistrimin e kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.

10. Më 24 dhjetor 2012, Paneli i Lirimit me Kusht dërgoi përgjigje ndaj kërkesës së parashtruesit, bashkë me dokumentet e tjera përkitazi me rastin e parashtruesit.

11. Më 13 mars 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga parashtresat e palëve dhe të dokumenteve të bashkëngjitura, mund të nxirren fakte si në vijim.

13. Më 26 janar 2004, me aktgjykim të Gjykatës së Qarkut në Pejë, parashtruesi u shpall fajtor për veprën penale të vrasjes, siç përcaktohet me nenin 30, paragrafi 1, të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës

(KPPK) dhe u dënua me 11 vjet burgim, duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim.

14. Ekzekutimi i vuajtjes së dënimit me burg nga parashtruesi filloi më 26 korrik 2003.

15. Pas kryerjes së gjysmës së dënimit, në bazë të nenit 80.2 të KPPK-së, parashtruesi dorëzoi kërkesën e tij të parë për lirim me kusht.

16. Kërkesa e parashtruesit u shqyrtua më 17 prill 2009, nga Paneli për Lirim me Kusht, i përbërë nga tre gjyqtarë, të cilët vendosën se kushtet e përcaktuara me nenin 80 të KPPK-së nuk ishin përmbushur për shkak të sjelljes së parashtruesit. Shqyrtimi i rastit të parashtruesit u caktua pas një viti.

17. Më 30 prill 2010, Paneli shqyrtoi kërkesën e re të parashtruesit dhe e hodhi poshtë atë, me arsyetimin se, edhe pse parashtruesi ka filluar të përmbahet nga sjellja negative, nga të dhënat e ekipit profesional të qendrës korrektuese, është konstatuar që nuk ka arritur të kuptojë pasojat e veprës penale.

18. Paneli për Lirim me Kusht, më vonë, hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për lirim me kusht. Kjo ndodhi më 7 qershor 2011.

19. Më 7 tetor 2011, Paneli për Lirim me Kusht edhe një herë shqyrtoi kërkesën e parashtruesit, duke vepruar *ex officio*, dhe e hodhi poshtë atë. Në atë vendim, Paneli pranoi se kishte bërë gabim teknik në vendimin e mëhershëm, të 7 qershorit 2011, duke argumentuar se parashtruesi kishte arritur të ikte nga burgu. Paneli caktoi shqyrtimin e ri pas tre muajsh.

20. Kërkesa e parashtruesit për lirim me kusht u mor parasysh prapë, më 21 shkurt 2012, dhe u hodh poshtë vijimisht. Paneli i sugjeroi parashtruesit që të bëjë përpjekje për pajtim dhe përmirësim të marrëdhënieve me familjen e viktimës.

21. Më 29 maj 2012, Paneli për Lirim me Kusht edhe një herë shqyrtoi kërkesën e parashtruesit, si dhe gjeti që kushtet për lirimin e tij ende nuk ishin përmbushur, në bazë të sjelljes së parashtruesit, pasi ai kishte kërcënuar një zyrtar korrektues.

Pretendimet e parashtruesit

22. Argumenti kryesor i parashtruesit, në mbështetje të kërkesës së tij, ishte që Vendimi i 29 majit 2012, i nxjerrë nga Paneli i Lirimit me Kusht, ishte

i bazuar në fakte të gabueshme, si dhe kështu ishte i jashtëligjshëm. Ai argumentonte se kushtet për lirim, të përcaktuara me nenin 80 të KPPK-së, si dhe me dispozitat përkatëse të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Nr. 03/02-191, ishin përmbushur, si dhe, kështu, Gjykata Kushtetuese do të duhej të ndryshonte vendimin e kontestuar të 29 majit 2012.

Përgjigja nga pala e interesuar

23. Në përgjigje ndaj kërkesës, Paneli i Lirimit me Kusht ofroi pasqyrën e hollësishme të të gjitha vendimeve dhe të dokumenteve, në bazë të të cilave ishin miratuar këto vendime.

24. Përfundimisht, u propozua nga Paneli që të hidhet poshtë kërkesa e parashtruesit si e pabazuar.

Ligji i zbatueshëm

25. Neni 80 i KPPK-së (i publikuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/25, më 6 korrik 2003) përcakton:

"Lirimi me kusht

Neni 80

(1) Personi i dënuar mund të lirohet me kusht nëse ekziston baza e arsyeshme se ai nuk do të kryejë vepër të re penale. Kur merret vendimi për lirimin me kusht të personit të dënuar duhet të merret parasysh sjellja e tij gjatë mbajtjes së dënimit.

(2) Personi i dënuar, i cili e ka mbajtur gjysmën e dënimit me burgim, mund të lirohet me kusht dhe të lirohet nga burgu me kusht se ai nuk do të kryejë vepër tjetër penale para skadimit të dënimit.

(3) Personi i dënuar, i cili ka mbajtur një të tretën e dënimit me burgim, përjashtimisht mund të lirohet me kusht kur rrethanat e veçanta që lidhen me personin e dënuar tregojnë se ai nuk do të kryejë vepër të re penale.

(4) I dënuari, i cili ka mbajtur tri të katërtat e dënimit me burgim afatgjatë, mund të lirohet me kusht.

(5) Për lirimin me kusht vendos trupi gjykues i themeluar nga organi kompetent publik në fushën e çështjeve gjyqësore në pajtim me ligjin".

26. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (2010/03-L-191), i 22 korrikut 2010, deri në masën relevante, përcakton në nenet e tij 128 dhe 129 si në vijim:

"Neni 128

Lirimi me kusht

1. Personit të dënuar mund t'i lejohet lirimi me kusht në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës.

2. Personi i dënuar ka të drejtë t'i paraqesë kërkesë për lirim me kusht panelit të themeluar në pajtim me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës nëpërmjet institucionit korrektues në të cilin ai është duke e mbajtur dënimin.

3. Pas paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht, Drejtori i Institucionit Korrektues kërkon nga Shërbimi Sprovues që të vizitojë të dënuarin dhe të nënshkruajë marrëveshjen për mbikëqyrjen e tij pas lirimit me kusht.

4. Drejtori i institucionit korrektues mund të paraqesë propozim për lirimin me kusht.

5. Pas paraqitjes së kërkesës apo propozimit për lirimin me kusht, drejtori i institucionit korrektues, panelit për lirim me kusht menjëherë i dorëzon kopjen e dosjes personale të personit të dënuar dhe raportin mbi personin e dënuar të hartuar nga ekipi profesionist në institucionin korrektues me anë të shkresës përcjellëse të cilën e nënshkruan Drejtori i Institucionit Korrektues.

6. Nëse paneli për lirim me kusht nuk ka të dhëna të mjaftueshme, mund të kërkojë nga institucioni korrektues të dhëna shtesë.

7. Raporti nga paragrafi 5. i këtij neni përfshin:
7.1. llojin e veprës penale të kryer nga personi i dënuar;
7.2. qëndrimin e personit të dënuar ndaj veprës penale, viktimës dhe familjes së

viktimës;
7.3. ndonjë vepër penale të kryer më parë nga ai;
7.4. rrethanat e tij familjare dhe të kaluarën shoqërore;
7.5. gjendjen e tij fizike dhe psikologjike, duke përfshirë vlerësimin e rrezikshmërisë kurdo që konsiderohet e nevojshme nga një psikiatër apo
psikolog;
7.6. sjelljen e tij në institucionin korrektues dhe suksesin e arritur në shmangien
e faktorëve të veprës penale;
7.7. planet e tij pas lirimit;
7.8. përkrahja që mund t'i ofrohet pas lirimit dhe
7.9. ndonjë rrethanë që tregon se ai nuk do të kryejë vepër të re penale.

Neni 129

1. Paneli për lirim me kusht, i themeluar nga Ministri i Drejtësisë, përbëhet nga një gjyqtar dhe dy (2) gjyqtarë laikë, të cilët kanë njohuri dhe përvojë në psikologji, kriminologji, psikiatri, pedagogji, sociologji dhe shkenca të tjera shoqërore lidhur me lirimin me kusht.

2. Paneli për lirim me kusht vendos për të gjitha kërkesat dhe propozimet për lirimin me kusht".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Në fillim, Gjykata thekson se parashtruesi nuk bën ndonjë pohim për shkelje të Kushtetutës, vetëm një shkelje të pretenduar të zbatimit të drejtë të ligjit vendës.

28. Parashtruesi vetëm sa kërkon nga Gjykata të vlerësojë ligjshmërinë e refuzimit në diskrecion të kërkesës së tij për lirim me kusht nga pjesa e mbetur e dënimit të tij, edhe pse Paneli i Lirimit me Kusht ka dhënë arsyetime të gjera për refuzimin e tillë të kërkesës së parashtruesit.

29. Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese do të donte të përkujtonte që, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet faktike apo juridike (ligjshmëria), që pohohen të jenë bërë nga Paneli për Lirim me Kusht, përveç nëse dhe deri në masën që ato mund të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Konventë

(kushtetutshmëria). Kështu, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet që merren.

30. Në përfundim, parashtruesi as nuk e ka ndërtuar rastin e tij mbi ndonjë shkelje të ndonjë të drejte të tij të garantuar me Kushtetutë, e as nuk ka dorëzuar prova *prima facie* për një shkelje të tillë (*Shih, Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i ECHR-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005*).

31. Kjo Gjykatë nuk mund të shërbejë si interpretuese e zbatimit të duhur të ligjit vendas.

32. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36.1. (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton: *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar"*.

33. Kështu, i propozoj Kolegjit shqyrtues të nxjerr përfundimin se, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, si dhe në bazë të rregullit 36 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KOMUNIKOJË palëve këtë vendim;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 18/13, Blerim Uka, datë 31 maj 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Ac. nr. 1314/2012, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 7 dhjetorit 2012

Lënda 18/13, Aktvendim për papranueshmëri i 16 prillit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë për masë të përkohshme, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut.

Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009.

Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën më 15 shkurt 2013, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me ç'rast kërkoi nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

Parashtruesi, në kërkesë, pretendon se me atë aktgjykim i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij sipas nenit 21 (Parimet e Përgjithshme), nenit 22 (Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), si dhe nenit 6 së Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Me Vendimin e Kryetarit, nr. GJR. KI 18/13, të 26 shkurtrit 2013, gjyqtari Almiro Rodrigues u caktua si Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit, KSH 18/13, u caktua Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama Hajrizi.

Pas shqyrtimit të rastit, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk arriti t'i argumentojë dhe t'i provojë mjaftueshëm pretendimet e tij në kuptimin e shkeljes kushtetuese të të drejtave të tij nga Gjykata Komunale dhe nga Gjykata e Qarkut. Përveç kësaj, Gjykata thekson që aktgjykimet dhe vendimet e Gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut janë mjaft të argumentuara dhe të arsyetuara, si dhe nuk shfaqin ndonjë arbitraritet.

Sa i përket kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thjesht kërkon vendosjen e masës së përkohshme, por nuk ka ofruar asnjë argument apo dokument relevant me të cilin do të shpjegonte dhe do të tregonte pse dhe si kishte pësuar dëm të pariparueshëm.

Duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e kërkesës së parashtruar, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në seancën e 16 prillit 2013, arriti në përfundim se kërkesa është e papranueshme, sepse është qartazi e pabazuar si dhe se kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme duhet refuzuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI18/13
Parashtrues
Blerim Uka
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Ac. nr. 1314/2012, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 7 dhjetorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues është Blerim Uka, i lindur në Mitrovicë, aktualisht me banim në Prishtinë, i përfaqësuar nga avokati Gani Asllani nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin Ac. nr. 1314/2012, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 7 dhjetorit 2012, që i është dorëzuar atij më 16 janar 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon që gjykata nuk ka nxjerrë aktgjykim të drejtë dhe të paanshëm, duke cenuar kështu dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

4. Parashtruesi gjithashtu kërkon që Gjykata të vendosë Masë të përkohshme, duke pezulluar ekzekutimin e Urdhrit të Gjykatës në Prishtinë [E. nr. 915/12], të 5 marsit 2013.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 dhe në nenin 21.4 të Kushtetutës; në nenet: 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); si dhe në rregullin 56, paragrafi 2, e Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

6. Më 15 shkurt 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 26 shkurt 2013, Kryetari emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues, si dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtarë).

8. Më 16 prill 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës dhe refuzimin e kërkesës për Masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 31 mars 2000, parashtruesi lidhi marrëdhënie pune si drejtor ekzekutiv i kompanisë private "P. P. DAK INGENIERING", pronë e H. S.

10. Në nëntor të vitit 2001, pronari i kompanisë, H. S., për shkak të problemeve financiare vendosi të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, si dhe urdhëroi parashtruesin, në ushtrim të funksioneve të tij si drejtor ekzekutiv, të informojë me shkrim të gjithë punëtorët e kompanisë se ishin ndërprerë marrëdhëniet e tyre të punës.

11. Më 27 nëntor 2002, parashtruesi i dorëzoi me shkrim punëtorit I. H. vendimin për ndërprerje të kontratës së tij, të 15 gushtit 2001, por I. H. refuzoi ta pranojë atë.

12. Në një datë të panjohur, më 2006, I. H. parashtroi në Gjykatën Komunale në Prishtinë një padi kundër parashtruesit për kompensim të dëmeve dhe për pagesë të pagave mujore sipas kontratës së punës. Parashtruesi pohon se ai asnjëherë nuk e ka marrë padinë nga Gjykata.

13. Parashtruesi thekson se I. H. "ishte shumë i vetëdijshëm që nuk kishte krijuar marrëdhënie pune me Blerim Ukën (Parashtruesin), por me kompaninë 'N. P. DAK ENGINEERING', pronar i së cilës ishte H. S.".

14. Më 15 dhjetor 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë aprovoi kërkesëpadinë si dhe nxori Aktgjykimin C1. nr. 139/2006 me të cilin urdhëroi "P. P. DAK INGENIERING", që ta paguajë I. H.-në sipas kontratës së punës, të nënshkruar më 15 gusht 2001.

15. Megjithatë, parashtruesi thekson se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale ka urdhëruar kompaninë "P. P. DAK INGENIERING" që të paguajë I. H.-në, "duke më obliguar, në cilësinë e pronarit nganjëherë (ndërsa, në fakt, kam qenë i punësuar njësoj si paditësi, me kontratë pune) dhe nganjëherë në cilësinë e përfaqësuesit ligjor", si dhe, si duket, duke mos ditur "dallimin mes pronarit dhe drejtorit ekzekutiv të një kompanie" pasi, në fakt, H. S. ishte pronar i "P. P. DAK INGENIERING", "i cili kishte krijuar marrëdhënie pune" me I. H.-në.

16. Më 16 prill 2009, parashtruesi bëri ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktgjykimit C1. nr. 139/2006, të 15 dhjetorit 2008.

17. Më 27 prill 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, nxori Aktgjykimin Ac. nr. 540/2009, duke hedhur poshtë ankesën e parashtruesit, si dhe duke mbështetur në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C1. nr. 139/2006, të 15 dhjetorit 2008.

18. Më 17 maj 2012, I. H. parashtroi kërkesë për përmbarim të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C1. nr. 139/2006, kundër kompanisë "DAK-ADK INGENIERING", pronë e Blerim Ukës.

19. Më 10 tetor 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin Ekz. nr. 915/2012, duke aprovuar kështu kërkesën për përmbarim.

20. Më 16 tetor 2012, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, kundër Vendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, Ekz. nr. 915/2012.

21. Më 7 dhjetor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar, si dhe mbështeti Vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, Ekz. nr. 915/2012, të 10 tetorit 2012.

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi pretendon se nuk ka qenë pronar i kompanisë *"P. P. DAK INGENIERING", sepse ka pasur vetëm marrëdhënie pune si drejtor ekzekutiv.*

23. Parashtruesi gjithashtu pretendon se, më 24 nëntor 2004, ai ka themeluar një kompani të re, të quajtur *"ADK", e cila, si subjekt i veçantë juridik, nuk kishte të bënte me asgjë me "P. P. DAK INGRNIERIN", pronë e atëhershme e H. S.-së.*

24. Parashtruesi argumenton se, më 17 maj 2012, ka ndodhur një gabim në parashtrimin e kërkesës për përmbarim, me të cilën është kërkuar përmbarimi ndaj kompanisë *"DAK-ADK", e cila nuk përmendet në dispozitivin e aktgjykimit përfundimtar (Cl. nr. 139/2006), të 15 dhjetorit 2012.*

25. Parashtruesi konkludon se gjykatat e rregullta kanë nxjerrë vendimet e tyre pa përcaktuar gjendjen e plotë faktike, në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës dhe të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut.

26. Parashtruesi pretendon se janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij sipas nenit 21 (Parimet e Përgjithshme); nenit 22 (Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare); nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), të Kushtetutës; duke përfshirë edhe nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

27. Në përgjithësi, parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese

> "*të vlerësojë ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave të rregullta, përputhshmërinë e këtyre vendimeve me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe protokollet e saj".*

28. Parashtruesi, më tutje, pret që "*Gjykata Kushtetuese të japë vlerësimin e saj për këtë çështje juridike civile".*

Pranueshmëria e kërkesës

29. Parashtruesi pohon se asnjëherë nuk e ka pranuar padinë që ka parashtruar I. H. kundër tij në Gjykatën Komunale. Parashtruesi, më tutje, pohon se, në të gjitha shkallët, "gjykatat nuk kanë përcaktuar fare gjendjen faktike mbi atë se kush është i padituri si dhe kush në fakt është dashur të jetë i padituri".

30. Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi ka përmbushur të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, si dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

31. Gjykata i referohet paragrafit 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, i cili përcakton:

> "Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

32. Gjykata vëren se rregulli 36.1.(c) i Rregullores së punës përcakton:

> "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar".

33. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 36.2.(d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> "*Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi te pabazuar, nëse bindet se: (d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

34. Gjykata Kushtetuese vëren se Gjykata Komunale në Prishtinë, në Aktgjykimin e saj, C1. nr. 139/2006, të 15 dhjetorit 2008, ka theksuar që "i padituri, edhe pse është ftuar rregullisht për mbajtjen e shqyrtimit kryesor, që vërtetohet me pranimin e thirrjes së 4 dhjetorit 2008, nuk i është përgjigjur ftesës së Gjykatës, si dhe nuk ka arsyetuar mungesën e tij, kështu Gjykata, në përputhje me nenin 295 të LPK-së, si dhe sipas propozimit të të autorizuarit të paditësit, ka mbajtur seancën kryesore publike në mungesë të tij".

35. Parashtruesi nuk është ankuar asnjëherë, gjatë procedurave të rregullta, ndaj mospranimit të padisë së parashtruar në Gjykatën Komunale kundër tij nga I. H.-ja; as nuk ka paraqitur e as nuk e ka provuar këtë argument para Gjykatës për këtë shkelje të pretenduar.

36. *Në anën tjetër, Gjykata e Qarkut, në aktgjykimin e saj të 7 dhjetorit 2012, arsyeton që*

> "pretendimet ankimore në rrethanat si më lart që debitori, kompania "ADK" nuk ka obligim ndaj kreditorit në lidhje me kompensimin e dëmeve, pasi që aktgjykimi përfundimtar ka obliguar kompaninë "DAK-Engineering", nuk aprovohen nga kjo gjykatë si të bazuara. Kjo për shkak se është i njëjti i paditur, tanimë debitor. Ky fakt është konfirmuar nga gjykata sipas dëshmive në shkresat e rastit. Me fjalë të tjera, debitori, me akt publik, ka paraqitur që "DAK-Engineering", pronar i së cilës ishte H., dhe drejtor Blerim Uka, tanimë udhëhiqet me emrin e kompanisë "ADK", ku pronar është Blerim Uka, derisa drejtor është H. S. E gjithë kjo flet për faktin që është e njëjta kompani, vetëm se ka ndërruar emrin e saj. Ndërrimi i emrit të kompanisë dhe ndërrimi

mes vete i drejtorit dhe pronarit nuk e lirojnë kompaninë nga obligimet ndaj debitorit, gjë që është konfirmuar me aktgjykimin përfundimtar".

37. Gjykata Kushtetuese përkujton palët se nuk është gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta për vlerësimin e fakteve dhe për zbatimin e ligjit.

38. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë të drejtën procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I*).

39. Gjykata Kushtetuese thekson se parashtruesi ka pasur mundësi të shumta të argumentonte rastin e tij dhe të dorëzonte provat që ai i konsideron të rëndësishme për rastin e tij në gjykatat e rregullta. Arsyetimet faktike dhe juridike në vendimet e gjykatave të rregullta janë të hollësishme në gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut. Gjykata e Qarkut ka nxjerrë një aktgjykim, duke i dhënë përgjigje argumenteve të parashtruesit, duke mbështetur arsyetimin faktik dhe juridik të aktgjykimit të Gjykatës Komunale.

40. Kështu, edhe Gjykata Komunale edhe ajo e Qarkut, kanë marrë parasysh dhe, në fakt, i janë përgjigjur ankesave të parashtruesit.

41. Gjykata Kushtetuese ka autoritet të kufizuar në vlerësimin e gabimeve të pretenduara në fakte ose në ligj, ashtu siç merren nga gjykatat e rregullta, si dhe nuk mund të zëvendësojë qëndrimet e tilla të gjykatave të rregullta me të vetin (*Shih, GJEDNJ, Jantner kundër Republikës Sllovake, nr. 39050/97, paragrafi 32, Aktgjykim i 4 marsit 2003*).

42. Kështu, parashtruesi nuk arrin të argumentojë dhe të provojë mjaftueshëm pretendimet e tij në kuptimin e shkeljes kushtetuese të të drejtave të tij nga Gjykata Komunale dhe nga Gjykata e Qarkut. Përveç kësaj, Gjykata thekson që aktgjykimet dhe vendimet e Gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut janë mjaft të argumentuara dhe të arsyetuara, si dhe nuk shfaqin ndonjë arbitraritet.

43. Kështu, rrjedh që kërkesa është e papranueshme sepse, sipas rregullit 36.2.(b) të Rregullores së punës, është qartazi e pabazuar.

Kërkesa për Masë të përkohshme

44. Neni 27 i Ligjit, e më hollësisht rregulli 54 (1) i Rregullores së punës, përcakton që "*Në çfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e Masës së përkohshme*".

45. Megjithatë, pasi kërkesa është e papranueshme, kërkesa për Masë të përkohshme nuk i përmbush kriteret që parashihen sipas rregullit 54 (1) të Rregullores së punës.

46. Prandaj, kërkesa për Masë të përkohshme hidhet poshtë si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 20 e me nenin 27 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.2, me rregullin 54, me rregullin 55 e me rregullin 56 të Rregullores së punës, më 17 maj 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

IV. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 41/13, Sadik Qollopeku, datë 31 maj 2013- Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 61/2008, të 16 tetorit 2009, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, AC. nr. 158/2010, të 10 tetorit 2011, dhe kërkesë për caktimin e masës të përkohshme

Rasti KI41/13, Aktvendim për papranueshmëri i 30 prillit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kontest civil, kërkesë për masë të përkohshme, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtje e pronës, barazia para ligjit, shterimi i mjeteve efektive juridike

Parashtruesi i kërkesës pretendonte se Aktgjykimi C. nr. 61/08, i 16 tetorit 2009, i Gjykatës Komunale në Prizren dhe Aktgjykimi Ac. nr. 158/2010, i Gjykatës së Qarkut në Prizren, i 10 tetorit 2011, ia shkelnin atij të drejtat e garantuara me nenin 3. paragrafi 1 dhe 2, nenin 21, 31 dhe 46, paragrafi 3 të Kushtetutës; si dhe me nenin 6 dhe 14 të KEDNJ-së.

Në këtë rast, Gjykata gjeti se, kërkesa e parashtruesit ishte e parakohshme, meqë kontesti pronësor ishte në fazën e vendosjes në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Prandaj, Gjykata konsideroi se parashtruesi nuk i kishte shteruar mjetet efektive juridike të parapara me ligj. Përderisa kërkesa nuk i kishte përmbushur kriteret procedurale për pranueshmëri, edhe kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme është refuzuar si e papranueshme nga Gjykata.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI DHE VENDIM PËR KËRKESËN PËR MASË TË PËRKOHSHME
në
Rastin Nr. KI41/13
Parashtrues
Sadik Qollopeku
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 61/2008, të 16 tetorit 2009, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, AC. nr. 158/2010, të 10 tetorit 2011,
dhe
kërkesë për caktimin e Masës së përkohshme

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Sadik Qollopeku, nga Prizreni, i përfaqësuar nga z. Naim Qelaj, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, AC. nr. 158/2010, të 10 tetorit 2011.

3. Më 31 tetor 2012, parashtruesi parashtroj kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë. Zyra e Prokurorit të Shtetit, me Njoftimin nr. KMLC. nr. 111/2012, e 23 nëntorit 2012, refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Parashtruesi e pranoi njoftimin për refuzimin e kërkesës më 26 nëntor 2012.

Objekti i çështjes

4. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, AC. nr. 158/2010, të 10 tetorit 2011, përkitazi me njohjen e të drejtës së shfrytëzimit të banesës.

5. Parashtruesi kërkon, gjithashtu, që Gjykata të vendosë Masë të përkohshme për pezullimin e përmbarimit të vendimit E. nr. 1889/12, të Gjykatës Themelore-Dega në Prizren, ku titull përmbarues është Aktgjykimi C. nr. 61/2008, i 16 tetorit 2009.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); në nenin 27 dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 28 e rregullin 54 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

7. Më 20 mars 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatë dhe e njëjta u regjistrua në regjistrin përkatës të Gjykatës, me nr. KI41/13.

8. Më 25 mars 2013, Kryetari, caktoi gjyqtarin Dr. sc. Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përberë nga të gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues, që zëvendëson gjyqtarin Robert Carolan), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

9. Më 3 prill 2013, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën e Apelit dhe kërkoi dokumentacion shtesë nga e njëjta. Gjithashtu u njoftua edhe Zyra e Prokurorit të Shtetit në Prishtinë.

10. Më 5 prill 2013, parashtruesi deponoi në Gjykatë kërkesë për caktimin e Masës se përkohshme, derisa kjo Gjykatë të marrë vendim meritor për çështjen.

11. Më 17 prill 2013, Gjykata e Apelit dorëzoi përgjigje në kërkesë, duke ia bashkëngjitur asaj: vendimet gjyqësore, ankesat dhe parashtresat e parashtruesit përkitazi me çështjen e tij.

12. Më 30 prill 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës dhe refuzimin e kërkesës për caktimin e Masës së përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 22 shtator 1990, parashtruesi i kërkesës pohon se, sipas Vendimit nr. 518, të 22 shtatorit 1990, të pleqësisë së shkollës fillore "Ortakoll" në Prizren, fitoi të drejtën e shfrytëzimit të banesës (Lam. 8, banesa nr. 32) që ndodhet në lagjen Ortakoll, rruga "Xherdapi", në Prizren.

14. Kundër vendimit të pleqësisë së shkollës fillore "Ortakoll" në Prizren për ndarjen e banesës kontestuese, në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Gjakovë, kanë ushtruar ankesë: Xhemshir Reza, Mevlyde Shimshek dhe Dragan Gadzić.

15. Më 25 tetor 1990, Gjykata e Themelore e Punës së Bashkuar në Gjakovë, me Vendimin K. nr. 130/90, refuzoi ankesat e ushtruara nga personat e lartcekur dhe la në fuqi vendimin e pleqësisë së shkollës fillore "Ortakoll" të Prizrenit.

16. Më 15 korrik 2006, parashtruesi i është drejtuar Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore me kërkesë për kthimin e të drejtës së shfrytëzimit të banesës kontestuese.

17. Më 15 korrik 2006, Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore nxori vendimin HPPCC/REC/65/2006 dhe shqyrtoi kërkesat e palëve sipas kriterit të kategorizimit, ndër to edhe kërkesën e parashtruesit. Komisioni verifikoi se kërkesa e kategorisë C. nr. DS600770, e z. Dragan Gadzić, i përket pronës së njëjtë sikurse kërkesa e kategorisë A nr. DS201262, që në këtë rast është kërkesa e parashtruesit. Vlerësimi i Komisionit, përkitazi me banesën kontestuese, citon:

[...]

"Pasi që ishte njoftuar paraqitësi A për vendimin e Komisionit, si palë kërkuese, ai ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim brenda afatit prej 30 ditësh. Pala kërkuese ka pohuar se kishte vendim valid mbi ndarjen dhe me tutje deklaron se paraqitësi C nuk ishte punëtor i bartësit të së drejtës së ndarjes dhe ka hyrë në pronë në mënyrë jo ligjore. Në mbështetje të tij pala kërkuese ka paraqitur vendime të gjykatës, me të cilat tregon se paraqitësi C ka uzurpuar në mënyrë të paligjshme pronën e kërkuar për të cilën është gjobitur.

Drejtorati ka informuar palën përgjegjëse se paraqitësi A ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim. Pala përgjegjëse ka pohuar se nuk është e vërtetë që ai nuk është punëtor i bartësit të së drejtës së ndarjes. Më tutje ai pohon se prona i është ndarë në mënyrë ligjore. Komisioni me kujdes ka shqyrtuar pohimet dhe dëshmitë e ofruara dhe gjen se, siç është cekur me sipër, paraqitësi i kategorisë A nuk ka përmbushur kërkesat për kërkesë të kategorisë A. Më tutje Komisioni gjen se dëshmitë e ofruara nga pala kërkuese tregojnë se pala përgjegjëse ka hyrë në pronën e kërkuar në mënyrë të paligjshme dhe mënyra më të cilën e ka bartur posedimin, ndarjen dhe blerjen e mëvonshme të pronës së kërkuar ishte qartësisht e paligjshme. Ashtu që Komisioni përfundon se kërkesa për rishqyrtimi e palës përgjegjëse është e suksesshme për aq sa i takon dështimit të palës përgjegjëse për të demonstruar se më vonë e kishte të drejtën e pronës mbi pronën e kërkuar më 24 mars 1999, siç kërkohet nga neni 1.2 (c) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe neni 2.6 i Rregullores së UNMIK-ut 200/60". [...].

18. Më 31 janar 2008, Dragan Gadzić (paditësi) ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Prizren dhe kërkoi që t'i njihet e drejta e pronësisë së banesës kontestuese.

19. Më 16 tetor 2009, Gjykata Komunale në Prizren nxori Aktgjykimin C. nr. 61/2008, aprovoi si të bazuar padinë e ushtruar nga z. Dragan Gadzić dhe ia njohu atij të drejtën e pronësisë së banesës kontestuese. Më të njëjtin aktgjykim, e njëjta refuzoi si të pabazuar kundërpadinë e parashtruesit, përkitazi me kërkesën e tij për anulimin e kontratës së shitblerjes së banesës kontestuese (Leg. nr. 734/93, të 18 shkurtit 1993) që ishte legalizuar nga kjo instancë.

20. Më 18 janar 2010, parashtruesi ushtroi të drejtën e ankesës në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër aktgjykimit të lartcekur, për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuehëm të së drejtës materiale.

21. Më 10 tetor 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin Ac. nr. 158/2010, refuzoi ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin C. nr. 61/2008, e 16 tetorit 2009, të Gjykatës Komunale në Prizren. Arsyetimi i vendimit të Gjykatës, ndër të tjera, citon:

"Kjo gjykatë vlerëson se nuk ka bazë për nulimin e kontratës, sepse kontrata, nulimi i së cilës kërkohet nuk është në kundërshtim

me parimet dhe dispozitat e detyrueshme apo me moralin. [...] Pretendimet ankimore se aktgjykimi nuk ka arsye për faktet vendimtare dhe se diapozitivi është në kundërshtim me arsyetimin, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndron sepse diapozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe nuk është i përfshirë me kundërthëniet dhe është në përputhje të plotë me arsyetimin dhe me arsyetim janë dhënë arsyet e plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike dhe mbi këtë bazë aktgjykimi i shkallës së parë nuk mund të vihet në pyetje".

22. Më 30 nëntor 2011, nëpërmjet Gjykatës Komunale në Prizren, parashtruesi ushtroi revizion në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

23. Më 13 janar 2012, Gjykata Komunale në Prizren (Aktvendimi C. nr. 61/2008) hodhi poshtë si të palejuar revizionin e ushtruar nga parashtruesi kundër Aktgjykimit Ac. nr. 158/2010, të 10 tetorit 2011, të Gjykatës së Qarkut në Prizren. Sipas aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, nuk u lejua revizioni për shkak se në kontestet pronësore, në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkim të të hollave, me dorëzimin e sendit apo me ekzekutimin e ndonjë veprimi, vlera e kontestit që është theksuar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000,00 euro.

24. Më 30 tetor 2012, nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar ligjor, parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë te Prokurori i Shtetit, kundër vendimeve të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë.

25. Më 23 nëntor 2012, Zyra e Prokurorit të Shtetit (lënda KMLC. nr. 111/2012), pasi kishte shqyrtuar aktgjykimet e kundërshtuara, e njoftoi parashtruesin se nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme ligjore për ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

26. Më 20 mars 2013, parashtruesi dorëzoi dokumentacion shtesë në Gjykatë, përkatësisht një vërtetim të lëshuar nga Gjykata e Apelit në Prishtinë, ku thuhet: "*Në bazë të kërkesës së z. Sadik Qollopeku, Gjykata e Apelit lëshon ketë: Vërtetim, Më të cilin vërtetohet se lënda Ac. nr. 3154/12 gjendet në regjistrat e kësaj gjykate, është në punë dhe do të zgjidhet sipas radhës së arritjes [...]".*

27. Më 17 prill 2013, Gjykata e Apelit (shkresa A. Gj. nr. 130/13) dorëzoi përgjigjen në kërkesë, duke bashkëngjitur parashtresat e parashtruesit dhe të gjitha vendimet gjyqësore për çështjen e tij. Gjykata e Apelit, nëpërmjet kësaj shkrese, përkitazi me ankesën e parashtruesit, ushtruar kundër Aktvendimit C. nr. 61/2008, të 13 janarit 2012, njoftoi Gjykatën Kushtetuese se lënda Ac. nr. 3145/2012 (kontesti pronësor) është në procedurë të vendosjes dhe për këtë ankesë Gjykata e Apelit duhet të vendosë duke respektuar radhën e arritjes së lëndës në këtë gjykatë.

Pretendimet e parashtruesit

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Komunale në Prizren, me Aktgjykimin C. nr. 61/08, e 16 tetorit 2009, dhe Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin Ac. nr. 158/2010, e 10 tetorit 20011, ia kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3, paragrafi 1 dhe paragrafi 2; me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme]; me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; me nenin 46, paragrafi 3 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës; si dhe me nenin 6 e me nenin 14 të KEDNJ-së.

29. Parashtruesi pretendon se, me përmbarimin e Vendimit të Gjykatës Themelore-Dega në Prizren, E. nr. 1889/12, ku titull përmbarues është Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 61/2008, i 16 tetorit 2009, atij dhe familjes së tij do t'i shkaktohen dëme të pariparueshme për faktin se ai dhe familja e tij duhet ta lirojnë banesën kontestuese me kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje me Ligj dhe me Rregulloren e punës të Gjykatës.

31. Sa i përket kësaj, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 7, të Kushtetutës, që parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

32. Neni 47.2 i Ligjit dhe rregulli 36.1 (a) gjithashtu përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

2. "Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Rregulli 36 [Kriteret e pranueshmërisë]

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

a) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar".

33. Gjykata vëren se parashtruesi ankohet ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 61/2008, të 16 tetorit 2009, të vërtetuar më 10 tetor 2011 nga Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin Ac. nr. 158/2010. Kundër këtij aktgjykimi, nëpërmjet Gjykatës Komunale në Prizrenit, parashtruesi ushtroi revizion, më 30 nëntor 2011, në Gjykatën Supreme. Revizioni u refuzua si i palejuar, nga Gjykata Komunale e Prizrenit. Parashtruesi, më pas, u ankua në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit C. nr. 61/2008, të 13 janarit 2012, me të cilin nuk iu lejua ushtrimi i këtij mjeti juridik.

34. Gjykata e Apelit, sipas kërkesës së Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet shkresës A. Gj. nr. 130/13, më 17 prill 2013, njoftoi se ankesa e parashtruesit, e ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 61/2008, të 13 janarit 2012, është në fazën e vendosjes (lënda Ac. nr. 3154/2012).

35. Bazuar nga sa u tha më lartë, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, meqë kontesti pronësor është akoma në fazën e vendosjes nga Gjykata e Apelit në Prishtinë. Prandaj, në rastin konkret, kemi të bëjmë me mosshterjen e të gjitha mjeteve juridike në dispozicion.

36. Gjykata Kushtetuese nuk vendos për meritat e kërkesës, përderisa kërkesa e parashtruar nuk përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri. Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një kontest pronësor që ende nuk ka përfunduar në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Andaj, çdo vendim i Gjykatës, përderisa të mos përfundojë një çështje juridike (vendimi i kontestuar) para autoriteteve të rregullta gjyqësore, do të konsiderohej ndërhyrje në pavarësinë dhe në vendimmarrjen e tyre.

37. Në pajtim me parimin e subsidiaritetit, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është i detyruar të shterë të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, siç parashihet në nenin 113 (7) të Kushtetutës dhe në dispozitat e tjera ligjore, të cilat u përmendën më lart.

38. Në të vërtetë, qëllimi i rregullit të shterimit është që gjykatave të rregullta t'i ofrohet mundësia e korrigjimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës. Rregulli i shterimit është në mënyrë funksionale i ndërthurur me karakterin e subsidiaritetit të kornizës procedurale të drejtësisë kushtetuese. (*Shih, mutatis mutandis, Selmouni kundër Francës [GCl, § 74; Kudla kundër Polonisë [GCl, § 152; Andrashik dhe të tjerët kundër Sllovakisë [dec.]).*

39. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Ndryshe, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo nëse dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Ai dështim do të kuptohet si heqje dorë nga e të drejta për të kundërshtuar më tej shkeljen dhe si heqje dorë nga e drejta për t'u ankuar. *(Shih, Aktvendimi në rastin KI07/09, Deme Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18).*

40. Kurdo që kontestohet një vendim në bazë të një qëndrimi juridik që është i papranueshëm nga pikëvështrimi i të drejtave dhe i lirive themelore të njeriut, gjykatave të rregullta që sollën vendimin, duhet ofruar mundësinë e rishqyrtimit të vendimit të kontestuar. Kjo do të thotë se, çdoherë, kur pretendohet shkelja e të drejtave të njeriut, nuk është e thënë që ky pretendim të arrijë në Gjykatën Kushtetuese para se të shqyrtohet paraprakisht nga gjykatat e rregullta.

41. Në fakt, kjo analizë është në përputhshmëri me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane, e cila parasheh që parashtruesit vetëm duhet shteruar mjetet vendëse që i kanë në dispozicion në teori dhe në praktikë në kohën përkatëse, që do të thotë se ato janë të arritshme, se janë në gjendje të sigurojnë zgjidhje për ankesat e tyre dhe se ofrojnë mundësi të arsyeshme për sukses. (*Shih, Sejdovic kundër Italisë [GCl, nr. 56581/00, KEDNJ 2006-IJ § 46).* Duhet vlerësuar, në të gjitha rrethanat e rastit, nëse parashtruesi i kërkesës ka bërë gjithçka që me

arsye pritet prej tij për të shteruar mjetet vendëse. *(Shih, D. H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke [GCl, §§ 11622).*

Kërkesa për Masë të përkohshme

42. Parashtruesi, gjithashtu, kërkon që Gjykata të vendosë Masë të përkohshme për pezullimin e vendimit të Gjykatës Themelore-Dega në Prizren, E. nr. 1889/12, ku titull përmbarues është Aktgjykimi C. nr. 61/2008, i 16 tetorit 2009, i vërtetuar nga Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin Ac. nr. 158/2010, e 10 tetorit 2011.

43. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 116.2 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të paripërueshme".*

44. Gjykata, gjithashtu, merr në konsideratë nenin 27 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Gjykata Kushtetuese, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës, mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të paripërueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik".*

45. Për më tepër, rregulli 54 (1) i Rregullores së punës, parasheh:

> "*Në çfarëdo kohe, përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës se përkohshme*".

46. Së fundi, rregulli 55 (1) i Rregullores së punës, parasheh:

> *"Kërkesa për Masë të përkohshme do të shqyrtohet me shpejtësi nga Gjykata dhe do t'i jepet përparësi para të gjitha kërkesave të tjera".*

47. Duhet që, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, të gjejë se: Në mënyrë që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme

"(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme; dhe

(c) Masa e përkohshme është me interes publik.

Nëse pala që kërkon Masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

48. Nga arsyet e cekura më lart del se kërkesa e parashtruesit nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 113.7 dhe të nenit 116 (2) të Kushtetutës; të nenit 27 dhe të nenit 47.2 të Ligjit; dhe nuk është në pajtueshmëri me rregullin 36.1 (a) e me rregullin 55 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7 dhe në bazë të nenit 116.2 të Kushtetutës; në bazë të nenit 27 dhe të nenit 47.2 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.1 (a), me rregullin 55 dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores; më 17 maj 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 02/13, Halil Mazreku, datë 31 maj 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 691/01, të 11 dhjetorit 2007, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 24/09, të 12 majit 2011

Rasti KI02/13, Aktvendim për papranueshmëri i 30 prillit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kontest civil, shkelje e të drejtave të procedurës kontestimore, kërkesë qartazi e pabazuar

Parashtruesi pretendonte se gjykatat e rregullta, me vendimet e tyre, ia kishin shkelur atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Parashtruesi nuk kishte specifikuar në kërkesë se cilat të drejta kushtetuese i ishin shkelur nga autoritetet publike, përkatësisht nga gjykatat e rregullta. Ai vetëm kishte përmendur se gjykatat e rregullta, gjegjësisht Gjykata e Qarkut në Prizren aplikoi gabimisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore dhe dispozitat e ligjit për ndërrimin dhe për plotësimin e ligjit për qarkullimin e patundshmërive.

Në këtë rast, parashtruesi nuk i kishte mbështetur pretendimet e tij në baza kushtetuese. Ai nuk kishte argumentuar pse dhe si Gjykata e Supreme ia kishte shkelur atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane. Në këtë rast, Gjykata gjeti se, kërkesa nuk i përmbushte kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe të rregullit 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, prandaj dhe kërkesa u deklarua e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPARANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI02/13
Parashtrues
Halil Mazreku
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 691/01, të 11 dhjetorit 2007, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 24/09, të 12 majit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Halil Mazreku, me vendbanim në lagjen "Arbana", komuna e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 691/01, e 11 dhjetorit 2007, dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 24/09, e 12 majit 2011.

3. Ndërsa, në rastin konkret, mjet i fundit juridik, për shkak të respektimit të afatit katër (4) mujor, konsiderohet Njoftimi KMLC nr. 45/11, i 6 korrikut 2011, i Prokurorit të Shtetit të Kosovës, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 25 korrik 2011.

Objekti i çështjes

4. Çështja bazë e kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 691/2001, të 11

dhjetorit 2007, dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 24/09, të 12 majit 2011, përkitazi me të drejtën e parashtruesit.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe rregulli 28 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 9 nëntor 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesë të pakompletuar në Gjykatë.

7. Më 11 nëntor 2011, Gjykata kërkoi nga parashtruesi dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm, përfshirë këtu edhe vendimet gjyqësore të gjykatave të rregullta.

8. Më 8 janar 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, duke ia bashkëngjitur asaj edhe dokumentacionin e kërkuar.

9. Më 18 janar 2013, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën Themelore në Prizren dhe Gjykatën e Apelit në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës KI02/13 në regjistrin përkatës të Gjykatës.

10. Më 30 janar 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues dhe caktoi edhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues, që e zëvendëson gjyqtarja Snezhana Botusharova), Ivan Čukalović (anëtar) dhe Prof dr. Enver Hasani (anëtar).

11. Më 5 shkurt 2013, Gjykata kërkoi dokumentacion shtesë nga Gjykata Themelore në Prizren.

12. Më 5 shkurt 2013, Gjykata Themelore e Prizrenit dërgoi dokumentacionin e kërkuar.

13. Më 30 prill 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 5 dhjetor 2001, parashtruesi ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Prizren, në bazë të kontratës mbi shitblerjen (kontrata e pavërtetuar), e lidhur më 6 janar 1984, ndërmjet z. Halil Mazrekut (blerësi) dhe, tani të ndjerit, Bajram Sadik Berishës (shitësi). Parashtruesi pohon se pas blerjes është bërë pronar i patundshmërisë (ngastra kadastrale nr. 402, ZK Arbanë, me kulturë arë e kl. IV, në vendin e quajtur "Nën fshat, te rruga", me sipërfaqe 1.17,00 ha, ngastër kadastrale të cilën shitësi e kishte marrë në emër të ndërrimit me parcelën 146 dhe me parcelën 383 nga KBI "Progres-Export" në Prizren). Të paditurit, gjegjësisht familjarët e ish-pronarit, tani të ndjerit Bajram Berisha, nëpërmjet kontestit civil, kanë arritur ta rikthejnë ngastrën kadastrale me nr. 383, në vendin e quajtur "Nën fshat, te rruga", arë e kl. IV, me sipërfaqe 0.74,33 ha, në bazë të fletës poseduese nr. 254, KK Arbanë, e cila evidencohet në emër të të paditurve. Parashtruesi, nëpërmjet padisë së ushtruar, ka kërkuar vërtetimin e kontratës së shitblerjes së patundshmërisë dhe njohjen e pronësisë mbi patundshmërinë e blerë, si dhe regjistrimin e tij si pronar të saj.

15. Më 11 dhjetor 2007, Gjykata Komunale në Prizren, me Aktgjykimin C. nr. 691/01, e 11 dhjetor 2007, refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit për vërtetimin e pronësisë për të cilën parashtruesi pretendon se e kishte blerë nga tashmë i ndjeri Bajram Berisha (shitësi). Me aktgjykimin e njëjtë, gjykata në fjalë refuzoi ankesën e ushtruar nga të paditurit, gjegjësisht nga familjarët e të ndjerit Bajram Berisha, për kthimin e parcelës nr. 146, në vendin e quajtur "Bregu, te rruga", me kulturë arë jopjellore, me sipërfaqe 30 m2, dhe me kulturë arë e kl. IV, me sipërfaqe 0.65,03 hektarë, dhe parcelën nr. 383, në vendin e quajtur "Nën fshat, te rruga", me kulturë arë e kl. IV, me sipërfaqe 0.74,33 hektarë – të gjitha së bashku me sipërfaqe 1.39,66 hektarë, sipas listës poseduese nr. 252, ZK Arbanë.

16. Më 12 maj 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin Ac. nr. 24/09, refuzoi ankesën e ushtruar nga parashtruesi dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 691/2001, e 11 dhjetorit 2007. Gjykata e Qarkut, në këtë rast, konstatoi se vendimi i gjykatës së shkalles së parë nuk përbënte shkelje esenciale të procedurës kontestimore, siç pretendohej nga ankuesit, për faktin që shkalla e parë kishte vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe, po ashtu, kishte aplikuar drejt ligjin në këtë çështje juridike.

17. Më 23 qershor 2011, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës ushtroi të drejtën e tij me propozim që Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës

të iniciojë procedurë për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, kundër Aktgjykimit të fuqisë së prerë të Gjykatës Komunale në Prizren, C. Nr. 691/2001, të 11 dhjetorit 2007, dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. Nr. 24/09, të 12 majit 2011.

18. Më 6 korrik 2011, Prokurori i Shtetit, nëpërmjet Njoftimit KMLC nr. 45/11, refuzoi propozimin e parashtruesit përkitazi me ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë, pasi nuk gjeti bazë të mjaftueshme ligjore për ngritjen e saj.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta, me vendimet e tyre, ia kanë shkelur atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Parashtruesi nuk ka specifikuar në kërkesë se cilat të drejta kushtetuese i janë shkelur nga autoritetet, përkatësisht nga gjykatat e rregullta. Ai vetëm ka përmendur se gjykatat e rregullta, gjegjësisht Gjykata e Qarkut në Prizren, ka aplikuar gabimisht dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe dispozitat e Ligjit për ndërrimin dhe për plotësimin e Ligjit për qarkullimin e patundshmërive.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata vlerëson së pari nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi konteston vendimin e shkallës së parë dhe vendimin e shkallës së dytë, si akte konkrete të autoriteteve publike. Parashtruesi, në kërkesën e tij, nuk ka specifikuar saktësisht shkeljet kushtetuese të të drejtave të tij. Megjithatë, Gjykata vëren se bëhet fjalë për të drejtat pronësore. Parashtruesi, gjithashtu, ka përmendur se çfarë dëshiron të arrijë nëpërmjet kërkesës se tij dhe ka bashkëngjitur vendime të ndryshme dhe informata e dokumente të tjera mbështetëse.

21. Sa i përket të drejtës në pronë, neni 46 i Kushtetutës, në mënyrë specifike përcakton:

> *"Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe*

pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve eksproprijohet". (Shih paragrafin 3, e nenit 46).

22. Gjykata Kushtetuese vëren se bazat e ankesës së parashtruesit, si në shkallën e parë, si në shkallën e dytë, ashtu edhe në propozimin për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, përmbajnë pretendime që kanë të bëjnë me shkelje substanciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes se ligjit të aplikuar në rastin konkret.

23. Gjykata Kushtetuese konsideron se këto pretendime mund të jenë të fushës së ligjshmërisë. Kërkesa duhet të ngrihet dhe të argumentohet mbi bazën e ankimit kushtetues (kushtetutshmërisë), duke përmendur saktësisht dispozitat kushtetuese me të cilat pretendohen shkeljet e të drejtave kushtetuese të parashtruesit a parashtruesve.

24. Megjithatë, Gjykata analizon dhe vlerëson nëse parashtruesi ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, duke i mbështetur me prova pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë. Parashtruesi duhet të qartësojë në kërkesën e tij se cilat të drejta kushtetuese pretendon se i janë shkelur me aktin e autoritetit a të autoriteteve publike. Përkitazi me këtë, Gjykata vëren se neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese qartazi përcakton se *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar"*.

25. Për më tepër, rregulli 36.2 i Rregullores së punës, përcakton:

"(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie;

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

26. Së fundi, neni 46 i Ligjit përcakton që *"Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7, të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore"*.

27. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk tregon pse dhe si gjykatat e rregullta ia kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe as që ka ofruar prova për shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese. Gjykata rikujton që rasti duhet të ndërtohet në baza kushtetuese, në mënyrë që kjo gjykatë të ndërhyjë.

28. Është kompetencë e gjykatave të rregullta të vlerësojë ligjshmërinë e një dokumenti, në këtë rast të kontratës për shitblerjen e patundshmërisë, sipas bindjes së tyre, konform ligjit, bazuar në faktet dhe në provat që ofrojnë palët e përfshira në procedurë të rregullt gjyqësor.

29. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me lajthitje të fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), gjoja të kryera nga gjykatat e rregullta, përveç nëse dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë. Prandaj, në këtë rast, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së tretë. Është detyrë dhe obligim i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I*).

30. Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë vetëm nëse provat para gjykatave dhe para organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (*Shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991*).

31. Në të vërtetë, parashtruesi nuk i ka mbështetur pretendimet e tij në baza kushtetuese, duke treguar pse dhe si Gjykata e Supreme ia ka shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga Gjykata Supreme. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të gjejë pse dhe si ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme (*Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,*

Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

32. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata gjen së kërkesa nuk i përmbush kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe të rregullit 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës dhe, si e tillë, është qartazi e pabazuar.

33. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 20 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 56.2 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 48 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36.2 (b) dhe (d) dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores, më 31 maj 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA REFUZOJ kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 73/12, Bujar Sahitaj, datë 31 maj 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 24/2009, të 7 dhjetorit 2011

Rasti KI 73/12, Aktvendim për papranueshmëri 15 majit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë e dorëzuar jashtë afatit, Aktvendim për Papranueshmëri, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kontest pronësor

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se me vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev, Nr. 24/2009 qe koniformonte vendimet e instancave më të ulta gjyqësore të cilat kishin vërtetuar tranferimin e pronësisë së një pjese të tokës nga pronësia shoqëroe në ate private dhe që kishte ndikuar negativisht në një pjesë tjetër të tokës që i takon banorëve të tjerë të fshatit, një ndër të cilët është edhe parashtruesi. Prandaj, pretendohet se ka rezultuar me shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe të nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Prej dokumentacionit të dorëzuar nga parashtruesi, Gjykata konkluldoi se kërkesa është parashtruar në Gjykatën Kushtetuese më 31 korrik 2012, përderisa vendimi i Gjykatës Supreme, i cili pretendohet nga parashtruesi se ia shkel të drejtat, ka fletëpranimin më 15 shkurt 2012. Si rrjedhojë, del se kërkesa është dorëzuar në Gjykatë Kushtetuese 5 muaj e 16 ditë pas pranimit të vendimit të Gjykatës Supreme.

Prandaj, Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme, pasi që ishte dorëzuar pas afatit të paraparë me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e Punës së Gjykatës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI73/12
Parashtrues
Bujar Sahitaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 24/2009, të 7 dhjetorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Bujar Sahitaj, me vendbanim në fshatin Sopijë, komuna e Suharekës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 24/2009, i 7 dhjetorit 2011, i cili i është dërguar parashtruesit më 15 shkurt 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës ankohet se pronësia e një pjese të tokës në shtratin e lumit në fshatin Sopijë është transferuar nga pronësia shoqërore në atë private me anë të një vendimi të Gjykatës Komunale në Suharekë. Pretendohet se kjo ka ndikuar negativisht në një pjesë tjetër të tokës që i takon banorëve të tjerë të fshatit, një ndër të cilët është edhe parashtruesi. Prandaj, pretendohet se ka rezultuar me shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe të nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 31 korrik 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Me Vendimin e Kryetarit të Gjykatës, Nr. GJR. 73/12, të 4 shtatorit 2012, gjyqtari Altay Suroy u emërua Gjyqtar raportues. Në po të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit, Nr. KSH. 73/12, u caktua Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 27 shtator 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua edhe Gjykatës Supreme të Kosovës.

8. Më 28 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese i dërgoi një shkresë Gjykatës Komunale në Suharekë, në të cilën kërkohej të dorëzohet në Gjykatë Kushtetuese fletëpranimi që dëshmon datën kur e ka pranuar parashtruesi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 24/2009, e 7 dhjetorit 2011.

9. Më 3 tetor 2012, Gjykata pranoi një shkresë nga Gjykata Komunale e Suharekës, të cilës i ishte bashkëngjitur kopja e fletëpranimit, e nënshkruar më 15 shkurt 2012 nga bashkëshortja e parashtruesit.

10. Më 15 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë.

Përmbledhja e fakteve

11. Me Aktgjykimin C. Nr. 83/89, të 18 majit 1989, Gjykata Komunale e Suharekës ia ndau familjes R. të drejtat pronësore mbi shtratin e lumit në hapësirë prej 0.50.60 ha, në bazë të "parashkrimit fitues". Më herët, kjo pjesë e tokës ishte e dokumentuar në librat kadastralë si shtrat i lumit dhe pronë shoqërore që i takonte Komunës së Suharekës. Regjistrimi i tillë ishte zbuluar të jetë bërë gabimisht, pasi që familja R. e

kishte blerë këtë pjesë të tokës 35 vjet më parë dhe që nga atëherë e kishte shfrytëzuar vazhdimisht.

12. Drejtoria për Çështje Juridike Pronësore, me Aktvendimin 10-466/190, të 6 tetorit 2006, vendosi që pjesa specifike e tokës së shtratit të lumit prej 0.11,45 ha, e blerë nga familja R., ka qenë e uzurpuar, pasi aktgjykimi fillestar, që ia njihte të drejtat pronësore, nuk ishte ekzekutuar e as nuk ishte regjistruar në librat kadastralë si pronë private, dhe edhe më tutje e njeh si pronë shoqërore.

13. Pronarët e parcelave kadastrale 351-354, të cilat janë të ngjitura me parcelën 1528, pohonin se prona e kontestuar ishte duke u dëmtuar, pasi pronarët e ngushtonin atë duke ndërtuar një mur. Nëpërmjet kësaj, ata donin të tjetërsonin rrjedhën natyrale të lumit dhe kështu të rrezikoheshin nga vërshimet tokat fqinje dhe të vështirësohej qasja në to.

14. Me parashtresën kundërshtuese, E. Nr. 266/06, Kuvendi Komunal i Suharekës i bëri thirrje Gjykatës Komunale në Suharekë të refuzojë procedurën e përmbarimit, pasi kishte skaduar afati i përgjithshëm 10-vjeçar për përmbarimin e vendimeve gjyqësore.

15. Më 9 korrik 2006, ishte iniciuar procedura e përmbarimit të aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Suharekë, në bazë të kërkesës së kreditorit R. A. R., me qëllim të vërtetimit të së drejtës së tij pronësore.

16. Komuna e Suharekës, më 27 tetor 2007, propozoi pezullimin e kësaj procedure, me arsyetimin se kërkesa për përmbarimin e aktgjykimit është bërë jashtë afatit kohor, deri sa Prokurori Publik i Qarkut në Prizren të vendosë përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

17. Kryeshefi Ekzekutiv kishte bërë një ankesë, Nr. 976, më 24 nëntor 2006, e cila ishte refuzuar si e pabazë dhe kështu mbeti në fuqi Vendimi i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike Pronësore, Nr. 466/190.

18. Gjendja e përshkruar nga pronarët e parcelave kadastrale 351-354 ishte konfirmuar nga një inspektim i vendit nga një ekspert i gjeodezisë së Gjykatës Komunale, në seancën e 8 dhjetorit 2006, me rastin e shqyrtimin të ankesës për pengim të posedimit. Gjykata Komunale vendosi masë të përkohshme me të cilën e obligoi R. R. të pezullojë veprimet e tij dhe të shembë murin.

19. Më 24 korrik 2007, Bujar Sahitaj dhe I. S., duke pretenduar statusin e ndërhyrësit në procedurë, propozuan përsëritjen e procedurës nga Gjykata Komunale në Suharekë, duke u arsyetuar se Komuna nuk e ka pranuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu, dorëzoi edhe një deklaratë nga ish-Avokati Publik i Komunës së Suharekës, A. B., duke pohuar se, me rastin e përfundimit të punësimit të saj, rasti C. Nr. 83/89 ishte në vazhdim e sipër dhe se nënshkrimi i saj, që mbështeste aktgjykimin, ishte falsifikuar.

20. Gjykata Komunale në Suharekë, me Vendimin nr. 187/2007, e refuzoi propozimin për përsëritjen e procedurës, pasi ndërhyrësit nuk ishin paraqitur si palë në procedurat e mëparshme, prandaj nuk mund të gëzonin statusin e palës.

21. Në ankesën e parashtruesit kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale në Suharekë, Gjykata e Qarkut në Prizren nxori Aktvendimin Ac. Nr. 55/2008, e 6 tetorit 2008, me të cilin refuzoi ankesën si të pabazuar dhe rikonfirmoi vendimin e Gjykatës Komunale në Suharekë.

22. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut, duke pretenduar shkelje të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.

23. Gjykata Supreme e Kosovës, në pajtim me nenin 232 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, konsideroi që propozimi për revizion është i pabazuar. Gjykata Supreme theksoi se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale, C. Nr. 83/89, është përfundimtar për këtë rast, me të cilin konfirmohet pronësia për parcelën kadastrale nr. 1528. Gjithashtu, në pajtim me kreun IV të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili rregullon çështjen e statusit të palës, refuzoi ankesën e ushtruar nga ndërhyrësit si të papranueshme.

Pohimet e parashtruesit të kërkesës

24. Paraqitësi i kërkesës pretendon se tre dëshmitarët kanë qenë të manipuluar dhe nën presion me rastin e dhënies së dëshmisë së tyre në Gjykatën Komunale në vitin 1989.

25. Më tej, parashtruesi konsideron si të gabueshëm vazhdimin e procedurës në Gjykatën Komunale në Suharekë, edhe pse pala paditëse kishte tërhequr kërkesën për njohjen e të drejtës pronësore.

26. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 421, paragrafi 2, në lidhje me nenin 423, paragrafi 3, të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

27. Parashtruesi pretendon se i është shkelur e drejta në pronë, e garantuar me nenin 46, dhe e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

28. Gjykata Kushtetuese, për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".*

30. Prej dokumentacionit të dorëzuar nga parashtruesi, mund të konkludohet se kërkesa është parashtruar në Gjykatën Kushtetuese më 31 korrik 2012, përderisa vendimi i Gjykatës Supreme, i cili pretendohet nga parashtruesi se ia shkel të drejtat, ka fletëpranimin më 15 shkurt 2012. Si rrjedhojë, del se kërkesa është dorëzuar në Gjykatë Kushtetuese 5 muaj e 16 ditë pas pranimit të vendimit të Gjykatës Supreme.

31. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata gjen se kërkesa nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të parapara më nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, prandaj, në pajtim me nenin 49 të Ligjit, është e papranueshme dhe nuk mund të procedohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 20 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.2 dhe 56 të Rregullores së punës, më 27 maj 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 03/13 i KO 28/13, Demë Dashi dhe të tjerët si dhe Ali Lajçi, datë 14 qershor 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për Parkun Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna", të publikuar më 21 janar 2013, në Gazetën Zyrtare

Lënda KI 03/13 i KO 28/13, Aktvendim për papranueshmëri i 15 majit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, parashtruesi i dytë Komuna e Pejës, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për Parkun Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna".

Kërkesa e parashtruesit të parë është bazuar në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës; në nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetues (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).
Kërkesa e parashtruesit të dytë është bazuar në nenin 113.4. të Kushtetutës.

Parashtruesit paraqitën kërkesat në Gjykatën Kushtetuese, më 10 janar 2013 dhe më 5 mars 2013.

Parashtruesit e parë pretendojnë se Ligji është *"kundër të drejtave themelore të njeriut, sepse nuk e respekton të drejtën e pronës".*
Parashtruesi i dytë thekson se Ligji "*zvogëlon dhe shkel pronën e Komunës, shkel interesat e saj (zvogëlon të ardhurat).*

Me Vendimin e Kryetarit, nr. GJR. KI 03/13, të 30 janarit 2013, u caktua gjyqtari Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues, dhe në të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit, KSH 03/13, u caktua Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama Hajrizi.

Gjykata gjatë shqyrtimit të rastit konstatoi:

Së pari, parashtruesi i parë nuk e ka saktësuar aktin e autoriteti publik *(në pajtim me nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese)* që pretendohet të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre individuale të garantuara e Kushtetutë dhe me konventat ndërkombëtare, të cilat janë drejtpërdrejt të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Së dytë, Gjykata vëren se parashtruesi i dytë deklaron se Ligji nr. 03/L-121 për Parkun Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna" "zvogëlon dhe cenon pronën e Komunës, i shkel interesat e saj *(i zvogëlon të hyrat)".*

Sa i përket parashtruesit të parë, Gjykata konsideron se Kushtetuta nuk parashikon *actio popularis,* e cila është një modalitet i ankesës së individit, që u mundëson atyre që të iniciojnë vlershmin abstrakt, pavarësisht nga interesi i tyre specifik juridik në rastin në fjalë.

Sa i përket parashtruesit të dytë, Gjykata konsideron se shpjegimet fillestare dhe shtesë, si dhe provat e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës, nuk janë relevante dhe të rëndësishme për një konkluzion të arsyeshëm se Komuna është prekur nga ligji i kontestuar, duke bërë shkelje të përgjegjësisë së saj apo duke i zvogëluar të ardhurat e saj, në pajtim me nenin 113.4 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

Në përfundim, sipas nenit 113 (1) të Kushtetutës, Gjykata nuk mund të vendosë për një çështje e cila nuk i është adresuar asaj në një mënyrë ligjore, sepse në pajtim me dispozitat e kombinuara ligjore të nenit 113 (4) dhe (7) të Kushtetutës, parashtruesi i parë dhe i dytë nuk janë palë të autorizuara.

Rrjedhimisht, në seancën e mbajtur më 15 maj 2013, Gjykata arriti në përfundim se të dy kërkesat KI 03/13 i 28/13 janë të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastet nr. KI03/13 dhe KO28/13
Parashtruesit
Demë Dashi dhe të tjerët
dhe Ali Lajçi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë
së Ligjit për Parkun Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna“,
të publikuar më 21 janar 2013 në Gazetën Zyrtare

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesit

1. Parashtrues të kërkesës janë Demë Dashi dhe të tjerët nga Peja (në tekstin e mëtejmë**:** Parashtruesi i parë) dhe Ali Lajçi si përfaqësues i Komunës së Pejës (në tekstin e mëtejmë**:** Parashtruesi i dytë).

Vendimi i kontestuar

2. Të dy parashtruesit kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit 2011/04-L-086 për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, të aprovuar nga Kuvendi më 13 dhjetor 2012, të shpallur me Dekretin Nr. DL-60-2012 të Kryetarit të Republikës së Kosovës, më 26 dhjetor 2012, dhe të publikuar në Gazetën Zyrtare më 21 janar 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i parë pretendon se Ligji *“është kundër të drejtave themelore të njeriut, sepse nuk e respekton të drejtën e pronës.“*

4. Parashtruesi i dytë pretendon se Ligji *“e zvogëlon dhe cenon pronën e komunës, i cenon interesat e saj (i zvogëlon të hyrat)”.*

Baza juridike

5. Kërkesa e parashtruesit të parë bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës; nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

6. Kërkesa e parashtruesit të dytë bazohet në nenin 113.4 të Kushtetutës.

Procedura në Gjykatë

7. Më 10 janar 2013, parashtruesi i parë paraqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

8. Më 14 janar 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i parë që të parashtrojë kërkesën në formën e paraparë me Rregullore.

9. Më 21 janar 2013, parashtruesit e parë paraqitën kërkesë siç kërkohej nga Gjykata.

10. Më 30 janar 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama Hajrizi.

11. Më 5 mars 2013, parashtruesi i dytë e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

12. Më 21 mars 2013, Gjykata i dërgoi shkresë parashtruesit të dytë, duke kërkuar informata shtesë në lidhje me rastin.

13. Më 25 mars 2013, Kryetari, në pajtim me rregullin 37.1 të Rregullores së punës urdhëroi bashkimin e kërkesave KI03/13 dhe KO28/13.

14. Më 26 mars 2013, Gjykata e njoftoi Kuvendin e Kosovës se Ligji 2011/04-L-086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" është objekt i çështjes së kërkesave të dorëzuara nga të dy parashtruesit.

15. Më 8 prill 2013, parashtruesi i dytë i dorëzoi informatat shtesë të kërkuara nga Gjykata më 21 mars 2013.

16. Më 29 prill 2013, parashtruesi i parë kërkoi që Gjykata të bëjë ndarjen e rasteve dhe trajtimin e tyre në mënyrë individuale.

17. Më 14 maj 2013, Kryetari, në bazë të propozimit të Gjyqtarit Raportues, mbajti në fuqi vendimin për bashkimin e rasteve KI03/13, KO28/13.

18. Më 15 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e Kërkesave.

Përmbledhja e fakteve

19. Ligji nr. 03/L-121 për Parkun Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna“ ishte aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 13 dhjetor 2012, i shpallur me Dekretin Nr. DL-60-2012 e Kryetarit të Republikës së Kosovës më 26 dhjetor 2012 dhe i publikuar në Gazetën Zyrtare më 21 janar 2013.

20. Neni 1 i atij Ligji thekson se *“pjesa e territorit të Bjeshkëve të Nemuna si tërësi hapësinore e cila veçohet me vlera dhe raritete natyrore, me numër të madh të ekosistemeve të rëndësishme pyjore dhe ekosisteme të tjera të ruajtura, me numër të konsiderueshëm të llojeve endemike dhe relikte, me karakteristika të pasura gjeo-morfologjike, hidrologjike dhe peizazhore që kanë rëndësi shkencore, edukativo – arsimore, kulturore–historike, rekreative - turistike dhe veprimtaritë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik sipas kritereve mjedisore, shpallet Park kombëtar me emrin: Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.*

21. Neni 3 i Ligjit parasheh se *“Në territorin e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” vendosen regjimet e mbrojtës sipas zonave.”* Më tej në Ligj janë specifikuar katër zona.

22. Përveç kësaj, neni 5 i Ligjit parasheh se *“Të drejtat pronësore dhe denacionalizimi rregullohen me ligje të veçanta dhe nuk janë objekt i këtij Ligji.”*

23. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i parë, banorët e zonës së Rugovës, iniciuan procedurën për kontestimin e Ligjit të miratuar, gjegjësisht nënshkruan një peticion kundër tij.

24. Më 30 mars 2012, një grup prej 31 (tridhjetë e një) anëtarëve të Kuvendit Komunal të Pejës e dorëzuan një Propozim në Kuvendin Komunal të Pejës *“Të shpallet krahina e Rugovës zonë e interesit të veçantë nacional për turizëm dhe kulturë me tendencë të zhvillimit të një komune ekologjike, në kuadër të zhvillimeve kombëtare për mbrojtjen e ambientit”*. Në arsyetimin e Propozimit thuhet se “*Qeveria e Kosovës ka autorizuar Komisionin Parlamentar për Planifikim*

Hapësinor dhe Zhvillim Ekonomik për përgatitjen e Ligjit për parqet nacionale, gjë që del edhe nga raporti i Progresit që një pjesë e territorit të shpallet park nacional. Sipas propozimeve, parku nacional do të përfshinte disa pjesë të rajonit të Dukagjinit në 5 komuna – Gjakovë, Junik, Deçan, Pejë dhe Istog."

25. Të njëjtën datë, Kuvendi Komunal i Pejës aprovoi Konkluzionin *"duke përkrahur propozimin – kërkesën e këshilltarëve të Kuvendit Komunal Pejë 'për shpalljen e krahinës– zonës së Rugovës në sipërfaqe prej 32.492 ha, zonë të interesit të veçantë nacional për turizëm dhe kulturë me tendenca të zhvillimit të një komune ekologjike në kuadër të zhvillimeve kombëtare për mbrojtje të ambientit' dhe i rekomandohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përkatësisht Komisionit Parlamentar për Planifikim Hapësinor dhe Zhvillim Ekonomik për përgatitjen e Ligjit për Parqe Nacionale, që këtë formulim si të tillë ta përfshijë në tekstin e Projekt-Ligjit për Planifikim Hapësinor, si formulim i drejtë dhe adekuat, që është njëkohësisht në interes të zonës në fjalë, banorëve të saj, si dhe në interes kombëtar të Kosovës në tërësi."*

26. Më 11 prill 2012, Komuna e Pejës ia dërgoi Konkluzionin e miratuar të Komunës së Pejës Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Komisionit Parlamentar për Planifikim Hapësinor.

Pretendimet e parashtruesit

27. Parashtruesi i parë pretendon se nënshkruesit e peticionit nuk janë të konsultuar nga ligjvënësit për hartimin e ligjit.

28. Parashtruesi i parë më tutje pretendon se në vitin 1946, pronat private të nënshkruesve të peticionit u patën konfiskuar dhe sipas Vendimit të Kuvendit Komunal, prona e lartpërmendur i ishte dhënë në shfrytëzim kooperativave bujqësore.

29. Parashtruesi i parë pohon se sipërfaqja e përfshirë me ligjin e ri konsiderohet si pronë kontestuese dhe ajo duhet t'iu kthehet pronarëve të mëparshëm.

30. Parashtruesi i parë në fund pretendon se një numër i madh i padive tashmë janë dorëzuar në Gjykatën Komunale nga nënshkruesit e peticionit për kthimin e pronës.

31. Parashtruesi i parë kërkon nga Gjykata:

"ta anulojë Ligjin për Parkun Kombëtar "Bjeshket e Nemuna" të miratuar më 13 dhjetor 2012 dhe të hartohet ligji i ri që nuk do ta përfshijë zonën e Rugovës në zonat e parkut deri sa të zgjidhen çështjet pronësore juridike."

32. Parashtruesi i dytë pretendon se Ligji nr. 03/L-121 për Parkun Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna" "zvogëlon dhe cenon pronën e komunës, i shkelë interesat e saj *(i zvogëlon të hyrat)*, sepse *"- Nuk është e garantuar se prona private nuk do të tjetërsohet dhe nuk është e garantuar se do të kompensohet - Pronarët nuk e dëshirojnë Parkun Nacional"*

Pranueshmëria e kërkesës

33. Para se të fillohet me vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesave, Gjykata rikujton se, në bazë të rregullit 37.1 të Rregullores së Punës, ishte urdhëruar bashkimi i dy Kërkesave.

34. Rregulli 37.1 i Rregullores së Punës parasheh se, kur "kërkesa mund të jetë e ndërlidhur për nga çështja e trajtuar në të me një kërkesë tjetër të parashtruar para Gjykatës dhe të jetë e drejtuar kundër aktit të njëjtë të një autoriteti publik", Kryetari mund të urdhërojë bashkimin e kërkesave të ndara". Rregulli më tej parasheh se " nëse pala nuk pajtohet me vendimin e Gjykatës për t'i bashkuar ose ndarë kërkesat, ajo mund të kërkojë rishqyrtimin e vendimit, së bashku me çfarëdo argumenti faktik ose ligjor, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e fundit urdhrit të Kryetarit për t'i bashkuar ose ndarë (...) kërkesat".

35. Parashtruesi i parë kërkoi që Gjykata të bëjë ndarjen e rasteve dhe trajtimin e tyre në mënyrë individuale.

36. Sidoqoftë, parashtruesi i parë nuk e mbështeti dhe nuk dëshmoi me fakte ose argumente juridike që do të çonte në rishqyrtimin e vendimit.

37. Prandaj, Kryetari, sipas propozimit të Gjyqtarit raportues, mbajti në fuqi vendimin për bashkimin e kërkesave KI03-13 dhe KO28-13, për shkak të mungesës së bazës së mjaftueshme për ndarjen e sërishme të kërkesave.

38. Pas shqyrtimit paraprak, Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar të gjitha kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Rregulloren e Punës.

39. Gjykata i referohet Nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili parasheh si në vijim:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim: (1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;

(...)

4. Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.

5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

40. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (3) c) të Rregullores së punës që parasheh:

Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese: kur:

c) kërkesa parashtrohet nga një palë e paautorizuar;

41. Në fakt, neni 113 (2) i Kushtetutës përcakton se vetëm Kuvendi, Presidenti i Republikës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë palë të autorizuara për të ngritur në Gjykatën Kushtetuese çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

42. Veç kësaj, neni 113 (5) i Kushtetutës përcakton se dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi.

43. Në këtë mënyrë, individët e referuar në nenin 113 (7) të Kushtetutës nuk janë palë të autorizuara t'i ngrenë çështjet në Gjykatën Kushtetuese përkitazi me përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën. Përkundrazi, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

44. Së pari, Gjykata vëren se parashtruesi i parë nuk e ka saktësuar aktin e autoritetit publik *(shih neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese)* që pretendohet të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre individuale të garantuara me Kushtetutë dhe me konventat ndërkombëtare, të cilat janë drejtpërdrejtë të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

45. Së dyti, Gjykata vëren se parashtruesi i dytë deklaron se Ligji nr. 03/L-121 për Parkun Kombëtar „Bjeshkët e Nemuna "zvogëlon dhe cenon pronën e komunës, i shkelë interesat e saj *(i zvogëlon të hyrat)"*.

46. Në fakt, në rastin konkret, parashtruesi i parë i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës si bazë ligjore për parashtrimin e Kërkesës 03/13; derisa parashtruesi i dytë i referohet nenit 113 (4) të Kushtetutës si bazë ligjore për parashtrimin e Kërkesës 28/13. Sidoqoftë, të dyja referencat janë pa ndonjë themel përmbajtjesor.

47. Sa i përket parashtruesit të parë, Gjykata konsideron se Kushtetuta nuk parashikon *actio popularis,* e cila është një modalitet i ankesës së individit, që u mundëson atyre që të iniciojnë vlerësimin abstrakt, pavarësisht nga interesi i tyre specifik juridik në rastin në fjalë.

48. Në të vërtetë, neni 113.7 nënkupton ankesa të veçanta dhe të drejtpërdrejta për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese si një instancë e mjetit të fundit për një shkelje të pretenduar nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive individuale të garantuara me Kushtetutë.

49. Prandaj, Gjykata vjen në përfundim se parashtruesi i parë nuk mund të konsiderohet palë e autorizuar që mund t'i adresojë çështjet kushtetuese *in abstracto* përkitazi me vlerësimin kushtetues të Ligjit,

duke kërkuar që të sigurojë një mjet juridik në emër të interesit kolektiv.

50. Sa i përket parashtruesit të dytë, Gjykata përkujton se, më 21 mars 2013, ishte kërkuar nga Komuna e Pejës që të dorëzojë sqarime shtesë dhe prova me të cilat do ta mbështetnin bazën juridike të kërkesës, gjegjësisht si dhe pse ligji i kontestuar cenon përgjegjësitë e Komunës dhe i zvogëlon të ardhurat e saj.

51. Gjykata vëren se më 8 prill 2013, parashtruesi i dytë u përgjigj, duke deklaruar si në vijim:

> *" – Ligji i përmendur i shkel të drejtat dhe interesat e pronës së pronarëve të shënuar (pronarëve ekzistues) bazuar në librin kadastral, si dhe të pronarëve të pronave të cilat ishin shpronësuar nga regjimi i mëparshëm në forma të ndryshme, siç është konfiskimi, reforma agrare, etj, të cilat ishin mënyra diskriminuese dhe qëllimi ishte për të spastruar atë zonë nga banorët e kombësisë shqiptare. Prandaj, një ligj i tillë do t'u paraqiste pengesë ligjore këtyre pronarëve për realizimin e të drejtave të tyre, të rrezikuara nga ligjet diskriminuese, siç është konfiskimi, reformat agrare, etj.*
> *- Ligji i kontestuar nuk ishte harmonizuar me ministritë përkatëse dhe në të njëjtën kohë nuk ishte siguruar pëlqimi paraprak nga banorët e zonës së Rugovës, të cilët paraqitën shumë vërejtje gojore dhe me shkrim për të metat e këtij ligji, por asnjëherë nuk u morën parasysh nga hartuesi i këtij ligji, pavarësisht nga fakti se në vendet demokratike fjala e qytetarit, sidomos i atij që është i pambrojtur ndaj një ligji, duhet të kuptohet dhe të merret parasysh. Për këtë arsye, nga ajo që u tha më lart dhe nga provat e paraqitura më herët me kërkesë, ne i bashkëngjisim kësaj letre, prova shtesë, që ne i konsiderojmë të jenë relevante për rishikimin e kësaj çështjeje nga ana e Gjykatës."*

52. Parashtruesi i dytë kishte bashkangjitur sqarimit shtesë dokumentet si në vijim: pasqyrat kadastrale për 14 Zona të fshatit Rugovë, dhe nënshkrimet e qytetarëve për peticion.

53. Gjykata konsideron se sqarimi fillestar dhe ai shtesë si dhe provat e dorëzuara nga parashtruesi i dytë nuk janë domethënëse dhe relevante që të konkludohet në mënyrë të arsyeshme se Komuna është e prekur nga ligji i kontestuar, duke iu cenuar përgjegjësitë e saj ose zvogëluar të hyrat e saj.

54. Me sa duket, parashtruesi i dytë është duke vepruar, ashtu siç sqaroi, në mbrojtjen e *"të drejtave dhe interesave të pronës së pronarëve të shënuar (pronarët ekzistues) bazuar në librin kadastral, si dhe të pronarëve të pronave të cilat ishin shpronësuar nga regjimi i mëparshëm në forma të ndryshme, siç është konfiskimi, reforma agrare, etj, të cilat ishin mënyra diskriminuese dhe qëllimi ishte për të spastruar atë zonë nga banorët e kombësisë shqiptare*."

55. Megjithatë, për qëllim të interpretimit të nenit 113 (4) të Kushtetutës, Komuna duhet të konsiderohet si një subjekt i veçantë ligjor i *pronarëve të interesuar ekzistues*, të cilët parashtruesi i dytë pretendon t'i përfaqësojë.

56. Edhe në qoftë se parashtruesi i dytë do të ishte lejuar me rregull për të përfaqësuar të ashtuquajturit *pronarët ekzistues*, rezultati logjik dhe bindës do të ishte pikërisht i njëjtë si për parashtruesin e parë.

57. Për më tepër, në mënyrë që parashtruesi i dytë të referojë çështjen më vete, duhet të pretendohet dhe vërtetohet se Komuna është e prekur nga ligji i kontestuar, duke i cenuar përgjegjësitë e saj ose zvogëluar të hyrat e saj.

58. Gjykata konsideron se asnjë pretendim nuk është provuar dhe asnjë provë nuk është paraqitur nga parashtruesi i dytë që të argumentohet në mënyrë të arsyeshme dhe të përfundohet se janë plotësuar kriteret e parapara me nenin 113 (4) të Kushtetutës. Kështu, Komuna e Pejës nuk mund të jetë palë e autorizuar për të referuar objektin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, as të përfaqësojë *pronarët ekzistues* dhe as më vete.

59. Në përfundim, sipas nenit 113 (1) të Kushtetutës, Gjykata nuk mund të vendosë për një çështje e cila nuk i është adresuar asaj në një mënyrë ligjore, sepse në pajtim me dispozitat e kombinuara ligjore të nenit 113 (4) dhe (7) të Kushtetutës, parashtruesi i parë dhe i dytë nuk janë palë të autorizuara.

60. Rrjedhimisht, sipas rregullit 36 (3) të Rregullores së punës, të dy kërkesat KI03/03 dhe 28/13 janë të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 dhe 27 të Ligjit, dhe rregullave 36.2, 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës, më 7 qershor 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 01/13, Betim Ramadani, datë 14 qershor 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së njoftimit nga Prokurori i Shtetit, KMLC. nr. 106/2012, të 23 tetorit 2012

Rasti KI 01/13, Aktvendim për papranueshmëri i 30 prillit 2013

Fjalë kyçe: barazia para ligjit, kërkesë individuale, mbrojtje gjyqësore e të drejtave, qartazi e pabazuar, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkelja e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi, z. Betim Ramadani, parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar njoftimin nga Prokurori i Shtetit, KMLC.nr. 106/2012, të 23 tetorit 2012. Parashtruesi pohoi se ai "[...] është larguar në mënyrë të dhunshme nga organi përmbarues, Gjykata Komunale në Gjilan, nga lokali afarist të cilin ai e ka shfrytëzuar, në bazë të kontratës së 4 shkurtit 2009, dhe pa asnjë procedurë gjyqësore." Për më tepër, ai kërkoi nga Gjykata "[...] që të anulojë të gjitha vendimet e procedurës përmbarimore të Gjykatës Komunale në Gjilan dhe të Gjykatës së Qarkut në Gjilan dhe të urdhërohet Gjykata Komunale në Gjilan që t'ia lejojë shfrytëzimin me qira të lokalit afarist, në bazë të të drejtave dhe obligimeve nga kontrata e 4 shkurtit 2009."

Sa i përket çështjes së pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konsideroi se kërkesa ishte e papranueshme sepse parashtruesi ka dështuar të paraqesë prova se procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Prandaj, Gjykata konkludoi se kërkesa ishte qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI01/13
Parashtrues
Betim Ramadani
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së njoftimit nga Prokurori i Shtetit, KMLC. nr. 106/2012, të 23 tetorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1 Kërkesa është parashtruar nga z. Betim Ramadani (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi), të cilin e përfaqëson z. Shevqet Xhelili, avokat nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston njoftimin nga Prokurori i Shtetit, KMLC. nr. 106/2012, e 23 tetorit 2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 27 tetor 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon se njoftimi i lartpërmendur ka cenuar të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht me nenin 3 [Barazia para Ligjit], me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], si dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 3 janar 2013, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 30 janar 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese emëroi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues, si dhe caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 27 shkurt 2013, kërkesa iu komunikua Prokurorit të Shtetit.

8. Më 15 prill 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan me gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar raportues, si dhe gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi me gjyqtarin Enver Hasani, si anëtarë të Kolegjit shqyrtues.

9. Më 30 prill 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandim për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Në vitin 2009, parashtruesi i kërkesës bëri një marrëveshje me Xh. K., për të marrë me qira një lokal afarist për dhjetë vjet, gjë që edhe e bëri, si dhe, përveç kësaj, ai bëri edhe disa investime. Megjithatë, sa i përket këtij lokali, ka pasur një procedurë gjyqësore në vazhdim e sipër, përkitazi me konfirmimin e pronësisë mes Xh. K. dhe Z. Y.

11. Më 15 mars 2011, Gjykata Komunale në Gjilan (Vendimi C. nr. 420/2005) gjeti që Xh. K. kishte tërhequr padinë e tij për konfirmim të pronësisë. Rrjedhimisht, Z. Y. parashtroi kërkesë për përmbarimin e këtij vendimi dhe largimin e parashtruesit nga lokali afarist që ai kishte marrë me qira nga Xh. K.

12. Parashtruesi pohon se, më 27 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Gjilan (Vendimi E. nr. 2907/2011) lejoi përmbarimin e Vendimit të saj, C. nr. 420/2005, të 15 marsit 2011.

13. Ndërkohë, më 1 shkurt 2012, Z. Y. edhe një herë parashtroi kërkesë për përmbarimin e Vendimit C. nr. 420/2005, të 15 marsit 2011, si dhe kërkoi që parashtruesi të largohej nga lokali afarist.

14. Më 15 shkurt 2012, parashtruesi, si palë e tretë, parashtroi kundërshtim ndaj kërkesës për përmbarim. Gjykata Komunale në Gjilan e hodhi poshtë kundërshtimin si të pabazuar (Vendimi E. nr. 2907/2011, i 5 marsit 2012).

15. Kësisoj, më 20 mars 2012, parashtruesi u ankua kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, e cila hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar si dhe vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale, të 5 marsit 2012 (Vendimi E. nr. 2907/2011).

16. Më 4 maj 2012, Gjykata Komunale në Gjilan njoftoi parashtruesin se përmbarimi i vendimit ishte në fuqi, si dhe përmbarimi do të bëhej më 4 qershor 2012.

17. Më 31 maj 2012, parashtruesi dorëzoi një propozim për shtyrjen e përmbarimit në Gjykatën Komunale në Gjilan. Gjykata Komunale në Gjilan hodhi poshtë propozimin për shtyrje si të pabazuar (Vendimi E. nr. 2907/2011, i datës 4 qershor 2012).

18. Më 8 qershor 2012, parashtruesi u ankua ndaj aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, e cila hodhi poshtë ankesën si të pabazuar (Aktvendimi Ac. nr. 222/2012, i datës 19 shtator 2012).

19. Parashtruesi pohon se, më 11 qershor 2012, Gjykata Komunale e përmbaroi vendimin e Gjykatës Komunale dhe largoi parashtruesin nga lokali afarist që e kishte marrë me qira. Nuk ka prova në shkresat e rastit që vërtetojnë këtë pohim të parashtruesit.

20. Më 10 tetor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pranë Prokurorit të Shtetit. Prokurori i Shtetit hodhi poshtë këtë kërkesë, sepse nuk gjeti asnjë bazë në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë (Njoftimi KMLC., nr. 106/2012, i datës 23 tetor 2012).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi pohon se ai *"[...] është larguar në mënyrë të dhunshme nga organi përmbarues i Gjykatës Komunale në Gjilan, nga lokali afarist të cilin ai e ka shfrytëzuar në bazë të kontratës së datës 4 shkurt 2009, dhe atë pa u zhvilluar asnjë procedurë gjyqësore"*.

22. Në këtë kuptim, parashtruesi i kërkon Gjykatës Kushtetuese *"[...] që të anulojë të gjitha vendimet e procedurës përmbarimore të Gjykatës Komunale në Gjilan dhe të Gjykatës së Qarkut në Gjilan dhe të urdhërohet Gjykata Komunale në Gjilan që t'ia lejojë shfrytëzimin me qira të lokalit afarist në bazë të të drejtave dhe të obligimeve nga kontrata e datës 04.02.2009"*.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar me tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

24. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 113.1, që përcakton se *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar"*.

25. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i cili parashikon: "*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë"*.

26. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu merr parasysh rregullin 36.1 (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton që *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar"*.

27. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet në fakte apo në ligje (ligjshmëria), që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç dhe deri në masën që gabimet e tilla të kenë cenuar të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Kështu, kjo gjykatë nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur trajton vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (*Shih, mutatis mutandis, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr.*

30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

28. Me fjalë të tjera, Gjykata mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë prezantuar në atë mënyrë që procedurat në përgjithësi, të shikuara në plotësinë e tyre, janë zhvilluar ashtu që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (*Shih, ndër dokumente të tjera, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991*).

29. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se parashtruesi nuk ka mbështetur me prova pretendimin e tij në baza kushtetuese, si dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë cenuar nga gjykatat e rregullta.

30. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konkludojë se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (*Shih, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009*).

31. Gjykata më tutje thekson se parashtruesi nuk ka iniciuar ndonjë procedurë ndaj Xh. K., përkitazi me të drejtat dhe me obligimet e tij sipas kontratës. Gjykata Komunale në Gjilan dhe Gjykata e Qarkut në Gjilan vetëm se kanë përcaktuar të drejtën e pronësisë ndërmjet Xh. K. dhe Z. Y.

32. Në përgjithësi, parashtruesi nuk ka treguar pse dhe si i janë cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Vetëm renditja e disa dispozitave kushtetuese nuk mund të konsiderohet ankesë kushtetuese. Kësisoj, nga parashtruesi i kërkesës nuk është parashtruar çështja në mënyrë ligjore në Gjykatë, prandaj, në bazë të rregullit 36.1 (c) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.1 të Kushtetutës; në bazë të nenit 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe në bazë të rregullit 36.1 (c) dhe 56.2 të Rregullores së punës, më 23 maj 2013 njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË vendimin në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. TA SHPALL se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 13/13, Nexhat Tahiri, datë 14 qershor 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvëndimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-09-0042, të 29 gushtit 2012

Rasti KI-13/13, Aktvendim për papranueshmëri i 15 majit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e paaafatshme, res judicata, barazia para ligjit, e drejta për punë dhe ushtrim të profesionit, e drejta e qasjes në dokumente publike

Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar Aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-09-0042, të 29 gushtit 2012, me të cilin është zgjidhur kontesti pronësoro-juridik, në mes të parashtruesit të kërkesës dhe personave të tretë, lidhur me të drejtën për punë dhe të drejtat e tjera pronësore, të cilat i kanë punëtorët gjatë procesit të privatizimit.

Parashtruesi i kërkesës ngriti kontest gjyqësor në lidhje me përfundimin e marrëdhënies së punës në kombinatin industrial-bujqësor „AGROKULTURA“ të Gjilanit, në të njëjtën kohë ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve, të cilëve u takon e drejta në 20% të mjeteve nga privatizimi i ndërmarrjes.

Me Aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-09-0042, të 29 gushtit 2012, gjykata e ka hedhur poshtë si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin; *“... .Thelbi i lëndës paraprake dhe i lëndës në parim është i njëjtë. Ankesa lidhet me të njëjtën çështje lëndore dhe kërkon të njëjtin kompensim. Kolegji i Ankesave konstaton se lënda është e gjykuar tanimë dhe se tanimë ekziston një lëndë res judicata. Lënda duhet të hidhet poshtë ex officio ... ".*

Parashtruesi i kërkesës konsideroi se janë shkelur një numër i neneve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe Deklarata Universale për të Drejta të Njeriut, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe protokollet e tyre.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit Nexhat Tahiri, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese konkludoi se kërkesa nuk është e pranueshme për shqyrtim, në pajtim me nenin 49 (Afatet) të Ligjit dhe rregullin 36 (1b) të Rregullores së punës, sepse kërkesa është dorëzuar pas afatit katër mujor, prej ditës kur vendimi për mjetin e fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI13/13
Parashtruesi
Nexhat Tahiri
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme ASC-09-0042 të 29 gushtit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues i kërkesës është Nexhat Tahiri nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet aktvendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ASC-09-0042 i 29 gushtit 2012, me të cilën është refuzuar si e pabazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ASC-09-0042 të 9 korrikut 2009.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është kontesti pronësoro-juridik ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe palëve të treta në lidhje me të drejtën në punë dhe të drejtat e tjera pronësore që kanë punëtorët në procesin e privatizimit i cili ka përfunduar me aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme ASC-09-0042 të 29 gushtit 2012, e që sipas pretendimeve të parashtruesit ka shkelur një numër të neneve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe nenin 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 shkurt 2013 Parashtruesi ka parashtruar Kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 22 mars 2013, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe nga Agjencia Kosovare e Privatizimit të dorëzojnë dokumentacionin shtesë me dëshmitë se kur parashtruesi e ka pranuar aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ASC-09-0042 të 29 gushtit 2012.

7. Më 26 mars 2013, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese fletëdërgesën e cila dëshmon se Parashtruesi më 6 shtator 2012 e ka pranuar aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ASC-09-0042 të 29 gushtit 2012.

8. Më 15 maj 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Parashtruesi ngriti kontest gjyqësor në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në kombinatin industrial-bujqësor „AGROKULTURA“ të Gjilanit, në të njëjtën kohë ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve të cilëve u takon e drejta në 20% të mjeteve nga privatizimi i ndërmarrjes.

10. Këto konteste përfunduan me Aktvendimin e formës së prerë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ASC-09-0042 të 29 gushtit 2012, e që i është dorëzuar Parashtruesit më 6 shtator 2012.

11. Me Aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ASC-09-0042 të 29 gushtit 2012, është hedhur poshtë ankesa e Parashtruesit si e pabazuar me arsyetimin:

> *"...Thelbi i lëndës paraprake dhe i lëndës në parim është i njëjtë. Ankesa lidhet me të njëjtën çështje lëndore dhe kërkon të njëjtin kompensim. Kolegji i Ankesave konstaton se lënda është e gjykuar tanimë dhe se tanimë ekziston një lëndë res judicata. Lënda duhet të hidhet poshtë ex officio..."*.

Pretendimet e parashtruesit

12. Parashtruesi pretendon se janë shkelur nenet në vijim: neni 3 (Barazia para Ligjit), neni 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare), neni 24 (Barazia para Ligjit), neni 41 (e Drejta e Qasjes në Dokumente Publike), neni 49 (e Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit), neni 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e tyre.

13. Parashtruesi i Kërkesës nuk shpjegon se si ka ardhur deri te shkelja e neneve të lartpërmendura, por vetëm i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me pretendimin në vijim:

> *"Nëse shiqohen shkresat e lëndës sipas kësaj ankese, Gjykata nuk ka shqyrtuar kërkesëpadinë time sipas fakteve por vetëm ka bërë interpretim paushall."*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Gjykata Kushtetuese për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

15. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese i referohet nenit 49 (Afatet) të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e*

drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi...“

16. Gjykata vëren se nga dokumentet shtesë të dorëzuara nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme është konstatuar se parashtruesi ka pranuar aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ASC-09-0042 të 29 gushtit 2012 më 6 shtator 2012 kur parashtruesi edhe e ka nënshkruar fletëdërgesën.

17. Aktvendimi i formës së prerë i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës i është dorëzuar Parashtruesit më 6 shtator 2012, ndërsa Parashtruesi ka dorëzuar Kërkesën në Sekretariatin e Gjykatës Kushtetuese më 4 shkurt 2013.

18. Nga kjo del se Kërkesa është e papranueshme për shqyrtim në pajtim me nenin 49 (Afatet) të Ligjit dhe me rregullin 36 (1b) të Rregullores së Punës që përcakton: „Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi,...”

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 qershor 2013, njëzëri

VENDOSI

I. **TA HEDHË POSHTË** kërkesën si të papranueshme;

II. T'ua komunikojë vendimin palëve dhe ta publikojë vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 04/13, Zahir Hasani, datë 14 qershor 2013— Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 5/2011, të 27 janarit 2011

Rasti KI 04/13, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 majit 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë Individuale, e pa afatshme, Aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se, me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Kosovës, dhe atë: E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm (neni 31).
Parashtruesi i kërkesës ka pohuar, gjithashtu, se ka pasur shkelje te dispozitave të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë dhe çështja nuk është parashtruar në Gjykatë në mënyrë ligjore nga parashtruesi i kërkesës, pasi që në bazë të nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese kërkesa është e paafatshme, andaj kërkesa deklarohet si e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI04/13
Parashtrues
Zahir Hasani
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 5/2011, të 27 janarit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Zahir Hasani, nga fshati Sharban, komuna e Prishtinës, tash në vuajtje të dënimit me burg, të cilin e përfaqëson i vëllai, z. Sabit Hasani, po ashtu nga fshati Sharban i komunës së Prishtinës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar i autoritetit publik është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 5/2011, i 27 janarit 2011, për të cilin parashtruesi i kërkesës pohon se e ka pranuar më 20 gusht 2012.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), më 14 janar 2013, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin u refuzua kërkesa e të gjykuarit Zahir Hasani për mbrojtjen e ligjshmërisë, e paraqitur kundër Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 297/05, të 21 prillit 2010, dhe kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AP. nr. 260/2010, të 3 dhjetorit 2010.

Baza juridike

4. Neni 113.7, lidhur me nenin 21.4, të Kushtetutës; neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009; dhe rregulli 54, rregulli 55 e rregulli 56.2, të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 14 janar 2013, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi kërkesë në Gjykatë. Kërkesa u regjistrua në regjistrin përkatës me Nr. KI04/13.

6. Më 30 janar 2013, me Vendimin GJ. R. KI04/13, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese, ndërsa, me Vendimin KSH4/13, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Prof. dr. Enver Hasani e Almiro Rodrigues (anëtarë).

7. Më 13 shkurt 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme përkitazi me regjistrimin e kërkesës.

8. Më 30 prill 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandim për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 21 prill 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin P. nr. 297/05, me anë të të cilit, të akuzuarin z. Zahir Hasani, nga fshati Sharban, komuna e Prishtinës, e shpalli fajtor për veprën penale vjedhje pylli, sipas nenit 285, paragrafi 2, i Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK), duke e dënuar të akuzuarin me dënimin me burgim në kohëzgjatje 6 (gjashtë) muaj.

10. Kundër këtij aktgjykimi, z. Hasani paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, duke e mohuar fajësinë e tij dhe duke pretenduar se atij i është mohuar e drejta e paraqitjes së dëshmitarëve që do të dëshmonin në favor të tij.

11. Më 3 dhjetor 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga z. Hasani, nxori Aktgjykimin Ap. nr. 260/10, me të cilin APROVOI pjesërisht ankesën e të akuzuarit Zahir Hasani

dhe, me këtë rast, Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 297/05, të 21 prillit 2010, e NDRYSHOI vetëm në pjesën e dënimit, ashtu që Gjykata e Qarkut në Prishtinë, për veprën penale vjedhje pylli, të dënueshme sipas nenit 285 të KPK-së, e shpalli fajtor të akuzuarin Hasani dhe ia shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje 3 muaj, ndërkohë që konstatoi se Gjykata Komunale në Prishtinë ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe se ajo ka bërë administrimin e provave të ofruara nga palët në mënyrë të rregullt dhe ligjore.

12. Ndaj këtyre dy aktgjykimeve, tashmë të formës së prerë, z. Hasani paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, me të njëjtat pretendime sikurse në ankesën që kishte parashtruar edhe në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

13. Më 27 janar 2011, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Pkl. nr. 5/2011, me të cilin refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ushtruar kundër aktgjykimeve të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 297/2005, të 21 prillit 2010, dhe të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AP. nr. 260/2010, të 3 dhjetorit 2010, për arsye se nuk kishte gjetur shkelje substanciale procedurale apo ligjore në aktgjykimet e atakuara nga parashtruesi i kërkesës.

14. Më 10 janar 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë bëri ekzekutimin e dënimit me burg, në përputhje me aktgjykimet e formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 297/2005, dhe të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AP. nr. 260/2010.

Pretendimet e parashtruesit për shkeljet kushtetuese

15. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se, me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Kosovës, dhe atë: E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm (neni 31).

16. Parashtruesi i kërkesës ka pohuar, gjithashtu, se ka pasur shkelje te dispozitave të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të

specifikuara më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës.

18. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike, të përcaktuara me ligj".*

Gjykata, gjithashtu, merr parasysh nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ku shprehimisht përcaktohet:

> "*Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".*

19. Për të vërtetuar faktin nëse parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën brenda aftit katërmuajsh, Gjykata i referohet kohës së pranimit të vendimit të fundit nga parashtruesi i kërkesës, si dhe i referohet datës së paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

20. Nga kopja e formularit standard për paraqitjen e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese, konstatohet fakti se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar që Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 5/2011, e 27 janarit 2011, e ka pranuar më 20 gusht 2012, ndërsa kërkesën në Gjykatën Kushtetuese e ka dorëzuar më 14 janar 2013, që do të thotë se kërkesa është dorëzuar në Gjykatë 24 ditë pas kalimit të aftit katërmuajsh, të paraparë me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

21. Në këto rrethana, parashtruesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, për sa i përket afatit brenda të cilit duhet të parashtrohet kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, andaj kërkesa duhet të deklarohet si e papranueshme.

22. Gjykata gjithmonë thekson se qëllimi i rregullit për afatin katërmujor është të promovojë sigurinë juridike, të sigurojë se rastet e ngritura për

çështje kushtetuese do të shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme, dhe për të mbrojtur autoritetet dhe personat e tjerë të interesuar nga të qenit në një situatë të pasigurisë për një periudhë të gjatë kohore (*Shih, mutatis mutandis, PM v Mbretëria e Bashkuar, Kërkesa nr. 6638/03, 19 korrik 2005*).

23. Bazuar në ato që u thanë më sipër, parashtruesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë dhe çështja nuk është parashtruar në Gjykatë në mënyrë ligjore nga parashtruesi i kërkesës, pasi që në bazë të nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese kërkesa është e paafatshme. Andaj,

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.1 të Kushtetutës, nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullit 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 24 maj 2013 njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË vendimin në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 127/12, Zade Zeqiroviq, datë 14 qershor 2013 -Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ASC-09-0084 të 12 shtatorit 2012

KI 127/12, Aktvendim për papranueshmëri i datës 27 maj 2013

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, kompensimi i dëmit material, kamata vjetore, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, qartazi e pabazuar

Parashtruesja pretendon se me aktgjykimin e Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ASC-09-0084 të 12 shtatorit 2012 i janë cenuar të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) me rastin e, siç pretendohet nga parashtruesja e kërkesës, mosnjohjes së të drejtës për kamatën vjetore në shumën e kompensimit të dëmit të shkaktuar nga zjarri.

Për gjitha arsyet e lartpërmendura, Gjykata është e bindur që faktet e paraqitura nga parashtruesja e kërkesës nuk arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese, si dhe që parashtruesja nuk ka ofruar dëshmi që të drejtat dhe liritë e saj të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
Rastin Nr. KI 127/12
Parashtruese e kërkesës
Zade Zeqiroviq
Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ASC-09-0084 të 12 shtatorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesën e ka parashtruar Zade Zeqiroviq (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson Shemsi Uka.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston aktgjykimin e Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ASC -09-0084 të 12 shtatorit 2012, që i është dorëzuar Parashtrueses së kërkesës më 22 shtator 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me aktgjykimin e Kolegjit për Ankesa të Dhomës së Posaçme për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ASC-09-0084 të 12 shtatorit 2012 i janë cenuar të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) me rastin e, siç pretendohet nga Parashtruesja e kërkesës, mosnjohjes së të drejtës

për kamatën vjetore në shumën e kompensimit të dëmit të shkaktuar nga zjarri.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese Nr. 03/L-121 të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullin 56.2 të Rregullores së Punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 7 dhjetor 2012, Parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 10 janar 2013, Kryetari e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).

7. Më 5 shkurt 2013, Gjykata e njoftoi Parashtruesen dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit lidhur me regjistrimin e Kërkesës.

8. Më 29 prill 2013, me vendim të Kryetarit për zëvendësimin e Gjyqtarit raportues Nr. GJR. KI 127/12, Gjyqtarja Snezhana Botusharova u caktua Gjyqtare raportuese. Në të njëjtën ditë, me vendim të Kryetarit Nr. KSH. 127/12, u caktua Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Enver Hasani (anëtar).

9. Më 14 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit

10. Sipas dokumenteve të bashkëngjitura në Kërkesë, Parashtruesja është pronare e kompanisë "Muki Trade", e cila prej 26 tetorit 1999 deri më 25 shkurt 2000 ka pasur një kontratë qiramarrjeje për shfrytëzimin e një depoje me Ndërmarrjen Shoqërore «Qendra Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike» në Prishtinë. Më 25 shkurt 2000, u paraqit një zjarr në «Qendrën Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike» në Prishtinë, i cili u përhap në depot tjera të marra me qira, duke përfshirë depon me qira të Parashtrueses së kërkesës.

11. Më 9 mars 2005, Parashtruesja e kërkesës parashtroi padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e ndërlidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, duke kërkuar kompensimin e dëmeve nga «Qendra Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike» në Prishtinë. Kopja e padisë së 9 marsit 2005 nuk i është bashkëngjitur Kërkesës nga Parashtruesja. Është aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, i datës 18 gusht 2006, që i referohet padisë së parashtruar nga Parashtruesja e kërkesës.

12. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit në aktgjykimin e saj të 18 gushtit 2006, nr. SCC-05-80 vendosi që *"nuk ka kompensim që mund të jepet në lidhje me këtë padi në bazë të ligjit"*, duke shpjeguar më tutje që padia nuk është parashtruar brenda afatit pesë (5) vjeçar siç përcaktohet me nenin 376, paragrafi 2, të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore. Në të njëjtën datë, Dhoma e Posaçme nxori aktgjykime për 12 (dymbëdhjetë) raste të ndërlidhura, duke e shpallur «Qendrën Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike» në Prishtinë përgjegjëse për dëmet e shkaktuara ndaj paditësve, si dhe duke vendosur kompensimin e dëmeve në favorin e tyre.

13. Më 25 mars 2008, Parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë për rigjykim të rastit. Përfaqësuesi i Parashtrueses së kërkesës Dhomës së Posaçme i dorëzoi provat që më 16 mars 2004, ishte dorëzuar padia për të njëjtin kompensim dëmesh në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Faktet e dorëzuara në Dhomën e Posaçme ishin në formën e një vendimi të Gjykatës Komunale të Prishtinës, të datës 6 shkurt 2008.

14. Në bazë të provave të dorëzuara nga Parashtruesja e kërkesës, që konfirmojnë që padia ishte parashtruar për të njëjtin kompensim në Gjykatën Komunale, më 20 qershor 2008, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme vendosi të rigjykojë rastin.

15. Më 10 shtator 2008, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, duke iu referuar juridiksionit të saj në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13 gjithashtu nxori një aktvendim për të tërhequr nga Gjykata Komunale në Prishtinë rastin C. Nr. 254/08 të parashtruar nga Parashtruesja e kërkesës.

16. Dhoma e Posaçme angazhoi një ekspertizë të përgjithshme për vlerësimin e shumës së dëmeve që ishin shkaktuar nga zjarri.

17. Më 15 tetor 2009, Paneli Gjyqësor i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, në aktgjykimin e tij SCC-05-0080 shpalli «Qendrën Sociale,

Sporteve, Kulturës dhe Ekonomisë» në Prishtinë përgjegjëse për dëmet, si dhe kështu obligoi «Qendrën Sociale, Sporteve, Kulturës dhe Ekonomisë» në Prishtinë t'i paguajë paditësve kompensimin e dëmeve. Në rastin e Parashtrueses së kërkesës, Paneli gjyqësor urdhëroi që të paguhen 106,650 EUR në emër të dëmeve, në vend të shumës së pretenduar prej 195,000 EUR.

18. Më 12 nëntor 2009, Parashtruesja e kërkesës parashtroi kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme duke kërkuar që të korrigjonte aktgjykimin e 15 tetorit 2009, si dhe të përfshinte kamatën prej 3.5 % për Parashtruesen e kërkesës në dispozitivin e Aktgjykimit.

19. Më 21 maj 2010, Paneli Gjyqësor i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme hodhi poshtë kërkesën si të papranueshme, duke argumentuar që Aktgjykimi i 15 tetorit 2009 ishte dorëzuar tek Parashtruesja e kërkesës më 18 tetor 2009, dhe që Parashtruesja e kërkesës kishte dorëzuar kërkesën më 12 nëntor 2009, duke e konsideruar kështu kërkesën të pasafatshme, sipas nenit 49.1 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6. Në fakt, Trupi Gjykues nuk mori parasysh që vonesa e pretenduar ishte e përfshirë në termin "*Gabime teknike*". Paneli Gjyqësor më tutje argumentoi që Parashtruesja e kërkesës ka kërkuar «aktgjykim plotësues, e jo të korrigjuar», si dhe e shpalli kërkesën për ndryshim të aktgjykimit si të afatshme, por të pabazuar, duke konsideruar që aktgjykimi fillestar kishte nënkuptuar që Parashtruesja e kërkesës nuk kishte kërkuar kamatat ligjore. Paneli Gjyqësor theksoi që "*çdo kundërshtim në lidhje me këtë duhet korrigjuar, nëse shpallet i bazuar, vetëm me vendimin e shkallës së dytë.*" Në këtë rast, Trupi Gjykues vendosi që kërkesa e Parashtrueses nuk mund të konsiderohet si padi e re, pasi që procedura e regjistrimit është specifike, dhe as nuk mund të konsiderohet si ankesë, pasi që nuk përmbush kriteret e përcaktuara me nenin 60.1 të Urdhëresës Administrative (AD) 2008/6.

20. Më 7 korrik 2010, Parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin për ankesa të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizmit, duke kërkuar kompensimin e vonesës së pagesës së kamatës me të njëjtën shumë si në rastet tjera, duke filluar nga 25 shkurti 2000 deri në pagesën përfundimtare. Parashtruesja e kërkesës pretendonte që disa raste ishin shqyrtuar në mënyrë kolektive, duke obliguar "Qendrën Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike"në Prishtinë që të paguajë kamatë vonesën , si dhe gjithashtu pretendonte që në dokumentet e mëhershme ka kërkuar kompensimin për gjitha shpenzimet procedurale. Parashtruesja në ankesë gjithashtu i referohet Aktgjykimit

të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të datës 18 gusht 2006, në të cilin Dhoma e Posaçme thekson që padia ka të bëjë me kërkesën për të obliguar "Qendrën Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike" në Prishtinë që "*të paguajë kamatën për shkak të vonesës në shumën prej 5 % në vit, duke filluar nga dita e zjarrit e deri në pagesën përfundimtare.*"

21. Kolegji për ankesa i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me aktvendimin e tij ASC-10-0045, të datës 13 shtator 2012, hodhi poshtë ankesën e parashtruar nga Parashtruesja e kërkesës si të pabazuar, si dhe konfirmoi vendimin e Trupit Gjykues SCC -05-0080, të datës 21 maj 2010.

22. Kolegji për ankesa në vendimin e lartpërmendur, thekson që:

[...]

"Është e saktë që DHPGJS-ja më 18 gusht 2006, në Aktgjykimin e saj thekson që padia e Ankuesit e 9 marsit 2005 përbëhet nga kërkesa për të obliguar të Padituri n e parë që të paguajë kamatë, për shkak të vonesës, në shumën prej 5 për qind në vit, duke filluar nga dita e zjarrit deri në pagesën përfundimtare. Megjithatë, kjo kërkesë nuk mund të gjendet në shkresat e rastit SCC-05-0080, e as në dokumentet e ankesës në Kolegjin për Ankesa. Thëniet e DHPGJS-së më 18 gusht 2006 kështu nuk mund të konsiderohen si provë që ka pasur kërkesë për kamatë para 18 gushtit 2006."

Kolegji për ankesa më tutje i referohet padisë së Parashtrueses së kërkesës në shkresat e rastit të Trupit Gjykues SCC-05-0080, dorëzuar më 15 dhjetor 2008, në të cilin Parashtruesi kërkon pagesën e kamatëvonesës , por argumenton që [...] *"në bazë të nenit 376.2 të Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore, e drejta e parashtrimit të padisë skadon pesë vjet pas shkaktimit të dëmtimit apo humbjes, kështu që kërkesa e paditësit e datës 15 dhjetor 2008 nuk është e afatshme."*

23. "Qendra Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike" në Prishtinë, Agjencia e Kosovare e Privatizimit, si dhe World Company, parashtruan ankesa në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, respektivisht më 23 nëntor 2009, 20 nëntor 2009 dhe 16 nëntor 2009, kundër Aktgjykimit të Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të datës 15 tetor 2009, për rastet e bashkuara SCC-05-80, SCC-06-0029, SCC-06-0470, SCC-06-0482 dhe SCC- 06-0524.

24. Kolegji për ankesa në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në aktgjykimin e tij të datës 12 shtator 2012 vendosi të shpallë

ankesën e "Qendrës Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike" në Prishtinë pjesërisht të bazuar, si dhe të ndryshojë Aktgjykimin e Trupit Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 15 tetor 2009, duke obliguar "Qendrën Sociale, Sportive, Kulturore dhe Ekonomike" në Prishtinë t'i paguajë Parashtrueses dhe paditësve tjerë si në vijim: *"75,000 EUR Parashtrueses së kërkesës ; 75,000 EUR dhe 3.5% kamatë vjetore për dëmet nga 26 shkurti 2000 deri në ditën e pagesës për paditësin e dytë; 80,000 EUR dhe 3.5% kamatë vjetore për dëmet nga 26 shkurti 2000 deri në ditën e pagesës përfundimtare për paditësin e tretë; 65,000 EUR dhe 3.5% kamatë vjetore për dëmet nga 26 shkurti 2000 deri në datën e pagesës përfundimtare për paditësin e katërt; 180,000 EUR dhe 3.5% kamatë vjetore për dëmet nga 26 shkurti 2000 deri në datën e pagesës për paditësin e pestë."*

Pretendimet e Parashtrueses së kërkesës

25. Siç theksohet më lart, Parashtruesja e kërkesës pohon që Aktgjykimi i Kolegjit për ankesa në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ASC-09-0084, të datës 12 shtator 2012, ka cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenin 24 [Barazia para ligjit] si dhe nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm].

26. Parashtruesja e kërkesës më tutje pohon që "*Sipas Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 6/2008 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 13/2002, nenit 70 i Urdhëresës në dispozitat e saj përfundimtare përcakton që në interpretimin e asaj Urdhërese Administrative, ose në shqyrtimin e çështjeve që nuk marrin përgjigje të duhur, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat në fuqi të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Sipas nenit 190 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, si ligj në fuqi në kohën e marrjes s% vendimeve nga Dhoma ka qene e paraparë qe paditësi deri në momentin e mbylljes së shqyrtimit kryesor ka mundur ta ndryshojë padinë. Edhe po të mos e kishte kërkuar paditësja me padi kamatëvonesën kur e ka kërkuar me parashtresa dhe thanje në shqyrtime para mbylljes së shqyrtimit kryesor atëherë ky pretendim nga Dhoma është dashtë të merret si i afatshëm."*

Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesës

27. Para së gjithash, për të shqyrtuar kërkesën e Parashtrueses, Gjykata duhet të vlerësojë nëse Parashtruesja e kërkesës ka përmbushur të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë dhe saktësohen më tej me Ligj dhe Rregullore të Punës.

28. Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse Parashtruesja është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në Gjykatë, në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës.

Neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës, përcakton që:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Në lidhje me këtë Kërkesë, Gjykata thekson që Parashtruesja e kërkesës është person fizik, si dhe është palë e autorizuar në pajtim me nenin 113.7 [Juridiksioni dhe palët e autorizuara] të Kushtetutës.

29. Gjykata gjithashtu duhet të vlerësojë nëse Parashtruesja e kërkesës, në pajtim me kërkesat e nenit 113 (7) të Kushtetutës, si dhe neni 47 (2) i Ligjit, ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Në rastin aktual, vendimi i fundit në rastin e Parashtruesit është Aktgjykimi i Kolegjit për ankesa në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ASC-09-0084, të datës 12 shtator 2012. Si rrjedhojë, Parashtruesja e kërkesës ka dëshmuar që ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligjet në fuqi.

30. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu duhet të dëshmojë që ka përmbushur kërkesat e nenit 49 të Ligjit, në lidhje me dorëzimin e Kërkesës brenda afatit ligjor. Nga shkresat e rastit mund të shihet që Aktgjykimi Kolegjit për ankesa në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ASC-09-0084, të datës 12 shtator 2012 është dorëzuar më 22 shtator 2012, derisa Parashtruesja e kërkesës ka dorëzuar Kërkesën në Gjykatë më 7 dhjetor 2012, që do të thotë se Kërkesa është dorëzuar brenda afatit katërmujor, siç përcaktohet me Ligj dhe Rregullore të Punës.

31. Në lidhje me Kërkesën, Gjykata gjithashtu merr parasysh Rregullin 36 të Rregullores së Punës, i cili përcakton që:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa nuk është qartazi e bazuar."

32. Sipas shkresave të rastit, Gjykata thekson që arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Kolegjit për ankesa të Gjykatës Supreme është i qartë, si

dhe pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata gjithashtu ka gjetur që procedurat e gjykatave të rregullta nuk kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, 30 qershor 2009).

33. Gjykata po ashtu rithekson që sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është mandat i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës [DHM],* nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GjEDNj] 1999-I, shih edhe, *Vendimi për papranueshmëri në rastin nr. 70/11, Parashtruesit Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme* A. Nr. 983/08, të 7 shkurtit 2011).

34. Fakti që Parashtruesja e kërkesës nuk është e kënaqur me rezultatin e aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nuk mund t'i shërbejë asaj si e drejtë që të ngrisë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 24 [Barazia para ligjit] dhe nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës. (shih, *mutatis mutandis Aktgjykimin e GjEDNj-së Apl. Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* Aktgjykim i datës 26 korrik 2005).

35. Për gjitha arsyet e lartpërmendura, Gjykata është e bindur që faktet e paraqitura nga Parashtruesja e kërkesës nuk arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese, si dhe që Parashtruesja e kërkesës nuk ka ofruar dëshmi që të drejtat dhe liritë e saj të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga gjykatat e rregullta.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe në përputhshmëri me rregullat 36.2 dhe 56.2 të Rregullores së Punës, më 27 maj 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 105/12 dhe KI 133/12, Shoqata e gjuetarëve "Dukagjini" Klinë dhe Federata e Gjuetarëve të Kosovës, datë 14 qershor 2013 – Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011

KI 105/12 dhe KI 133/12, Aktvendim për papranueshmëri i datës 24 maj 2013

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, Vendim i Ministrisë së Punëve të Brendshme, lejet për regjistrimin e armëve, jashtë afatit

Parashtruesit e kërkesës kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011, në bazë të të cilit kartelat WRCU/WRC (ose lejet për regjistrim të armëve, të njohura si armë të gjuetisë ose të rekreacionit), të cilave u vazhdohet afati deri më 1 nëntor 2012, ndryshohen në kartela të Ministrisë së Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejmë: MPB).

Nga parashtresat shihet që kërkesat në Gjykatën Kushtetuese janë parashtruar me 22 tetor 2012 dhe me 24 dhjetor 2012, ndërkohe që Vendimi i MPB-së, Nr. 847/2011, i 14 nëntorit 2011, i është komunikuar Federatës se Gjuetareve te Kosovës me postë elektronike me 17 nëntor 2011, qe do te thotë se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor te parapare me nenin 49 te Ligjit.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
rastet Nr. KI105/12 dhe Nr. KI133/12
Parashtrues të kërkesës
Shoqata e Gjuetarëve "Dukagjini" e Klinës. Dhe Federata e Gjuetarëve të Kosovës
Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Shoqata e Gjuetarëve "Dukagjini", me seli në Klinë, dhe Federata e Gjuetarëve të Kosovës, të përfaqësuara nga Cenë Gashi dhe nga Rexhep Shkodra.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar i autoritetit publik, me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutën e Kosovës, është Vendimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Nr. 847/2011, i 14 nëntorit 2011, i cili ka hyrë në fuqi në ditën e nënshkrimit, më 14 nëntor 2011.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011, në bazë të të cilit kartelat WRCU/WRC (ose lejet për regjistrim të armëve, të njohura si armë të gjuetisë ose të rekreacionit), të cilave u vazhdohet afati deri më 1 nëntor

2012, ndryshohen në kartela të Ministrisë së Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejmë: MPB).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës; neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe rregulli 37.1 e rregulli 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 22 tetor 2012, parashtruesi i parë i kërkesës, Shoqata e Gjuetarëve "Dukagjini", me seli në Klinë, parashtroi kërkesë në Gjykatë.

6. Më 5 nëntor 2012, me vendimin GJ. R. KI105/12, Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtar raportues Zëvendëskryetarin Ivan Čukalović, ndërsa, me vendimin KSH KI105/12, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova (anëtare) dhe Kadri Kryeziu (anëtar).

7. Më 5 nëntor 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës (KI105/12) dhe MPB-në për regjistrimin e kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.

8. Më 22 nëntor 2012, MPB-ja dërgoi komentet e saj përkitazi me kërkesën. Në shkresën e saj, Ministria e Punëve të Brendshme, thotë: "*Ne kemi mbajtur takime të rregullta me Federatën e Gjuetarëve dhe u kemi shpjeguar atyre se ne si MPB nuk mund të zbatojmë kërkesën e tyre për përjashtim nga provimi profesional, sepse Ligji për Armët nuk ka paraparë dispozitë përjashtuese për asnjë kategori të shoqërisë së Kosovës*".

9. Më 24 dhjetor 2012, parashtruesi i dytë, Federata e Gjuetarëve të Kosovës, parashtroi kërkesë në Gjykatë.

10. Më 26 dhjetor 2012, në pajtim me rregullin 37.1 të Rregullores së punës, Kryetari urdhëroi bashkimin e kërkesave KI105/12 dhe KI133/12, për arsye se kërkesa ishte drejtuar kundër aktit të njëjtë të autoritetit publik. Me këtë urdhër ishte caktuar që Gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të ishte e njëjtë, ashtu siç ishte vendosur me vendimet e Kryetarit, të 5 nëntorit 2012, për caktimin e Gjyqtarit raportues dhe të Kolegjit shqyrtues.

11. Më 22 janar 2013, Gjykata njoftoi parashtruesin e dytë të kërkesës (KI133/12) dhe MPB-në për regjistrimin e kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.

12. Më 31 janar 2013, Gjykata i dërgoi parashtruesit të dytë të kërkesës (Federatës së Gjuetarëve të Kosovës) dhe MPB-së kërkesë për informatë shtesë.

13. Në kërkesën e saj për informatë shtesë, të 31 janarit 2013, drejtuar Federatës së Gjuetarëve të Kosovës, Gjykata kërkoi konfirmim se me cilën datë Federata e Gjuetarëve kishte pranuar nga MPB-ja Vendimin Nr. 847/2011, e 14 nëntorit 2011.

14. Në kërkesën e saj për informatë shtesë, të 31 janarit 2013, drejtuar MPB-së, Gjykata kërkoi konfirmim për numrin e shoqatave të gjuetarëve që janë të autorizuara për lëshimin e certifikatave për dhënien me sukses të provimit profesional në kuadër të Vendimit Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011, si dhe kërkoi konfirmim se kur dhe në çfarë mënyre është publikuar vendimi te palët përkatëse.

15. Më 6 shkurt 2013, MPB-ja dërgoi përgjigje në kërkesën e Gjykatës, të 31 janarit 2013, duke sqaruar:

    "*Sipas Ligjit për Armë (04/L-143) i vetmi autoritet i cili lëshon certifikata për dhënien me sukses të provimit profesional për armë është Ministria e Punëve të Brendshme, gjegjësisht Departamenti për Siguri Publike. Vendimi Nr. 847, i datës 14/11/2011, në pikën 5, ka lënë të hapur mundësinë e diskutimit nga grupet e interesit dhe kjo pikë e vendimit nuk është ekzekutive*".

16. Më 13 shkurt 2013, Federata e Gjuetarëve të Kosovës dërgoi përgjigje në kërkesën e Gjykatës, të 31 janarit 2013, duke njoftuar se Federata e Gjuetarëve ka pranuar me postë elektronike, më 17 nëntor 2011, Vendimin Nr. 847/2011.

17. Më 29 prill 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Më 14 nëntor 2011, MPB-ja miratoi një vendim në bazë të të cilit kartelat WRCU/WRC (ose lejet për regjistrim të armëve, të njohura si armë të

gjuetisë ose të rekreacionit), të cilave u vazhdohet afati deri më 1 nëntor 2012, ndryshohen në kartela të MPB-së. Sipas të të njëjtit vendim, Departamenti për Siguri Publike (në tekstin e mëtejmë: DSP) i MPB-së i lëshon kartelë me afat njëvjeçar aplikuesit që përmbush një sërë kushtesh, të përcaktuara me nenin 2 të Vendimit Nr. 847/2011. Më tej, sipas Vendimit, nëse brenda afatit njëvjeçar poseduesit e lejeve për regjistrim të armëve (WRC) sjellin edhe certifikatën për dhënien me sukses të provimit profesional, atëherë DSP-ja lëshon kartelë me afat pesë (5) vjet.

19. Sipas parashtruesve të kërkesës, një numër i konsiderueshëm i anëtarëve të Shoqatës së Gjuetarëve "Dukagjini" dhe të Federatës së Gjuetarëve të Kosovës, i ka kryer shumë vite më parë testet praktike dhe teorike, të kërkuara me Vendimin e MPB-së, prandaj ata edhe kanë fituar të drejtën për armë gjuetie.

20. Neni 5, i Vendimit të MPB-së, përcakton: *"Ministria shqyrton mundësinë e përjashtimit nga testi teorik apo testi praktik për poseduesit e lejeve të përmendura në nenin 1 dhe nenin 2 në rast se testi teorik apo praktik mund të dështohet me ndonjë certifikatë relevante e lëshuar në procedurë të rregullt nga organet legjitime"*. Parashtruesi i parë i kërkesës (KI105/12) pohon se MPB-ja nuk i ka pranuar certifikatat e lëshuara në procedurë të rregullt, duke obliguar gjuetarët t'i nënshtrohen një testi në klubin e shenjëtarisë "Katana" në Obiliq, sipas parashtruesit i vetmi klub në Republikën e Kosovës, duke obliguar gjuetarët që për test të paguajnë një shumë fikse: 170 euro.

21. Sipas dokumentacionit të paraqitur në kërkesë, përkatësisht në shkresën e parashtruesit të dytë (KI133/12), drejtuar MPB-së më 1 nëntor 2011, bëhet me dije se, në kuadër të regjistrave të 24 (njëzetekatër) shoqatave të gjuetarëve, janë të evidencuara 4.188 (katërmijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) certifikata gjuetarësh të kualifikuar gjatë periudhës 2001-2007 dhe në periudhën para vitit 2001. Parashtruesi i kërkesës (KI133/12), në emër të shoqatave të gjuetarëve, ka kërkuar nga MPB-ja, gjithashtu, lirimin e gjuetarëve nga provimi teorik dhe nga provimi praktik për armë, me arsyetimin se gjuetarët janë të pajisur me certifikata të gjuetisë, të lëshuara nga organet legjitime.

22. Parashtruesit e kërkesës deklarojnë se nuk kanë ushtruar ankesë ndaj Vendimit të MPB-së, Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011, duke pohuar se nuk kanë pasur të drejtë ankese.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkeljet kushtetuese

23. Parashtruesi i parë i kërkesës (KI105/12) pohon se Vendimi i MPB-së, në bazë të të cilit të gjithë gjuetarët, pa dallim moshe dhe profesioni, i nënshtrohen testit, është i padrejtë dhe i paligjshëm, për arsye se një numër i konsiderueshëm gjuetarësh janë gjuetarë të sprovuar dhe me pasion dhe se e kanë ushtruar këtë sport për më shumë se tridhjetë (30) vjet, dhe të njëjtit kanë kryer shërbimin e rregullt ushtarak, duke u trajnuar për përdorimin e armës dhe, gjithashtu, posedojnë certifikatat e lëshuara nga Federata e Gjuetarëve të Kosovës nëpërmjet një komisioni legjitim. Parashtruesi i parë i kërkesës më tej shpjegon se, në strukturën e gjuetarëve, është një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, i pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës, të cilët, në kuadër të profesionit të tyre, janë trajnuar për përdorimin e armëve, duke pretenduar se është e padrejtë, e pajustifikueshme, e kundërligjshme dhe kundërkushtetuese që këto kategori të gjuetarëve t'i nënshtrohen testit të kërkuar në bazë të Vendimit të MPB-së, Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011.

24. Parashtruesi i parë i kërkesës (KI105/12) pohon se, me Vendimin e MPB-së, Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011, janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës: neni 3 i Kushtetutës [Barazia para Ligjit]; neni 21 [Parimet e Përgjithshme]; neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; neni 24 [Barazia para Ligjit]; neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; neni 44 [Liria e Asociimit]; neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]; neni 55 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore].

25. Parashtruesi i dytë i kërkesës (KI133/12) pohon se, me Vendimin e MPB-së, Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011, janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës: neni 3 [Barazia para Ligjit]; neni 16 [Epërsia e Kushtetutës]; neni 17 [Marrëveshjet Ndërkombëtare]; neni 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare]; neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare]; neni 21 [Parimet e Përgjithshme]; neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; neni 24 [Barazia para Ligjit]; neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; neni 44 [Liria e Asociimit]; neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]; neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore].

26. Parashtruesi i dytë i kërkesës (KI133/12) më tej pohon se, Vendimi i MPB-së, Nr. 847/2011, i 14 nëntorit 2011, është në kundërshtim me dispozitat e nenit 1 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, Nr. 02/L-42; me dispozitat e nenit 47 (Ligji për Gjuetinë, Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 37, i 25 shtatorit 1979, KK Nr. 112-57/79); me dispozitat e nenit 63 të Ligjit për Gjuetinë, Nr. 02/L-53, të 16 dhjetorit 2005; dhe me dispozitat e nenit 7 të Ligjit për Armët, Nr. 03/L-143, të 17 nëntorit 2009.

27. Parashtruesit e kërkesës, në kërkesën e tyre, në emër të të gjithë gjuetarëve të kualifikuar, me anëtarësi në shoqatat e gjuetarëve, kërkojnë shqyrtimin e ligjshmërisë dhe të kushtetutshmërisë së vendimit të organeve kompetente të MPB-së për mosnjohje të kualifikimeve ligjore të gjuetarëve për armë dhe për gjueti, deri në vitin 2007.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesve, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë dhe që saktësohen me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Sa i përket kërkesës së parashtruesve, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

"*Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi*".

30. Për të vërtetuar faktin nëse parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën brenda afatit të përcaktuar katërmuajsh, Gjykata i referohet kohës së pranimit të vendimit të fundit nga parashtruesit e kërkesës si dhe datës së paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

31. Nga parashtresat shihet që kërkesat në Gjykatën Kushtetuese janë parashtruar më 22 tetor 2012 dhe më 24 dhjetor 2012, ndërkohë që Vendimi i MPB-së, Nr. 847/2011, i 14 nëntorit 2011, i është komunikuar Federatës së Gjuetarëve të Kosovës me postë elektronike më 17 nëntor 2011, që do të thotë se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

32. Bazuar në atë që u tha më sipër, rezulton se kërkesa është e paafatshme.

33. Prandaj, kërkesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme, për shkak të mosrespektimit të afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës; në përputhshmëri me nenin 49 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.1 (b) të Rregullores, më 24 maj 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 34/13, Besart Begu, datë 14 qershor 2013 –Vlerësim i kushtetutshmërisë së procedurës në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës në rastin A. nr. 1578/12.

Rasti KI 34/13, Aktvendim për papranueshmëri i 15 majit 2013

Fjalë kyçe: kërkesë individuale, mos-shterimi, shkelja e të drejtave dhe lirive të njeriut

Parashtruesi, z. Besart Begu, parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke u ankuar se më 22 dhjetor 2012 kishte paraqitur padi në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, e regjistruar me numrin A. nr. 1578/12, dhe sa i përket padisë nuk kishte marrë asnjë përgjigje nga ana e tyre. Prandaj, ende nuk ka vendim përfundimtar, i cili do të kontestohej ne Gjykatë.

Sa i përket çështjes së pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata gjeti se kërkesa ishte e papranueshme, sepse lënda është në procedurë e sipër në gjykatat e rregullta, ku parashtruesi do të jetë në gjendje të ngrejë ankesat e tij përkitazi me shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij. Prandaj, Gjykata konsideron se ende nuk ka vendim përfundimtar që do të kontestohej në Gjykatë.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në

Rastin Nr. KI34/13
Parashtrues
Besart Begu
Vlerësim i kushtetutshmërisë së procedurës në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, në rastin A. nr. 1578/12

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Besart Begu (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi), me vendbanim në Mitrovicë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), duke u ankuar se më 22 dhjetor 2012 kishte paraqitur padi në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, e regjistruar me numrin A. nr. 1578/12, dhe sa i përket padisë nuk kishte marrë asnjë përgjigje nga ana e tyre. Prandaj, ende nuk ka vendim përfundimtar, i cili do të kontestohej në Gjykatë.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon, pa precizuar ndonjë dispozitë specifike të Kushtetutës, se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza ligjore

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 11 mars 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

6. Më 25 mars 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI34/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues. Në të njëjtë datë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. KSH. KI34/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Almiro Rodrigues (anëtarë).

7. Më 29 mars 2013, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

8. Më 29 prill 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan me gjyqtarin Enver Hasani, si anëtar i Kolegjit shqyrtues. Kështu, gjyqtari Almiro Rodrigues është kryesues i Kolegjit shqyrtues.

9. Më 15 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 29 dhjetor 2011, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale refuzoi kërkesën e kompanisë së parashtruesit "Mani Com" për licencë, sipas nenit 6 (1.5.2) të Ligjit për Miniera dhe Minerale, Nr. 03/L-163, që parasheh si në vijim: *"Personi që dëshiron të marrë ose mbajë një Licencë ose Leje, ose ta vazhdojë ose të pranojë një bartje të një Licence ose Leje ekzistuese, ka të drejtë ta marrë atë nëse: nuk bie ndesh me lëndën e një kërkese paraprake nga ndonjë parashtrues tjetër që ka prioritet"*. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale konsideroi se ka konflikt të drejtpërdrejtë me objektin e çështjes së një kërkese të mëparshme të një kompanie tjetër. Parashtruesi u ankua kundër këtij vendimi në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale – Komisioni për Ankesa.

11. Më 14 nëntor 2012, Komisioni për Ankesa i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi vendimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, të 29 dhjetorit 2011.

12. Më 21 dhjetor 2012, parashtruesi inicioi procedurën e konfliktit administrativ në Gjykatë Supreme. Parashtruesi u ankua se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka shkelur dispozitat e Ligjit për Miniera dhe Minerale, ka përcaktuar në mënyrë të gabueshme gjendjen faktike dhe ka aplikuar në mënyrë të gabueshme të drejtën materiale.

13. Padia e parashtruesit në Gjykatën Supreme është regjistruar me numrin A. nr. 1578/12.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi pretendon se ai "*nuk ka marrë ndonjë përgjigje nga Gjykata Supreme në Prishtinë për padinë të cilën e ka parashtruar si konflikt administrativ me datën 22.12.2012 me numër të lëndës A. nr. 1578/12*".

15. Për më tepër, parashtruesi pretendon se *"arsyeja pse ai ka ngritur padi ndaj Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në Prishtinë është se disa herë kam aplikuar për licencë, por gjithmonë më është refuzuar nga ana e tyre, për çfarë arsye as unë nuk jam i njoftuar, ku të gjitha obligimet i kam të kryer"*.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton: *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi t'i kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"* dhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili përcakton: *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

18. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat e rregullta, në mënyrë që t'i parandalojë shkeljet e Kushtetutës, ose, nëse ka, të korrigjojë shkeljet e tilla të të drejtave themelore.

19. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për shterimin e mjeteve juridike është që t'ua ofrojë autoriteteve në fjalë, përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose për ta korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës do të sigurojë mjet efikas juridik për mbrojtje nga shkelja e të drejtave kushtetuese. (*Shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999*). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të ceken në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Përderisa çështja ishte ngritur në mënyrë implicite ose në substancë, rregulli i shterimit të mjeteve juridike është plotësuar (*Shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, Nr. 56679/00, vendim i 28 prillit 2004*).

20. Në rastin konkret, Gjykata vëren se lënda është në procedurë e sipër në Gjykatën Supreme, ku parashtruesi do të jetë në gjendje të ngrejë ankesat e tij përkitazi me shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij. Prandaj, Gjykata konsideron se ende nuk ka vendim përfundimtar që do të kontestohej në Gjykatë.

21. Si përfundim, parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 47.2 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës; në bazë të nenit 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe në bazë të rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, më 3 qershor 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 37/13, Faton Sefa, datë 14 qershor 2013 –Kërkesë për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. KI 75/12.

Fjalë kyçe: vazhdim i rastit, kërkesë individuale, *res judicata*, shkelje e të drejtave dhe lirive të njeriut

Parashtruesi z. Faton Sefa, e parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës. Kërkesa e tanishme është vazhdim i rastit Nr. KI 75/12. Parashtruesi tani ankohet se "kjo Gjykatë nuk ka shqyrtuar provat shtesë te cilat iu dorëzuan Gjykatës, më 21 nëntor 2012."

Sa i përket çështjes së pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata gjeti se kërkesa ishte e papranueshme sepse parashtruesi ka dështuar të dorëzojë prova dhe bazë të re dhe të mjaftueshme për një vendim të ri. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme, sepse Gjykata Kushtetuese tashmë kishte vendosur në lidhje me rastin Nr. KI 75/12., përkatësisht rasti është *res judicata*.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI37/13
Parashtrues
Faton Sefa
Kërkesë për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. KI75/12, të 15 janarit 2013, Nr. ref.: RK342/13

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues është z. Faton Sefa, me banim në Gjakovë, i cili më 13 gusht 2012 kishte dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) kërkesën e parë (Rasti Nr. KI75/12). Më 27 nëntor 2012, kërkesa është hedhur poshtë si e papranueshme.

Vendimi i kontestuar

2. Në kërkesën e tanishme, parashtruesi kërkon nga kjo Gjykatë që ta rishqyrtojë Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin KI75-12 të po kësaj gjykate, të 15 janarit 2013, me të cilën Gjykata e ka shpallur të papranueshme kërkesën e parashtruesit, sepse ishte qartazi e pabazuar. Më 31 janar 2013, parashtruesit i është dorëzuar Aktvendimi për papranueshmëri.

Objekti i çështjes

3. Në këtë kërkesë për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri, parashtruesi ankohet se kjo Gjykatë nuk ka shqyrtuar provat shtesë të cilat iu dorëzuan Gjykatës, më 21 nëntor 2012.

Baza juridike

4. Rregulli 36.3 (e) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 13 mars 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për rishqyrtim të Aktvendimit për papranueshmëri të po kësaj gjykate, në Rastin Nr. KI75-12, të 15 janarit 2013.

6. Më 25 mars 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI37/13, caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, me Vendimin nr. KSH. KI37/13 Kryetari i Gjykatës Kushtetuese caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani (anëtarë).

7. Më 7 maj 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan me gjyqtarin Almiro Rodrigues, si Gjyqtar kryesues të Kolegjit shqyrtues.

8. Më 15 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

9. Përkitazi me rastin e mëhershëm, Nr. KI75/12, të parashtruesit, të vendosur më 21 nëntor 2012, Gjykata gjeti kërkesën si të papranueshme, me arsyetimin se parashtruesi nuk kishte paraqitur ndonjë dëshmi që tregon nëse ai ishte ftuar ose jo për të marrë pjesë në procedurat disiplinore dhe nëse Gjykata Supreme kishte injoruar këtë fakt apo jo. Mospajtimi i thjeshtë me Aktgjykimin e shoqëruar me renditjen e disa dispozitave kushtetuese, nuk është i mjaftueshëm për të ndërtuar një rast të shkeljes kushtetuese.

10. Më 13 mars 2013, parashtruesi dorëzoi një letër në Gjykatë, duke pretenduar se, më 21 nëntor 2012, ai kishte dorëzuar në Gjykatë dokumente shtesë, të cilat Gjykata nuk i kishte marrë parasysh. Dokumentet shtesë, të dorëzuara nga parashtruesi më 21 nëntor 2012, ishin këto:

    a. Korrespondenca me postë elektronike ndërmjet parashtruesit dhe një prokurori të Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë. Parashtruesi i kishte shkruar këtij prokurori, duke

kërkuar nga ai të konfirmojë se ndërprerja e kontratës së punës nuk ishte bërë në përputhje me ligjin e zbatueshëm. Prokurori ishte përgjigjur se nuk mund t'i ndihmojë.

b. Deklarata pranë prokurorit të Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë. Më 27 nëntor 2006, parashtruesi, në cilësinë e dëshmitarit, kishte dhënë një deklaratë për punën e tij pranë Tribunalit Ndërkombëtar Penal të ish-Jugosllavisë.

11. Për më tepër, me këtë letër, të 13 marsit 2013, parashtruesi i ka siguruar Gjykatës dokumentacion shtesë, i cili nuk ishte në kërkesën fillestare:

a. Më 8 gusht 2006, punëdhënësi kishte nxjerrë një urdhër, me ç'rast sistemi i bonuseve për punëtorët ishte anuluar dhe se parashtruesi, si udhëheqës i sektorit të tij, mund t'u jepte bonuse punëtorëve të tij brenda atij sektori, nëse ai konsideron se ata kanë punuar mirë, mbi mesatare.

b. Në një datë të paspecifikuar, komisioni disiplinor kishte shqyrtuar njoftimin për ndërprerjen e kontratës së punës së parashtruesit dhe, sipas provave që posedonin, mbështetën njoftimin për ndërprerjen e kontratës së punës së parashtruesit.

c. Më 7 korrik 2012, një e punësuar e ndërmarrjes ku punonte parashtruesi, kishte shkruar një deklaratë ku deklaronte se nën presion dhe nën kërcënim e kishte nënshkruar procesverbalin e komisionit.

d. Marrëveshjen e tij të punësimit.

e. Marrëveshjen për arritjen e caqeve të ndërmarrjes.

f. Përgjigjen e parashtruesit në ankesë të Ndërmarrjes për Gjykatën e Qarkut në Gjakovë.

Pranueshmëria e kërkesës

12. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

13. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36.3 (e), i cili përcakton: *"Një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet*

vijuese kur: Gjykata tashmë ka nxjerrë një vendim për rastin në fjalë dhe kërkesa nuk ofron bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e një vendimi të ri".

14. Parashtruesi ankohet se ai kishte dorëzuar në Gjykatë dokumentacion shtesë, siç përmendet në paragrafin 10, të cilin Gjykata nuk e kishte marrë parasysh.

15. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se këto dokumente shtesë ishin pranuar nga Gjykata, më 3 dhjetor 2012, derisa Gjykata tashmë kishte mbajtur këshillimin për Rastin, më 27 nëntor 2012.

16. Më tej, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit ishte refuzuar nga kjo Gjykatë në aktvendimin e vet për papranueshmëri, në Rastin Nr. KI75/12, sepse, sipas dokumenteve të dorëzuara nga parashtruesi, Gjykata konsideroi se parashtruesi ka dështuar të ndërtojë një rast për shkelje kushtetuese.

17. Përkitazi me dokumentet e reja të dorëzuara, sipas paragrafit 11, Gjykata vëren se këto dokumente nuk konfirmojnë pretendimin e parashtruesit se ai asnjëherë nuk kishte pasur një takim me ndërmarrjen dhe me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës asnjëherë nuk është specifikuar se cilat dispozita ligjore ishin shkelur nga punëdhënësi.

18. Prandaj, Gjykata konsideron se dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi nuk sigurojnë bazë të re dhe të mjaftueshme për një vendim të ri.

19. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se kërkesa është e papranueshme, në pajtim me rregullin 36.3 (e) të Rregullores së punës, sepse Gjykata tashmë ka vendosur përkitazi me këtë çështje.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të rregullit 36.3 (e) dhe të rregullit 56.2 të Rregullores së punës, më 31 maj 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme, sepse Gjykata tashmë ka vendosur për rastin e parashtruesit (Rasti Nr. KI75/12), d.m.th. rasti është *res judicata*;

II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. TË SHPALLË që ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 23/13, Melihate Hakiqi, datë 18 qershor 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit A nr. 1197/2012, të 27 dhjetorit 2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rasti KI 23/13, Aktvendim për papranueshmëri i 14 qershorit 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesa individuale, qartazi e pabazuar, aktvendim për papranueshmëri.

Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e parashtruar më 27 shkurt 2013, kërkon "vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit A. nr. 1197/2012, të 27 dhjetorit 2012, të Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin Gjykata Supreme kishte refuzuar padinë e parashtrueses për vlerësimin e ligjshmërisë të Aktvendimit Nr. 5081032, të 7 shtatorit 2012, të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS), në procedurën e konfliktit administrativ.

Gjykata konstaton që parashtruesi i ankesës nuk ka “argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”, andaj Gjykata gjen se, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pika (c) dhe (d), duhet të refuzohet kërkesa si e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
Rastin Nr. KI23/13
Parashtrues
Melihate Hakiqi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit A nr. 1197/2012 të 27 dhjetorit 2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës,

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtrues i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është znj. Melihate Hakiqi, nga fshati Llapashticë e Epërme, komuna e Podujevës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është Aktgjykimi A. nr. 1197/2012 i 27 dhjetorit 2012 i Gjykatës Supreme të Kosovës, të cilin parashtruesi i kërkesës nuk e ka potencuar se kur e ka pranuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së lëndës së parashtruar më 27 shkurt 2013, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit A. nr. 1197/2012 të 27 dhjetorit 2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin Gjykata Supreme kishte refuzuar padinë e parashtrueses për vlerësimin e ligjshmërisë të Aktvendimit Nr. 5081032 të 7 shtatorit 2012 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenës Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS), në procedurën e konfliktit administrativ.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 29 i Rregullores.

Procedura në Gjykatë

5. Më 27 shkurt 2013, Gjykata Kushtuese pranoi kërkesën e znj. Melihate Hakiqi dhe e regjistroi atë në regjistrin përkatës të Gjykatës, me Nr. KI23/13.

6. Më 28 shkurt 2013, me Vendimin GJ.R. KI23/13 Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues, dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani (anëtarë).

7. Më 21 mars 2013, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës dhe parashtruesin e kërkesës për regjistrim të kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.

8. Më 15 maj 2013, me Vendimin e Kryetarit për zëvendësimin e anëtarit të Kolegjit Shqyrtues, Gjyqtarja Snezhana Botusharova caktohet kryesuese e Kolegjit Shqyrtues.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 20 korrik 2006, Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, kishte nxjerrë vendimin me nr. të dosjes 5081032, me të cilin, në bazë të kërkesës së 19 korrikut 2005, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, kishte miratuar kërkesën e parashtruesit lidhur me pension për persona me aftësi të kufizuar.

10. Ndaj këtij vendimi, në aftin ligjor, nuk kishte ndonjë ankesë të parashtruar nga ndonjë palë.

11. Më 21 maj 2012, Komisioni mjekësor për rishqyrtime i MPMS-së, kishte nxjerrë vendimin që mbante të njëjtin nr. të dosjes 5081032, e që i dedikohej znj. Melihate Hakiqi, me ç'rast i është REFUZUAR e drejta për pension të personave me aftësi të kufizuar.

12. Më 7 shtator 2012, Këshilli i ankesave për pensionet e personave me aftësi të kufizuar i MPMS-së, nxori aktvendimin me nr. të dosjes

5081032, me të cilin refuzoi ankesën e parashtruesit dhe njëkohësisht konstatoi se vendimi i shkallës së parë ishte "plotësisht i bazuar konform Ligjit nr. 2003/23".

13. Në arsyetimin e këtij aktvendimi thuhej se komisioni mjekësor i shkallës së parë ka konstatuar drejt dhe të plotë gjendjen faktike, me faktin se kandidati nuk i përmbush kriteret e nenit 3 të Ligjit Nr. 2003/23, dhe faktin se komisioni i shkallës së dytë, i përbërë nga ekspertët mjekësorë të fushave përkatëse, ka analizuar komplet dokumentacionin shëndetësor të parashtruesit dhe ka konstatuar gjendjen e njëjtë si në dispozitivin e vendimit të shkallës së parë.

14. Kundër këtij aktvendimi, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur padi në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke kërkuar vlerësimin e ligjshmërisë së tij.

15. Më 27 dhjetor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas padisë së parashtruesit të kërkesës në procedurën e konfliktit administrativ, ka nxjerrë Aktgjykimin A. nr. 1197/2012, me të cilin e ka REFUZUAR padinë e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.

16. Në arsyetimin e aktgjykimit të vet, Gjykata Supreme ka theksuar se pala e paditur ka aplikuar drejt të drejtën materiale, kur ka konstatuar se paditësja nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me nenin 3 të Ligjit për PPAK dhe, gjithashtu, edhe komisionet mjekësore, të përbëra nga ekspertë mjekësorë të fushave përkatëse, pa mëdyshje e kanë vërtetuar drejt gjendjen shëndetësore të parashtruesit të kërkesës, andaj Gjykata Supreme, nga thëniet në padi, nuk gjen prova se do të duhej të vendosej ndryshe, apo se vendimet e MPMS-së janë të kundërligjshme.

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi i kërkesës ka pohuar se komisionet mjekësore të MPMS ia kanë refuzuar në mënyrë joligjore "të drejtën për pension për personat me aftësi të kufizuar", edhe pse i ka plotësuar kushtet për një pension të tillë, ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës, duke refuzuar padinë e parashtruesit në procedurën e konfliktit administrativ, gjithashtu ka bërë të njëjtën shkelje.

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me aktgjykimin e kontestuar, i janë shkelur këto të drejta të njeriut, të mbrojtura me Kushtetutë:

a) Neni 23 (Dinjiteti i Njeriut)
b) Neni 24 (Barazia para Ligjit)

c) Neni 25 (E Drejta për Jetën)

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë.

20. Për këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

21. Gjithashtu, Gjykata merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
> *c) kërkesa është qartazi e bazuar".*

22. Duke iu referuar kërkesës së parashtruesit dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë, që pretendohet se janë shkelur, Gjykata konstaton**:** nenin 51 të Kushtetutës [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], paragrafi 2, është paraparë qartazi:

> *"Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj".*

23. Nga përkufizimi juridik i nenit 51 të Kushtetutës, shihet qartë se sigurimi social për "aftësi të kufizuar, papunësi dhe moshë të shtyrë" rregullohet me ligj, në rastin konkret çështja e pensionit të personit me aftësi të kufizuar është rregulluar me Ligjin për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë, Nr. 2003/23, të aprovuar në Kuvendin e Kosovës më 6 nëntor 2003.

24. Procedurat e aplikimit dhe të plotësimit të kushteve për gëzimin e kësaj të drejte janë të parapara me këtë ligj, sikur edhe e drejta e apelimit të vendimeve kur palët nuk janë të kënaqura me vendimet që kanë të bëjnë me kërkesën e tyre.

25. Komisionet administrative të MPMS-së, duke nxjerrë vendimin e 21 majit 2012 dhe aktvendimin e 7 shtator 2012, kishin vepruar pikërisht në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Për më tepër, Gjykata Supreme, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre në procedurën e konfliktit administrativ me aktgjykimin e saj përfundimtar, A. nr. 1197/2012, të 27 dhjetorit 2012, i kishte cilësuar si tërësisht ligjore dhe të bazuara.

26. Gjykata Kushtetuese, duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 23 (Dinjiteti i Njeriut); të nenit 24 (Barazia para Ligjit); dhe të nenit 25 (E Drejta për Jetën) të Kushtetutës, konstatoi se parashtruesi nuk ka paraqitur fakte, para kësaj gjykate, që do të vërtetonin pretendimin e parashtruesit, sepse, në fakt, pos konstatimit se parashtruesi i ka plotësuar kushtet për pension, nuk ka ofruar dëshmi që do të vërtetonin shkeljet e pretenduara dhe as dëshmi se nga cilat organe gjyqësore apo administrative është trajtuar si i pabarabartë.

27. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e faktit dhe, me këtë rast, dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, e në këtë rast edhe i organeve administrative, dhe se roli i saj është vetëm të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (*Shih, mutatis mutandis, i. a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D., 1996-IV, paragrafi 65*).

28. Gjykata Kushtetuese ka rol subsidiar krahasuar me sistemet e rregullta gjyqësore apo edhe administrative vendëse dhe është e dëshirueshme që gjykatat vendëse ose organet kompetente administrative me kompetenca të vendimmarrjes efektive të kenë fillimisht mundësi të vendosin për çështje të pajtueshmërisë të së drejtës së brendshme me Kushtetutën (*Shih vendimin e GJEDNJ-së, A, B dhe C, kundër Irlandës [DHM], § 142*).

29. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (*Shih, mutatis mutandis, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005*).

30. Gjykata Kushtetuese kishte vepruar njëjtë, në kushte dhe në rrethana të njëjta, edhe në Rastin KI101/11, kur kishte nxjerrë Aktvendimin për papranueshmëri, duke e refuzuar kërkesën e parashtruar para saj si qartazi të pabazuar.

31. Në këto rrethana, parashtruesi i kërkesës "nuk ka argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij", andaj, i propozoj Kolegjit shqyrtues që, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pikat c dhe d, ta refuzojë kërkesën si qartazi të pabazuar, dhe

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36.2 pika (c) dhe (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 qershor 2013, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 31/13, Ramadan Muja, datë 18 qershor 2013- Ekzekutimi i Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 516/07 të 12 nëntorit 2007

Lënda KI 31/13, Aktvendim për papranueshmëri i 15 majit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, ekzekutimi i aktgjykimit të gjykatave.

Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Parashtruesi i kërkesës, më 11 mars 2013, parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me ç'rast kërkoi nga Gjykata ekzekutimin e aktgjykimeve të gjykatave që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave të tij.

Parashtruesi në kërkesë nuk përmend se cilat të drejta kushtetuese i janë shkelur.
Me Vendimin e Kryetarit nr. GJR. KI 31/13, të 22 marsit 2013, u caktua gjyqtari Almiro Rodrigues si Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit nr. KSH. KI 31/13, u caktua Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu, Arta Rama Hajrizi.

Gjykata, gjatë shqyrtimit të kërkesës, konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47 (2) të Ligjit, si dhe rregullit 36 (1) a).

Duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në seancën e mbajtur më 15 maj 2013, e shpalli kërkesën si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI31/13
Parashtruesi
Ramadan Muja
Ekzekutimi i Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren
C. nr. 516/07 të 12 nëntorit 2007

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Ramadan Muja, fshati Strazhë, komuna e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet ekzekutimi i Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 516/07 të 12 nëntorit 2007.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon ekzekutimin e aktgjykimeve që kanë të bëjnë me të drejtat e tij e fituara. Megjithatë, ai nuk përmend se cilat të drejta kushtetuese i janë shkelur.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56

paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e Punës).

5. Më 16 prill 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Procedura në Gjykatë

6. Më 11 mars 2013, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 22 mars 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar Raportues dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama Hajrizi.

8. Më 2 prill 2013, Gjykata Kushtetuese përmes një shkrese e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Gjykatës Themelore në Prizren, si pasardhëse e Gjykatës Komunale në Prizren.

9. Më 15 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. *Më 5 qershor 1969, parashtruesi kishte themeluar marrëdhënie pune në ndërmarrjen tregtare „Sredačka Župa“ në Prizren dhe për shkak të disa konflikteve ai kishte iniciuar procedurë përmes gjykatave të rregullta me qëllim që të realizonte të drejtat e pretenduara.*

11. *Pas një kohe të gjatë, më 24 korrik 2006, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës duke kërkuar që ta obligojë ndërmarrjen "Sredačka Župa" që parashtruesit t'ia paguajë shumën prej 19.568,22 Euro.*

12. *Më 2 korrik 2007, Dhoma e Posaçme nxori vendim (Lënda SCC-06-0344) për t'ia referuar* "këtë çështje Gjykatës Komunale në Prizren dhe kështu duke ia dhënë kompetencën kësaj gjykatë që të vendos për këtë çështje. Në rast se vendimi ose aktgjykimi i kësaj gjykate ankimohet, ankesa parashtrohet në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. "

13. *Në fakt, ky vendim ishte marrë* "në bazë të nenit 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13 dhe nenit 17 të Urdhëresës Administrative të

UNMIK-ut 2006/17, Dhoma, pavarësisht nga kompetencat e veta, mund t'i referojë paditë specifike ose kategoritë e padive cilësdo gjykatë që ka juridiksion për atë çështje sipas ligjit në fuqi, sipas kërkesës së palës ose sipas iniciativës së vet nëse është e bindur se janë përmbushur kushtet nga neni 17.(b). Kushtet janë si në vijim:

> Dhoma e Posaçme është e bindur se gjykata së cilës i referohet kërkesëpadia do të sjellë vendim të paanshëm duke pasur parasysh:
> (i) natyrën e palëve;
> (ii) vlerën e shumës kontestuese dhe
> (iii) rrethanat tjera të kërkesëpadisë".

14. *Më 12 nëntor 2007, Gjykata Komunale në Prizren nxori aktgjykimin [C.no.516/07], duke e urdhëruar "Sredačka Župa" që parashtruesit t'ia paguajë borxhin për të ardhurat personale për periudhën prej 4 qershorit 1990 deri më 2 shkurt 1998, në shumë prej 19.568,22 Euro ku përfshihen edhe shpenzimet për ekspertizën dhe për procedurën gjyqësore.*

15. *Më 1 prill 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP) e njoftoi Gjykatën Komunale në Prizren „*se në pajtim me nenin 2.1 të Ligjit nr. 03/L-067, ajo është e autorizuar për administrimin duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve të përkufizuara në këtë ligj. " *Në përfundim të shkresës thuhet se:* "Agjencia do t'i shqyrtojë të gjitha kërkesat, duke përfshirë edhe kërkesën e parashtruesit për realizimin e të drejtave të tij, vetëm nëse parashtruesi paraqet kërkesë para komisionit për likuidim, në pajtim me dispozitat e ligjit."

16. *Më 10 janar 2011, AKP e informoi parashtruesin se* "likuidimi i ndërmarrjes 'Župa Rečane' ka filluar më 31 dhjetor 2010 dhe se të gjitha obligimet ndaj parashtruesit, duke përfshirë të gjitha rrogat e papaguara të cilat punëdhënësi ia ka borxh në bazë të kontratës për punësim, do të trajtohen sipas rregullores së likuidimit".

17. *Më 28 janar 2011, AKP kërkoi nga parashtruesi:* "të konfirmoni se kërkesa juaj mbetët e pandryshuar nga dita e likuidimit (...)" *dhe* "plotësoni formularin e kërkesës të bashkëngjitur (...)". Parashtruesi duhet ta kthejë formularin e kërkesës për likuidim "më ose para 20 marsit 2011".

18. *Më 21 shkurt 2011, parashtruesi ia ktheu AKP-së formularin e paraqitjes së kërkesës për likuidim.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. *Parashtruesi deklaron se, edhe përkundër faktit se vendimet gjyqësore janë në dobi të tij, ai nuk po mund t'i realizojë të drejtat e veta që 23 vjet.*

20. *Parashtruesi pretendon se* "më 31 dhjetor 2010, ne, të gjithë punëtorët u informuam dhe pranuam vendimin se ndërmarrja jonë është në procedurën e likuidimit dhe se të gjithë jemi të larguar nga puna, dhe se ndërmarrjes duhet t'ia paraqesim paditë tona, dhe se në afat prej tre muajsh do të jemi të njoftuar për vlerësimin e kërkesave tona, 2 vjet kaluan, nuk morëm kurrfarë njoftimi as ndonjë provë valide se ata i kanë pranuar dokumentet (...).

21. *Parashtruesi gjithashtu pretendon:* "Unë nuk i di dispozitat kushtetuese, unë nuk jam jurist, në këtë kërkesë e kam paraqitur veten time si fshatar dhe besoj se ju më kuptoni".

22. *Parashtruesi më tutje pretendon se brenda afatit ligjor e ka dërguar dokumentacionin e kërkuar në AKP por qe dy (2) vjet është duke e pritur përgjigjën.*

23. *Me një fjalë, parashtruesi kërkon që t'i paguhen të gjitha rrogat e papaguara, siç është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren [C.no.516/07] të 12 nëntorit 2007, duke përfshirë të drejtën e 20% i cili i takon sipas Ligjit për privatizim.*

Pranueshmëria e kërkesës

24. Para së gjithash, për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të cilat parashihen me Kushtetutë dhe specifikohen më tej me Ligj dhe Rregullore të Punës.

25. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës cili parasheh se:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

26. Në anën tjetër, neni 47(2) i Ligjit gjithashtu përcakton se:

Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

27. Për më tepër, rregulli 36(1) a) i Rregullores së Punës parasheh se:

Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar.

28. Parashtruesi pohon se brenda afatit ligjor e ka dërguar dokumentacionin e kërkuar nga AKP-ja. Megjithatë, parashtruesi është duke pritur përgjigjën që nga 21 shkurti 2011, dita kur e ka dërguar dokumentacionin. Kjo do të thotë se çështja është ende e pazgjidhur në AKP dhe shterja e mjeteve juridike të përcaktuara me ligjin në fuqi ende nuk është përmbushur.

29. Gjykata rikujton se ajo mund të vendosë për pranueshmërinë e kërkesës vetëm nëse parashtruesi/ja tregon se ai/ajo i ka shterur të gjitha mjetet juridike efektive që i ka në dispozicion në bazë të ligjit në fuqi.

30. Në fakt, parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi t'i shterë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt me qëllim që të parandalohet shkelja e Kushtetutës ose, nëse ka shkelje të një të drejte themelore, e njëjta të korrigjohet.

31. *Arsyeja për rregullin e shterimit është që autoritetet përkatëse,* përfshirë këtu edhe AKP-në të kenë mundësi për të parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë një mjet efektiv kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës. (Shih Aktvendimi për papranueshmëri: Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës KI-41/09 i 21 janarit 2010, dhe shih mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

32. Në fakt, si rregull i përgjithshëm, Gjykata Kushtetuese intervenon aty ku ka shkelje të interpretimit të Kushtetutës ose ku ligjet nuk përputhen me Kushtetutën, por vetëm pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

33. Andaj, kërkesa, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47(2) të Ligjit dhe rregullit 36(1) a) të Rregullores së Punës, është e parakohshme dhe si e tillë e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 36.2 dhe 56 të Rregullores së punës, më 27 maj 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,

IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 110/12 , Dara Menkovič, datë 18 qershor 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit përshpalljen e listës përfundimtare të 20 %-shit, të hartuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rasti KI 110/12, Aktvendim për papranueshmëri i datës 17 qershor 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesa Individuale, mosshterje e mjeteve juridike, Aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e parashtruar më 1 nëntor 2012, kërkon "vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit për shpalljen e listës përfundimtare të 20 %-shit, të hartuar nga Agjensia Kosovare e Privatizimit, duke pretenduar se "AKP-ja, gjatë procedurës për ndarjen e shumës së 20%-shit nga procesi i privatizimit të ndërmarrjes "INTEGJ", me seli në Gjilan, ka bërë diskriminim me rastin e pagesës së punëtorëve që e kanë fituar të drejtën në pagesë, në pajtim me nenin 2, paragrafi 1, pika a-b, sipas nenit 3, paragrafi 1, në lidhje me nenin 4, paragrafi a, i, j, k, të Ligjit kundër diskriminimit, Nr. 2004/3, pasi punëtorët e tjerë, të cilët ishin përfshirë në listë, kishin marrë një pjesë të të hollave të 20%-shit.

Gjykata konstaton që parashtruesi nuk i ka shteruar mjetet ligjore të ofruara me ligj, siç kërkohet, në mënyrë që të mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtetues.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI110/12
Parashtrues
Dara Menkovič
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit për shpalljen e listës përfundimtare të 20%-shit, të hartuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga znj. Dara Menkovič, me vendbanim në Cernicë, fshat në komunën e Gjilanit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin për shpalljen e listës përfundimtare dhe mospagesën e shumës së 20%-shit nga privatizimi i ndërmarrjes së tekstilit "INTEGJ", me seli në Gjilan, nga ana e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës ankohet se është larguar nga pagesa e shumës së 20%-shit nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore "INTEGJ", me seli në Gjilan, përkundër dorëzimit me kohë të të gjitha dokumenteve të nevojshme për pagesën e kësaj shume.

4. Parashtruesi nuk i referohet asnjë dispozite të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës; neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 1 nëntor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

7. Më 6 nëntor 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesi që ta plotësojë kërkesën në pajtim me rregullin 36.4 të Rregullores së punës.

8. Më 22 nëntor 2012, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një dokument shtesë, "Aktvendim për përcaktimin e koeficientit për pagesën e rrogës".

9. Më 4 dhjetor 2012, Kryetari me Vendimin Nr. GJR. KI110/12 caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI110/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (gjyqtare kryesuese), Ivan Čukalovič dhe Arta Rama-Hajrizi.

10. Më 14 dhjetor 2012, Gjykata njoftoi AKP-në përkitazi me regjistrimin e kërkesës.

11. Më 5 shkurt 2013, Gjykata kërkoi nga AKP-ja që, në afatin kohor 15-ditësh, AKP-ja të japë komentet për atë se pse parashtruesi i kërkesës është përjashtuar nga lista dhe pse parashtruesja e kërkesës nuk i ka marrë mjetet (20%) nga të ardhurat e shitjes së Ndërmarrjes Shoqërore "INTEGJ", me seli në Gjilan.

12. Më 14 shkurt 2013, AKP-ja i është përgjigjur çështjeve të ngritura nga Gjykata.

13. Më 29 prill 2013, Kryetari me Vendimin Nr.KSH.KI110/12 bëri zëvendësimin e gjyqtarëve të Kolegjit shqyrtues. Në vend të gjyqtares Arta Rama-Hajrizi anëtar të Kolegjit shqyrtues KI110/12 u caktua Kryetari Prof. Dr. Enver Hasani.

Përmbledhje e fakteve

14. Parashtruesi i kërkesës ankohet se, kundër dëshirës së saj, është larguar nga pagesa e shumës së 20%-shit nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore "INTEGJ", me seli në Gjilan, përkundër dorëzimit me kohë të të gjitha dokumenteve të nevojshme për pagesën e kësaj shume.

15. Më 14 shkurt 2013, AKP-ja, në përgjigjen e saj drejtuar Gjykatës përkitazi me çështjet e ngritura nga Gjykata, ka theksuar se parashtruesi i kërkesës gjendet në listën përfundimtare të punëtorëve, të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hollave nga pjesa e shumës së 20%-shit nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore "INTEGJ", me seli në Gjilan. AKP-ja, në përgjigjen e saj, më tej thekson se disa nga ankuesit e kanë kundërshtuar të drejtën e parashtruesit së kërkesës për marrjen e kësaj shume, andaj parashtruesi nuk është përjashtuar nga lista, por është kundërshtuar e drejta e saj nga ana e ankuesve, dhe AKP-ja është duke pritur vendimin meritor të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme përkitazi me kundërshtimin për të proceduar më tutje me shpërndarjen e mjeteve.

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesi pretendon se "AKP-ja, gjatë procedurës për ndarjen e shumës së 20%-shit nga procesi i privatizimit të ndërmarrjes "INTEGJ", me seli në Gjilan, ka bërë diskriminim me rastin e pagesës së punëtorëve që e kanë fituar të drejtën në pagesë, në pajtim me nenin 2, paragrafi 1, pika a-b, sipas nenit 3, paragrafi 1, në lidhje me nenin 4, paragrafi a, i, j, k, të Ligjit kundër diskriminimit, Nr. 2004/3, pasi punëtorët e tjerë, të cilët ishin përfshirë në listë, kishin marrë një pjesë të të hollave të 20%-shit ".

17. Parashtruesi pretendon se " ajo ka qenë në këtë listë, por nuk ka marrë të holla, përkatësisht pohon se është përjashtuar nga pagesa kundër dëshirës së saj ".

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

18. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

19. Për këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

20. AKP-ja, në shkresën e saj drejtuar Gjykatës, më 14 shkurt 2012, thekson se e drejta e parashtruesit së kërkesës për marrjen e shumës së 20%-shit nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore "INTEGJ", me seli në Gjilan, është kundërshtuar nga ana e ankuesve dhe se AKP-ja është duke pritur vendimin meritor të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, përkitazi me kundërshtimin, për të proceduar më tutje me shpërndarjen e mjeteve. Përderisa procesi është në vazhdim e sipër dhe nuk ka vendim përfundimtar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.

21. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua ofrojë autoriteteve në fjalë, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose për ta korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës do të sigurojë mjete efektive për mbrojtjen e të drejtave të garantuara me kushtetutë (*Shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni v. France, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999*).

22. Kjo Gjykatë e ka përdorur të njëjtin arsyetim në Vendimin për papranueshmëri, më 27 janar 2010, mbi bazën e mosshterjes së mjeteve juridike në Rastin Nr. KI41/09, Universiteti AAB-RIINEST sh.p.k., Prishtinë, kundër Qeverisë së Kosovës; dhe në Vendimin e 23 marsit 2010, në Rastin Nr. KI73/09, Mimoza Kusari kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

23. Duke u bazuar në shkresën e dërguar nga AKP-ja, më 14 shkurt 2013, kuptohet se çështja e ngritur nga parashtruesi është ende në procedurë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme andaj kërkesa e parashtruesit është e parakohshme. Prandaj, parashtruesi nuk i ka shteruar mjetet ligjore të ofruara me ligj, siç kërkohet, në mënyrë që të mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36.1 pika (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 qershor 2013, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 119/11, Sadri Mazreku, datë 18 qershor 2013- Vlerësim i Vendimit të Gjykatës Komunale në Malishevë (C. Dr. 90/2004), të 10 qershorit 2005 dhe të Aktgjykimit te Gjykatës Supreme, PKL Nr. 120/08, të 1 shtatorit 2009

Rasti KI119/11, Aktvendim për papranueshmëri i 4 qershorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë papranueshme, kërkesë e paaftshme, e drejta në pronë, rastet paraprake, *ratione temporis*.

Kërkesa bazohet në Nenin 113.7 të Kushtetutës, Neni 22 i Ligjit dhe rregullin 56 të Rregullores së punës. Parashtruesi, ndër të tjera, pohoi se vendimet e gjykatave të rregullta kanë cenuar të drejtat e tij në pronë.

Gjykata theksoi se njëri prej vendimeve të kontestuara nga parashtruesi i kërkesës ishte nxjerrë para hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës çka do të thotë se kërkesa e tillë nuk përkon me juridiksionin kohor të Gjykatës. Kurse për vendimin tjetër të kontestuar, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte dorëzuar pas afatit ligjor prej (4) katër muajve dhe si e tillë ishte e paafatshme. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata bazuar në Nenin 113 të Kushtetutës, Nenet 49 dhe 56 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) dhe (3) h) të Rregullores së punës vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesve të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin KI 119/11
Sadri Mazreku
Vlerësim i Vendimit të Gjykatës Komunale në Malishevë (C. nr. 90/2004), të 10 qershorit 2005 dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PKL Nr. 120/08, të 1 shtatorit 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Kërkesa

1. Kërkesa është parashtruar nga Sadri Mazreku, nga Malisheva (Parashtruesi i kërkesës).

2. Parashtruesi i kërkesës cek Vendimin e Gjykatës Komunale në Malishevë (C. nr. 90/2004), të 10 qershorit 2005, i cili i është dorëzuar më 22 korrik 2007, si vendim përfundimtar.

3. Përveç vendimit të cekur, parashtruesi i kërkesës përmend aktgjykimet e tjera: Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Deçan, KA. Nr. 14/2008, të 27 gushtit 2008; Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Deçan, KA. Nr. 14/2008, të 7 tetorit 2008; dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PKL. Nr. 120/08, të 1 shtatorit 2009.

4. Parashtruesi i kërkesës përmend aktgjykimet e tjera si provë në lidhje me kontestin për pronën dhe parashtroi kërkesë "për shkak të padrejtësisë në emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve si SL dhe HB".

5. Parashtruesi kërkon nga Gjykata "që për shkelësit e qëllimshëm të ligjit SL dhe HB (...) të konkludohet se ata janë shkelës të vetëdijshëm të ligjit

me rekomandim për shkarkimin e tyre për shkak të veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare".

6. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk tregon se cila është baza kushtetuese e kërkesës, nuk cek se cilat janë shkeljet e pretenduara të Kushtetutës dhe nuk shpjegon se pse faktet e paraqitura shkelin të drejtat kushtetuese.

7. Kërkesa me sa duket bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatë

8. Më 26 gusht 2011, parashtruesi i kërkesës i parashtroi kërkesën Gjykatës.

9. Më 1 shtator 2011, Kryetari caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj gjyqtare raportuese si dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Iliriana Islami.

10. Më 26 nëntor 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues si dhe Kolegjin e ri shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu, meqenëse gjyqtaret Iliriana Islami dhe Gjyljeta Mushkolaj kishin përfunduar mandatin e tyre në Gjykatë.

11. Më 29 janar 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në një datë të paspecifikuar të vitit 2004, ka filluar procedura gjyqësore në Gjykatën Komunale në Malishevë për të siguruar të drejtën e pretenduar për pronën, që kaloi nëpërmjet Gjykatës Komunale në Deçan deri në Gjykatën Supreme.

13. Më 1 shtator 2009, Gjykata Supreme (P. kl. Nr. 120/08) ka vendosur për kërkesën e Prokurorit të Shtetit në Kosovë për mbrojtjen e ligjshmërisë, të parashtruar kundër vendimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Deçan (KA. Nr. 14/2008), të 9 tetorit 2008, ku Sadri Mazreku (parashtruesi i kërkesës) ka qenë "paditës subsidiar".

14. Gjykata Supreme arriti në përfundim se "kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar. Më tej konkludoi se "me vendimin e përmendur janë kryer shkelje të dispozitave të neneve 304 deri 316 të KPPK në favor të të pandehurit Emrush Kastrati".

15. Megjithatë, Gjykata Supreme gjithashtu konstatoi se "pasi që konform nenit 457 paragrafi 2 të KPPK-së, kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se "me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Malishevë ka pasur një shkelje të nenit 113 (paragrafi 1, pika 7) të Kushtetutës" (sic).

17. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pohon: "Prona ime dhe prona e 18 trashëgimtarëve tjerë ka qenë e gëzuar vetëm nga Hamdi Mazreku, me ç'rast, me Aktgjykimin e formës së prerë na janë cenuar të drejtat në pronë".

Pranueshmëria e kërkesës

18. Para së gjithash, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregulloren e punës.

19. Në atë rast, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], i cili përcakton:

> *1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

20. Në shqyrtimin e kërkesës së afatit ligjor, Gjykata vëren se neni 56 (Rastet paraprake) të Ligjit parasheh:

> *"Afatet e përcaktuara në këtë ligj për fillimin e një procedure për çështjet për të cilat është kompetente Gjykata Kushtetuese dhe të cilat janë ngritur para hyrjes në fuqi të këtij ligji fillojnë të llogariten në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji".*

21. Nga ana tjetër, neni 49 (Afatet) i Ligjit thotë:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".

22. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) b) dhe (3) h) të Rregullores së punës parasheh:

1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi;
3. Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:
h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën.

23. Duke marrë parasysh këto dispozita ligjore, duhet konkluduar se juridiksioni kohor i Gjykatës Kushtetuese për rastet paraprake fillon në datën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës, e që ishte më 15 qershor 2008 dhe vazhdon deri më 15 maj 2009, që do të thotë katër muaj (shih nenin 49 të Ligjit) pas hyrjes në fuqi të Ligjit, që ishte më 15 janar 2009.

24. Gjykata vëren se, në këtë rast, vendimi i cekur i formës së prerë i Gjykatës Komunale në Malishevë (C. nr. 90/2004), është i datës 10 qershor 2005 dhe i është dorëzuar parashtruesit më 22 korrik 2007.

25. Pra, ky vendim është dërguar dhe dorëzuar para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, më 15 qershor 2008.

26. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të merret me një kërkesë që ka të bëjë me ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës (Shih aktvendimet e Gjykatës për pranueshmërinë në Rastin Nr. 18/10, Denic et al i 17 gushtit 2011 dhe në Rastin Nr. KI152/11: Bekim Murati, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Kosovës, i 20 qershorit 2012).

27. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

28. Për më tepër, Gjykata vlerëson se, edhe në qoftë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme (PKL. Nr. 120/08), i 1 shtatorit 2009, do të mund të merrej si vendim përfundimtar për t'u kontestuar, kërkesa sërish do të ishte e paafatshme.

29. Në fakt, Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është nxjerrë më 1 shtator 2009.

30. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë më 26 gusht 2011, që do të thotë gati njëzet muaj pas afatit kohor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

31. Prandaj, kërkesa është e paafatshme, sepse nuk i ishte parashtruar Gjykatës në përputhje me nenin 49 të Ligjit, dhe në këtë mënyrë nuk ishte parashtruar në mënyrë ligjore, siç parashihet me nenin 113 (1) të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113 të Kushtetutës; me nenin 49 e me nenin 56 të Ligjit; dhe me rregullin 36 (1) b) dhe (3) h) të Rregullores së punës, më 4 qershor 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 129/12, Nezir Bytyqi, datë 20 qershor 2013- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 204/2008 të 29 gushtit 2011.

Rasti KI 129/12, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 majit 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë Individuale, e paafatshme, Aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai nuk ka përfituar nga gjykimi i drejtë dhe i paanshëm gjatë vendosjes në lidhje me padinë e tij. Në veçanti, parashtruesi i kërkesës pretendon se prania e gjyqtares së njëjtë (G. S.) në dy procedura të Gjykatës Komunale dhe në trupin gjykues të Gjykatës Supreme të Kosovës, qon në përfundimin se gjykatat nuk kishin qenë të paanshme.

Gjykata konkludon se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit katër mujor të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të Punës, dhe duhet të refuzohet si e paafatshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI 129/12
Parashtrues
Nezir Bytyqi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 204/2008 të 29 gushtit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtruesi i kërkesës është Nezir Bytyqi me vendbanim në Prishtinë. Ai përfaqësohet nga Florim Shefqeti, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme Rev. Nr. 204/2008 të 29 gushtit 2011. Parashtruesi i kërkesës pohon se atij vendimi i është dorëzuar më 24 shtator 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i lartpërmendur i kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, në veçanti të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkeljen e nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], dhe nenit 106.2 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës. Për më tepër, Parashtruesi pretendon shkeljen e nenit 7 dhe 10 të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e Drejtave të Njeriut.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullin 56, paragrafi 2, i Rregullores së Punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 dhjetor 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 10 janar 2013, Kryetari caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët:Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

7. Më 4 mars 2013, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme.

8. Më 4 mars 2013, është kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të sigurojë një kopje të konfirmimit të pranimit, e cila e tregon datën kur Vendimi i Gjykatës Supreme Rev.Nr.204/2008, të 29 gushtit 2011, i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.

9. Më 7 mars 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë e dorëzoi një kopje të konfirmimit të dorëzimit, duke treguar se Vendimi i Gjykatës Supreme Rev. Nr. 204/2008, të 29 gushtit 2011, i është dorëzuar avokatit Naim Haliti më 17 tetor 2011.

10. Më 14 mars 2013, është kërkuar nga parashtruesi i kërkesës të sqarojë dallimin në mes të datës së dorëzimit të Vendimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 204/2008, siç është treguar në Kërkesë si dhe siç ishte dorëzuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

11. Më 28 mars 2013, Parashtruesi e parashtroi përgjigjen e tij.

12. Më 15 maj 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues zëvendësues të gjyqtarit Robert Carolan në Kolegjin shqyrtues. Kolegji shqyrtues përbëhet nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

13. Më 15 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit

14. Prej 21 majit 1992, parashtruesi i kërkesës ishte në marrëdhënie të punës me kohë të pacaktuar me *NSH Tregu* në Prishtinë. Parashtruesi ishte i punësuar si inkasant. Më 22 mars 1999, për shkak të luftës në Kosovë, parashtruesi kishte ikur dhe kishte shkuar në kampin e refugjatëve në Turqi.

15. Në shtator 1999, parashtruesi ishte kthyer në Prishtinë dhe ishte lajmëruar menjëherë në vendin e punës. Si duket, kjo nuk ishte e mundur në atë kohë. Rrjedhimisht, më 22 qershor 2000, parashtruesi i kërkesës paraqiti një kërkesë me shkrim për t'u kthyer në vendin e tij të mëparshëm të punës. Më 28 qershor 2000, kjo kërkesë ishte refuzuar. Parashtruesi paraqiti kërkesë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për kthim në punë në *NSH Tregu* në Prishtinë

16. Më 8 gusht 2000, (Cl.nr.29/2000), Gjykata Komunale e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës. Ky vendim ishte nxjerrë nga trupi gjykues prej një gjyqtari, G. S., dhe dy gjyqtarëve porotë.

17. Më 30 tetor 2001, (Cl.nr. 302/2001), Gjykata Komunale refuzoi përsëri padinë e parashtruesit, këtë herë nga një gjyqtar i vetëm, G. S.

18. Më 18 tetor 2004, (Ac.nr. 86/2002), Gjykata e Qarkut në Prishtinë urdhëroi rigjykimin e rastit.

19. Më 29 qershor 2005, (Cl.nr. 375/2004), Gjykata Komunale në Prishtinë e refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës, pas rigjykimit.

20. Më 4 shkurt 2008, (Ac.nr. 676/2006), Gjykata e Qarkut e ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe urdhëroi kthimin e parashtruesit në vendin e tij të punës.

21. Më 11 qershor 2009, (Cl.nr. 237/2008), Gjykata Komunale në Prishtinë në procedurën epërmbarimit, të bazuar në aktgjykimin e fundit të Gjykatës së Qarkut, e urdhëroi *NSH Tregu* t'ia paguajë parashtruesit pagat e parealizuara, të plotësuara me kamatë ligjore.

22. Më 29 gusht 2011, (Rev.Nr.204/2008), Gjykata Supreme shpalli të bazuar revizionin që ishte ushtruar nga *NSH Tregu* kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut AC.nr.676/2006. Gjykata Supreme e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 29 qershorit 2005, (Cl.nr. 375/2004), me të cilin nuk kërkohej nga *NSH Tregu* t'a kthejë parashtruesin në vendin e tij të punës. Njëri nga tre gjyqtarët e trupit gjykues të Gjykatës Supreme ishte G. S.

23. Më 4 shtator 2012, (AC.nr. 1144/2009), Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në procedurën e përmbarimit ndaj ankesës, vërtetoi aktgjykimin për përmbarim të Gjykatës Komunale të 11 qershorit 2009, duke urdhëruar *NSH Tregu* ti paguajë parashtruesit pagat e parealizuara me kamatë ligjore.

Argumentet juridike të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës

24. Në substancë, parashtruesi i kërkesës pretendon se ai nuk ka përfituar nga gjykimi i drejtë dhe i paanshëm gjatë vendosjes në lidhje me padinë e tij. Në veçanti, parashtruesi i kërkesës pretendon se prania e gjyqtares së njëjtë (G. S.) në dy procedura të Gjykatës Komunale dhe në trupin gjykues të Gjykatës Supreme të Kosovës, qon në përfundimin se gjykatat nuk kishin qenë të paanshme.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Gjykata Kushtetuese, për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

26. Gjykata duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat sipas nenit 113 (7) të Kushtetutës dhe nenit 47 (2) të Ligjit.

27. Neni 113, paragrafi 7 parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

28. Vendimi përfundimtar në rastin e parashtruesit përkitazi me kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese është Vendimi i Gjykatës Supreme (Rev.nr.204/2008) i 29 gushtit 2011. Si rezultat, parashtruesi ka treguar se ai i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas ligjeve në fuqi.

29. Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se ai i ka plotësuar kriteret e nenit 49 të Ligjit, në lidhje me parashtrimin e kërkesës brenda afatit ligjor. Siç u tha më lart, vendimi përfundimtar në lidhje me rastin e parashtruesit është Vendimi i Gjykatës Supreme (Rev.nr. 204/2008), të 29 gushtit 2011. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 12 dhjetor 2012.

30. Gjykata vëren se konfirmimi i dorëzimit tregon se Vendimi i Gjykatës Supreme (Rev.nr. 204/2008), të 29 gushtit 2011, i ishte dorëzuar avokatit Naim Haliti më 17 tetor 2011.

31. Më 28 mars 2013, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një shkresë Gjykatës, duke theksuar se më 17 tetor 2011 Vendimi i Gjykatës Supreme (Rev.nr.204/2008) i ishte dorëzuar Naim Halitit, i cili nuk ishte përfaqësues i autorizuar ligjor i parashtruesit në procedurën e Gjykatës Supreme, por ai thjesht ishte angazhuar për "*hartimin e revizionit*." Parashtruesi i kërkesës thekson se ky Vendim i Gjykatës Supreme, në fakt, i ishte lënë te dyert e banesës së tij më 23 shtator 2012. Parashtruesi i kërkesës kërkon që data 23 shtator 2012 të konsiderohet si datë e dorëzimit të vendimit përfundimtar në lidhje me këtë rast, dhe prandaj afati prej katër muajve fillon të rrjedhë nga kjo datë.

32. Gjykata vëren se avokati Naim Haliti ishte shënuar në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të 29 gushtit 2011 si përfaqësues i parashtruesit të kërkesës. Për më tepër, Gjykata vëren se avokati i njëjtë ishte shënuar në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të 4 shkurtit 2008 si përfaqësues i parashtruesit të kërkesës dhe ky avokat gjithashtu është shënuar si përfaqësues i parashtruesit në aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 29 qershorit 2005.

33. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se dorëzimi i aktgjykimit të Gjykatës Supreme (Rev.nr. 204/2008), të 29 gushtit 2011, avokatit Naim Haliti, është i bazuar në përfundimin tërësisht të arsyeshëm se ky avokat në fakt, është përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesit të kërkesës. Për më tepër, përveç deklaratës së parashtruesit të kërkesës se Naim Haliti nuk ishte përfaqësuesi i tij i autorizuar, nuk është paraqitur asnjë dëshmi tjetër për ta mbështetur këtë pohim.

34. Si përfundim, Gjykata konstatoi se vendimi përfundimtar në rastin e parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar në mënyrë ligjore më 17 tetor 2011. Kërkesa ishte dorëzuar më 12 dhjetor 2012, që është gati 14 muaj pas datës së dorëzimit të vendimit përfundimtar në rastin e parashtruesit të kërkesës.

35. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit katër mujor të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të Punës, dhe duhet të refuzohet si e paafatshme.

36. Rrjedhimisht, për arsyet e cekura më lart, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 14 qershor 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 11/13, Izahir Troni, datë 20 qershor 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev nr. 34/12, të 8 tetorit 2012

Rasti KI-11/13, Aktvendim për papranueshmëri i 14 majit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, barazia para ligjit, gjuhët, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mbrojtje gjyqësore, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev nr. 34/12, të 8 tetorit 2012, me të cilin ishte zgjidhur kontesti pronësoro-juridik, i krijuar me kërkesën për vërtetim të pronësisë mbi paluajtshmërinë kontestuese në mes të parashtruesit të kërkesës dhe personave të tretë.

Parashtruesi i kërkesës konsideron se me këtë rast i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese nga neni 3 (Barazia para Ligjit), neni 5 (Gjuhët) neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), neni 54 (E Drejta për Mbrojtje Gjyqësore) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 (Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut), për shkak të mosdorëzimit të aktgjykimit në gjuhën e tij amtare, me rastin e përpilimit të aktgjykimit, gjykata e ka përpiluar atë vetëm në gjuhën serbe, e jo edhe në gjuhën shqipe, dhe me këtë i ka shkaktuar vështirësi për ta kuptuar në mënyrë të plotë përmbajtjen e aktgjykimit.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit Izahir Troni, Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se gjykata e shkallës së parë i kishte udhëzuar palët se kanë të drejtë që në gjykim dhe gjatë gjithë procedurës, të shërbehen me gjuhën e tyre zyrtare, por palët janë deklaruar se e njohin gjuhën në të cilën udhëhiqet procedura dhe se nuk kanë nevojë për përkthim, gjë të cilën parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur si bazë për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

Prandaj, parashtruesi i kërkesës ka hequr dorë nga e drejta, së cilës i referohet se i është shkelur, ashtu që kërkesa e tij është qartazi e pabazuar, sepse faktet e paraqitura nuk e arsyetojnë në asnjë mënyrë pretendimin për shkeljen e ndonjë të drejte kushtetuese.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI11/13
Parashtrues
Izahir Troni
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 34/12 të 8 tetorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Izahir Troni nga fshati Kovaçec, komuna e Kaçanikut, i përfaqësuar nga Sabri Kryeziu, avokat nga Lipjani.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.34/12 të 8 tetorit 2012, me anë të cilit është refuzuar revizioni kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtine Ac.nr.845/2010 të 27 janarit 2011, dhe është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. Nr. 1266/2003, i 4 dhjetorit 2009.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes ka të bëjë me të drejtën e pronësisë mbi pronën e paluajtshme të kontestuar, që përfundoi me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.34/12 të 8 tetorit 2012, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur një numër i neneve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 dhe 21. 4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë Ligji) dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së Punës (në tekstin e mëtejmë Rregullorja e punës).

Procedura në gjykatë

5. Më 30 janar 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata)

6. Më 14 maj 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtares Snezhana Botusharova, Kolegji Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

7. Parashtruesi i kërkesës, në Gjykatën Komunale në Prishtinë, ka iniciuar kontest për të drejtat pronësore me palët e treta në lidhje me pronësinë në lidhje me pronën e regjistruar si ngastër kadastrale nr.505/1, nr.505/2 dhe nr.505/3, në vendin e quajtur „Fshat-oborri i shtëpisë", në sipërfaqe prej 0.10,70 ha, e regjistruar në fletëposedimin nr. 22 të ZK të Fushë Kosovës.

8. Më 4 dhjetor 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin C.nr. 1266/2003, në lidhje me këtë rast pronësor, me një arsyetim të detajuar, konstatoi gjendjen faktike si në vijim:

   I. *"**VËRTETOHET** se kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluejtshme është e lidhur përmes të autorizuarit midis paditësit- kundër të padituri Petra Rapaic nga Nëntë Jugoviqët si shitës në njërën anë, dhe Izahir Tronit, i padituri-kundërpaditësi nga Fushë-Kosova si blerës në anën tjetër, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë si Ov. Nr. 712/2001, të 07.01.2001 si i pavlefshëm dhe se nuk prodhon efekt juridik.*

   II. *"**APROVOHET** kërkesë padia e paditësit- kundër të padituri, dhe **vërtetohet** se paditësi- kundëripadituri Mefail Shaqiri nga Prishtina ka fituar të drejtën e pronësisë në bazë të*

*kontratës me shkrim mbi shitblerjen e pasurisë së patundshme të datës 14.11. 1997, në ngastrat kadastrale nr. 505/1 dhe nr. 505/2, në vendin e quajtur „*Fshat-oborri i shtëpisë”, *në sipërfaqe të përgjitshme prej 0.10,70 ha, e regjistruar në fletën poseduese nr. 22 KK Fushë-Kosovë, të cilën i padituri Petar Rapajic është i obliguar të njohë këtë të drejtë, ndërsa i padituri kundërpaditësi Izahir Troni të njohë të drejtën e pronësisë, të lejojë regjistrimin e të drejtës në Librin Kadastral, në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë të Komunës së Prishtinës si dhe pronën e kontestuar t'ia dorëzojë paditësit-kundër të padituritMefail Shaqiri në afat prej 15 ditëve nga data e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.“*

III. *“* ***REFUZOHET*** *kërkesë padia e të padituritkundërpaditësit Izahir Troni nga Fushë-Kosova si e* ***pabazuar****, me të cilën ka kërkuar që Gjykata të vërtetojë se kontrata me shkrim e datës 28.10.1999, e lidur midis Petar Rapajicit si shitës në njërën anë dhe Nexhmi Begollit nga Prishtina, si blerës nga ana tjetër, mbi shitblerjen e ngastrave kadastrale nr. 505/1, nr. 505/2 dhe nr. 505/3 KK Fushë-Kosovë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.16,74 ha, me çmim të kontraktuar të shitblerjes në vlerë prej 80.000 DM që si e tillë nuk prodhon efekt juridik.“*

IV. *“* ***REFUZOHET*** *kërkesë padia e të padituritkundërpaditësit Izahir Troni nga Fushë-Kosova si e* ***pabazuar****, me të cilën ka kërkuar që Gjykata të vërtetojë se kontrata me shkrim e datës 28.12.2001, e lidhur midis Nexhmi Begollit, si shitës dhe Izahir Tronit nga Kovaqica, komuna e Kaçanikut, mbi shitblerjen e ngastrave kadastrale nr. 505/1, nr. 505/2 dhe nr. 505/3 KK Fushë-Kosovë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.16,74 ha, me çmim të kontraktuar të shitblerjes në vlerë prej 315.000 DM, dhe se kontrata prodhon efekt juridik të plotë midis palëve kontraktuese, në bazë të së cilës i padituri- kundërpaditësi Izair Troni është pronar ligjor i këtyre ngastrave.“*

9. Më 27 janar 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin AC. nr. 845/2010 refuzoi në tërësi ankesën e të padituritkundërpaditësit Izahir Troni, dhe vërtetoi Aktgjykimin e përmendur të Gjykatës së shkallës së parë, duke mbështetur si të drejta të gjitha gjetjet faktike dhe juridike të Gjykatës së shkallës së parë.

10. I padituri/kundërpaditësi Izahir Troni parashtroi revizion për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me ç'rast propozon që

revizioni i tij të konfirmohet si i bazuar, dhe që aktgjykimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta të ndryshohen, duke konfirmuar kështu kundërpadinë e tij si të bazuar, ose që të njëjtat aktgjykime të anulohen dhe lënda të kthehet për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

11. Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin rev.nr.34/12 të 8 tetorit 2012, me ç'rast refuzoi revizionin si të pabazuar, me arsyetim të detajuar për secilën gjetje në Aktgjykim, me ç'rast paraqet arsyetimet e mëposhtme, në mes tjerash:

"...Nuk qëndrojnë si të bazuara pretendimet e revizionit se me aktgjykimet e instancës më të ultë, palëve në procedurë u është cenuar e drejta e përdorimit të shkrimit dhe gjuhës së tyre zyrtare. Pasi që nga procesverbali i seancës kryesore, të datës 04.10.2007, konstatohet se Gjykata e shkallës së parë ka udhëzuar palët që kanë të drejtë që në gjykim dhe gjatë gjithë procedurës, të shërbehen me gjuhën e tyre zyrtare, por palët janë deklaruar se e njohin gjuhën në të cilën udhëhiqet procedura dhe se nuk iu është i nevojshëm përkthimi, nga kjo rezulton se aktgjykimet e lartpërmendura nuk janë përfshirë në këtë shkelje thelbësore të procedurës, të parashikuar në nenin 182.2, pika (k) të LPK."

Pretendimet e parashtruesit

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelu Neni 3 (Barazia para Ligjit) i Kushtetutës, si në vijim:

"Me veprimet e Gjykatës Komunale në Prishtinë, të vërtetuara me vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, dhe përfundimisht edhe me vendimin e gjykatës së revizionit – Gjykatës Supreme të Kosovës, është shkelur neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse Gjykata Komunale në Prishtinë dhe dy instancat tjera gjyqësore pa ndonjë arsyetim të qëndrueshëm e kanë refuzuar kërkesën e kundërpadisë, duke mohuar dhe shkelur shtyllat kryesore në të cilat ndërtohet marrëdhënia juridiko civile (ndershmëria dhe ndërgjegjshmëria), duke u shkelur institucioni juridik i të drejtës sendore posedimi, duke u shkelur instituti juridik i bazës më të fortë juridike, dhe përfundimisht, duke u shkelur e drejta e pronësisë."

13. Parashtruesi më tej konsideron se është shkelur Neni 5 (Gjuhët) i Kushtetutës, si në vijim:

"Në veprimet procedurale të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, e që nuk janë eliminuar dhe nuk janë vlerësuar nga gjykata e revizionit, është shkelur edhe neni 5 i Kushtetutës. Në seancën kryesore të datës 04.12.2009, shqyrtimi është mbajtur m prezencën e përkthyeses gjyqësore për të pasur mundësi që palët të përdorin gjuhën e vet amtare, për t'u shprehur lirshëm dhe për të mos pasur mundësi që në mungesë të mosnjohjes së gjuhës t'u bëhet ndonjë shkelje e të drejtave procedurale dhe të drejtave materiale."

"Në këtë drejtim, gjykata e ka zbatuar edhe dispozitën ligjore rrjedhimisht *edhe dispozitën kushtetuese, mirëpo në përpilimin e aktgjykimit nuk ka vepruar njëjtë, sepse aktgjykimin e ka përpiluar vetëm në gjuhën serbe e jo edhe në gjuhën shqipe, kur rrjedhimisht është shkaktuar vështirësi për ta kuptuar në mënyrë të plotë përmbajtjen e aktgjykimit. Për shkak të kësaj rrethane, i padituri Izahir Troni në seancën kryesore të mbajtur më 04.12.2009, ka kërkuar që procedura të zhvillohet me ndihmën e përkthyeses, ashtu siç ishte vendosur nga gjykata, mirëpo, nuk është vepruar ngjashëm kur është përpiluar aktgjykimi, dhe si rrjedhojë kjo shkelje është theksuar edhe në ankesë, ku edhe Gjykata e Qarkut në Prishtinë, palëve ua dorëzon aktgjykimin vetëm në gjuhën serbe. Ndërsa kjo shkelje është theksuar edhe në revizion, ku Gjykata Supreme, në vend që ta vërtetojë shkeljen e kësaj natyre të përdorimit të gjuhës dhe shkresave në gjuhën amtare të palës, ajo në arsyetimin e vet në faqen 4 të kryerreshtit të 4 të vendimit të vet deklarohet se gjykata i ka pyetur palët në lidhje me përdorimin e gjuhës së vet amtare dhe palët janë deklaruar se nuk kanë nevojë për përkthyes. Këto janë veprime të pa analizuara dhe të pa mbështetura në prova dhe me veprimet e të gjitha gjykatave është shkelur dispozita e nenit 5 dhe dispozitave nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës."*

14. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, rrjedhimisht janë bërë shkelje të dispozitave të Nenit 31 (E Drejta Për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) dhe Nenit 54 (E drejta për Mbrojte Gjyqësore) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe shkelje të Nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

"... për faktin se të padituri-kundërpaditësit Izahir Troni, me mosdorëzimin e aktgjykimi në gjuhën e tij amtare, dhe me mosdorëzimin e revizionit Prokurorit të Shtetit për tu deklaruar në lidhje me kërkesën për mbrojte të ligjshmërisë, vendosjen nga

Gjykata Supreme pa prova- argumente se revizioni i është dorëzuar Prokurorit Shtetëror, të vendosur sipas një gjykimi të padrejtë dhe është vendosur duke shkelur parimin e barazisë midis palëve në procedurë."

15. Parashtruesit e kërkesës i drejtohen Gjykatës Kushtetuese me kërkesën në vijim:

"Në bazë të shkeljeve procedurale, materiale dhe kushtetuese të kryera ndaj të paditurit- kundërpaditësit Izahir Troni, nga Gjykata Kushtetuese kërkojmë që të ***anulojë*** *aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Rev.nr.34/2012 të datës 08.10.2012, dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr. 845/2010 të datës 27.10.2011, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C. Nr. 1266/03 të datës 04.12.2009, dhe çështja të kthehet në rigjykim në Gjykatën Komunale në Prishtinë".*

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës thekson se bazë për Kërkesën e tij është neni 3 (Barazia para Ligjit), neni 5 (Gjuhët), neni 31 (E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), neni 54 (E drejta për Mbrojtje Gjyqësore) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

17. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.

18. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], bnr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

19. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99 të 31 majit 2005).

Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se në çfarë mënyre nenet 3, 5, 31, 54 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ mbështesin kërkesën e tij, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat e tij janë shkelur nga përcaktimi i gabuar i fakteve dhe zbatimi i gabuar i ligjit nga gjykatat e rregullta, duke pohuar se gjykata *„duke mos ia dorëzuar Aktgjykimin në gjuhën e tij amtare*“, ka shkelur Nenin 5 (Gjuhët) të Kushtetutës.

21. Nga shkresat e lëndës shihet qartë se Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin rev. nr.34/12 të 8 tetorit 2012, ka refuzuar revizionin si të pabazuar, duke arsyetuar hollësisht Gjykata *„konstaton se Gjykata e shkallës së parë ka udhëzuar palët që kanë të drejtë që në gjykim dhe gjatë gjithë procedurës, të shërbehen me gjuhën e tyre zyrtare, por palët janë deklaruar se e njohin gjuhën në të cilën udhëhiqet procedura dhe se nuk iu është i nevojshëm përkthimi”,* gjë të cilën parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur si bazë për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

22. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë dhënë mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit të cilin e konsideron se është i pasaktë, para Gjykatës Komunale në Prishtinë, Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe Gjykatës Supreme. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat përkatëse, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis,* Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ për pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06 të 30 qershorit 2009).

23. Së fundi, kriteret për pranueshmëri nuk janë plotësuar në këtë kërkesë. Parashtruesi nuk ka arritur të paraqesë dhe të mbështesë me dëshmi se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.

24. Nga kjo rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, e cila parasheh se *„Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi e pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.”*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me Nenin 113.7 të Kushtetutës, me Nenin 48 të Ligjit, dhe me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 7 qershor 2013, njëzëri

VENDOSI

I. **TA HEDHË POSHTË** kërkesën si të papranueshme;

II. T'ua komunikojë vendimin palëve dhe ta publikojë vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 98/12 , Ruzhdi Shala, datë 02 korrik 2013- Kërkesë kushtetuese kundër zvarritjes dhe jo efikasitetit të procedurës hetimore PPN nr.812-1/2008 nga Prokuroria e Qarkut në Prishtinë.

Rasti KI 98/12, Aktvendim për papranueshmëri i 29 prill 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë Individuale, qartazi të pabazuar, refuzim i mbajtjes së seancës dëgjimore

Parashtruesi pretendon që si babai i vajzës së vdekur, është person i autorizuar që të parashtrojë Kërkesën në këtë Gjykatë, si dhe citon praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së për ta mbështetur pretendimin e tij.

Parashtruesi pretendon se katër vite hetime kanë kaluar pa ndonjë provë të veprimit substancial nga Prokuroria, për të identifikuar ndonjë të dyshuar që ka kryer vrasjen, për të ngritur aktakuzë apo për ta pezulluar atë, apo për të mbyllur rastin tërësisht.

Parashtruesi pretendon që ka marrë një "raport informativ" të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për Prokurorin e Qarkut në Prishtinë, nga i cili: "nuk mund të nxirret asnjë informatë përkitazi me vdekjen e vajzës së tij".

Parashtruesi pretendon që Prokuroria i ka privuar të drejtat e tij për të pasur qasje, si i afërm i drejtpërdrejtë i personit të vdekur, në dosjen e hetimeve të Prokurorisë. Parashtruesi pretendon që të drejtat e përmendura i sigurohen atij, si palë e dëmtuar, me nenin 143 [Shikimi i dosjeve] të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPPK), si dhe nenin 40 [Dëgjimet publike dhe qasja në dokumente] të Konventës.

Parashtruesi kërkon mbajtjen e seancës dëgjimore në pajtim me Rregullin 39 të Rregullores së Punës;

Gjykata konsideron se në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Parashtruesi, si prind i vajzës së vdekur është viktimë indirekte dhe kështu është person i autorizuar për të parashtruar kërkesë në këtë Gjykatë. (Shih rastin Gakiyev dhe Gakiyeva kundër Rusisë, Kërkesa nr. 3179/05, Aktgjykimi i 6 nëntorit 2009).

Sa i përket pretendimit të Parashtruesit për shkeljen e nenit 1 [Obligimi për respektimin e të drejtave të njeriut], nenit 2 [E drejta për jetë] në ndërlidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës, përkitazi me zvarritjen e procedurave hetimore nga autoritetet publike të Kosovës, Gjykata thekson që në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Shteti ka obligim

qenësor dhe procedural që të mbrojë jetën e të gjithë personave nën juridiksionin e tij, që nënkupton se e drejta për jetë duhet mbrojtur me ligj si obligim qenësor në njërën anë, si dhe me zhvillimin e një hetimi adekuat si kërkesë procedurale, në anën tjetër.

Gjykata thekson se në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ekzistojnë disa elemente që sigurojnë "qëllimin thelbësor" të hetimit, përkatësisht: i) obligimi i autoriteteve publike për të filluar hetimin pas njoftimit me rastin, pavarësisht nga ankesa formale e parashtruar nga i afërmi, ii) pavarësia dhe paanësia, në ligj dhe në praktikë, e personave që janë përgjegjës për hetimin, iii) hetimi duhet të jetë adekuat në kuptimin që duhet të çojë drejt një vendimi mbi shkaqet dhe rrethanat e vdekjes, [...] si dhe 'zbulimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës'.

Rrjedh që kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hedhet poshtë si e papranueshme si dhe kërkesa e Parashtruesit për mbajtje të seancës dëgjimore hedhet poshtë si e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI98/12
Parashtruesi
Ruzhdi Shala
Kërkesë kushtetuese kundër zvarritjes dhe jo efikasitetit të procedurës hetimore PPN nr.812-1/2008 nga Prokuroria e Qarkut në Prishtinë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtruesi është Ruzhdi Shala, përfaqësuar nga firma ligjore "Sejdiu & Qerkini" SHPK, me seli në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston zvarritjen e procedurës hetimore PPN no. 812-1/2008 nga Prokurori i Qarkut në Prishtinë.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së Kërkesës është ankesa e Parashtruesit, se Prokurori i Qarkut në Prishtinë nuk i ka përmbyllur për katër vjet hetimet përkitazi me vrasjen e vajzës së tij.

4. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të mbajë seancë dëgjimore në pajtim me Rregullin 39 të Rregullores së Punës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; nenin 20 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe Rregullin 56.2 të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 15 tetor 2012, Parashtruesi parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 5 nëntor 2012, Kryetari emëroi Gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar Raportues, si dhe Kolegjin Shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

8. Më 13 nëntor 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Prokurorinë e Qarkut, si dhe Kryeprokurorin e Shtetit të Kosovës për regjistrimin e Kërkesës.

9. Më 7 dhjetor 2012, Kryeprokurori i Shtetit parashtroi përgjigjet në Gjykatë përkitazi me Kërkesën.

10. Më 17 dhjetor 2012, Prokuroria e Qarkut në Prishtinë parashtroi përgjigjet në Gjykatë përkitazi me Kërkesën.

11. Më 24 dhjetor 2012, Parashtruesi i shkroi Gjykatës duke shprehur interesimin për statusin e kërkesës dhe kërkoi që Gjykata të mbajë seancë dëgjimore në pajtim me Rregullin 39 të Rregullores së Punës.

12. Më 28 dhjetor 2012, Gjykata iu përgjigj pyetjeve të parashtruesit.

13. Më 29 prill 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve të evidencuara sipas dokumenteve të parashtruara nga Parashtruesi

14. Në ose rreth mesnatës së 1 dhjetorit 2008, vajza e Parashtruesit, M.Sh. tragjikisht u privua nga jeta prej personave ende të panjohur për prokurorinë. Vajza e Parashtruesit ishte në veturë me katër persona të tjerë, në kohën kur po shtihej me armë. Ajo u qëllua, por katër personat tjerë në veturë mbetën të padëmtuar.

15. Vajza e Parashtruesit u dërgua me shpejtësi në Njësinë e Emergjencës së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, ku ndërroi jetë. Raporti mjekësor vërtetoi që ajo ishte vrarë me armë zjarri.

16. Më 2 dhjetor 2010, Parashtruesi u ankua tek Inspektorati Policor i Kosovës, për të kuptuar më shumë rreth vdekjes së vajzës së tij.

17. Më 6 janar 2011, Parashtruesi ngriti shqetësimin e tij në Qendrën për Këshillim Juridik dhe Zhvillim Rajonal (në tekstin e mëtejmë: CLARD).

18. Më 20 janar 2011, Parashtruesi paraqiti kërkesë tek Prokurori i EULEX-it për të shprehur dyshimet e tij për hetimin e vdekjes së vajzës së tij, si dhe për t'i kërkuar Prokurorit të EULEX-it që të marrë rastin përsipër.

19. Më 28 janar 2011, Parashtruesi paraqiti kërkesë në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë, përkitazi rreth hetimeve për vdekjes së vajzës së tij.

20. Më 17 tetor 2011, parashtruesi informoi Avokatin e Popullit për rastin e tij.

21. Më 24 nëntor 2011, Parashtruesi u informua që rasti i vajzës së tij i ishte caktuar Prokurorit Publik në Prishtinë.

22. Më 19 maj 2012 dhe 9 korrik 2012, Parashtruesi, bashkë me CLARD-in, kërkoi nga Prokurori i Qarkut në Prishtinë kopjet e shkresave të rastit, në bazë të të drejtave të palës së dëmtuar, të përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, Konventën Evropiane për të Drejta të njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa), si dhe instrumentet tjera ligjore ndërkombëtare të zbatueshme në Kosovë.

23. Parashtruesi u takua me kreun e Këshillit Prokurorial të Kosovës, me Presidenten e Republikës së Kosovës, për të shpjeguar rastin e tij, gjithashtu ka provuar të kontaktojë me Kryeministrin e Republikës së Kosovës si dhe Kryetarin e Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it.

24. Më 17 dhjetor 2012, Prokurori i Qarkut në Prishtinë iu përgjigj Gjykatës përkitazi me Kërkesën, duke shpjeguar masat e ndërmarra nga Prokuroria, përfshirë masat e fshehta teknike, mungesën e provave dhe dyshimit të arsyeshëm që personat e dyshuar kanë kryer krimin, intervistimin e dëshmitarëve, e kështu me radhë. Prokuroria gjithashtu ka informuar që kanë kontaktuar me Parashtruesin disa herë, si dhe janë në pritje të rezultateve të masave të fshehta teknike për të vepruar në bazë të provave të mbledhura.

Pretendimet e Parashtruesit

25. Parashtruesi pretendon që si babai i vajzës së vdekur, është person i autorizuar që të parashtrojë Kërkesën në këtë Gjykatë, si dhe citon praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së për ta mbështetur pretendimin e tij.

26. Parashtruesi pretendon se katër vite hetime kanë kaluar pa ndonjë provë të veprimit substancial nga Prokuroria, për të identifikuar ndonjë të dyshuar që ka kryer vrasjen, për të ngritur aktakuzë apo për ta pezulluar atë, apo për të mbyllur rastin tërësisht.

27. Parashtruesi pretendon që ka marrë një "raport informativ" të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për Prokurorin e Qarkut në Prishtinë, nga i cili: *"nuk mund të nxirret asnjë informatë përkitazi me vdekjen e vajzës së tij"*.

28. Parashtruesi pretendon që Prokuroria i ka privuar të drejtat e tij për të pasur qasje, si i afërm i drejtpërdrejtë i personit të vdekur, në dosjen e hetimeve të Prokurorisë. Parashtruesi pretendon që të drejtat e përmendura i sigurohen atij, si palë e dëmtuar, me nenin 143 [Shikimi i dosjeve] të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPPK), si dhe nenin 40 [Dëgjimet publike dhe qasja në dokumente] të Konventës.

29. Parashtruesi, me respekt, kërkon nga Gjykata që:

- Kërkesën e tij të konstatohet si e pranueshme;
- Të urdhërojë një seancë dëgjimore në pajtim me Rregullin 39 të Rregullores së Punës;
- Të konstatojë që ekziston shkelja në lidhje me jo efikasitetin e procedurës hetimore dhe të të drejtave individuale të Parashtruesit, të garantuara me nenin 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave] të Kushtetutës, neni 7 [Barazia para ligjit] të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, si dhe nenin 1 [Obligimi për respektimin e të drejtave të njeriut], nenin 2 [E drejta për jetë] dhe nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës;dhe

- Të përcaktojë të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve të përmendura në këtë Kërkesë që kjo Gjykatë i konsideron të arsyeshme dhe juridikisht të bazuara.

Ligji

KPPPK, KAPITULLI XVI: SHIKIMI I SHKRESAVE

Neni 143

(1) I dëmtuari dhe përfaqësuesit e tij ligjorë ose përfaqësuesi i autorizuar kanë të drejtë të shikojnë, kopjojnë ose fotografojnë shkresat dhe provat materiale që i disponon gjykata ose prokurori publik nëse legjitimohet interesi i tij.

(2) Gjykata ose prokurori publik mund të refuzojnë lejimin e shikimit, të kopjimit ose të fotokopjimit të shkresave ose provave materiale nëse interesi legjitim i të pandehurit dhe i personave të tjerë kalon interesin e të dëmtuarit, ose nëse ka gjasa reale që shikimi mund të rrezikojë qëllimin e hetimit a jetën dhe shëndetin e njerëzve apo do të zvarriste në mënyrë të konsiderueshme procedurën dhe nëse i dëmtuari ende nuk është pyetur si dëshmitar.

Ligji nr. 03/L –225 PËR PROKURORINË E SHTETIT

Neni 10

Marrëdhëniet me publikun

1. Prokurori i Shtetit i ofron publikut rregullisht informacione lidhur me veprimtaritë e saj.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, Prokurori i Shtetit nuk ofron asnjë informatë qoftë drejtpërdrejtë apo tërthorazi që do të zbulonte sekretet zyrtare, do të rrezikonte një hetim apo procedurë penale në zhvillim e sipër , do të dëmtonte integritetin, dinjitetin, sigurinë dhe të drejtat mbi privatësinë e cilitdo person, apo që do të shkelte të drejtat e të miturve.

Vlerësimi i pranueshmërisë

30. Gjykata Kushtetuese, për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës

31. Gjykata i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës:

> *"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

32. Gjykata konsideron se në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Parashtruesi, si prind i vajzës së vdekur është viktimë indirekte dhe kështu është person i autorizuar për të parashtruar kërkesë në këtë Gjykatë. *(Shih rastin Gakiyev dhe Gakiyeva kundër Rusisë, Kërkesa nr. 3179/05, Aktgjykimi i 6 nëntorit 2009).*

33. Sa i përket pretendimit të Parashtruesit për shkeljen e nenit 1 [Obligimi për respektimin e të drejtave të njeriut], nenit 2 [E drejta për jetë] në ndërlidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës, përkitazi me zvarritjen e procedurave hetimore nga autoritetet publike të Kosovës, Gjykata thekson që në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Shteti ka obligim qenësor dhe procedural që të mbrojë jetën e të gjithë personave nën juridiksionin e tij, që nënkupton se e drejta për jetë duhet mbrojtur me ligj si obligim qenësor në njërën anë, si dhe me zhvillimin e një hetimi adekuat si kërkesë procedurale, në anën tjetër.

34. Gjykata thekson se në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ekzistojnë disa elemente që sigurojnë "qëllimin thelbësor" të hetimit, përkatësisht: i) obligimi i autoriteteve publike për të filluar hetimin pas njoftimit me rastin, pavarësisht nga ankesa formale e parashtruar nga i afërmi, ii) pavarësia dhe paanësia, në ligj dhe në praktikë, e personave që janë përgjegjës për hetimin, iii) hetimi duhet të jetë adekuat në kuptimin që duhet të çojë drejt një vendimi mbi shkaqet dhe rrethanat e vdekjes, [...] si dhe 'zbulimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës'.

35. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në bazë të dokumenteve të përmbajtura në Kërkesë: i) autoritetet shtetërore në fakt kanë marrë masa të arsyeshme hetimore pasi janë njoftuar me rastin, ii) nuk ka prova apo shenja të shkeljes së pavarësisë e as paanësisë së personave të

përfshirë në hetim; iii) hetimi ende është në zhvillim e sipër dhe nuk është përmbyllur, por kjo nuk do të thotë që hetimi është joadekuat, pasi që hetimi është obligim që të ndërmerren hapat e duhur dhe nuk përbën një obligim për të arritur një rezultat të caktuar.

36. Gjykata vëren që në rastin konkret, Parashtruesi nuk ka fajësuar autoritetet publike të Kosovës për vdekjen e vajzës së tij; e as nuk është sugjeruar që autoritetet kanë ditur apo është dashur të dinë që jeta e vajzës së Parashtruesit ka qenë në rrezik nga palë të treta, si dhe që kanë dështuar të ndërmarrin masat e duhura për të mbrojtur vajzën e Parashtruesit nga ai rrezik. *(Shih GJEDNJ, Vendimi mbi Pranueshmërinë e Kërkesës nr. 47916/99, Menson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, i 6 majit 2003)*. Pra, rasti i Parashtruesit duhet dalluar nga rastet që kanë të bëjnë me përdorimin e supozuar të forcës vdekjeprurëse nga agjentët shtetëror ose nga palët private në bashkëpunim kriminal me agjentët shtetëror. *(shih, për shembull, McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, aktgjykim i 27 shtatorit 1995, Seria A nr. 324; Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 24746/94, aktgjykim i 4 majit 2001, ECHR 2001-III (ekstrakte); Shanaghan kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 37715/97, aktgjykim i 4 majit 2001, KEDNJ 2001-III (ekstrakte)*

37. Gjykata i referohet parimeve të përgjithshme të zbatuara nga GJEDNJ-ja përkitazi me hetimet, që në radhë të parë shtjellon se mungesa e konkluzioneve në cilindo hetim, nuk do të thotë hetimi si i tillë ka qenë joefektiv: obligimi për të hetuar "është obligim që të ndërmerren hapat e duhur dhe nuk përbën obligim për të arritur një rezultat të caktuar ." *(shih Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 46477/99, § 71, ECHR 2002 – II).*

38. Në rastin konkret, nga dokumentet e parashtruara me Kërkesë, Gjykata vëren që hetimet janë ende në zhvillim e sipër, dhe se aktualisht, Prokuroria nuk ka mbledhur prova të mjaftueshme për të ngritur aktakuzën ndaj të dyshuarve të mundshëm.

39. Gjykata vëren që në bazë të ligjit të zbatueshëm në Kosovë, qasja në dosjen hetimore, është diskrecion Prokurorit për qëllime të vetë hetimit, si dhe për mbrojtjen e secilit që është përfshirë në procesin e përmendur.

40. Gjykata u informua nga Prokuroria që parashtruesi ishte kontaktuar disa herë nga ana e tyre, me ç'rast janë marrë në pyetje disa dëshmitarë duke u bazuar në iniciativën dhe propozimin e tij; dhe që parashtruesi

gjithashtu është njoftuar përkitazi me masat e ndërmarra nga Prokuroria dhe me statusin e hetimeve.

41. Gjykata vëren se zhvillimi i procedurës hetimore, duke përfshirë përfundimin apo pushimin e saj, përveç mbrojtjes së dosjes hetimore, është diskrecion dhe prerogativë e Prokurorit, që i është akorduar me ligjin e zbatueshëm në Kosovë, kështu që çdo ndërhyrje nga Gjykata në diskrecionin e Prokurorit përbën cenim të autonomisë së tij.

42. Për më tepër, Zyra e Prokurorit Publik të Qarkut ka informuar Gjykatën mbi statusin e hetimeve dhe se Prokuroria do të veprojë në bazën e provave të mbledhura.

43. Rrjedh që kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

44. Sa i përket kërkesës së Parashtruesit për të mbajtur seancë dëgjimore, Gjykata i referohet nenit 20 të Ligjit:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.*
>
> *2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës".*

45. Gjykata konsideron që dokumentet e përfshira në Kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur këtë rast, sipas formulimit të paragrafit 2 të nenit 20 të Ligjit.

46. Prandaj, kërkesa e Parashtruesit për mbajtje të seancës dëgjimore hedhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe nenit 20 të Ligjit si dhe në pajtim me rregullin 36 (1) c të Rregullores së punës, më 17 qershor 2013, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për mbajtje të seancës dëgjimore;

III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve, dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Prof. Dr. Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 109/12, Kumrije Maloku dhe të tjerë, datë 02 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 466/2009, të 7 qershorit 2012.

Rasti KI 109/12, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 majit 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë Individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesit pretendojnë se Gjykata e Qarkut, në ankesën e dytë, dhe Gjykata Supreme, në revizion, i kishin shkelur të drejtat e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohen me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6, para. 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Si pasojë e interpretimit të gjykatave, parashtruesit pohojnë se kolegji civil që gjykoi rastin e tyre nuk ishte as i pavarur e as i paanshëm. Parashtruesit thonë se ata kanë të drejtë kompensimi për vdekjen e anëtarit të familjes së tyre.

Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese që të bëjë një vlerësim të saktë të përgjegjësisë së Kompanisë Publike Komunale për Sport dhe Marketing dhe të eliminojë shkeljet e pretenduara të së drejtës materiale nga Gjykata e Qarkut dhe nga Gjykata Supreme. Parashtruesit kërkojnë që t'u njihet e drejta e kompensimit për vuajtjet e tyre shpirtërore.

Gjykata konsideron se nuk ka prova që do të tregonin se gjykatave që e kanë shqyrtuar rastin u ka munguar paanshmëria apo që procedurat në ndonjë mënyrë kanë qenë të padrejta.

Prandaj, Gjykata Kushtetuese gjen se pretendimet e parashtruesve të kërkesës nuk janë mbështetur me prova dhe se ato duhet të refuzohen si të pabazuara.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI109/12
Parashtrues
Kumrije Maloku dhe të tjerët
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 466/2009, të 7 qershorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Kumrije Maloku dhe Aida, Edina, Idriz, Remzije, Muhamet, Shaip, Ajete e Myrvete Maloku, të përfaqësuar nga Vahide Braha, avokate.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 466/2009, të 7 qershorit 2012, i cili u është dorëzuar më 2 gusht 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit pretendojnë se Aktgjykimi, me të cilin u është refuzuar kërkesa për revizion kundër Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (AC. nr. 281/2008, të 23 qershorit 2009), i ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, respektivisht me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenet: 47, 48 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-121), të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullat: 28, 29 dhe 30 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 1 nëntor 2012, parashtruesit parashtruan kërkesë në Gjykatë.

6. Më 14 dhjetor 2012, Gjykata Kushtetuese i informoi parashtruesit, Gjykatën Supreme dhe Gjykatën Komunale në Prishtinë, për regjistrimin e kërkesës.

7. Më 6 dhjetor 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

8. Më 12 shkurt 2013, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesit që ta informojnë për datën në të cilën Gjykata Supreme ua dorëzoi Aktgjykimin Rev. nr. 466/2009.

9. Më 20 shkurt 2013, parashtruesit e informuan Gjykatën se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 466/2009, i 7 qershorit 2012, u është dorëzuar më 2 gusht 2012.

10. Më 13 maj 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 29 gusht 2001, rreth orës 18:20 në mbrëmje, Hakif Hoti, dhëndri i tij, Dalip Maloku, dhe një shok, Islam Musliu, ishin duke u kthyer për në Prishtinë nga një shëtitje në Parkun e Gërmisë. Duke kaluar afër pishinës së hapur "Gërmia", thuhet se Dalip Maloku kishte shprehur interesim për ta parë pishinën nga afër.

12. Në këtë kohë të ditës, pishina ishte e mbyllur. Pishina ishte e rrethuar me rrethojë të mbyllur dhe ruhej nga personeli i "Balkan International Security, SHPK". Dalip Maloku e kishte njohur njërin nga rojtarët dhe

kishte kërkuar nga ai që ta lejojë të afrohet te pishina, kinse "vetëm për ta shikuar". Rojtari e lejoi Dalip Malokun dhe shoqëruesit e tij të hyjnë.

13. Me atë rast, pa kërkuar leje, Dalip Maloku i hoqi rrobat e tij, hyri në ujë dhe filloi të notojë. Pas notimit në një distancë të caktuar, thuhet se Dalip Maloku i kishte ngritur duart dhe kishte kërkuar ndihmë. Si duket, as shoqëruesit e tij dhe as rojtarët e "Balkan International Security" nuk kishin ditur not. Asnjëri prej tyre nuk hyri në ujë për ta ndihmuar Dalip Malokun.

14. Policia e Kosovës dhe KFOR-i u alarmuan dhe arritën në vendin e ngjarjes. Rreth orës 19:45, një zhytës arriti ta nxjerrë trupin e Dalip Malokut nga fundi i pishinës. Më 30 gusht 2001, me autopsi u konstatua se Dalip Maloku kishte vdekur si pasojë e mbytjes.

15. Dalip Maloku la pas vetes bashkëshorten, Kumrije Hoti-Maloku, dhe dy fëmijët e mitur: Aida dhe Edina Maloku. Dalipi ishte i biri i Idriz dhe Remzije Malokut dhe vëlla i Muhametit, i Shaipit, i Ajetes dhe i Myrvete Malokut. Këta nëntë persona janë parashtrues të kësaj kërkese. Të gjithë parashtruesit vareshin nga të ardhurat e të ndjerit Dalip Maloku.

16. Më 28 janar 2003, parashtruesit paraqitën kërkesëpadi për kompensimin e dëmeve materiale dhe jomateriale në Gjykatën Komunale në Prishtinë, në pajtim me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD). Të paditur në kërkesëpadi ishin: Drejtoria për Sport dhe Marketing e Komunës së Prishtinës dhe "Balkan International Security, SHPK". E paditura, Drejtoria për Sport dhe Marketing, u identifikua më vonë në aktgjykimet e gjykatave si Kompania Publike Komunale për Sport dhe Marketing. Kjo kompani publike komunale ishte autoritet përgjegjës i pishinës "Gërmia" dhe e kishte kontraktuar sipas ligjit kompaninë "Balkan International" që të ofrojë siguri për këto objekte. Parashtruesit pretenduan se të padituri ishin përgjegjës që të ofrojnë siguri në pishinë dhe se neglizhenca e tyre e shkaktoi vdekjen e Dalip Malokut.

17. Më 27 shtator 2005, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin C. nr. 67/03. Gjykata Komunale gjeti se e paditura, Kompania Publike Komunale për Sport dhe Marketing, objektivisht ishte përgjegjëse për "objektin e rrezikshëm", që do të thotë për pishinën, sipas nenit 173 të LMD-së. Me rastin e caktimit të kompensimit, Gjykata mori parasysh veprimet e të ndjerit për hyrje në pishinë pa leje, të cilën Gjykata e karakterizoi si "mashtrim". Gjykata e

urdhëroi të paditurën, Kompaninë Publike Komunale për Sport dhe Marketing, të paguajë 600 euro për shpenzime të varrimit, si dhe 541 euro kompensim për shpenzime të gjykatës. Për më tepër, Gjykata caktoi edhe kompensim për dëmet jomateriale në shumën 5.000 euro, për dhimbje shpirtërore të gruas, të dy fëmijëve të mitur dhe të nënës së të ndjerit. Gjykata i refuzoi kërkesat e mëtejme për shuma më të larta, si dhe kërkesat për kompensim të parashtruesve të tjerë. Si duket, parashtruesit kishin hequr dorë nga kërkesa e tyre kundër të paditurës së dytë, kompanisë "Balkan International Security".

18. Parashtruesit ushtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, duke kërkuar miratimin e shumës së plotë të kërkesës fillestare dhe miratimin e kërkesave të parashtruesve të tjerë. E paditura, Kompania Publike Komunale për Sport dhe Marketing, gjithashtu ushtroi ankesë, duke kërkuar që të gjitha kërkesat e parashtruesve të refuzohen si të pabazuara, ose që rasti të kthehet në Gjykatën Komunale për rigjykim. Të dy ankesat u trajtuan bashkë nga Gjykata e Qarkut.

19. Më 6 qershor 2006, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Ac. nr. 41/2006) e prishi aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe e ktheu rastin në rigjykim. Gjykata e Qarkut gjeti se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ishte mjaftueshëm i qartë dhe i mungonte arsyetimi adekuat për konkluzionet e tij. Gjykata e Qarkut gjithashtu kishte konstatuar se aktgjykimi i shkallës së parë ishte kontradiktor, si në vlerësimin e lartësisë së kompensimit që do të jepej, në numrin e kërkesëpadive që do të miratoheshin, ashtu edhe në konstatimin e përgjegjësisë së të paditurës. Gjykata Komunale ishte urdhëruar t'i vlerësonte të gjitha provat e parashtruara nga palët, si dhe:

> *"[...] të bëjë konstatim të drejtë të gjendjes faktike sa i përket vlerësimit të përgjegjësisë së të paditurës për shkaktimin e dëmit dhe në pajtim me vërtetimin dhe vlerësimin e të gjitha kritereve si dhe me zbatimin e drejtë të dispozitave materiale do të gjykojë lidhur me kërkesëpadinë e paditësve".*

20. Më 29 maj 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë (C. nr. 1191/06) nxori aktgjykim në procedurën e rigjykimit. Gjykata Komunale gjeti se e paditura, Kompania Publike Komunale për Sport dhe Marketing, ishte objektivisht përgjegjëse si poseduese e "objektit të rrezikshëm", sipas nenit 173 të LMD-së. Për më tepër, Gjykata urdhëroi kompaninë e paditur t'i paguajë 900 euro për shpenzimet e varrimit si dhe 793 euro për shpenzime të procedurës. Gjykata e kishte rritur çmimin për kompensim jomaterial ndaj parashtruesve në 13.000 euro, duke

përfshirë kompensimin për parashtruesit e përjashtuar më herët. Gjykata Komunale i refuzoi si të pabazuara argumentet e të paditurës se ajo duhet të lirohet nga përgjegjësia.

21. Që të dy palët, edhe parashtruesit e edhe e paditura, Kompania Publike Komunale për Sport dhe Marketing, ushtruan ankesa kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Parashtruesit kërkuan nga Gjykata e Apelit që ta rritë shumën e kompensimit të dëmit në lartësinë e cekur në kërkesëpadinë e tyre, ose që aktgjykimi i Gjykatës Komunale të prishet dhe të kthehet në rigjykim. E paditura kërkoi nga Gjykata e Apelit t'i shpallë të pabazuara kërkesat për kompensim ose ta prishë aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe ta kthejë lëndën në rigjykim.

22. Më 23 qershor 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Ac. nr. 281/2008) nxori aktgjykim me të cilin refuzoi ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe e shpalli si të pabazuar aktgjykimin me të cilin ishte miratuar kompensimi. Gjykata e Qarkut e aprovoi ankesën e të paditurës, Kompanisë Publike Komunale për Sport dhe Marketing, si të bazuar dhe e ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale. Gjykata e Qarkut gjeti se i ndjeri Dalip Maloku kishte vdekur si pasojë e veprimeve të veta, dhe prandaj e paditura nuk ka qenë "objektivisht përgjegjëse" për dëmin e shkaktuar me vdekjen e tij.

23. Parashtruesit paraqitën kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme. Parashtruesit kërkuan nga Gjykata Supreme që të konstatojë se Gjykata e Qarkut e ka zbatuar në mënyrë të gabueshme të drejtën materiale.

24. Më 7 qershor 2012, Gjykata Supreme (Rev. nr. 466/2009) e refuzoi revizionin si të pabazuar. Gjykata Supreme kishte gjetur se Gjykata e Apelit kishte zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale, pasi që vdekja e të ndjerit ishte shkaktuar plotësisht nga veprimet e veta. Gjykata Supreme gjeti se parashtruesit kishin dështuar të provonin se vdekja i atribuohet ndonjë gabimi të kompanisë së paditur publike komunale për sport dhe marketing. Përveç kësaj, Gjykata Supreme gjeti se, sipas nenit 177 (1) dhe (2) të LMD-së, pronari i "objektit të rrezikshëm" lirohet nga përgjegjësia nëse provon se dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë "objektit", në këtë rast nga veprimet e të ndjerit.

Argumentet juridike të paraqitura nga parashtruesit

25. Parashtruesit pretendojnë se Gjykata e Qarkut, në ankesën e dytë, dhe Gjykata Supreme, në revizion, i kishin shkelur të drejtat e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohen me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6, para. 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

26. Parashtruesit pretendojnë se, duke konstatuar që vdekja e Dalip Malokut është shkaktuar ekskluzivisht nga veprimet e tij, ku autoritetet përgjegjëse të pishinës "Gërmia" nuk bënë asgjë për ta shpëtuar atë kur u bë e qartë se ai ishte në telashe, gjykatat kanë konstatuar gabimisht se parashtruesit nuk kishin të drejtë në kompensim për dëmin që ata pësuan. Parashtruesit mendojnë se përgjegjësia e autoriteteve të pishinës është pasojë e lejimit me vetëdije të të ndjerit të hyjë në zonën e pishinës, në kundërshtim me protokollet e tyre të sigurisë.

27. Parashtruesit pohojnë se gjykatat e interpretuan çështjen e përgjegjësisë sikur të ishte një çështje e përcaktimit të përgjegjësisë penale për vdekje, ndërsa pretendimet e tyre kishin të bënin vetëm me përcaktimin e detyrimit objektiv në një çështje civile të vdekjes, të shkaktuar nga një send i rrezikshëm.

28. Si pasojë e interpretimit të gjykatave, parashtruesit pohojnë se kolegji civil që gjykoi rastin e tyre nuk ishte as i pavarur e as i paanshëm. Parashtruesit thonë se ata kanë të drejtë kompensimi për vdekjen e anëtarit të familjes së tyre.

29. Parashtruesit kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese që të bëjë një vlerësim të saktë të përgjegjësisë së Kompanisë Publike Komunale për Sport dhe Marketing dhe të eliminojë shkeljet e pretenduara të së drejtës materiale nga Gjykata e Qarkut dhe nga Gjykata Supreme. Parashtruesit kërkojnë që t'u njihet e drejta e kompensimit për vuajtjet e tyre shpirtërore.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës.

31. Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës që përcakton:

> "1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
> (...)
> 7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

32. Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

33. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (2) të Rregullores së punës, që parasheh:

> *"Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
>
> *[...], ose*
>
> *(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese; ose*
>
> *[...],*
>
> *(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

34. Sa i përket kësaj, Gjykata Kushtetuese rithekson se, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, në lidhje me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, Avdyli kundër Gjykatës Supreme të Kosovës, KI13/09, 18 qershor 2010; Shih, *mutatis mutandis,* García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

35. Në të vërtetë, Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë ashtu që

parashtruesit të kenë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e 10 korrikut 1991).

36. Në rastin e tanishëm, parashtruesve u janë dhënë shumë mundësi për ta paraqitur rastin e tyre dhe për ta kontestuar interpretimin e ligjit, të cilin ata e konsideronin si të gabuar, pranë Gjykatës së Qarkut dhe pranë Gjykatës Supreme. Pas shqyrtimit të të gjitha procedurave civile në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk gjen se proceduarat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta ose arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e Kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

37. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk ka prova që do të tregonin se gjykatave që e kanë shqyrtuar rastin u ka munguar paanshmëria apo që procedurat në ndonjë mënyrë kanë qenë të padrejta. Thjesht, fakti se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrenë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (Shih, Memetoviq kundër Gjykatës Supreme të Kosovës, KI50/10, 21 mars 2011*; S*hih, *mutatis mutandis,* Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, GJEDNJ, Kërkesa Nr. 5503/02, e 26 korrikut 2005).

38. Prandaj, Gjykata Kushtetuese gjen se pretendimet e parashtruesve të kërkesës nuk janë mbështetur me prova dhe se ato duhet të refuzohen si të pabazuara.

39. Rrjedhimisht, për arsyet e cekura më lart, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 46 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36.2 (b) të Rregullores së punës, më 24 qershor 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,

IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 122/12, Edison Rinxhi, datë 02 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje, Nr. reg. 46854/2012, të 19 tetorit 2012

Lënda KI 122/12, Aktvendim për papranueshmëri i 13 majit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës për Kundërvajtje në Prishtinë.

Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Parashtruesi i kërkesës, më 4 dhjetor 2012, e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me ç'rast kërkoi nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës për Kundërvajtje në Prishtinë.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjatë procedurës në Gjykatën për Kundërvajtje ka pasur shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit.

Me Vendimin e Kryetarit, nr. GJR.122/12, të 10 janarit 2013, u caktua gjyqtarja Arta Rama Hajrizi si Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit, nr. KSH.KI 122/12, u caktua Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Prof. dr. Enver Hasani.

Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka cekur se cilat të drejta kushtetuese i janë shkelur me aktvendimin e Gjykatës për Kundërvajtje, edhe pse neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës thotë:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij dhe nuk ka ofruar prova se i janë shkelur të drejtat dhe liritë nga ana e gjykatave të rregullta.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në seancën e mbajtur më 13 maj 2013, e hedh poshtë kërkesën si qartazi të pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI122/12
Parashtrues
Edison Rinxhi
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje, Nr. reg. 46854/2012, të 19 tetorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Edison Rinxhi, i lindur në Republikën e Shqipërisë, me qëndrim të përkohshëm në Slivovë, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. reg. 46854/2012, e 19 tetorit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës për Kundërvajtje në Prishtinë, Nr. reg. 46854/2012, heqja e dënimit, si dhe kthimi i lëndës në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës; në nenet: 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së

Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 56, paragrafi 2, të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës, më 4 dhjetor 2012, i parashtroi kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Me Vendimin e Kryetarit (Nr. GJR. 122/12, të 10 janarit 2013), gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi u caktua Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit (Nr. KSH. KI122/12) u caktua Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Prof. dr. Enver Hasani.

7. Më 1 mars 2013, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore se kërkesa është regjistruar me numrin KI122/12.

8. Më 29 prill 2013, me vendim të Kryetarit (Nr.GJ.R.K.122/12), emërohet Gjyqtari Kadri Kryeziu si Gjyqtar Raportues, duke zëvendësuar Gjyqtaren Arta Rama Hajrizi.

9. Më 13 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. *Më 8 gusht 2012, Departamenti i policisë kufitare të Republikës së Kosovës, i dorëzoi Edison Rinxhit, shtetas i Republikës së Shqipërisë (parashtrues i kësaj kërkese), urdhrin për të lëshuar territorin e Republikës së Kosovës.*

11. *Më 15 tetor 2012, në orën 22:30, Departamenti për të huaj dhe migrim ilegal i Ministrisë së Punëve të Brendshme, gjatë inspektimit të objektit "D. P. H. te Nazi", rrugës Prishtinë – Gjilan, konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte vepruar sipas urdhrit që i ishte dorëzuar atij më 8 gusht 2012, por kishte vazhduar të punojë si muzikant në objektin e përmendur.*

12. *Më 19 tetor 2012, Departamenti për të huaj dhe migrim ilegal, kundër parashtruesit të kërkesës, i parashtroi Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje [Nr. 2012-YR-486] përkitazi me kundërvajtjet nga neni 33, në lidhje me nenin 32, paragrafi 1.1.6, në kuptimin e nenit 88.1.1 dhe 2 të Ligjit për të Huaj, Nr. 04/L-069 (Shih paragrafin 14. a dhe b).*

13. *Më 19 tetor 2012, Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë nxori Aktvendimin [Nr. 46854/12], me të cilin të pandehurit (parashtruesit të kësaj kërkese) i shqiptoi gjobë në shumën 50 euro, në pajtim me nenin 88.1.1 të Ligjit për të Huaj, Nr. 04/L-069 (Shih paragrafin 14. c).*

14. *Gjykata, me të njëjtin aktvendim, i shqiptoi parashtruesit të kërkesës masën mbrojtëse të dëbimit të menjëhershëm pa të drejtë hyrje në territorin e Republikës së Kosovës në kohëzgjatje prej 2 vjetësh, në pajtim me nenin 88.2. të Ligjit për të Huaj, Nr. 04/L-069 (Shih paragrafin 14. d).*

15. *Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë (data nuk është në dispozicion në dosjen e lëndës) ndaj Aktvendimit të Gjykatën Komunale për Kundërvajtje [Nr. 46854/4], të 19 tetorit 2012.*

16. *Më 5 nëntor 2012, Gjykata e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë pjesërisht pranoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe nxori Aktvendimin [GJ. nr. 1234/2012], me të cilin konfirmoi gjobën në të holla për parashtruesin e kërkesës, kurse masën për ndalimin e hyrjes në territorin e Republikës së Kosovës prej 2 (dy) vjetësh e ndryshoi në 1 (një) vit ndalim.*

Ligji relevant

17. *Ligji për të Huaj, Nr. 04/L-069:*

    a) *Neni 33, Kufizimi kohor i qëndrimit pa vizë:*

    "I huaji, të cilit për hyrje në Republikën e Kosovës nuk i kërkohet viza, mund të qëndrojë në Kosovë jo me gjate se nëntëdhjetë (90) ditë, në një periudhë kohore prej gjashtë (6) muajve, të llogaritur nga dita e parë e hyrjes, përveç se me dispozitat këtij ligji apo me marrëveshje ndërkombëtare nuk parashihet ndryshe".

    b) *Neni 32, Kalimi ilegal i kufirit:*
    1.6. 1. "Kalimi ilegal i kufirit shtetëror konsiderohet atëherë kur i huaji '(...) hyn në Republikën e Kosovës ndërkohë që urdhri për largim me ndalesë për ri-hyrje është në fuqi'".

    c) Neni 88.1.1: "*Me gjobë prej pesëdhjetë (50) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro dënohet me kundërvajtje i huaji*

nëse në mënyrë të paligjshme kalon kufirin e shtetit, sipas nenit 32 i këtij ligji".

"[...]"

d) Neni 88.2: "*Përveç rasteve të lartpërmendura të huajit gjithashtu mund t'i shqiptohet masa e dëbimit".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjatë procedurës në gjykatat për kundërvajtje ka pasur shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit.

19. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesën si vijon:

> *"Që Gjykata të lirojë të pandehurin Edison Rinxhi (parashtrues i kësaj kërkese) nga përgjegjësitë e dënimit të shqiptuar, ngase gjendja faktike nuk është konstatuar në mënyrë të drejtë, dhe që Gjykata të anulojë Aktvendimin e atakuar dhe të kthejë lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim".*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Në mënyrë që të jetë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, dhe detajisht të shpjeguara në Ligj dhe në Rregullore të punës së Gjykatës Kushtetuese.

21. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku thuhet:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

22. Gjykata vëren se në dosjen e lëndës ekziston Aktvendimi i Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje [GJ. nr. 1234/2012], i 5 nëntorit 2012, porse ai

nuk është objekt i kësaj kërkese, ngase kërkesa ka të bëjë me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje, Nr. reg. 46854/2012, të 19 tetorit 2012.

23. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka cekur se cilat të drejta kushtetuese i janë shkelur me Aktvendimin e Gjykatës Komunale për Kundërvajtje [Nr. reg. 46854-12], të 19 tetorit 2012, edhe pse neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës thotë:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

24. Gjykata thekson se është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës (GC), Nr. 30544/96, par. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

25. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në gjykata e rregullta, shikuar në tërësi, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur një gjykim të ndershëm (Shih, *mutatis mutandis*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

26. Parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij dhe nuk ka ofruar prova se i janë shkelur të drejtat dhe liritë nga ana e gjykatave të rregullta (Shih, *mutatis mutandis*, Šub kundër Lituanisë, GJEDNJ, Vendimi për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

27. Rregulli 36 (2) b) i Rregullores së punës parasheh se "*Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se (...) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese".*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës; me nenin 20 të Ligjit; dhe me rregullin 36.2 e me rregullin 56 të Rregullores së punës, më 28 qershor 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 22/13, Sokol Mushkolaj, datë 02 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 164/2012, të 5 dhjetorit 2012; të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ap. nr. 4/12, të 28 shtatorit 2012; të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 3 tetorit 2011; dhe të Vendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 20 dhjetorit 2011

Rasti KI 22/13, Aktvendim për papranueshmëri i 10 qershorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë papranueshme, kërkesë qartazi e pabazuar, masa të përkohshme, mos zbulimi i identitetit, parashkrimi i ndjekjes penale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenet 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar me vendimet e Gjykatava të rregullta të Republikës së Kosovës. Parashtruesi, ndër të tjera, pohoi se ishin shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit për shkak se ndjekja penale ndaj tij ishte parashkruar sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe se Gjykatat e rregullta nuk ia kishin dorëzuar vendimin atij personalisht ashtu siç parashihet me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit nuk përmbante ndonjë dëshmi që provon se gjykatat e rregullta e kishin gjykuar atë përtej parashkrimit, ose që vendimi ishte dorëzuar në mënyrë të paligjshme. Përkitazi me kërkesën e parashtruesit për vënien e masave të përkohshme dhe mos zbulim të identitetit, Gjykata në rastin e parë konstatoi se kërkesa pë masa të përkohshme nuk i përmbush kriteret e parapara me Nenin 116.2 të Kushtetutës dhe Nenin 27 të Ligjit, kurse në rastin e dytë, Gjykata e refuzoi kërkesën e parashtruesit për mos zbulim të identitetit pashkak se ishte e paarsyetuar. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata bazuar në Nenet 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës, Nenet 20 e 27 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) c) dhe 54 të Rregullores së punës vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI22/13
parashtrues
Sokol Mushkolaj
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme , Pkl. nr. 164/2012, të 5 dhjetorit 2012; të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ap. nr. 4/12, të 28 shtatorit 2012; të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 3 tetorit 2011; dhe të Vendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 20 dhjetorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Sokol Mushkolaj, avokat, me vendbanim në Fushë-Kosovë.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 164/2012, të 5 dhjetorit 2012; Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ap. nr. 4/12, të 28 dhjetorit 2012; Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 3 tetorit 2011; dhe Vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 20 dhjetorit 2011.

Baza juridike

3. Neni 113.7 dhe neni 116.2, të Kushtetutës; nenet: 20, 22.7, 22.8 dhe 27, të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është ankesa e parashtruesit të kërkesës se gjykatat e rregullta e kanë dënuar atë me gjashtë muaj burg, duke aplikuar gabimisht nenin 90.6 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK), që ka të bëjë me parashkrimin absolut të ndjekjes penale, si dhe nenet: 124, 125 dhe 126, të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPPK), që ka të bëjë me dorëzimin e dokumenteve gjyqësore.

5. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) që, në bazë të nenit 116.2 të Kushtetutës, të vendosë Masën e përkohshme dhe të pezullojë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/2008, të 3 tetorit 2011, si dhe të pezullojë përmbarimin e dënimit me burg, deri në përfundimin e kësaj çështjeje juridiko-penale.

6. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të mos i zbulohet identiteti.

Procedura në Gjykatë

7. Më 25 shkurt 2013, parashtruesi i parashtroi kërkesë Gjykatës.

8. Më 28 shkurt 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtarë).

9. Më 12 mars 2013, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.

10. Më 13 mars 2013, Gjykata kërkoi dokumente shtesë nga Gjykata Komunale në Prishtinë dhe nga parashtruesi i kërkesës.

11. Më 19 dhe 21 mars 2013, parashtruesi dhe Gjykata Komunale në Prishtinë u përgjigjën në kërkesën e Gjykatës.

12. Më 29 prill 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani (anëtarë).

13. Më 13 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të dëshmuara me dokumentet e ofruara nga parashtruesi i kërkesës

14. Më 3 tetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin P. nr. 601/08, gjeti se parashtruesi i kërkesës kishte kryer vepër penale mashtrimi nga neni 261, par. 1, i KPPK-së, prandaj i shqiptoi dënim me burg, të cilin parashtruesi i kërkesës do ta mbajë pasi Aktgjykimi të marrë formën e prerë.

15. Në dispozitivin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, thuhej:

> "...
>
> *AKTGJYKIM*
>
> *I pandehuri, SOKOL MUSHKOLAJ nga babai H. dhe nëna B. e gjinisë H., i lindur me 19.12.1952 ne Deçan, rruga 'Dëshmorët e Kombit' nr. 86, ku edhe tani jeton, ka të kryer fakultetin juridik, me profesion avokat në Deçan, i martuar baba i një fëmiu, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa gjykuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale.*
>
> ËSHTË FAJTOR
>
> *Sepse me qëllim që vetit t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, me fshehjen e fakteve i pandehuri Sokol Mushkolaj më dt. 23.11.2006 në Prishtinë, në zyrën e tij të avokatisë nga të dëmtuarit N. H. dhe N. H. ka marrë shumën e të hollave prej 500 euro, dhe në vazhdimësi më dt. 25.11.2006 nga të njëjtit ka marrë shumën e të hollave prej 2.000 euro, ku i pandehuri Sokol Mushkolaj, duke i vënë në lajthim dhe duke u premtuar se do të ndikoj në vendimin e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit dhe Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila gjykatë kishte shqiptuar dënim me 20 vjet burgim, duke u thënë se këtë dënim do t'ia zbret deri në 10 ose 13 vjet burg, dhe prapë gjatë muajit prill të vitit 2007 në një restorant në Pejë, nga të dëmtuarit N. H. dhe N. H., i pandehuri duke iu dhënë të njëjtat premtime si të lartcekurat ka marrë nga të dëmtuarit N. H. dhe N. H., shumën e të hollave prej 3.000 euro, dhe nga ajo ditë të dëmtuarve të lartcekur nuk iu ka kthyer paratë.*

Me këtë ka kryer vepër penale mashtrimi nga neni 261 par. 1 i KPK.

Prandaj, Gjykata në bazë të neneve 3, 34, 38, 64 dhe nenit 261 par. 1 i KPK, si dhe nenit 391 të KPK,

GJYKON

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj të cilin do ta mbaj pasi që Aktgjykimi të merr formën e prerë.

...”

16. Më 20 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Vendimin P. nr. 601/08, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, si të paafatshme.

17. Më 28 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Vendimin Ap. nr. 4/12, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës ndaj Vendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 20 dhjetorit 2011.

18. Më 5 dhjetor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pkl. nr. 164/2012, hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Vendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 20 dhjetorit 2011, dhe kundër Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ap. nr. 4/12, të 28 shtatorit 2012.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ndjekja penale ndaj tij do të duhej të kishte përfunduar për shkak të parashkrimit të paraparë me nenin 90.6 të KPPK-së. Pretendon, gjithashtu, se gjykatat e rregullta kanë aplikuar gabimisht nenin 90.6 të KPPK-së, në dëm të tij.

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta nuk ia kishin dorëzuar vendimin atij personalisht, siç parashihet me nenet: 124, 125 dhe 126, të KPPPK-së. Pretendon se gjykatat e rregullta kanë vepruar në shkelje të neneve: 124, 125 dhe 126, të KPPPK-së, në dëm të tij.

21. Parashtruesi i kërkesës pohon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6

[E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

22. Parashtruesi i kërkesës propozon vendosjen e Masës së përkohshme për suspendim të përkohshëm të përmbarimit të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 3 tetorit 2011, në bazë të nenit 116.2 të Kushtetutës.

Ligji

"...

Mashtrimi

Neni 261

(*1*) *Kushdo që me qëllim për t'i sjellë vetes apo personit tjetër ndonjë dobi pasurore e mashtron ose e sjell personin tjetër në lajthim me anë të paraqitjes së rreme apo duke i fshehur faktet dhe me këtë e shtyt personin e tillë që të veprojë apo të mosveprojë në dëm të pasurisë së tij ose të pasurisë së ndonjë personi tjetër, dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.*

Parashkrimi i ndjekjes penale

Neni 90

(*1*) *Me përjashtim të rasteve kur është paraparë ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse nuk kanë kaluar afatet e mëposhtme:*

6) Dy vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim ose dënim me gjobë.

..."

Vlerësimi i pranueshmërisë

23. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.

24. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Komunale në Prishtinë gjeti fajtor për mashtrim parashtruesin e kërkesës dhe e dënoi atë me gjashtë muaj burgim. Më pastaj, ky dënim u konfirmua nga po e njëjta gjykatë, nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë dhe nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

25. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta zgjodhën që t'i shqiptojnë parashtruesit të kërkesës dënim më të vogël sesa është paraparë me ligj, duke argumentuar se parashtruesi i kërkesës është në moshë relativisht të shtyrë. Fakti se ai nuk ishte dënuar më parë dhe faktorë të tjerë shërbyen si rrethana lehtësuese në dobi të tij.

26. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se ai është gjykuar përtej parashkrimit, ose se nuk i ishte dorëzuar vendimi atij personalisht, Gjykata vëren se në kërkesë nuk kishte asgjë që do të sugjeronte se gjykatat e rregullta kishin gjykuar parashtruesin e kërkesës përtej parashkrimit, apo se i kishin dorëzuar atij vendimin në mënyrë të paligjshme.

27. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon që i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, pa ofruar ndonjë dëshmi *prima facie* që do mbështeste pohimet e tij.

28. Për më tepër, Gjykata vëren se ekziston dallim ndërmjet gjykimit të drejtë dhe atij të përkryer dhe Gjykatës i është i ditur fakti se gjatë rrjedhës së procedurës së rregullt gjyqësore, qoftë ajo penale apo civile, mund të ndodhin gabime procedurale. Megjithatë, kjo nuk nënkupton automatikisht se parashtruesit potencial të kërkesës i është rrezikuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kjo, thjesht, nënkupton se parashtruesve të mundshëm u është mohuar e drejta për gjykim të përkryer dhe, vetvetiu, kjo nuk është e njëjtë me shkeljen e të drejtave elementare.

29. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve. Gjykata Kushtetuese rithekson se konstatimi i gjendjes faktike, i drejtë dhe i plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i saj

është vetëm të sigurojë pajtueshmëri me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt *(Shih, mutatis mutandis, i. a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, par. 65).*

30. Gjykata konsideron se kërkesa nuk tregon si dhe pse kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë gjykatat e rregullta. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me ato të gjykatave të rregullta. Si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë dëshmitë para vetes. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë dëshmitë *(Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, Kërkesa Nr. 13071/87, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 3, të 10 korrikut 1991).*

31. Fakti se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'iu shërbejë atyre si bazë që të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës *(Shih, mutatis mutandis Aktgjykim i GJEDNJ-së, Kërkesa Nr. 5503/02, MezoturTiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).*

32. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për vendosjen e Masës së përkohshme, Gjykata konsideron se një kërkesë e tillë nuk i përmbush kriteret e përcaktuara me nenin 116.2 të Kushtetutës, me nenin 27 të Ligjit dhe me nenin 54 të Rregullores së punës, çka do të shtynte Gjykatën që të vendosë Masën e përkohshme; prandaj, refuzohet kërkesa për Masë të përkohshme.

33. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për moszbulim të identitetit të tij, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar prova që do të mbështesnin miratimin e një kërkese të tillë, dhe as që ka e ka arsyetuar atë, prandaj Gjykata refuzon kërkesën e parashtruesit për moszbulim të identitetit.

34. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe, si e tillë, duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 dhe me 116.2 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 20 e me nenin 27 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.1 (c) e me rregullin 54 të Rregullores së punës, më 10 qershor 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për Masë të përkohshme;

III. TA HEDHË POSHTË kërkesën për moszbulim të identitetit;

IV. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Ivan Čukalović

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 38/13, Miftar Krasniqi, datë 02 korrik 2013--Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 48/2012, të 13 prillit 2012.

Rasti KI 38/13, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 majit 2013.

Fjalë kyçe: Kërkesë Individuale, e pa afatshme, Aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi pretendon se Gjykata Komunale në Gjakovë, Gjykata e Qarkut në Pejë dhe Gjykata Supreme e kishin shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.

Parashtruesi pretendon se ekspertiza në të cilën janë mbështetur gjykatat gjatë gjykimit kishte dështuar të përcaktojë nëse shoferët e ndryshëm të përfshirë në aksidentin e komunikacionit rrugor kishin qenë nën ndikimin e alkoolit, dhe se kjo ekspertizë e mangët kishte çuar në një interpretim të gabuar të rrethanave të aksidentit. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, duke i mohuar atij një rigjykim në bazë të ekspertizës së tij të pavarur, gjykatat kanë shkelur të drejtën e tij për një gjykim të drejtë.

Gjykata vlerëson se kërkesa nuk është dorëzuar në mënyrë ligjore, sepse ajo nuk është dorëzuar brenda afatit katër mujor, të përcaktuar me Ligj dhe me Rregullore të punës, prandaj ajo duhet të hedhet poshtë si e papranueshme pasi që është e pa afatshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI38/13
Parashtrues
Miftar Krasniqi
Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 48/2012, të 13 prillit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues është Miftar Krasniqi, me vendbanim në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (Pkl. nr. 48/2012), të 13 prillit 2012. Parashtruesi nuk ka cekur asnjë datë të pranimit të këtij vendimi.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se vendimi i Gjykatës Supreme, me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë, i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, respektivisht me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut **(**në tekstin e mëtejmë: KEDNJ)**.**

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (7) të Kushtetutës; në nenin 47, në nenin 48 dhe në nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 28, në rregullin 29 dhe në

rregullin 30 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 14 mars 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 25 mars 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 2 prill 2013, Gjykata Kushtetuese e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai t'ia dorëzojë Gjykatës kopjet e aktgjykimeve dhe të vendimeve gjyqësore relevante për rastin e tij.

8. Më 17 prill 2013, parashtruesi i dorëzoi kopjet e aktgjykimeve dhe të vendimeve gjyqësore relevante, siç ishte kërkuar nga Gjykata Kushtetuese.

9. Më 15 maj 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Enver Hasani për të zëvendësuar gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi në Kolegjin shqyrtues. Kështu, Kolegji shqyrtues është i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

10. Më 15 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit

11. Në një datë dhe kohë të pacaktuar, parashtruesi ishte përfshirë në një aksident komunikacioni.

12. Më 24 shtator 2010, Gjykata Komunale në Gjakovë (P. nr. 431/2007) e dënoi parashtruesin për veprën penale Rrezikimi i Trafikut Publik, dhe e dënoi atë me 6 muaj burgim.

13. Më 31 tetor 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë (AP. nr. 126/2010) e vërtetoi këtë gjykim dhe këtë dënim.

14. Në një datë të mëvonshme të paspecifikuar, si duket, parashtruesi e kishte kryer një ekspertizë të pavarur përkitazi me rrethanat e fatkeqësisë. Më pas, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Komunale në Gjakovë që rasti i tij të rishikohet dhe të rigjykohet bazuar në gjetjet e këtij eksperti të pavarur.

15. Më 10 janar 2012, Gjykata Komunale në Gjakovë (P. nr. 431/2007) e refuzoi këtë kërkesë.

16. Më 14 shkurt 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë (P. nr. 12/2012) e shpalli ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale.

17. Më 13 prill 2012, Gjykata Supreme (Pkl. nr. 48/2012) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të dorëzuar në emër të parashtruesit.

Argumentet ligjore të paraqitura nga parashtruesi

18. Parashtruesi pretendon se Gjykata Komunale në Gjakovë, Gjykata e Qarkut në Pejë dhe Gjykata Supreme e kishin shkelur të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.

19. Parashtruesi pretendon se ekspertiza në të cilën janë mbështetur gjykatat gjatë gjykimit kishte dështuar të përcaktojë nëse shoferët e ndryshëm të përfshirë në aksidentin e komunikacionit rrugor kishin qenë nën ndikimin e alkoolit, dhe se kjo ekspertizë e mangët kishte çuar në një interpretim të gabuar të rrethanave të aksidentit. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, duke i mohuar atij një rigjykim në bazë të ekspertizës së tij të pavarur, gjykatat kanë shkelur të drejtën e tij për një gjykim të drejtë.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka plotësuar të gjitha kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë rast, Gjykata duhet të përcaktojë në mënyrë të veçantë nëse parashtruesi i ka plotësuar kushtet e nenit 113 (1) të Kushtetutës dhe të nenit 49 të Ligjit si dhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

22. Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

    33. "Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

[...]

7. *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

23. Parashtruesi është palë e autorizuar dhe, si duket, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

24. Megjithatë, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht[...]".

25. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) b) i Rregullores së punës parasheh:

"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
(b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi".

26. Gjykata vëren se vendimi përfundimtar në rastin e parashtruesit është Vendimi i Gjykatës Supreme (Pkl. nr. 48/2012), i 13 prillit 2012.

27. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 14 mars 2013. Parashtruesi nuk ka ofruar asnjë informatë përkitazi me datën e pranimit të vendimit të Gjykatës Supreme.

28. Në këto rrethana, Gjykata vëren se vendimi përfundimtar është ai i datës 13 prill 2012, kurse parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij më 14 mars 2013, që është më shumë se njëmbëdhjetë (11) muaj pas atij vendimi.

29. Gjykata vlerëson se nuk është e arsyeshme të konsiderohet që vendimi i Gjykatës Supreme, i cili ka të bëjë me dënimin penal, nuk i është dorëzuar parashtruesit deri në një datë, katër muaj para dorëzimit të kërkesës më 14 mars 2013, respektivisht deri më 14 nëntor 2012.

30. Prandaj, Gjykata vlerëson se kërkesa nuk është dorëzuar në mënyrë ligjore, sepse ajo nuk është dorëzuar brenda afatit katërmujor, të

përcaktuar me Ligj dhe me Rregullore të punës, prandaj ajo duhet të hedhet poshtë si e papranueshme pasi që është e paafatshme.

31. Rrjedhimisht, për arsyet e sipërpërmendura, Kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 49 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 24 qershor 2013, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,

IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 134/11, KI 135/11, KI 136/11, KI 137/11, Enver Gashi, Shefqet Bici, Ibush Gela, Mustafë Emini, datë 02 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së 4 Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rasti KI134/11, KI135/11, KI136/11, KI137/11, Aktvendim për papranueshmëri i 27 qershorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë papranueshme, kërkesë e paaftshme, Koroporata Energjetike e Kosovës, e drejta në punë, *ratione temporis*.

Kërkesa bazohet në Nenin 113.7 të Kushtetutës, Neni 20 i Ligjit dhe rregullin 56 të Rregullores së punës. Parashtruesit, ndër të tjera, kërkuan nga Gjykata që të anuloj vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës sepse vendimi në fjalë vërtetonte vendimin e Korporatës Energjetike të Kosovës për ndërprerje të kontratës së punës dhe kështu ua cenonte atyre të drejtën në punë.

Gjykata theksoi se kërkesat e disa prej parashtruesve në këtë rast nuk përkonin me juridiksionin kohor të Gjykatës dhe si të tilla ishin *ratione temporis* të papajtueshme me Kushtetutën. Kurse për kërkesat e parashtruesve tjerë, Gjykata konstatoi se ishin të paafatshme për shkak se ishin dorëzuar pas afatit ligjor prej (4) katër muajve. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenet 49 dhe 56 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) b) dhe (3) h) e 56 (2) të Rregullores së punës vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesve të papranueshme.

AKTVENDIM PER PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr.
KI 134/11, KI 135/11, KI 136/11, KI 137/11
Parashtruesit
Enver Gashi, Shefqet Bici, Ibush Gela, Mustafë Emini
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së 4 Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLJKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Kadri Kryeziu, Gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, Gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesat janë parashtruar në Gjykatën Kushtetuese individualisht nga 4 ish-punëtorë të KEK-ut, gjegjësisht Enver Gashi, Shefqet Bici, Ibush Gela dhe Mustafë Emini.

Vendimet e kontestuara

2. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, si në vijim:

KI 134/11	Rev. I. nr. 158/08, të 27.01.2009
KI 135/11	Rev I. nr. 192/05, të 21.03.2006
KI 136/11	Rev.I. nr. 187/07, të 17.01.2008
KI 137/11	Rev.I. nr. 148/09, të 01.06.2009

Baza ligjore

3. Kërkesat bazohet në nenin 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 20 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së Punës së Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Objekti i çështjes

4. Vendimi që është marrë në bazë të nenit 12 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 27/2001, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/40 për shpalljen e Ligjit Bazë të Punës në Kosovë. Çështja për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese është Memorandumi për ndërprerjen e punësimit të parashtruesve, i marrë nga Bordi Mbikëqyrës i KEK-ut.

Procedura në Gjykatë

5. Kërkesat e parashtruara në Gjykatën Kushtetuese janë identike në tërësinë e tyre.

6. Më 20 tetor 2011, parashtruesit, gjegjësisht Enver Gashi, Shefqet Bici, Ibush Gela, Mustafë Emini, kanë parashtruar kërkesat e tyre në Gjykatën Kushtetuese.

7. Më 17 shkurt 2012, Kryetari i Gjykatës e caktoi Gjyqtarin Kadri Kryeziu si Gjyqtar Raportues, si dhe Kolegjin Shqyrtues të Gjykatës, të përbërë nga Gjyqtarët: Altay Suroy (Kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.

8. Më 1 mars 2013, Kryetari, me vendimin (KSH.KI-134/11,135/11,136/11,137/11) e caktoi Gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit Shqyrtues, pas përfundimit të mandatit të Gjyqtares Iliriana Islami si Gjyqtare e Gjykatës.

9. Më 15 janar 2012, kërkesat iu komunikuan Gjykatës Supreme.

10. Në të njëjtën datë, Gjykata Kushtetuese e njoftoi KEK-un në lidhje me parashtresat e parashtruesve.

11. Gjykata Kushtetuese nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Gjykata Supreme, e as nga KEK-u, në lidhje me këtë çështje.

12. Më 6 mars 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues ia rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

13. Më 28 shkurt 2003, Bordi Mbikëqyrës i KEK-ut ua ndërpreu marrëdhënien e punës parashtruesve të lartpërmendur për shkak të

"ndryshimeve ekonomike, teknologjike apo strukturore që kanë rrjedhur si rezultat i zvogëlimit të numrit të punëtorëve", me hyrje në fuqi nga 31 maji 2003.

14. Më 15 gusht 2003, KEK-u nënshkroi një Memorandum, ku thuhej që vendimi nuk kishte qenë në "përputhje me vendimin e Bordit Mbikëqyrës", si dhe kështu i njoftoi parashtruesit që marrëdhënia e tyre e punës me KEK-un do të ndërpritej përfundimisht më 31 gusht 2003, duke i njoftuar gjithashtu që pagat e tyre shtesë do të paguheshin në fund të gushtit të atij viti.

15. Parashtruesit i paraqitën paditë e tyre në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke kërkuar që të ktheheshin në pozitat e tyre të mëparshme.

16. Gjykata Komunale, përmes vendimit të saj, p.sh. në rastin e parashtruesit të parë Enver Gashi CI. nr. 323/2003, aprovoi padinë e parashtruesit, si dhe anuloi memorandumin e Korporatës Energjetike të Kosovës, si dhe e obligoi atë që ta kthejë parashtruesin në vendin e tij të punës.

17. KEK-u dorëzoi ankesën e vet kundër Aktgjykimit të lartpërmendur dhe aktgjykimeve tjera për parashtruesit tjerë.

18. Gjykata e Qarkut në Prishtinë miratoi ankesën e dorëzuar nga KEK-u, si dhe i shpalli si të pabazuara kërkesat e parashtruesve.

19. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës i refuzoi individualisht kërkesat e parashtruesve për revizion si të pabazuara.

Pretendimet e Parashtruesve

20. Parashtruesit thjesht kërkojnë anulimin e Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, pa përmendur veçanërisht ndonjë shkelje kushtetuese, e as ndonjë informatë mbi atë se pse pretendojnë që këto vendime mund të jenë arbitrare.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesave

21. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesat e parashtruesve, duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesit kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

22. Sa i përket kërkesave të Enver Gashit dhe Mustafë Eminit, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton si në vijim:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".

23. Sa i përket Parashtruesve Enver Gashi dhe Mustafë Emini, mund të shihet që kërkesat janë dorëzuar individualisht më 20 tetor 2011. Vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. I. nr. 158/08 dhe Rev.I.nr. 148/09 datojnë ndërmjet 27.01.2009 dhe 01.06.2009. Pra, Kërkesat nuk janë parashtruar brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

24. Rrjedh se kërkesat e lartpërmendura janë të paafatshme siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit.

25. Në lidhje me kërkesat e Shefqet Bicit dhe Ibush Gelës, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) (h) i cili parashikon si në vijim:
"Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

h) kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën."

26. Për ta përcaktuar juridiksionin kohor të Gjykatës është me rëndësi të identifikohet, në secilin rast specifik, koha e saktë e shkeljes së pretenduar. Me këtë rast, Gjykata duhet të marrë parasysh faktet për të cilat parashtruesi ankohet dhe për masën e të drejtës kushtetuese që pretendohet të jetë shkelur (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Rastin Blečić kundër Kroacisë, Kërkesa nr. 59532/0, e 8 marsit 2006, para. 82).

27. Sa i përket Parashtruesve Shefqet Bici dhe Ibush Gela, mund të shihet nga kërkesat e parashtruara që vendimet përfundimtare të gjykatës në lidhje me rastet e tyre janë Vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.I.nr. 192/2005, të 21.03.2006 dhe Rev.I.nr. 187/07, të 17.01.2008, derisa ata kanë dorëzuar kërkesat e tyre në Gjykatën Kushtetuese më 20 tetor 2011. Kjo do të thotë që ndërhyrja e pretenduar në të drejtën e parashtruesit, e garantuar me Kushtetutë, ka ndodhur para 15 qershorit

2008, që është data e hyrjes në fuqi e Kushtetutës, si dhe data nga e cila Gjykata ka kompetencë kohore.

28. Rrjedh se kërkesat e lartpërmendura nuk janë "*ratione temporis*" në pajtim me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 dhe 56 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) b) dhe (3) h), dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 27 qershor 2013, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 te Ligjit.

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 66/13, Milazim Gashi, datë 09 korrik 2013 Kundër Kryetarit të Komunës së Graçanicës, z.Bojan Stojanovic

Rasti KI 66/13, Aktvendim për papranueshmëri i 20 qershorit 2013

Fjalë kyçe: *actio popularis*, emërimi i nënkryetarit te Komunës, palë e paautorizuar, e drejta e votës, e drejta për të ushtruar profesionin, shkelje e të drejtave dhe lirive të njeriut

Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pretenduar se *"nenet 62, 123 dhe 124 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës janë shkelur për shkak të mosveprimit të Kryetarit të Komunës së Graçanicës, në lidhje me procedimin e çështjes për emërimin e nënkryetarit të kësaj komune."*

Sa i përket çështjes së pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata konkludoi se kërkesa ishte e papranueshme sepse parashtruesi nuk është palë e autorizuar që të mund të referojë çështje kushtetuese *in abstracto* përkitazi me zgjedhjen ose mos-zgjedhjen e nënkryetarit të Komunës së Graçanicës në mënyrë që të arrijë një mjet në emër të interesit kolektiv. Parashtruesi nuk ka specifikuar asnjë akt të autoritetit publik (shih nenin 48 të Ligjit) që pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat dhe liritë e tij individuale.

Përveç kësaj, Kushtetuta nuk parasheh *actio popularis*, që është një modalitet i ankesës individuale, çfarë u mundëson individëve, të iniciojnë shqyrtim abstrakt, pa marrë parasysh interesin e tyre specifik ligjor në rastin në fjalë. Neni 113.7 i Kushtetutës presupozon një shkelje individuale dhe të drejtpërdrejtë për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese si një mundësi e fundit për një shkelje të pretenduar nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive individuale të garantuara me Kushtetutë.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI66/13
Parashtrues
Milazim Gashi
kundër
Kryetarit të Komunës së Graçanicës, z. Bojan Stojanović.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Milazim Gashi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), me vendbanim në Graçanicë.

Pala kundërshtare

2. Pala kundërshtare është kryetari i Komunës së Graçanicës (në tekstin e mëtejmë: pala kundërshtare).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se *"nenet 62, 123 dhe 124 të Kushtetutës së Kosovës janë shkelur për shkak të mosveprimit të kryetarit të Komunës së Graçanicës, në lidhje me procedimin e çështjes për emërimin e nënkryetarit të kësaj komune."*

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit, Nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 29 prill 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 29 prill 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 14 maj 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesi të gjitha dokumentet relevante në lidhje me emërimin ose mosemërimin e nënkryetarit të komunitetit joshumicë të Graçanicës, duke përfshirë:

    a. Procesverbalin e seancave të Kuvendit Komunal të Graçanicës, ku është diskutuar çështja e emërimit ose mosemërimit të nënkryetarit të Komunës nga komuniteti joshumicë i Graçanicës;
    b. Vendimet; dhe
    c. Komunikimin me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

8. Më 14 maj 2013, kërkesa iu komunikua palës kundërshtare.

9. Më 22 maj 2013, parashtruesi dorëzoi dokumentet shtesë të kërkuara.

10. Më 17 qershor 2013, Kryetari i Gjykatës e zëvendësoi gjyqtaren Arta Rama Hajrizi si anëtare të Kolegjit shqyrtues me gjyqtarin Enver Hasani.

11. Më 20 qershor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 1 mars 2010, partia politike Lidhja Demokratike e Dardanisë e njoftoi kryetarin e Komunës së Graçanicës se, *"në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale, neni 61, Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), e emëron z. Milazim Gashi në pozitën e nënkryetarit të Komunës, për Komunitete në Komunën e Graçanicës."*

13. Më 28 maj 2010, Kuvendi Komunal mbajti një mbledhje, ku njëra nga temat ishte zgjedhja e nënkryetarit të Komunës për Komunitete. Në Procesverbal të asaj mbledhjeje theksohet si në vijim:

"Kryesuesi i Komisionit për Komunitete theksoi se komuniteti i shqiptarëve nuk është i kënaqur se qe 5 muaj nuk është zgjedhur nënkryetari nga komuniteti pakicë dhe se nënkryetari duhet të jetë nga komuniteti i shqiptarëve.

I.S., anëtar i Komisionit, deklaroi se në këtë pikë të rendit të ditës duhet të theksohet se komuniteti rom duhet të dorëzojë kërkesën për zgjedhjen e nënkryetarit, pasi që komuniteti rom është pakica më e madhe në komunën e Graçanicës me 10.6%, ndërsa komuniteti i shqiptarëve përbën 3.6% dhe ai goran 1.8% dhe se kryetari tanimë është në negociata me komunitetin rom.

A.K., anëtar i Komisionit, pajtohet me I.S., anëtar i Komisionit.

Kryesuesi i Komisionit për Komunitete pajtohet se komuniteti rom është më i madh se komuniteti shqiptar, por komuniteti shqiptar mori pjesë në zgjedhje dhe votuan për partinë e tyre, përderisa komuniteti rom kishte votuar për partinë "SLS", dhe se sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, neni 61, pika 61.3, nënkryetari për Komunitete propozohet nga kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë si dhe shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës që janë të pranishëm dhe votojnë e të cilët u përkasin komuniteteve joshumicë dhe pasi që ai vjen nga komuniteti pakicë, ai do të votojë për anëtarin e partisë së tij.

I.S., anëtar i Komisionit, deklaroi se sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, pika 61.1 në komunat ku së paku 10% e banorëve i takojnë komunitetit joshumicë, ata do të kenë një kryesues për komunitete dhe ai është komuniteti rom."

14. Më 7 qershor 2010, Kuvendi Komunal mbajti një mbledhje, ku njëra nga pikat ishte një letër nga partia politike Lidhja Demokratike e Dardanisë në lidhje me zgjedhjen e nënkryetarit të Komunës për Komunitete. Në procesverbal të mbledhjes theksohet si në vijim:

"Kryetari ka thënë se më 04.06.2010 ka marrë një shkresë nga Lidhja Demokratike e Dardanisë, LDD, me të cilën është kërkuar që pika e re e rendit të ditës të diskutohet në komuna. Por, kjo është seancë e jashtëzakonshme, kështu që kjo pikë nuk do të

përfshihet në rend të ditës. Ata kanë kërkuar që të zgjidhet nënkryetari i Kuvendit nga komunitetet, dihet se në këtë post është i zgjedhur A.K. nga e njëjta parti më 28.01.2010, kështu që me siguri është bërë gabim në përkthim dhe me siguri është kërkuar që të zgjidhet nënkryetari i Komunës nga komuniteti pakicë. Kryetari ka thënë se ka biseduar me kryetarin dhe ai i është përgjigjur se nënkryetar nuk mund të jetë dikush që nuk është banor i komunës së Graçanicës, dhe që në shkresë nuk është shkruar emri i kandidatit, por sipas disa informatave, ai është nga rrethina e Pejës dhe Klinës, dhe që tani ai jeton në Prishtinë. Dihet se propozimi për nënkryetarin nga komuniteti vjen nga propozimi i vetë kryetarit, por ende propozimi nuk është paraqitur. Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale numri i komunitetit pakicë duhet të jetë 10% që të kenë të drejtën për këtë post, i cili zgjidhet çdo 4 vjet.

Kryetari ka thënë se në komunën e Graçanicës, shkalla e numrit të komuniteteve pakicë është:romë 10,6%, shqiptarë 3,6%, goranë 1,8% dhe deri tani propozimin e ka paraqitur vetëm kjo parti shqiptare, LDD, dhe me siguri do të paraqitet edhe nga komuniteti rom, por Kuvendi nuk mund ta miratojë propozimin derisa vetë kryetari nuk e bën propozimin e tij, dhe për këtë post duhet të dihet e tërë biografia e personit.

Deputeti A.K. nga LDD-ja ka thënë se ai e di se sipas Ligjit, nënkryetari i kryetarit të Kuvendit zgjidhet me votime, dhe pajtohet se është bërë gabim në përkthim. Një nënkryetar komunal mund të zëvendësohet nëse tre muaj nuk ka marrë pjesë në seanca, apo nëse ka bërë ndonjë gabim shumë të madh, kështu që nuk mund të zëvendësohet dhe për këtë ka kompetencë vetëm kryetari i Komunës dhe nuk i vjen mirë se personi i propozuar nuk është nga komuna e Graçanicës, por pajtohet me propozimin e partisë së tij dhe e di se propozimin e jep vetë kryetari. Tani propozimi shkon në Kuvend për miratim dhe për këtë arsye, partia LDD ka pasur nevojë këtë shkresë t'ia paraqesë në fillim kryetarit, tani Kuvendit."

15. Më 24 qershor 2010, kryetari i Komunës së Graçanicës kërkoi nga z. A.K., kryetar i Komisionit për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve në Komunën e Graçanicës, *"[...] një rekomandim për emërimin e nënkryetarit të Komunës, i cili do të merret me çështjet e komuniteteve."*

16. Më 4 prill 2013, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e njoftoi kryetarin e Komunës së Graçanicës se *"bazuar në nenin 61 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, komunat ku të paktën 10% e qytetarëve u përkasin komuniteteve joshumicë, do të kenë një nënkryetar të Komunës për Komunitete. Nënkryetari i Komunës për Komunitete propozohet nga kryetari i Komunës dhe miratohet nga Kuvendi i Komunës sipas nenit 61.3 të Ligjit për vetëqeverisje lokale."*

17. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal gjithashtu njoftoi se *"gjatë monitorimit të Komunës së Graçanicës, është konstatuar se në këtë komunë ende nuk është emëruar nënkryetari i Komunës për Komunitete, ashtu siç është parashikuar me ligj. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në të gjeturat e cekura më lart dhe duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen lokale, kërkon nga organet e Komunës përkatësisht nga kryetari i Komunës që të propozojë në Kuvendim e Komunës emërimin e nënkryetarit të Komunës për Komunitete në pajtim me paragrafin 1 të nenit 61 të Ligjit për vetëqeverisje lokale."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi pretendon se kryetari i Komunës së Graçanicës *"në mënyrë të vazhdueshme me mosveprim dhe veprim në kundërshtim me Kushtetutën, Ligjin dhe Statutin e Komunës i cenon dhe i shkel:*

    a. *Të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë të anëtarëve të komunitetit joshumicë në Komunën e Graçanicës për përfaqësim si një komunitet,*

    b. *Të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë të z. Milazim Gashi në mënyrë individuale në ushtrimin e votës dhe profesionit".*

19. Prandaj, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese, *"të bëjë interpretimin përfundimtar se a janë veprimet dhe mosveprimet e kryetarit të Komunës së Graçanicës në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës, konkretisht me nenet 62, 123, 124 dhe për rastin individual nenet 45 e 49 të Kushtetutës."*

20. Parashtruesi pretendon se *"kryetari i Komunës së Graçanicës, Bojan Stojanović, i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli, vazhdimisht prej se ushtron detyrën publike, me mosveprime dhe veprime të qëllimshme bën shkelje kushtetuese; sepse nuk procedon zgjedhjen e*

zëvendëskryetarit të Komunës, në këtë rast z. Milazim Gashit në pozitën që i takon me Kushtetutë si përfaqësues i komunitetit joshumicë të propozuar nga përfaqësuesi i komunitetit joshumicë në Asamblenë Komunale ."

21. Parashtruesi më tutje pretendon se *"Asambleja Komunale disa herë ka ngritur çështjen e moszgjidhjes së nënkryetarit të Komunës [...]"*.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata së pari i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."*

24. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton se:

> *1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar*
>
> *(...)*
>
> *7. "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

25. Për më tepër, Gjykata merr parasysh nenin 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit, i cili parasheh se:

> *1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

2. Individi mund ta ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

26. Për më tepër, Gjykata gjithashtu merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh se:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."

27. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (3.c) të Rregullores së punës, i cili parasheh se:

"(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur: c) kërkesa parashtrohet nga një palë e paautorizuar;"

28. Gjykata vëren se parashtruesi nuk e ka specifikuar asnjë akt të autoritetit publik (shih nenin 48 të Ligjit) që pretendohet t'i ketë shkelur të drejtat dhe liritë e tij individuale, të garantuara me Kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

29. Përveç kësaj, Kushtetuta nuk parasheh *actio popularis*, që është një modalitet i ankesës, çfarë u mundëson individëve, të iniciojnë shqyrtim abstrakt, pa marrë parasysh interesin e tyre specifik ligjor në rastin në fjalë.

30. Në fakt, neni 113.7 i Kushtetutës presupozon një shkelje individuale dhe të drejtpërdrejtë për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese si një mundësi e fundit për një shkelje të pretenduar nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive individuale, të garantuara me Kushtetutë.

31. Kjo konsideratë vërtetohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas së cilës, *"sistemi i peticioneve individuale ... përjashton parashtrimet me anë të actio popularis. Prandaj, ankesat duhet të sillen nga apo në emër të personave që pretendojnë se janë viktima të një apo më shumë shkeljeve të dispozitave të Konventës. Këta persona duhet të jenë në gjendje të tregojnë se janë "prekur drejtpërsëdrejti" nga masa e ankuar"* (shih p.sh. Aktgjykimi në rastin Ilhan kundër Turqisë, Nr. 22277/93, 27 qershor 2000, paragrafi 52).

32. Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar që të mund të referojë çështje kushtetuese *in abstracto* përkitazi me zgjedhjen ose moszgjedhjen e nënkryetarit të Komunës së Graçanicës, në mënyrë që të arrijë një mjet në emër të interesit kolektiv.

33. Prandaj, kërkesa është e papranueshme në bazën a lartpërmendur.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 dhe nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (3.c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 4 korrik 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe,

IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 27/13, Kadri Çitaku, datë 09 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 556 / 2011, të 28 shtator 2012

Rasti KI-27/13, Aktvendim për papranueshmëri i 14 qershorit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta për pension, e paafatshme.

Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës. Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, Gjykata supozon se objekt i çështjes është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, A. nr. 556 / 2011, i 28 shtatorit 2012, me të cilin është vërtetuar Aktvendimi i Ministrisë së Punës dhe i Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS)–Departamenti i Administratës Pensionale (në tekstin e mëtejmë: DAP), nr. 5097359, të 15 marsit 2011, me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës që t'i njihet e drejta për pension për personat me aftësi të kufizuar."

Parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Kushtetuese 49 faqe dokumentacion të ndryshëm, pjesa më e madhe e të cilit ka të bëjë me dokumentacionin lidhur me realizimin e së drejtës për pension për persona me aftësi të kufizuar.

Edhe përkundër njoftimit nr. ref. 713/13/rl, të 4 prillit 2013, të Gjykatës Kushtetuese, parashtruesi i kërkesës nuk e kishte plotësuar formularin dhe as nuk kishte cekur cilat nene të Kushtetutës dhe të drejta, të garantuara me Kushtetutë, i janë shkelur parashtruesit të kërkesës.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit Kadri Çitaku, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese konkludoi se kërkesa nuk është e pranueshme për shqyrtim, në pajtim me nenin 49 (Afatet) të Ligjit dhe rregullin 36 (1b) të Rregullores së punës, sepse kërkesa është dorëzuar pas afatit katër mujor, prej ditës kur vendimi për mjetin e fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI27/13
Parashtruesi
Kadri Çitaku
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 556/2011, të 28 shtatorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Kadri Çitaku nga fshati Gjurakoc, komuna e Istogut.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 556/2011, i 28 shtatorit 2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 16 tetor 2012.

Objekti i çështjes

3. Gjykata supozon në bazë të dokumenteve të paraqitura se objekt i çështjes është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 556/2011 të 28 shtatorit 2012, me të cilin është aprovuar Aktvendimi i Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS)– Departamentit të Administratës Pensionale (në tekstin e mëtejmë: DAP), nr. 5097359 të 15 marsit 2011, me të cilin është hedhur poshtë kërkesa e parashtruesit për t'iu njohur e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuara.

4. Parashtruesi i kërkesës nuk e ka plotësuar formularin e kërkesës të cilin ia ka dërguar Gjykata Kushtetuese nëpërmjet njoftimit nr. ref. 713/13/rl të 4 prillit 2013, e as nuk i ka cekur se cilat nene të Kushtetutës dhe cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur parashtruesit të kërkesës.

Baza juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenet 113.7 i 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7. dhe 22.8. të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Parashtruesi i kërkesës më 4 mars 2013, insistoi që Gjykata Kushtetuese të regjistrojë dhe të pranojë dokumentacionin të cilin parashtruesi e ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), edhe pse nga këshilltari ligjor është udhëzuar se duhet të plotësojë formularin e kërkesës dhe të tregojë se cilat nene të Kushtetutës dhe cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur parashtruesit të kërkesës.

7. Më 4 prill 2013, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës se Gjykata e ka regjistruar lëndën, ia dorëzoi parashtruesit formularin e kërkesës me kërkesë që ta plotësojë dhe ta dorëzojë në Gjykatë.

8. Më 14 maj 2013, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Supreme ta dorëzojë dokumentacion shtesë së bashku me dëshmitë se kur parashtruesi e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 556 / 2011 të 28 shatorit 2012.

9. Më 17 maj 2013, Gjykata Supreme të Kosovës e ka dorëzuar fletëkthesën në Gjykatën Kushtetuese, e cila dëshmon se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 556/2011 të 28 shtatorit 2012, më 16 tetor 2012.

10. Më 14 qershor 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (Kryesues), Almiro Rodrigues dhe Prof. Dr. Ivan Čukalović, i ka rekomanduar Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 4 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti te MPMS-DAP kërkesë për njohjen e të drejtës të parashtruesit të kërkesës për pension për persona me aftësi të kufizuara. MPMS-DAP me Vendimin nr. 5097359 të 4 shtatorit 2010, e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit, sepse nuk i plotëson kriteret për t'iu njohur e drejta në pension për aftësi të kufizuara.

12. Kundër Vendimit të MPMS-DAP nr. 5097359 të 4 shtatorit 2010, parashtruesi i kërkesës më 6 janar 2011, paraqiti ankesë në MPMS-DAP – Këshillit për ankesa dhe pensione për persona me aftësi të kufizuara, i cili, duke vendosur sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës, me Aktvendimin nr. 5097359 të 15 marsit 2011 e ka refuzuar ankesën e 6 janarit 2011, për njohjen e të drejtës për pension për persona me aftësi kufizuara, si të pabazuar dhe e ka vërtetuar vendimin e Komisionit mjekësor të shkallës së parë, si plotësisht të bazuar në përputhje me Ligjin nr. 2003/23.

13. Kundër Aktvendimit të MPMS–DAP– Këshillit për ankesa dhe pensione për persona me aftësi të kufizuara nr. 5097359 të 15 marsit 2011, parashtruesi i kërkesës ushtron padi në Gjykatën Supreme të Kosovës.

14. Duke vendosur sipas padisë së parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin A. nr. 556/2011, të 28 shtatorit 2012, e hedh poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës me këtë arsyetim:

> *"Në procedurën sipas ankesës, organi i paditur siguroi konstatimin dhe mendimin e komisionit mjekësor të të padituës nr. 5097359, dt. 25.02.2011, për vlerësimin e Komisionit mjekësor të personave me aftësi të kufizuara, organit të faktit, i cili përputhet me konstatimin dhe mendimin e komisioneve mjekësore të dhëna më parë, prandaj edhe me vendimin e kundërshtuar e refuzoi si të pabazuar ankesën e paditësit dhe vërtetoi vendimin e atakuar."*
>
> *"Duke pasur parasysh se komisionet mjekësore të autorizuara me ligj, kanë vërtetuar se te paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar për punë, Gjykata konstaton se organet administrative kanë zbatuar drejt dispozitën e nenit 3 të Ligjit të cekur më lart, në bazë të të cilit edhe është refuzuar kërkesa e paditësit që t'i njihet e drejta për pension invalidor."*

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi i kërkesës ia ka dorëzuar Gjykatës Kushtetuese 49 faqe të dokumenteve të ndryshme, numri më i madh i të cilave ka të bëjë me dokumentacionin në lidhje me realizimin e së drejtës për pension për persona me aftësi të kufizuara.

16. Parashtruesi i kërkesës pavarësisht nga njoftimi me shkrim nr. ref. 713/13/rl të 4 prillit 2013 të Gjykatës Kushtetuese, nuk e ka plotësuar formularin dhe as që i ka cekur se cilat nene të Kushtetutës dhe cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur parashtruesit të kërkesës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të qenë në gjendje për të gjykuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kërkesat për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë dhe Ligj.

18. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese i referohet nenit 49 (Afatet) të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të llogaritet në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të llogaritet që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.".*

19. Gjykata vëren se nga dokumentacioni shtesë të cilin e ka dorëzuar Gjykata Supreme e Kosovës, është konstatuar se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 556/2011 të 28 shtatorit 2012, më 16 tetor 2012, kur parashtruesi i kërkesës e ka nënshkruar fletëkthesën.

20. Vendimi përfundimtar i Gjykatës Supreme të Kosovës i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 16 tetor 2012, ndërsa parashtruesi i kërkesës më 4 mars 2013 e paraqiti parashtresën në Sekretariatin e Gjykatës Kushtetuese.

21. Nga kjo rrjedh se kërkesa nuk është e pranueshme për shqyrtim në pajtim me nenin 49 (Afatet) të Ligjit dhe rregullit 36 (1b) të Rregullores së punës, i cili parasheh: *„Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm*

nëse b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit parashtruesit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv".

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 korrik 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 29/13, Feriha Hoti, datë 09 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Mlc. nr. 12/2009, të 14 majit 2012

Rasti KI 29/13, Aktvendim për papranueshmëri i 4 korrikut 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme, kërkesë papranueshme, mbrojtja e pronës, mbrojtja gjyqësore e të drejtave.

Kërkesa bazohet në Nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës. Parashtruesja, ndër të tjera, pohoi se ishin shkelur e drejta në pronë dhe drejta në mbrojtje gjyqësore.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrueses ishte dorëzuar pas afatit ligjor katër mujor. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtrueses si të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI29/13
Parashtrues
Feriha Hoti
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Mlc.nr. 12/2009, të 14 majit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues është Feriha Hoti, e përfaqësuar nga Merita Limani nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Mlc.nr. 12/2009 të 14 majit 2012. Data kur vendimi i është dorëzuar parashtruesit është e panjohur.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është ankesa e parashtruesit se Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të

paraqitur nga prokurori publik, mori vendim që t'i anulojë vendimet e gjykatave më të ulëta, të cilat ishin të favorshme për parashtruesin.

Procedura në Gjykatë

5. Më 6 mars 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 22 mars 2013, Kryetari caktoi Gjyqtarin Robert Carolan si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

7. Më 3 prill 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme të Kosovës në lidhje me regjistrimin e kërkesës.

8. Më 10 prill 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesi të dorëzojë dëshminë e pranimit të aktgjykimit të Gjykatës Supreme.

9. Më 17 prill 2013, parashtruesi iu përgjigj Gjykatës.

10. Më 19 prill 2013, Gjykata e njoftoi Gjykatën Komunale në Prishtinë në lidhje me regjistrimin e kërkesës, dhe të njëjtën kohë kërkoi nga ajo të parashtrojë dëshmi në lidhje me dorëzimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme parashtruesit.

11. Më 19 qershor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Historiku i kërkesës

12. Më 21 janar 2010, parashtruesi kishte lidhur një kontratë mbi dhurimin me M.SH., në të cilën M.SH. ishte dhuratëdhënës dhe parashtruesi dhuratëmarrës. Patundshmëria, e regjistruar si ngastër kadastrale P-71813068 – 01396-7, me sipërfaqe prej 183 m² fleta poseduese nr. UL – 71813068 – 13487 ZK Prizren, i jepet parashtruesit. Kontrata për dhuratë ishte legalizuar në Gjykatën Komunale në Prizren.

13. Sidoqoftë, dhuratëdhënësi M.SH. ishte i përfshirë në një kontest pronësor me palë të treta në lidhje me patundshmërinë, të cilën ia kishte dhënë parashtruesit. Kontesti pronësor ishte zgjidhur në procedurë gjyqësore nga Gjykata Supreme e Kosovës, pas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga prokurori publik.

14. Parashtruesi si dhuratëmarrës i pronës së kontestuar, vendosi të parashtrojë kërkesë në Gjykatë.

Përmbledhje e fakteve siç dëshmohet nga dokumentet e paraqitura nga parashtruesi

15. Më 13 maj 2008, Gjykata Komunale në Prizren me Aktgjykimin C.nr. 772/07 vendosi se M.SH. ka të drejtë në përdorimin e tokës kontestuese ndërtimore dhe në të njëjtën kohë hodhi poshtë pretendimet e kundërpaditësve dhe i detyroi ata që të pranojnë kushtet e përcaktuara në aktgjykimin e përmendur.

16. Më 13 shkurt 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin Ac.nr. 438/2008, e vërtetoi Aktgjykimin C.nr. 772/07 të Gjykatës Komunale në Prizren.

17. Më 14 maj 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Mlc.nr. 12/2009, e pranoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga prokurori publik, duke i hedhur poshtë aktgjykimet e kundërshtuara të Gjykatës Komunale dhe të Qarkut të Prizrenit, dhe njëkohësisht refuzoi kërkesëpadinë e M.SH. dhe aprovoi kërkesëpadinë e kundërpaditësve për tokën e kontestuar ndërtimore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi pretendon se vendimi i Gjykatës Supreme është karakterizuar me konflikt të interesi dhe ka qenë i ndikuar nga A.S., "*që është pjesë e institucioneve gjyqësore dhe ka shkaktuar pabarazi juridike, e cila ka ndikuar te Kolegji i Gjykatës Supreme në vendimin e saj.*"

19. Parashtruesi pretendon shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

21. Në lidhje me kërkesën e parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të llogaritet në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të llogaritet që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.

22. Nga parashtresat mund të shihet se kërkesa është dorëzuar më 6 mars 2013, dhe se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është nxjerrë më 14 maj 2012. Kërkesa është dorëzuar pas afatit katër (4) mujor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

23. Gjykata kërkoi nga parashtruesi të paraqesë dëshminë e pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, në çka ajo u përgjigj:

"...Ju njoftoj se vendimi Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës i është dorëzuar vëllait tim, M.SH., i cili ma ka dorëzuar vendimin pas një kohe të gjatë".

24. Bazuar në përgjigjen e lartpërmendur, parashtruesi nuk mundi të dëshmojë para kësaj gjykate se kërkesa ishte parashtruar në afatin e paraparë sipas nenit 49 të Ligjit.

25. Rezulton se kërkesa është e paafatshme.

26. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak të mospërputhjes me afatin e përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe nenin 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 4 korrik 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 45/13, Jasmine Baxhaku, datë 09 korrik 2013- Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ac. nr. 65/2012, të 29 tetorit 2012

Rasti KI45/13, Aktvendim për papranueshmëri i 19 qershorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kontest civil, e drejta për gjykim të drejtë, e drejta për një proces të rregullt, kërkesa qartazi e pabazuar

Parashtruesja pretendonte se Gjykata e Qarkut në Prizren dhe Gjykata Supreme ia kishin shkelur asaj të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 6 dhe 14 të KEDNJ-së. Parashtruesja në Gjykatën Kushtetuese ankohej për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Në ketë rast, Gjykata gjeti se, parashtruesja nuk kishte argumentuar, si dhe pse, Gjykata Supreme ia kishte shkelur asaj të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Asnjë pretendim i ngritur mbi bazën e kushtetutshmërisë nuk ishte bërë nga parashtruesja, qoftë në mënyrë implicite, qoftë në substancë, që do mbështeste shkeljen e pretenduar të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare. Në tërësi, Gjykata gjeti se kërkesa e parashtrueses nuk i përmbushte kërkesat e kërkuara me rregullin 36 (1) c) dhe 36 (2) a) dhe d) të Rregullores së punës, dhe si të tillë, Gjykata e deklaroi kërkesën të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin Nr. KI45/13
Parashtrues
Znj. Jasmine Baxhaku
Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ac. nr. 65/2012, të 29 tetorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Jasmine Baxhaku nga Dragashi, me vendbanim në Prishtinë (parashtruesja).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Ac. nr. 65/2012, të 29 tetorit 2012, të cilin parashtruesja e ka pranuar më 19 nëntor 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ac. nr. 65/2012 të 29 tetorit 2012, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat kushtetuese të parashtrueses të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit] të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta); neni 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe në rregullin 28 dhe 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 mars 2013, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

6. Më 25 mars 2013, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesja e kërkesës që ta kompletonte kërkesën e saj.

7. Më 16 prill 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin: Almiro Rodrigues, si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 8 maj 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe e informoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 17 qershor 2013, Kryetari zëvendësoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi, si anëtare të Kolegjit shqyrtues, me Prof. dr. Enver Hasanin.

10. Më 19 qershor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 8 maj 2012, bashkëshorti i parashtrueses paraqiti padi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër parashtrueses për zgjidhjen e martesës, të lidhur më 7 korrik 2010.

12. Më 12 korrik 2012, parashtruesja iu përgjigj padisë, duke e kontestuar kërkesën e paditësit për zgjidhjen e martesës, për faktin se ata asnjëherë nuk kishin diskutuar për shkëputjen e saj.

13. Më 15 maj 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktvendimi, C. nr. 1003/2012) sipas kërkesës së parashtrueses (pala e mbrojtur) lëshoi një "urdhër për mbrojtje" duke e ndaluar bashkëshortin të ushtrojë çfarëdo lloj kërcënimi ose dhune familjare kundër parashtrueses dhe e urdhëroi atë që ta lejojë parashtruesen t'i marrë gjërat e saj personale në shtëpi.

14. Më 27 korrik 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktgjykimi, C. nr. 125/12) mori vendim për "zgjidhjen me shkurorëzim" të martesës ndërmjet ndërgjyqësve dhe e detyroi parashtruesen t'i kompensojë shpenzimet e procedurës. Gjykata e arsyeton vendimin e saj si më poshtë:

> *"Prandaj, Gjykata konsideron që një martesë mund të ekzistojë vetëm në rastet kur në mes të bashkëshortëve ekziston dashuria, respekti reciprok, jeta e përbashkët dhe dëshira që të jetohet në bashkësi martesore, mirëpo, në rastin konkret këto elemente nuk qëndrojnë, e kjo arsyeton që martesa në fjalë duhet të zgjidhet, ngase nuk është në interes as të bashkëshortëve, e as të shoqërisë që martesa të ekzistojë vetëm në librat e organeve kompetente derisa e njëjta në realitet nuk ekziston. Gjykata nuk e pranoi propozimin e të autorizuarit të të paditurës që të dëgjohet në cilësi të palës edhe paditësi, kjo për arsye se paditësi është me punë në Austri dhe nuk është provuar me asnjë provë se ai është në Prizren, pasi që në pyetjen e Gjykatës se paditësi ka qenë në javën e fundit në Kosovë, e paditura është përgjigjur se nuk ka qenë dhe në të njëjtën kohë Gjykata konsideron se mjafton vetëm të dëgjohet njëra palë ndërgjyqëse. Vetë fakti se e paditura në mënyrë të qartë ka sqaruar raportet e çrregulluara martesore në aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Komunale në Prishtinë, është e mjaftueshme për këtë gjykatë, për të përfunduar se raportet e bashkëshortëve janë çrregulluar seriozisht dhe kanë marrë karakter të përhershëm, dhe se qëllimi i vetëm i këtij propozimi është që të shtyhet, përkatësisht të prolongohet zgjidhja e kësaj martese, e jo se nuk janë çrregulluar raportet në mes të palëve ndërgjyqëse".*

15. Më 22 gusht 2012, parashtruesja ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren.

16. Më 29 tetor 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Ac. nr. 65/2012), e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren C. nr. 125/2012 të 27 korrikut 2012. Gjykata Supreme arsyetoi se gjykata e instancës së parë "*në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka vlerësuar provat e administruara në kuptim të nenin 8 te LPK-së, nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Gjykata e shkallës së parë ka zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale neni 69 pika 1 dhe 2 të Ligjit mbi familjen, kur ka zgjidhur martesën e ndërgjyqësve, duke gjetur se martesa në mes ndërgjyqësve e ka humbur qëllimin e ekzistimit të saj. Martesa duhet të mbahet vetëm kur*

ekziston dashuria e ndërsjellë e bashkëshortëve, e cila shfaqet edhe me një bashkëjetesë të harmonishme të tyre dhe nuk mjafton për ruajtjen e saj dëshira e njërit bashkëshort".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata e Qarkut në Prizren dhe Gjykata Supreme ia kanë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 6 dhe 14 të KEDNJ-së.

18. Parashtruesja ankohet në Gjykatën Kushtetuese "për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale."

19. Parashtruesja kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të detyrojë bashkëshortin të paguajë një dëmshpërblim në vlerë prej 15.000 eurosh, si pagim për gjërat e saj personale dhe të familjes së saj, të cilat nuk e kanë lejuar atë që t'i marrë ato, si dhe dëmshpërblimin për vitet e humbura, ndërprerjen e shkollës dhe traumave psikologjike, duke marrë parasysh që vetëm paditësi ka kërkuar shkurorëzimin dhe jo ajo.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata vlerëson se nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e parapara për pranueshmëri, të cilat janë të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (1) dhe (7) *që përcakton se:*

> *1. "Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar."*
> *[...]*
> *7. "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

22. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit i cili parasheh se:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij/saj të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë*

cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

23. Për më tepër, rregulli 36 (1) c) dhe (2) a) dhe d) i Rregullores së punës parasheh që:

(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
[...]
c) Kërkesa është qartazi e bazuar.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
a) Kërkesa nuk arsyetohet prima facie;
[...]
d) Kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

24. Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesja e kërkesës nuk paraqet asnjë argument dhe provë si dhe pse Gjykata Supreme ia ka shkelur asaj të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Asnjë pretendim i ngritur mbi bazën e kushtetutshmërisë nuk është bërë nga parashtruesja, qoftë në mënyrë implicite qoftë në substancë, që do mbështeste shkeljen e pretenduar të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare.

25. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesja ushtroi ankesë mbi baza të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

26. Gjykata konsideron se këto pretendime janë të fushës së ligjshmërisë, të cilat bien nën juridiksion të gjykatave të rregullta.

27. Për më tepër, Gjykata rikujton se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të trajtojë gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përderisa ato nuk i shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

28. Ndërkohë, parashtruesja nuk ka shpjeguar pse dhe si i janë shkelur të drejtat e saj kushtetuese; ajo nuk e mbështet *prima facie* kërkesën e saj në baza kushtetuese dhe nuk ofron prova që tregojnë se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e saj, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme. Në

fakt, parashtruesja nuk e ka mbështetur dhe dëshmuar pretendimin në baza kushtetuese.

29. Kështu, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e marra nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse si të së drejtës procedurale dhe atë të së drejtës materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

30. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse të Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis,* Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

31. Prandaj, Gjykata gjen se, parashtruesja e kërkesës as nuk e ka ndërtuar, e as nuk ka dëshmuar një rast *prima facie,* qoftë mbi bazën e meritave apo pranueshmërisë së kërkesës.

32. Në tërësi, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtrueses, në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe 2) a) dhe d) të Rregullores së punës është qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) dhe 36 (1) c) dhe 2) a) dhe d) të Rregullores së punës, më 4 korrik 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 56/13, Jashar Avdullahi, datë 09 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 5/2013, të 4 marsit 2013

Rasti KI-56/13, Aktvendim për papranueshmëri i 20 qershorit 2013.

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, qartazi e pabazuar, masë e përkohshme, dënim me burg, vepër penale.

Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 5/2013, të 4 marsit 2013. Parashtruesi i kërkesës konsideroi se *"me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, në procedurën e mbrojtjes së ligjshmërisë si dhe në aktgjykimet e lartpërmendura në procedurën gjyqësore, janë shkelur të drejtat për gjykim të ndershëm, të paanshëm dhe të barabartë."*

Në të njëjtën kohë, ka kërkuar vendosjen e masës së përkohshme, duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 vjet e 6 muaj dhe në çdo moment mund të ftohet për vuajtjen e dënimit, konsideron se deri në vendosjen lidhur me kërkesën në fjalë mund caktohet masa e përkohshme e propozuar, për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burg, në mënyrë që të evitohet dëmi i pariparueshëm nëse kërkesa bazë do të ketë sukses."

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit Jashar Avdullahi, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese, nga shkresat e lëndës konstatoi se Gjykata e Qarkut në Gjilan, me Aktgjykimin P. nr. 138/2011, të 24 shkurt 2012, ka dhënë arsyetim të hollësishëm se pse disa prova i ka pranuar dhe pse disa prova i ka refuzuar, si dhe në bazë të cilës gjendje faktike ka ardhur në përfundim se parashtruesi i kërkesës ka kryer vepër penale, duke marrë parasysh me këtë rast rrethanat rënduese, por edhe ato lehtësuese në shqiptimin e aktgjykimit.

Në bazë të asaj që u cek më lart, Gjykata Kushtetuese nuk ka konstatuar se procedurat përkatëse, në ndonjë mënyrë kanë qenë të padrejta ose arbitrare. Prandaj, Gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.

Në të njëjtën kohë, Gjykata e ka refuzuar kërkesën e parashtruesit për masë të përkohshme, me arsyetim se i njëjti nuk ka dorëzuar asnjë provë bindëse, e cila do ta justifikonte caktim e masës së përkohshme, si të nevojshme për t'u

shmangur ndonjë dëm i pariparueshëm, ose provë se një masë e tillë është në interesin publik.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI56/13
Parashtrues
Jashar Avdullahi
Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 5/2013, të 4 marsit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Jashar Avdullahi nga Gjilani, të cilin në Gjykatën Kushtetuese e përfaqëson avokati Halim Sylejmani nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Pkl. nr. 5/2013 i 4 marsit 2013, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruesit të kërkesës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P. nr. 138/2011, të 24 prillit 2012 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap. nr. 197/2012, të 7 nëntorit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është procedura penale me të cilën parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor për vepër penale të rrezikimit të komunikacionit publik, nga neni 297, paragrafi 5, lidhur me paragrafin 3 dhe 1 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë KPK) dhe është dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në kohëzgjatje prej 3

(tri) vjet e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të ankesës *"...është vënë në pozitë të pabarabartë vetëm nga fakti se nga fatkeqësia e përmendur e komunikacionit ka kaluar pa pasoja, ndërsa pjesëmarrësi tjetër ka përfunduar me pasoja fatale për të dhe bashkudhëtarët."*

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56, paragrafi 2 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Parashtruesi i kërkesës, më 17 prill 2013, ia ka parashtruar kërkesën Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin mëtejmë: Gjykata), duke kërkuar njëkohësisht caktimin e masës së përkohshme me arsyetimin:

> *"Duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 vjet e 6 muaj dhe në çdo moment mund të ftohet për vuajtjen e dënimit, konsideron se deri në vendosjen lidhur me kërkesën në fjalë, mund të caktohet masa e përkohshme e propozuar, për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burg, në mënyrë që të evitohet dëmi i paripareshëm, nëse kërkesa bazë do të ketë sukses."*

6. Më 20 maj 2013, Gjykata Kushtetuese e ka njoftuar parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme, se e ka filluar procedurën e shqyrtimit të kushtetutshmërisë në rastin nr. KI-56/13.

7. Më 20 qershor 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Robert Carolan, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Më 8 maj 2009, Prokuroria Publike e Qarkut në Gjilan, me aktakuzën PP. nr. 49/2009, e ka akuzuar parashtruesin e kërkesës, Jashar Abdullahi nga Gjilani, për kryerje të veprës penale të rrezikimit të

trafikut publik, nga neni 297, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 dhe 1 të KPK-së.

9. Me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P. nr. 102/9, të 20 janarit 2010, është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të rrezikimit të trafikut publik, nga neni 297, paragrafi 5, lidhur me paragrafin 3 dhe 1 të LPK-së dhe është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh.

10. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P. nr. 102/2009, të 20 janarit 2010, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur ankesë, e cila është aprovuar pjesërisht nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës, me Aktvendimin Ap. nr. 148/2010, të 5 majit 2011, me të cilin pjesërisht është anuluar aktgjykimi i lartpërmendur dhe lënda i është kthyer Gjykatës së Qarkut për rigjykim.

11. Në procedurën e përsëritur, me respektimin e plotë të rekomandimeve të Gjykatës Supreme, të cekura në Aktvendimin Ap. nr. 148/2010, të datës 5 maj 2011, si dhe me arsyetim të hollësishëm të të gjitha çështjeve kontestuese, Gjykata e Qarkut në Gjilan, me Aktgjykimin P.nr. 138/2011, të datës 24 shkurt 2012, e ka shpallur fajtor parashtruesin e kërkesës, Jashar Abdullahi dhe e ka dënuar me dënim burgimi prej 3 (tri) vjet e 6 (gjashtë) muaj.

12. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P. nr. 138/2011, të datës 24 shkurt 2012, parashtruesi i kërkesës dhe prokurori publik i Qarkut në Gjilan kanë ushtruar ankesa, të cilat janë refuzuar si të pabaza me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 197/2012, të datës 7 nëntor 2012 dhe është vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P. nr. 138/2011, i 24 shkurtit 2012.

13. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 197/2012, të 7 nëntorit 2012, parashtruesi i kërkesës i ka paraqitur Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

14. Duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin Pkl. nr. 5/2013, të datës 4 maj 2013, e ka refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar, me arsyetimin:

> *"Mbrojtësi, edhe pse e konteston aktgjykimin për shkelje të Kodit Penal dhe shkelje të Kodit të Procedurës Penale, në dëm të të dënuarit, në esencë e konteston gjendjen e konstatuar faktike, duke pohuar se i dënuari nuk e ka bërë veprën penale për të cilën*

është dënuar. Mbrojtësi pohon se në aktgjykim nuk janë vlerësuar veprimet e, tani të ndjerit J. S., i cili, sipas pohimeve të mbrojtësit, vetë e ka shkaktuar fatkeqësinë, duke e drejtuar automjetin e tij me shpejtësi të madhe prej 104 km në orë, ndërsa i dënuari e ka drejtuar automjetin e tij me shpejtësi prej 75 km në orë, prandaj, sipas mendimit të mbrojtësit, përgjegjës i vetëm për fatkeqësinë ka qenë tani i ndjeri. Aq më tepër, sipas pohimeve të mbrojtësit, janë shkelur edhe dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, duke pasur parasysh se mungon vlerësimi i provave kundërthënëse, fare nuk është vlerësuar mendimi i ekspertit M. H. dhe në këtë mënyrë është shkelur dispozita e nenit 185 e KPPK-së."

"Pohimet e mbrojtësit të të dënuarit Jashar Abdullahi, kanë të bëjnë me gjendjen faktike, që nuk mund të jetë lëndë shqyrtimi, me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, si mjet i jashtëzakonshëm juridik, sepse në pikëpamje të gjendjes faktike nuk ka mbetur asnjë dyshim për asnjë rrethanë. I dënuari Jashar Abdullahi ka bërë tejkalimin e automjetit tjetër, në kundërshtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për siguri në komunikacionin rrugor, duke shkaktuar pasojë të ndaluar, në të cilën e kanë humbur jetën J. S. dhe T. S., ndërsa B. S. dhe M. T. kanë pësuar lëndime të rënda trupore. Thënia e aktgjykimit përmban përshkrimin faktik të veprimeve të palejueshme të të dënuarit Jashar Abdullahi, i cili i ka ndërmarrë duke shkelur dispozitat ligjore. Arsyetimet e aktgjykimeve të kontestuara përmbajnë fakte të nevojshme dhe arsye juridike për faktet esenciale, si dhe vlerësimin e domosdoshëm dhe ligjor të provave. Gjykata e ka vlerësuar ekspertizën e ekspertit I. B. dhe të grupit të ekspertëve të Fakultetit Teknik, të cilët Gjykata i ka autorizuar për kryerjen e ekspertizës, ndërsa ekspertiza e M.H. është bërë në bazë të angazhimit të mbrojtësit të të dënuarit dhe si e tillë nuk ka qenë lëndë vlerësimi."

"Lidhur me shkeljen e Kodit Penal, mbrojtësi i të dënuarit pohon se nuk është konstatuar se i dënuari ka bërë veprime të palejueshme, prandaj, nuk ka pasur vend që të shpallet fajtor dhe gjykatat me aktgjykime, përkundër kësaj, pa bazë e kanë shpallur fajtor dhe e kanë dënuar. Në bazë të gjendjes, në mënyrë të drejtë dhe të plotë është konstatuar mënyra faktike, kjo gjykatë vlerëson se Kodi Penal është zbatuar në mënyrë të drejtë kur gjykata e shkallës së parë e ka shpallur fajtor për vepër penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 297, paragrafi 5, lidhur me paragrafin 3 dhe 1 të KPK, ndërsa këtë e ka vërtetuar edhe

Gjykata Supreme e Kosovës, prandaj, në mënyrë të pabazuar kontestohen aktgjykimet e të dy gjykatave, me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë."

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi i kërkesës konsideron *"se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, në procedurën e mbrojtjes së ligjshmërisë si dhe në aktgjykimet e lartpërmendura në procedurën gjyqësore, janë shkelur të drejtat për gjykim të ndershëm, të paanshëm dhe të barabartë me pjesëmarrësin tjetër në fatkeqësinë e përmendur të komunikacionit."*

16. Prandaj, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës *"qëllimisht apo rastësisht, parashtruesi i kërkesës është vënë në pozitë të pabarabartë, vetëm nga fakti se në fatkeqësinë e përmendur të komunikacionit ka kaluar pa pasoja, ndërsa pjesëmarrësi tjetër ka përfunduar me pasoja fatale për të dhe bashkudhëtarët."*

17. Parashtruesi i kërkesës konsideron se *"janë shkelur dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për garantimin e barazisë dhe të paanshmërisë së pjesëmarrësve në procedurat e zbatuara ligjore, si dhe në dispozitat ligjore për emërim dhe zgjedhje të gjyqtarëve."*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon *"se dispozitat e shkelura të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për garantimin e barazisë dhe të paanshmërisë së pjesëmarrësve në procedurat e zbatuara ligjore, si dhe në dispozitat ligjore për emërim dhe zgjedhje të gjyqtarëve",* janë bazë për parashtresën e tij.

19. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë parashtresën e parashtruesit të kërkesës, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.

20. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij që qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë

cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik, të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

21. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë apeli, kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë ligjin dhe t'i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis,* Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

22. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë provë *prima facie,* e cila tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës Sllovake, vendimi i GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, të datës 31 maj 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk përmend se në cilat nene të Kushtetutës mbështetet kërkesa e tij, siç është paraparë në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 48 të Ligjit.

23. Parashtruesi i kërkesës pohon *"se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, në procedurën e mbrojtjes së ligjshmërisë, si dhe me aktgjykimet e lartpërmendura në procedurën gjyqësore, i janë shkelur të drejtat për gjykim të ndershëm, të paanshëm dhe të barabartë..."*

24. Nga shkresat e lëndës shihet qartë se Gjykata e Qarkut në Gjilan, me Aktgjykimin P. nr. 138/2011, të datës 24 shkurt 2012, ka dhënë arsyetim të hollësishëm se pse disa prova i ka pranuar dhe pse disa prova i ka refuzuar, si dhe në bazë të cilës gjendje faktike ka ardhur në përfundim se parashtruesi i kërkesës ka kryer vepër penale, duke marrë parasysh me këtë rast rrethanat rënduese, por edhe ato lehtësuese në shqiptimin e aktgjykimit.

25. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P.nr. 138/2011, i 24 shkurtit 2012, në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 197/2012, të 7 nëntorit 2012, si dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 5/2013, të 4 majit 2013, me arsyetime të hollësishme të të gjitha pretendimeve të ankesave të parashtruesit të kërkesës.

26. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta për ta paraqitur rastin e tij dhe për ta kontestuar interpretimin të ligjit, për të cilin konsideron se është i pasaktë, në Gjykatën e Qarkut në Gjilan dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka konstatuar se procedurat përkatëse, në ndonjë mënyrë kanë qenë të padrejta ose arbitrare (shih, *mutatis*

mutandis, Shub kundër Lituanisë, vendimi i GJEDNJ-së lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06 të 30 qershorit 2009).

27. Në fund, kriteret për pranueshmëri në këtë kërkesë nuk janë përmbushur. Ai nuk ka arritur që të cekë dhe të mbështesë me prova pretendimin se me aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.

28. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, i cili parasheh: *"Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese."*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 paragrafi 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2.b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 korrik 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafin 4 të Ligjit; dhe,

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. dr. Enver Hasani

KI 107/12, Jovica Đorđević, datë 09 korrik 2013- Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Gž.nr.1490-2011, të 26 qershorit 2012

Lënda 107/12, Aktvendim për papranueshmëri i 19 qershorit 2013

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës së Qarkut

Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në bazë të neneve 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, neneve 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009.

Më 29 tetor 2012, parashtruesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, me ç'rast kërkoi nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

Parashtruesi i kërkesës pohon se me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut i janë shkelur të drejtat pronësore sipas nenit 46 (Mbrojtja e Pronës) si dhe të nenit 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës së Kosovës.

Me Vendimin e Kryetarit, nr. GJR. KI 107/12, të 6 dhjetorit 2012, u caktua gjyqtari Kadri Kryeziu si Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit, KSH 107/12, u caktua Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Prof. dr. Enver Hasani.

Gjatë shqyrtimit të rastit, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me nenin 113.7 të Kushtetutës.

Duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në seancën e mbajtur më 19 qershor 2013, e shpalli kërkesën të papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
Rastin nr. KI107/12
Parashtruesi
Jovica Đorđević
Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Gž.nr.1490-2011, të 26 qershorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përberë nga:

Enver Hasani, Kryetar,
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Jovica Gjorgjeviq, nga fshati Kolevicë, Komuna e Prishtinës, (në tekstin vijues "parashtruesi i kërkesës"), të cilin e përfaqëson avokati Zhivojin Jokanoviqi nga Prishtina.

Vendim i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston aktvendimin e formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Gž. nr. 1490-2011, të datës 26 qershor 2012, i cili parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar më 19 korrik 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës së paraqitur në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin vijues: "Gjykata"), më 29 tetor 2012, është vërtetimi i të drejtës së pronës në katër (4) ngastra, të cilat janë objekt i kontratës së lidhur, më 29 dhjetor 1998.

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenet 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin vijues: "Kushtetuta"), nenin 21.4, nenet 20, 22.7 dhe

22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 15 janar 2009 (në tekstin vijues: "Ligji") dhe rregullin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin vijues: "Rregullorja e Punës").

Procedura në Gjykatë

5. Më datën 29 tetor 2012, parashtruesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, e cila është regjistruar me shenjën KI 107/12.

6. Më 6 dhjetor 2012, Kryetari e ka emëruar gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues dhe Kolegjin për Shqyrtim, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe prof. dr. Enver Hasani.

7. Më 1 mars 2013, Gjykata Kushtetuese e ka njoftuar parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë se kërkesa e parashtruesit është regjistruar me shenjën KI 107/12.

8. Më 14 maj 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji Shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve (Procedura në gjykatat e rregullta)

9. Më 29 dhjetor 1998, tani i ndjeri ZH.GJ., nga fshati Kolevicë, Komuna e Prishtinës, ka lidhur kontratë për ndërrimin e tokës me Kuvendin e Qytetit të Prishtinës.

10. Me atë kontratë, ZH.GJ., ia ka lëshuar qytetit të Prishtinës 4 (katër) ngastra të tij me sipërfaqe të përgjithshme prej 1,58.86 ha, me ç'rast nga qyteti i Prishtinës dhe Kombinati Bujqësor Industrial në Fushë Kosovë (në tekstin vijues: "KBI-Fushë Kosovë") i ka marrë 4 (katër) ngastra, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1,52.15 ha.

11. Në ndërkohë, Komuna e Prishtinës dhe KBI - Fushë Kosova, përkatësisht trashëgimtari juridik - Agjencisë të Privatizimit të Kosovës, e kontestojnë validitetin e kësaj kontrate.

12. Më 20 nëntor 2006, parashtruesi i kërkesës i cili është trashëgimtar juridik i të ndjerit ZH.GJ., ka paraqitur padi civile në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër Komunës së Prishtinës dhe KBI- Fushë Kosovës, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e të drejtës pronësore për 4 (katër) ngastrat që janë lëndë e kontratës [Vr. nr. 4149], nga data 29 dhjetor 1998.

13. Më 1 nëntor 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë e ka miratuar kërkespadinë e parashtruesit dhe ka marrë aktvendim [P. nr. 226/06], me të cilin e ka vërtetuar të drejtën pronësore të parashtruesit të kërkesës.

14. Gjatë kohës së zhvillimit të procedurës në Gjykatën Komunale, e paditura, Agjencia e Privatizimit i ka tjetërsuar 3 (tri) parcela (dita e tjetërsimit të parcelave nuk gjendet në shkresat e lëndës), të cilat janë objekt i këtij kontesti sipas nenit 5.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (shih paragrafin 30).

15. Në datë të panjohur, e paditura paraqet ankesë ndaj aktgjykimit të Gjykatës Komunale [P.nr. 2264/06] të datës 1 tetor 2007.

16. Më 21 maj 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxjerrë aktgjykimin [Gž. (Ac) nr. 181/2008], me të cilin pjesërisht e vërteton aktgjykimin e Gjykatës Komunale [P.nr. 2264/06] të datës 1 tetor 2007. Në aktgjykim Gjykata ka vërtetuar të drejtën pronësore të parashtruesit vetëm për një ngastër, nr.1811 prej 0,62.46 ha, ndërsa për tri (3) ngastra të tjera aktgjykimi është shfuqizuar dhe lënda i është kthyer Gjykatës Komunale për rivendosje.

17. Gjatë kohës së procedurës ankimore në Gjykatën e Qarkut, Agjencia e Privatizimit, në bazë të të njëjtit nen 5.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 e ka tjetërsuar edhe ngastrën nr. 1811, e cila i është dhënë paditësit (parashtruesit të kësaj kërkese), me aktgjykimin [Gž. (Ac) nr. 181/2008], ashtu që ekzekutimi nuk ka mundur të bëhet as për ngastrën nr. 1811.

18. Më 4 maj 2009, lidhur me kundërshtimin e Agjencisë të Privatizimit, Gjykata Komunale, me aktvendimin [P.nr. 1144/08] shpallet realisht jo kompetente për këtë çështje juridike. Gjykata në aktvendim thekson "se vetëm Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është kompetente për zgjidhjen e këtij kontesti pronësor-juridik dhe se procedura e vërtetimit të së drejtës pronësore për 4 (katër) ngastrat që janë lëndë e kontratës [Vr.nr. 4149 të datës 29], ka kaluar në kompetencë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në të cilën do të zhvillohet procedura, me shenjën e lëndës SCC-09-0225."

Procedura lidhur me kërkesën për ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut [Gž. (Ac) Nr. 181/2008]

19. Në datë të panjohur të vitit 2009, parashtruesi i kërkesës ia ka paraqitur Gjykatës Komunale kërkesën për aplikimin e masës së sigurisë së ekzekutimi të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut [Gž. (Ac)nr.181/2008], të datës 21 maj 2008, në dispozitivin e të cilit është përfshirë vetëm ngastra nr.1811.

20. Parashtruesi i kërkesës kërkon që sipas ligjit të atëhershëm në fuqi, me aktvendim të caktohet masa e përkohshme për një ngastër tjetër nr.1831 ZK Prishtinë, e cila është në pronësi të të paditurës, në sipërfaqe prej 0,62.46 ha dhe palëve të paditura tu ndalohet tjetërsimi apo ngarkimi i pjesës së përmendur të ngastrës, me qëllim të sigurimit të saj deri në vendimi përfundimtar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

21. Më 18 prill 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë me aktvendimin [I.NR.583/08] e refuzon kërkesën e parashtruesit. Në aktvendim Gjykata thekson "*se kërkesa e parashtruesit refuzohet sepse në bazë të nenit 5.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr.03/1-067), është paraparë që Agjencia është e autorizuar për qeverisjen e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore, pavarësisht a i nënshtrohen transformimit apo jo. Në bazë të nenit 4.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13, për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, juridiksionin ekskluziv lidhur me kërkesën e parashtruesit e ka Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (shih paragrafin 31)*".

22. Më 16 tetor 2011, lidhur me ankesën e parashtruesit, Gjykata e Qarkut, me aktvendimin [Gž..nr.461-211] miraton ankesën, ndërsa aktvendimin e Gjykatës Komunale [I.nr.583/2008], të datës 18 prill 2011, e prish dhe lëndën ia kthen Gjykatës Komunale për rishqyrtim dhe rivendosje.

23. Më 16 nëntor 2011, Gjykata Komunale, me aktvendimin [nr.538/08] përsëri e refuzon kërkesën e parashtruesit si të pabazuar.

24. Në një datë të panjohur, parashtruesi paraqet ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale [nr.538/08].

25. Më 26 qershor 2012, Gjykata e shkallës së dytë-Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me aktvendimin përfundimtar [Gž.nr.1490/2011] e refuzon ankesën e parashtruesit si të pabazuar, ndërsa aktvendimin e Gjykatës Komunale [I.nr.583/08], të datës 18 prill 2011, e vërteton në tërësi.

26. Më 30 korrik 2012, parashtruesi i ka dërgua kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë Prokurorit të Shtetit të Kosovës kundër aktvendimit të formës së prerë të Gjykatës së Qarkut [Gž.nr.1490-2011] të datës 26 qershor 2011.

27. Më 7 gusht 2011, Prokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën [ZZZG.nr.80-12] e ka njoftuar parashtruesin se nuk ka gjetur bazë ligjore për paraqitje të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë lidhur me këtë rast.

Pohimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pohon se i janë shkelur të drejtat pronësore sipas nenit 46 (Mbrojtja e Pronës) si dhe të nenit 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) të Kushtetutës së Kosovës.

29. Po ashtu, parashtruesi pohon se neni 22 i Kushtetutës së Kosovës imponon zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe veçanërisht e thekson Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut, dhe atë, nenet 8, 10 dhe 17, të cilat rregullojnë të drejtën e njeriut që gjykatat nacionale ta mbrojnë në mënyrë efikase nga shkelja e të drejtave themelore që i janë garantuar me Kushtetutë dhe ligje.

30. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me këtë kërkesë:

"Që Gjykata ta vlerësojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar dhe që të konstatojë se në dëm të parashtruesit të kërkesës është shkelur e drejta e tij e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, se dy gjykatat e shkallës më të ulët (Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut në Prishtinë) e kanë shkelur Ligjin për procedurën e përmbarimit në dëm të parashtruesit dhe që aktvendimet janë jokushtetuese".

Legjislacioni relevant

31. Neni 5.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit;

> *"Agjencia ka kompetenca që të administrojë ndërmarrjet në pronësi shoqërore dhe publike të regjistruara ose që veprojnë në*

territorin e Kosovës si dhe pasurinë e këtyre ndërmarrjeve në territorin e Kosovës".

32. Neni 4.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2002/13 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme "Dhoma e Posaçme ka juridiksion parësor për paditë dhe kundërpaditë që lidhen me, si vijon";

"[...]"

d) "Paditë që përfshijnë njohjen e një të drejte, një titulli apo interesi pronësor, që është në posedim apo nën kontrollin e një ndërmarrjeje a korporate, që aktualisht është ose ka qenë më parë nën autoritetin administrues të Agjencisë, kur paditë e tilla janë ngritur gjatë kohës ose para kohës, kur ndërmarrja apo korporata e tillë, i është nënshtruar autoritetit administrativ të Agjencisë".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesve, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë dhe që saktësohen me Ligj dhe me Rregullore të punës.

34. Në këtë drejtim, Gjykata thirret në nenin 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjithamjetet juridike të përcaktuara me ligj".

35. Në anën tjetër, neni 47(2) i Ligjit po ashtu parasheh që:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridiketë përcaktuara me ligj.."

36. Për më tepër, rregulli 36(1) a) parasheh që:

"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: a) janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar

37. Parashtruesi në kërkesën e paraqitur Gjykatës Kushtetuese ka theksuar se në bazë të kundërshtimit të Agjencisë të Privatizimit, kompetenca për

zgjidhjen e këtij kontesti pronësor-juridik, të datës 4 maj 2009, ka kaluar në juridiksionin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, se lënda është regjistruar me shenjën "SCC-09-0225" dhe që procedura është duke vazhduar. Gjykata Kushtetuese thekson se këto pohime të parashtruesit detajisht janë arsyetuar në dispozitivin e aktvendimit të Gjykatës Komunale [P.nr.1144/08] nga data 04 maj 2009 (shih paragrafin 17).

38. Gjykata vëren se më 18 prill 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë me aktvendimin (I.nr.583/08] e ka refuzuar kërkesën për ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Komunale [Gž.(Ac) nr.181/2008] të paraqitur nga ana e parashtruesit. Në aktvendim Gjykata ka theksuar: "se kërkesa e parashtruesit refuzohet" [...]. Në bazë të nenit 4.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13, për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatë Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, jurisdikcioninin ekskluziv për kërkesën e parashtruesit e ka Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës.

39. Gjykata po ashtu vëren se në periudhën nga 20 nëntori 2006 deri më 4 maj 2009, procedura e vërtetimit të së drejtës së pronësisë për këtë çështje juridike është zhvilluar në gjykatat e rregullta, edhe pse në atë periudhë ka qenë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit nga data 13 qershor 2002, e cila i ka rregulluar edhe çështjet e kontesteve kundër Agjencisë.

Neni 30.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, thotë:

"Dhoma e Posaçme ka juridiksion ekskluziv për të gjitha paditë kundër Agjencisë".

40. Gjykata përkujton se parimi i subsidaritetit kërkon që parashtruesi ti shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të pengohet shkelja e Kushtetutës, nëse ekziston, ta përmirësojë shkeljen e tillë të së drejtës themelore njerëzore. Në pajtim me këtë, shterja e mjeteve juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi në këtë rast ende nuk është plotësuar.

41. Arsyetimi për rregullën e shterjes është që tua jap organeve të pushtetit mundësinë që ta parandalojnë apo përmirësojnë shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulla është e bazuar në supozimin që rregullimi shtetëror i Kosovës të sigurojë mjet efikas kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih Aktvendimi për mospranueshmëri; Universiteti AAB-RIINVEST, Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI-

41/09, i datës 21 janar 2010 dhe të shihet mutatis mutandis KEDNJ, Selmouni kundër Francës nr.25803/94, vendimi i datës 28 korrik 1999).

42. Në të vërtetë si rregull i përgjithshëm, Gjykata Kushtetuese do të intervenojë vetëm kur ka shkelje të interpretimit të Kushtetutës, apo kur ligjet nuk janë në pajtim me Kushtetutë, por vetëm pasi të jenë shterur të gjitha mjetet tjera të parapara me ligj.

43. Prandaj, kërkesa në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47(2) të ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores, është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36(1)a) dhe 56 (2) të Rregullores së Punës, më 5 korrik 2013 njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Dr. sc. Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

KI 07/13, Ibish Kastrati, datë 09 korrik 2013 - Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës Komunale në Pejë, N. Nr. 137/08, të 17 nëntorit 2008

KI 07/13, Aktvendim për papranueshmëri i datës 5 korrik 2013

Fjalë kyçe: Kërkesë individuale, mbrojtja e pronës, mos-shterimi i mjeteve juridike, kërkesë e parakohshme

Parashtruesi i kërkesës kërkon të realizojë të drejtën për disponim të lirë dhe të plotë të pasurisë së patundshme sipas kontratës shitblerëse, duke kërkuar zbatimin e Vendimit të Gjykatës së Rrethit në Pejë, A. 1174/56-57, të 17 tetorit 1957.

Parashtruesi i kërkesës po ashtu i drejtohet Gjykatës me kërkesën për ndërprerjen e procedurës gjyqësore, e cila është duke u zhvilluar pranë Gjykatës Themelore në Pejë.

Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Komunale në Pejë me Vendimin e saj Nr. 137/08 të 17 nëntorit 2008 ka vendosur të pezullojë procedurën jokontestimore në mënyrë që parashtruesi i kërkesës të ushtrojë padi civile në gjykatën kompetente. Si rezultat i vendimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës ka ushtruar padi në gjykatën kompetente, ku ende është duke u zhvilluar procedura gjyqësore.

Duke marrë për bazë faktin që rasti i parashtruesit të kërkesës është ende në shqyrtim e sipër në procedurë të rregullt gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Pejë, Gjykata konkludoi se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në
astin Nr. KI07/13
Parashtrues
Ibish Kastrati
Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Pejë, N. nr. 137/08, të 17 nëntorit 2008

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ibish Kastrati (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi i kërkesës) me vendbanim në Pejë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Vendimi i Gjykatës Komunale në Pejë, N. Nr. 137/08, i 17 nëntorit 2008, dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 dhjetor 2008.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkon të realizojë të drejtën për disponim të lirë dhe të plotë të pasurisë së patundshme sipas kontratës shitblerëse, duke kërkuar zbatimin e Vendimit të Gjykatës së Rrethit në Pejë, A. 1174/56-57, të 17 tetorit 1957, dhe ndërprerjen e rigjykimit të sërishëm.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56, pika 2, të

Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 janar 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Kryetari emëroi gjyqtarin Altay Suroy si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 15 shkurt 2013, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës lidhur me regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelorë në Pejë lidhur më regjistrimin e kërkesës, duke kërkuar njëkohësisht konfirmimin nëse lidhur me kërkesën është duke u zhvilluar procedurë në këtë gjykatë.

8. Më 27 shkurt 2013, Gjykata pranoi shkresën e Gjykatës Themelore në Pejë, e cila njoftoi se lidhur me lëndën N. Nr 137/08, më 17 nëntor 2008 është pezulluar procedura dhe pala është udhëzuar në kontest civil, gjithashtu duke e njoftuar që lënda është në procedurë pranë kësaj gjykate.

9. Më 1 mars 2013, Gjykata nga parashtruesi i kërkesës ka pranuar një shkresë, së cilës edhe një herë i bashkëngjitet Aktvendimi i Gjykatës së Rrethit në Pejë A. 1174/56-57, i 17 tetorit 1957, dhe Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Pejë, N. Nr. 137/08, i 17 nëntorit 2008.

10. Më 17 qershor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve siç janë dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës

11. *Sipas dokumenteve të bashkëngjitura në kërkesë, parashtruesi i kërkesës, të drejtën e pronësisë e kishte fituar përmes kontratës për shitblerje, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë, me Nr. 882/61, të 1 gushtit 1961. Me rastin e vërtetimit të kontratës, nuk ishte shënuar numri i ngastrës kadastrale dhe sipërfaqes së blerë, por patundshmëria ishte vërtetuar sipas Aktvendimit N. Nr. 1174/56 të*

Gjykatës së Rrethit, të 17 tetorit 1957, për ndarjen e patundshmërisë në mes të ish–pronarit të patundshmërisë dhe vëllait të tij.

12. *Parashtruesi i kërkesës pohon që patundshmërinë e tij, ashtu siç ia kishte dorëzuar ish-pronari, e kishte poseduar në kufijtë e saj deri në vitin 1999. Me rastin e djegies së koshit gjatë luftës, i cili kufizonte patundshmërinë e tij dhe atë fqinje, poseduesi i patundshmërisë fqinje kishte vendosur një rrethojë teli dhe sipas pohimeve të parashtruesit të kërkesës, kishte hyrë në pronën e parashtruesit të kërkesës.*

13. *Më 17 qershor 2008, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Komunale kishte parashtruar propozimin për përkufizimin e patundshmërisë dhe përcaktimin e mezhdës (megjës) për ngastrat 475/1 dhe 475/2.*

14. *Gjykata Komunale në Pejë, në kuadër të procedurës jokontestimore, me qëllim të identifikimit dhe përcaktimit të mezhdës (megjës) kishte urdhëruar daljen në vend të ekspertëve gjeodetë. Në raportin e tyre, ekspertët gjeodetë kishin konstatuar se që nga viti 1956 nuk ishte bërë matje kadastrale dhe në mungesë të shënimeve kadastrale nuk kishte qenë i mundur përcaktimi i mezhdës (megjës) sipas propozimit të parashtruesit të kërkesës dhe urdhrit të Gjykatës Komunale.*

15. *Më 17 nëntor 2008, pas deklaratave të palëve, mendimit të ekspertëve dhe daljes në vendngjarje nga gjykata, Gjykata Komunale në aktvendimin e saj N. Nr. 137/08 erdhi në përfundim se, "në mes të propozuesit dhe kundërpropozuesit ka mosmarrëveshje sa i përket megjës kadastrale". Si rezultat i mungesës së të dhënave dhe mosmarrëveshjes mes palëve lidhur me ekzistimin e mezhdës (megjës) në vend, Gjykata vendosi që të pezullojë procedurën jokontestimore në mënyrë që parashtruesi i kërkesës të parashtronte padi në gjykatën kompetente.*

16. *Sipas shkresës njoftuese të Gjykatës Themelore në Pejë, pranuar në Gjykatën Kushtetuese më 27 shkurt 2013, konfirmohet se parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi civile në Gjykatën Komunale të Pejës, e regjistruar në Gjykatë si lënda C. Nr. 1033/08. Në shkresën e saj njoftuese, Gjykata Themelore në Pejë, po ashtu konfirmon se lidhur me lëndën C. Nr. 1033/08 është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore, duke njoftuar njëkohësisht se janë mbajtur dy seanca gjyqësore, përkatësisht më 26 dhjetor 2012 dhe më 10 janar 2013, dhe se seancat e radhës do të caktohen në të ardhmen.*

Pr

etendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi në kërkesën e tij dorëzuar në Gjykatë, kërkon të realizojë të drejtën për disponim të lirë dhe të plotë të pasurisë së patundshme sipas kontratës shitblerëse, duke kërkuar zbatimin në tërësi të Aktvendimit të Gjykatës së Rrethit në Pejë, A. 1174/56-57, të 17 tetorit 1957.

18. Parashtruesi i kërkesës po ashtu i drejtohet Gjykatës me kërkesën për ndërprerjen e procedurës gjyqësore, e cila është duke u zhvilluar pranë Gjykatës Themelore në Pejë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kërkesat e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë dhe specifikohen më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

20. Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në Gjykatë, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës.

    Neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës përcakton:

    "Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

    Në lidhje me kërkesën, Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës është person fizik, si dhe është palë e autorizuar në pajtim me nenin 113.7 [Juridiksioni dhe palët e autorizuara] të Kushtetutës.

21. Gjykata gjithashtu duhet të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës, në pajtim me kërkesat e nenit 113 (7) të Kushtetutës, nenin 47 (2) të Ligjit dhe rregullin 36.1 të Rregullores së punës, ka shteruar të gjitha mjetet juridike.

22. Neni 47 (2) i Ligjit për Gjykatën, parasheh:

    Individi mund ta ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që t'i ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

23. Për më tepër, rregulli 36 (1. a) i Rregullores së punës parasheh:

"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar."

24. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Komunale në Pejë me Vendimin e saj Nr. 137/08 të 17 nëntorit 2008 ka vendosur të pezullojë procedurën jokontestimore në mënyrë që parashtruesi i kërkesës të ushtrojë padi civile në gjykatën kompetente. Si rezultat i vendimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës ka ushtruar padi në gjykatën kompetente, ku ende është duke u zhvilluar procedura gjyqësore.

25. Duke marrë për bazë faktin që rasti i parashtruesit të kërkesës është ende në shqyrtim e sipër në procedurë të rregullt gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Pejë, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme.

26. Në këtë rast, Gjykata rithekson se gjykatat e rregullta janë të pavarura në ushtrimin e pushtetit të tyre gjyqësor dhe se është obligim i tyre kushtetues dhe prerogativë që të interpretojnë çështjet e faktit dhe të ligjit që janë relevante për rastet e ngritura para tyre.

27. Qëllimi i rregullit të shterimit është që, në këtë rast, t'u ofrohet gjykatave të rregullta mundësia e rregullimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih, *Aktvendimi për papranueshmëri - AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës,* KI-41/09 të 21 janar 2010, dhe shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25 803/94, Aktvendim i 28 korrikut 1999).

28. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, administrative ose gjyqësore, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka, të rregullohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. (Shih, *Aktvendimi në rastin KI07/09, Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl.nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18*).

29. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të vlerësojë shkeljet e pretenduara kushtetuese, pa iu dhënë mundësia gjykatave të rregullta për të përfunduar procedurat që ishin në vazhdim e sipër dhe për t'i korrigjuar shkeljet e pretenduara.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (a) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 5 korrik 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues
Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
Prof. Dr. Enver Hasani

INDEKSI I SHPREHJEVE LIGJORE

TERMAT		NUMRI I FAQËS
Actio popularis	**A**	50, 52, 56, 85, 272, 278, 400, 428, 432, 743, 751, 894, 901;
Agjencioni Kadastral i Kosovës (AKK)		66 -70;
Agjencioni i Kosovës për Inteligjencë (AKI)		641;
Agjencioni Kosovarë i Mirëbesimit (AKM – tani AKP)		68, 225, 228, 251, 252, 254 – 256; 332, 333, 521, 560, 936, 938;
Agjencioni Kosovarë i Privatizimit (AKP)		66, 68 - 70; 72, 127, 130, 227, 253, 259, 260, 262, 335, 337, 696, 764, 773 – 775; 778 -813; 817 -820; 933 – 938;
Aktgjykim		174, 281, 307, 460, 605, 643;
Aktvendim për Papranueshmëri		19, 26, 36, 45, 53, 58, 65, 79, 90, 100, 107, 114, 121, 128, 134, 140, 148, 154, 159, 165, 223, 233, 246, 260, 266, 273, 288, 298, 333, 339, 345, 351, 357, 362, 371, 378, 387, 394, 403, 410, 418, 429, 435, 443, 505, 519, 528, 543, 549, 558, 566, 578, 588, 598, 694, 701, 709, 717, 737, 745, 756, 763, 768, 774, 784, 792, 798, 804, 811, 818, 824, 830, 837, 847, 857, 867, 874, 883, 889, 895, 904, 910, 916, 924, 932, 941;
Akti Administrativë		86, 594, 601;

Aktet Ligjore/Juridike (aktet nënligjore)		50, 94, 273, 277, 283, 398, 432, 464, 469, 520, 611 – 614; 621, 624, 631, 639, 650;
Aktvendim për përmirësimin e gabimeve teknike në Aktvendimin për Papranueshmëri, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës		534, 535;
Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës		59, 60, 80, 83, 96, 97, 284, 396, 608 - 610;619, 620, 642, 643, 648, 660, 661, 669, 680, 683, 688, 690, 750, 849; 899;
Baza Juridike (ligjore)	**B**	20, 27, 36, 46, 53, 59, 66, 79, 91, 101, 108, 115, 122, 129, 135, 141, 149, 154, 160, 166, 176, 224, 234, 247, 253, 261, 267, 274, 283, 289, 299, 307, 334, 340, 345, 352, 357, 362, 371, 379, 395, 403, 411, 419, 429, 444, 454, 461, 506, 520, 538, 543, 550, 559, 567, 579, 589, 598, 606, 644, 695, 702, 710, 718, 730, 738, 746, 756, 763, 769, 775, 785, 792, 799, 804, 811, 819, 831, 837, 848, 857, 867, 875, 884, 889, 896, 905, 910, 916, 925, 932, 942;
Barazia para Ligjit		43, 47, 64, 65, 69, 70, 77, 84, 164, 167, 222, 223, 266, 332, 335, 383, 428, 429, 457, 460, 467, 471, 472, 480, 520, 716, 755, 756, 762, 765, 773, 774, 779, 781, 788, 806, 808, 830, 836, 840, 842, 850;
Banka Qendrore e Kosovës (BQK)		644, 653 – 656; 665, 657, 667, 668, 671 – 673; 680, 682;
Deputetët e Kuvendit të	**D**	47, 74, 75, 283, 285, 605, 619,

Kosovës		623, 624, 638, 640, 641, 661, 664, 677, 686, 688, 689, 751;
Deklarata Universale për të Drejta të Njeriut		43, 48, 148, 167, 174, 193, 272, 276, 308, 424, 626, 762, 765, 830, 850, 936;
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	**DH**	64 – 72; 222 - 230; 251 – 262; 332 – 337; 373, 384 - 391; 399, 475, 518 – 525; 557 - 563; 693 – 699; 762 – 766; 773 – 782; 813 – 821; 892; 934 - 938;
E Drejta për Jetën	**E**	43, 306, 308, 312, 313, 321, 321, 325, 806, 808, 845, 846, 850, 852;
E Drejta Ndërkombëtare		545, 624, 626, 789;
E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike		164, 167, 762, 765;
E Drejta e Pronës		25, 30 – 32; 71, 386, 557, 561, 627, 664, 668, 683, 684, 720, 732, 823, 909, 932;
E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm		25, 32, 64, 65, 70, 77, 84, 87, 120 – 122; 136 – 140; 159 - 168; 172, 174, 193, 197, 204, 217, 222, 223, 232 – 235; 238, 243, 244, 296, 302, 332 - 336; 344, 348, 361, 366, 369, 370, 377, 383, 386, 402, 406, 417, 424, 432, 435, 442, 458, 472 – 477; 480, 486 – 505; 509, 511, 516, 520, 527, 564, 574, 577 - 582; 708, 712, 716, 722, 736, 755, 756, 767, 770 – 774; 779, 781, 788, 836, 841, 842, 873, 877 - 880; 915, 916, 919;
E Drejta e Pronësisë		28 – 32; 72, 254, 445, 562, 720,733, 739, 840;
E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit		74, 122, 133, 134, 409, 414 – 416; 434, 435, 604, 610, 611, 629, 638,

765;

E Drejta për Pension (mosha, fondi, aftësia e kufizuar, pensionistët, sigurimi i invaliditetit) 43 – 62; 77 – 86; 99 – 103; 248, 272 – 276; 278, 287, 290 – 291; 293, 294, 295, 353, 354, 542, 544 – 546; 805 – 808; 903 – 907;

Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve 133, 136, 318, 924;

Epërsia Kushtetuese 43, 47, 542, 545, 624, 788;

Ex lege 39;

Ex officio 187 – 190; 202, 236, 296, 300, 302, 304, 338, 339, 343, 456, 509, 534 – 536; 703, 725, 762, 764;

G

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 24, 34, 42, 51, 56, 63, 73, 88, 95, 105, 113, 119, 126, 132, 138, 146, 153, 157, 171, 205, 231, 250, 258, 264, 272, 279, 286, 295, 305, 325, 337, 343, 349, 355, 360, 366, 369, 374, 376, 385, 392, 401, 408, 416, 427, 433, 441, 451, 481, 526, 533, 536, 541, 547, 556, 563, 576, 586, 596, 602, 638, 646, 648, 663, 678, 679, 686, 687, 691, 699, 707, 715, 742, 743, 745, 747, 754, 766, 782, 789, 790, 796, 802, 809, 816, 822, 828, 835, 844, 855, 865, 872, 881, 887, 893, 902, 908, 914, 921, 930, 939, 946;

Gazeta Zyrtare - Republikës Socialiste Federative të Jugosllavis, KSAK 46, 47, 67, 267, 275, 290, 535;

GJ

Gjykata Supreme e Kosovës 18, 25, 35, 64, 89, 99, 113, 120, 133, 139, 153, 158, 172, 222, 232, 245, 265, 287, 296, 332, 350, 361, 370, 386, 402, 409, 417, 442, 458, 482, 504, 518, 527, 548, 557, 564,

	577, 693, 736, 762, 767, 773, 791, 803, 823, 829, 836, 856, 873, 882, 888, 903, 909, 915, 922, 935;
Gjykata e Lartë për Kundërvajtje	869, 870;
Gjykata e Qarkut në Gjakovë	800;
Gjykata e Qarkut në Gjilan	755, 758 - 760; 922, 924, 926, 929;
Gjykata e Qarkut në Mitrovicë	344 – 349; 428 - 432;
Gjykata e Qarkut në Prishtinë	18, 20 – 23; 92, 106, 107, 109, 112, 116, 117, 155, 179 – 181; 184, 186, 196, 197, 206 – 211; 213, 233 – 236; 248, 291, 412, 414, 443, 446, 448, 452 – 454; 465, 473, 529, 553, 577, 579, 580 – 582; 708, 709, 711, 713, 768, 769, 770, 832, 833, 837, 839, 840 - 843; 857, 860, 861, 873, 874, 877 – 879; 891, 931 - 936;
Gjykata e Qarkut në Pejë	120– 124; 142, 299, 301, 361, 362, 364, 367, 373, 377, 378, 382, 403 – 407; 420 – 424; 504 – 509; 511 - 516, 702, 882 - 885;
Gjykata e Qarkut në Prizren	30, 31, 160, 161, 380, 434 – 436; 439, 566, 568, 571 – 575; 716 – 718; 720 – 725, 728, 731, 732, 740, 912, 915, 918, 919;
Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)	33, 71, 104, 111, 118, 125, 137, 144, 185, 240, 243, 249, 257, 270, 294, 342, 368, 375, 384, 391, 450, 470, 475, 489, 500, 512, 515, 532, 555, 562, 574, 595, 632, 713, 734, 759,

	781, 842, 863, 871, 921, 929;
Gjykata Komunale në Gjakovë	66, 69, 72, 123, 141, 142, 299 – 301; 370, 373, 405, 406, 587, 590 – 592; 882, 884, 885;
Gjykata Komunale në Deçan	363, 364, 368, 825;
Gjykata Komunale në Gjilan	37 – 40; 388, 390; 755, 757 – 759;
Gjykata Komunale në Ferizaj	116, 183;
Gjykata Komunale në Lipjan	90, 92 – 94;
Gjykata Komunale në Malishevë	823 – 827;
Gjykata Komunale në Klinë	381, 382;
Gjykata Komunale në Kaçanik	411, 412, 414;
Gjykata Komunale në Prishtinë	19 – 22; 46, 78, 80 - 87; 108, 109, 111, 247, 248, 267, 291, 292, 306 – 311; 313, 320 – 322; 324, 326 – 329; 397, 443 – 448; 464, 465, 483, 495 – 499; 529, 536, 539, 546, 710 – 715; 768 – 770; 776, 832, 833, 837, 838, 840, 842, 858 – 861; 867 – 869; 871, 873 – 879; 891, 911, 917, 918, 933 – 936; 938;
Gjykata Komunale në Prizren	25 – 32; 438, 439, 695, 716, 717, 720 – 723; 728 - 732, 810 – 813; 912;
Gjykata Komunale në Pejë	395, 940 – 943; 945;
Gjykata Komunale në Podujevë	552 – 554;
Gjykata Komunale në Vushtrri	345 – 347; 428 - 431;
Gjykata Komunale në Therandë	564 – 575 ; 737 – 740;

Imunitet	**I**	393, 394, 397, 452, 454, 455, 457;
Intigritet		314, 380, 747, 851;
In abstracto		44, 50, 272, 278, 752, 894, 901;
Inter alia		22, 37, 74, 77, 81, 84, 167, 273, 287, 291, 344, 383, 346, 386, 409, 412, 462, 464, 466, 477, 491, 501, 507, 542, 559, 616, 618, 633, 677, 720, 823, 864;
Juridiksion i Gjykatave të Rregullta	**J**	35, 41, 95, 296, 304, 351, 354, 369, 407, 409, 415, 418, 808, 880, 920;
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Republikës së Kosovës	**K**	116, 412, 414, 432 – 436;
Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)		149 – 151, 167, 282, 306, 308, 309 – 314; 316, 320, 324;
Kryeministri i Qeverisë së Kosovës		47, 60, 282, 284, 607, 669, 700, 750, 849;
Kryetari i Kuvendit të Kosovës		47, 280 – 286; 606, 610, 644, 646, 647, 674, 675, 686, 689, 840;
Kuvendi i Republikës së Kosovës (Autoriteti, Kompetencat)		47, 49, 74, 75, 267, 277 - 285, 355, 439, 568, 603 – 607; 609, 610, 617 - 628, 636, 638, 642, 644, 647, 659 – 664; 669, 670, 677, 678, 686 - 691, 745, 747, 750, 807;
KFOR		393, 394, 397 - 399; 859;
Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore		719;
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale		793, 794;

Komisioni Qendror Zgjedhorë (KQZ)	86, 242, 614, 641, 821;
Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)	137, 288 – 295; 459, 477, 479, 523, 888 -891;
Kodi Penal i Kosovës (KPK)	37, 143, 194, 239, 300, 370, 420, 421, 431, 454, 507, 529, 580, 705,769, 770, 873, 877, 924, 925, 926, 927;
Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK)	144, 161, 178 – 181; 194, 200, 207, 211, 218, 302 – 304; 371 – 374; 380 - 383; 419, 423, 424, 426; 702, 767, 770, 875- 877;
Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)	39, 89, 91, 92, 508, 512, 581, 849;
Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK)	39, 40, 141 - 145; 180, 186 – 194, 196; 201 - 203; 373 - 375; 381 - 383; 431, 845, 849, 950, 851; 875, 877, 927;
Kompensim (E drejta e kompensimit; e dëmeve; monetar; per rrogat e papaguara/parealizuara)	18, 21, 22, 82, 113, 114, 228, 229, 245, 246, 247, 267 – 294; 313, 334, 336, 347, 388, 389, 493, 544, 545, 548, 551 – 554; 640, 649, 652, 667, 683, 771, 713, 733, 762, 765, 773 - 777, 856; 859 - 862;
Konfiskim	240, 752, 753;
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut	26, 27, 121, 124, 133, 136, 138, 149, 159 – 162; 167, 172 – 174; 186, 193, 197 – 200; 204, 205, 210, 213, 215, 217, 232, 235, 242 – 244; 272, 275, 295, 303, 304, 306, 308, 310, 312, 313, 321 – 325; 331, 332, 334, 336, 342, 348, 361, 367, 369, 383, 393, 395, 398, 407, 424, 428, 432 – 435; 442,

	449, 450, 458, 459, 472 – 477; 479, 480, 486, 488, 490, 493, 494, 497, 499, 504, 505, 509, 511, 512, 514, 516, 521, 548, 549, 554, 557, 558, 564, 574, 577, 582, 595, 611, 627, 632, 674, 708, 709, 711, 712, 716, 722, 724, 728, 734, 762, 765, 830, 836, 841 – 843; 849, 853, 856, 857, 862, 878, 882 – 885; 915 -920, 938;
Kompania e Ujësjellësit Rajonal "Batllava" në Prishtinë (KUR)	18, 20 – 22;
Komuna e Deçanit	362, 363, 748;
Komuna e Gjakovës	23, 64, 66 – 69; 372, 403 – 405; 587 – 593; 595;
Komuna e Gjilanit	53, 388, 389, 528, 530, 818;
Komuna e Graçanicës	894 – 901;
Komuna e Ferizajit	116;
Komuna e Hanit të Elezit	260 – 262;
Komuna e Istogut	904;
Komuna e Klinës	378, 505;
Komuna e Kaçanikut	411, 412, 414, 837, 839;
Komuna e Rahovecit	159;
Komuna e Prishtinës	768, 769, 859, 860, 867, 932, 933;
Komuna e Prizrenit	729, 811;
Komuna e Pejës	58, 743 – 745; 747, 748, 753;
Komuna e Podujevës	90, 100, 548 - 553; 804;

Komuna e Shtimes		114 - 116;
Komuna e Therandës		435, 503, 566 - 568, 737 – 739;
Ligji për Procedurën Kontestimore	**L**	23, 24, 30, 117, 248, 255, 292, 311, 365, 728 - 780;
Ligji për Procedurën Përmbarimore		109, 110, 111, 447, 448, 936;
Ligji për Sigurimin Shëndetësor		43, 46, 47, 48, 49, 276, 613, 618;
Ligji për Pensionistët dhe Invalidët e punës		43, 46, 47, 81, 273 -276; 290, 292;
Ligji për Konfliktet Administrative		86, 600;
Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare		96, 97, 642, 643, 646–648; 653–657; 661- 667; 669 – 673; 675 - 679;
Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës		373, 374;
Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale		259, 263, 592, 594, 896, 897, 898, 899;
Ligji i Punës		124, 292, 465, 467, 473, 478, 483, 485, 615, 619, 835;
Liria e Shprehjes		841;
Marrëveshje Ndërkombëtare	**M**	43, 47, 77, 84, 260, 263, 266, 361, 366, 369, 582, 712, 722, 789, 936;
Masa e Përkohshme		69, 70, 74 – 76; 96 – 98; 133, 136, 139, 141, 145, 146, 161, 172, 175, 176, 205, 222, 224, 231– 233;

236, 237, 244, 296, 298, 299, 302 -305; 317, 389, 417, 418, 426, 427, 442, 444, 451 - 457, 504 –510, 516, 517, 527 – 533; 548, 549, 555 – 558; 582, 585, 586, 603, 604, 606, 608, 638, 642 - 645; 679, 708 - 710; 715 – 719; 725 – 727; 739, 873, 878, 880, 881, 992, 925, 930, 935;

Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave — 35, 38, 41, 296, 302, 306, 323, 328, 383, 428, 429, 542, 545, 564, 574, 755, 756, 765, 788, 830, 836, 841, 842, 850, 909, 912, 931, 936;

Mbrojtja e Ligjshmërisë — 35 – 40, 94; 143, 182, 183, 212, 232, 235, 236, 238 – 240; 243, 255, 256, 296, 298, 299, 301, 303, 311, 347, 365, 373 – 375; 382, 390, 423, 426, 439, 443, 447, 448, 508, 512, 529, 530, 581, 582, 584, 717, 721, 731 - 733; 739, 758, 768, 770, 825, 826, 841, 877, 883, 885, 910 - 912; 922, 924, 926 – 929; 936;

Mbrojtja e Pronës — 25 – 27, 32, 77, 84, 96, 120 - 122; 344, 348, 393, 395, 548, 549, 554, 642, 648, 675, 679, 716, 722, 736, 737, 909, 912, 931, 936, 940;

Mjetet Juridike Ligjore (E drejta për të përdorur) — 18, 23, 24, 35, 38, 40, 41, 55, 61, 71, 72, 77, 84 – 87; 118, 172, 193, 222, 223, 229, 230, 238, 241, 256, 261, 270, 296, 302, 303, 306, 311, 312, 319 – 325; 330, 336, 242, 359, 367, 368, 393, 399, 407, 414, 425, 432, 440, 470, 471, 510, 511, 513, 525, 562, 564, 583, 587, 592, 595, 597, 600, 601, 697, 698, 722 – 724; 750, 751, 771, 780, 794, 795, 807, 810, 814, 815, 821, 833, 863, 870, 886, 900, 919, 931, 937,

	944, 945;
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	436 – 439;
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	591, 594, 748;
Ministria e Financave	644, 655 – 659; 662 – 665;
Ministria (Ministri) e Shëndetësisë	47, 242, 452 – 455; 457, 514, 539, 607 -609; 611 – 618; 621, 625, 631, 636; 639;
Ministria e Punëve të Brendshme	135, 136, 320, 323, 783 – 787; 868;
Ministria (Ministri) e Drejtësisë	60, 282, 283, 320, 323, 340, 701, 706;
Ministria (Ministri) e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)	47, 48, 77 – 85; 87, 99, 100, 103, 245 – 248; 290, 292, 352, 464, 543, 545, 803, 804, 903, 904;
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	169, 635, 636;
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	663, 668, 672, 681;
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	896 - 899;
Ministria e Administratës Publike	644, 650, 655, 657, 658, 665, 667, 671, 673, 682;
Mutatis mutandis	23, 33, 41, 70, 71, 87, 95, 104, 111, 112, 118, 125, 137, 144, 145, 213, 230, 240, 241, 243, 244, 249, 257, 270, 294, 295, 303, 336, 350, 355, 368, 369, 375, 384, 391, 407, 408, 415, 416, 422, 426, 432, 450, 458, 471, 479, 512, 513, 515, 516, 524, 532, 555, 562, 563, 574, 575, 584, 601, 697, 714, 724, 734, 759, 760, 772, 781, 795, 808, 815, 821, 842,

		863, 864, 871, 880, 892, 921, 929, 938, 945;
Ndërmarrje Shoqërore (NSH)	**N**	27 – 29; 31, 128 – 130; 224, 445, 446, 560, 561, 625, 832, 833;
Ndalimi i Diskriminimit (Ligji kundër diskriminimit)		78, 84, 149, 167, 269, 332, 336, 472, 521, 606, 818, 916;
Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues		43, 48;
Ne bis in idem		564, 573, 575, 564;
Nënkryetarët nga Kryesia e Kuvendit		282;
OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë	**O**	393 - 398;
OJQ - Organizatë Jo Qeveritare		98, 268, 311, 312, 315, 374, 375, 642, 644, 647 - 668; 671 - 676; 680 - 684;
Palët (Pala) e Autorizuara	**P**	43, 44, 48, 50, 52, 56, 85, 130, 156, 172, 193, 237, 257, 269, 271, 276, 337, 400, 510, 531, 583, 623, 698, 712, 744, 750, 751, 753, 780, 786, 826, 900, 906, 944;
Palët (Pala) e Paautorizuara		38, 40, 43, 52, 272, 393, 400, 751, 894, 901;
Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor		94, 121, 133, 136, 332, 475;
Person Juridik		43, 50, 110, 269, 272, 278, 319, 428, 432, 601, 650, 653, 656, 660, 665, 671, 676;
Prona e Patundshme (paluajtshme)		27, 28, 30, 32, 64, 66 – 70; 72, 106, 109, 111, 127, 129, 251 - 253; 255, 364, 366, 389, 405, 442 – 445; 550, 552, 553, 561, 667, 836,

		837;
Prima facie		62, 105, 106, 112, 113, 118, 131, 137, 228, 232, 236, 237, 243, 244, 249, 361, 369, 426, 450, 456, 504, 510, 515, 516, 562, 575, 700, 707, 726, 733, 842, 879, 920, 921, 929;
Presidenti i Republikës së Kosovës		47, 84, 284, 317, 318, 493, 610, 619, 644, 646, 663, 669, 677, 678, 686, 689, 690, 691, 750, 849;
Prokuror		35, 38 – 41; 141, 153, 155, 156, 160 – 162; 177 – 179; 186, 189 – 192; 194 - 196; 198, 201 - 203; 207, 234, 255, 257, 318, 341, 347, 354, 365, 373, 374, 379, 381, 382, 417, 419 – 423; 440, 441, 443, 447, 448, 454, 455, 597 – 601; 641, 721, 729, 731, 732, 739, 755, 756, 758, 800, 826, 841, 842, 847. 849; 851; 853, 854, 911, 912, 926, 936;
Qeveria e Republikës së Kosovës (Autoriteti, Kompetencat, Vendimet, Rregulloret)	**Q**	23, 48, 49, 57 – 59; 61, 62, 72, 82, 87, 242, 259, 269, 277, 280 – 284; 293, 336, 426, 432, 452, 455, 514, 539, 601, 607, 609, 620, 623, 625, 644, 669, 697, 747, 750, 815, 821, 827, 938, 945;
Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve		538 - 540;
Ratione temporis	**R**	23, 377, 384, 386, 391, 656, 823, 827, 888, 892, 893;
Res Judicata		147, 152, 158, 163, 222, 228 - 230; 573, 575, 762, 765, 797, 802;
Revizioni		22, 30 – 33; 111, 117, 124, 248, 292, 311, 361, 364 – 367; 403, 406, 407, 412, 413, 459, 460, 465 – 467; 471, 473, 474, 478, 480,

		483, 484, 488, 491, 495, 496, 499, 502, 554, 566, 568, 573, 574, 721, 723, 740, 832, 834, 837, 839, 840 – 843; 856, 857, 861, 862, 891;
Rigjykim		30, 172, 175, 232, 235, 240, 347, 508, 512, 529, 530, 553, 776, 832, 842, 860, 861, 867, 870, 882, 885, 926, 941;
RTK - Radio Televizioni i Kosovës		60;
Sindikata e Pavarur e Pensionistëve dhe i Personave me Aftësi të Kufizuara të Punës të Kosovës	**S**	43, 45 – 47;
Sindikata e Pavarur		115;
Sundimi i Ligjit		390, 466, 476, 490,491, 501, 502, 675, 678, 691, 692;
Suspendim (Pezullim)		28, 68, 74, 75, 82, 86, 97, 199, 233, 236, 237, 262, 304, 313, 317, 422, 437 – 439; 452, 454, 456, 509, 603, 604, 606, 638, 643, 648, 679, 709, 718, 725, 739, 845, 850, 875, 878, 940, 942, 943, 945;
Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK)	**SH**	92, 134 – 136; 377, 384, 579, 641, 788, 849, 859;
Taksat Gjyqësore (shpenzimet)	**T**	113, 114;
Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)	**U**	147 - 152; 169;
UNMIK-u (Rregulloret)		47, 68, 116, 120, 124, 127, 129, 130, 186, 248, 253, 265 – 269; 275, 290 - 292; 332 – 337; 389,

		393 - 400; 413, 418– 422; 425, 426, 467, 473, 478, 485, 519, 520, 522 – 524; 571, 660, 662, 664, 704, 720, 776 - 789; 812, 813, 890, 934 - 938;
Univerziteti i Prishtinës (Publik)		57, 58, 62;
Univerziteti AAB – Riinvest (Privat)		23, 72, 87, 242, 269, 336, 426, 432, 514, 601, 697, 815, 821, 938, 945;
Vlerësimi Abstrakt i Kushtetutshmërisë së Ligjit	**V**	56, 393,
Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit		18, 25, 35, 52, 57, 64, 74, 77, 89, 96, 99, 106, 113, 120, 127, 133, 139, 147, 153, 158, 164, 172, 205, 222, 232, 245, 251, 259, 265, 287, 296, 332, 338, 344, 350, 356, 377, 386, 402, 409, 417, 434, 442, 452, 458, 504, 518, 527, 537, 542, 548, 557, 564, 577, 587, 597, 603, 642, 693, 700, 708, 716, 728, 736, 743, 755, 762, 767, 773, 791, 803, 810, 817, 823, 829, 836, 856, 866, 873, 882, 888, 903, 909, 915, 922, 931, 940;
Zëvendës Kryeministri i Kosovës	**Z**	60, 282;

INDEKSI I NENEVE TE KUSHTETUTËS

Neni	Titulli/Emërtimi	Vendimi/Numri i faqes
	KAPITULLI I	
	DISPOZITAT THEMELORE	
1	Përkufizimi i Shtetit	84
3	Barazia Para Ligjit	43; 47; 48; 266; 428; 430; 460; 467; 471; 716; 722; 756; 765; 788
4	Forma e Qeverisjes Ndarja e Pushtetit	276; 428; 430;624; 690
5	Gjuhët	332; 335; 336; 520; 836; 840; 841
7	Vlerat	43; 47; 48; 332; 335; 336; 361; 367; 369; 402; 406
10	Ekonomia	223; 642; 648; 684; 688
16	Epërsia e Kushtetutës	43; 47; 48; 545; 624; 788
19	Zbatimi Marrëveshjeve Ndërkombëtare	43; 47; 48; 788
	KAPITULLI II	
	TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE	
21	Parimet e Përgjithshme	53; 59; 133; 148; 167; 247; 332; 335; 336; 361; 367; 369; 402; 406; 564; 567; 576; 708; 710; 712; 716; 722; 746; 764; 788; 830; 931
22	Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare	43; 47; 48; 77; 84; 260; 263; 266; 272; 275; 361; 367; 369; 402; 406; 582; 708; 712; 716; 722; 765; 788

23	Dinjiteti Njerëzor	43; 47; 48; 77; 84; 260; 263; 272; 275; 332; 335; 336; 370; 375; 455; 520; 806; 808
24	Barazia Para Ligjit	65; 69; 70; 77; 84; 148; 167; 223; 266; 332; 335; 336; 383; 460; 467; 471; 489; 520; 765;773; 774; 788; 806; 808; 830
25	E Drejta për Jetën	43; 47; 48; 306; 310; 321; 325; 806; 808
27	Ndalimi i Torturës, Trajtimit Çnjerëzor dhe Poshtërues	43; 47; 48
29	E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë	424
31	E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm	26; 32; 65; 70; 77; 84; 121; 133; 140; 149; 159; 162; 173; 197; 205; 223; 232; 238; 244; 296; 302; 306; 310; 325; 332; 348; 361; 367; 369; 370;375; 383; 402; 406; 424; 434; 435; 442; 449; 472; 475; 477; 480; 486; 496; 504; 509; 511; 520; 527; 564; 577; 582; 708; 712; 716; 722; 736; 737; 756; 767; 770; 773; 774; 788; 830; 836; 840; 841; 856; 877; 883; 916; 919
32	E Drejta për Mjete Juridike	41; 77; 84; 223; 296; 302; 306; 310; 325; 564; 576
33	Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Çështjet Penale	232; 234; 238; 244; 877
34	E Drejta për të mos u Gjykuar dy Herë për të Njëjtën Vepër	223
36	E Drejta e Privatësisë	148; 167
41	E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike	148; 167; 765

44	Liria Asociimit	642; 648;684; 688; 788
46	Mbrojtja e Pronës	26; 32; 77; 84; 121; 348; 393;395; 402; 406; 548; 549; 557; 558; 642; 648; 683; 716; 722; 732; 736; 737; 912
49	E Drejta e Punës Ushtrimit të Profesionit	87; 121;413; 415; 416; 434; 435; 610; 611; 629; 765
51	Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale	43; 47; 48; 77; 84; 272; 275; 294; 354; 424
53	Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut	121; 296; 302; 360; 361; 367; 369; 402; 406; 475; 537; 538; 582; 788
54	Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave	41; 296; 302; 306; 310; 323; 325; 383; 428; 430; 545; 564; 576; 765; 788; 830; 836; 840; 841; 912
55	Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore	383; 424; 627; 788
56	Të Drejtat dhe Liritë Themelore Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme	428; 430

KAPITULLI III

TË DREJTAT E KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE

61	Përfaqësimi në Punësim në Institucionet Publike	600
62	Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal	894; 895; 899

KAPITULLI IV

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

65	Kompetencat e Kuvendit	277; 624

80	Miratimi i Ligjeve	686; 689

KAPITULLI V

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

84	Kompetencat e Presidentit	43; 47; 48; 689

KAPITULLI VI

QEVERIA E REPULIKËS SË KOSOVËS

93	Kompetencat e Qeverisë	277
98	Imuniteti	449

KAPITULLI VII

SISTEMI I DREJTËSISË

102	Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor	94; 121; 332; 133; 335; 336
103	Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave	94
104	Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve	133
105	Mandati dhe Riemërimi	347
106	Papajtueshmëria	830
108	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	282

KAPITULLI VIII

GJYKATA KUSHTETUESE

113.1	Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara	85; 96; 276; 341; 399; 642; 750
113.5		606; 623; 751
113.7		25; 40; 53; 59; 61; 71; 79; 85; 91; 99; 108; 115; 120; 127; 130; 134; 153; 156; 160; 172; 192; 222; 224; 234; 237; 247; 249; 256; 267; 270; 274; 287; 296; 299; 306; 319; 332; 338; 340; 344; 350; 352; 356; 359; 370; 377; 386;393; 404; 407; 409; 417; 430; 434; 452; 461; 506; 518; 520; 527; 539; 543; 548; 550; 559; 564; 567; 583; 589; 592; 597; 694; 702; 708; 708; 730; 736; 746; 757; 762; 764; 769; 775; 785; 791; 799; 805; 810; 818; 823; 831; 836; 848; 866; 873; 888; 903; 909; 922; 931; 932; 941
113.9		280; 284
116	Efekti Juridik i Vendimeve	76; 98; 304; 516; 873

KAPITULLI IX

MARRËDHËNIET EKONOMIKE

119	Parimet e përgjithshme	43; 47; 48; 251; 253; 260; 263
121	Prona	251; 253; 361; 367; 369; 402; 406

KAPITULLI X

QEVERISJA LOKALE DHE ORGANIZIMI TERRITORIAL

123	Parimet e përgjithshme	894
124	Organizimi dhe Funksionimi i Qeverisjes Lokale	894

KAPITULLI XI

SEKTORI I SIGURISË

KAPITULLI XII

INSTITUCIONET E PAVARURA

KAPITULLI XIII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

144 Amendamentimi 283

KAPITULLI XIV

DISPOZITAT KALIMTARE